Bujar Leskaj

Brenda dhe Jashtë... Parlamentit
maj 2007 - maj 2009

Në këtë libër janë përfshirë diskutime në Kuvendin e Shqipërisë në periudhën maj 2007-maj 2009, prononcime të ndryshme të autorit, në cilësinë e deputetit të Vlorës 2005-2009 (si përfaqësues i Partisë Demokratike) dhe veprimtari të zhvilluara në Vlorë gjatë kësaj periudhe.
(Dy nga katër vite jetë parlamentare)

Bujar Leskaj

Brenda dhe Jashtë...
Parlamentit

maj 2007 - maj 2009

Tiranë, 2009

Redaktor	Gëzim Llojdia Harilla Koçi
Design & Layout	Grafika Elzana
Kopertina:	Ziso Kamberaj
Shtypshkronja	GEER

© Insituti Studimeve Politike “Ismail Qemali”, Autori

Botoi: Shtëpia Botuese GEER

ISBN 978-99956-33-98-1

Tiranë 2009

Pasqyra e Lëndës

Në vend të hyrjes – Intervistë e gushtit 2008 11

KREU I
DISKUTIME NË SEANCAT PLENARE TË KUVENDIT 15
I.1. Vizioni për industrinë numër një të Shqipërisë, Turizmin (Mbi projektligjin "Për Turizmin") 15
I.2. Sfidat e arsimit të lartë. (Mbi projektligjin "Për arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë") 20
I.3. Ati i madh - NDERI I KOMBIT 25
I.4. Jo provokacioneve politike ndaj VLORËS 29
I.5. Dëmshpërblimi i ish të përndjekurve politikë – Detyrim ligjor Kushtetues (Mbi projektligjin "Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist") 34
I.6. Viti 2008, Viti i investimeve publike në Shqipëri (Mbi projektligjin "Për buxhetin e shtetit të vitit 2008") 40
I.7. Huamarrja e Qeverisjes Vendore – Oportunitet zhvillimi (Mbi projektligjin "Për huamarrjen e qeverisjes vendore") 46
I.8. Ndërtimi i rrugës Transballkanike në Vlorë kërkon edhe Shpronësim korrekt të qytetarëve 54
I.9. Administrim ligjor dhe me efikasitet i fondeve dhe i pasurive publike (Mbi projektligjin "Për ankandin publik") 56
I.10. Për një treg funksional të titujve financiarë (Mbi projektligjin "Për titujt") 59
I.11. Një ligj bashkëkohor i së drejtës (Mbi projektligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare") 64
I.12. Banka e Shqipërisë, Institucionet Financiare dhe shërbimet e produktet bankare (Mbi Raportin Vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 2007) 70
I. 13. Nxitës dhe avokat i konkurrencës (Mbi raportin vjetor të Autoritetit të Konkurrencës) 76
I.14. Imuniteti i deputetit?! - Një nen i vetëm 79
I.15. Thellimi i reformave fiskale përmes konsolidimit të Sistemit Tatimor (Mbi projektligjin "Për procedurat

tatimore në Republikën e Shqipërisë") 83
I.16. Pasojat në ekonomi dhe lufta për parandalimin e pastrimit të parave (Mbi Projektligjin "Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe të Financimit të Terrorizmit") 89
I.17. Të marrim pjesë në marshimin kulturor kombëtar në Qafë – Botë 93
I.18. Menaxhim efektiv e bashkëkohor i sistemit buxhetor (Mbi projektligjin "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH") 95
I.19. Për standarde emancipuese të politikës (Mbi projektligjin "Për barazinë gjinore në shoqëri") 101
I.20. Poetët dëshmorë në Altarin e Kombit 104
I.21. Një falje fiskale në dobi të të gjithëve 107
I.22. Mbi privatizimin e ARMO –s 111
I.23. Një letër kredeciale e sigurt 114
I.24. Prokuroria duhet të depolitizohet 117
I.25. Çertifikimi i buxhetit 2007 - Seriozitet i Qeverisë (Mbi projektligjin "Për miratimin e buxhetit faktik të shtetit të vitit 2007") 120
I.26. Çertifikimi arritjesh dhe detyrat për të ardhmen 123
I.27. Avokatura e Shtetit – Institucion në mbrojtje të interesave publike (Mbi projektligjin "Për avokaturën e shtetit") 127
I.28. Buxheti i kontinuitetit dhe stabilitetit makroekonomik Mbi projektligjin "Për buxhetin e shtetit të vitit 2009") 131
1.29. Pakti, 7 kompani zotërojnë 86 % të tregut të naftës 137
I.30. Nevoja për mesazhe të qarta të Bankës së Shqipërisë (Ndryshime në ligjin nr 9630, "Për faktoringun") 142
I.31. Forcimi i shtetit demokratik përmes lustracionit (Mbi projektligjin "Për pastërtinë e figurave të zyrtarëve të lartë të administratës dhe të të zgjedhurve") 148
I.32. Ratifikimi i marrëveshjeve ndërmjet Qeverisë dhe Komuniteteve Fetare 154
I.33. Një demokraci pa kujtesë, e sheh veten në vuajtje 157
I.34. Reforma rregullatore e regjistrimit dhe licencimit të biznesit (Mbi projektligjin "Për licencat, autorizimet dhe lejet në RSH") 160
I.35. Porti i Shëngjinit – Porti i integrimeve shqiptare 165
I.36. Shoqëria civile dhe mbështetja e saj nga qeveria (Mbi projektligjin "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për mbështetjen e Shoqërisë civile") 169

I.37. Pallati i Kulturës – tërësisht për Bibliotekën Kombëtare dhe Teatrin e Operës
(Ndryshime në ligjin "Për kthimin dhe kompensimin e pronës") 173
I.38. Të shpejtohen ritmet e dëmshpërblimit të ish të përndjekurve politikë
(Ndryshime në ligjin "Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve nga regjimi komunist") 177
I.39. Të jemi seriozë me historinë 181
I.40. Rritje e ndjeshme e nivelit të sigurimit bankar
(Ndryshime në ligjin "Për sigurimin e depozitave") 183
I.41. Privatizim, Efiçencë dhe Transparencë në tregun e Energjisë 187

Intermexo I **192**
Shënime mbi romanin ABSURDI i autorit Koço Kosta 192

KREU II **199**
DISKUTIME NË GRUPIN PARLAMENTAR TË PD-së, SHKRIME, INTERVISTA DHE KOMENTE TE MEDIAS RRETH TYRE **199**
II.1. Refleksion politik mbi një datë që nuk duhej harruar! 199
II.2. Nuk kam inate me Berishën 203
II.3. Me Berishën takohemi në shtator 207
II.4. Dëmshpërblimi i ish të përndjekurve politikë 213
II.4.1. Të rishikohet ligji për të përndjekurit 213
II.4.2. Ish të përndjekurit: Bien kërkesat e Leskajt 213
II.4.3.Të përndjekurit, sherr PR-PD 214
II.4.4. Shpresoj ende te PD 215
II.4.5. Nuk ka faturë që dëmshpërblen të përndjekurit 215
II.5. Hapja e dosjeve të politikanëve e domosdoshme 217
II.6. Berisha t'i kalojë në skaner gjithë zyrtarët e lartë 219
II.7. Pengu im që nuk pastrova FSHF-në 222
II.8. Imazhi Shqiptar i Politikanit të Ri 223
II.9. Ligji i Gjobave ndez debatin në kuvend 225
II.10. Përgjegjësi e njëjtë për të gjithë 226
II.11. Mbi ndryshimet në Kushtetutë 231
II.12. Kushtetuta, PD merr votat e aleatëve 233
II.13. Këtë radhë do të jem i kujdesshëm në votim 235
II.14. Turi "Shqipëria në NATO" – Test elektoral 237
II.15. Ish-të përndjekurit politik të futen në administratë 238
II.16. Jo mocionit ndaj kryetares Topalli 239
II.17. Zgjedhjet, PS-PD marrin veton 241

II.18. Potenciali i Industrisë së Turizmit dhe impakti në ekonominë e Vlorës 243
II.18.1. MSA-ja, Standardet e BE-së dhe Kuadri Ligjor në Shqipëri për Turizmin 243
II.18.2. Turizmi në Vlorë, E Sotmja dhe E Ardhmja 245
II.18.3. Planifikimi i Qëndrueshëm dhe Axhenda 21 247
II.19. Ministrat me dosje të largohen me turp 249
II.20. I papranueshëm ultimatumi i Godos 250
II.21. Skandali, Universitetit të Vlorës tentohet t'i hiqet emri "Ismail Qemali" 256
II.22. Maxhoranca konfirmohet pa PDK 258
II.23. Ndryshime në Komisionin e Ligjeve 259
II.24. Falja e gjobave 259
II.25. Raporti i KLSH ndez debatin në Komisionin e Ekonomisë 260
II.26. Aleatët, jo në listën e PD-së 261
II.27. Koalicion i përbashkët me lista të veçanta 263
II.28. Ina Rama të heqë Shtyllën 266
II.28.1. Sollaku depolitizoi Prokurorinë 266
II.28.2. Fushata e shpifjeve, sepse enverisët nuk e pranojnë dot qeverisjen e Berishës 267
II.28.3. Një mesazh në postën elektronike 268
II.29. Paratë e privatizimeve, 20 % për ish të përndjekurit 270
II.30. 8 Dhjetori, Dita e Rinisë, Dita e Lirisë 271
II.31. "Ligji i spiunëve" i vonuar 273
II.32. Deputetët: Të shkarkohet Bollano 275
II.33. Abstenim mbi një marrëveshje 276
II.34. Si do të zhvillohet ekonomia shqiptare gjatë 2009-ës 277
II.35. Republika e Kosovës - Burim stabiliteti rajonal dhe krenarie kombëtare 280
II.36. Ligji i ekspertëve kontabël 283

Intermexo II **285**
Mirushi dhe Muhameti i tij 285

KREU III
VEPRIMTARI KULTURORE-POLITIKE TË ZHVILLUARA NË VLORË, NËN KUJDESIN DHE MBËSHTETJEN E DEPUTETIT **290**
III.1. Deputeti Bujar Leskaj promovon vitin kulturor – Vlora, ne dhe shkrimtarët 290
III.2. Sesion shkencor në Vlorë mbi marrëdhëniet Shqiptaro-Amerikane 292

III.3. Në ditën ndërkombëtare të dhurimit të gjakut. 294
III.4. Inteligjenca vlonjate kërkon ridimensionimin e figurës së Eqerem bej Vlorës, intelektual i madh dhe burrë shteti i shquar 296
III.5. "Lufta Civile në Shqipëri 1943-1945" e Uran Butkës, kalon testin e publikut vlonjat 298
III.6. Historiku i Vlorës në librin e Enver Memishës 300
III.7. Zona 94 në epiqëndër të vëmëndjes time 302
III.8. Leskaj u premton mbështetje grave të Transballkanikes 304
III.9. Deputeti që i gjendet Vlorës çdo ditë 305
III.10. Këshilli i Bashkisë Vlorë miraton propozimin e deputetit Bujar Leskaj për vendosjen e busteve të kryetarëve të Bashkisë Vlorë për periudhën 1912-1939, në lulishten e Sheshit të Flamurit. 307
III.11. Solidarizim me dhimbjen e banorëve të Gërdecit 309
III.12. Ago Agaj, burrë shteti dhe intelektual i shquar 310
III.13. Çamëria – pengu dhe malli ynë. 312
Në Qafë-Botë shkova si përfaqësues i Vlorës 312
III.14. Profil - Një ditë në zyrën e deputetit, Bujar Leskaj 316
III.15. Përkujtohet Klubi i Shqiptarëve "Labëria", në 100 vjetorin e krijimit të tij 318
III.16. Vlora dhe Bujar Leskaj, nderojnë 13 krijues vlonjatë për vitin 2008 320
III.17. Përurimi i librit të shkrimtares Vilhelma Vranari 322
III.18. Pritje zyrtare me rastin e 28 Nëntorit 323
III.19. Festimi me 300 të rinj nga Vlora, i Ditës së Rinisë 324
III.20. Një shembull që vlen të nderohet 325
III.21. Konferenca e VII studentore mbi Ekonominë 327
III.22. Konferencë shkencore "Ismail Qemali dhe Identiteti i shqiptarëve" 329
III.23. 200 libra për Gjimnazin Publik "Halim Xhelo" 331
III.24. Promovimi i librit "Rezervati i derrave të egër" 333
III.25. Më i votuari në sondazhin e medias vendore në Vlorë 334
III.26. Vlora zhvillon sesionin shkencor "Shqipëria në NATO" 336
III.27. Libra dhuratë për gjimnazin "Ali Asllani" në luginën e Shushicës 339
III.28. Promovimi i librit "Përfaqësuesit e Vlorës në Kuvendin e Shqipërisë, 1912-2009" 342

Intermexo III **346**
Ese e Dr. Rugovës "Pavarësia Kombëtare" e shkruar në vitin 1968 346

KREU IV
VEPRIMTARI PËR KOSOVËN DHE NË KOSOVË **348**
Poem kosovar (nga Mitrush Kuteli) 348

IV.1. 17 Shkurti 2008 do të shënohet përkrah 28 Nëntorit 1912 348
IV.2. Vizita në Kosovë e gazetarëve vlonjatë 350
IV.3. Kryeministri, Hashim Thaçi, vlerëson deputetin Bujar Leskaj për vizitën e gazetarëve në Kosovë 351
IV.4. Lutfi Haziri: Ura Bashkëpunimi 352
IV.5. Takim me akademikun Rexhep Ferri 352
IV.6. Në Prekaz, tek shtëpia e nipit të Adem Jasharit 353
IV.7. Vizita në institucione kulturore në Prishtinë 356
IV.8. Një udhëtim i paharruar me deputetin Bujar Leskaj, në trojet shqiptare 357
IV.9. Në Tetovë rrëzë Malit të Sharrit 358
IV10. Takim me personalitetin e shquar z. Arbën Xhaferri 359
IV.11. Në Shpellën e Mermerit të Gadimes së Ferizajt 361
IV.12. Homazhe në varrin e Rugovës 362
IV.13. Vizitë në Galerinë e Arteve Prishtinë 363
IV.14. Takim i vlonjatëve me akademikun Rexhep Ferri 364
IV.15. Në Prekaz të Skënderajt, në vendin ku edhe burrat derdhin lot 367
IV.16. Në Gjakovën e Astrit Haraçisë 370
IV.17. Në Prizren, vendi i lidhjes së besës shqiptare 373
IV.18. Aorta e kombit, Rruga Durrës-Kukës-Morinë-Prishtinë 375
IV.19. Memento për Rugovën 376
IV.20. Kosova-Shtet i pavarur 377

Në vend të mbylljes - Libri i dashurisë për Vlorën **379**

Dedikim 387

Treguesi i lëndës 388

Në vend të hyrjes – Intervistë e gushtit 2008

Këtë botim, (pjesë nga diskutimet në Kuvendin e Shqipërisë, Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike, shkrime, intervista dhe veprimtari politike e kulturore të zhvilluara në Vlorë, në periudhën maj 2007 - maj 2009), e shikoj si pjesë e një veprimtarie, për t'u gjykuar, e vlerësuar nga bashkëqytetarët e mi (të cilët më dhanë besimin e madh për ti përfaqësuar në Legjislaturën XVII të Kuvendit në periudhën shtator 2005 – shtator 2009), dhe më gjerë nga studentë të shkencave juridike, politike, ekonomike dhe opinioni publik. Në vend të hyrjes kam zgjedhur një intervistë të zhvilluar në gusht të vitit 2008, për vetë tematikën dhe problematikën që trajton mbi veprimtarinë legjislative të Kuvendit të Shqipërisë. Gjatë Legjislaturës së XVII, 2005-2009 veprimtaria legjislative e Kuvendit të Shqipërisë, është zhvilluar në sinkron me reformat e ndërmarra të Qeverisë Shqiptare duke e shndërruar Kuvendin e Shqipërisë në institucionin më të rëndësishëm të jetës politike në vend. Funksioni legjislativ i realizuar më së miri nga ky Kuvend është në përputhje të plotë me Kushtetutën e Shqipërisë, në mbështetje të ekzekutivit dhe produktet e tij, ligjet, rezolutat, ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian drejt konsolidimit të shtetit të së drejtës.

Intervista në Televizionin Ora News, 1 gusht 2008

Gazetari: Z. Leskaj si e shikoni veprimtarinë e këtij sesioni parlamentar?

B.L. Edhe ky sesion parlamentar tregoi atë që tashmë është ravijëzuar qartë, Kuvendi i Shqipërisë (Parlamenti Shqiptar) po kthehet në institucionin publik kryesor të jetës politike në Shqipëri. Varet këndvështrimi nga shihet puna e institucionit të Parlamentit, por në përgjithësi duhet pranuar, që puna e Parlamentit ka qenë sinkron, pra grupi i mazhorancës ka ditur të finalizojë përpjekjet

dhe ambiciet e qeverisë me detyrimet ligjore, kushtetuese për të dhënë një numër të madh ligjesh, të përgatitura nga qeveria dhe të konsultuara në Kuvend, apo edhe nga grupet e interesit. Nga ana tjetër edhe interpelancat e ndryshme të realizuara me ministrat, diskutimet jashtë rendit të ditës në seancën një-orëshe, apo raportimet e institucioneve të pavarura japin një fizionomi të plotë të punës së Kuvendit. Veprimtaria e kësaj legjislature e parlamentarëve shqiptarë tregon më së miri se politika jonë po shkon drejt asaj që nuk pajtohet me konceptin elitarist që do të thotë se ka disa mendje të zgjuara dhe të tjerët vërtiten rreth tyre, por as me konceptin egalitarist në bazë të cilit Parlamenti është vendi ku kushdo mund të shkojë dhe të përfaqësohet. Parlamenti si çdo vend ku konkurrenca shfaqet dukshëm, në radhë të parë në bindje, ide politike, mes partive politike, grupimeve të ndryshme të organizuara në parti apo grupe parlamentare dhe mes deputetëve të rinj apo atyre që janë në parlament për herë të dytë apo të tretë nga ana tjetër. Në këtë koncept një sy i vëmendshëm gazetari, opinionisti dhe qytetari di të bëjë dallimin në punën e deputetëve të veçantë.

Gazetari: Cili është roli i opozitës në Kuvend?

B.L. Fjalia standard që thotë një deputet i mazhorancës për rolin e opozitës tashmë dihet dhe unë edhe të dua nuk i shpëtoj dot, por tek opozita, veprimtaria e saj, duhen dalluar dy momente. Së pari: opozita duhet përgëzuar për atë pjesëmarrje, për atë mirëkuptim, konsensus që ka dhënë në disa projektligje të rëndësishme, veçanërisht për reformën në drejtësi, sistemin e ri zgjedhor, kur ka ndërmarrë nisma për interpelanca dhe ka bërë objeksione konstruktive, por duhet pranuar e theksuar që opozita socialiste në Kuvendin e Shqipërisë nuk po di të shkëputet nga ajo traditë e prodhuar në 17 vjet nga politika, pra që ta shikojë me syze të errëta çdo nismë të qeverisë. Në këtë kontekst opozita shqiptare është shoqëruar disa herë nga qëndrime agresive dhe të papajtueshme jo vetëm me kornizën parlamentare por edhe më gjerë duke harruar me vetëdije faktin e thjeshtë e të rëndësishëm që më shumë se për sherret tona të pabukë, pa protagonizëm, pa përmbajtje që merren me emra të veçantë të familjarëve të mazhorancës, politika shqiptare ka nevojë të debatojë për ide, zgjidhje problemesh ekonomike, shoqërore që shtron koha dhe zhvillimet në Shqipëri, të cilat duhet të shkojnë në dobi të qytetarit e vendit. Nuk është në atributet e mia si deputet i PD dhe Vlorës të bëj vlerësimin për opozitën, skanerin e saj, sepse përpos të tjerash unë i qëndroj mendimit se për çdo parlament opozita është një vlerë e pazëvendësueshme

për parlamentarizmin, pavarësisht devijimeve jo demokratike në momente të caktuara, apo provokimeve të rënda kundrejt shumicës dhe Qeverisë që shpesh herë opozita socialiste realizon, si haraç, taksë që socialistët i paguajnë të kaluarës së tyre.

Gazetari: Roli i mazhorancës në Kuvend ?

B.L. Unë i takoj atij grupi deputetësh që duke vlerësuar dhe inkurajuar me realizëm arritjet e qeverisë që nuk mund ti mohojë njeri, jam intrasigjent, jam kërkues për ato detyra që nuk u realizuan këtë fazë të punimeve të Kuvendit. Kështu ne të gjithë duhet të jemi të shqetësuar se reforma zgjedhore dhe reforma në drejtësi kanë ngelur në vend dhe nuk po realizohen në atë kohë dhe afat që kishim caktuar. Dhe padyshim kjo duhet të na bënte neve të nxitonim për ta mbyllur deri në shtator për tu lënë kohë institucioneve të tjera të gjyqësorit apo KQZ-së dhe formulave partiake të ndërtojnë strategjinë e tyre që rrjedhin nga Kodi Zgjedhor apo ligji për gjyqësorin. Nga ana tjetër janë dy projektligje të cilat ne kemi gati 2 vjet, që i zvarrisim dhe unë mendoj se nuk nderojnë asnjë deputet të shumicës apo opozitës, të pa verifikuar apo "të verifikuar" dy herë. Konkretisht janë ligjet për kufizimin e imunitetit të të zgjedhurve kryesisht të deputetëve dhe e dyta për verifikimin e figurës, pastërtinë e saj apo siç njihet Ligji i Lustracionit. Dy projektligje që janë nevojë objektive e zhvillimeve të shoqërisë shqiptare dhe e detyrimeve ndërkombëtare dhe e krejt këtij ambienti shoqëror politik që mbizotëron sot në botë dhe që ne si mazhorancë dhe opozitë duhet të realizojmë për vendin tonë. Personalisht mendoj se grupi i PD-së duhet të jetë i vëmendshëm dhe të mos lejojë që kjo lojë jo e ndershme e PS ti kalojë këto ligje në kalendat greke apo ti kalojë të marrin formë ligjore në një kohë kur të mos kenë mundësi të implementohen. Është e rëndësishme që këto 2 projektligje të kalojnë brenda sesionit vijues të kësaj legjislature dhe në atë kohë që të kenë mundësi implementimi pasi është një nga kërkesat që shtron koha dhe zhvillimet politike. Vetë Kuvendi si institucion publik po karakterizohet nga ato parime të një legjislativi të mirë për të realizuar atë që kërkon shoqëria shqiptare dhe përmbush pesë kolonat kryesore: transparencë, përgjegjshmëri, pjesëmarrje, efikasitet dhe koherencë veprimesh. Janë këto pesë parime që sikurse karakterizojnë një qeverisje të mirë, duhet të karakterizojnë dhe një legjislaturë të mirë dhe ne mund të pohojmë se përgjithësisht janë ravijëzuar dhe kanë karakterizuar punën e Kuvendit të Shqipërisë në këtë legjislaturë. Kuptohet që ka nevojë për perfeksionim dhe shtohen kërkesat që plotësohen nga muaji në muaj. Kuptohet që këto probleme që unë i përmenda më sipër, janë katër mosarritje që duhet të na bëjnë të shqetësohemi, të mendojmë pavarësisht se jemi deputet të

opozitës apo mazhorancës që në tërësi nuk kemi qenë të suksesshëm në këtë sesion pavarësisht arritjeve që nuk mund të mohohen, një morie ligjesh të miratuara në sinkron me detyrimet integruese të vendit në BE, përfshirë këtu edhe ndryshimet në aktet normative, interpelancat, veprimtaritë në komisionet parlamentare e më gjerë.

Gazetari : Mendimi juaj për tentativën e opozitës për mocion ndaj Kryetares së Kuvendit?

B.L. Veprimi i opozitës që sa herë ka kriza brenda vetes përpiqet ta transferojë këtë në parlament, apo sa herë ka probleme të papërballueshme me produktin e punës së qeverisë përpiqet që sulmin politik opozitar ta kalojë tek Kryetarja e Kuvendit, në optikën time nuk më duket veprim i moralshëm nga ana politike, për më tepër veprim provokativ në aspektin legjislativ për ne si deputet. Ashtu si Kuvendi i Shqipërisë në këto tre vjet ka rritur peshën specifike në jetën politike të Shqipërisë duke dalë në atë rol që ia jep dhe kërkon Kushtetuta e Shqiperisë në institucionin kryesor legjislativ e politik, ashtu si çdo deputet ka rritur peshën e vet politike, të gjithë ne, duhet të pranojmë që edhe Kryetarja e Kuvendit ka arritur që falë punës së vet, përpjekjeve të pareshtura , ideve të veta politike dhe krejt përmbajtjes politike të saj, zonës dhe shtresës që përfaqëson që në përputhje me programin politik të PD-së, të Qeverisë Berisha të shfaqet në një rol të ri më të plotë, më përfaqësues e integralisht konform kornizave të Kushtetutës, ligjeve në fuqi dhe rregullores së Kuvendit të Shqipërisë. Në këtë suazë nisma e opozitës është e pakuptimtë dhe si nismat e tjera kundër Kryetares do të dështojë. Znj. Topalli gëzon mbështetjen e plotë jo vetëm të PD-së dhe grupit të saj parlamentar por edhe të deputetëve të tjerë të djathtë dhe të qendrës. Dhe unë mendoj se në veçanti deputetët e vjetër duhet t'i njohin atë rol dhe duhet ta vlerësojnë e respektojnë Kryetaren e Kuvendit se diti të zhvilloj dhe ta implementoj teorinë e diplomacisë parlamentare duke i dhënë peshën e vet, rëndësinë e vet Kuvendit, legjislaturës dhe në probleme të tjera madhore siç janë ambicia që ne kemi për anëtarësim në BE , në këtë kuadër ratifikimi i MSA nga parlamentet e vendeve evropiane apo siç pritet ratifikimi i marrëveshjes për hyrjen në NATO si dhe diplomacia në rajonin e Evropës Juglindore, në veçanti në vendet e Ballkanit duke konfirmuar atë fakt të pamohueshëm e të suksesshëm për të gjithë ne që Shqipëria është vend stabël që prodhon dhe eksporton stabilitet dhe në vendet e rajonit.

Intervistoi: Edlira Prenga

Kreu i parë

Diskutime në seancat plenare të Kuvendit

I.1. Vizioni për industrinë numër një të Shqipërisë, Turizmin

Diskutimi në seancë plenare mbi Projektligjin "Për Turizmin".

Tiranë, datë 14.05.2007

Në fakt është për të ardhur keq që këto kohët e fundit grupin e opozitës po e dominon niveli i ulët intelektual edhe në problemet teknike derisa edhe në këtë diskutim parlamentar për një projektligj për turizmin, në një grup në të cilin ka mbi tre-katër ish-ministra të turizmit flet një agronom nga Belshi (megjithatë, kjo është punë e Grupit të Partisë Socialiste), që ndërton diskutimin e tij pa kuptim, vendos tullën e parë gabim deri në fund të diskutimit. Ky projektligj, i dashur shoku agronom, nuk është përgatitur në bashkëpunim me Bankën Botërore, por është përgatitur në bashkëpunim me Organizatën Botërore të Turizmit, e cila quhet ose njihet ndryshe, ta dish për kulturë, si FMN-ja e turizmit në botë. Ky projektligj ka tetë- nëntë muaj që diskutohet me grupin e interesit, nën drejtimin e një eksperti në fushën e turizmit, jo në fushën e grabitjes së tokave, në fshat apo në qytet, në Golem apo ku i keni bërë ju tash 8 vjet, por ekspert në industrinë e turizmit, duke asistuar me ndihmën, njohuritë e tij për këtë ligj edhe në Shqipëri ashtu siç ka ndihmuar në 66 vende të botës. Megjithatë, ne të gjithë, aktorët dhe faktorët e turizmit në vend, operatorët e turizmit, biznesi privat, njësitë shtetërore, njësitë publike, deri dhe ministria, ishim të ndërgjegjshëm, për atë që ligji i turizmit, i cili datonte në vitin 1993, kishte një sërë mangësish dhe kishte nevojë për ndryshime.

Pikërisht, rrjedhojë e një pune gjithëpërfshirëse ishte që ky projektligj është paraqitur, për hir të së vërtetës, në nëntor 2006 nga ministria përgjegjëse për politikat e turizmit në ministritë e linjës.

Pas një sërë diskutimesh, konsultimesh ose marrjesh mendimi të grupeve të interesit, ka kaluar më 23 janar në Këshillin e Ministrave, për të vazhduar me tej në Kuvendin e Shqipërisë. Natyrisht, unë si deputet i këtij Parlamenti, ish-ministër i i Turizmit vlerësoj punën e të gjithë kolegëve anëtarë të Komisionit të Veprimtarive Prodhuese, ndihmesën që ata dhe ne të gjithë dhamë për këtë projektligj, projektligj i cili duhet të kuptohet që mundëson zgjidhjen e dy çështjeve madhore që shtrohen përpara zhvillimit të këtij sektori: rregullimin ligjor të tij, licencimin, kategorizimin, kontrollin dhe monitorimin e përhershëm, sigurimin e statistikave të besueshme për vendimmarrje, si dhe një program të qartë e gjithëkombëtar për zhvillimin me përparësi të turizmit. Organizata Botërore e Turizmit dhe Ministria e Turizmit kanë ofruar, pa dyshim edhe Parlamenti, edhe komisioni, meqenëse ju e sollët një variant të komisionit, një kuadër të ri licencimi për sektorin e turizmit. Ky është një shans i mirë për të krijuar një sistem certifikimi modern, transparent dhe efikas. Sistemi do të aplikohet jo vetëm për operatorët e udhëtimit, por edhe për krejt operatorët turistikë në vend. Qëllimi kryesor i sistemit të licencimit është të ruajë standardet profesionale, nga mungesa e të cilave vuan sistemi ynë i sotëm. Megjithatë, ky sistem nuk duhet të jetë aq burokratik sa të frenojë anëtarët e rinj në sektor ose të irritojë në një farë kuptimi ata që tashmë janë të përfshirë.

Procesi i marrjes së një certifikate ose licence duhet dhe besoj se do të jetë sa më i thjeshtë dhe transparent që të jetë e mundur. Përbërësit bazë të sigurimit të cilësisë në industrinë e udhëtimit dhe të turizmit janë regjistrimi dhe licencimi. Këtu duhen standarde minimale që në fillim, në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e konsumatorit. Regjistrimi është thjesht një detyrë për t'u regjistruar tek autoriteti kompetent dhe zakonisht për të paguar një tarifë që do të ndihmojë për të paguar monitorimin dhe inspektimin. Licencimi të jetë ose të ndalojë autoritetin për t'u futur në një treg ose profesion të caktuar. Ligji i ri, gjithashtu, mundëson që së shpejti Shqipëria të jetë vendi me sisteme të shëndosha auditimi dhe inspektimi për turizmin. Ato do të sigurojnë profesionalizëm, vijimësi dhe do të mbrojnë dhe nxisin imazhin e turizmit shqiptar. Kështu mënjanohen rreziqet e deformimeve, qoftë turizmi seksual apo edhe investimet e parave të pista në turizëm. Qëllimi është që të rriten standardet e përgjithshme të turizmit në vend në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Zyra Kombëtare e Asistencës së Turistëve është një strukturë e re, e cila do të mundësojë zbatimin e ligjit, është një strukturë e re, e cila do t'u japë mbrojtjen e duhur ligjore turistëve të huaj te ne dhe, njëherazi, është një garanci për të gjithë investitorët e huaj që dëshirojnë të investojnë në turizëm.

Kurse Agjencia Kombëtare e Zhvillimit të Turizmit do të realizojë bashkëpunimin efikas mes Qeverisë dhe qeverive vendore, OJF-ve lokale dhe biznesit turistik, qoftë ky i huaj apo vendas. Në tërësi, me miratimin e këtij projektligji për turizmin dhe nisjen e menjëhershme për zbatimin e tij, çka është më e rëndësishme, si tek të gjitha ligjet, pa dyshim ne do të vazhdojmë të ecim në atë rrugë që gradualisht turizmi jo vetëm të kthehet në një industri të qëndrueshme, por të kthehet edhe në industrinë e parë të vendit. Duke falënderuar me sinqeritetin më të madh ndihmesën që kanë dhënë të gjithë anëtarët e Komisionit të Veprimtarive Prodhuese, duke falënderuar të gjithë ata aktorë apo faktorë, që operojnë në fushën e turizmit shqiptar, unë do të dëshiroja që, për sa u përket fondeve për promovimin e turizmit, ndoshta edhe komisioni të ishte përpjekur të lobonte më shumë, ndoshta mund të arrijmë këtu në Kuvend një shtesë tek neni, Fondi i Zhvillimit të Turizmit, që unë mendoj ta paraqes në formë amendamenti e cila, është e rëndësishme për industrinë turistike shqiptare për tu shfaqur sa më kompetitive në rajon, që ne, në mënyrë eksplicite, të përcaktojmë në këtë ligj si një zë të veçantë, fondin për zhvillimin promocional të turizmit shqiptar.

Shënim 1: *Projektligji, i miratuar në Këshillin e Ministrave në datën 23/01/2007 dhe i shqyrtuar në 14.05.2007 në Kuvend u miratua me 80 vota pro, 1 kundër, 1 abstenim.* ***Ligji nr. 9734, datë 14.05.2007 "Për turizmin",*** *synon të ndihmojë konkretisht zhvillimin e industrisë turistike, në përputhje me drejtimet strategjike të zhvillimit të turizmit, duke u dhënë përparësi burimeve të trashëgimisë, kulturore dhe natyrore. Ai përcakton parimet dhe rregullat që veprojnë në fushën e turizmit, si dhe vendos dhe zhvillon standarde të shërbimeve turistike dhe shërbimeve të tjera të lidhura me të.*

Shënim 2: *Në respekt të punës dhe veprimtarisë së bashkëpunëtorëve të mi në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, të cilën pata nderin ta drejtoj shtator 2005-mars 2007, kohë gjatë së cilës u ideua dhe u përgatit ky projektligj për tu dërguar në fillim të muajit shkurt 2007 në Kuvendin e Shqipërisë, po jap më poshtë një përshëndetje timen në këtë periudhë, në cilësinë e Ministrit përgjegjës për politikat e turizmit në takim me përfaqësuesit e industrisë së turizmit në vend.*

Vizioni për industrinë numër një të Shqipërisë, Turizmin

Projektligji i ri "Për turizmin", i miratuar nga Këshilli i Ministrave në mbledhjen e tij të datës 23 janar 2007, ofron në mënyrë

cilësore dhe në përputhje të plotë me standardet dhe direktivat e Bashkimit Evropian, rregullimin e sektorit dhe mbulimin e një sërë aspekteve të patrajtuara nga ligji ekzistues i vitit 1993. Vizioni dhe interesi themelor në përgatitjen e këtij drafti është fuqia e tij për të ndihmuar konkretisht zhvillimin e industrisë turistike në përputhje me drejtimet strategjike të zhvillimit të turizmit tonë, duke priorizuar dhe harmonizuar resurset natyrore me trashëgiminë kulturore. Ambicia jonë është që të shndërrojmë turizmin në industrinë e parë të vendit (ai aktualisht zë vendin e dytë, pas ndërtimit) dhe në një sektor që punëson rininë shqiptare, si dhe hap vende pune për zonat rurale të vendit. Në raport me ligjin ekzistues të 14 viteve më parë, i cili përbën një ligj specifik në drejtim të identifikimit të zonave me prioritet zhvillimin e turizmit dhe dhënien e lehtësirave fiskale për biznese të zhvilluara brenda tyre jashtë skemave të kontrollit, projektligji i paraqitur, ofron avantazhe të konsiderueshme. Kështu, ai synon shfrytëzimin në të gjithë territorin e vendit të potencialeve natyrore dhe kulturore, në shërbim të zhvillimit të turizmit, si një oportunitet për ngritjen e nivelit ekonomik. Projektligji i sotëm ka një raport të natyrshëm e ndihmues me interesat e ruajtjes dhe miradministrimit të mjedisit shqiptar. Ai në thelb krijon mekanizma të dhënies së asistencës financiare për bizneset turistike, duke siguruar kontrollin e përdorimit të tyre, nëpërmjet hartimit të programeve të financimit dhe veprimit të strukturave përgjegjëse. Ne duam që turisti shqiptar dhe ai i huaj të vijë jo vetëm një herë në njësitë tona të pritjes turistike, por të bëhet klient i përhershëm. Për këtë projektligji jep parimet bazë për një zhvillim të qëndrueshëm të turizmit dhe krijon partneritete me grupet e interesit dhe njësitë e pushteteve vendore. Zhvillimi i turizmit nuk është vetëm një detyrë e përgjegjësi e qeverisë qendrore, por në radhë të parë ky zhvillim shkon në interesin e komuniteteve lokale dhe qeverive të tyre. Po ashtu biznesi lokal, OJF-të lokale dhe grupet e tjera të organizuara të komunitetit duhet të jenë në pararojë përsa i përket nismave turistike. Por për këtë subjektet që ushtrojnë veprimtari turistike dhe organet shtetërore duhet të kenë një raport shumë të qartë të detyrave reciproke dhe të përgjegjësive e të drejtave. Prandaj dhe ky projektligj merr përsipër të rregullojë marrëdhëniet ndërmjet institucioneve publike dhe subjekteve private, personave fizik e juridik, vendas apo të huaj, që ushtrojnë veprimtari turistike. Ai po ashtu përcakton të drejtat dhe detyrimet e subjekteve pjesëmarrëse në veprimtaritë turistike, në përputhje me standardet e vendosura dhe nga vet Bashkimi Evropian për këtë industri. Ne duhet ta kemi të qartë se nuk mund të zbatojmë si duhet MSA-në me BE-në në

turizëm, në rast se nuk vendosim në ligj kriteret e licencimit dhe kategorizimit të veprimtareve turistike, në të cilët duhet të përfshihen natyrshëm njësitë akomoduese (hotelet, motelet, kampet turistike, dhomat e shtëpitë që jepen me qira, etj), agjencitë e udhëtimit dhe të tureve e me radhë. Fuqia licencuese dhe kategorizuese e sanksionuar në ligj do të na japë mundësinë të zhvillojmë standardet që kërkohen në turizmin bashkëkohor, të realizojmë një ofertë turistike integrale të Shqipërisë, e cila të jetë konkurruese në rajon, si dhe të rrisim ndjeshëm dhe qëndrueshëm fluksin e turistëve të huaj. Në rast se njësitë tona akomoduese apo agjencitë e udhëtimeve, për shembull, nuk respektojnë kërkesat e kategorive të caktuara, të jemi të sigurt se turistët e huaj do të gabonin një herë duke ardhur tek ne, por pastaj nuk do të ktheheshin kurrë më duke bindur për këtë edhe shumë e shumë të tjerë farefis, miq apo të njohur të tyre. Prania e një zyre për dhënien e asistencës ndaj turistëve është një strukturë e mirëpritur nga turistët kudo në botë dhe kjo garantohet nga projektligji i ri. Ai do të mundësojë krijimin e një strukture embrionale të inspektoratit turistik (Zyra e Asistencës së Turistëve), me funksionin e dhënies së informacionit për turistët, trajtimin e ankesave dhe inspektimin e zbatimit të dispozitave ligjore. Nuk mund të lejojmë një gjendje amorfe apo kaotike të nivelit të shërbimeve turistike, sidomos të ofrimit të paketave turistike. Ky nivel nuk mundet thjesht të rregullohet nga konkurrenca në treg, por duhet ndërhyrë me autoritetin shtetëror për të mbrojtur konsumatorin e këtyre shërbimeve (turistin vendas dhe të huaj), në rast se ato rezultojnë jashtë cilësisë së deklaruar apo nënshkruar në kontratë. Projektligji po ashtu realizon sigurimin e përpunimit, transmetimit dhe vërtetësisë së të dhënave statistikore, të domosdoshme në procesin e planifikimit turistik dhe orientimin e politikave në këtë fushë. Pesha e strukturave shtetërore që do të kontrollojnë zbatimin e standardeve të shërbimeve turistike forcohet me këtë projektligj dhe një peshë e tillë është e nevojshme më shumë se kurrë për të mos lejuar riciklimin e parave të pista në turizëm apo shfrytëzimin e oportuniteteve turistike për zhvillim të trafiqeve të qenieve njerëzore. Së fundi, projektligji parashikon zhvillimin e zonave rurale, të mundshme për t'u kthyer në destinacione të formave të turizmit rural. Potenciali për turizmin me bazë natyrën dhe turizmin rural është i jashtëzakonshëm dhe shpresohet që me partneritetet që nxit projektligji "Për Turizmin" këto dy lloje aktivitetesh turistike të bëhen ndër dominueset në të ardhmen në industrinë turistike.

I.2. Sfidat e arsimit të lartë

Diskutimi në seancë plenare mbi projektligjin "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë"

Tiranë, datë 21.05.2007

Më mirë vonë se kurrë! Urtësia e popullit na ngushëllon për faktin që ky projektligj për arsimin e lartë vjen nga Qeveria jonë, Ministria e Arsimit me plot një vit vonesë. Vjen me plot një vit vonesë, duke bërë që në mënyrë të paligjshme, me një amendament të cunguar prej 14 marsit të vitit 2006, autoritetet dhe organet drejtuese të universiteteve të jenë të paligjshme. Duhet të pranojmë se programi i Qeverisë Berisha, në fushën e arsimit të lartë, mbetet tejet ambicioz dhe për t' u lavdëruar, për sa i përket rritjes së buxhetit për arsimin e lartë dhe për arsimin në përgjithësi, në raport me GDP-në, integrimit të mësimdhënies me kërkimin shkencor, rritjes së nivelit të autonomisë institucionale, universitare në të tre përbërësit e saj, strukturor, administrativ, financiar, përkrahja e universiteteve private pa lënë pas dore ato publike e të tjera.

Një koleg i nderuar, i opozitës këtu, natyrisht ne kemi një defekt, është defekt kombëtar, po edhe i këtij Parlamenti, që jemi me memorie pak të shkurtër, përmendi një sërë profesorësh të opozitës, ish-pozitës të tetë vjetëve, duke u përpjekur të na sugjestionojë me titujt e tyre, por harroi atë se ku e gjeti "Qeveria Berisha" arsimin e lartë, ku e latë ju pas tetë vjetësh në pushtet, harroi të thotë atë që të gjithë ministrat e Arsimit të qeverisjes socialiste të këtyre tetë vjetëve kanë pasur për këshilltarë ish-këshilltarin e shokut Manush Myftiu, dhe kanë mbajtur specialistë në Ministrinë e Arsimit drejtues të Shoqatës së Vullnetarëve të Enverit.

Do të dëshiroja dhe besoj që ministri ynë i ri nuk i ka këta këshilltarë dhe këta drejtues. Ne gjetëm arsimin e lartë me një ligj që po i shkatërronte universitetet, duke mos u garantuar autonomi. Ne e gjetëm me një qeverisje të universiteteve nga urdhri dhe jo nga ligji dhe me një Ministri Arsimi, organ vetëm administrativ, duke harruar funksionet e saj politik-bërëse.

Qeveria socialiste e para 3 korrikut 2005, i vuri vulën punës së saj me arsimin e lartë, me atë vendim qesharak të hapjes së tri universiteteve private në fund të mandatit të saj, në fund të korrikut 2005 si të hapte tri kopshte fëmijësh, me qëllimin e vetëm që të vazhdonin të thellonin kaosin në universitete, duke u fshehur pas Procesit të Bolonjës si pas "gjethes së fikut".

Megjithatë, ne të gjithë, dhe ju vetë jeni të ndërgjegjshëm dhe e pohuat këtu që tashmë ligji ekzistues është një ligj pengues, është një ligj që i rri ngushtë realitetit.

Duke vlerësuar pa asnjë paragjykim punën dhe përpjekjet pozitive të ministrit aktual të Arsimit, zotit Pollo (vërejtjet për të cilin i bëra në Grupin Parlamentar të PD), njëherazi vlerësoj vendimin politik të Partisë Demokratike në mbledhjen e grupit parlamentar të saj për të realizuar përmirësimet në projektligj, në përputhje në radhë të parë, me programin për arsimin e lartë të paraqitur në fushatën e 3 korrikut 2005 dhe si reflektim i vërejtjeve të bëra nga profesorati i nderuar, pedagogët e thjeshtë dhe studentët.

Anëtarët e maxhorancës në Komisionin e Edukimit, e në veçanti profesor Karapici, Vuksani, por edhe anëtarët e opozitës, si kryetarja Valentina Leskaj, ish-ministri Memushi, zoti Ulqini e të tjerë, ia dolën më së miri që në mënyrë të natyrshme, në mënyrë organike, të fusin apo të përmirësojnë nene të rëndësishme. Të gjithë ne këtu nuk duhet ta prishim atë frymë, që në këtë ligj të arsimit të lartë të jenë standardet bashkëkohore, ato që kërkon koha, që kërkon në thelb procesi i evropianizimit të universiteteve tona, në përputhje në radhë të parë me programin politik të Partisë Demokratike.

Heqja e neneve 95 dhe 96 të projektit të mëparshëm janë tregues i faktit që Partia Demokratike, Qeveria "Berisha" reflekton, synon funksionimin e universiteteve publike dhe jopublike shqiptare sipas standardeve perëndimore, duke stimuluar qeverisjen autonome, strukturore, administrative, financiare dhe demokratike të universiteteve mbi parimin e zgjedhjeve të drejtpërdrejta.

Heqja e nenit antikushtetues 95 eliminon çoroditjen që do të krijohej qysh me hyrjen në fuqi të ligjit, nëse ky nuk do të ankimohej në Gjykatën Kushtetuese. Ndërsa, heqja e nenit 96 vendos në themel të zgjedhjes së drejtuesve të universiteteve, jo seleksionimin me kritere të dyshimta, por efektivitetin e punë së tyre, që ballafaqohet tashmë me rregulla të ndryshme nga ato të mëparshmet dhe me një seleksionim që do të bëjë vota e stafeve dhe studentëve të universiteteve tona. Para se t'i shkojë mendja kujt sot, cilido qoftë ai, në pozitë apo në opozitë, që të numërojë mandatet apo vitet e drejtimit të autoriteteve drejtuese në

universitete, seksione, departamente, fakultete apo universitete, duhet **së pari** të gjykojë dhe të vendosë rregulla për të stimuluar efektivitetin e drejtimit, verifikimin e realizimit të programeve të shpallura përpara zgjedhjes, të transparencës dhe promocionit të realitetit, të funksionimit të universiteteve sipas standardeve të matshme dhe të krahasueshme me ato perëndimore. Modeli i Fakultetit të Ekonomisë të Universitetit të Tiranës i drejtuar me nivel pedagogjiko-administrativ e përkushtim të lartë nga dekani Prof. Dr. Dhori Kule, ku unë kam pasur nderin të jem pjesë e stafit të pedagogëve, duhet të shërbejë si shembull i transformimit pozitiv të universiteteve tona, sikurse e ka theksuar me të drejtë edhe Kryeministri Berisha. Autonomia e universiteteve në të vërtetë, në thelbin e saj përmban, së pari, autonomi strukturore, në lidhje me atë se universiteti përcakton sesi duhet të përcaktohet, organizohet seksioni, departamenti, fakulteti e të tjera, e realizuar kjo më së miri përmes këtij projektligji.

Së dyti, autonomia administrative, e cila konsiston në administrimin e universiteteve nën përgjegjësinë e tyre si institucion, edhe kjo e realizuar më së miri përmes këtij projektligji, dhe **së treti**, autonomia financiare, e cila konsiston në atë që universiteti duhet të shpërndajë në mënyrë indipendente fondet e akorduara nga shteti dhe të vetë përdorë, e theksoj, të ardhurat dytësore të krijuara nga ai vetë.

Kjo është e realizuar, për hir të së vërtetës, pjesërisht në këtë projektligj, duke reflektuar vërejtjet e profesoratit, veçanërisht ato të Fakultetit të Ekonomisë. Tashmë, në këto kushte, me këtë ligj bashkëkohor, që do të miratohet sot, është detyrë e universiteteve të rrisin transparencën e veprimeve të tyre financiare dhe efektivitetin e përdorimit të parave publike.

Duke bërë dhe propozimet përkatëse në Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike, te drejtuesit e Komisionit të Edukimit, si edhe për atë pjesë të pa reflektuar që unë kam paraqitur sot në formë amendamenti, dëshiroj të theksoj se dhënia e transfertës së pakushtëzuar në formë granti, përcaktimi i destinacionit të përdorimit të saj, jo në ndarje në "zëra", por në përballimin e ciklit të parë të studimeve dhe përballimin e ciklit të dytë dhe të tretë, pra "master" dhe "doktoratë" dhe formave të tjera të studimeve nga të ardhurat e vetë institucioneve publike të arsimit të lartë, është një domosdoshmëri tashmë për efektivitetin dhe transparencën e përdorimit të burimeve financiare, duke përfshirë edhe studentët në vendimmarrjen e përdorimit të burimeve financiare që sigurohen nga tarifat e shkollimit që ata paguajnë. Duke realizuar këtë gjë në

projektligjin në fjalë, ne si maxhorancë, realizojmë njëherazi edhe ato premtime tonat, të dhëna përpara zgjedhjeve të 3 korrikut dhe më pas.

Duke qenë ndër ata deputetë, propozues në seancën parlamentare të javës së mëparshme për të shtyrë diskutimin e këtij projektligji, për ta gjykuar me qetësi, me gjakftohtësi, me synim reflektimin e propozimeve që na kishin ardhur nga bota akademike, me qëllimin e mirë duke i përkrahur ato, duke respektuar njëherazi dhe punën e ministrisë e, në veçanti të ministrit të Arsimit, mendoj që Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike veproi më së miri. Njëherazi me mbështetjen për projektligjin me ndryshimet në fjalë, tashmë të referuara nga Komisioni i Edukimit dhe i Mediave dhe një pjesë të paraqitura nga deputetë të veçantë, unë dëshiroj të theksoj në veçanti një falënderim për nënkryetarin demokrat të komisionit, Prof .Gëzim Karapici, si dhe për Kryeministrin Sali Berisha, kryetar i Partisë Demokratike, për mirëkuptimin e treguar në këtë rast.

Shënim: *Në relacionin shoqërues të Këshillit të Ministrave, Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik për Projektligjin në fjalë si dhe në përmbledhjen e përgatitur nga specialistët e Shërbimit të seancave të Kuvendit në Raportin e Legjislacionit ndër të tjera veçojmë:*

*"**Ligj nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në RSH",** u miratua në Kuvend me 70 vota pro, 27 kundër, 2 abstenime. Data e hyrjes në Kuvend 26.03.2007.*

Ligji fokusohet në përmirësimin e mëtejshëm të legjislacionit në fushën e arsimit të lartë, duke ecur kështu në koherencë të plotë me ritmin e zhvillimeve të arsimit bashkëkohor. Ligji garanton nivel të lartë ekspertize në çështjen e politikave afatgjatë të arsimit të lartë, siguron parametrat e kërkuar në përftimin e njohurive bashkëkohore, ngritjen cilësore të nivelit të mësimdhënies, përdorimin sa më efikas të teknologjisë së informacionit, përsosjen e mëtejshme të zgjedhjeve në universitete dhe siguron një pjesëmarrje shumë më aktive të studentëve në tërë proceset e botës universitare.

Krijimi i Këshillit të Administrimit dhe përmirësimet e tjera ligjore synojnë rritjen e efikasitetit të qeverisjes në universitete, duke vënë në funksionimin e duhur mekanizmat e kontrollit, të transparencës dhe të miradministrimit. Ligji realizon autonomi të plotë financiare dhe liri akademike. Ai u garanton institucioneve të arsimit të lartë, pavarësi institucionale, në përputhje dhe në zbatim të kornizës të përcaktuar me këtë ligj. Modernizimi i sistemit të arsimit të lartë, rritja e cilësisë për garantimin e kualitetit të produktit të shkollës së lartë është një tjetër objektiv i rëndësishëm i këtij ligji.

Ligji mundëson shkollat e larta të jenë tërësisht autonome në përdorimin e grantit të buxhetit të shtetit, të programojnë veprimtaritë e tyre nëpërmjet shërbimeve që sigurojnë burime të tjera financiare.

Ligji njeh dhe lejon për herë të parë njohjen dhe transferimin e programit apo pjesëve të programit të studimit nga një shkollë në një tjetër brenda dhe jashtë vendit, pjesë të sistemit të arsimit të lartë ose jo. Pra lejohet njohja, vlerësimi dhe ekuivalentimi i ciklit të plotë apo pjesë të tij me qëllim që studenti të mund të transferohet apo të vazhdojë ciklin tjetër të studimeve në degë brenda një trungu të përbashkët dhe atij ti lejohet mundësia e njohjes së studimeve të kryera deri në atë kohë dhe e plotësimit të tyre apo vazhdimësisë sipas rregullave të brendshme të vetë institucioneve të arsimit të lartë.

Studentët dhe të drejtat e tyre zënë një vend të rëndësishëm në këtë ligj. Për herë të parë përfaqësimi i tyre në senate dhe këshilla do të jetë jo rastësor sipas preferencave të rektorëve apo dekanëve por nga studentët e zgjedhur nga vetë këto këshilla studentore. Arsimi privat gjithashtu është i rëndësishëm dhe përfshihet në një kapitull të veçantë. Shteti do të kontrollojë në mënyrë të vazhdueshme këto institucione me qëllim sigurimin e cilësisë së mësimdhënies si dhe të diplomës që ato do të lëshojnë".

I.3. Ati i madh - NDERI I KOMBIT

Diskutim jashtë rendit të ditës

Tiranë, 27 Shtator 2007

Në këtë humbje të rëndë për kulturën shqiptare, klerin katolik dhe popullin shqiptar është një ogur i mirë, nderues e respektues që ne deputetët e Kuvendit të Shqipërisë, pavarësisht bindjeve politike, vrapojmë kush e kush më parë të thurim ditirambe për eruditin At Zef Pllumi, për atë që regjimi komunist i baballarëve të disave prej krahut të majtë të sallës e anatemoi, e luftoi, e sakrifikoi për 50 vjet rresht.

Personalisht, si përfaqësues i kësaj maxhorance, ndihem i nderuar që u deshën 15 vjet, pas rrëzimit të regjimit të Enver Hoxhës dhe Ramiz Alisë, që në vitin 2006, me propozimin e Kryetares së Kuvendit, zonjës Topalli, ministri i Kulturës i asaj kohe, i Qeverisë "Berisha", i propozoi Presidentit të Republikës dhe ai e nderoi At Zef Pllumin me titullin e lartë "Nderi i Kombit" me motivacionin: "Si një nga personalitetet më në pah të kulturës kombëtare bashkëkohore, si një përfaqësues i spikatur i lobit kulturor më të fuqishëm që ka njohur historia jonë, pra atij françeskan".

Shkrimtari që me veprën e tij edukoi estetikisht dhe moralisht letërsinë shqipe të këtyre viteve, por edhe historinë shqipe të këtyre viteve, njeriu që rrnoi (jetoi) vetëm për me tregue dhe për me ofrue historinë tjetër të shqiptarëve me një qasje letrare-unike e konture filozofike, që e çoi mendimin shoqëror në shkallët sipërore, At Zef Pllumi, është i njohur për të gjithë ne. Veprat e tij janë një sinor i përjetshëm dhe ato do të dëshmojnë para botës se asnjë nuk është i detyruar, në asnjë rrethanë dhe në asnjë kohë, të bëhet i keq ose i ulët, të humbasë humanizmin e tij, parimet e tij. At Zef Pllumi është quajtur "Frat i dëshmive", madje nga studiues seriozë është quajtur "Frat i dëshmive historike", që me veprën e tij tregoi vullnetin për ta rilexuar historinë e për ta rishkruar atë, duke iu qasur gjithmonë e më tepër së vërtetës. Pikërisht, për këtë ka nevojë sot shoqëria shqiptare.

Veprën e tij, siç shprehet në parathënien e librit monumental "Rrno vetëm për me tregue" At Zef Pllumi ua kushtoi atyre që vdiqën njerëz, atyre që qëndruen njerëz gjatë asaj periudhe të vështirë, në të cilën njeriu u shndërrua në kafshë pune.

Megjithatë, duke u kthyer te nderimi për këtë kolos, për këtë ikonë të kulturës sonë kombëtare, dua të theksoj se At Zef Pllumi ngelet mësuesi i përjetshëm i vendit, ndriçuesi i historisë kurrë të shkrueme. Atij nuk mund t'i marrësh asgjë, se nuk ka asgjë të vetën, dhe nuk mund t'i japësh asgjë që i mungon, se ai e ka zemrën plot e përplot me dashuri. Për veprën e At Zef Pllumit, ne kemi nevojë të gjithë dhe, mbi të gjitha, ka nevojë ndërgjegjja jonë, ndërgjegjja jonë kulturore kombëtare. Për veprën e këtij shkrimtari, publicisti, memorialisti të shkëlqyer kanë në veçanti nevojë të rinjtë tanë.

Në mbyllje të kësaj fjale, përfitoj të mbështes veprimin e Kryetares së Kuvendit, që ta kërkojë minutën e zisë për At Zef Pllumin, kur të fillojë seanca normale, me pjesëmarrje të plotë të deputetëve.

Shënim 1: *Dy ditë më parë, 25/09/2007 u nda nga jeta kleriku i shquar At Zef Pllumi. Fjalët e mësipërme janë homazhi im në Kuvendin e Shqipërisë, në seancën plenare.*

Kush ishte At Zef Pllumi?

U lind më 7 prill të vitit 1924 në Malin e Rrencit të Lezhës. Në vitin 1929, në moshën 5 vjeçare, bëhet nxënës i Alfons Trackit, misionarit gjerman në Velipojë të Shkodrës. Në vitin 1931 hyn në kolegjin françeskan të Shkodrës, kolegj në të cilin jepnin mësim personalitete të shquara të kulturës kombëtare si At Gjergj Fishta, Padër Anton Harapi, Martin Gjoka, At Gjon Shllaku, etj., ku ndjek aty gjithë ciklin e arsimimit deri në vitin 1944, dhe merr formimin klasik në filozofi, teologji, letërsi dhe përvetëson mjaft mirë gjuhët e huaja latinisht, italisht, frëngjisht, gjermanisht e greqishte e vjetër. Në vitin 1943-1944 At Zef Pllumi është një nga bashkëpunëtorët e revistës "Hylli i Dritës", ndërsa në vitet 1943-1944 është sekretar personal i Padër Anton Harapit. Nga 14 dhjetori i vitit 1946 deri në nëntor të vitit 1949 burgoset dhe vuan dënimin në Beden dhe Orman Pojan. Nga viti 1949-1951 merret me numizmatikë si teknik i muzeut të Shkodrës, ndërsa në vitin 1956, në moshën 32-vjeçare shugurohet meshtar. Nga viti 1956 – 1967 shërben si meshtar i Dukagjinit me qendër në Shosh. 1967-1989, për 23 vjet rresht, burgoset përsëri dhe vuan dënimin në Beden, Orman Pojan, Spaç, Reps, Skrofotinë të Vlorës, Ballsh, Shënkoll, Tiranë. Në vitin 1990, Natën e Këshëndellave, fillon meshtarinë tek Kisha e Shna Nout në Tiranë deri në vitin 1997.

Në vitin 1993 nxjerr revistë "Hylli i Dritës" ku është botues e drejtor i saj, në bashkëpunim me intelektualët më të mirë të Shqipërisë. Kjo revistë vazhdon deri në vitin 1997. Në 3 korrik 2006 u nderua me titullin e lartë "Nderi i kombit".

Po në vitin 2006 At Zef Pllumi merr çmimin letrar "Penda e Artë" për triologjinë e tij me kujtime "Rrno vetëm për me tregue" të akorduar nga Ministria e Kulturës e Shqipërisë. "Juria paska pranuar edhe mendimin ndryshëm, edhe mendimin kundër, këtu besoj është vlera që ka demokracia. Kjo është vlefta më e madhe që i bëhet librit tim. Të tjerat janë për mua kurora që çohen në funerale që i vdekuri nuk i sheh", ka thënë Zef Pllumi me rastin e pranimit të çmimit.

At Zef Pllumi është autor i disa librave, si triologjia "Rrno vetëm për me tregue", "Françeskanët e mëdhenj", "Ut heri diçebamus – siç thonim dje", "Frati i Pashallarëve Bushatli, Erazmo Balneo", "Parathënia e Lahutës së Malcisë", botimi i 15-të, Shkodër, etj.

Botime nën kujdesin e At Zef Pllumit: "Gomari i Babasit"(i plotë) Gjergj Fishta, "Lahuta e Malcisë" Gjergj Fishta, Juda Makabe" Gjergj Fishta, "Vlerë Shpirtnore"Anton Harapi, "Dukla" Dom Nikollë Mazreku, "Sapiana" Dom Nikollë Mazreku. Po del nën kujdesin e tij kolana e shkrimtarëve françeskanë "Visaret e kombit", "Kanuni i Lek Dukagjinit", "Sintaksa e Justin Rrota", "Vepra e Baladin Palajt", "Fjalori i Benedik Demës", e shumë vepra të tjera të cilat janë në proces. Gjithashtu At Zef Pllumi ka një kontribut të vyer në përgatitjen e brezit të ri, ku me ndërhyrjen personale të tij, mbi njëqind studentë shqiptarë u janë akorduar bursa studimi në universitetet më prestigjioze të Evropës.

Gazeta 55, në specialen e saj të datës 27 shtator 2007, në rubrikën "Vlerësime Për At Zef Pllumin" ndër të tjera citon:

Nderim për veprën monumentale të At Zef Pllumit

"... Vepra e tij monumentale "Rrno vetëm për me tregue" e të tjera si "Histori kurrë e shkrueme" janë një sinor i përjetshëm, "ato dëshmojnë para botës se asnjë njeri nuk është i detyruar prej rrethanave të bëhet i keq , i ulët, të humbasë humanizmin e tij. At Zef Pllumi tregon me jetën e tij se edhe ne shqiptarët mund ta kalojmë provën e zjarrit, atë qe ndan mënjanë arin e kulluar dhe ndan mënjanë skoriet e kombit". At Zef Pllumi, nxënësi i Fishtës, Harapit, Shllakut mësuesve të përjetshëm të këtij kombi, sot më shumë se kurrë më ngjan me Diogjenin, filozofin grek, "atij s'mund t'i marrësh asgjë, pse s'ka asgjë të vetën, dhe s'mund t'i japësh asgjë që i mungon, pse ai ka zemrën plot e përplot me dashuri".

Nga Bujar Leskaj, ish ministër i MTKRS-së

Shënim 2: *Në korrik të vitit 2006 personaliteti i nderuar erudit antikomunist At Zef Pllumi pati mirësinë të jepte një vlerësim publik për punën time. Për faktin që këtë akt, unë e konsideroj si një nga vlerësimet më të vyera mbas besimit që më dha populli i Vlorës me mandatin e deputetit në Kuvendin e Shqipërisë dhe vlerësimit të Kryeministrit Berisha, që më besoi për një vit e gjysmë detyrën e Ministrit në kabinetin e tij, po e jap të plotë më poshtë:*

Dokumenti vlerësues i At Zef Pllumit për Ministrin e Kultures z. Bujar LESKAJ

Shum i nderuemi Z. Bujar Leskaj Minister I Kultures dhe Rinise e Sporteve.

Me ane te ksaj letre kryesisht due me ju falnderue per propozimin e perpjekjet tuaja personale qe te me jepet Urdhri Nderi I Kombit.

Me fole te drejten kam ndjeke me vemendje te madhe veprimtarine tuaj njvjecare si titullar I ksaj ministrie e cila mue m'intereson shum, dhe simbas mendimit tim, pa medyshje, jeni Ministri me i suksesehem I periudhes postkomuniste per Kulturen shqiptare ashtu edhe ma properendimori.

Me kane pelqye mjaft memoriali I Vilson Blloshmit e Genc Lekes si figura te panjoftuna te kultures shqiptare, por mendoj se duhen rri ne pah dhe figurat madhore te Kultures shqiptare si At Gjergj Fishta, Shtjefen Gjecari, Faik Konica e ndonje tjeter te perbuzur gjate diktatures proletare.

Mendoj se emrat e ktyre duhen perhape ne te gjithe Shqiprine, sidomos me ane monumentesh, emra rrugesh, sheshesh dhe shkollash te rendesishme.

Perfundoj me urimet ma te mira per veprimtarine tuaj e u pershendes me zemer.

At Zef Pllumi

firma

Shkoder, 8 korrik 2006

I.4 - Jo provokacioneve politike ndaj VLORËS

Diskutim jashtë rendit të ditës

Tiranë, datë 29.10.2007

E mora fjalën këtu për të denoncuar një veprim të papërgjegjshëm, një provokim do të thosha, një veprim tejet të ulët të përfaqësuesit politik të Partisë Socialiste në lidhje me problemet e ndërtimit të Petroliferës në Vlorë, në lidhje me raportet e Qeverisë Berisha me qytetin e Vlorës dhe më gjerë.

Si për të na vërtetuar që thënia e sociologut dhe e politologut Maks Weber që "politika bëhet vetëm me kokë dhe jo me pjesët e tjera të trupit dhe të shpirtit" jo gjithmonë është e vërtetë, përfaqësuesi, kryetari i Komisionit të Ligjeve të Partisë Socialiste, një ish- zyrtar i lartë i qeverisjes socialiste të viteve të fundit, del dhe kërkon as më shumë e as më pak, që të inkurajojë, të provokojë, të stimulojë me politikat e tyre atë lëvizje qytetare, që pjesë-pjesë dhe përfaqësues të veçantë të saj janë tejet në rregull për t'iu kundërvënë Qeverisë, për t'iu kundërvënë pushtetit duke harruar, i fshehur në rërë si struci, veprimet që ka bërë Qeveria e tij e mëparshme. Konkretisht, çfarë ka bërë Qeveria e zotit Berisha? Qeveria e zotit Berisha, maxhoranca jonë në këta dy vjet, nuk pati mundësi, mendoj unë, që të ndalojë, të rishikojë, të revokojë një marrëveshje të lidhur në Parlamentin e dalë nga zgjedhjet e kontestuara të vitit 2001, një marrëveshje, e cila është votuar tërësisht nga maxhoranca e majtë e asaj kohe dhe i është kërkuar këtij Parlamenti nga Qeveria miratimi i saj nëpërmjet vendimeve të Këshillit të Ministrave me nr. 297, datë 8 maj 2003, me nr. 171, datë 26 mars 2004 dhe me nr. 278, datë 12 maj 2004. Kjo marrëveshje koncesioni e lidhur në maj të vitit 2004 mori vulën nga ju të gjithë, pa përjashtim, të nderuar deputetë të së majtës, pasi në atë kohë e djathta e kundërshtoi këtë marrëveshje.

Për të qenë korrekt dhe i sinqertë, për të qenë i hapur me popullin e Vlorës, unë dëshiroj, (nuk ka problem që ju të shfrytëzoni të drejtën e replikës), t'i përmend popullit të Vlorës ata anëtarë "të

nderuar" të Qeverisë së Fatos Nanos, në periudhat 29 korrik 2002 - 29 dhjetor 2003, dhe 29 dhjetor 2003 - 10 shtator 2005. Pra, nga këta politikanë dhe pjesa më e madhe e deputetëve, populli i Vlorës ka këtë, figurativisht mund ta quaja, kërpudhë të helmatisur, në rast se do të isha në pozitat e profesorëve të nderuar e të apasionuar të ekologjisë, si Sazan Guri me shokë, që luftojnë me të drejtë për këtë çështje. Mund ta quaja një mundësi për zhvillimin ekonomik të qytetit të Vlorës, në rast se do të isha në pozita të tjera, apo përcaktime të tjera, kjo nuk ka rëndësi. Por për të qenë në koherencë me atë që kërkon politika e sotme, se nuk doli një jurist i ri, ky *homo nuovus* në Partinë Socialiste, ju, deputet të pakicës në këtë Kuvend dhe ish-qeveritarë të djeshëm, ose duhet të pranoni që në këto momente Partia Socialiste drejtohet nga një pjesë e jashtë jush, ose do të pranoni që kryetari Komisionit të Ligjeve të Partisë Socialiste ka hedhur poshtë ato firma kur ju keni votuar në Parlament, ato firma kur ju keni firmosur në vendimet e Këshillit të Ministrave, të para Shtatorit 2005.

Me respekt për ju, pa dashur të kem ndonjë gjë personale, po ju lexoj emrat dhe për nostalgji dhe për t'ju kujtuar funksionet kur keni përgatitur dhe kornizuar ligjërisht këtë investim për Vlorën. Pra, jeni ju ish-qeveritarë të gjithë bashkëfajtorë, iniciatorë, ekzekutorë, "zhvillues" të qytetit të Vlorës, janë këta ish-qeveritarë socialistë që kanë inkurajuar, që kanë realizuar këtë marrëveshje, e cila nuk u bë e mundur dot të revokohej nga Qeveria jonë e djathtë, në zbatim të detyrimeve tregtare ndërkombëtare e koncesioneve të dhënë nga Kuvendi i mëparshëm. Ilir Meta, zëvendëskryeministër dhe ministër i Jashtëm është në Qeverinë e 29 korrikut 2002 - 29 dhjetor 2003, Luan Rama ministër, Zoti Majko, ministër i Mbrojtjes, Kastriot Islami ministër i Financave, Arben Malaj ministër i Ekonomisë, Besnik Dervishi ministër i Turizmit, (këta të dy janë dhe deputetë të Vlorës), Viktor Doda ministër i Energjetikës, ka dhe një kallëzim në prokurori për këtë nga komuniteti vlonjat, zonja Dade ministre e Kulturës, zoti Memushi ministër i Arsimit, zonja Leskaj ministre e Punës Sociale, zoti Xhuveli, natyrisht, i përhershëm, ministër i Mjedisit, zoti Blushi ministër i Pushtetit Vendor, zoti Klosi ministër Shteti, Zonja Meksi Zëvendëskryeministre dhe Ministre e Integrimit. Diku nga mesi i kësaj periudhe ka dhënë dorëheqjen zoti Meta.

Qeveria e dytë, 29 dhjetor 2003 - 10 shtator 2005: Fatos Nano Kryeministër, Zoti Dokle zëvendëskryeministër, Zoti Majko ministër i Mbrojtjes, zoti Islami ministër i Punëve të Jashtme, Arben Malaj ministër i Financave, del Angjeli, që rron me stilolapsat në zemrat tona, zoti Xhafaj ministër i Drejtësisë, prapë Viktor Doda ministër

i Energjetikës, Blendi ka kaluar ministër Kulture, zoti Memushi ministër i Arsimit, Engjëll Bejtaj, Partia Socialdemokrate tashmë, ka qenë ministër i Punës Sociale, zoti Ruka ministër Mjedisi, Blushi përsëri ministër i Pushtetit Vendor dhe zoti Bello, ministër Shteti.

***Shënim 1**: Prof. As. Dr. Sazan Guri në librin e tij "VLORA dhe R` AMBOT" ndër të tjera, ka shkruar shkrimin:*

Dorëheqja e paralajmëruar e një ministri vlonjat

Në momentet e para të përpjekjeve të Aleancës përgjatë debateve mbi TEC-et me qeverisjen rozë nuk mungoi të shfrente dufin opozitar dhe qeverisja e sotme blu, madje në disa raste nuk kujdeseshin as për terminologjinë e zgjedhur kundër të kuqve, që do të pllakosnin Vlorën me katranët me bojë të zezë. Ata nuk munguan të përthithnin dhe argumentet tanë shkencorë (dihet se partitë politike janë të vetmet vende ku njerëzit nuk flasin për politikën), për t`i përdorur nëpër ekrane si shpoti ndaj lidhjeve të ekomafies përtej dhe këtej detit, si p.sh TEC-i të ndërtohet në Akërni, në asnjë mënyrë në gjiun si vashë të bukur të Vlorës ose për La Pertoliferën e AMBO-n të shikohet mundësia e spostimit drejt veriut Seman apo Porto Romano, fiks fare siç i mendonte sipas kritereve shkencore edhe Aleanca. Por krushqia me aleancën dhe bujaria me të do të vazhdonte për aq kohë sa kali ose çështja lidhesh me pozitën e atëhershme. Dhe nuk vonon, kur dielli sjell në horizont blu-në në qeverisje.

Si për të thënë, që ne TEC-in kurrë nuk do ta bëjmë, si për të treguar që ne Petroliferën asnjëherë nuk do ta lejojmë dhe si për të dëftyer që ne AMBO-n do të synojmë ta s'postojmë, qeverisja u formatua dhe me një Ministër Vlonjat, të cilit i korrespondonte pasuria me mendjen, bujaria me emrin, si dhe edukimi me kulturën. Bir jo thjesht vlonjat, por nga ata tipik e denjësisht Vlonjat, sa dhe gjuha dhe kunjat, që të kujtonin bejtexhinjtë e krahinës nuk e tradhtonin në formulimin e frazave apo mesazheve sa për kulturën dhe kur e donte rasti edhe për veprat me naftë. Ai u shpreh qartë dhe më se njëherë, se - do të jap dorëheqjen në rast se do të merret hap nga qeveria, megjithëse e tij, për ngritjen e TEC-eve, por sidomos të La Petroliferës e AMBO-s, sepse jo vetëm e dinte, por e ndjente që Vlora dhe nafta janë aq të afërm sa ç`është qymyri me diamantin, në ndryshim nga kolegët e vet që vetëm e dinin. Ai u tregua bujar me postin e vet, jo se nuk donte të vazhdonte, por se nuk mund të ishte pjesëtar i një qeverisje, që po bëhej trime për të dënuar gjiun e Vlorës. Ai i shtriu dorën qeverisjes së vet, duke toleruar dhe bërjen e një TEC-i aq sa mund të tërhiqesh lehtë, sepse nuk mund të bëhesh pjesëtar i një vendimi që nuk mendoi për të mos e vrarë atë qytet, që e burrëroi, i cili dhe e kalëroi. Si një kalorësiak fisnik, ai e dinte se trim nuk është ai që vret, por ai që mendon për të mos vrarë, sepse Ai, jo si të tjerët kuptoi, se kur zhurmonin faktet shkencore, qeveria duhet të heshte.

Dhe në fakt, Qeveria heshti dhe nuk bëzajti për aq kohë sa i duhesh të bënte kapërxyellin nga një mbështetës i aleancës në kundërshtar kokë mushkë të saj. Ajo organizoi tre tavolina debatesh midis Aleancës dhe pjesës shtetërore projektuese të bëmave me naftë, ku kuptoi se Aleanca nuk mund të përballohesh në fakte sui generis. Ajo kurrë nuk dha përgjigje për këto debate, sepse kuptoi që e vërteta ishte një mik i madh i aleancës. Ajo kurrë nuk vazhdoi të lidhesh apo të pyeste aleancën, sepse kuptoi se Aleanca ishte gatitur për punëra më të mëdha dhe se kish ardhur të luftonte për një kauzë e jo t'ja mbathte si ketri nga ujku.

Në këtë vorbull u censurua një referendum, ku morën krahë korbat dhe u nëpërkëmbën pëllumbat. Pra, prerazi, qeveria ia mbathi nga e vërteta dhe dalëngadalë u fut në marrëzinë e saj, duke ngulur këmbë fillimisht për një TEC, si për të thënë dale sa të fus kokën, por harroi se kjo kokë nuk kishte shpatulla, pastaj iu shpjegua dhe ra preh nga ekomafiozët, por kësaj radhe për këtej detit, të cilët nuk nguruan të sajonin se TEC-i është vëlla siamez me një fabrikim nafte tip Petrolifere, pra do na duhet dhe ajo, përkrah së cilës në fazën e dytë me rafineri nafte do të kërkohet një TEC i dytë, dhe më vonë faza e tretë e saj me petrokimi do të dojë simotrën e vet – TEC-in e tretë.

Memecit (qeverisë) i erdhi goja. Ajo njëzëri së bashku me korrin e të mundu(ar)ve firmosën vendimin famëkeq e fatkeq të zënies vend pranë këtyre TEC-eve dhe të aktivitetit me naftë të Kompanisë Italiane "La Petrolifera". Të bënte thjesht gabim do ta quanim njerëzore, por të ngulte këmbë në këtë gabim do ta quanim marrëzi. Sepse le ta zemë se s'pati problem që nuk mundën ta zgjidhnin në tavolinë çështjen TEC, por ata nuk shprehen vullnet të mirë, as dhe besim reciprok. Mbi të gjitha guxuan të mos kenë as frikë reciproke, ndërkohë që duhet të guxonin të dinin, të mësonin, por siç nuk ditën të heshtnin nuk ditën as të flisnin.

Në këtë zallamahi, u ngushtua dhe u përgatit situata për dorëheqjen e Ministrit Vlonjat, që në gjuhën zyrtare u përkthye riformatim i qeverisë, sepse ai pa diellin dhe nuk u morr me hijet, ndërkohë që të tjerët u morën me hijet dhe nuk panë diellin, sepse ai e tha dhe postin e lehtësoi, ndërkohë që të tjerët ministra nuk dëgjuan dhe shpirtin e rënduan.

Kësisoj, Vlora e pret me krah hapur dhe e fton të gëzojë të mirat e saj, ndërkohë që të tjerët frikën dhe peshën e mëkatit do të ndjejnë.

Shënim 2: Qëndrimi im si kandidat për deputet në vitin 2005, deputet i Vlorës dhe i Partisë Demokratike në vitet 2005-2009, ministër në qeverinë Berisha për një vit e gjysmë, ka qenë dhe është pro ndërtimit të një TEC-i në Vlorë dhe kundër ndërtimit të Petroliferës.

Njëkohësisht, kam qenë dhe jam kundër tentativës nga grupe të caktuara në Vlorë për t'ju imponuar me forcë qeverisë me mjete dhe metoda jodemokratike, të rrugës, për të mos lejuar ndërtimin e Petroliferës.

Tentativa destabilizuese e këtij grupimi provokonte Vlorën, inkurajonte destabilitetin dhe kthente frikshëm për qytetin dhe qytetarët hijet e vitit të mbrapshtë 1997.

Qytetarët e Vlorës duhet të kuptojnë se ishte tepër e vështirë, pothuajse e pamundur, për qeverinë Berisha të mos respektonte një marrëveshje të ratifikuar nga Kuvendi i mëparshëm, (me shumicë socialiste) për shkak të detyrimeve ligjore, tregtare ndërkombëtare dhe respektimit të investitorëve fqinj dhe shtetit mik italian për më tepër përpjekjeve tona kombëtare për tu anëtarësuar në BE.

Gjithsesi veprimtaria e Petroliferës, (pavarësisht se unë, si deputet i Vlorës apo ish ministër, në asnjë rast nuk e kam përkrahur apo inkurajuar ndërtimin e saj), duhet dhe besoj do të jetë në kontroll të institucioneve të specializuara për mbrojtjen e mjedisit dhe opinionit të pastër qytetar vlonjat.

I.5. Dëmshpërblimi i ish të përndjekurve politikë – Detyrim ligjor Kushtetues

Diskutimi në seancë plenare i projektligjit "Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist"

Tiranë, 12 Nëntor 2007

Në preambulën e Kushtetutës së Shqipërisë, ne të gjithë, populli shqiptar dhe përfaqësuesit e tij, theksojmë vendosmërinë për të ndërtuar një shtet të së drejtës, demokratik e social, për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut duke e pranuar njëherazi shtetin e së drejtës si një nga parimet më fondamentale në shoqërinë tonë postkomuniste. Projektligji "Për dëmshpërblimin e ish-të përndjekurve politikë të regjimit komunist" konkretizon jo vetëm premtimin politik publik të mazhorancës sonë të djathtë në përmbushjen e detyrimeve morale dhe ligjore që shoqëria jonë ka ndaj kësaj shtrese të nderuar, por njëherazi formaton seriozisht korpusin e ligjeve për shtetin e së drejtës që ne po ndërtojmë. Me këtë, ne si mazhorancë japim një provë të qenësishme si në plotësimin e kërkesave të drejta të shoqërisë shqiptare në këto 17 vjet tranzicion por edhe të kërkesave që Forumet Evropiane, Institucionet Evropiane kërkojnë për një qeverisje të standardit perëndimor ku ne aspirojmë të integrohemi.

Larg frazeologjive të bukura letrare, larg çdo patetizmi që gjithsesi do të ishte i drejtë, më duhet të theksoj në krye të herës në këtë fjalë, se ne plotësojmë kërkesat ligjore që garantohen në nenin 44 të Kushtetutës së Shqipërisë të vitit 1998: "Kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose zhdëmtohet në përputhje me ligjin në rast se është dënuar për shkak të një akti veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore".

Ne të gjithë, shoqëria shqiptare kemi arritur në deduksionin logjik se: Regjimi komunist në Shqipëri 1944-1990, ishte antikombëtar, i paligjshëm dhe kriminal. Studiues më të avancuar argumentojnë se ky regjim ka qenë i imponuar nga Serbët dhe

Rusët. Si i tillë ky regjim është dënuar nga gjithë shoqëria shqiptare pa të drejtë apelimi. Kuvendi i Shqipërisë, Parlamenti i Parë Pluralist i Republikës së Shqipërisë me Ligjin nr. 7514 datë 30.09.1991 "duke përdorur kompetencat e tij, u jep ish-të burgosurve, dhe të përndjekurve politikë pafajësinë dhe e konsideron në nderin e vet që si përfaqësuesi më i lartë i popullit, në emër të shtetit Juridik t'u kërkoj falje këtyre njerëzve për dënimet politike dhe vuajtjet që kanë pësuar në të kaluarën".

Neni 1 i ligjit sanksionon se: "Janë të pafajshëm dhe quhen të padënuar për efekte moshe, politike, sociale dhe ekonomike të gjithë personat që janë dënuar për agjitacion dhe propagandë kundër shtetit, arratisje, sabotim, pjesëmarrje në organizatat politike etj". E pra, kjo pafajësi, e theksoj PAFAJËSI, e lidhur me nenin 18 të Kushtetutës për barazi para ligjit u jep të drejtë të dëmshpërblehen në masën e parashikuar në Kodin Penal, e konkretisht në nenin 57 të tij. Për të arritur tek Kuvendi aktual që duke iu referuar Rezolutave të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës dhe konkretisht Rezolutës nr.1096 (viti 1996) "Masat për të çrrënjosur trashëgiminë e sistemeve totalitare komuniste". Rezoluta nr.1481 (vitit 2006) "Domosdoshmëria për dënimin ndërkombëtar të krimeve të regjimeve totalitare komuniste" si dhe vendimeve të Konventës së Parë Kombëtare të Shoqatës Mbarëkombëtare për Integrimin e të Përndjekurve Politikë dhe të Qendrës Shqiptare të Rehabilitimit të të Mbijetuarve të Torturës". Për dënimin e krimeve të komunizmit në Shqipëri" datë 12.05.2006, në pikën 15 të Rezolutës të miratuar nga ky Kuvend:

"Mbështet hartimin e një strategjie kombëtare për eliminimin e pasojave të totalitarizmit gjysmë shekullor në Shqipëri dhe fton institucionet shtetërore të përmbushin të gjitha detyrimet ligjore lidhur me statusin e të përndjekurve politikë për integrimin, arsimimin, punësimin, strehimin dhe dëmshpërblimin e tyre në një kohë sa më të shpejtë". Pra Qeveria në këtë rast s'ka bërë asgjë tjetër veçse ka përmbushur detyrimin e saj ligjor, e theksoj Detyrimin Ligjor Kushtetues.

Nga ana tjetër sipas të Drejtës Ndërkombëtare bashkëkohore konkretisht: Deklarata e Parimeve Themelore të Drejtësisë për viktimat e krimeve dhe të abuzimit me Pushtetin aprovuar me Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, viti 1985, "Viktimat kanë të drejtën për dëmshpërblim të menjëhershëm për dëmin e pësuar dhe se shtetet duhet të përpiqen të parashikojnë kompensim financiar ".

Ligji i datës 29.07.1993 nr. 7748 "Për Statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist",

obligon shtetin demokratik që pavarësisht nga vështirësitë me të cilat ndeshet shteti dhe shoqëria shqiptare ta ketë si detyrë dhe përgjegjësi morale e historike që të respektojë dhe të marrë masa konkrete për realizimin e së drejtës ligjore të dëmshpërblimit e kompensimit këtij grupimi të madh, të konsiderueshëm, të orientuar historikisht e politikisht. Duke sintetizuar në një të Drejtat Kushtetuese, Dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë, përfshi Kodin Penal etj, si dhe detyrimet nga e Drejta Ndërkombëtare, në funksion të përmbushjes edhe të detyrimeve që shtron integrimi në radhën e shteteve demokratike evropiane, Qeveria e sjell këtë Projektligj për kompensim financiar duke u bazuar në parimet e rëndësishme të drejtësisë dhe barazisë.

Parimi i Drejtësisë ka marrë në konsideratë edhe interesat e tjera të shoqërisë, si dhe interesin publik në tërësi duke pasur synimin kryesor zvogëlimin (pa arritur dot objektivisht zerimin) e pasojave të këtyre padrejtësive përmes përcaktimit të grupimeve përfitues, masës së dëmshpërblimit, shtrirjes në kohë të tij etj, në mënyrë që zgjidhja të jetë e qëndrueshme dhe efektive. Parimi i Barazisë kërkon ndalimin e diskriminimit dhe trajtim të barabartë në të drejta të të gjithë viktimave. Duke qenë të vetëdijshëm se dëmshpërblimi dhe kompensimi në tërësi janë detyrime pozitive të shtetit për integrimin dhe rehabilitimin e kësaj kategorie njerëzish në shoqërinë shqiptare. Pra, filli kryesor i këtij projektligji është respektimi i dinjitetit të barabartë të çdo personi që për shkak të burgosjes apo përndjekjes politike gjatë regjimit komunist përfiton nga Kushtetuta dhe ligjet shqiptare. Dëmshpërblimi dhe kompensimi i të burgosurve politikë duhet të jetë më shumë reflektim i detyrimeve ligjore por edhe vuajtjeve të tyre, hallet dhe problemet me të cilat ballafaqohet jeta e përditshme.

Vlonjati trim Reshat Kripa, Kryetar i Shoqatës Antikomuniste të Përndjekurve Politikë të Tiranës, shkruan se: "Te flasësh për gjenocidin komunist të ushtruar në vendin tonë, është njësoj sikur të përshkruash tmerret e ferrit. Pyetini ata që kanë mundur të shpëtojnë gjallë nga këto tmerre dhe do të mësoni ngjarje të padëgjuara ndonjëherë, të pa konceptuara për një mendje të shëndoshë. Do mësoni për burgje dhe kampe të krijuara posaçërisht për shfarosjen e njerëzve, për tortura të lemerishme të ushtruara mbi nacionalistë të shquar dhe intelektual demokrat që jetën ia kushtuan Atdheut". Projektligji i shoqëruar me vërejtjet e Komisionit të Ligjeve e të Ekonomisë që reflektojnë propozimet e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike mbas mirëkuptimit dhe mirëpritjes nga Kryeministri, garanton tashmë dhe sigurinë juridike duke pasur në

përmbajtje të tij nene të qarta, të përcaktuara dhe të kuptueshme. Ne ndërhymë drejt duke reflektuar kërkesat e gjithë shoqatave të të Përndjekurve politikë që shmangëm nenin 6 "Funksione a detyra të papajtueshme për përfitimin e dëmshpërblimit" si një nen që kompromotonte qëllimet e mira të hartimit të këtij ligji dhe që do të shkaktonte një reaksion nga shtresa e ish të përndjekurve ndaj qeverisë, që kjo qeveri e në veçanti Kryeministri Berisha nuk i meritonte. Në një shënim shoqërues të poemës "Zhaverët dhe Zhanvalzhanët" një poemë therëse për kohën e helmuar shkruar me 22-31 gusht 2007, poeti rebel Pano Taçi shkruante, se: "Drafti që është përgatitur për ne viktimat e komunizmit (kur ende ishte në fuqi neni 6) i mungon dashamirësia njerëzore, i mohohet e drejta e njeriut të lirë, i ndan viktimat në të ndershëm e të çndershëm, paçka se kanë vuajtur njësoj, punuar në punën e skllavit po njësoj, kanë derdhur gjak e djersë po njësoj". Por ne, Kryeministri dhe grupi parlamentar i PD-së, reaguam pozitivisht duke e abroguar këtë nen poshtërues e provokator duke i dhënë këtij projektligji peshën dhe dinjitetin që meriton, atë qëllim të mirë, sensitiv e detyrim moral që Partia Demokratike ka shfaqur gjatë gjithë kohës ndaj shtresës fisnike të të përndjekurve, pavarësisht ndonjë ulje të momentit apo faktit kur kjo Parti ka qenë në opozitë.

Revolucioni i Vitit 1997 përveç fatkeqësive të tjera ndërpreu atë proces stabilizimi dhe integrimi plotësisht të merituar që forcat demokratike e kishin nisur në Vitet 90, ndaj atyre që mbajtën gjallë demokracinë në Shqipëri kur jo të gjithë u përballën me diktaturën komuniste në variantin më të mirë apo i shërbyen asaj. Dua të kujtoj këtu që, Ligji i Qeveris socialiste i vitit 2004, i cili me të drejtë u hodh poshtë nga qeveria demokratike mbas vitit 2005 parashikonte ta dëmshpërblente këtë kategori me një vlerë financiare në një muaj, që është e barabartë me dëmshpërblimin në një ditë që projektligji i Qeverisë sonë parashikon dhe që kam besim të plotë që do të miratohet sot.

Me këtë projektligj të paraqitur, Qeveria dhe mazhoranca kthehet me dinjitet dhe plotëson atë obligim moral, politik e historik jo vetëm thjesht ndaj shtresës së ish-të përndjekurve politikë por edhe më gjerë, detyrimet ligjore ndaj Kushtetutës apo dokumenteve të ndryshme ndërkombëtare. Ky miratim është njëherazi provë serioze e politikës së djathtë shqiptare dhe e respektimit të Kushtetutës. Për ata deputet që janë konfuz apo dashakeqës ndaj faturës financiare që shoqëron këtë projektligj me dashamirësi do t'u sugjeroja që të lexojnë librin e Z. Agim Musta "Libri i Zi i komunizmit Shqiptar" e konkretisht kreun e

8 të tij, ku flitet për burgjet dhe kampet me punë të detyruar të bonifikimeve, të ndërtimit të veprave industriale, aeroporteve, veprave të tjera në bujqësi, në miniera etj. Puna diskriminuese dhe çnjerëzore, puna e papaguar e ish të përndjekurve politikë në 45 vjet flet, akuzon dhe mbron çdo faturë financiare sado e madhe që ajo të jetë. Këtë fjalë dua ta mbyll me apelin që Shoqata Kombëtare e Trashëgimtarëve të të Pushkatuarve Politikë të Shqipërisë i ka drejtuar politikës: "Zotërinj pushtetar dhe Deputet, mos u trembni nga një Faturë Dëmshpërblimi mbi të cilën rëndojnë disa tonelata gjak, mijëra vitesh Burgu dhe vuajtjesh pa fund të bashkatdhetarëve tuaj që sakrifikuan jetën për një Shqipëri Demokratike me vizion Perëndimor". Më lejoni të nderuar Deputet që sot kur ne do të miratojmë projektligjin "Për dëmshpërblimin e ish të përndjekurve politikë" t'i kërkoj Kryeministrit të Shqipërisë Z. Sali Berisha riaktivizimin e idesë së tij të vitit 2006, e cila ishte parashikuar dhe në buxhetin e Ministrisë së Kulturës në vitin 2007, për ngritjen në kryeqytet, në qendër të Tiranës të një Memoriali "Për qëndrestarët dhe viktimat e komunizmit në Shqipëri 1944-1990".

Diskutimi u botua në gazetën 55, dt. 20/11/2007.

Shënim: Ligji nr. 9831, datë 12.11.2007 "Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist" *u miratua me 77 vota ,0 kundër, 16 abstenime.*

Në relacionin shoqërues të Këshillit të Ministrave, Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik për Projektligjin në fjalë si dhe në përmbledhjen e përgatitur nga specialistët e Shërbimit të seancave të Kuvendit në Raportin e Legjislacionit ndër të tjera veçojmë:

"Data e hyrjes në Kuvend 26.07.2007

Komisionet parlamentare që kanë shqyrtuar ligjin:

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Seancë plenare: 22 tetor 2007 (shtyhet)

Seancë plenare: 29 tetor 2007 (shtyhet, amendamente nga PR)

Seancë plenare: 12 nëntor 2007

Ligji është pjesë e një pakti të rëndësishëm masash, që parashikon sigurimin e një jete më dinjitoze për ish të dënuarit politikë të regjimit komunist, familjarët e viktimave dhe, gjithashtu, shënon përmbushjen e një premtimi të madh politik, bërë nga mazhoranca e sotme ndaj përfaqësuesve të shtresës më të vuajtur të shoqërisë shqiptare. Ligji synon të dëmshpërblejë

kontingjentin më të ndjeshëm të ish persekutuarve politikë, persona, që kanë vuajtur drejtpërdrejt dënimin në burgjet komuniste.

Ligji synon masën dhe kriteret ligjore, që duhet të përmbushë personi, për të fituar dëmshpërblim, si dhe përcakton, në mënyrë të hollësishme, të gjitha procedurat për aplikim për dëmshpërblim dhe organet përgjegjëse, për shqyrtimin e kërkesës, miratimin apo refuzimin e saj, sipas rastit, dhe shpërndarjen apo mbikëqyrjen e mënyrës së shpërndarjes së këtij dëmshpërblimi. Nga ana teknike ligji synon të përcaktojë një procedurë të qartë e transparente, për të gjithë personat. Ligji është një ligj procedurial për zbatimin e një skeme financiare dëmshpërblimi, që garanton që procesi të jetë transparent dhe i mbikëqyrur periodikisht jo vetëm nga pushteti ekzekutiv apo Kuvendi, por edhe nga çdo qytetar apo grup interesi."

I.6. Viti 2008, Viti i investimeve publike në Shqipëri

Diskutimi në seancë plenare i projektligjit "Për buxhetin e shtetit të vitit 2008"

Tirane, 19.11.2007

Sot jemi mbledhur për të diskutuar projektin më të rëndësishëm ekonomik të vendit. Është kënaqësi të konstatoj se tek projektbuxheti 2008 kam gjetur një projekt ambicioz që besoj se ka për ti dhënë një shtysë të dukshme ekonomisë shqiptare, jo vetëm gjatë vitit 2008 por ka për të krijuar një bazë të mirë për zhvillimin e vendit për vitin në vazhdim, për buxhetin e shtetit të vitit 2009.

Nëse do të analizonim shifrat, projektbuxheti 2008 është projekti më ambicion që është hartuar gjatë këtyre 16 viteve ekonomi tregu. Avantazhet e tij janë të dukshme jo vetëm krahasuar me projektet e hartuara nga qeveria demokratike në këto dy vjet qeverisje por krahasuar me krejt projektet që qeveritë shqiptare kanë hartuar gjatë periudhës së tranzicionit. Buxheti 2008 është projekti më i madh, jo vetëm në terma absolutë por dhe në raport me Produktin e Brendshëm Bruto. Qeveria shqiptare ka parashikuar një total shpenzimesh prej 370 miliardë lekë, niveli më i lartë ky jo vetëm në terma nominalë por dhe në terma realë. Nëpërmjet shpenzimeve publike qeveria shqiptare ka për të kontribuar në financimin e mbi 34% të mallrave dhe shërbimeve që kanë për tu prodhuar gjatë vitit 2008 në ekonominë shqiptare. Ky nivel kontributi në PBB është i rritur krahasuar me vitet e kaluara, ku kujtoj që parashikimi për vitet 2005, 2006, 2007 kanë qenë respektivisht 27%, 28% dhe 30%.

Nga ana tjetër është besimi i plotë se ky është një projekt tërësisht i realizueshëm. Që prej dy vitesh është demonstruar vendosmëria e qeverisë për rritjen e të ardhurave buxhetore. Edhe pse në buxhetin 2008 parashikohet një ulje të barrës fiskale për bizneset, është tërësisht e mundshme rritja e të ardhurave tatimore duke vazhduar luftën ndaj korrupsionit dhe informalitetit në kuadrin e përgjithshëm të vendosjes së shtetit ligjor në shoqërinë dhe ekonominë shqiptare.

Është pikërisht realizimi i të ardhurave garancia për realizimin faktik të shpenzimeve të premtuara. Për vitin 2008 parashikohet të mblidhen të ardhura në vlerë 283 miliardë lekë ose 30 miliardë lekë më shumë se sa parashikimi për vitin 2007. Është e rëndësishme të theksoj se të ardhurat e buxhetit të shtetit po sigurohen gjithnjë e më shumë nga të ardhurat tatimore. Për vitin 2008 pritet që të ardhurat tatimore të shkojnë në 262 miliardë lekë duke realizuar mbi 92% të të ardhurave të buxhetit të shtetit. Ky është një nivel i shtuar krahasuar me vitin aktual ku të ardhurat tatimore janë parashikuar të zënë 90% të krejt të ardhurave. Duke mbetur përsëri tek të ardhurat, e shikoj me optimizëm për ekonominë rritjen e volumit të të ardhurave që pritet të sigurohen nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, pasi është ky zë tatimor garancia e të ardhurave buxhetore për një vend me ekonomi tregu. Kjo pritet të rrisë dhe peshën e këtij tatimi në raport me PBB-në duke e çuar këtë tatim drejt standardeve të synuara.

Deficiti buxhetor në vitin 2008 pritet të kapë nivelin e 7.9% të Produktit të Brendshëm Bruto. Për skeptikët ky nivel mund të duket i lartë krahasuar me vitet e shkuara. Por nëse do të analizonim mund të them se deficiti buxhetor është në nivele të pranuara. Normalisht deficiti buxhetor duhet të jetë i barabartë, në nivelin e parashikuar të rritjes ekonomike. Nëse rritja ekonomike e parashikuar gjatë vitit 2007 është në nivelet 6-7% atëherë niveli i parashikuar i deficit është më se normal. Kjo është edhe me standardet e vendeve evropiane të cilët ruajnë një nivel të barabartë të rritjes ekonomike dhe deficitit buxhetor në masën 3%. Mendoj se është e rëndësishme të kujtoj se deficit buxhetor përdoret tërësisht për të financuar një pjesë të investimeve ndërkohë që para pak viteve (2002) qeveria merrte borxh për të financuar shpenzimet korente.

Projektbuxheti 2008 është gjithashtu një projekt i cili merr në konsideratë interesat e të gjitha shtresave të popullsisë duke parashikuar më shumë fonde për pensionet, shëndetësinë, ndihmën ekonomike etj. Qeveria pritet të japë 19 miliardë lekë, ose mbi 200 milionë dollarë për të financuar pensionet, 5.8 miliardë lekë për të financuar shëndetësinë dhe mbi 12 miliardë lekë për të mbështetur shtresat në nevojë me ndihmë ekonomike.

Në projektin e qeverisë për vitin 2008 është parashikuar një grant i shtuar për pushtetin lokal. Kjo ka për të krijuar mundësinë për më shumë investime në komuna e bashki. Gjithashtu një shpërndarje e drejtë e fondeve sipas komunave dhe bashkive nxit zhvillimin dhe në zona periferike duke luftuar fenomenin e përqendrimit të fondeve vetëm në qendër, pasojë e së cilës ka qenë papunësia dhe migrimi i popullatës brenda vendit. Njëherësh këto fonde shkojnë

në Komuna a Bashki pa shikuar, pa diferencuar forcat politike që i drejtojnë ato dhe kjo është një vlerë tjetër e këtij projektbuxheti.

Si përparësinë kryesore të këtij projektbuxheti do të veçoja investimet publike. Është e dukshme rritja e nivelit të investimeve publike dhe peshës që ato zënë në raport me Produktin e Brendshëm Bruto. Me një nivel investimesh prej 105 miliardë lekë apo rreth 1.2 miliardë dollarë, qeveria pritet të investojë mbi dy herë më shumë krahasuar me vitin 2004 dhe 2005 ku volumi i investimeve të parashikuara ka qenë respektivisht 48 miliardë lekë dhe 50 miliardë lekë. Një tregues më i mirë për të demonstruar këtë fakt është pesha që investimet zënë në raport me Produktin e Brendshëm Bruto. Kështu për vitin 2008 investimet publike pritet të zënë 9.8% të Produktit të Brendshëm Bruto, një nivel rekord ky për krejt periudhën e tranzicionit dhe dukshëm i shkëputur nga viti 2007 ku investimet zinin 7.1%. Përqendrimi i buxheteve qeveritare gjithnjë e më shumë drejt investimeve e shoh si avantazhin më të madh të këtij projektbuxheti. Investimet publike janë të rëndësishme për rritjen ekonomike të vendit ku një rol të veçantë luajnë investimet për transport. Besoj jemi të gjithë të bindur se investimet, dhe në veçanti investimet publike janë mënyra më e mirë për të nxitur zhvillimin ekonomik të vendit dhe zbutjen e probleme ekonomike dhe sociale që vijnë nga mungesa e zhvillimit. Investimet publike janë të rëndësishme pasi ato jo vetëm shtyjnë ekonominë përpara por prekin fusha të cilat nuk shohin me interes nga bizneset private vendase dhe të huaja. Në veçanti, për një vend në zhvillim si Shqipëria, investimet publike janë jetike për zhvillimin pasi nëpërmjet tyre përmirësohet infrastruktura e vendit, dhe sidomos ajo rrugore. Pozicioni gjeografik mes vendeve të Ballkanit dhe Lindjes nga njëra anë dhe Evropës Perëndimore në anën tjetër i jep vendit favorin e të qenit mes rrugëve të kalimit të burimeve të energjisë, mallrave dhe njerëzve. Kjo mundësi, e shfrytëzuar pak deri më tani, mund të kthehet në burim zhvillimi vetëm nëpërmjet ndërtimit të rrugëve, porteve, aeroporteve.

Përveç kësaj, zhvillimet e pritshme në Ballkan dhe veçanërisht kristalizimi "de facto" dhe "de juro" i shtetit të ri Kosovar e bën të domosdoshme parapërgatitjen e Shqipërisë për të forcuar më shumë lidhjet ekonomike me Kosovën. Ky nuk është thjesht vetëm një mision patriotik por një detyrë që buron nga interesi i përbashkët i ekonomisë shqiptare dhe asaj kosovare. Fillimi i punimeve të Rrugës Durrës-Kukës dhe vazhdimi me një ritëm të shtuar gjatë vitit 2008 kanë për të çuar në realitet ëndrrën për lidhjen e Prishtinës me Tiranën nga një rrugë e niveleve bashkëkohore, rruga e kombit.

Projektbuxheti i paraqitur i kushton vëmendjen e duhur investimeve dhe për Qarkun e Vlorës, si ato në infrastrukturë, rruga Lushnjë-Fier-Vlorë, rruga Transballkanike në qytetin e Vlorës, rruga drejt bregut të detit të Himarës dhe Sarandës, ndërtimi i rrjetit të ri të ujësjellësit të qytetit ashtu dhe ato investime në arsim, kulturë, shëndetësi, politika sociale etj.

Në mbyllje do të përmblidhja përparësitë që shoh në projektbuxhetin e vitit 2008:

Së pari, ulja e normës së tatim fitimit në 10% duke e barazuar me Tatimin mbi të ardhurat personale dhe tatimi mbi dividentin. Përgjysmimi i tatimfitimit do u krijoj një frymëmarrje bizneseve duke rritur shanset për një zhvillim të sektorit privat që do të thotë një ritëm i shtuar i të ardhurave, punësimit etj. Ky përgjysmim i rënies së tatim fitimit është sakrificë për qeverinë pasi shkakton rënien e të ardhurave nga ky zë. Por kjo rënie pritet të kompensohet nga rritje e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar duke siguruar realizimin e të ardhurave buxhetore dhe duke garantuar në këtë mënyrë realizimin e shpenzimeve që parashikohen për vitin 2008.

Së dyti, e shoh si pozitive barazimin e normës së Tatim fitimit me Tatimin mbi të ardhurat personale dhe tatimi mbi dividenti. Ky standardizim e thjeshton sistemin tatimor dhe e bën atë më të kuptueshëm për publikun. Përveç kësaj ky standardizim, ul incentivat për evazion dhe është një mjet më në luftën ndaj korrupsionit në administratën tatimore.

Së treti, projektbuxheti 2008 i kushton vëmendjen e duhur arsimit dhe shëndetësisë. Mbi 24 miliardë lekë do ti akordohen Ministrisë së Shëndetësisë nga të cilat rreth 5 miliardë lekë janë të destinuara për investime të reja në shëndetësi. Sa i përket arsimit qeveria ka parashikuar ti akordojë Ministrisë së Arsimit mbi 37 miliardë lekë nga të cilat 7.5 miliardë janë të destinuara për investime të reja në arsim. Pra arsimi dhe shëndetësia kanë për të thithur së bashku mbi 61 miliardë lekë apo rreth 700 milion dollarë, fakt ky që tregon për vëmendjen që do të kenë këto sektorë nga qeveria shqiptare.

Së katërti, siç e përmenda dhe më lart ky projekt buxhet merr në mbrojtje shtresat e popullsisë pa të ardhura apo me të ardhura të ulëta. Rritja e financimit të qeverisë për fondin e sigurimeve shoqërore do siguroj financimin e shtesës së pensioneve. Gjithashtu rritja e fondit të ndihmës ekonomike ka për të ofruar më shumë ndihmë për shtresat pa të ardhura.

Së pesti, ky projektbuxhet është në harmoni me ambiciet integruese të vendit për në NATO dhe Bashkimin Evropian. Me një

volum të parashikuar investimesh prej 5.8 miliardë lekë, Ministria e Mbrojtjes vjen e treta për sa i përket volumit të investimeve, (pas Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës). Çka është më e rëndësishme buxheti për mbrojtjen është mbi 2% të PBB në vlerën e 21.6 miliardë lekëve, duke plotësuar kështu një premtim të Qeverisë dhe kusht financiar për anëtarësimin e kërkuar në NATO.

Së gjashti, ky projekt buxhet është projekti që pritet të japë një hov në ekonomi nëpërmjet një rekordi investimesh. Kjo e çon vendim drejt rrugës së zhvillimit, drejt rritjes së ekonomisë dhe plotësimit të standardeve integruese për në BE. Përqendrimi i investimeve drejt infrastrukturës rrugore na lidh me vendet fqinje dhe bën vendin më atraktiv për investitorët e huaj.

Kjo e bën projektbuxhetin e vitit 2008 ta quajmë: Viti i investimeve publike kudo në Shqipëri.

Dhe **së fundmi** përgatitja dhe miratimi në kohë i projektbuxhetit mundëson fillimin e zbatimit të këtij projekti që në muajin janar duke shpërndarë më mirë gjatë vitit shpenzimet gjë që rrit shpresat për realizimin sipas programit të të gjithë elementëve të parashikuar.

Diskutimi i mësipërm u botua në gazetën 55, dt. 20/11/2007 nën titullin "Projektbuxheti 2008, më ambiciozi gjatë 16 viteve të ekonomisë së tregut"

Shënim: Ligji nr. 9836, datë 26.11.2007 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2008"*, u miratua me 61 vota pro, 34 kundër, 0 abstenime.*

Në Raportin e Legjislacionit, përgatitur nga specialistët e Sekretarisë së Shërbimit të Seancave të Kuvendit ndër të tjera veçojmë:

"Data e hyrjes në Kuvend 29.10.2007.
Komisionet parlamentare që kanë shqyrtuar ligjin:
Komisioni për Ekonominë dhe Financat.
(komisionet e tjera).
Seancë plenare: 20 nëntor 2007 (në parim)
Seancë plenare: 26 nëntor 2007 (nen për nen dhe në tërësi)
Shumica e kërkuar: e thjeshtë

Kuvendi i Shqipërisë në disa mbledhje rradhazi nëpër komisionet parlamentare shqyrtoi në parim projektligjin "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008". Në përputhje me kreun III të Rregullores së Kuvendit, Komisioni për Ekonominë dhe Financat hartoi një program të veçantë për bashkërendimin e punës me komisionet e tjera të përhershme të Kuvendit.

Ministri i Financave prezantoi projektbuxhetin në Konferencën e Kryetarëve, duke u ndalur në veçoritë, objektivat dhe prioritetet që ai synon të mbështesë.

Në një mbledhje të posaçme, Komisioni i Ekonomisë shqyrtoi raportet e komisioneve të tjera të përhershme të Kuvendit, duke u ndalur në mendimet dhe propozimet e tyre për politikat sektoriale të parashikuara në projektbuxhet, si dhe për mbështetjen me fonde publike të ministrive e institucioneve buxhetore, sipas fushave specifike që ata mbulojnë.

Ligji shpreh përparësitë e programit të Qeverisë, të miratuar nga Kuvendi, për zhvillimin e ekonomisë dhe rritjen e mirëqenies së vendit, nëpërmjet ruajtjes së stabilitetit makroekonomik, reformimit të sistemit fiskal dhe rritjes së të ardhurave të tij, mbështetjes me përparësi të sektorëve të arsimit, shëndetësisë, infrastrukturës, mbrojtjes së vendit, politikave për rritjen e pagave e pensioneve, si dhe thellimit të mëtejshëm të procesit të decentralizimit. Treguesit e tij janë në përputhje me ata të parashikuar në Programin Buxhetor Afatmesëm 2008-2010 dhe janë konsultuar me institucionet financiare ndërkombëtare, si Fondi Monetar Ndërkombëtar e Banka Botërore.

Gjatë vitit 2008 ekonomia e vendit do të vazhdoje të ruajë qëndrueshmërinë e saj dhe do të ketë një rritje vjetore prej 6%, ndërsa niveli i inflacionit parashikohet të jetë 3%".

I.7. Huamarrja e Qeverisjes Vendore – Oportunitet zhvillimi

Diskutimi në seancë plenare mbi projektligjin "Për huamarrjen e qeverisjes vendore".

Tiranë, 04. 02. 2008

Duke plotësuar kërkesat e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore si dhe në zbatim të "Strategjisë Kombëtare të Decentralizimit dhe Autonomisë Vendore", Qeveria Shqiptare me projektligjin "Për huamarrjen e Qeverisjes Vendore" jo vetëm hedh një hap në thellimin e decentralizimit fiskal, por si qeveri, mazhorancë dhe parlament vendosim një DOKUMENT besimi dhe mirëkuptimi me pushtetin vendor.

Vende si i yni, të vegjël dhe që kanë përjetuar një centralizim të pushtetit për një periudhe tejet të gjatë ndeshen me këtë ligj si një risi dhe domosdoshmëri e zhvillimit në këtë realitet 17 vjeçar të ekonomisë së tregut dhe të vendosjes së raporteve të reja që plotësohen çdo ditë ndërmjet pushtetit qendror, pushtetit vendor dhe kapitalit privat. Nga një vend ku pushteti ishte i centralizuar si pjesë e tranzicionit kemi kalimin e kompetencave dhe fuqizimin e pushtetit vendor, për të vazhduar me këtë projektligj në ekspansionin e këtij pushteti, pra atij vendor drejt tregjeve të kapitalit. Ne sot po kornizojmë huamarrjen vendore jo vetëm si mjet efikas për menaxhimin dhe rritjen e shërbimeve publike në komuna dhe bashki, por dhe si pjesë të rëndësishme të financave publike të vendit. Politikat fiskale në viteve 90` kanë qenë përgjithësisht kudo konservatore për sa i përket trajtimit të borxhit publik duke e kufizuar atë deri në 20% të P.B.B-së. Ky raport borxhi është rritur ndjeshëm së fundmi në të gjitha vendet në ekonominë e tregut, duke u mishëruar në huamarrje të të gjitha formave dhe madhësive dhe së fundmi me anë të këtij ligji edhe në Shqipëri krijohen oportunitet ligjore që pushteti vendor të marrë pjesë në këtë huamarrje publike.

Po cila është eksperienca e vendeve të ngjashme me vendin tonë në histori politike dhe zhvillim tregu, por që i kanë paraprirë këtij problemi tashmë me sukses në këto vite?

Në **Sllovaki** rregullimi i Huamarrjes vendore përfshihet në Ligjin për Buxhetin. Ky rregullim është i ngjashëm me atë në Republikën Çeke. Ligji Sllovak përfshin gjithashtu:

- rregulla që reduktojnë huamarrjen afatgjatë vetëm në financimet kapitale.
- Huat afatshkurtra mund të përdoren vetëm nëse shërbimi ndaj huas është vjetor.
  Ligji sllovak ashtu si dhe ligji që po prezantojmë përcakton kufij të huamarrjes në këto nivele.
- Huaja nuk duhet të kalojë 60% të të ardhurave të vitit pararendës
- Shërbimi ndaj borxhit nuk duhet të kaloje 25% të të ardhurave operative të vitit pararendës.
- Konsiderimi për 60 ditë, si afat për konsiderimin si moment i mos-shlyerjes.

Nga eksperienca **Hungareze** mund të veçojmë faktin se janë bërë shumë rregullime lidhur me procedurat për shlyerjen e borxhit. Përshpejtimi i këtyre procedurave mund të bëhet në rast të mos-shlyerjes edhe përpara afatit 60 ditor, me miratimin e qeverisë vendore dhe huadhënësit. Kufiri i huas nuk kalon 70% të të ardhurave të vitit pararendës. Kjo eksperiencë na mëson:

- huamarrja vendore nuk duhet të jetë si një zëvendësues i huamarrjes qendrore,

- investimet që gjenerojnë një normë të ardhurash më të madhe se sa shpenzimet për koston e kapitalit, janë të justifikueshme,

- shërbimi ndaj borxhit duhet të jetë i përballueshëm nga të ardhurat vendore,

- huamarrja duhet bazuar në rregulla strikte financiare, skema të financimit optimal dhe projekte të besueshëm për gjenerimin e të ardhurave.

Huamarrja vendore në **Poloni** nga ana tjetër ndryshon disi nga eksperienca Çeke dhe ajo Hungareze. Sipas Kushtetutës Polake, borxhi publik nuk duhet të kalojë 60% të P.B.B-së dhe nëse ky borxh kalon kufirin 50% atëherë iniciohen procedurat specifike. Në Poloni janë krijuar gjithashtu dhe 16 zyra, të cilat merren me kontrollin e financimit të qeverive vendore.

Më pas në këto vende janë bërë disa rregullime të mëtejshme që kanë lidhje me nivelin e garancive që pushtetit qendror duhet të

ofronte ndaj pushtetit lokal. Këtë rregullim ligji që po prezantohet e bën më së miri. Përgjithësisht orientimet e Komunitetit Evropian janë në drejtim të:

- shoqërimit të fenomenit me një kuadër të mirë ligjor,
- përcaktimi i kufijve të huamarrjes vendore dhe i shërbimit ndaj borxhit,
- rekomandohet një unifikim i teknikave matëse dhe regjistruese të huamarrjes vendore,
- auditimi i njësive vendore duhet të bëhet nga institucione të pavarura,
- rregullimet qendrore janë të reduktuara deri në zero dhe lehtësimi ka vetëm orientim fiskal

Eksperienca e këtyre viteve ka treguar se komunitetet vendore kanë aftësi të mira të menaxhimit të burimeve vendore dhe të fondeve që ato përdorin. Në kuadrin e decentralizimit një përkrahje në këtë drejtim është dhe mundësia që këto pushtete vendore të marrin hua nga faktorë të ndryshëm në treg. Menaxhimi i vlerave vendore nga vet pushteti lokal rrit efektivitetin e përdorimit të fondeve. Lidhja më e afërt mes fondeve dhe pronës rrit produktivitetin e përdorimit të tyre. Ligji i paraqitur nga qeveria prek të gjitha çështjet e rëndësishme të huamarrjes vendore duke përcaktuar qartë objektin, qëllimin, kompetencat, kushtet e huas, titujt dhe natyrën e huamarrjes si dhe është përpjekur të marrë në konsideratë orientimet e mësipërme. Nisur nga kushtet korrente në vend dhe përvoja e sipërcituar, projektligji përbën një hap të rëndësishëm dhe vendimtar në fushën e huamarrjes vendore si një proces të bazuar në parimet e dobishmërisë, efektivitetit dhe transparencës. Njësitë e qeverisjes vendore mund të marrin hua në formën e marrëveshjes së kredisë, qirasë financiare, linjës se kreditit etj, si dhe nëpërmjet emetimit të letrave me vlerë – obligacione të ndryshme bashkiake.

Me këtë ligj njësitë e qeverisjes vendore kanë mundësi të marrin hua në tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare dhe pikërisht duke qenë se tregjet ndërkombëtare i gjykojnë të gjitha institucionet huamarrës të një vendi si një entitet i vetëm, me të drejtë në ligj është parashikuar që huaja vendore nga tregjet ndërkombëtare të jetë subjekt i miratimit të qeverisë Shqiptare nëpërmjet Ministrisë së Financave për të minimizuar riskun për qeverinë dhe imazhin e Shqipërisë në këto tregje. Kjo gjithashtu do të përbënte dhe një faktor parandalues i importimit të inflacionit të tregjeve ndërkombëtare. Kjo i shërben ruajtjes së stabilitetit makroekonomik, të politikave të borxhit të konsoliduar publik si dhe për të minimizuar risqet për njësitë e qeverisjes vendore.

Fushat e zakonshme të përdorimit të Huamarrjes vendore mund të jenë:

1. mirëmbajtje e rrugëve jokombëtare,
2. infrastruktura e kanalizimeve të ujërave të bardha dhe të zeza,
3. zhvillimi kulturor komunitar,
4. shërbimi i zjarrfikësve,
5. ndotjet vendore të mjedisit etj.

Megjithatë do jenë institucione të tilla si, Kryetari i Njësise Vendore dhe Këshillat e Qeverisjes Vendore të cilat do të përcaktojnë këto hua dhe fushat e përdorimit të tyre nëpërmjet një procesi tashmë ligjor, transparent dhe të sigurt.

Duke i gjykuar nga natyra e shërbimit të borxhit huamarrja mund të jetë:

- në natyrë
- në të ardhura

Titujt në natyrë janë ata për të cilët ekziston e drejta e emetuesit të titullit që t`i shërbejë borxhit jo vetëm me para por edhe me obligacione të tjera.

Titujt të tipit në të ardhura janë ato që shërbimi i borxhit është vetëm me para dhe ndalohet emetimi i titujve të tjerë për t`i shërbyer këtij titulli.

Kreu i katërt i projektligjit në fjalë "Kufizimi i borxhit" parashikon qartë kufizime të borxhit afatshkurtër, të borxhit afatgjatë, të linjës së kredisë dhe në veçanti citojmë nenin 20 "Kufizimin Shumator të Borxhit" që thekson: "shuma e borxhit afatshkurtër, afatgjatë u nënshtrohet kufizimeve të përcaktuara në ligjin "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor", mbi kufijtë e borxhit publik. Për ruajtjen e stabilitetit makroekonomik dhe të politikave të borxhit të konsoliduar publik, si edhe për të minimizuar risqet për njësitë e qeverisjes vendore, veçanërisht në fazat e para të huamarrjes vendore, projektligji parashikon disa kufizime sasiore për vëllimin e borxhit të çdo njësie të qeverisjes vendore:

- borxhi afatshkurtër nuk mund të tejkalojë 10 % të të ardhurave, gjithsej të vitit buxhetor pararendës nga taksat e tarifat vendore dhe taksat e ndara,
- shërbimi vjetor i borxhit afatgjatë nuk mund të tejkalojë 20% të të ardhurave gjithsej të vitit buxhetor pararendës nga taksat e tarifat vendore, taksat e ndara dhe transfertat e pakushtëzuar,
- shërbimi i borxhit që paguhet çdo vit për borxhin afatgjatë nuk mund të tejkalojë 75% të tepricës operative të vitit fiskal pararendës të llogaritur si diferenca e të ardhurave operative,

gjithsej nga burimet e veta, taksat e ndara dhe transferta e pakushtëzuar me shpenzimet jo të kushtëzuara operative të njësisë së qeverisjes vendore ne vitin fiskal pararendës,
- garancitë për huat e marra nga subjekte të kontrolluara nga njësia e qeverisjes vendore dhe çdo linjë kredie, qoftë edhe e pashfrytëzuar përllogariten si borxh i vet njësisë së qeverisjes vendore për efekt të kufizimeve,
- kufizimi për shërbimin shumator të borxhit afatshkurtër dhe afatgjatë është i njëjtë me atë të borxhit afatgjatë.

Kjo është bërë në përputhje me eksperiencën botërore dhe ajo ç`ka është më e rëndësishme me vende me natyrë të ngjashme si ai i yni. Nga të gjithë dihet që marrëdhënia e huas është një vendimmarrje me risk dhe duke qenë se minimizimi i risqeve për huamarrjen është në interesin e çdo komuniteti vendor dhe në interesin publik, me të drejtë projektligji parashikon masa korrektuese në raste të mos-shlyerjes nga njësia vendore të principalit apo të interesit për një borxh si dhe masa rregulluese në rast të mos-përmbushjes. Gjithashtu nenet 23 "Vështirësia Financiare", neni 24, neni 25 "Paaftësia Paguese", janë nene të cilat synojnë të paralajmërojnë dhe të miratojnë plane përmirësimi financiar të njësisë së qeverisjes vendore në rast të konstatimit të vështirësive financiare.

Duke qenë se vet hartuesit e këtij ligji mendojnë se nuk e ezaurojnë të gjithë gamën e çështjeve që lidhen me mundësinë e shfaqjes së vështirësisë financiare dhe paaftësisë paguese vendore dhe duke qenë se huamarrja vendore është një fushë e re, mendoj se ndërhyrja në disa nene të këtij ligji, ndoshta në një fazë të dytë të tij, do të fuqizonte idenë e tij për decentralizim dhe fuqizim të mëtejshëm të pushtetit vendor. Kështu dy mund të jenë momentet e ndërhyrjes në këtë ligj:

1. trajtim më i gjerë i garancive,
2. trajtim fiskal i huamarrjes vendore

Nga teoria dihet se risku i një titulli mund të reduktohet më tej me anë të mundësisë për t`a shkëmbyer atë me një titull tjetër më të sigurt. Kjo d.m.th se, në rast të një dështimi të mundshëm, mbajtësi i titullit (komuniteti lokal, banka etj) ka mundësi të konvertojë titullin me një titull të qeverisë qendrore si bono thesari etj. Kjo redukton riskun në kufij minimal d.m.th në rast të një mundësie për mos-shlyerjen e borxhit, blerësit e huave vendore kanë mundësi të rifitojnë paratë e investuara duke i konvertuar titujt vendorë me tituj të Qeverisë Qendrore. Në këtë mënyrë nuk është Ministria e Financave ajo që vjen në ndihmë dhe "shpëton" organet vendore,

por është vet tregu i kapitaleve që jep "shtegun" e shpëtimit. Këta kufij përcaktohen në raportin e konvertibilitetit që mund të jetë 1.3 me 1 (100 lekë të titullit qendror = 130 lekë të titullit lokal). Ky raport i jep mundësi mbajtësit të titullit lokal të konvertojë lekët e investuara në tituj të qeverisë qendrore, pra është ai që zgjedh në rast të një falimentimi të mundshëm të mos detyrojë bashkinë të kthej lekët, por të ketë mundësi të ri-investojë paratë në një titull qendror, pa e vënë në vështirësi organin lokal për të shlyer domosdoshmërish detyrimin për titullin e emetuar prej saj. Raportet e konvertibilitetit duhet të jenë të shpallura më parë. E rëndësishme është që raporti të jetë i njëjtë për fusha të njëjta të përdorimit të të ardhurave të siguruar nga titujt. D.m.th për një titull të ardhurat e të cilit përdoren në fushën e infrastrukturës, raporti 1.5 me 1 dhe për një titull në fushën e zhvillimit kulturor komunitar, 1.7 me 1. Shuma e garancisë mund të "luhatet' në mënyre subjektive, duke rritur vlerën në treg të TITUJVE VENDORË. Sa më e lartë kjo garanci aq më i favorizuar është një institucion lokal. Me anë të udhëzimeve të mëtejshme duhet të sqarohet se çfarë përfshin garancia: garanci për principalin?, garanci për interesat? apo garanci për principalin dhe interesat?. Garancia nga pushteti qendror rrit vlerën e titujve lokale. Kjo shprehet në mënyrën se si tregu përcakton normat e interesit të titujve: "interesi të cilin një investitor dëshiron të korr për paratë e dhëna hua, është shprehje e riskut që ai ndërmerr në këtë investim". Për çdo rritje në risk përtej normës baze ose normës pa risk, investitori kërkon rritje të shpërblimit ose të interesit të korrur. Interesi shtesë për riskun shtesë është më i ulët nëse garancia e titullit bëhet dhe nga qeveria qendrore, pra sa më shumë garant të hyjë qeveria qendrore, aq më pak i duhet të paguajë pushtetit vendor për huat e marra. Pra ndërhyrja e qeverisë qendrore ul normën e interesit, por nëse garancia lëshohet pa u emetuar titulli dhe kjo gjë bëhet publike, nënkupton de fakto se është shteti ai që merr përsipër dhe pagesat në rast mos-shlyerje të borxhit. Kjo gjithashtu mund të hap shteg për abuzime nga autoritete vendore në menaxhimin e vlerave të marra hua. Nëse Qeveria Qendrore ndërhyn pas emetimit të titullit dhe vetëm në rast vështirësish, atëherë ulet tendenca për të keq-menaxhuar vlerat e marra hua, por përsëri ndërhyn në pavarësinë e pushtetit lokal.

Duke u nisur nga fakti që huamarrja vendore është një fenomen i ri për vendin tonë dhe tregu i kapitaleve nuk ofron shërbim në standardet maksimale, për t`a favorizuar ofertën publike të pushtetit vendor, mendoj se duhet bërë lehtësimi fiskal, pra mos tatimi i titujve vendorë, veçanërisht i Obligacioneve Bashkiake.

Evitimi i pagesës së tatimit në burim për interesat e fituara nga blerësit e titujve vendor rrit vlerën e këtyre titujve në treg. Ekskludimi i interesave të lidhur me titujt vendor është një praktikë e njohur në Sh.B.A.

Përfundimisht përparësitë e ligjit për huamarrjen e qeverisjes vendore janë të shumta, por mendoj se më kryesoret janë:

- mundësia e madhe që i ofrohet njësive të qeverisjes vendore për të financuar nevojat e tyre dhe për të qenë pjesë e huamarrjes publike,
- nisur nga fakti që një numër i konsiderueshëm i njësive te qeverisjes vendore, veçanërisht ato në qytetet Tiranë, Vlorë, Durrës, Elbasan etj, janë nën drejtimin e opozitës, ky ligj që ne miratojmë sot është indikator i qartë i emancipimit të plotë dhe përkrahjes së gjithanshme që kjo Qeveri i jep pushtetit vendor,
- ligji për huamarrjen vendore së bashku me ligjin e ri tregtar, ligjin "Për Titujt" dhe ligjin e borxhit që do të paraqiten së shpejti nga Qeveria Shqiptare krijon një infrastrukturë të re për tregun Shqiptar të kapitaleve dhe një kuadër të plotë ligjor rregullues.

Diskutimi u botua në gazetën Rilindja Demokratike dhe 55, dt. 05/02/2008

Shënim: Nga *Raporti i Legjislacionit, i cili paraqet një përmbledhje të veprimtarisë ligjvënëse për këtë legjislaturë kemi* veçuar:"***Ligji nr. 9869, datë 4.2.2008 "Për huamarrjen e qeverisjes vendore".***

"Data e hyrjes në Kuvend 09.01.2008
Nismë e Këshillit të Ministrave
Propozuar nga Ministri i Brendshëm.
Komisionet parlamentare që kanë shqyrtuar:
Komisioni për Ekonominë dhe Financat.
Shqyrtimi në seancë plenare: 04.02.2008
Ligji është miratuar me 97 vota pro, 0 kundër, 0 abstenime.
Shumica e kërkuar: e thjeshtë

Ligji është pjesë e reformës së përgjithshme të decentralizimit, e në mënyrë të veçantë është një hap thelbësor në rritjen dhe thellimin e decentralizimit fiskal. Në strategjinë e decentralizimit, e miratuar në vitin 1999 dhe në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" parashikohet e drejta e njësive të qeverisjes vendore për të marrë hua, sipas kushteve e rregullave të përcaktuara me ligj të veçantë. Për këtë arsye miratohet ky ligj qëllimi i të cilit është përcaktimi i kritereve dhe i procedurave për huamarrjen vendore,

në thelb të të cilave qëndrojnë parimet e dobishmërisë, aftësisë paguese, përgjegjshmërisë dhe transparencës.

Ligji është në përputhje me masat dhe programin e qeverisë për reformat institucionale në drejtim të vazhdimit e thellimit të decentralizimit dhe të autonomisë fiskale për përmirësimin e cilësive qeverisëse në drejtim të efiiencës, efektivitetit e forcimit të përgjegjshmërisë e rritjes së transparencës. Gjithashtu ligji është edhe në zbatim të objektivave të tjera të këtij programi, konkretisht ato të zhvillimit të infrastrukturës dhe të politikave të zhvillimit të turizmit, zhvillimit harmonik e të integruar urban etj për aq sa këto do të zbatohen në nivelin vendor të qeverisjes".

I.8. Ndërtimi i rrugës Transballkanike në Vlorë kërkon edhe shpronësim korrekt të qytetarëve

Diskutim jashtë rendit të ditës

Tiranë, datë 11.02.2008

Personalisht mendoj se nuk është serioze për një deputet të pozitës të ngrejë në Parlament drejtpërdrejt probleme të zonës apo të raporteve të zonës dhe të qytetarëve të saj me Qeverinë, për arsye se këto probleme ka ku t'i ngrejë, në mbledhjen e Grupit parlamentar të shumicës. Por, problemi që do të shtroj sot dhe vet prezenca e Kryeministrit ma bën më të lehtë prezantimin, për arsye se këtu fare mirë do të di të gërshetoj atë që rëndom quhet besnikëri ndaj zgjedhësve; së dyti, besnikëria ndaj partisë, që nuk do të na mungojë gjithmonë dhe; së treti, mbajtja e fjalës së dhënë.

Një qeveri është vërtet e suksesshme atëherë kur ato vendime të drejta që nxjerr në dobi të qytetarëve, kur ato investime të forta që jep për zona dhe për krahina të caktuara shkojnë në vend, zbatohen nga nëpunësit e saj, nga institucionet në varësi të saj dhe nga raportet që duhet të krijojnë ministritë e linjës me pushtetin vendor dhe më gjerë. Për të qenë më i saktë, e kam fjalën për vendimin nr. 857, datë 29 nëntor 2007 "Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme" për pronën private që preket nga ndërtimi i "Rrugës Transballkanike" në Vlorë.

E para, më duhet të theksoj pa hipokrizi që ky investim është një pjesë e rëndësishme e zhvillimit të qytetit dhe është pjesë e premtimeve të mbajtura të kësaj maxhorance. E dyta, Qeveria dhe Kryeministri në vëmendje të plotë ka qenë i kujdesshëm për të përcaktuar edhe një shumë prej 29 milionë lekësh të reja për shpronësimin e këtyre pronarëve, duke përcaktuar në vendimin në fjalë, konkretisht në pikën 6, edhe një afat që shpronësimi të fillojë më 01.12. 2006 dhe të përfundojë më 30.12.2007. Kjo vleftë e përgjithshme përcaktohet në pikën 5, si e detyrueshme që të vihet në

dispozicion nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave në Bankën e Shqipërisë, nga fondi i shpronësimeve.

Deri këtu jemi në rregull. Por, të vijmë më vonë te pronarët, dhe bëhet fjalë për 54 të tillë, nga të cilët 50 janë me dokumente të rregullta dhe të konfirmuara, ndërsa 4 janë në proces gjyqësor. Pronarët e përfitojnë këtë vleftë pasi të paraqesin dokumentet në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe pika 8 e vendimit ngarkon Ministrinë e Punëve Publike, Ministrinë e Financave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi të rëndësishëm, jo vetëm për këta qytetarë që shpronësohen në qytetin e Vlorës, por për këtë rrugë të rëndësishme për këtë qytet, jemi drejtpërdrejtë të interesuar edhe ne deputetët e atij qyteti, 2 deputetët e Partisë Demokratike, por, pa dyshim, në radhë të parë vetë Qeveria "Berisha". Në këto momente del problemi i paaftësisë, më e pakta që detyrohem të them për etikë. Nuk dua të mendoj asnjë dashakeqësi nga nëpunës apo institucione të caktuara, por duke qenë se qytetarët nuk janë njoftuar në mënyrë nominale nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, pushteti vendor, Ministria e Drejtësisë dhe e Punëve Publike, këta qytetarë, në mënyrë arbitrare dhe jo të ligjshme nga një institucion tjetër, tashmë në varësi të pushtetit qendror, të këtij pushteti që realizon gjithë këtë investim dhe çel fonde për shpronësim, detyrohen të lënë shtëpitë e tyre, për arsye se do t'i prishë Policia Ndërtimore.

Çfarë është Policia Ndërtimore? Është institucion në varësi të këtij shteti? Pa dyshim që po. Është institucion në varësi të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit? Pa dyshim që po. Cilët janë këta drejtorë dhe nëndrejtorë, që me një të rënë të lapsit dërgojnë fadroma e ekskavatorë, a thua se dërgojnë "tanke për mbrojtje" dhe a thua se kjo Qeveri do t'i ketë këta për ditë të keqe që në një mënyrë të jashtëligjshme detyrojnë 54 familje të lenë shtëpitë e tyre? Vendimi nr. 850, datë 29 nëntor 2007, i Qeverisë "Berisha" quhet i realizuar, në radhë të parë, kur qytetarët e Vlorës të kenë paratë në portofolat e tyre, që janë shpërblim i dëmit që shkaktohet nga një investim i drejtë publik. Në momentin që këta qytetarë nuk kanë të plotë shumën e faturës financiare të dëmshpërblimit për shpronësimin e detyruar në llogaritë e tyre rrjedhëse, asnjë institucion nuk ka të drejtë t'u tregojë krahët, nuk ka të drejtë t'u thotë këtyre qytetarëve: dilni ju jashtë, se ne do të bëjmë punën tonë, do prishim ndërtimet tuaja.

Sinqerisht, zoti Kryeministër, edhe në emër të qytetarëve të Vlorës, unë ju falënderoj për investimin, për fondin e dhënë për shpronësimin e këtyre qytetarëve, por mendoj që nesër zyra e shpronësimeve në Drejtorinë e Rrugëve le ta vendosë tavolinën e punës atje në "Rrugën Transballkanike" dhe t'i ndihmojë këta qytetarë të plotësojnë formularët për të marrë lekët që shteti u detyrohet dhe ju si qeveri me aktin ligjor përkatës ua keni dhënë.

I.9. Administrim ligjor dhe me efikasitet i fondeve dhe i pasurive publike

Diskutimi në seancë plenare mbi projektligjin "Për ankandin publik"

Tiranë, datë 14.02.2008

Që në fillim më duhet të shprehem se, projektligji "Për ankandin publik", së bashku me ligjin "Për prokurimin publik" dhe ligjin "Për koncesionet" formojnë një trekëndësh të plotë ligjor të administrimit të fondeve dhe pasurive publike për të realizuar një qeverisje të mirë, të bazuar në pesë kolona themelore: transparencë, pjesëmarrje, përgjegjësi, efikasitet dhe koherencë të veprimeve.

Deri më sot procedurat e ankandit janë rregulluar rast pas rasti nga institucionet që realizonin një procedure të tillë dhe bazuar në rregulla të përgjithshme, vendime të qeverisë, disa prej të cilave të miratuara qe prej vitit 1991, ose më parë, duke lënë shteg për abuzime. Çfarë mund të theksojmë për procedurat e ankandit të realizuara deri më sot? Nuk ka pasur asnjë element të transparencës në realizimin e procedurave të ankandit deri më sot, duke filluar që nga njoftimet të cilat kanë qenë spontane, por edhe kur janë bërë, ato nuk bëheshin në ndonjë buletin zyrtar, pra që këtu nisnin preferencat në përzgjedhjen e pjesëmarrësve. As që nuk bëhej fjalë për kushte të barabarta për pjesëmarrje, apo dokumentacion të ankandit lehtësisht të aksesueshëm. Veç të gjitha këtyre problemeve, sikur të mos mjaftonin, pjesëmarrësit e pakënaqur nga procesi, nuk gjenin vend ku të ankoheshin. Pra qarku ishte krejtësisht i mbyllur, ankande pa plan, pa njoftim, pa barazi, pa procedura ankimi. Ky projektligj plotëson atë boshllëk që ekzistonte që prej vitesh në legjislacionin tonë, pasi për here të parë realizimi i shitjes së pasurive publike po rregullohet me ligj. Vihet re se projektligji "Për ankandin publik" është hartuar duke u mbështetur në modelet më të mira të vendeve të BE-së dhe duke pasur parasysh një ndër angazhimet që Shqipëria ka marrë për përafrimin e legjislacionit

në kuadrin e miradministrimit të pasurive publike, bazuar në *acquis communautaire*.

Ky projektligj arrin këto qëllime:

- miradministrimi i pasurive publike;
- krijimin e mundësive te përfshirjes së çdo individi apo shoqërie në blerjen e pasurive publike në mënyrë të barabarte;
- Të nxisë konkurrencën ndërmjet blerësve;
- Të sigurojë trajtim të barabarte dhe jo diskriminues për të gjithë pjesëmarrësit në procedurën e ankandit publik;
- Të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e ankandit publik.

Projektligji, vihet re se është hartuar duke pasur kujdes t'i japë zgjidhje problemeve që kanë pasur deri tani procedurat e ankandit. Po kështu, është shumë e rëndësishme, që për herë të parë në procedurat e ankandit, i jepet e drejta e ankimit palëve pranë Agjencisë së Prokurimit publik si një organizëm i paanshëm dhe transparent. Siç e thashë më lart, kjo e fundit nuk mund të ndërhynte në asnjë rast ligjërisht për të trajtuar ankesa lidhur me shkeljet në procedurat e ankandit dhe as nuk mund të rekomandonte ndonjë institucion tjetër kompetent pasi nuk ishte i përcaktuar një i tillë. Në këtë mënyrë pjesëmarrësve në garat e ankandeve u garantohet e drejta e ankimit, një e drejtë që atyre u buron nga parimet e së drejtës. Lidhur me të drejtën e ankimit dhe garantimin e transparencës në procedurat e ankandit publik dhe institucioni i Avokatit të Prokurimeve Publike është një garanci më shumë. Në projektligj përcaktohen rregullat e procedurave të ankandit, duke dhënë parime si mos diskriminimi, e drejta për informim, fshehtësia e procesit, shmangia e veprimeve korruptive dhe konfliktit e interesit, format e komunikimit, etj, të cilat janë parime të konsoliduara tashmë në praktikat më të mira evropiane.

Vlen të theksohet se në format e komunikimit është parashikuar dhe komunikimi elektronik, duke e konsideruar këtë personalisht një sukses tjetër të qeverisë, pas hartimit të platformës së prokurimeve elektronike. Për herë të parë do të ketë dokumente standarde për procedurat e ankandit, duke krijuar lehtësi për pjesëmarrësit në garë dhe duke standardizuar procedurat. Duke qenë i bindur se në rregullat e ankandit, ashtu si dhe në rregullat e prokurimit, qeveria do të vendosi detyrimin e publikimit të tyre online, e konsideroj këtë një hap shumë të rëndësishëm në rritjen e transparencës dhe luftën kundër korrupsionit. Nga relacioni që shoqëron projektligjin "Për ankandin publik", konstatoj se është hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e

Drejtësisë. Duke e konsideruar një ligj kyç në tërësinë e legjislacionit që rregullon përdorimin e fondeve dhe pasurive publike, gjej rastin të përgëzoj hartuesit e projektligjit.

Shënim: Nga *Raporti i Legjislacionit, i cili paraqet një përmbledhje të veprimtarisë ligjvënëse për këtë legjislaturë veçojmë:*
"Ligj nr. 9874, datë 14.02.2008 "Për ankandin publik".
Data e hyrjes në Kuvend 11.01.2008.
Nismë e Këshillit të Ministrave Propozuar nga Kryeministri.
Komisionet parlamentare që kanë shqyrtuar:
Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.
Komisioni për Integrimin Evropian.
Shqyrtimi në seancë plenare: 14. 02. 2008
Ligji është miratuar me 66 vota pro, 2 kundër, 27 abstenime.
Shumica e kërkuar: e thjeshtë

Ligji "Për ankandin publik" është hartuar duke u mbështetur në modelet më të mira të vendeve të Bashkimit Evropian . Ligji u bashkëlidhet edhe dy ligjeve të tjera tashmë të miratuara, atij për prokurimin publik dhe të koncensioneve duke plotësuar në këtë mënyrë paketën e plotë të administrimit të fondeve dhe pasurive publike, sipas standardeve të Bashkimit Evropian".

I.10. Për një treg funksional të titujve financiarë

Diskutimi në seancë plenare mbi projektligjin "Për titujt".

Tiranë, 21.02.2008

Që në fillim të fjalës sime dua të përshëndes ardhjen në Kuvend të këtij projektligji shumë të rëndësishëm për ekonominë shqiptare. Pavarësisht se gjithë periudha 17 -vjeçare etiketohet si tranzicion, mund të them se tashmë jemi në një situatë ku marrëdhëniet e ekonomisë së tregut janë kristalizuar dhe janë konsoliduar në shumë drejtime. Qeveria shqiptare, prej vitesh, siguron financim nëpërmjet emetimit të bonove të thesarit dhe së fundi ka filluar të hedhë në treg dhe obligacionet e thesarit. Sistemi bankar shqiptar ka shtuar volumin e kredisë që ofron për ekonominë dhe një numër i konsiderueshëm shoqërish krediti ofrojnë financim për bizneset e vogla dhe të mesme. Në vend ushtrojnë veprimtarinë e tyre një numër i konsiderueshëm bankash (16 banka), shoqërish kreditimi, kompani sigurimi, plane pensioni, etj. Ky sektor ka arritur të tërheqë vëmendjen e kapitalit të huaj, i cili është afruar nga banka dhe kompani sigurimi serioze, të cilat pritet që të kenë ndikimin e tyre pozitiv në imazhin e Shqipërisë dhe thithjen e investimeve. Është shtuar gama e produkteve bankare dhe niveli i kreditimit që ofrohen nga sistemi. Por, pavarësisht nga këto zhvillime, përsëri ndërmjetësit financiarë në Shqipëri nuk i përmbushin të gjitha nevojat për fonde të ekonomisë. Shtimi i kreditimit po u përgjigjet këtyre nevojave, por bankat ndeshen me problemin e riskut të shtuar të kredisë, gjë që e pengon rritjen e kreditimit përtej një niveli të caktuar. Zhvillimi i ardhshëm i sistemit bankar ka për të rritur volumin e financimit që ai do të ofrojë, por, ashtu si në vendet e tjera me ekonomi tregu, asnjëherë nuk do të financojë krejt nevojat e ekonomisë për fonde. Një pjesë e ekonomisë ka nevoja specifike financiare, të cilat nuk mund t'i plotësojnë bankat dhe as ndërmjetësit e tjerë financiarë. Funksionimi i një tregu të titujve financiarë do të krijojë një mundësi alternative për sigurimin e burimeve të financimit për bizneset, sidomos ato të mëdha.

Në këtë kontekst, projektligjin "Për titujt" e vlerësoj si një domosdoshmëri që duhet t'i përgjigjet pikërisht nevojës së ekonomisë për financim, duke luajtur në këtë mënyrë atë rol që ai ka në një ekonomi tregu. Ligji i mëparshëm, ligji nr. 8080 i vitit 1996 "Për letrat me vlerë" besoj se është ezauruar me kohë dhe formulimi dhe miratimi i një baze të re ligjore është e domosdoshme për të krijuar infrastrukturën e nevojshme ligjore, me qëllim lindjen dhe zhvillimin e një tregu të titujve financiarë.

Në çfarë situate gjendemi sot?

Kur flet për titujt financiarë, gjëja e parë e rëndësishme që duhet të ekzistojë është bursa. Shqipëria, të paktën nga ana institucionale, e ka një bursë. E krijuar që prej 12 vitesh, Bursa e Tiranës nuk ka arritur të shndërrohet në një treg funksional të titujve financiarë. Një pjesë e parashikimeve për këtë treg nuk është realizuar ende. Kështu, ideja fillestare mbi të cilën u ngrit Bursa e Tiranës ishte që ajo do të shërbente si treg primar dhe sekondar i bonove dhe obligacioneve të thesarit. Kjo nuk është arritur akoma edhe sot, ndoshta dhe për shkak të një bashkëpunimi jo të mirë mes këtij institucioni dhe Bankës së Shqipërisë. Një ndër pasojat e kësaj situate janë normat e larta të interesit për bonot dhe obligacionet e thesarit, më të larta këto se normat e interesit që bankat paguajnë për depozitat bankare me të njëjtin afat. Kjo ka krijuar një situatë alogjike, pasi teorikisht dhe praktikisht bonot e thesarit janë instrumente me risk zero dhe normalisht duhet të kenë normat më të ulëta të interesit në një treg titujsh financiarë. Normat e larta të interesit për këta tituj kanë shtrenjtuar koston me të cilën qeveria siguron borxh nga publiku. Më shqetësuese është fakti që përfituesit e këtyre interesave të larta që qeveria paguan, nuk janë individët, të cilët në të vërtetë janë ata që i japin borxh qeverisë, por bankat e nivelit të dytë dhe institucionet e tjera financiare, të cilat, me paratë e publikut blejnë pjesën dërrmuese në çdo emetim. Përveç bonove të thesarit, Bursa e Tiranës do duhej të tregtonte dhe aksionet që do të krijoheshin nga konvertimi i bonove të privatizimit. Mbyllja e fondeve të përbashkëta pas vitit '97 dhe privatizimet e pabazuara mbi bonot e privatizimit, zvogëluan ndjeshëm vlerën e tyre, duke i nxjerrë krejtësisht jashtë tregut e jo më të flitej për një konvertim të mundshëm të tyre në aksione.

Një shans tjetër për tregtimin e aksioneve në Bursën e Tiranës do të duhej të vinte nga kuotimi i aksioneve të kompanive shtetërore që do të privatizoheshin. Përvoja e viteve të kaluara, kur është

privatizuar një pjesë e madhe e shoqërive shqiptare, ndonjëherë me çmime spektakolare qesharake dhe shumë të debatueshme, nuk njeh asnjë rast të tillë. Kjo ka çuar më tej në mosrespektimin e një kushti të tillë dhe nga kompanitë private që kanë blerë prona shtetërore. Aktualisht, shoqëritë aksionere private apo shtetërore nuk kanë një ofertë publike për aksionet që mbajnë. Gjithsesi, siç e përmenda dhe më lart, Bursa e Tiranës të paktën ekziston si institucion dhe duhet infrastruktura e përshtatshme ligjore që të shndërrohet në një treg funksional të titujve financiarë, pikërisht këtë do ta realizojë projektligji që do të aprovojmë sot. Përveç Bursës së Tiranës, në Shqipëri janë të ngritura dhe institucione të tjera që do t'i shërbejnë këtij qëllimi:

- është krijuar Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, të cilit ligji i ri i jep një rol qendror në miratimin e rregullave, instrumenteve dhe aktorëve që do të luajnë në tregun e titujve financiarë.
- ekziston një numër shoqërish komisionere të licencuara për të, tregtuar në Bursën e Tiranës.
- Ekziston një numër i konsiderueshëm shoqërish aksionere private dhe publike.
- Ekzistojnë Bonot e Thesarit dhe Obligacionet e Thesarit, si të vetmit tituj financiarë që tregtohen.

Natyrisht që këto institucione dhe instrumente që sapo përmenda nuk janë të mjaftueshëm për krijimin e një tregu funksional titujsh, por janë një bazë e mirë nisjeje. Rregullimi që krijon projektligji "Për Titujt" ka për t'i dhënë shtysë emetimit dhe tregtimit të titujve të tjerë financiarë. Kjo do të ndihmojë në funksionimin e Bursës së Tiranës, duke dhënë kontribut jo vetëm në financimin e ekonomisë, por dhe në zhdërvjelltësimin e saj. Përveç kësaj, Bursa do të shërbejë dhe si një burim i mirë informacioni dhe një indeks për matjen e "temperaturës" së ekonomisë, ndoshta më i mirë se sa indekset që ofrojnë institucione të ndryshme publike apo private, shpesh e më shpesh jo profesionalisht po përdoren nga politika vetëm e vetëm për qëllimet e saj.

Konkluzionet e mia për këtë projektligj do t'i përmblidhja në, disa pika:

Së pari; ky projektligj përcakton në mënyrë të qartë tituj financiarë më të rëndësishëm mbi bazën e të cilëve mund të ngrihet dhe gjallërohet një bursë e letrave me vlerë. Si një dokument që ndjek përvojën më të mirë, ky projektligj paraqet në mënyrë të plotë përkufizimet në lidhje më titujt, cilësitë që duhet të kenë emetuesit, mënyrën e licencimit të shoqërive komisionere dhe agjentëve të

bursës, mënyrën e licencimit të një burse dhe formën e organizimit të saj, mënyrën e rregullimit të të drejtave dhe detyrimeve në kontratat e shitblerjes së titujve financiarë, etj. Ky projektligj është një mundësi e mirë për zgjerimin e sistemit financiar me burimet e reja të financimit që ofron emetimi i titujve financiarë.

Së dyti, sipas këtij projekti, i jepet një rol udhëheqës Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, i cili do të licencojë operatorët e bursës dhe do të rregullojë dhe mbikëqyrë marrëdhëniet mes tyre

Së treti, tek ky projektligj gjej një nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të drejtave të investitorëve. Detyrimi që ligji përcakton për standardet që duhen plotësuar për licencimin e një tregu të letrave me vlerë, një shoqëri komisionere apo dhe për të punuar si agjent i bursës, standardizon dhe ul nivelin e riskut në bursë (nenet 44-92). Gjithashtu, kërkesat për të qenë transparentë, sidomos për subjektet që do të emetojnë tituj, krijojnë mundësitë që investitorët të kenë njohuri për titujt që blejnë, duke ulur riskun e investimit.

Së katërti, pavarësisht detyrimeve për standarde dhe transparencë, gjykoj se projektligji i jep liri tregut financiar dhe nuk e ngarkon me mbikëqyrje në një masë të tillë që të pengojë dinamikën e tij, por, përkundrazi. Besoj se kufizimet dhe mbikëqyrja kanë për të ndihmuar në ngritjen e një tregu dinamik dhe me nivel të ulët risku.

Së pesti, ky projektligj lë hapësira për emetimin dhe shitjen e titujve financiarë edhe për kompanitë e huaja, duke ofruar kushte lehtësuese për vendet e Bashkimit Evropian dhe SHBA-ve (neni 38), gjë që lehtëson sigurimin e fondeve për investitorët e huaj. Kjo mundësi jep një arsye më shumë për të ngritur biznesin e tyre në Shqipëri.

Së gjashti, do ta vlerësoja këtë ligj për mundësinë që krijon për nisjen e procesit të financimit të pushtetit lokal me fonde nëpërmjet titujve. Është pikërisht neni 5 "E drejta për të emetuar tituj", i cili, ndër subjektet që kanë të drejte të emetojnë tituj përcakton dhe "njësitë e qeverisë vendore". Ky ligj, së bashku me Ligjin "Për huamarrjen vendore", i hap rrugë procesit të financimit të qeverive vendore me fonde nëpërmjet emetimit të titujve të borxhit, proces që do të ndikojë pozitivisht në rritjen e investimeve nga këto njësi të qeverisjes. Natyrisht që do të jenë aktet nënligjore dhe rregulloret e mëtejshme që do krijojnë mundësinë e emetimit të titujve financiarë nga bashkitë dhe komunat.

Së shtati, ky ligj krijon bazën dhe fasilitete për zhvillimin jo vetëm të Bursës së Tiranës, por dhe të ngritjes dhe zhvillimit të bursave të organizuara si shoqëri me aksionerë privatë.

Dhe së fundi, duke qenë akoma në hapat e para në fushën e tregtimit të titujve financiarë, referimi projektligjit tek përvojat më të mira dhe të mundshme për Shqipërinë, dhe sidomos referimi tek ligji kroat dhe gjerman, është një arsye për të besuar që ky ligj ka për të funksionuar, duke nxitur lindjen dhe zhvillimin e një tregu të titujve financiarë në Shqipëri. Natyrisht që do të jenë aktet nënligjore që do të përshtatin referimin më shumë me realitetin shqiptar.

Diskutimi u botua në gazetën Rilindja Demokratike, dt. 22/02/2008

Shënim: Nga *Raporti i Legjislacionit, i cili paraqet një përmbledhje të veprimtarisë ligjvënëse për këtë legjislaturë veçojmë:*

*"**Ligj nr. 9879, datë 21.02.2008 "Për titujt".***
Data e hyrjes në Kuvend 04.01.2008
Nismë e Këshillit të Ministrave
Propozuar nga Ministri i Financave .
Komisionet parlamentare që kanë shqyrtuar:
Komisioni për Integrimin Evropian.
Komisioni për Ekonominë dhe Financat
Shqyrtimi në seancë plenare: 21.02.2008
Ligji është miratuar me 81 vota pro, 0 kundër, 0 abstenime.
Shumica e kërkuar: e thjeshtë

Ligji ka për qëllim ngritjen e një infrastrukture ligjore, të standardizuar dhe të përshtatshme, për situatën aktuale në vend, për krijimin dhe zhvillimin e një tregu financiar të shëndoshë, të besueshëm, funksional, si dhe për integritet të titujve, në përputhje me standardet bazë evropiane, të përcaktuara nga acquis communautaire, në këtë fushë. Ligji për titujt dhe ofertën publike të tyre përfaqëson fazën e parë të përafrimit të legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Evropian. Dhe është bazuar në parimet bazë për klasifikimet e titujve, shërbimet financiare të investimit dhe emetimin e tyre, personat e autorizuar për kryerjen e transaksioneve me to, si dhe shërbimet e tjera, që kanë të bëjnë me këshillimin e investitorëve për investimin e fondeve të tyre në titujt, regjistrimin dhe kujdestarinë e titujve, ruajtjen e integritetit dhe besueshmërisë ndaj tregut".

I.11. Një ligj bashkëkohor i së drejtës

Diskutimi në seancë plenare mbi projekt ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"

Tiranë, date 14.04. 2008

Të gjithë e dimë se veprimtaria tregtare është zemra e sistemit të ekonomisë së tregut, në të cilin Shqipëria ka rreth 15 vite që ka hyrë. Në demokraci, liria e iniciativës në fushën e tregtisë, është një nga të drejtat e garantuar për subjektet e së drejtës. Ushtrimi i kësaj veprimtarie, ashtu si edhe i shumë veprimtarive të tjera që realizohen në shoqëri, normohet nga rregulla ligjore të cilat krijojnë garanci për ushtrimin efikas të veprimtarisë tregtare dhe pakësojnë mundësinë e abuzimit në këtë fushë. Sipërmarrësit (tregtarë apo shoqëri tregtare) kanë nevojë për rregulla të sakta dhe të qarta ligjore, në mënyrë që klima e biznesit të jetë e favorshme dhe nxitëse për zhvillimin e veprimtarive ekonomike, të cilat në fund të fundit ndikojnë drejt për drejtë në rritjen ekonomike të vendit tonë.

Në nenin 11 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcaktohet se:

1. Sistemi ekonomik i Republikës së Shqipërisë bazohet në pronën private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe lirinë e veprimtarisë ekonomike.

2. Prona private dhe publike mbrohen njësoj.

3. Kufizime të lirisë së veprimtarisë ekonomike mund të vendosen vetëm me ligj dhe vetëm për arsye të rëndësishme publike.

Rregullimi juridik i biznesit në Shqipëri dhe në veçanti i tregtarëve dhe shoqërive tregtare, daton që në fillimet e shtetit shqiptar dhe posaçërisht gjatë periudhës së mbretërimit të Zogut. Në planin historik, rregullimi i parë i mirëfilltë ligjor në Shqipëri, në fushën e së drejtës tregtare, ishte Kodi Tregtar i Zogut, i vitit 1932, hartuar nën drejtimin e statistit Mehdi Frashëri. Ky Kod përbënte një kornizë të plotë ligjore për ushtrimin nga tregtarët dhe shoqëritë

tregtare të veprimtarisë tregtare. Kodi Tregtar i vitit 1932 ishte mjaft i plotë dhe modern për kohën, pasi për hartimin e tij u morën si model legjislacionet e vendeve të zhvilluara perëndimore të kohës (p.sh Italia).

Gjatë sistemit totalitar 50 vjeçar, e drejta tregtare u tkurr gradualisht duke u kufizuar vetëm në format e ndërmarrjeve shtetërore dhe kooperativave të kohës, pasi të gjithë e dimë se në atë kohë u ndalua plotësisht veprimtaria private në fushën e tregtisë.

Vetëm me ardhjen e demokracisë, sistemi ligjor shqiptar rifilloi të pasurohej me ligje që rregullonin dhe normonin veprimtarinë ekonomike, përfshirë këtu edhe format e organizimit tregtar. Ligji nr. 7512, datë 10. 08. 1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private dhe nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit", çeli rrugën e gjatë dhe të vështirë të riformatimit të sistemit ligjor shqiptar, për t'ju përshtatur ekonomisë së tregut në rrugën drejt së cilës hyri Shqipëria. Në vijim u miratuan ligji nr. 7632, datë 04. 11. 1992 "Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të Kodit Tregtar", ligji nr. 7638, datë 19. 11. 1992 "Për shoqëritë tregtare" dhe ligji nr. 7667, datë 28. 01. 1983 "Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare".

Në miratimin dhe adoptimin e ligjeve të mësipërme u morën për bazë modelet e legjislacionit perëndimor të kohës. Më lejoni të falënderoj dhe t'i bëjmë homazh veprimtarisë dhe punës së palodhur shkencore në mendimin ekonomik të Dr Baki Berberi këshilltari dhe drejtuesi i grupeve të punës që përgatitën këtë legjislacion në vitet 1991-1994. Doktori i Shkencave z. Baki Berberi në librin e tij për shoqëritë tregtare ka theksuar se, ligji ynë për shoqëritë tregtare është huazuar nga ligji francez nr. 66-537 "Mbi shoqëritë tregtare", por pa rimarrë shumë nene nga ky i fundit. Sipas Dr. Berberit, ligji ynë "Për shoqëritë tregtare" (që është edhe sot në fuqi me disa ndryshime) u miratua në një kohë kur nuk kishte dalë ende Kodi Civil dhe ky fakt bëri që në ligjin tonë të inkorporoheshin edhe disa dispozita që i gjejmë në Kodin Civil Francez. Legjislacioni tregtar në Shqipëri, karakterizohej edhe nga disa pasaktësi dhe zbrazëti në shkrimin e dispozitave të ndryshme, çka ka krijuar paqartësi për zbatuesit e këtyre ligjeve. Këtij fakti i shtohet edhe mungesa në masë të madhe e literaturës dhe punimeve juridike që duhet të kishin për qëllim qartësimin e mëtejshëm të kuptimit të dispozitave të ndryshme tregtare. Sidoqoftë këtu mbetet të përmendet se Doktori i Shkencave z. Baki Berberi, i cili ndonëse kishte një profil profesional fondamental ekonomik dhe jo juridik, ka luajtur një rol të rëndësishëm në plotësimin e vakumit interpretative të dispozitave

të ligjeve tregtare, nëpërmjet botimit të disa librave dhe artikujve shkencorë në këtë drejtim.

Në fakt një nga të metat e legjislacionit tonë tregtar ka konsistuar në faktin se ai është shtrirë në shumë ligje të veçanta (rregullimet e të cilëve jo vetëm binin ndesh me njëri-tjetrin), duke ndjekur kësisoj një metodë legjislative të shpërndarë në krahasim me atë që konsiston në miratimin e një Kodi Tregtar, që të përmbledhë në vetvete të gjitha çështjet që lidhen me veprimtarinë tregtare, tregtarët dhe shoqëritë tregtare, përfshirë këtu edhe regjistrimin, likuidimin dhe falimentimin etj, të subjekteve tregtare. Natyrisht që realizimi i një Kodi Tregtar kërkon një punë të mundimshme dhe të gjatë, por që në fund të fundit përbën një arritje më vete, në aspektin e ruajtjes dhe forcimit të asaj tradite juridike shqiptare që ka qenë krijuar që në vitet 30 të shekullit të kaluar. Hartimi i ligjeve të veçanta në fushën tregtare bën që kuorumi i nevojshëm për miratimin e tyre, konform nenit 81 të Kushtetutës, të mos jetë tre të pestat, çka do të ndodhte nëse do të hartohej një Kod Tregtar. Në këtë pikëpamje miratimi i ligjeve të veçanta në fushën e së drejtës tregtare, ka edhe anën e saj pozitive, pasi bën që kjo e drejtë të jetë më fleksibël për t'ju përshtatur ndryshimeve që mund të diktohen nga evolimi i marrëdhënieve ekonomike dhe përshtatja e mëtejshme me legjislacionin e Bashkimit Evropian (*acquis communitaire*).

Është krejt e natyrshme dhe e justifikueshme që, për kohën (1992-1993) kur janë hartuar tekstet e ligjeve tregtare, të jenë lejuar inkoherenca, pasaktësi në ndonjë formulim apo edhe në përkthimin nga origjinali në gjuhë të huaj prej nga është marrë teksti i njërës apo tjetrës dispozitë. Megjithatë, nuk janë këto që ndikojnë aq shumë nevojën e përmirësimeve të këtij legjislacioni, se sa arsyet që lidhen me përafrimin e legjislacionit tonë me atë të Bashkimit Evropian dhe të reflektimit të kushteve dhe kërkesave të sotme në fushën e tregtisë, në kuadër edhe të globalizimit dhe integrimit gjithnjë e më të madh të tregjeve në botë (përfshirë dhe Shqipërinë).

Sidoqoftë duhet theksuar se ligji nr. 7638, datë 19. 11. 1992 "Për Shoqëritë Tregtare" së bashku me ligjin nr. 7632, datë 04. 11. 1992 "Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të Kodit Tregtar" dhe ligje të tjera, shërbyen për krijimin dhe disiplinimin e veprimtarisë së subjekteve tregtare, parë kjo kryesisht në aspektin e shoqërive tregtare private dhe jo atyre publike (të cilat ekzistonin edhe më parë). Nëpërmjet këtyre ligjeve u njohën katër lloje shoqërish tregtare (shoqëria kolektive, shoqëria komandite, shoqëria me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëria anonime), të cilat mund të paraqiteshin në qarkullimin juridik si subjekte të së drejtës. Shoqëritë më të përhapura

mbetën ato me përgjegjësi të kufizuar (SHKP) dhe shoqëritë anonime (SHA). Ligjet e mësipërme rregullonin përkufizimin e tregtarit dhe të shoqërisë tregtare, veprimtarinë tregtare, formalitet dhe kushtet që duheshin ndjekur e respektuar për themelimin e regjistrimin e këtyre subjekteve tregtare, kuptimin dhe përmbajtjen e statutit dhe aktit të themelimit, selinë, personalitetin juridik të shoqërive tregtare, përgjegjësinë për themelim të parregullt të shoqërive tregtare, organet e shoqërive të ndryshme (administratorët, asambleja e ortakëve, drejtoria këshilli mbikëqyrës, asambleja e aksionerëve etj), veprimtarinë e administrimit të shoqërisë tregtare, shndërrimin e shoqërive tregtare, prishjen, bashkimin apo ndarjen e këtyre shoqërive, si dhe likuidimin.

Zhvillimet e reja ekonomike në vend dhe detyrimi i përafrimit të legjislacionit tonë tregtar me atë të Bashkimit Evropian, bën që të lindë nevoja për miratimin e një ligji të ri "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" që të reflektojë në të eksperiencën më të mirë të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, në optikën e rregullimeve të legjislacionit të BE-së, qoftë ai parësor (traktatet) apo dytësor (rregulloret apo direktivat).

Në këtë kuadër ligji i ri "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i cili do të miratohet sot, duket se është strukturuar në mënyrë më cilësore në raport me ligjet që janë sot në fuqi dhe përmbledh në vetvete rregullimet e duhura ligjore në funksion të përqasjes së legjislacionit tonë tregtar me atë të Bashkimit Evropian. Miratimi i këtij ligji është në vazhdën e reformimit të legjislacionit tonë tregtar, ku një vend të rëndësishëm zë edhe ligji nr. 9723, datë 03. 05. 2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Në ligjin e ri vihet re një referim i shpeshtë pikërisht tek ligji i mësipërm.

Ligji i ri "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" ripërcakton se shoqëritë tregtare janë shoqëritë kolektive, shoqëritë komandite, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare. Këtu vihet re një ndryshim në emërtim i shoqërive që më parë quheshin anonime dhe tashmë emërtohen aksionare.

Ky ligj rregullon në mënyrë të përgjithshme mënyrën e themelimit të shoqërive tregtare dhe referon për elementë të ndryshëm (si p.sh përmbajtja e statusit) tek ligji nr. 9723, datë 03. 05. 2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Vihet re se ky ligj përfshin në vetvete dhe mban parasysh zhvillimet më të fundit teknologjike, sic është p.sh: komunikimi nëpërmjet internetit.

Në ligj përcaktohen më qartë parimet kryesore të funksionimit të shoqërive tregtare, ku detyrimi i besnikërisë merr një pozitë të veçantë. Transparenca e funksionimit të shoqërisë tregtare,

garantohet nga e drejta e informimit që kanë ortakët apo aksionerët e shoqërisë nga personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë. Mjaft interesant paraqitet neni 16 i ligjit që flet për abuzimin me detyrën dhe formën ligjore të shoqërisë dhe që mundëson, në kushte të caktuara, shndërrimin e përgjegjësisë nga e kufizuar në të pakufizuar. Ndalimi i konkurrencës dhe sekreti tregtar paraqiten si risi në mënyrën se si janë konceptuar në nenet 17 e 18 të ligjit. Një dallim thelbësor që vihet re në ligjin e ri të miratuar tashmë dy ditë më parë, në raport me ligjin që është në fuqi "Për shoqëritë tregtare", lidhet me rikonceptimin e rolit të punëmarrësve në shoqërinë tregtare, duke u krijuar këshilli i punëmarrësve dhe duke u përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e këtij këshilli. Në rastin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar (SHPK), në nenin 70 të ligjit është parashikuar se kjo shoqëri nuk mund të ketë një kapital më të vogël se 100 lekë. Në ligj është përcaktuar më qartë e drejta e ortakëve të një SHPK-je për shpërndarjen e fitimeve.

Risi paraqet edhe përcaktimi më i detajuar i tagrave që kanë organet e shoqërisë më përgjegjësi të kufizuar si dhe rastet e prishjes së kësaj shoqërie dhe modalitetet e largimit apo përjashtimit të ortakëve. Gjithashtu edhe mbrojtja e palëve të treta, kreditorëve, të cilët hynë në marrëdhënie me shoqërinë tregtare është risi e ligjit të ri.

Po ashtu, në rastin e shoqërive aksionere, në ligj janë përcaktuar disa specifikime më të sakta në raport me ligjin "Për Shoqëritë Tregtare" që është sot në fuqi. Mjafton këtu të përmendet dallimi midis aksioneve të zakonshme dhe aksioneve me përparësi, si dhe mënyra e fitimit dhe kalimit të aksioneve. Më tej përcaktimi i marrëdhënieve ligjore ndërmjet shoqërisë dhe aksionerëve i shërben vendosjes së rregullave të sakta për mbarëvajtjen e veprimtarisë së shoqërisë aksionare. Edhe në raport me organet e shoqërisë aksionere, vihet re një evoluim në lidhje me atë që parashikon ligji aktual "Për shoqëritë tregtare", ku përveç asamblesë së përgjithshme është krijuar mundësia që në varësi të statutit të ketë një këshill administrimi (sistemi me një nivel) ose këshill mbikëqyrës dhe një a më shumë administratorë (sistemi me dy nivele). Ligji i ri "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" parashikon në pjesën VII të tij, grupimin e shoqërive, duke bërë rregullime mjaft të rëndësishme në këtë fushë, çka mungon në legjislacionin aktual në fuqi.

Përveç sa më sipër, mund të thuhet se ligji i ri "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i parë në lidhje të ngushtë me ligjet e tjera të miratuara nga Kuvendi si p.sh: ligji " Për Qendrën Kombëtare

të Regjistrimit", ligji "Për titujt", ligji "Për huamarrjen e qeverisjes vendore" etj dhe ligjet që do të miratohen në të ardhmen, përbën kuadrin dhe mjedisin ligjor të kornizuar bindshëm të biznesit në Republikën e Shqipërisë. Nëpërmjet këtyre ligjeve, krijohet më shumë qartësi për sipërmarrësit dhe garanci e lehtësi të tjera për nxitjen e investimeve në vend, duke plotësuar njëherazi edhe kërkesat e marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit (konkretisht nenet 6, 50, 70 respektivisht pikat 1, 3, 2) edhe për më tepër duke përafruar legjislacionin tonë me atë evropian të shoqërive tregtare.

Diskutimi u botua në gazetën Panorama, dt. 16/04/2008

Shënim: Nga *Raporti i Legjislacionit,i cili paraqet një përmbledhje të veprimtarisë ligjvënëse për këtë legjislaturë veçojmë :"*

Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008

"Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Data e hyrjes në Kuvend 27.02.2008

Nismë e Këshillit të Ministrave

Propozuar nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Komisionet parlamentare që kanë shqyrtuar:

Komisioni për Ekonominë dhe Financat.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shqyrtimi në seancë plenare: 14.04.2008

Ligji është miratuar me 79 vota pro, 2 kundër, 2 abstenime.

Shumica e kërkuar: e thjeshtë

Hartimi i një ligji të ri për shoqëritë tregtare bëhet në kuadër të ndryshimeve që kanë ndodhur në ekonominë e vendit gjatë periudhës 15 vjeçare të zbatimit të tij në praktikë të ligjit ekzistues nr. 7638, datë 19.11.1992, kryerjes së një reforme të plotë dhe tërësore të legjislacionit tregtar dhe harmonizimin e tij me ligjin "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", ligjin "Për titujt", si dhe me pjesë të tjera të legjislacionit aktual.". Hartimi i ligjit është kërkesë e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit dhe synon përafrimin me legjislacionin evropian të shoqërive tregtare. Ligji përcakton rregullat për themelimin, administrimin, riorganizimin dhe likuidimin e shoqërive; të drejtat dhe detyrimet e themeluesve, ortakëve dhe aksionarëve, marrëdhëniet ndërmjet ortakëve me njëri tjetrin dhe me të tretët, marrëdhëniet ndërmjet shoqërisë me ortakët dhe aksionerët etj".

I.12. Banka e Shqipërisë, Institucionet Financiare dhe shërbimet e produktet bankare

Diskutimi në seancë plenare mbi raportin vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 2007

Tiranë, 24 Prill 2008

Një pasqyrë e saktë është paraqitja në Kuvend e raportit vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 2007, si një dokument i rëndësishëm që raporton zhvillimet ekonomike në përgjithësi dhe të sektorit bankar në veçanti, pjesë kjo e rëndësishme dhe më shumë e zhvilluar e sistemit financiar në Shqipëri.

Banka e Shqipërisë është rregullatori kryesor financiar në ekonomi, emetuesi i vetëm i monedhës së vendit dhe institucioni përgjegjës për hartimin e zbatimin e politikës monetare. Pa cenuar pavarësinë e saj Banka e Shqipërisë synon koordinimin e politikës së saj monetare me politikën fiskale dhe me politikat e tjera makroekonomike. Vlerësoj se ky institucion në zbatim të ligjit nr 8269 datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" është gjithashtu duke e kryer rolin që asaj i jep ligji si "përgjegjëse për mbikëqyrjen e të gjitha bankave në Republikën e Shqipërisë".

Gjatë vitit 2007 është i dukshëm zgjerimi i aktivitetit bankar si në shtimin e degëve dhe agjencive bankare dhe në drejtim të shtimit të produkteve që bankat kanë ofruar. Indeksi që mat konkurrencën (indeksi H-Herfinadalfit -faqe 72) vazhdon të jetë në rënie nga viti në vit dëshmi kjo e një niveli të rritur të konkurrencës bankare (teorikisht dihet që sa më i ulët indeksi aq më e lartë konkurrenca. Për depozitat-0.17 nga 0.2 që ishte ne 2006; dhe për huat - 0.11 dhe për aktivet 0.15 nga 0.18 që ka qenë në vitin 2006. Këto janë dëshmi e shpërndarjes më të mirë të aktiveve, depozitave dhe kredive ndërmjet bankave të sistemit bankar). Është për tu vlerësuar zgjerimi i aktivitetit bankar, i cili tani ka një shpërndarje më të gjerë në mbi 400 degë dhe agjenci në të gjithë vendin. Por ky zgjerim do të kishte

qenë më i madh nëse shtimi i numrit të degëve dhe agjencive do të ishte shoqëruar dhe me shtimin e licencave të reja bankare. Që prej 3 vitesh sistemi bankar shqiptar mbetet me 17 banka për shkak të ndalimit të licencimit të bankave të reja (faqe 69). Nëse do të marrim parasysh dhe faktin që këtë vit bashkimi i Bankës Italo-Shqiptare me Bankën Amerikane të Shqipërisë (pronë të bankës italiane Intesa San Paolo) normalisht anuloi licencën e BIA-s, atëherë në sistem kemi një bankë më pak. I ndërgjegjshëm se konkurrenca e lartë nuk është e kështillueshme për sistemin bankar, por bazuar në nevojat e një ekonomie në rritje si është ekonomia shqiptare, mendoj dhe besoj se një zgjerim i kontrolluar i sistemit drejt rritjes së numrit të bankave do kishte përparësitë e veta. Në këtë pikë dua të inkurajoj Bankën e Shqipërisë në studimin dhe nxitjen e licencimit të bankave lokale, një mënyrë kjo që mendoj se do i shërbejë shpërndarjes së zhvillimin nga qendra drejt rretheve të tjera të Shqipërisë, problem politik, ekonomik dhe demografik shqiptar.

Në lidhje me funksionimin institucional të Bankës së Shqipërisë konstatohet se gjatë vitit 2007 e në vazhdim ky institucion ka qenë i pavarur në arritjen e objektivave të tij ligjore. Marrëdhënia ndërmjet BSH-së dhe Qeverisë bazohet mbi parimet e bashkëpunimit dhe pavarësisë. Banka e Shqipërisë ka punuar e pa ndikuar nga politika dhe puna e saj nuk është cenuar nga debatet politiko-ekonomike gjë që ndikon në rritjen e efiçencës së punës në këtë institucion duke bërë më të mundshme arritjen e objektivave të politikës monetare që harton dhe zbaton Banka e Shqipërisë. Krahas hartimit dhe zbatimit të politikës monetare, Banka e Shqipërisë kryen detyra rregullatore dhe mbikëqyrëse që lidhen me segmente të sistemit tonë financiar. Pra, BSH promovon stabilitetin e sistemit financiar, duke sinergjizuar politikën monetare dhe mbikëqyrjen bankare. Një sistem financiar i shëndosh, parakusht për stabilitetin e çmimeve, nënkuptohet para së gjithash nga një sistem bankar i shëndosh si pasqyrim dinamik të një ekonomie të qëndrueshme.

Por që të jetë më efektiv dhe më i dobishëm për ekonominë puna e këtij institucioni duhet bashkërenduar me punën e institucioneve të tjera që prekin të njëjtat fusha apo fusha të ngjashme. Ligji nr 8269 datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" në nenin 24 të tij sanksionon që "Banka e Shqipërisë bashkëpunon me organet legjislative dhe ekzekutive të Republikës së Shqipërisë për të përmbushur objektivat e saj dhe në bazë të ligjit, kur e konsideron të nevojshme, ndërmerr veprime për të nxitur këtë bashkëpunim në kryerjen e funksioneve të saj". Sipas raportit që Banka e Shqipërisë ka paraqitur sot në Kuvend, ky detyrim ligjor duket i lënë në plan

të dytë. E them ketë për shkak të mungesës së një pjesë të veçantë në raport në të cilën të paraqitet niveli i bashkëpunimit të Bankës së Shqipërisë me institucionet e tjera financiare në vend dhe veçanërisht me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, Autoritetin e Konkurrencës dhe Drejtorinë e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Agjencinë e Sigurimit të Depozitave etj. Me këtë dua të inkurajoj një bashkëpunim më të dukshëm me këto institucione pasi besoj se kjo do t'i shërbejë jo vetëm punës së këtyre institucioneve por dhe arritjes së objektivave të vetë Bankës së Shqipërisë. Rritja dhe nxitja e konkurrencës në sistemin bankar kërkon në veçanti përfshirjen e Autoritetit të Konkurrencës, krahas çështjeve rregullatore. Kjo përfshirje duhet të mbështesë pavarësinë dhe kapacitetet teknike të të dy institucioneve me qëllim krijimin e kushteve të konkurrencës së ndershme në segmentet e industrisë financiare duke mos favorizuar askënd.

Duke mbetur tek bashkëpunimi, vlerësoj nivelin e bashkëpunimit që Banka e Shqipërisë ka arritur me institucionet ndërkombëtare financiare dhe simotrat e saj të vendeve të tjera. Në veçanti dua të përqëndrohem tek bashkëpunimi me Autoritetin Qendror Bankar në Kosovë, i cili rezulton i zbehtë deri me tani siç dhe e dëshmon raporti në fjalë. Shtimi i kontakteve me autoritetet financiare dhe bankare në Kosovë bëhet imperativ sidomos tani pas zhvillimeve politike të cilat kristalizuan pavarësinë e Kosovës. Bashkëpunimi në nivel qendror dhe njëkohësisht nxitja e bankave të nivelit të dytë për të parë mundësitë e zgjerimit drejt Kosovës, krijojnë një bazë të mirë për rritjen e bashkëpunimit ekonomik mes vendeve tona, jo vetëm në sektorin bankar, por edhe në sektorët e tjerë. Për shkak të lehtësirave që ofron infrastruktura bankare për ekonominë ky bashkëpunim duhet të paraprijë dhe bashkëpunimet e tjera ne sektorë të tjerë të ekonomisë. Dua të theksoj se rritjen e bashkëpunimit nuk e kërkoj thjesht dhe vetëm për motive patriotike por e mbështes në bindjen time se kjo është një mundësi e mirë për interes dhe përfitim të përbashkët. Kjo sinkronizon më së miri dhe me projektet e tjera te përbashkëta të tilla si rruga Durrës- Prishtinë të orientuara nga qeveria Berisha dhe zhvillimet integruese të dy shteteve tona drejt të ardhmes së përbashkët në Bashkimin Evropian.

Ndonëse jo të pasqyruara drejtpërdrejtë në këtë raport, mendoj se sistemi bankar shqiptar përgjithësisht ka përmirësuar jo vetëm sasinë por dhe cilësinë e shërbimeve. Por përsëri mbeten akoma për t'u bërë në funksion të përmirësimeve të mëtejshme. Një rrugë e mundshme për përmirësim është minimizimi i mëtejshëm i pagesave cash në ekonomi. Fushatat sensibilizuese dhe puna që

Banka e Shqipërisë ka bërë në vite për këtë gjë mendoj se i kanë dhënë frytet e veta në një shtim të shërbimeve bankare sidomos prirjeve drejt masivizimit të llogarive bankare dhe kartave të pagesës. Këtu dua të theksoj dhe bashkëpunimin nga ana e qeverisë e cila ka ndihmuar duke kanalizuar pagat e buxhetorëve nëpërmjet bankave. Kushtëzimi i një praktike të tillë edhe për bizneset private do të çojë më tej përdorimin e shërbimeve bankare të pagesave duke minimizuar pagesat cash në ekonomi.

Por mendoj se objektivi në këtë drejtim do të ishte arritur më mirë nëse në këtë proces do të kishte një bashkëpunim edhe nga ana e sistemit bankar. Bankat e nivelit të dytë nuk duhet ta shohin veten vetëm si përfituese në këtë proces por mendoj se duhet të bëjnë më shumë për mbështetjen dhe masivizimin e shërbimeve bankare. E them këtë pasi akoma dhe sot ndeshim komisione të larta në shërbime bankare të cilat për raste të veçanta shkojnë deri në 3 %. Sipas një llogaritje të thjeshtë, një biznes në Shqipëri i cili ka një marzh fitimi neto prej 15%, nëse përdor një shërbim bankar për të cilin do duhet të paguajë një komision sa 3% të xhiros i bie që t'i paguajë bankës një shumë sa 20% të fitimit të tij neto, kosto kjo më e madhe se vetë norma aktuale e tatimit. Pra me këto nivele komisionesh shërbimet bankare shkaktojnë për bizneset një kosto të krahasueshme me pagesat e tatimit ose e thënë ndryshe një tatim të dytë. Kostoja e shërbimeve bankare duhet të jetë në nivele atraktive për biznesin, duke bërë më tërheqës krejt sistemin bankar të aftë që t'i bashkëngjitet përpjekjeve të Qeverisë për formalizmin e ekonomisë shqiptare.

Në kuadër të përmirësimit të produkteve dhe shërbimeve bankare, vërehet një shtim dhe përmirësim të produkteve bankare gjatë vitit 2007. Kjo natyrisht që është shpejtuar dhe nga rritje e konkurrencës së sistemit bankar. Por për përmirësimin e shërbimeve, mendoj se Banka e Shqipërisë duhet t'i kushtojë më tepër vëmendje transparencës së çmimeve për shërbimet që bankat ofrojnë. Në rolin e saj si bankë e bankave, Banka e Shqipërisë duhet të jetë mbrojtëse e interesave të publikut duke orientuar sistemin bankar drejt një niveli të ulët risku dhe një niveli të lartë transparence dhe korrektësie. E theksoj këtë pasi akoma dhe sot në tregun bankar gjen banka të cilat nuk reklamojnë me transparencë dhe vërtetësi çmimet e produkteve të tyre, dhe sidomos huave. Kjo jo vetëm që prek interesat e publikut por cenon dhe funksionimin e sistemit bankar. Pra rritja e transparencës besoj do ti shërbejë jo vetëm publikut që përdor shërbimet bankare, por dhe vetë bankave të cilat në thelb mbeten biznese që njëherazi i shërbejnë dhe përfitojnë prej tij.

Duke mbetur tek transparenca, është për t'u vlerësuar angazhimi i Bankës së Shqipërisë në krijimin e regjistrit të kredive. Në bazë të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", në nenin 127 të tij që në pikën e parë sanksionohet që "Banka e Shqipërisë mban Regjistrin e Kredive, i cili përmban informacion në lidhje me kreditë që bankat dhe degët e bankave të huaja u japin klientëve të tyre". Këtë detyrim ligjor të Bankës së Shqipërisë e shoh në rrugën e përmbushjes dhe këtë e vlerësoj së një ndër zhvillimet më të rëndësishme të sistemit bankar në kuadër të rritjes së sigurisë së tij. Ky është një zhvillim që është jetik sidomos në kushtet e sotme ku niveli i kredisë në sistemin bankar është rritur me hapa të shpejtë nga viti në vit.

Por edhe pse në rritje, bankat përsëri angazhojnë një pjesë jo të vogël të burimeve në blerjen e bonove të thesarit. Një shqetësim që do të doja të ngrija në lidhje me këtë pikë ka të bëjë me vazhdimin e normave të larta të interesit për këto instrumente. Që prej shumë vitesh qeveria siguron një pjesë të burimeve te financimit nëpërmjet huamarrjes nga publiku me anë të shitjes së bonove të thesarit. Shqetësimi këtu qëndron tek normat e larta të interesi të cilat në pjesën më të madhe i përfitojnë bankat. Viti 2007 jo vetëm që ruajti por theksoi rritjen e normave të interesit për bonot e thesarit. Bankat e nivelit të dytë vazhdojnë të sigurojnë fitim të pastër në kurriz të buxhetit të shtetit për shkak se nga mënyra e zhvillimit të ankandit normat e interesit për bonot e thesarit mbeten të larta. Nuk ka dyshim se gjendemi në një situatë alogjike financiare në të cilën bonot e thesarit, instrumenti më i sigurt ne vend, paguajnë norma interesi më të larta se depozitat bankare. Në këtë pikë mendoj se Banka e Shqipërisë përveç ndërhyrjeve që ka bërë në këtë treg për stabilizimin e normave të interesit duhet të inkurajojë pjesëmarrjen e publikut në blerjen e bonove. Ky inkurajim i shoqëruar dhe me një liberalizim të vërtetë të tregut do të ulte koston e borxhit për qeverinë nga njëra anë, si dhe do të rriste përfitimet nga investimi për publikun, nga ana tjetër. Gjithashtu kjo do të shërbente dhe si një sinjal pozitiv për bankat që të menaxhojnë më mirë burimet e tyre drejt financimit të ekonomisë reale. Me këtë dua të theksoj që autoritetet përgjegjëse që drejtojnë këto operacione të ligjshme e të nevojshme financiare nuk mund të vazhdojnë "të fshihen" pas parimeve klasike të ekonomisë së tregut, apo "dorës së padukshme" të Adam Smithit që tani mësohet që në leksionet e shkollës së mesme, por të vazhdojnë të inkurajojnë liberalizimin e tregut, transparencën e tij, shtimin e aktorëve etj. Hapja funksionale e rrjetit për tregun sekondar të bonove të thesarit, rritja e pjesëmarrjes së individëve

në tregun e bonove të thesarit si dhe diversifkimi i shërbimit të tyre duhet të përbëjë një prioritet të bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Bankës së Shqipërisë.

Dhe në tërësi e rëndësishme është të kuptohet që administrimi i borxhit publik, të brendshëm dhe të jashtëm, përbën një sfidë të përbashkët si për Ministrinë e Financave dhe Bankën e Shqipërisë.

Në fund, por jo më pak e rëndësishme se çështjet e përmendura më lart, do të doja të theksoja rolin e Bankës së Shqipërisë në zhvillimin e ekonomisë. Këtu dua të ndalem tek bujqësia. Duke lexuar të dhënat që raportohen për bujqësinë, si çdo shqiptar, ndjehem i pakënaqur për agoninë e këtij sektori dhe besoj se mund të gjenden rrugë për mbështetjen e tij. Shqipëria vërtet ka marrë rrugën drejt shërbimeve por kjo nuk justifikon lënien në harresë të bujqësisë. Akoma dhe sot një numër i madh familjesh sigurojnë të ardhurat e tyre nga puna në bujqësi dhe ndikojnë në ekonominë e tyre veçmas dhe në atë kombëtare së bashku. Banka e Shqipërisë nuk duhet të mbetet thjesht në pozicionin e raportuesit por duhet të kërkojë rrugë për inkurajimin e këtij sektori duke orientuar bankat e nivelit të dytë që të prodhojnë produkte që mund ti shërbejnë dhe bujqësisë.

Në përfundim paraqitja e Raportit Vjetor të Bankës së Shqipërisë sot, si një detyrim ligjor i drejtuesve të këtij institucioni ndaj Kuvendit, që zgjedh dhe emëron anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës dhe Guvernatorin, është në respekt dhe dobi të deputeteve, Guvernatorit e drejtuesve të bankës dhe në shërbim të publikut.

Diskutimi u botua në gazetën Panorama në dy pjesë. Dt. 26/04/2008 me titull "Banka e Shqipërisë dhe Institucionet" dhe pjesa e dytë dt. 28/04/2008 "Shërbimet dhe produktet bankare"

I. 13. Nxitës dhe avokat i konkurrencës

Diskutimi në në seancë plenare mbi raportin vjetor të Autoritetit të Konkurrencës

Tiranë, datë 29. 04. 2008

Veprimtaria e Autoritetit të Konkurrencës është realizuar sipas angazhimeve te marra për të siguruar një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg në zbatim të ligjit Nr. 9121 dt. 28. 07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" si dhe të gjithë kuadrit ligjor që rregullon aktivitetin e një institucioni të pavarur në Republikën e Shqipërisë. Ky institucion ka funksionuar si nxitës dhe avokat i konkurrencës midis palëve në treg dhe i mbrojtjes së interesave të konsumatorit, me synimin final që tregu të gjenerojë zhvillim përmes një konkurrence të ndershme.

Gjatë vitit të kaluar Parlamenti Shqiptar dhe Qeveria krijoi mundësinë e aplikimit të një strukture të re organizative si dhe të shtimit të numrit të stafeve të specialistëve. Ky suport është justifikuar nga Autoriteti i Konkurrencës duke rritur rastet e ndërhyrjes në treg për praktikat anti konkurruese në përputhje me ligjin, si dhe është rritur prania e tij pranë institucioneve të ekzekutivit, nëpërmjet vendim-marrjeve, rekomandime për aktet ligjore dhe rregullative. Ky institucion ka vepruar duke vlerësuar me seriozitetin maksimal angazhimet e shprehura në rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë "Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2006".

Një nga aspektet kryesore, e cila është konsideruar edhe një nga sfidat kryesore ishte ngritja dhe krijimi i kulturës për një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg, ndërgjegjësimi i komunitetit të biznesit dhe konsumatorëve për efektet pozitive që sjell konkurrenca në treg. Duke ndjekur me vëmendje zhvillimet në treg në aspektin e konkurrencës, Autoriteti i Konkurrencës ka arritur të mbyllë me sukses hetimet e nisura dhe të hapë një sërë hetimesh të reja në sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Ndërhyrjet e Autoritetit të

Konkurrencës për rivendosjen e konkurrencës në treg janë shtrirë në sektorë të rëndësishëm të ekonomisë si telekomunikacioni, tregu i sigurimeve, betoni, energjia etj. Në përgjithësi është arritur progres në fushën e konkurrencës, fakt i cili është evidentuar edhe nga Raporti i Progresit të Komisionit Evropian. Për herë të parë Autoriteti i Konkurrencës u shpreh me një vendim të veçantë duke gjobitur për abuzim me pozitën dominuese dy kompanitë celulare, apo është shprehur për ndalimin e marrëveshjeve në tregun e sigurimeve, të bukës dhe atë të prodhimit të betonit. Por efiçenca e këtyre vendime nuk mund të realizohet pa një sistem (veprim) efektiv të sistemit gjyqësor (pasi vendimet e AK janë të ankimueshme në gjykatë). Për më tepër veprimtaria e këtij institucioni të ri në lidhje me një nga praktikat anti konkurruese është pezulluar me një vendim të Gjykatës së Tiranës. Në këtë mënyrë është cenuar misioni kryesor i funksionimit te Autoritetit, i cili është miratuar nga Kuvendi me anë të ligjit 9121 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës". Është dashur rreth një vit që të filloj procesi pranë gjykatës së faktit Tiranë, për më tepër, ka që në vitin 2005 pa përfunduar proceset gjyqësore për vendimet e ndërmarra nga ky institucion (vendimi i AK për gjobën për refuzimin e dhënies së informacionit ndaj AMC 1.6 milion lekë). Ky institucion si vëzhgues i tregut na informon se ekonomia shqiptare ka hyrë në një proces të shit/blerjes së aksioneve apo të përqëndrimeve midis firmave jo vetëm në tregun financiar (bankar dhe sigurimeve) por edhe në sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Ky fakt flet se volumet e punës që përballon ky institucion janë gjithënjë e në rritje.

Autoriteti i Konkurrencës nuk mund të funksionojë i shkëputur nga institucionet që monitorojnë aspekte të veçanta të tregut si: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, INSTAT, etj. Mbështetja dhe sigurimi i informacionit të kërkuar nga Autoriteti duhet të ketë përparësi nga këto institucione, pasi nga sigurimi në kohë i informacionit krijohet mundësia e marrjes së vendimeve në kohë reale. Në përmbushje të detyrimit ligjor të tij ky institucion ka për detyrë që të vlerësojë aktet ligjore, funksion i cili nuk mund të realizohet plotësisht pa ekzistencën e vullnetit dhe të kujdesit të të gjitha institucioneve të legjislativit, ekzekutivit dhe enteve rregullatore që ta informojnë me draftet përkatëse të këtyre akteve. Për të sensibilizuar këto institucione si dhe për të tërhequr vëmendjen e tyre, autoriteti ka hartuar dhe miratuar udhëzuesin për vlerësimin e pasojave të legjislacionit mbi konkurrencën, i cili i adresohet të gjitha njësive parlamentare dhe qeveritare, si dhe enteve rregullatore sektoriale të cilat ndërmarrin hartimin e akteve

normative. Personalisht vlerësoj gjithashtu botimin e dy vëllimeve të buletineve të veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës që nga viti 2004 si një shembull përveç të tjerash edhe i transparencës. Transparenca dhe vetëm transparenca duhet të karakterizojë punën e të gjitha ministrive dhe institucioneve të varësisë, si një cilësi e kësaj mazhorance përballë një opozite shpesh herë agresive.

Të nderuar kolegë, duke reflektuar se në ç'mënyrë mund të ndihet veprimtaria e Autoritetit në mbrojtje të konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, mendoj se, në një zë të vetëm duhet të theksojmë detyrimin ligjor që kanë të gjitha institucionet e ekzekutivit, për ta konsideruar me prioritet opinionet dhe vendimet e Komisionit të Konkurrencës. Pasi, ky organ është përbërë nga njerëzit më profesionalist (kujtoj që kryetari i Autoritetit është doktoruar në Angli, në fushën ekonomike), me integritet personal, dhe të përkushtuar ndaj detyrës, cilësi për të cilat ky parlament ka dhënë votën e tij. Autoriteti sot është shndërruar në një institucion serioz të pavarur e bashkëkohor, në ndryshim të thellë me atë të para vitit 2005, ku problemi kryesor ishin sherret e kryetarit dhe zv.kryetarit për vulën e institucionit. Nëse Autoriteti i Konkurrencës has vështirësi në marrjen e informacioneve apo në përmbushjen e detyrimeve ligjore nga institucionet e tjera publike dhe te ekzekutivi, atëherë e ftoj Autoritetin të informojë dhe të raportojë pranë Kuvendit të Shqipërisë.

Në përfundim të këtij diskutimi dua të vlerësoj dhe inkurajoj drejtuesit e Autoritetit të Konkurrencës që me profesionalizëm po realizojnë detyrimet ligjore të shprehura në mënyrë sintetike në nenin 1 të ligjit Nr. 9121 dt. 28. 07. 2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" duke realizuar qëllimin e ligjit që është "Mbrojtja e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, duke përcaktuar rregullat e sjelljes së ndërmarrjeve, si dhe institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e konkurrencës dhe përgjegjësitë e tyre".

Diskutimi u botua në gazetën Rilindja Demokratike, dt. 01/05/2008

I.14. Imuniteti i deputetit?! - Një nen i vetëm

Diskutim në seancë plenare, çështje jashtë rendit të ditës.

Tiranë, datë 08.05.2008.

Të dhënat më të fundit të sondazhit të Institutit për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi të miratuara nga USAID-i, Agjencia e Shteteve të Bashkuara të Zhvillimit Ndërkombëtar, për sa i përket besimit ndaj Institucioneve të Parlamentit (me 39.5 pikë) apo Partive Politike (me 31.9 pikë), [nga 100 pikë vlerësimi maksimal–shumë besim], tregojnë që besimi i qytetarëve tek institucionet vazhdon të mbetet i ulët.

Këto rezultate kthejnë edhe një herë, por tashmë të shumëfishuar në optikën qytetare një kërkesë të drejtë të opinionit publik për sa i përket problemit të imunitetit të veçantë që gëzojnë elemente të caktuara të shoqërisë shqiptare, të zgjedhur apo të emëruar, partiak apo jopartiakë, në legjislativ, ekzekutiv e gjyqësor.

Në këtë diskutim do të fokusohem në problemin e imunitetit të deputetëve të kësaj Legjislature e në tërësi të imunitetit të deputetit si pararendës për zgjidhjen e një morie problemesh.

Sot, më shumë se kurrë vendosja e një standardi të qartë dhe të zbatueshëm, të lehtësuar nga pasojat e qëllimshme apo jo të imunitetit politik është një element thelbësor në zhvillimin social, politik dhe ekonomik të vendit, i cili do të jetë përcaktues veçanërisht në fushatën kombëtare kundër korrupsionit që tashmë ka përfshirë vendin tonë, duan apo s'duan politikanët, të vjetër e të rinj, të majtë, të djathtë e të qendrës.

Problemi tashmë është në skakierën jo vetëm politike, por kombëtare mbi të gjitha, për zgjidhje dhe kërkon nga ne, deputetët aktual, nëse do të bëhemi pjesë e zgjidhjes politike duke vlerësuar ata që na kanë zgjedhur, vetveten, moralin e më gjerë apo do të vazhdojmë të zvarritemi si deri më sot, si pjesë gangrenizuese e këtij problemi.

Imuniteti politik i deputetëve, i parlamentit shqiptar sot në kuadrin e zhvillimit ekonomik e shoqëror të vendit tashmë shihet qartë se është anakronik, jo pozitiv dhe në kundërshtim me parimet themelore të Kushtetutës dhe barazisë para ligjit. Ky imunitet që ne vazhdojmë ta mbajmë, të kujton maksimën e njohur Orëelliane të shprehur tek "Ferma e kafshëve" se, " të gjitha kafshët janë të barabarta, por disa kafshë janë më të barabarta se të tjerat".

Një sondazh ndërkombëtar i para disa viteve i "Gallup International" aktual për ne, shqiptarët sot, jepte se, 63% e vlerësonin imunitetit ndaj ndjekjes penale të zyrtarëve parlamentarë e shtetëror si shkakun kryesor të rritjes së korrupsionit në vendin e tyre, duke theksuar irritimin për faktin se politikanët e dyshuar për korrupsion shpesh gëzojnë imunitet nga krime të tilla si, ryshfetet politike, skandalet për konflikte interesash dhe korrupsioni. Ky sondazh ndërkombëtar për vende demokratike e properëndimore s'ka nevojë për koment, se sa aktual e domethënës është për ne, klasën politike shqiptare.

Imuniteti për deputetin dihet që është një formë e vjetër sa vet politika si një mjet për mbrojtjen e figurave të larta shtetërore dhe gjykatësve. Por debati për këtë problem në kohë ka njohur mendime nga më të ndryshme. Në thelb imuniteti njeh dy kategori ose parime:

- parimi i mos përgjegjësisë ose i mos mbajtjes përgjegjësi për fjalën e thënë (shprehur në Parlament e debate politike). Kjo është mbrojtja e parë bazë që u jepet politikanëve dhe i referohet pra kryesisht atyre.

- parimi i paprekshmërisë (pacenueshmëria), që i referohet një mbrojtjeje më të gjerë e elastike, që e imunizon, mbron deputetin për të mos u vëzhguar, hetuar apo arrestuar (në rast se ka të dhëna për shkelje ligji).

Parimi i parë, ai i mos përgjegjësisë apo mos mbajtjes përgjegjësi për fjalën dhe mendimet e shprehura i referohet votimit dhe deklarimeve apo qëndrimeve të tjera zyrtare në të cilat duhet të mbrohen interesat e njerëzve që përfaqësojnë parlamentin, duke u lidhur ngushtë me parimin e mos kushtëzimit të lirisë së fjalës ai bazohet në mirëkuptimin e pashpallur që akuzat apo deklaratat të pabazuara, shpifëse do të reduktohen në minimum. Ky parim përgjithësisht është absolut. Por elementë të këtij parimi përgjithësisht janë të çimentuara tashmë në realitetin shqiptar, falë te tjerave edhe guximit, analizës, mprehtësisë të një sërë gazetash, analistësh, opinionistësh apo politikanësh të rinj tashmë në partitë politike pa imunitetin e deputetit por me energjinë që të jep fjala e

lirë, e mençur dhe analitike. Aty ku shkelet e drejta për lirinë e fjalës vet institucioni i ka në dorë rregullat e përgjegjësitë ligjore për të pezulluar përkohësisht një parlamentar në rast shkelje (më gjerë këto shkruhen në Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë).

Në dallim nga parimi i mos mbajtjes së përgjegjësisë apo i lirisë së fjalës i cili është gjerësisht i pranuar pa ngjallur polemika, parimi tjetër, parimi i dytë ai i paprekshmërisë (pacenueshmërisë) apo i ekzagjerimit në të drejta është mjaft kundërshtues në ditët e sotme dhe varet gjerësisht nga mjedisi dhe kornizat politike. Në disa vende debatet kanë çuar në reformimin procedurave ligjore dhe në ndryshimin e politikave që ndjekin legjislaturat parlamentare, pra thënë ndryshe vihen kufizime në shkallën e paprekshmërisë. Përgjithësisht imuniteti i politikanëve synon të krijojë tre kushte për ta:

Së pari: ai siguron se deputeti mund të shprehet pa pasur frikën e sanksioneve civile, penale apo cenon reputacionin për të.

Së dyti: imuniteti mbron deputetin nga ndalimi arbitrar që mund ti pengojë ata të marrin pjesë në mbledhjet e Kuvendit

Së treti: imuniteti shërben si mburojë ndaj ndjekjes penale, keqdashëse për arsye politike.

Duke qenë se klima në vendin tonë ka vite që është demokratike, shteti ligjor është i konsoliduar dhe për faktin se, kategori të tjera (opinionistë, gazetar, shoqëri civile etj) janë mjaft aktiv në krahasim edhe me parlamentarët, pa pasur imunitetin e deputetit për ta, këto kushte bien (rrëzohen qartë). Pra imuniteti i politikanëve duhet të shihet si i dhënë për të mbajtur dhe avancuar procesin demokratik dhe jo për të forcuar një klasë individësh politikanë që të qëndrojnë mbi dhe përtej ligjit.

Sot më shumë se kurrë bëhet imediate shkurtimi i teprimeve dhe shkeljeve që lidhen me imunitetin politik, reduktimi i tyre, pse jo edhe zerimi si një nismë që do të rikthejë besimin te politikanët shqiptarë dhe produkti (politika) që ata prodhojnë. Ne deputetët e parlamentit shqiptarë duhet të reduktojmë përmes ligjit imunitetin e deputetit duke përkrahur, votuar, projektligjin e paraqitur nga PD dhe Kryeministri Sali Berisha, për këtë qëllim kohë më parë. Kjo do të tregojë besim në kapacitetin objektiv të institucioneve kushtetuese dhe gjyqësore në Shqipëri dhe një nivel të lartë të vullnetit politik të deputetëve e parlamentit, në favor të përgjegjësisë e barazisë. Është thelbësore që imunitetet dhe privilegjet të përcaktohen qartë dhe asnjëherë të mos shkojnë tej parimit të barazisë para ligjit. Ne duhet të ndjekim shembullin e vendeve të tilla si p.sh. Holanda (ku politikanët nuk gëzojnë paprekshmëri parlamentare të çdo lloji),

Britania (gëzojnë imunitet vetëm nga arrestimi për çështje civile), Suedia (imuniteti të mbulon vetëm ato krime të dënueshme vetëm me dy vjet burg), apo Finlanda (vetëm gjashtë muaj) etj, etj.

Personalisht, si deputet i Vlorës, në optikën time të detyrimeve, të drejtave e realitetit shqiptar ne duhet të miratojmë një ligj kushtetues për rishikimin thelbësor të imunitetit të deputetit të përbërë nga një nen dhe vetëm një, atë që konfirmon se: "Deputetët shqiptarë gëzojnë ato të drejta e privilegje, dhe vetëm ato, që gëzojnë të gjithë shtetasit në Republikën e Shqipërisë". Ky ligj eksplicit me një nen është imperativ i kohës në nder e vlerësim të zgjedhësve tanë, traditës, moralit e vetvetes, në shërbim të të sotmes dhe të ardhmes parlamentare, politike e shoqërore.

Mbasi me ligj të kemi hequr privilegjin e imunitetit për veten si deputet duhet të shikojmë e kornizojmë atë të drejtuesve të sistemit gjyqësor e institucioneve të pavarura kushtetuese apo zyrtarëve të tjerë të lartë, duke u mbështetur njëherazi në Kushtetutën, si dokument themeltar dhe në ruajtjen e pavarësisë klasike të këtyre institucioneve .

Diskutimi u botua në gazetën Panorama, dt. 09/05/2008

I.15. Thellimi i reformave fiskale përmes konsolidimit të Sistemit Tatimor

Diskutimi në seancë plenare mbi projektligjin "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"

Tiranë më 15.05.2008.

Sot, ne diskutojmë një projektligj të paraqitur nga qeveria e të konsultuar gjerësisht me grupet e interesit, atë "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i cili është thelbësor në paketën e reformave të ndërmarra në Shqipëri që do të përmirësoj në veçanti sistemin tatimor në vend duke u krijuar mundësi tatimpaguesve të plotësojnë me lehtësi detyrimet e tyre tatimore, me përfitime më të mëdha për ata, shtetin dhe të gjithë ne, dhe me një besim më të madh nga publiku. Një sistem tatimor duhet të jetë transparent me qëllim që qytetarët të njohin barrën e tatimit që efektivisht duhet të paguajnë. Tashmë dihet nga të gjithë se është pozitiv fakti që shteti të jetë transparent ndaj kontribuuesve dhe të mos i disinformojë ata dhe për faktin e thjeshtë se ato tatime që janë përcaktuar qartë, janë të preferueshme për t`u paguar nga tatimpaguesit. Në fakt për të përcaktuar se një sistem tatimor është i vlefshëm apo jo duhet t`a bazosh atë në norma legjislative dhe në përmbajtjen e tij konkrete, të cilat duhet të jenë në përputhje me natyrën ekonomike të vendit, sjelljen e kontribuesve dhe të administratës financiare. Ne jemi të qartë se nuk ekziston një sistem optimal për të gjitha vendet dhe të gjitha kohët, një formulë për të qenë i suksesshëm, në veçanti në vendet në tranzicion sepse sistemi tatimor duhet t'i përshtatet kushteve ekonomike dhe ambientit në të cilën vepron. Pikërisht fakti që ne të gjithë biem dakord që sistemi aktual ka mangësi, për sa i përket autoritetit të papërshtatshëm të administratës apo ligjeve jo të plota dhe ndonjëherë dhe kontradiktore që në këto vite janë ndryshuar edhe shpesh na bën ne që të vlerësojmë projektligjin e paraqitur për Procedurat Tatimore, tashmë si një ligj i parë i plotë integral që rregullon marrëdhëniet shtet biznes. Në këtë ligj

është kushtuar një vëmendje e veçantë si rregullimeve në krahun e biznesit, ashtu edhe rregullimeve në krahun e shtetit me qëllim të fundit të shtetit për t`i shërbyer më mirë biznesit si partnerin kryesor dhe direkt. Ligji është ndërtuar në këtë frymë bashkëpunimi duke tentuar rregullime më të detajuara, duke i lënë sa më pak vend abuzimeve nga ana e shtetit. Të gjithë jemi të ndërgjegjshëm që ky ligj i përgatitur nga qeveria në fillim të marsit 2008, në këto dy muaj u diskutua gjerësisht nga grupet e interesit, Komisionet Parlamentare të Ekonomisë e të Ligjve dhe ekspertëve të ndryshëm. Kjo, përveç të tjerash tregon orientimin e kësaj qeverie që ndërmerr reforma thelbësore në përmirësimin e një ligji jo thjesht si një qëllim në vetvete, por bërjen e një reforme në sistemin fiskal dhe në marrëdhëniet shtet – biznes, përmes një transparence dhe një debati publik. Këto marrëdhënie shihen me një rëndësi të veçantë nga qeveria me orientim kryesor luajalitetin dhe qëndrueshmërinë në kohë. Përmes këtij projektligji që unë besoj që do të shndërrohet në ligj mbas diskutimit dhe votimit në Parlamentin Shqiptar realizohen si mundësitë e tatimpaguesve për të plotësuar me lehtësi detyrimet e tyre tatimore ashtu dhe administrata tatimore të realizoj misionin kryesor të saj në mbledhjen e të ardhurave përmes një administrate që orientohet drejt ofrimit te shërbimeve në respekt të ligjit nga tatimpaguesit dhe ajo vetë. Meqenëse ligji është organizuar në atë mënyrë që të ndjekë formën e organizimit të vetë administratës tatimore dhe detyrat që ajo kryen mendoj që është lehtësisht i asimilueshëm dhe i adoptueshëm në marrëdhëniet privat – privat, privat – publik. Një pjesë e rëndësishme është e drejta e tatimpaguesit për t`u informuar në përputhje kjo me parimin bazë të kësaj Qeverie: – Sinqeriteti dhe hapja sa më e gjerë me biznesin dhe konsiderimi i tij si partner bazë. Ky ligj u diskutua gjerë në Komision Parlamentar të Ekonomisë, nga deputetë, përfaqësues të organizatave të biznesit dhe nga ekspertë të Ministrisë së Financave. Si rezultat i këtyre diskutimeve u bënë disa ndryshime, ku unë do të veçoja:

neni 16, pika 6, "Struktura e administratës tatimore qendrore", u ndryshua në atë që Ministri i Financave mund të bëjë kontraktimin vetëm për funksionet mbështetëse si teknologjia e informacionit etj dhe jo në të gjitha funksionet e administratës si ishte parashikuar më parë në variantin e qeverisë.

Neni 107, pika 5, "pagesa e detyrimit tatimor, objekt ankimi", ose si njihet ndryshe si neni i gjobave, u amendua duke hequr detyrimi i biznesit për pagimin 15% te gjobës për të pasur të drejtën e apelimit

*neni 53, pika 2, *"Fatura tatimore të përgatitura nga biznesi", ku

forma e auto faturës përcaktohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve dhe jo nga Ministri i Financave si ishte parashikuar fillimisht në projektligj. Krahas të drejtave në ligj paraqiten edhe detyrime shtesë, por këto detyrime janë në vetvete një ndihmë që i jepet biznesit legjitim në dëm të evazorëve të ligjit.

Kjo ndihmesë pa kushte shprehet në kurajën që ka kjo qeveri për t`u marrë me "gangrenën" kryesore që dëmton çdo biznes të ligjshëm – mos faturimin dhe përdorimin e kuponit tatimor apo kasës. Ky problem përbën një sfidë, e thjeshtë në pamje të parë, por në realitet e vështirë dhe që Ministria e Financave po merr në fushën e luftës kundër evazionit fiskal. Problemi i kasës nuk është i ri. Për të ka ligje që datojnë para hyrjes së këtij ligji në fuqi, por që duke qenë të vakëta dhe duke mos u marrë seriozisht me problemin e faturimit kanë shkaktuar një anomali të funksionimit të tregut dhe duke vështirësuar njëkohësisht detyrën e shtetit për luftimin e evazionit. E dimë që problemi i gjithë faturimit është një sfidë e madhe me të cilën ndeshet çdo vend në tranzicion, por në këtë ligj po theksohet që të kurohet përfundimisht kjo "gangrenë" e madhe që rëndon mbi kurrizin e çdo biznesi korrekt me tatimet.

Vlerësoj dhe i uroj sukses Ministrit të Financave dhe Drejtorit të Tatimeve që të paktën në këtë fushë të mos dështojnë si paraardhësit e tyre. Përfundimi i ciklit zinxhir të vlerave të shtuara me një faturim të plotë do të ndihmojë përfundimisht luftimin e evazionit, duke e kthyer këtë zinxhir vlerash në një zinxhir deklarimesh real të detyrimeve tatimore hallkë pas hallke.

Në përgjithësi ligji për procedurat tatimore po paraqitet si një ligj i plotë, i gjerë dhe që prek të gjithë fushat e rregullimit fiskal. Zgjerimi i të shumë njohurit "neni 36" "Vlerësimi tatimor" përmes tashmë nenit 71 bëhet në përputhje të plotë me kushtet aktuale të përdorimit të rrugëve bankare dhe të kasës. Në këtë mënyrë orientohet dhe administrata tatimore në menaxhimin e procesit vetë deklarues tatimor të bizneseve, në drejtim të orientimit të një sistemi rivlerësues më të plotë, më të qartë dhe më të goditur. I ndarë në dy pjesë, neni 71 dhe neni 72 , vlerësimi tatimor me metoda alternative përbën zemrën e ligjit mbi procedurat tatimore. Ndarja në dy pjesë është bërë në funksion të një detajimi të nevojshëm të kësaj pjese të ligjit:

1. Pjesa e parë sqaron saktë rastet se kur mund të bëhet vlerësimi tatimor dhe

2. Pjesa e dytë tregon se në ç'mënyrë duhet bërë ky rivlerësim. Ky rivlerësim prek qartë dhe merret me saktësimin e vlerave të shtuara në çdo hallkë të zinxhirit. Vlera e shtuar dhe detyrimet

tatimore që lidhen me ato si T.V.SH, Tatim Fitimi etj, paraqiten në çdo hallkë si diferencë e vlerave të arkëtuara dhe vlerave të paguara. Themeltare për këtë është deklarimi dhe plotësimi i formularëve që deklarojnë pikërisht vlerat e realizuara. Saktësimi i këtyre vlerave dhe kanalizimi i tyre përmes rrugëve bankare përbën pikërisht thelbin e këtij neni. Këtu duket dhe rëndësia e tij dhe detajimi në pjesën e dytë (neni 72) ku saktësohet mënyra bazë e vlerësimit alternativ. Afatit të parashkrimit deri në pesë vjet (nga gjashtë vjet që kishte parashikuar varianti qeveritar dhe tre që kërkonin komuniteti i biznesit) përputhet me të drejtën e parashkrimit të detyrimit tatimor, një parim universal i përdorur në të gjithë sistemet ligjore të të gjitha vendeve.

Për sa më sipër dhe duke vlerësuar ambiciet pozitive që shtron dhe kërkon projektligji por mbi të gjitha situatën dhe nivelin ku jemi dëshiroj të shpreh rezervat e mia apo thënë ndryshe drojën dhe frikën që kjo fuqi e madhe që po i jepet administratës mund të mos arrihet të menaxhohet në masën e duhur, duke pasur parasysh nivelin profesional të inspektorëve tatimor, që në shumicë të rasteve lë për të dëshiruar. Nuk kam asgjë me atë pjesë profesionale të administratës, por me pjesën tjetër e cila për fat të keq të qytetarëve dhe tatimpaguesve ende përbën një shumicë të konsiderueshme që rrezikon të kompromet ojë këtë reformë dhe të tjera të qeverisë.

Nëkëtëprojektligjmendojsekishtenevojëedhepërpërmirësimetë mëtejshme, të cilat në mënyrë të përmbledhur në optikën time janë:

neni 13, pika 2, ”organizmi i administratës tatimore”, mendoj se duhet të ndryshohet varësia nga Ministri i Financave, në një strukturë që vetëm raporton tek Ministri, në një strukturë administrate tatimore sa më e pavarur nga ndryshimet qeveritare. Si është, formulimi jep idenë që ministri, duke pasur nën varësi të plotë drejtorin, mund të ushtroj presion, apo të influencojë politikisht mbi atë duke e detyruar të ushtrojë kontrolle mbi kundërshtarët politikë, mbi financuesit e palës tjetër etj, etj. Drejtori i Përgjithshëm apo Nëndrejtorët duhet të jenë pozicione teknike dhe të zgjedhur me konkurs çka do të siguronte një pavarësi më të madhe të administratës. Heqja e të drejtës për të përdorur një “garanci bankare”, në rastet e vështirësive financiare, të mungesës së likuiditeteve dhe në kushtet e detyrimeve të larta fiskale bën që biznesi të jetë i detyruar të shesë ndoshta dhe një pjesë të pasurisë së tij të patundshme menjëherë. Kjo shitje e menjëhershme (brenda 30 ditëve) nënkupton kosto të mëtejshme dhe humbje financiare. Detyrimi për të paguar pa dhënë mundësinë e ndërhyrjes së një

banke dhe të një shoqërie sigurimi ul vlerat e realizuara nga biznesi, vlera të shprehura në aktivin e tij financiar. Këto vlera janë pasuri kombëtare dhe nuk mund të trajtohen si "armike" duke ulur kështu vlerën e punës së bërë nga biznesi

3. Ngritja e "Gjykatës Administrative" të pavarur e cila do të harmonizoj më mirë funksionimin e sistemit te tregut përmes harmonizimit të veprimtarisë së të tre pushteteve (Ekzekutiv- Parlamentar – Gjyqësor). Nëse përmirësimet e mësipërme do të ishin konsideruar në diskutime në komision nga përfaqësuesi i Ministrisë së Financave mendoj që ligjit do t`i ishin shtuar vlerat dhe qëndrueshmëria Megjithatë duhet të jem i qartë në atë që ky projektligj me vlerat, risitë, frymën integrale që mbart meriton të votohet me bindje që do të jetë i qëndrueshëm në kohë dhe pjesë e qenësishme e një kodi tatimor të ardhshëm..

Unë jam i bindur që ne si legjislaturë (pozitë dhe opozitë) do të dimë të sinergjizojmë përpjekjet tona me shoqatat e biznesit që përmes zhvillimit të mëtejshëm të këtij ligji dhe plotësimit e bashkimit me të tjerë, përmes një mendimi thellësisht profesional dhe brenda kësaj legjislature të arrihet hartimi i një "kodi tatimor", i cili do të ishte kompleks i pandryshueshëm në kohë dhe integral. Kjo do të siguronte bazën për një sistem fiskal më të qëndrueshëm dhe që ndikon më mirë në menaxhimin e vlerave të krijuara nga ekonomia, do të çonte në një menaxhim më të mirë të faktorëve të prodhimit (puna, toka dhe kapitali) dhe stimulim më të madh për zhvillimin ekonomik të vendit.

Përmbledhtas mund të shprehemi se ligji që do të aprovojmë është shprehje e një sistemi tatimor optimal që mbështetet në këto karakteristika:

1) Efektiviteti ekonomik. Sistemi tatimor inkurajon efektivitetin e burimeve monetare.
2) Thjeshtësia administrative. Sistemi tatimor është i thjeshtë, d.m.th. mbështetet në pak tatime dhe relativisht pak i kushtueshëm nga pikëpamja administrative.
3) Fleksibiliteti. Sistemi tatimor reagon me lehtësi (në disa raste automatikisht) ndryshimit të kushteve ekonomike.
4) Transparenca politike. Sistemi tatimor është formuluar në mënyrë të tillë që tatimpaguesit të jenë të vetëdijshëm për tatimet që paguajnë, kështu që procesi politik të mund të reflektoj më kujdesshëm preferencat e qytetarëve.
5) Drejtësia. Sistemi tatimor siguron që trajtimi i qytetarëve të ndryshëm të jetë i drejtë. Këto karakteristika janë në ekuivalencë

të plotë me parimet më të cilat janë ndërtuar sistemet tatimore në ekonomitë e zhvilluara perëndimore.

Diskutimi u botua në gazetën 55, dt. 15/05/2008

Shënim: *Nga relacioni shoqërues i Këshillit të Ministrave, Komisionit të Ekonomisë, Raporti i Legjislacionit, i cili paraqet një përmbledhje të veprimtarisë ligjvënëse për këtë legjislaturë ndër të tjerash veçojmë:*

"Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH".

Data e hyrjes në Kuvend 07.03.2008

Nismë e KM Komisionet parlamentare që kanë shqyrtuar: Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Komisioni për Çështjet ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Shqyrtimi në seancë plenare: 19.05.2009

Ligji është miratuar me: 63 vota pro, 17 kundër, 0 abstenime.

Shumica e kërkuar: e thjeshtë

Hartimi i një ligji të ri për procedurat tatimore u bë i nevojshëm për të unifikuar dhe konsoliduar procedurat tatimore që aktualisht janë të shpërndara në disa ligje tatimore, për të reflektuar ndryshimet e mjedisit ekonomik dhe atij të biznesit në këto 15 vjetët e fundit, për të afruar procedurat tatimore me standardet e Bashkimit Evropian dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Ai u hartua me ndihmën e ekspertëve të USAID-it, si pjesë e projektit të Korporatës së Mijëvjeçarit, si dhe është konsultuar me komunitetin e biznesit.

Ligji sjell disa risi dhe përmirëson dispozitat ekzistuese në disa drejtime. Ligji përmirëson procedurat tatimore në përputhje me praktikat ndërkombëtare dhe do të ndikojë në forcimin e respektimit të ligjit për reduktimin e procedurave burokratike administrative, reduktimin e korrupsionit, informalitetit dhe evazionit fiskal.

Ligji siguron mbrojtjen më të mirë të të drejtave të tatimpaguesve, reformim dhe modernizim të procedurës së mbledhjes së tatimeve, reformim të marrëdhënieve të administratës tatimore me biznesin, si dhe reduktim të konflikteve për probleme tatimore. Deputetët e opozitës e kundërshtuan ligjin, duke pretenduar se ai kufizon të drejtat e tatimpaguesve dhe i jep liri të gjerë veprimi administratës tatimore.

Gjatë shqyrtimit nen për nen u morën në konsideratë edhe disa nga vërejtjet e komunitetit të biznesit. Kuvendi miratoi ndryshimet e propozuara nga Komisioni Ekonomisë në formulimet e 46 neneve".

I.16. Pasojat në ekonomi dhe lufta për parandalimin e pastrimit të parave

Diskutimi në seancë plenare mbi projektligjin "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit" "

Tiranë, datë 19.05.2008

Projektligji "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit" vjen si dëshmi serioze e bashkëpunimit të Qeverisë Shqiptare, nëpërmjet plotësimit të rekomandimeve të përgjithshme në këtë fushë e në veçanti për Shqipërinë, me Moneyval (Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave të Luftës Kundër Pastrimit të Parave), FMN, Departamentin Amerikan të Thesarit e të tjera institucione ndërkombëtare. Në këtë projektligj reflektohen e pasqyrohen standardet shtesë të luftës kundër pastrimit të Parave të FATF (Task Force Act Financial-Taskë Force e Veprimit Financiar), Autoritetit kryesor ndërkombëtar në këtë fushë, të cilat tashmë kanë edhe 9 rekomandime të tjera të shtuar atyre 40 tradicionale. Regjimi, kuadri ligjor dhe administrativ kundër pastrimit të parave është një armë për të luftuar krimin, pasi pastrimi i parave përbën një krim si në rastin kur ai tenton të fshehë burimin e vërtetë të parave apo në rastin kur tenton të financojë terrorizmin, një aktivitet kriminal të përbotshëm. Sot në botë vlerësohet se pastrimi i parave vërtitet rreth disa qindra miliard dollarë ose mbi 2% të G.D.P globale, ndërsa në SHBA që kemi ndoshta nivelin me të lartë të dënimeve për pastrim parash se çdo vend tjetër, probabiliteti i dënimit për këtë krim është rreth 6.5%. Michel Camdessy ish-drejtor i F.M.N ka llogaritur se magnituda e pastrimit të parave është midis 2% dhe 5 % e G.D.P-së, ose të paktën 600 milion dollarë në vit në U.S.A). Në vendin tonë, në të cilin sipas deklarimeve të INSTAT-it 30% e ekonomisë është informale (ose atyre të CIA-s që e vlerësojnë me 50%) merr tepër rëndësi lufta kundër këtij krimi financiar. Një sërë transaksionesh, të hapura e të fshehta, legale dhe jolegale, të shumëllojshme e në vende të ndryshme përbëjnë fenomenin e

pastrimit të parave, qëllimi i të cilit është të fshihet burimi i aseteve financiare për përdorim të mëtejshëm pa kompromentuar zotëruesit e tyre. Zakonisht transaksioni në tërësi ndahet në:

1. vendosja e lidhjeve të paligjshme me institucionet financiare nëpërmjet transfertave, depozitave.

2. mbulimi- procesi i ndarjes së të ardhurave të aktivitetit kriminal nga origjina e tyre duke përdorur transaksione komplekse financiare.

3 integrimi- procesi i përdorimit të transaksioneve për të mbuluar aktivitetet e paligjshme.

Nga të gjithë tashmë pranohet se ne fakt pastrimi i parave ka pasoja potenciale shkatërruese për ekonominë, sigurinë dhe jetën sociale duke qenë burim kryesor për trafikimet e drogës e armëve, terroristët apo edhe zyrtarët e korruptuar etj. Gjithashtu mos kontrolli ndaj pastrimit të parave, mund të prishë integritetin e institucioneve financiare të një vendi dhe njëherazi paratë e pastruara paligjshmërisht vërshojnë në sistemin global financiar, duke dobësuar monedha e më tej ekonominë kombëtare.

Studiues të ekonomisë, të këtij fenomeni në veçanti dallojnë këto Efekte Ekonomike të Pastrimit të Parave, të cilat për vetë rëndësinë e njohjes edhe në Shqipëri po i përmend shkurtimisht:

1. Dobësimi i firmave të ligjshme në aspektin mikroekonomik. Kompanitë e zotëruara nga ata që duan të pastrojnë paratë zotërojnë fonde të tilla që mund të ofrojnë mallra dhe shërbime nën koston e tregut duke e bërë thuajse të pamundur për bizneset e ligjshme të vazhdojnë aktivitetin

Mbipopullimi i tregut privat me biznese të zotëruara nga organizata kriminale duke dëmtuar traditat e tregut të lirë të bizneseve të ligjshme në aspektin mikroekonomik do të shkaktojë më tej edhe pasoja negative makroekonomike.

2. Dobësimi i Integritetit të Tregjeve Financiare. Në rast se Institucionet Financiare do të mbështeten në të ardhurat kriminale kanë gjithmonë probleme në menaxhimin e aseteve dhe operacioneve të tyre. Në rast se p.sh një shumë e madhe parash, e pastruar, zhduket me shpejtësi, krijon probleme likuiditeti për bankën. Këto aktivitete kanë ndikuar në falimentimin e shumë bankave në botë, përfshi dhe bankën e parë të Internetit, Europian Union Bank, apo disa kriza financiare në vitet '90.

3. Humbja e kontrollit të Politikave. Duke qenë se magnituda e pastrimit të parave vërtitet nga 2 deri në 5 % të GDP-së në vendet e zhvilluara, kuptohet që në tregjet e vendeve në zhvillim këto para mund të pakësojnë buxhetet e shtetit, duke ndikuar në humbjen e kontrollit mbi politikat ekonomike nga qeveria. Pastrimi i parave

mund të rezultojë në ndryshime të paqarta në kërkesën për para dhe në rritje të vrullshme të kapitaleve ndërkombëtare, interesave dhe normave të interesit.

4. Çrregullimet ekonomike dhe destabiliteti. Duke qenë se pastruesit e parave nuk janë të interesuar në fitime nga investimet, por në legalizimin e ilegalitetit të tyre ata i investojnë fondet në aktivitete jo domosdoshmërish fitimprurëse për ekonominë e vendit Duke i drejtuar këto fonde në investime jo rentable rritja ekonomike e vendit pëson ulje.

5. Humbja e taksave. Kjo zakonisht do të thotë norma më të larta se çdo të ishin sikur paratë e pataksuara të kriminelëve të gjeneroheshin në mënyrë të ligjshme. Pastruesit e parave në mënyrë të tërthortë dëmtojnë taksapaguesit e ndershëm.

6. Rreziqet e përpjekjeve për privatizim. Organizatat kriminale kanë mundësitë financiare për të bërë oferta më të larta sesa tenderuesit e ligjshëm në privatizimin e ndërmarrjeve shtetërore, pra drejtpërdrejtë cenojnë reformat qeveritare të ndërmarra ndërmjet privatizimit.

Në një përmbledhje duke i integruar këto ndikime negative mikro dhe makroekonomike, monetare e fiskale mund të pohojmë se Fuqia e madhe ekonomike që grumbullohet nga pastrimi i parave ka një ndikim korruptiv në të gjithë elementët e shoqërisë. Pastrimi i parave, jo thjesht vendin tonë, Shqipërinë, por gjithë botën e përball me një sfidë komplekse dhe dinamike. Dhe me të vërtetë, kjo natyrë globale kërkon standarde ndërkombëtare n.q.s duam të zvogëlojmë mundësitë e ndikimit të këtij fenomeni antiligjor. E pikërisht projektligji i paraqitur sot për diskutim në Parlament realizon këto standarde ndërkombëtare e krijon jo vetëm koracën mbrojtëse ndaj këtij fenomeni por për më tepër ato të një aftësie siguruese, zbuluese e parandaluese. Ky projektligj përafron legjislacionin tonë me atë perëndimor duke përmbushur njëherazi kërkesat e neneve 4, 70 dhe 82 të MSA-së, si dhe Direktivën 2005/60 të Tetorit 2005 të BE. Përmbledhtas duhen theksuar risitë që sjell ky projektligj si: shtimin e numrit të subjekteve që raportojnë tek Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave; futjen e koncepteve të reja për vigjilencën e zgjeruar ndaj klientit me moton tradicionale në këtë fushë "Njih klientin", shtimin e masave që duhet të marrin Institucionet Financiare dhe jo financiare e më gjerë.

Ky projektligj përfundimisht plotëson 10 strategjitë e rekomanduara nga FBI-ja për Luftën Kundër Pastrimit të Parave, të cilat kërkohen të ndiqen nga vende dhe rajone për të sintetizuar standardet universale të adoptuara nga komuniteti ndërkombëtar në këtë fushë. Shkurtimisht këto janë:

- Rritja e bashkëpunimit midis zbatimit të ligjit, institucioneve financiare dhe juridike.
- Dënimi i krimit të pastrimit të parasë.
- Krijimi i Njësisë për Informacionin Financiar (NJIF)
- Shfuqizimi i ligjeve mbi sekretin bankar.
- Duhen raportuar transaksionet e mëdha dhe të dyshueshme.
- Identifiko klientët e bankës.
- Regjistro informacion mbi klientin dhe çdo transaksion.
- Duhen hartuar programe efektive nëpër banka për luftën kundër pastrimit të parave.
- Duhet siguruar bashkëpunimi ndërkombëtar.
- Duhen adoptuar ligjet e konfiskimit.

Diskutimi u botua në gazetën 55, datë 21.05.2008

Shënime: *Nga Raporti i Legjislacionit, i cili paraqet një përmbledhje të veprimtarisë ligjvënëse, veçojmë:*

"Ligj nr. 9917, datë 19.05.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit".

Data e hyrjes në Kuvend 26.03.2008

Nismë e KM

Komisionet parlamentare që kanë shqyrtuar:

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Komisioni për Çështjet ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut. Komisioni për Sigurinë Kombëtare

Shqyrtimi në seancë plenare: 19.05.2008

Ligji është miratuar me: 98 vota pro, 0 kundër, 0 abstenime.

Shumica e kërkuar: e thjeshtë

Hartimi i ligjit të ri "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit", i cili shfuqizon ligjin ekzistues, u bë i nevojshëm për të përfshirë në objektin e tij një sërë elementesh të reja, që synojnë përafrimin me legjislacionet e vendeve të BE-së, zbatimin e direktivave të Parlamentit e të Këshillit të Evropës dhe detyrimeve, që rrjedhin nga marrëveshja e Stabilizim-Asocimit. Ligji ri përmban disa ndryshime, që janë bërë të nevojshme gjatë zbatimit në praktikë të ligjit ekzistues, që plotësojnë e përmirësojnë përmbajtjen e tij.

Deputetët ishin të mendimit që ligji zgjeron dhe thellon masat parandaluese kundër pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit. Ai zgjeron kompetencat dhe rrit autoritetin e Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

Kuvendi e miratoi ligjin në parim me të gjitha votat e deputetëve që ishin të pranishëm."

I. 17. Të marrim pjesë në marshimin kulturor kombëtar në Qafë – Botë

Diskutim në seancë plenare

Tiranë, datë 26. 06.2008

Nesër është një ditë e shënuar, është një ditë historike për memorien kombëtare të shqiptarëve. Kam dalë këtu, në këtë podium të nderuar, në cilësinë e deputetit të Vlorës, në vazhdimin e asaj analize të bukur dhe të saktë që bëri deputeti i Partisë Socialiste, Shpëtim Idrizi, në vazhdimin e asaj përkrahje që deputetët Blerim Çela, Engjëll Cara, Pal Dajçi dhe Gëzim Karapici të Partisë Demokratike dhe ndonjë deputet tjetër kanë dhënë dhe mendoj qe duhet t'i japim të gjithë kësaj çështjeje të rëndësishme kombëtare.

Në këtë kontekst, unë jam i ndërgjegjshëm që problemi i fundit kombëtar i shqiptarëve në rajon e në Evropë është problemi çam, i ndërgjegjshëm që këtë problem ne politikanët shqiptarë do ta zgjidhim, në radhë të parë, duke respektuar të drejtat e popullsisë çame, ish-nënshtetas grekë, duke respektuar të drejtat evropiane, Kartën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, duke respektuar dhe duke u kondicionuar nga marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë Shqipëri-Greqi, për të zbatuar, në fund të fundit, atë Traktat të Miqësisë së mirë, të bashkëpunimit dhe sigurisë reciproke, që është firmosur ndërmjet dy shteteve në mars të vitit 1996, kur President ishte Sali Berisha dhe Kryeministër Aleksandër Meksi, traktat i cili është ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar i asaj kohe në korrik të vitit 1996 dhe nga Parlamenti Grek në vitin 1998, traktat i cili në nenin 15 të tij përcakton detyrimin e të dyja palëve për të zhvilluar dhe për të mbrojtur të drejtat e qytetarëve në shtetet respektive.

Në këto momente shprehja më e saktë që mund të themi, duke aspiruar dhe duke vlerësuar mbështetjen e Qeverisë Greke për Shqipërinë në këto vite të tranzicionit, për hyrjen në NATO, e cila tashmë është realitet, falë politikave të Qeverisë "Berisha". Duke aspiruar për hyrjen në BE dhe me ndihmën e fqinjëve tanë, është:

ajo që duhet të kemi frikë ne në trajtimin e çështjes kombëtare është vetë frika.

Megjithatë, ky është objekt i ndonjë diskutimi më të gjerë që ne duhet ta ndërmarrim në Parlament, është vazhdimi i atij diskutimi të historianëve, diplomatëve, akademikëve, është një problem kompleks për vetë çështjet që mbart.

Unë dola këtu për t'ju rikujtuar dhe për t'ju bërë një ftesë, edhe në emër të komunitetit çam, të popullit me vlerë, një pjesë prej të cilëve unë e përfaqësoj në këtë Parlament, pavarësisht se vetë jam lab me origjinë dhe jam krenar, t'ju ftoj nesër në atë marshim kulturor, kombëtar, paqësor që komuniteti çam organizon në Sarandë, në Qafë-Botë, marshim i cili bashkë me ceremonitë kulturore e politike që e shoqërojnë janë ceremoni tërësisht evropiane, është marshim tërësisht paqësor, tërësisht kombëtar e kulturor. Ky ishte problemi kryesor që unë doja të deklaroja këtu në Parlament, edhe për faktin që nesër komuniteti çam pret sa më shumë deputetë të Parlamentit Shqiptar të të gjitha ngjyrave politike. Të gjithë ne kemi detyrim, kush më shumë e kush më pak. Ne të pozitës, të maxhorancës së djathtë, interesat e tyre i kemi mbrojtur qysh në vitet 90 me krijimin e Partisë Demokratike, si nga kryetari Sali Berisha, Kryeministri Meksi, nga deputeti i ndjerë, heroi Azem Hajdari dhe deputetë të tjerë nacionalistë të Parlamentit Shqiptar. Partia Socialiste ka detyrim për atë "kompromis", për atë indiferencë që tregoi pas ardhjes në pushtet në vitin 1997, që bëri që kjo çështje të shuhet në mënyrë të pakuptimtë nga pala jonë, duke treguar një mungesë diplomacie, pse jo, edhe frikë në momente të caktuara.

I.18. Menaxhim efektiv e bashkëkohor i sistemit buxhetor

Diskutimi në seancë plenare mbi projektligjin "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"

Tiranë, datë 26.06.2008,

Jo vetëm teorikisht, por gjerësisht në praktikë në vendet në zhvillim apo në tranzicion është provuar lidhja, marrëdhënia e ndërsjelltë midis një Qeverisje të mirë dhe rezultateve më të larta social-ekonomike. Përgjithësisht sot parimet e përgjithshme për një drejtim më të mirë në qeverisje me parimet specifike për menaxhimin e financave publike janë të lidhura ngushtësisht bashkë. Si një dëshmi politiko-ekonomike dokumentare vijnë dhe ligjet për menaxhimin e sistemit buxhetor në vende të veçanta bazuar në aksiomën: Buxheti është Dokumenti Politik Kryesor i Qeverisë.

Projektligji për "Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" duke konfirmuar praktikat më të mira bashkëkohore njëherazi përshkruan integralisht kolonat themelore të një qeverisje të mirë që përmblidhen në: 1) Transparenca; 2) Përgjegjshmëria; 3) Efikasiteti; 4) Pjesëmarrja; 5) Koherenca e Veprimeve.

Ndërkohë qartas konfirmohen në Nenin 4 të Projektligjit në fjalë "Parimet e Funksionimit të Sistemit Buxhetor" dhe në tërësi në draft praktika më e mirë në menaxhimin e financave publike që përkon me karakteristika të tilla si:

1) Disiplina fiskale në përputhje me stabilitetin makroekonomik me zhvillimin e qëndrueshëm, ekonomik dhe social;

2) Shpërndarja e burimeve në përputhje me objektivat strategjike

3) Përdorimi ekonomik, efiçent dhe efektiv i burimeve publike,… etj.

Meqenëse buxheti është Dokumenti i vetëm më i rëndësishëm i Qeverisë ku objektivat politike gjejnë zbatim në realitet me të drejtë menaxhimi i financave publike shihet në radhë të parë në strukturën,

parimet dhe bazat e procesit buxhetor, marrëdhëniet financiare ndërqeveritare dhe përgjegjësitë për zbatimin e legjislacionit buxhetor, në tërësi (ky objekt jepet dhe në Nenin 1 të draftit që po diskutojmë si: Objekt i Ligjit).

Transparenca e Buxhetit e përcaktuar si publikimi i plotë i të gjithë informacionit fiskal në kohën e duhur dhe sistematikisht si dhe parime të tjera promovohen sot gjerësisht në reformën e menaxhimit të financave publike në mbarë botën nga një numër organizatash ndërkombëtare si Fondi Monetar Ndërkombëtar, Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, Banka Botërore për Rindërtim dhe Zhvillim, Forumi i Stabilitetit Financiar etj. Sot Ligjet organike të buxheteve në veçanti dhe politikat makroekonomike të kërkuara, infrastruktura institucionale dhe e tregut i referohen gjerësisht në gjenezë e zbatim dokumenteve të tilla të institucioneve të sipër përmendura si: Kodi i Praktikave të Mira të FMN-së për Transparencën Fiskale, 12 Standardet kyç për një sistem efektiv financiar të Forumit të Stabilitetit Financiar apo "Praktikat më të mira" të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, për transparencën e buxhetit të cilat përfshijnë edhe shkallën e lartë të përgjegjshmërisë dhe transparencës.

Transparenca Fiskale në thelb është një oponencë publike në strukturën dhe funksionet e Qeverisë, qëllimet dhe parashikimet e politikës fiskale dhe llogaritë e sektorit publik. Sintetikisht, Kodi i rishikuar i FMN-së për praktikat më të mira në transparencë fiskale kërkon dhe garanton katër parime bazë:

I. Role dhe përgjegjësi të qarta

II. Mundësia e marrjes së informacionit nga Publiku

III. Përgatitja, zbatimi dhe raportimi i buxheteve të hapura (apo raportimi transparent i buxhetit)

IV. Garantimi i Integritetit

Nisur nga pasqyrimi i plotë i këtyre parimeve në draftin që po diskutojmë po i përshkruajmë shkurtimisht:

I. Role dhe Përgjegjësi të qarta. Ky parim ka të bëjë me një informacion të qartë mbi strukturën dhe funksionet e Qeverisë, përgjegjësitë brenda Qeverisë dhe marrëdhëniet ndërmjet Qeverisë dhe pjesës tjetër të ekonomisë kombëtare.

II. Mundësia e marrjes së informacionit nga Publiku. Ky parim thekson rëndësinë e publikimit të një informacioni fiskal gjithëpërfshirës, në afate kohore të caktuara. Është thelbësore që ky informacion të publikohet në një format i cili mund të aksesohet lehtë nga përdoruesit e informacionit, të cilët jo gjithmonë mund të jenë specialistë në fushën e financave publike.

III. Përgatitja, Zbatimi dhe Raportimi Transparent i një Buxheti. Ky parim ka të bëjë me llojin e informacionit për procesin e buxhetit që bëhet i disponueshëm.

IV. Garantimi i integritetit. Ky parim i referohet cilësisë së të dhënave fiskale dhe nevojës për mbikëqyrje të pavarur të informacionit fiskal.

Pikërisht të gjitha këto parime edhe praktika përbëjnë themelin ideologjik të këtij projekt-ligji të ri. Projekt ligji për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH ndërtohet mbi bazën e koncepteve të akteve ligjore ekzistuese në fushën e financave publike sikurse merr në konsideratë edhe ndryshimet që sjell politika e Qeverisë për sa i përket menaxhimit të financave publike. Veçanërisht, projekti parashtron një bazë ligjore për:

1. Programin Buxhetor Afatmesëm
2. Konsolidimin e reformave të administratës publike duke synuar depolitizimin e shërbimit civil përmes prezantimit të sistemeve efektive të llogaridhënies
3. Riorganizimin e marrëdhënieve ndërqeveritare
4. Fuqizimin e menaxhimit të investimeve publike si me financim të brendshëm ashtu edhe me financim të huaj
5. Standardet ndërkombëtare statistikore dhe të kontabilitetit publik dhe
6. Monitorimin dhe kontrollin e brendshëm financiar publik.

Qartas këto jepen dhe në relacionin shoqërues të këtij projekt-ligji, përgatitur nga Qeveria. Programi buxhetor afatmesëm përbën një risi thelbësore në krahasim me ligjin ekzistues organik. Përmes programimit buxhetor afatmesëm mundësohet një lidhje e drejtpërdrejtë e qëllimeve dhe objektivave politike të çdo institucioni buxhetor me buxhetin e tyre. Në të njëjtën kohë sigurohet një transparencë më e madhe, veçanërisht për Kuvendin, për shpërndarjen e burimeve publike në programe për produkte që përbëjnë prioritete për qeverisjen. (përmendim neni 25-Projekti i Programit Buxhetor afatmesëm, neni 26-Programi Buxhetor afatmesëm, neni 28-P.B.A i rishikuar etj).

Për më tepër, programimi buxhetor afatmesëm, përmes një parashikimi afatmesëm të shpenzimeve publike mundëson një analizë në nivel produktesh të realizuara për një periudhë afatmesme në funksion të përmbushjes së objektivave në programin e Qeverisë dhe të realizimit të politikave të deklaruara në komunitet. Përkatësisht edhe funksioni i monitorimit nuk do të jetë thjesht në bazë të përqindjeve të realizimit të inputeve, por në bazë të realizimit të objektivave dhe realizimit të produkteve. Me synim përmirësimin

e cilësisë së shpenzimeve publike, me rëndësi të veçantë, të njëjta koncepte të programimit buxhetor afatmesëm janë parashtruar edhe për qeverisjen në nivel vendor.

Për të gjithë aktorët pjesëmarrës në procesin e menaxhimit të shpenzimeve publike është përcaktuar qartë roli dhe përgjegjësia në bazë të funksionit të tyre, duke mundësuar dallimin mes funksioneve politike dhe atyre të shërbimit civil që përkojnë me aspekte manaxheriale të procesit. Kështu është përcaktuar qartë roli i titullarëve të institucioneve si vizionarë dhe politik-bërës në sferën e tyre funksionale dhe roli i nëpunësve autorizues (neni 18 - nëpunësi i parë autorizues, neni 19 - nëpunësi autorizues) si zyrtarë të cilët mbajnë përgjegjësi për menaxhimin e shpenzimeve publike me efiçencë, efektivitet dhe ekonomi në funksion të performancës dhe arritjes së objektivave të përcaktuara politikisht nga titullarët e institucioneve. Kështu më shumë kohë i dedikohet cilësisht formulimit të orientimeve politike dhe më shumë mundësi i krijohet Kuvendit për të nxitur cilësinë optimale të financave publike.

Me rëndësi të veçantë për këtë ligj është përafrimi i koncepteve me standardet ndërkombëtare të *acquis communautaire* të BE-së në fushën e kontabilitetit publik në përputhje me Statistikat Financiare Qeveritare (Government Finance Statistics- GFS) dhe në fushën e kontrollin të brendshëm financiar publik dhe të inspektimit financiar. Përkatësisht njësi të pavarura të auditimit (të konfirmuara këto në nenin 69-auditimi i brendshëm) ngrihen pranë çdo institucioni buxhetor për të mundësuar vlerën e parasë të shpenzimeve publike dhe në mënyrë të veçantë krijohet edhe baza ligjore për inspektime financiare, detaje rreth të cilit do të duhet të sanksionohen në një ligj të veçantë (neni 70-inspektimi financiar).

Si konkluzion, projekt-ligji për menaxhimin e shpenzimeve publike, në përputhje me Kodin e Praktikave të Mira për Transparencën Fiskale, mundëson:

1. Role dhe Përgjegjësi të qarta.

a. Sektori i qeverisjes së përgjithshme (qendror, vendor dhe fondet speciale) dallohet dukshëm nga pjesa tjetër e sektorit publik dhe pjesa tjetër e ekonomisë, dhe rolet dhe përgjegjësitë për politikat dhe menaxhimin janë të qarta (neni 5-buxheti i shtetit, neni 6-buxheti vendor, neni 7-fondet speciale).

b. Ka një kuadër të qartë ligjor dhe administrativ për menaxhimin fiskal (neni 8, neni 9, neni 10).

2. Mundësia e marrjes së informacionit nga Publiku.

a. Publikut i ofrohet informacion i plotë për aktivitetin fiskal në të kaluarën (dy vite përpara), vitin korrent dhe vitet e ardhshme

(3 vjet) të qeverisjes së përgjithshme (neni 23-vlerësimet dhe parashikimet makroekonomike dhe buxhetore)

b. Një angazhim është marrë për të publikuar herë pas here informacionin fiskal (neni 32, neni 34).

3. Përgatitja, Zbatimi dhe Raportimi Transparent i një Buxheti.

a. Dokumentacioni i buxhetit specifikon objektivat politike fiskale, vlerësimet dhe parashikimet makroekonomike dhe politikën bazë për buxhetin dhe identifikon risqet kryesore fiskale (neni 23).

b. Informacioni i buxhetit prezantohet në një mënyrë që lehtëson analizat e politikave dhe nxit llogaridhënien (neni 29-projekt-buxheti vjetor, neni 24).

c. Procedurat për zbatimin dhe monitorimin e fondeve të miratuara dhe për mbledhjen e të ardhurave janë të qarta (neni 39, neni 40, neni 41).

d. Ka raportime të rregullta fiskale në parlament dhe në publik (neni 23, neni 25, neni 42 etj).

4. Garantimi i integritetit.

a. Informacioni fiskal plotëson standardet e pranuara mbi të dhënat cilësore (GFS).

b. Informacioni fiskal është subjekt i një shqyrtimi të pavarur (Kontrolli i Lartë i Shtetit) (neni 71-auditimi i jashtëm) .

Në përfundim, me kthimin e këtij projekt-ligji në ligj mbas votimit në Parlament, mund të themi që vërtet sistemi buxhetor në Republikën e Shqipërisë do të menaxhohet me transparencë, parashikueshmëri, disiplinë fiskale, nëpërmjet një përdorimi ekonomik dhe efiçent të burimeve publike, duke i realizuar këto në bazë të një strategjie të qartë makro-ekonomike dhe fiskale të Këshillit të Ministrave.

Diskutimi u botua në gazetën 55, dt. 27/06/2008 dhe gazetën Rilindja Demokratike, dt. 01.07.2008

Shënim: *Nga relacioni shoqërues i Këshillit të Ministrave dhe nga Raporti i Legjislacionit, i cili paraqet një përmbledhje të veprimtarisë ligjvënëse, veçojmë:*

"Ligj nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH".

Data e hyrjes në Kuvend 26.03.2008
Nismë e KM
Komisionet parlamentare që kanë shqyrtuar:
Komisioni për Ekonominë dhe Financa
Shqyrtimi në seancë plenare: 26.06.2008

Ligji është miratuar me: 66 vota pro, 3 kundër, 9 abstenime. Shumica e kërkuar: e thjeshtë

Ligji është kontribut i një pune të gjatë, rreth 5-vjeçare, të specialistëve të Ministrisë së Financave, mbështetur në konsulencën e specializuar të institucioneve ndërkombëtare, në mënyrë të veçantë të DFID (Qeverisë Britanike), në kuadrin e një projekti të përbashkët. Ai është konsultuar me komunitetin e donatorëve dhe institucione të ndryshme kërkimore, të tilla si: SIGMA, FMN, Banka Botërore, USAID, OSCE, Ambasada Holandeze, si dhe me përfaqësues të shoqërisë civile. Në të janë reflektuar komentet dhe vërejtjet e ministrive të linjës, Bankës së Shqipërisë dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit

Gjatë diskutimit parlamentar deputetët vlerësuan nevojën dhe rëndësinë e ligjit, cilësinë e përgatitjes së tij, risitë që ai sjell, si dhe kontributin që do të japë në programimin buxhetor afatmesëm e vjetor, mbështetur në strategjitë dhe prioritetet e qeverisjes së përgjithshme e të asaj vendore. Ata ishin të mendimit se ligji vendos kornizat dhe parimet e nevojshme në fushën e huamarrjes e të garancive financiare, kontabilitetit, monitorimit e auditimit të sistemit buxhetor, si dhe inspektimit financiar."

I.19. Për standarde emancipuese të politikës

Diskutimi në seancë plenare mbi projektligjin "Për barazinë gjinore në shoqëri"

Tiranë, datë 17.07. 2008

Pjesëmarrja e kufizuar e femrës shqiptare në politikë është tashmë një realitet shqetësues jo vetëm për gratë e pozitën e tyre të margjinalizuar politike e sociale por për krejt politikën e shoqërinë shqiptare. Qartas kjo shihet në përfaqësimin e grave në parlament e qeveri, i cili nga 1990 ka ardhur duke rënë. Kështu përqindja e vendeve në Parlament nga rreth 15% në 1996, zbret në 7% në 1997, 5.7% në 2001 dhe 7% në 2005. Kjo flet për atë që maskilizmi si një steriotip kulturor i forte, si një thelb i vjetër social nuk ndryshon e nuk ka ndryshuar jo brenda një viti por asnjë dekade edhe në realitetin produktiv, politik të jetës e partive politike në Shqipëri duke kontrastuar dukshëm me deklaratat paraelektorale të partive politike. Duke marrë të mirëqenë faktin që rezultatet e progresit ne çdo vend maten me shifra e standarde, të cilat respektohen nga politika moderne bashkëkohore nuk është serioze që ne të heshtim, të luajmë apo të realizojmë politikë hipokrite me gratë. Këto fakte përfaqësimi të gruas në jetën parlamentare, administrative e sociale të vendit nuk konfirmojnë vetëm brutalitetin, vrazhdësinë e maskilizmin e politikës shqiptare për sa i përket politikave gjinore por na shfaqin ne në parametra përfaqësimi më të ulëta në Evropë e të ngjashëm me vendet e Lindjes së Mesme e të Largët. Kështu përfaqësimi i grave në jetën politike në Shqipëri është i përafërt me shtetet të tilla si Armenia, Ukraina, Serbia, Turqia dhe shumë larg vendeve të Evropës Perëndimore që kanë p.sh. Gjermania, Austri 36%, Britania 19% etj.

Pyetjes "Kush e ka fajin''? Politika dhe natyra maskiliste e shoqërisë shqiptare nga njëra anë, apo vetë gratë dhe karakter specifik i gruas si natyrë, çdo mendje e shëndoshë e paragjykime ja jep lehtë përgjigjen. Ajo është politika me të thënat e të pathënat e

saj, me mediokritetin e jo largpamësinë e saj, me demagogjinë e jo konstruktivitetin e saj, me atë kornizë të çalët ligjore e cila na ka sjell në këta tregues specifikativ për negativitetin e tyre dhe largesën, ndarjen, distancën e zhvillimeve tona politike me ato vende që ne aspirojmë të bashkohemi. Gratë në botën modern vlerësohen jo vetëm për feminilitetin e tyre por edhe për potencialin e tyre politik, intelektual dhe social. Ne të gjithë kemi detyrimin t'i përkrahim gratë në politikë e jetë sociale, detyrim i cili së pari është kushtetues e ligjor, por specifikimi, kuotimi që ne i bëjmë pjesëmarrjes së gruas në Parlament përmes nenit 20."Pjesëmarrja në procesin e vendimmarrjes'' të projektligjit "Për barazinë gjinore në shoqëri" do ta bëj të qëndrueshëm e të pakthyeshëm këtë pjesëmarrje. Kjo do të shfaq edhe njëherë seriozitetin e këtij Parlamenti dhe përgjegjësin që ne si trup legjislativ pavarësisht ngjyrave partiake shfaqim, nëpërmjet këtij akti ligjor. E veçanta dhe risia e projektligjit është :

1. Parashikimi i masave të posaçme të përkohshme siç janë kuotat: -në masën mbi 30% në të gjitha organet e pushtetit legjislativ,ekzekutiv dhe gjyqësor dhe të institucioneve të tjera publike, si dhe në listën për kandidatë në zgjedhjet vendore,_ jo më pak se 30% e secilës gjini në listën e kandidatëve të paraqitur nga partitë politike për sistemin proporcional për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë.

2. Në sistemin publik masat e përkohshme pozitive synojnë në dhënien prioritete të kandidatëve të gjinisë më pak të preferuar gjatë shpalljes për pranimet në institucionet publike. Ky ligj për risitë që sjell tregon edhe idetë e punën serioze emancipuese të Kryeministrit BERISHA dhe të ministrit BARKA. Në këtë betejë emancipuese e sinjifikative të politikës, shoqërisë civile, organizatave të shumta joqeveritare të grave në Shqipëri ne shfaqemi të plotë koherent me pikëpamjet tona duke plotësuar përpos të tjerave dhe atë detyrim që ne si deputetë të popullit kemi ndaj atyre qindra grave që kanë kontribuar në fushatat tona paraelektorale dhe elektorale si aktiviste, manaxhuese, anëtare të qendrave të votimit, për ne si deputetë dhe partitë që ne përfaqësojmë .

Projektligji "Për barazinë gjinore në shoqëri" që unë besoj se do të kthehet në ligj do të shërbej në të ardhmen gjithashtu për t'i bërë gratë e politikës shqiptare më shumë solidare me njëra-tjetrën larg atij mentaliteti makiavelist që në këtë hapësirë të ngushtë politike për to ka imponuar politika shqiptare. Kufiri i detyruar prej 30% të përfaqësimit me gra do të zgjerojë njëherazi edhe hapësirën, terrenin e shtrirjes së femrave brenda partive respektive dhe politikës në

tërësi duke garantuar një mbijetesë politike për më shumë femra përmes një bashkëpunimi dhe solidariteti më koherent mes tyre, i cili do të filloj qysh nga forumet partiake e shoqërore. Ne të gjithë sot jemi optimist se gratë dhe vajzat shqiptare kanë nivel të lartë konkurrues arsimimi në të gjitha sistemet e arsimit e administratës, janë punëtore të disiplinuara e me rendiment sistematikë.

Përqindja reale, e duhur dhe që do ti shërbej së ardhmes evropiane të Shqipërisë e marrjes pjesë të grave në legjislativ e ekzekutiv dhe jetën politike e shoqërore në përgjithësi do të thyej skemën e vjetër tradicionale të politikës duke e shndërruar këtë të fundit në një fushë të bukur e produktive përmes realizimit edhe të dialogut të burrave me gratë duke mos e lënë atë të mbetet monolog dhe këngë e vjetër burrash, si shprehet sociologu dhe politologu Gëzim Tushe, në veprën e tij "Politika dhe Qytetari" në kapitullin e pestë "Gratë e politikës dhe politika për gra"

Diskutimi u botua në gazetën Shekulli dt. 20.07.2008.

Shënim: *Votimi i këtij projekt-ligji u krye përmes hezitimesh të shumta, por të pakuptimta të deputetëve të të dy krahëve të Kuvendit.*

I.20. Poetët dëshmorë në Altarin e Kombit

Diskutime jashtë rendit të ditës

Tiranë, datë 17.07.2008

17 korriku është një ditë përkujtimore, një ditë sa tragjike, aq edhe heroike. Një ditë që meriton të kujtohet nga të gjithë. Një demokraci pa kujtesë e sheh veten në vuajtje. Nuk duhet të harrojmë, me qëllimin fisnik të mos përsëritjes të së shkuarës. Kujtesa nuk është gjithnjë marrëdhënie vetëm me të kaluarën, për të balancuar ekuilibrat socialë, politikë dhe kulturorë.

Jo! Ajo është edhe vizion për të ardhmen, rojtare e patjetërsueshme e vlerave që duhet t'u përcjellë breznive; ajo është edhe barrierë për negativitetet tragjike që mund t'i qasen të përditshmes sonë. Kujtesa nuk është dhe nuk duhet të jetë revansh, se dufi i revanshit është i pandarë nga prodhimi i urrejtjes. Ky është edhe një nga qëllimet e diskutimit tim të sotëm.

17 korrik 2008, jemi plot 31 vjet më vonë nga pushkatimi terrorist i shtetit të diktaturës i poetëve të Librazhdit, Vilson Blloshmi dhe Genc Leka. Ne jemi në përvjetorin e 31-të të dy poetëve që jetuan dhe i vranë bashkë, dy shpirtra binjakë në poezinë shqipe që emrin e tyre e lanë të shkruar jo vetëm në antologjinë shqipe, por edhe në mendjet dhe në zemrat e një kombi të tërë në këtë rilindje post-diktature. Shteti totalitar i trembej fjalës së lirë dhe poseduesve të saj. Në aspiratën për të shkuar në botën demokratike, Ne përpos dëshmive të rënda dhe përpjekjeve të thella, duhet të tregojmë letrat e fisnikërisë dhe, së pari, ato të disidencës antikomuniste, të prodhuar, në atë kohë nga heronjtë dhe poetët e kohës. Ne sot, të vetëdijshëm për atë guxim të munguar dje, më së pari duhet të nderojmë ata që i shkaktuan frikë diktaturës me punën, jetën dhe veprën e tyre.

Zhvillimet historike na mësojnë se shtetet totalitare bien, por poetët mbesin; jeta dhe vargu i tyre janë monumenti më i përkryer i thelbit të njeriut, janë dëshmitari i përjetshëm i triumfit të lirisë

mbi tiraninë. Shteti komunist shqiptar i zgjodhi dhe i qëmtoi dy poetët Blloshmi e Leka, jo vetëm si pinjollë të klasave të përmbysura politikisht dhe që përfaqësonin dinjitetin e familjeve tradicionale shqiptare, por edhe për faktin e madh se ata ishin të kulturuar, lexonin dhe përkthenin libra, mblidhnin folklorin shqiptar, shkruanin edhe vetë poezi, duke krijuar një mikroklimë evropianiste për veten dhe miqtë e tyre në qëndresën dhe përballjen me shkretëtirën "Sahara" socialiste. E pikërisht këto vlera të prodhuara në kohën e diktaturës dhe të kuptuara gjithnjë e më shumë sot i bëjnë poetët martirë dëshmorë për të gjithë shqiptarët që ishin në kërkim të ndërgjegjes së humbur dhe të ruajtjes së karakterit kombëtar.

Për këtë Ata e kanë vendin në altarin e kombit. Altari i kombit nuk është vetëm retorikë për disa dhe prodhim politikash për të tjerë. Altari është apo, më saktë, duhet të jetë i prekshëm, i vizitueshëm, i përfaqësuar nga të gjithë dëshmorët e Kombit. Ky altar, pra Varrezat e Dëshmorëve të Kombit kanë vite e vite që presin dëshmorët e rinj të Atdheut të rreshtohen krahas atyre të mëparshëm, të vlerësuar nga të gjithë. Dhe poetët e Librazhdit kanë tash 30 e ca vjet që e dhanë jetën e tyre për Shqipërinë dhe vetëm 16 vjet që u dihet varri.

Prandaj, për sa më sipër, dhe për shumë arsye të tjera që historia, arti dhe politika i kanë nxjerrë tashmë, unë i propozoj Qeverisë shqiptare që dëshmorët poetë Vilson Blloshmi dhe Genc Leka të prehen në Varrezat e Dëshmorëve të Kombit në Tiranë, atje ku ata e kanë vendin.

Poetët kanë dy jetë: një fizike dhe një të përjetshme. Është kjo e dyta që sfidon vdekjen dhe pastron atdheun nga skoriet. Po kështu, edhe dëshmorët e çdo kohe, e pra, poetët dëshmorë apo dëshmorët poetë janë të pakrahasueshëm e të pa vlerësueshëm për të ardhmen e atdheut dhe të vetë kulturës kombëtare. Rishkrimi i domosdoshëm i historisë, veçanërisht asaj të këtij 70-vjeçari, larg çdo pasioni politik, larg çdo demagogjie, duhet të bëhet me akte konkrete dhe pikërisht ky do të jetë një akt nderimi moralo-politik për ata që dhanë jetën për liri, duke kundërshtuar diktaturën më të egër të Evropës, ashtu si qindra djem dhe vajza idealistë që ranë kundër fashizmit gjatë Luftës së Dytë Botërore e të nderuar nga të gjithë ne sot. Këta dëshmorë poetë ishin disidentë në një kohë frike dhe terrori dhe treguan krenari e dinjitet, duke e paguar dinjitetin dhe antikomunizmin që treguan me çmimin e jetës së tyre, kur ne të tjerët, më e pakta, ishim kokulur a indiferent ndaj saj.

Të njëjtën gjë, për Atdheun kanë bërë edhe Trifon Xhagjika, Havzi Nela dhe shumë të tjerë, që do të dokumentohen nga historia, morali dhe politika, më mirë se kurrë, përmes punës së Institutit të

Kujtesës Historike, që ne duhet dhe do ta ngremë, si detyrim moral, ligjor dhe politik për dekomunistizimin e shoqërisë shqiptare, larg çdo fryme revanshi. Kjo kërkesë tashmë është e bashkuar edhe me detyrimet për integrimin evropian që ne aspirojmë, të shprehur përmes deklaratës së janarit 2006 të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, nëpërmjet rezolutës 1481.

Duke i vendosur në Varrezat e Dëshmorëve të Kombit, në altarin kombëtar, poetët dëshmorë, ne dëshmojmë se drejtësia dhe sensi i nderimit janë rikthyer mes nesh të vetëdijshëm; se diktatura totalitare dje, por edhe periudha e turbullt dhe shpeshherë e pasqaruar e post komunizmit, ca nga amullia dhe ca nga mungesa e vullnetit politik, e kanë ngadalësuar piedestalin e këtyre martirëve të vërtetë të shpirtit tonë demokratik, piedestal, i cili, për fatin e tyre tragjik dhe heroik njëherësh, kaloi nëpërmjet një krenarie dhe formimi kombëtar demokrat, të ngritur, përveç të tjerave, edhe nga plumbi e litari që diktatura rezervoi për ta*).

Ne do të ndërtojmë (jemi të gjithë të vetëdijshëm për këtë dhe s'ka nevojë asnjë të marrë flamurin) Shqipërinë evropiane, të ardhmen dhe demokracinë në Shqipëri dhe do të forcojmë identitetin tonë kombëtar mbi themele të pastra, themele të historisë dhe luftës antifashiste dhe antikomuniste.

Diskutimi u botua në gazetën 55

***) Vargje nga Vilsoni**

Nëse nuk munda brengës t'i bëj ballë,
zjarr përsëri unë kam në shpirt të djegur,
Nëse m'i vdekur jam se çdo i gjallë,
Mirë pra,m'i gjallë jam se çdo i vdekur...

Vilson Blloshmi, 1 shtator 1972

I.21. Një falje fiskale në dobi të të gjithëve

Diskutimi në seancë plenare mbi projektligjin "Për faljen e detyrimeve doganore dhe tatimore, të detyrimeve të prapambetura të taksës vjetor të qarkullimit rrugor të mjeteve e të taksës së regjistrimit të përvitshëm të mjeteve, si dhe të gjobave e kamatëvonesave të papaguara të kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore".

Tiranë, 11 09 2008

Megjithëse në këndvështrimin personal dhe në qëndrimin e vazhdueshëm në përkrahje pa kushte të një amnistie financiare të plotë e të thellë (natyrisht duke përjashtuar të ardhurat e bizneseve kriminale e të jashtëligjshme dhe të korrupsionit të qeveritarëve) jam paksa larg këtij koncepti të faljes së sotme të detyrimeve tatimore e doganore të gjobave e kamatëvonesave më duhet të pohoj në krye të këtij diskutimi mbështetjen e plotë dhe vlerësimin pozitiv për këtë falje, amnisti të paraqitur nga qeveria, përmbi të gjithash si fakt evident i një politik-bërje të bazuar në treg dhe të orientuar drejt tregut dhe agjentëve të tij.

Duke qenë se në thelb falja fiskale është për gjobat apo interesat e detyrimeve tatimore, doganore e më gjerë dhe jo për principalin e detyrimeve ne mund të pohojmë se ne garantojmë barazinë e atyre që janë treguar korrekt me ligjin në kohë me ata që e kanë shkelur atë duke mos i diskriminuar të parët për ato raste të drejta, korrekte, të ndershme financiare e juridike të krijuara në kohë si vlerë e qenësishme që ka prodhuar, ushqyer e që duhet të rrisë në vijimësi biznesi shqiptar në raportet biznes privat - administrate shtetërore. Së dyti kjo amnisti inkurajon, ndihmon, kërkon por nuk detyron individ apo biznes për pjesëmarrje, pavarësisht atij fakti që shteti është i interesuar për pjesëmarrje sa më të gjerë të atyre që kanë detyrime fiskale të prapambetura në kohë, të fshehura apo të keq llogaritura. Vetë kohëzgjatja e kësaj amnistie, katër muaj është karakteristike e të gjitha amnistive të këtij lloji si amnisti që

përdoren gjerësisht në botë. Ne duhet të jemi të ndërgjegjshëm që s'jemi as të parët as do të ngelemi të fundit në listën e vendeve që aplikojnë amnisti.

Pra në esence të kësaj amnistie është jo vetëm lehtësia e zbatimit dhe përshtatshmëria e saj pa dallesa ndërmjet gjithë atyre taksapaguesve që kanë mungesa apo vonesa në kohë në pagimin e detyrimeve, qofshin biznese vendase apo të huaja, me bindje politike të poseduesve të tyre majtas apo djathtas përmes një kohëzgjatje normale të praktikave të tilla, por edhe besimi që përmes një administrimi efikas, intensiv dhe ekstensiv kjo amnisti fiskale do t'i arrijë qëllimet e saj të reflektuara drejtpërdrejtë në buxhetin e qeverisë, në reduktimin e informalitetit në përgjithësi dhe më kryesorja në buxhetin privat, qetësinë dhe veprimtarinë e individëve tatimpagues dhe bizneseve të amnistuara prej kësaj faljeje.

Situata fiskale në vend, përpjekjet e vazhdueshme dhe në disa drejtime të kësaj qeverie për ta shëndoshur atë përgjithësisht dhe në veçanti pjesë të programit politiko - ekonomike të Partisë Demokratike të paraqitura para zgjedhësve shqiptarë në 2005, na detyron ne, deputetëve të mazhorancës (dhe jo vetëm të mazhorancës) ta përkrahim këtë nismë qeveritare dhe ta votojmë atë, dhe çka do të jetë më e mira për të gjithë, ta votojmë atë pa ngjyra politike, pse i tillë është edhe destinacioni i saj, përfituesit e saj të drejtpërdrejtë. Me këtë ne dëshmojmë përmes të tjerave edhe kulturën tone politike dhe fiskale veçanërisht. Ne jemi të vetëdijshëm për atë marrëdhënie të brishtë, herë herë jo të sinqertë të partneritetit, biznes privat apo publik dhe administrate tatimore e doganore, nga ana tjetër, ku e drejta ka kaluar herë në një kah, herë në tjetrin, por gjithnjë në tendencën e rritjes të evazionit fiskal, duke dobësuar financat publike.

Këto arsye përfshijnë si barrën e rëndë të taksës, dobësinë e pandershmërinë e institucioneve të fiskut, shpërndarjen jo efikase të taksës, diskriminimin apo shkeljen e barazisë nga këto institucione nga njëra anë, por edhe tendenca për të fshehur detyrimet tatimore dhe doganore, tentativat për joshje dhe korruptim financiar të nëpunësve zyrtarë, tradita e kultura e mëparshme në këtë aspekt raportesh nga tatimpaguesit nga ana tjetër. Por rëndësia e vendosjes së këtij raporti biznes - qeveri në shina të drejta, të ndershme e obliguese reciprokisht, qëndron mbi të gjitha në faktin se taksa mbi bizneset, ashtu si çdo lloj takse tjetër paguhet nga individi. Firma tregtare nuk bën asgjë tjetër përveçse transferimit tek qeveria të atyre parave, të ardhurave që mbledh nga konsumatorët, që fiton

nga punonjësit apo vetë aksionerët e saj. Për këdo është e qartë që mund të performosh bukur nga ana retorike - politike, duke folur për taksat të biznesit apo performancat administrative por është fakt se taksat dhe të gjitha kostot e tjera qeverisëse paguhen nga qytetarët. Dhe pikërisht në dobi të qytetarëve, përmes lehtësimit e çlirimit të kapitaleve të tyre është vlera e parë dhe më kryesore që prodhojnë përgjithësisht amnisti të tilla e padyshim edhe kjo e sotmja që njëherësh realizon:

- gjallërimin, formalizimin dhe shëndoshjen e ekonomisë duke mbledhur një pjesë të borxhit të papaguar si taksë apo tatim me synimin e forcimit të financave publike pa asnjë kosto;

- nëpërmjet realizimit të amnistisë, shoqërisë i zgjerohen mundësitë për të dalë nga zona e ekonomisë informale, çka është problem jo vetëm për ne si vend në zhvillim por edhe për ato të përparuara, dhe tatimpaguesit të futen në rrjedhën normale të jetës ekonomike përmes nxitjes dhe lehtësimit të deklarimeve të ndershme e të plota të të ardhurave;

- amnistia fiskale do të ndryshojë në të ardhmen mënyrën e sjelljes së bizneseve, individëve dhe institucioneve tatimore dhe doganore duke reduktuar ndjeshëm frikën, stresin e bizneseve apo edhe arrogancën e organeve të fiskut.

Në veprën më të fundit analitike të tij "Epoka e tronditjeve-peripecitë e një bote të re", personaliteti më i madh i politikave korrente, monetare dhe financiare ndërkombëtare, Alan Greenspan ndër të tjera shkruan: "çdo zgjedhje ka patjetër përfitimet dhe kostot e saj. Që të sigurojmë përfitimet ne duhet të pranojmë kostot e tyre". E pra, ne në këtë rast duhet të minimizojmë njëherësh edhe efektet negative që mbartin këto lloj amnistish. Për këtë, bizneseve duhet të qartësohet kohëzgjatja dhe përmes faktit që kjo amnisti nuk do të përsëritet në të ardhmen të ndërgjegjësohen që efikasiteti i punës kontrolluese të institucioneve fiskale do të rritet në të ardhmen dhe pasojat financiare do të jetë të rënda për ata që nuk shlyejnë detyrimet përkatëse në kohë apo akoma më keq që nuk duan të përfitojnë nga kjo amnisti. Nga tatimpaguesit duhet të kuptohet, dhe kjo është detyrë funksionale e Ministrisë së Financave, që duke falur këto detyrime financiare, gjoba apo kamatëvonesa qeveria "fshin" financiarisht të kaluarën e tatimpaguesve, për të pastruar dhe shëndoshur të tashmen me ekzigjencë të plotë për të ardhmen. Tatimpaguesit, qytetarët shqiptarë janë dhe duhet të ndërgjegjësohen që kjo amnisti pavarësisht të ardhurave shtesë që mund të gjenerojnë në buxhet (gjë për të cilën unë nuk jam shumë optimist), qëllim kryesor ka t'u shërbejë më mirë tatimpaguesve,

bizneseve të tyre, rregullimit të raporteve të tyre me administratën shtetërore dhe më gjerë duke ekzekutuar politika që nxisin krijimin e pasurisë si një çelës rritjeje të të mirave materiale të një organizimi ekonomik të shëndoshë duke përdorur të gjitha resurset dhe në funksion të drejtpërdrejtë të shtimit të tyre. Kjo amnisti në fakt shërben si një hallkë modeste, si një suport, mjet ndihmës për atë drejtim politikash të sintetizuara në politika monetare e fiskale që dekani ideolog i ekonomisë bashkëkohore të sotëm Milton Friedman shpreh në veprën e tij "Kapitalizmi dhe liria": "Ne kemi nevojë jo për një drejtues të shkathët monetar të makinës ekonomike vazhdimisht duke dredhur e përdredhur timonin për t'ju përshtatur parregullsive të papritura të rrugës, por për disa mjete të cilat mund ta mbajnë pasagjerin monetar (e fiskal) në sediljen e prapme të makinës të palëkundur nga animet e papritura dhe tronditjet e timonit që mund ta nxjerrin makinën jashtë rrugës". E pikërisht qeveria përmes kësaj amnistie i shërben stabilitetit makroekonomik e rritjes ekonomike të vendit në përgjithësi e bizneseve e individëve në veçanti.

Diskutimi u botua në gazetën 55, dt. 12/09/2008

Shënim: *Problemet që dolën gjatë shqyrtimit nen për nen (qëndrimi refraktar i Ministrit të Financave për mos heqjen e nenit 9) më detyruan të abstenoj në votim.*

I.22. Mbi privatizimin e ARMO –s

Tiranë, datë. 25.09.2008

Në fillim të kësaj fjale dëshiroj të bëj sqarimin se i gjithë diskutimi im i sotëm, kjo vërejtje, nëse mund ta quaj të tillë, bëhet pa u konsultuar me lidershipin e grupit të PD-së. Ky është një vrojtim, një diskutim që, nëse do ta kisha zhvilluar ditë më përpara, ndoshta mund të gaboja, por prapë jam i bindur në vetvete që nuk do të nxitohesha në idenë që do të shtjellojë më poshtë.

Për mendimin tim personal, në cilësinë e deputetit të Vlorës, rëndësia e parë dhe më e rëndësishme e privatizimit të ARMO-s është konfirmimi de jure dhe de facto i orientimit properëndimor politik dhe ekonomik të Qeverisë dhe të vendit dhe jo vetëm të vendit tonë, por të krejt kombit shqiptar, pra përfshirë edhe Kosovën, duke bashkuar në një emërues të përbashkët zhvillimet makroekonomike të privatizimit të ekonomisë së vendit, me ato gjeostrategjike dhe politike, duke bërë të pamundur, e theksoj, duke bërë të pamundur kontrollin e këtij aseti të rëndësishëm, jo vetëm kombëtar, por rajonal e më gjerë, nga firma private, pjesëtare të konsorciumit blerës, të kontrolluara drejtpërdrejt apo tërthorazi nga aksionerë me kombësi nga vende jo mike të Shqipërisë e të Kosovës. Në qoftë se qendra të tilla, tipikisht, Kremlini apo derivate të tij, do të arrinin të kontrollonin naftën shqiptare, përpunimin e saj, ne shqiptarët, kurrsesi, nuk do të kishim garanci për zhvillimin e sigurt të Shqipërisë, por do të ishim dëshmitarë vetëm të përfitimeve të tyre, duke shkaktuar, pra, ky kontroll i tyre, një handikap të madh në sektorin e naftës në Shqipëri e më gjerë, në atë ekonomik e politik. Gjeopolitikisht jemi të vetëdijshëm se ky kontroll, nëse do të ndodhte, asnjëherë nuk do të kontribuonte në favor të progresit në Shqipëri e Kosovë, por do të ishte një mur pengese, i krijuar nga vetë ne, ndaj zhvillimit mbarëkombëtar e integrimit euroatlantik. Hyrja e kompanive ruse në këtë treg do të vijonte më tej me negativitete e reflektime regresiste në Kosovë, dhe unë mendoj se kjo është e rëndësishme të thuhet në

këtë sallë. Përmes këtij privatizimi tërësisht me transparencë dhe me rentabilitet ekonomik, ne, shqiptarët, njëherazi, kontribuojmë me modesti, për vetë peshën e rëndesës që kemi, në një nga përparësitë e kërkuara nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës për diversifikimin e burimeve të energjisë për Evropën në përgjithësi, e rajonin e Ballkanit në veçanti, në industrinë e përpunimit të naftës. Qeveria, posaçërisht Ministria e Ekonomisë, duke realizuar një privatizim transparent, të hapur e ekonomik, dëshmoi dhe largpamësinë e saj gjeopolitike dhe pro euroatlantike, të Kryeministrit dhe të ministrit Ruli në veçanti. Kjo, të nderuar kolegë, është e rëndësishme të thuhet sot. Shuma totale e shitjes së 85% të aksioneve të ARMO-s, këtij konsorciumi të llojit të veçantë në Shqipëri, që vetëm për vitin e kaluar realizoi 10 milionë fitim neto, është disa herë më e lartë nga ajo tentativë joekonomike, e bërë disa vite më parë nga qarqe të caktuara. Nisur nga rëndësia në rritje e naftës në ekonominë botërore, merr vlerë të veçantë investimi në vite nga kompania që po e privatizon në të gjitha drejtimet: të nxjerrjes, shfrytëzimit, përdorimit me efikasitet të metodave dytësore, dhe më kryesorja, të rafinimit të saj, në bazë të garancive financiare, të shprehura në nivelet përcaktuese të kësaj kontrate shitjeje. Unë besoj se kërkesa e vendeve mike të Shqipërisë, e shprehur kohë përpara këtij privatizimi, citoj: "Presim që Qeveria e Shqipërisë ta kryejë atë në mënyrë transparente dhe të hapur, duke siguruar një fushë të njëtrajtshme loje për të gjitha palët e interesuara", besoj se është përmbushur plotësisht. Qeveria kërkoi dhe arriti të marrë shumë më tepër se çfarë parashikohej për këtë privatizim, edhe nga konsulenti në privatizim, kompania amerikane, edhe me penalitetet e vendosura në kontratë, në rast mosrealizimi të investimit, të cilat janë po aq të rëndësishme sa edhe vlera e blerjes së kësaj kompanie.

Pra, në rast mosrealizimi të planit të biznesit, garancia bankare, dhe më gjerë, do ta garantojnë më shumë këtë privatizim të sigurt. Në mbyllje, përfitoj nga rasti, në këto minuta, të vë në dukje se në privatizimin e këtij aseti gjigant të naftës kanë meritë mbi të gjitha punonjësit dhe inxhinierët e naftës, për punën, mundin, dijen dhe përpjekjet e tyre para 1990-ës. E ndiej obligim që ne, si Parlament, dhe unë personalisht, të përmend, të nderoj dhe të vlerësoj në këtë sallë, emrat e inxhinierëve të tillë, si: Koço Plaku, Milto Gjikopulli, Lipe Nashi, të ekzekutuar nga diktatura në 1976-ën, apo më tej, të personalitetit të inxhinierisë së naftës dhe gjeologjisë shqiptare, Petraq Xhaçkën, Enriko Veizin, Mënyr Arapin, Petrit Sadushin e dhjetëra të tjerë. Në respekt të punës, të kontributit, në respekt të atij qëndrimi të nderuar, që në mënyrë të sintetizuar është shprehur

te libri i Petraq Xhaçkës "Kalvari i një intelektuali", përfitoj nga ky rast që të sjell në vëmendje të Qeverisë, veçanërisht të ministrit të Financave, që, pavarësisht problemeve, mospërputhjeve që mund të kenë me përfaqësuesit e FMN-së, të negociojnë që rinovimi i marrëveshjes trevjeçare, në janar të 2009-ës, dhe më tej, që të ardhurat nga privatizimi, përveçse në investime në sektorët strategjikë, përveçse për shlyerjen e borxhit, të kalojnë edhe për atë problem madhor politik, social-ekonomik, që ka shoqëria shqiptare, për dëmshpërblimin e të persekutuarve politikë. Për ta kuptuar që kjo fjali, kjo thënie imja është me kuptim, unë do t'ju ftoja, të nderuar kolegë deputetë, të lexonit librin e Xhaçkës "Kalvari i një intelektuali".

Shënim: Gjithë qëllimi i diskutimit ishte se: nëse Kremlini do të kontrollonte naftën shqiptare, ne nuk do të kishim garanci për zhvillimin pa trauma të Shqipërisë dhe Kosovës.

1.23. Një letër kredeciale e sigurt

Diskutim në seancë plenare, jashtë rendit të ditës

Tiranë, datë 29.09.2008

Diskutimi im modest përqendrohet në atë se, ratifikimi nga Senati i SHBA-së i protokollit të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO, disa ditë më parë, në një hark kohor të shkurtër nga adaptimi i këtij dokumenti në korrik të 2008-ës në Bruksel, mbas dhënies së ftesës në Samitin e Bukureshtit në prill të 2008-ës, do të shërbej jo vetëm si mbështetje zyrtare e shtetit më të fuqishëm të botës dhe liderit të kësaj aleance ushtarake, por, mbi të gjitha, një letër kredenciale e plotë dhe e sigurt për anëtarësimin e Shqipërisë në NATO, duke hedhur kështu hapin vendimtar për realizimin e ëndrrës më të bukur të shqiptarëve në Shqipëri e më gjerë, integrimin e vendit në BE dhe në NATO. Fjalë, shkrime, diskutime, deklarime, analiza apo dhe studime të ndryshme po bëhen në këto ditë për këtë akt të madh historik në dobi të shqiptarëve. Unë dëshiroj që në këtë sallë të nderuar të përfaqësuesve të popullit shqiptar, të ri sjellë deklarimin sintezë, të thellë e kuptimplotë në çdo segment të tij, të ambasadës amerikane në Tiranë, dhe citoj se ky akt i senatit ka një domethënie të jashtëzakonshme. Ai përfaqëson jo vetëm një votëbesim prej një prej partnerëve më të palëkundur, të Amerikës, por edhe një njohje të sinqertë të vendosmërisë së Qeverisë, opozitës dhe mbi të gjitha të popullit Shqiptar për të arritur këtë objektiv të rëndësishëm. Ky akt i lartë politik-njohës për Shqipërinë, i dhënë nga Senati Amerikan, i konfirmuar në vijimësi nga institucionet e larta Amerikane, përfshirë këtu dhe ideimin nga presidenti Bush, jo vetëm lidh pazgjidhshmërisht vendet tona, por e hipotekon, noterizon përfundimisht, përkatësinë dhe ardhmërinë properëndimore euroatlantike të Shqipërisë, duke degraduar e zeruar përfundimisht idetë ramiziste të fillimit të viteve '90, që Shqipëria nuk është as Lindje as Perëndim, të vazhduara më tej për implementim nga drejtuesit më të lartë të Partisë Socialiste, për fat

të keq deri në vitin 1995, në kundërshtim jo vetëm me vokacionin perëndimor të Partisë Demokratike, në fuqi në atë kohë, të qeverisjes demokratike dhe të presidentit të atëhershëm Berisha, por, mbi të gjitha, në kundërshtim me krejt aspiratat e shqiptarëve. Duke qenë i vetëdijshëm për dobësinë tonë si shqiptarë, veçanërisht të memories së dobët të klasës sonë politike e më gjerë, më lejoni të nderuar deputetë, t'ju sjellë në vëmendje disa konsiderata të analistit të mirënjohur amerikan me origjinë shqiptare, Elez Biberaj, dhënë në studimin e thelluar të tij "Shqipëria në tranzicion - rruga e vështirë drejt demokracisë", një vepër 600- faqëshe, e cila deri më sot është analiza më e plotë e rrugës së vështirë të Shqipërisë drejt rrugës 10-vjeçare të demokracisë, të cilën e ka filluar në pozita shumë të vështira. Citoj nga kreu i 7-të "Politikat e jashtme dhe çështjet ndërkombëtare", gjithnjë bëhet fjalë për zotin Elez Biberaj. "Që në fillim të qeverisjes së Berishës kishte shenja të qarta dhe bëhet fjalë për vitet `90-`92, se politika e jashtme e Shqipërisë anonte shumë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e cila kishte mbështetur fort demokratizimin e Shqipërisë. Në fillim të viteve `90, ndoshta nuk kishte vend në Evropë që të kishte aq simpati për Shtetet e Bashkuara sa në Shqipëri. Kjo u duk në qershor të vitit 1991, gjatë vizitës së Sekretarit të Shtetit të Shteteve të Bashkuara, Xhejms Bejker në Shqipëri, me ftesë të Sali Berishës. Qëllimi i Berishës, në vizitën e parë që bëri në SHBA, ishte që të siguronte mbështetjen e Shteteve të Bashkuara për zbatimin e reformave rrënjësor, politike dhe ekonomike, si dhe për të parandaluar shtrirjen e luftës në Kosovë. Berisha theksonte se Shqipëria ishte vend mik dhe aleat që mund të shërbente për realizimin e interesave të rëndësishme të Shteteve të Bashkuara në Ballkan", vazhdon Biberaj në studimin e tij, (faqja 352). "Qëndrimin pro amerikan të Berishës e sulmonin zëdhënësit e Partisë Socialiste, të cilët thoshin se ai ishte duke e bërë vendin e tij peng të interesave Amerikane në Ballkan. Deklaratat zyrtare të Partisë Socialiste dëshmonin se ajo vazhdonte të shikonte me dyshim qëllimet e Shteteve të Bashkuara ndaj Shqipërisë". (Faqja 353). "Socialistët ishin sidomos kundër zhvillimit të marrëdhënieve ushtarake midis Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara dhe paralajmëronin se këto marrëdhënie do të kishin pasoja të rënda, negative, për interesat e sigurimit të Shqipërisë".

Një paragraf i fundit vjen nga analisti Biberaj pas vizitës në shtator të vitit 1995 në Shtëpinë e Bardhë, pra 5 vjet pas përmbysjeve të viteve `90, citoj: "Berisha bëri edhe një vizitë në Pentagon dhe u ofroi Shteteve të Bashkuara shfrytëzimin e bazave në Shqipëri. Udhëheqësi socialist, Servet Pëllumbi, u ngrit menjëherë për të

kritikuar ofertën e bazave që kishte bërë Berisha, duke e quajtur ofertën e Presidentit të "papërgjegjshme".

Burimi që citon Biberaj në librin në fjalë është në gazetën "Zëri i Popullit", 15 shtator 1992, faqja 2, ku, natyrisht, kryeredaktor nuk besoj të ketë qenë Erioni. Për efekt të minutazhit në dispozicion, më duhet të theksoj që në këtë ratifikim, ne si Parti Demokratike vazhdojmë në atë deklarim të ideuar dhe të deklaruar në Kongresin paraelektoral të prillit 2005, që: "Projekti ynë i shndërrimit të ëndrrës evropiane të shqiptarëve në realitet përcakton plotësimin me rigorozitet të kritereve dhe standardeve të integrimit në BE dhe NATO, nëpërmjet reformave të thella politike, sociale, ekonomike dhe institucionale". Këtë rikujtesë të shkurtër për vitet `90 - `95 nuk e solla as për të atakuar një politikan socialist, tashmë në pension, i cili në pikëpamjet e mia, pavarësisht antagonizmave ideologjike dhe politike, ngelet një politikan i ditur dhe burrë relativisht i ndershëm, shumë më i ndershëm sesa socialistët e sotëm, apo për të provokuar një nga partitë e opozitës, për më tepër kur ka disa vite që forcat politike në Shqipëri e përkrahin dhe e kërkojnë pa rezerva këtë anëtarësim, por për të theksuar një të vërtetë historike.

Për të mësuar nga politika, po ju citoj një thënie, të të mirënjohurit Henri Kisinger, në veprën e tij "A ka nevojë Amerika për një politikë të jashtme" ku thotë: "Nevojitet një politikë amerikane më e ndjeshme, por edhe një politikë evropiane më pak dogmatike". Duke e përshtatur këtë thënie me realitetin shqiptar, shihet qartas se Ju, Zotërinj socialistë jeni tashmë te pjesa dogmatike e politikës euro-atlantike shqiptare.

Në fund të fundit, detyra e udhëheqësve është që t'i çojnë shoqëritë e tyre nga aty ku janë, në një nivel ku ato nuk kanë qenë kurrë më parë. E pra, pikërisht Shqipëria në NATO është niveli më i lartë i çdo vendi, i çdo aspirate për prosperitet e siguri.

I.24. Prokuroria duhet të depolitizohet

Diskutim në seancë plenare jashtë rendit të ditës

Tiranë, datë 16.10.2008

Besoj se shënimet që kam përgatitur sot nuk do të më vlejnë, për arsyen e vetme, se unë, personalisht, si deputet, jam tepër i zhgënjyer nga sjellja, hipokrizia, morali i dobët që ju, të nderuar deputetë të opozitës, po tregoni këtu.

Ju keni mbi një muaj që i keni servirur opinionit publik shpifje dhe gënjeshtra për aksidentin e një qytetari, një biznesmeni, duke akuzuar për vrasje politike, duke akuzuar për vrasje me prapaskenë etj. Pikërisht sot, kur e keni marrë vesh edhe zyrtarisht nga relacioni i Prokurorisë së Korçës dhe prokurorisë në përgjithësi, që kjo vrasje e supozuar nga ju ishte një aksident, asnjë nuk ngrihet këtu t'u kërkojë falje familjarëve të të ndjerit, t'i kërkojë ndjesë popullit shqiptar për këtë shpifje, që është vazhdë e të gjitha shpifjeve që ju po bëni në këtë periudhë. Për mendimin tim personal, kjo është kryqëzata e tretë agresive që ju, si e majtë, po ndërmerrni kundër PD-së dhe veçanërisht kundër Kryeministrit Sali Berisha.

Ju nuk mund t'ia falni Berishës faktin që në mars të '92-shit erdhi si i pari President i zgjedhur nga vota e lirë e popullit (në zyrën e Ramiz Alisë, që ju e keni fort për zemër), duke qenë i dyti drejtues i lartë i shtetit shqiptar, mbas Ismail Qemalit, që erdhi në pushtet pa asnjë vrasje, pa asnjë krim në kurriz, përkundrazi. Për këtë ardhje në pushtet të PD-së në '92-shin dha jetën, mes të tjerëve, edhe Heroi i Demokracisë, Arben Broci.

Pasi e mbyllët me humbje fazën e parë, '89-'92-shin, me PD-në dhe Sali Berishën, kaluat në kryqëzatën e dytë, 1992-2005, e cila, për fatin e keq të popullit shqiptar, pati një kulm suksesi tuajin, ju fituat një betejë në vitin 1997, por jo luftën, e shfrytëzuat, e molët pushtetin e gënjyet popullin shqiptar 8 vjet dhe mbasi PD-ja dhe Berisha erdhën në pushtet në korrik 2005, ju tashmë keni kaluar në atë që është sulmi i tretë frontal ose kryqëzimi i tretë që ju doni t'i

bëni jo thjesht Sali Berishës si individ, pasi Sali Berisha është më se i realizuar në jetën dhe karrierën e vet politike, por doni t'u bëni anëtarëve të PD-së, doni t'i bëni PD-së, partive të tjera të djathta dhe të qendrës dhe krejt demokracisë në Shqipëri.

Meqenëse jam këtu, pavarësisht diskutimit që, siç e thashë, e kisha për etikën parlamentare dhe në respekt të atyre të drejtave që kam si deputet i popullit, si deputet i qytetit të Vlorës, në respekt të atyre të drejtave që burojnë edhe nga fakti që unë, personalisht, si deputet, prokuroren e re të Përgjithshme, të zgjedhur 9 muaj më parë, me rregullat e derivatit i bie që e kam votuar dy herë, madje, për ndonjë që di të bëjë analiza, e kam votuar 3 herë, më lejoni që, në një frymë tepër miqësore, pa dashur të ndërhyj në punët e organit të prokurorisë, duke e ftuar dhe duke e inkurajuar t'i thellojë hetimet për këdo dhe mbi cilindo pa asnjë problem, t'i kujtoj miqësisht zonjës prokurore të Përgjithshme që, nëse ka kohë, të lexojë një roman të Ismail Kadaresë "Jeta, loja dhe vdekja e Lul Mazrekut". Në rast se ndonjë nga ju ose nga shoqëria civile do të jetë i interesuar, është e mira që këtë roman ta përkthejë edhe në anglisht.

Pse e them këtë? Në atë roman, prokurorja e Përgjithshme do të shikojë që figura qendrore më e urryer e atij romani sot është në krah të djathtë të saj. E pra, shqiptarët në '90-ën , shqiptarët në '92-shin, shqiptarët në 2005-ën nuk votuan që në Prokurorinë e Përgjithshme të jetë drejtues *de facto* një njeri i tillë. Ne, këtu në Parlament, votuam për Ina Ramën, nuk votuam për Zamir Ramën, nuk votuam për Shtyllën e Ramës, nuk votuam që ligjin, drejtimin në prokurori, ta bëjë një njeri që ka shërbyer që nga koha e Kadri Hazbiut, Feçor Shehut, Simon Stefanit, Qemal Lames, nxënës i Aranit Çelës.

(*Ka ndërhyrje nga deputetët e opozitës*.) Unë e di shumë mirë. Ju, po të keni mend, lexoni, shikoni CV-të e këtyre personave dhe do ta kuptoni sa absurde është të drejtojë një armik i demokracisë, të drejtojë një njeri që është i veçantë në specien e vet.

Ka pasur shumë persona që kanë punuar në ato organe para '90-ës dhe e kanë gjetur veten e tyre me shumë dinjitet sot në profesione të tjera. Por një drejtues i tillë është një shërbëtor i shumë zotërinjve, që prokurorët e tjerë, pasi i ka mjelë, i ka shitur dhe do të bëjë të njëjtën gjë edhe me zonjën Rama.

Por kjo është një frymë dhe zonja Rama duhet të vlerësojë ato arritje, pavarësisht që ne si pozitë nuk ditëm t'ia njihnim kryeprokurorit të mëparshëm, Dhori Sollakut, që, duam apo nuk duam ne, doni apo nuk doni ju, e depolitizoi Prokurorinë e Përgjithshme. Prokuroria e Përgjithshme duhet të jetë një organ i varur nga ligji dhe vetëm nga ligji.

Vazhdimin e idesë sime për diskutimin që kisha përgatitur e kisha në këtë kontekst, të nderuar deputetë, që këtu në Parlament populli pret nga ne, më shumë se sa deputetë partiakë, të jemi deputetë të popullit. Në këtë seancë, bazuar në nenin 45 të Rregullores, që ju e keni miratuar në vitin 2004, ne duhet të ngremë ato probleme që vërtet shqetësojnë, ato probleme që vërtet inkurajojnë zhvillimin progresist në vend.

Kështu, do të ishte mirë që në këto javë të punimeve të Parlamentit, përveç vrasjeve dhe krimeve që ju supozoni, të merreshim edhe me problemet të tilla si, fjala vjen, të falënderonim qeveritë dhe parlamentet e Malit të Zi dhe Maqedonisë për njohjen që i bënë shtetit të ri të Kosovës, të inkurajonim Kryeministrin Thaçi, që, për fat të mirë, e kemi mik të gjithë, dhe partitë politike në Kosovë për atë punë të mirë që po bëjnë për njohjen e Kosovës, të vlerësonim faktin (fryt edhe i vizitës së Kryetares së Kuvendit, që ju s'doni ta pranoni) që Emiratet e Bashkuara Arabe janë i pari vend islamik që njohu Kosovën (rrjedhojë edhe e diplomacisë sonë parlamentare).

Të hënën e kaluar, do të ishte nder për ne, si parlamentarë që këtu të flisnin profesorë të nderuar, si Gëzim Karapici, ndonjë ish-ministër nga ana juaj apo profesor i nderuar, të cilët do të inkurajonin dhe stimulonin studentët dhe pedagogët e rinj për fillimin e vitit të ri akademik, mbi 600 pedagogë të rinj që fituan konkurset, nga të cilët 160 janë vetëm në Universitetin e Tiranës dhe shumë e shumë probleme të tjera.

Ne, duke u ngritur këtu për të akuzuar njëri-tjetrin, me akuza të pabaza, nuk po bëjmë gjë tjetër, veçse po deformojmë vetveten. Duke deformuar vetveten, njëherësh, ne deformojmë edhe Parlamentin.

Shënim: *Pjesë nga diskutimi i mësipërm u komentuan në edicionin e lajmeve të RTSH dhe TV Klan, si dhe u komentuan nga gazetat e ditës së nesërme (shiko Kreu II).*

I.25. Certifikimi i buxhetit 2007 - Seriozitet i Qeverisë

Diskutimi në seancë plenare mbi projektligjin "Për miratimin e buxhetit faktik të shtetit të vitit 2007

Tiranë, datë 16.10..2008

Deduksioni logjik i analizës së buxhetit faktik 2007 i certifikuar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në rrjedhojë të detyrimeve kushtetuese që institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar ka në zbatim të nenit 164 për t'i paraqitur Kuvendit si raportim për zbatimin e buxhetit të shtetit ashtu dhe mendimin për raportin e Këshillit të Ministrave për shpenzimet e vitit të kaluar financiar para se të miratohet nga Kuvendi se (citoj nga raporti **i** K.L.Sh): "Ritmet e zhvillimit ekonomik të vendit kanë qenë të kënaqshme dhe situata makroekonomike ka qenë e qëndrueshme" si dhe përputhja e treguesve në të dy raportet, atë të Qeverisë dhe atë të Kontrollit të Shtetit e detyron pozitivisht Kuvendin ta miratojë projektligjin "Për miratimin e buxhetit faktik të vitit 2007", paraqitur nga Qeveria përmes Vendimit nr. 914, date 03.07.2008 të Këshillit të Ministrave. Buxheti faktik i vitit 2007 në tërësinë e etapave që ka kaluar deri sot është në përputhje përveçse me kuadrin tonë ligjor edhe me Kodin e Praktikave të Mira të F.M.N për transparencën fiskale ku veçojmë atë të përgatitjes, zbatimit dhe raportimit transparent të një Buxheti si dhe atë të Garantimit të integritetit, përmes fakteve që ky informacion fiskal plotëson standardet e pranuara mbi të dhënat cilësore (G.F.S) dhe është subjekt i një shqyrtimi të pavarur nga një institucion i lartë kontrollues fiskal siç është Kontrolli i Lartë i Shtetit përmes "Raportit për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2007" paraqitur më 23.09.2008 nga K.L.Sh-ja. Megjithëse sektori privat është udhëheqës e konsolidues në shpërndarjen e burimeve e për rrjedhojë në Produktin e Brendshëm Bruto të vendit, fakti që nëpërmjet sektorit publik shpërndahet dhe rishpërndahet mbi 30% e P.B.B të vendit e bëjnë qeverinë një faktor të rëndësishëm për

zhvillimin e vendit e për rrjedhojë analizën e punës së saj të vlefshme për këdo. Kjo analizë mund të bëhet në dy këndvështrime. Së pari, mënyra se si qeveria i siguron këto të ardhura duke shfrytëzuar instrumentet e duhur ligjore dhe financiar nëpërmjet sistemit të taksave dhe tatimeve dhe së dyti, duke analizuar shpenzimet që qeveria kryen jo vetëm si domosdoshmëri që publiku të kuptojë se cilat janë aktivitetet dhe shërbimet që ka ofruar dhe ofron ky Ent publik, pra qeveria si një e tërë por mbi të gjitha sot kur transparenca kërkohet dhe reflektohet kudo për të evidentuar koston e realizimit të shërbimeve që ofrohen nga Qeveria. Kontrolli i shpenzimeve buxhetore gjithashtu është një kusht i rëndësishëm, njësi matëse për kontrollin e burokracisë në administratën e një vendi.

Dy tregues të rëndësishëm, ai i rritjes ekonomike 6% në vitin 2007, nga 5.5% që ishte në 2005 dhe vlerësimi në terma nominal i Produktit të Brendshëm Bruto në fund të vitit 2007 në rreth 980 miliardë lekë, me një rritje prej 9.7% në krahasim me vitin 2006 të bëjnë optimistë për faktin se vendi ynë ka ritmin e rritjes së P.B.B më të lartë nga vendet e Evropës Qendrore e Lindore. Rritja prej 9% nga 2006 në 2007 e Produktit të Brendshëm Bruto për FRYMË, ose në vlerë absolute 310 mijë lek, pra 3875 dollarë na shtyn në pohimin e një konstatimi tjetër. Siç pohon dhe analisti Fareed Zaharia në veprën "E ardhmja e Lirisë" një tezë të shkencëtarit të çështjeve sociale Seymur Martin Lipset, "Shpjegimi më i thjeshtë për suksesin politik të një demokracie të re bazohet në suksesin e saj ekonomik- apo për të qenë më të saktë – në nivelin e lartë të ardhurave kombëtare për frymë. Një vend që përpiqet të kalojë drejt demokracisë, kur ka të ardhurat për frymë nga 3000 deri 6000 USD, ai ka për t'ia dal mbanë me sukses". Në vitin 2004 që ka botuar librin analisti Zaharia duke krahasuar vendet e Evropës Lindore pas 1989 citonte se "vende si Shqipëria iu duhet mjaft më shumë kohë për të konsoliduar demokracinë, se sa vende të tilla si Polonia, Republika Çeke, Hungaria etj". Pra fakti që ky korrelacion është provuar dhe historikisht në Evropë e botë dhe shifrat janë 310 mijë lekë nga 283 mijë lekë, 3300 U.S.D në 2006 duhet të na bëjë optimist për të ardhmen e shëndetshme të demokracisë sonë. Edhe ulja e normës së papunësisë në 13.2% në 2007 nga 13.8% në 2006 është një impakt pozitiv për sa përmenda më sipër, por që natyrisht për problemet që kalon vendi dhe qytetarët nuk duhet të na kënaqin. Fakti që synimet kryesore të buxhetit të shtetit për vitin 2007 (përmend: rritja e të ardhurave progresive të të ardhurave të buxhetit me 9.67% më shumë krahasuar me vitin 2006, apo ato tatimore e doganore me 14% më shumë se 2006 megjithëse plani u realizuar në 97% rritja e shpenzimeve publike

në sektorë prioritarë si mbrojtja, arsimi, shëndetësia, kontrolli i rreptë mbi deficitin buxhetor, i cili rezulton në 3.5% të P.B.B) dhe objektivat kryesorë të këtij buxheti janë realizuar pozitivisht na bën koherent si mazhorancë e qeveri me atë deklarimin të kryeministrit në paraqitjen e programit të Qeverisë 2005 – 2009 në shtator 2009 që deklaroi se: "Synimi i qeverisë është që ekonomia shqiptare të rikthehet në nivelet e larta të rritjes ekonomike rreth 6 – 8 % në vit, bazuar në një ekonomi të lirë, funksionale e institucionale tregu të modelit dhe standardeve evropiane por njëkohësisht një rritje e tillë nga e cila përfitojnë në mënyrë sa më të drejtë të gjithë shqiptarët, rritje e cila është faktori kryesor i reduktimit të varfërisë, i rritjes së punësimit e reduktimit të papunësisë deri në nivelin mesatar të vendeve të zhvilluara evropiane, si dhe një rritje afatgjatë që nuk komprometon shanset e brezave të ardhshëm". Dhe duke vlerësuar arritjet e mishëruara në këtë buxhet faktik si dhe ato të derisotme ne të gjithë biem dakord që kemi shumë për të bërë e më tej pjesa e deputetëve të mazhorancës bie dakord dhe beson plotësisht që Kryeministri Berisha do t'i realizojë me qeverinë e tij deri në 2009, me ose pa ndryshime në qeveri, përpos të tjerash në atë sfidë të madhe të kërkimit të një mandati të dytë në 2009.

A mund të jetë Raporti për buxhetin faktik më i plotë? Duhet të theksojmë se rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit për këtë pike janë profesionale e racionale. Ku mund të plotësohet?

Treguesit krahasimorë të shpenzimeve të buxhetit të shtetit të paraqiten si krahasim me vendet e rajonit të Ballkanit si dhe me vendet anëtare të B.E sipas klasifikimit ekonomik.

Analiza e shpenzimeve të buxhetit të shtetit të shoqërohet edhe me analizën e të ardhurave buxhetore si dhe të kryhen analiza më të thelluara në drejtim të analizës së shpenzimeve buxhetore, sidomos në sektorët më të rëndësishëm dhe prioritarë e shoqëruar kjo me analiza të kostos së shërbimeve dhe e krahasuar me nivelet e shpenzimeve dhe efiçencës së këtyre shpenzimeve në vendet e tjera.

Në mbyllje të këtij diskutimi konstatohet se qeveria ka plotësuar një pjesë të rekomandimeve të KLSH-së nëpërmjet kalimit të një ligji të ri "Për "Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 ashtu dhe përmes aktit ligjor të faljes fiskale të parakohshme nëpërmjet të cilit morën zgjidhje, detyrimet e akumuluara prej vitesh duke i dhënë këtij problemi të mbartur një zgjidhje ligjore racionale.

Diskutimi u botua në gazetën 55, datë 17.10.2008

I.26. Certifikim arritjesh dhe detyrat për të ardhmen

Diskutim në seancë plenare jashtë rendit të ditës

Tiranë, datë. 06.11.2008

Progres-raporti i BE-së mbi ecurinë e proceseve politike në Shqipëri, nuk është një raport i rëndomtë kancelarie por një dokument analize sintetike në të cilin jepen në mënyrë diplomatike, vlerësuese dhe inkurajuese, jo vetëm vlerësimi objektiv për punën e qeverisë shqiptare, por shtrohen dhe kërkesa për gjithë politikën dhe shoqërinë shqiptare, në atë objektiv madhor të përbashkët që kemi, anëtarësimin në BE.

Në këtë progres-raport konfirmohet fakti i rëndësishëm që qeveria shqiptare dhe kjo mazhorancë po bën përpjekjet maksimale për të arritur atë që sot në botën perëndimore mbizotëron, që fjala demokraci të nënkuptojë demokracinë liberale e cila përfshin: zgjedhje të lira, të drejta dhe të ndershme; sundim të ligjit; ndarje të pushteteve; mbrojtje të të drejtave themelore të lirisë së shprehjes, grupit, të besimit dhe të pronës.

Fjala progres është kudo në raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë dhe ky raport nuk lë vend për dyshime për progresin e bërë, do të shpreheshin Komisionerët e nderuar të tij. Mbi të gjitha evident, në atë diferencë cilësore pozitive me raportin e një viti më parë e më tej duke e bërë kështu raportin më të mirë, më vlerësues e inkurajues që qeveritë shqiptare kanë marrë këto vite tranzicioni.

Në raport theksohet se: "Shqipëria po ecën përpara me zbatimin e marrëveshjes së ndërmjetme dhe ka pasur progres në fusha të rëndësishme të reformave. Konsolidimi i shtetit ligjor dhe përforcimi i kapaciteteve administrative mbetet sfidë e madhe". Komisioneri Rehn ndërmjet të tjerash vlerëson se: "Shqipëria ka bërë progres në sektorët kyç siç është reforma në drejtësi dhe ajo zgjedhore, ndërsa përpjekjet për konsolidimin e shtetit ligjor janë intensifikuar. Shqipëria ka firmosur MSA-n në vitin 2006, procesi i ratifikimit po shkon drejt përfundimit dhe zbatimi i saj po avancon

gradualisht në të gjithë sektorët". Ky vlerësim sipas mendimit tim na bën optimist për arritjen e objektivit më të afërt, duke kaluar nga një vend potencialisht kandidat për anëtarësimin në BE në një vend me statusin e vendit kandidat për anëtarësimin e plotë.

Në pjesën e dytë të këtij raporti, që flet për situatën dhe treguesit ekonomikë me vlerësimin inkurajues për stabilitetin makroekonomik, theksohet se Shqipëria ka bërë progres në fushën ekonomike, duke arritur një rritje ekonomike prej 6%, të Prodhimit të Brendshëm Bruto, ndër më të lartën në këto vite, me një inflacion të mbajtur në kontroll, në nivelin 2-4% të përcaktuar nga Banka Qendrore, Qeveria dhe Institucionet Financiare Ndërkombëtare. Gjithashtu dhe treguesit e tjerë ekonomiko-financiarë janë pozitivë dhe flasin qartë për stabilitet makroekonomikë.

Me shqetësimin, të cilit të gjithë ne i bashkohemi, se korrupsioni është gangrene e shoqërisë shqiptare, në raport theksohet se: "Janë bërë përpjekje për reduktimin e mundësive për korrupsion në disa fusha, si në administrimin e taksave, shërbimet për biznesin, titujt e pronësisë, prokurimet publike duke aplikuar sistemin elektronikë", si dhe vlerësohet fakti që ligjet që kornizojnë marrëdhëniet tregtare janë përshtatur me Konventën kundër Korrupsionit të Këshillit të Evropës. Megjithëse ka një numër të madh zyrtarësh të nivelit të mesëm që janë larguar ose dënuar për ryshfet, siç evidentohet në raport ne duhet të reflektojmë më tej në kërkesat e BE-së për të thelluar luftën kundër korrupsionit, në të gjitha format dhe nivelet e tij dhe të pushtetit që e inkurajon atë (përmendim si një tregues kuptimplotë problemin me lejet e ndërtimit në Tiranë të cilat ishin 40% më pak se në 2007, tregues i cili flet vet për korrupsionin, poseduesit e inkurajuesit e tij dhe problematikën ekonomike që mbart).

Politikisht Komisionerët vlerësojnë se: "Shqipëria ka bërë progres në përmbushjen e kritereve politike të Kopenhagenit, të cilat konsistojnë në stabilitetin e institucioneve që garantojnë demokracinë, shtetin ligjor, të drejtat e njeriut dhe respektimin e të drejtave të minoriteteve".

Në këtë Progres- Raport, është pozitiv fakti për deputetët e Kuvendit të Shqipërisë, Kuvend i cili ka konsoliduar më shumë rolin e tij kushtetues në debatin politik se qartas konstatohet: " Një numër i konsiderueshëm ligjesh janë miratuar për të përafruar Legjislacionin shqiptarë me atë evropian sipas *acquis communiter*".

Ky raport ka vlerësime pozitive dhe kërkesa të larta për të ardhmen, por ku qëndron problemi me politikën shqiptare, për mendimin tim? Ne, politikanët shqiptarë po i kalojmë gjithmonë

e më tepër, në papajtueshmëri betejat politike me parimet morale, duke i disbalancuar ato nëpërmjet vendosjeve në plan të parë të politikës së ditës partiake në kurriz të moralit. Kjo shihet dhe në qasjen, vlerësimin që ne po i bëjmë këtij progres-raporti, duke e shoqëruar një pjesë e jona, një numër i konsiderueshëm politikanësh të majtë, Demokracinë si virtyt publik me vesin publik të mohimit të arritjeve dhe më tej të mashtrimit, edhe për dokumente të tilla serioze.

Ndërsa Berisha dhe mazhoranca e përcaktojnë si raport objektiv në vlerësimin e zhvillimeve të gjithanshme ose ndryshe siç e përcakton Kryeministri Berisha se: "Raporti përbën një dokument të shkëlqyer për Qeverinë time, si Program Pune, por në mënyrë absolute edhe si program elektoral për kërkesat që shtron dhe për problemet që duhet të zgjidhim për vitin e ardhshëm". Për më tej Kryeministri deklaron pa hezitim se: "po të ishte një marrëveshje bilaterale do ta firmosja pa i ndryshuar asgjë". Ndërsa opozita duke shkëputur pjesë të veçanta nga konteksti nuk mohon vetëm arritjet por çka është më e keqja në këtë rast nxin realitetin dhe errëson të ardhmen, një të ardhme që ne ende s'po kuptojmë se e kemi të përbashkët pavarësisht ngjyresave politike.

Më mirë kjo ide dhe detyrat e këtij raporti do realizohen nëse ne kuptojmë plotësisht një mesazh politik nga Senatori amerikan Jack Macain në përshëndetjen e tij mbas deklarimit të humbjes në fushatën presidenciale, ku thekson: "Vendi ynë është në kohë të vështira dhe unë (Jack Macain) i premtoj atij (Barack Obama) sonte, se do të bëj çdo gjë që është në fuqinë time për ta ndihmuar, të na drejtojë në sfidat e vështira me të cilat përballemi. Unë i kërkoj amerikanëve të më mbështesin e të bashkohen me mua jo vetëm për ta uruar Presidentin, por për t'i ofruar atij vullnetin tonë të mirë dhe përpjekjet e sinqerta për të gjetur zgjidhje të përbashkëta dhe kompromiset e domosdoshme për të lidhur ndryshimet tona dhe për të ndihmuar të riparojmë prosperitetin tonë, të mbrojmë sigurinë tonë në një botë të rrezikshme dhe t'u lemë fëmijëve dhe nipërve tanë një vend më të fortë dhe më të mirë nga ai që kemi trashëguar ne".

E pra ne shqiptarët duhet të punojmë më shumë për të realizuar detyrat tona të përbashkëta, që përmbledhtas konsistojnë në:

-Zgjedhjet 2009 të jenë në përputhje me standardet evropiane;

-Reforma në sistemin e Drejtësisë të jenë gjithpërfshirëse;

-Të zbatohet rigorozisht Strategjia e miratuar në luftën ndaj korrupsionit 2007-2013;

-Politika fiskale dhe monetare duhet të jetë e vëmendshme për ta mundësuar ekonominë të përballojë në një periudhë afatgjatë presionet konkurruese dhe forcat e tregut të Bashkimit Evropian, ku me të drejtë duam të gjithë të anëtarësohemi;

-Të përmirësojmë kulturën e dialogut mes partive politike dhe mbi të gjitha të konsolidojmë pavarësinë e institucioneve shtetërore.

Diskutimi u botua në gazetën 55, dt. 09.11.2008 me titull "Raporti i BE, një certifikim arritjesh dhe listim detyrash për të ardhmen"

I.27. Avokatura e Shtetit – Institucion në mbrojtje të interesave publike

Mbi projektligjin "Për avokaturën e shtetit"

Kuvendi i Shqipërisë votoi në parim projekt-ligjin "Për avokaturën e shtetit", paraqitur nga Këshilli i Ministrave. Duke qenë dakord me këtë projekt-ligj, punën e kujdesshme të bërë edhe në paraqitjen e risive të tij në materialin shoqërues si dhe me plotësimet pozitive të Komisionit të Ligjeve, do të doja t'u sugjeroja, në këtë shkrim të shkurtër, drejtuesve të institucionit të Avokaturës së Shtetit të përqendronin veprimtarinë e këtij institucioni edhe në disa drejtime që nuk janë prekur deri më sot ose janë cekur dobët. Këto sugjerime mendoj që plotësojnë më mirë misionin e Avokaturës së Shtetit, i cili dhe zyrtarisht përkufizohet se, "Është ndihma juridike, në funksionin e saj të dyfishtë, këshillimor dhe gjyqësor në mbrojtje të interesave të shtetit shqiptar, institucioneve të saj qendrore si dhe entet dhe organizmat publike të lidhur me të".

Së pari - Vite më parë, bazuar në ligjin e shndërrimit të ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare, në vendin tonë u krijuan shumë ndërmarrje të përbashkëta me partner të huaj, duke u dhënë të huajve shumicën e kuotave në këto shoqëri, bazuar edhe në faktin se ata merrnin përsipër të investonin për ti vënë në punë këto ndërmarrje si dhe të krijonin vende të reja pune. Me përjashtime të rralla, këto ndërmarrje pushuan së ekzistuari dhe ata që i blenë i rrënuan më tej duke i shndërruar në troje ndërtimi. Po kështu, shumë privatizime të bëra nga socialistët me 200 apo 300 mijë lekë, rezultojnë se asnjëherë nuk janë vënë në punë, por presin të privatizojnë edhe aksionet e mbetura e ti kthejnë këto ndërmarrje në troje për ndërtime pallatesh. Është detyrë e avokatit të shtetit, si mbrojtës i interesave ekonomike dhe financiare të shtetit, të bashkëpunojë me Ministrinë e Financave dhe atë të Ekonomisë për të evidentuar gjendjen e ndërmarrjeve të privatizuara dhe, atje ku nuk janë respektuar detyrimet kontraktuale ti drejtohen gjykatës për

t'i kthyer në gjendjet e mëparshme e për tu përdorur p.sh, si fond për kompensimin e ish pronarëve apo ish të përndjekurve politikë.

Së dyti - Gjatë viteve, shtetit i janë shkaktuar dëme financiare të konsiderueshme nga administrata shtetërore, të provuar kjo edhe me vendime civile të gjykatave. Ka me dhjetëra e qindra vendime gjykatash që detyrojnë shtetin të dëmshpërblejë persona fizikë dhe juridikë, ku një pjesë janë ekzekutuar dhe të tjera presin të ekzekutohen. Mendoj se është detyrë e avokatit të shtetit që të koordinojë punën me drejtuesit e institucioneve shtetërore për të evidentuar rastet kur këto dëme janë rezultat i papërgjegjshmërisë së dukshme të zyrtarëve të shtetit dhe ti detyrojnë ata të dëmshpërblejnë financiarisht. Vetëm duke u prekur xhepin, ne mund ti bëjmë më të përgjegjshëm zyrtarët në ushtrimin e përgjegjësive të tyre. Nëse do të vazhdoj kjo gjendje, kur si rezultat i hedhjes së firmave në mënyrë të papërgjegjshme nga disa zyrtar, shtetit i shkaktohen miliona lekë dëme dhe shteti nuk do të reagoj ndaj tyre, ne nuk do të bëjmë gjë tjetër veçse do të stimulojmë papërgjegjshmërinë e zyrtarëve të caktuar. Natyrisht nuk e kam fjalën për çdo rast, se ndryshe do të sillnim bllokim të funksionimit të administratës nga frika e hedhjes së firmave, por e kam fjalën kur rastet e papërgjegjshmërisë apo të korrupsionit janë qartësisht të dukshme.

Së treti - Ne kemi me dhjetëra a qindra zyrtarë të dënuar penalisht në vite për abuzim me detyrën, duke i shkaktuar dëme financiare shtetit. Në këto vendime, me gjithë se ka pasur vend për ngritjen e padisë civile nga institucionet e dëmtuara, ato në shumë pak raste janë ngritur. Nuk ka asnjë pengesë që avokati i shtetit, të koordinojë punën me institucionet e dëmtuara për evidentimin e këtyre rasteve me qëllim që të ngrihen padi civile pranë gjykatës për të kërkuar zhdëmtimin e dëmeve të pësuara nga kryerja e veprës penale të shpërdorimit të detyrës.

Së fundmi – dëshiroj të tërheq vëmendjen për një pakujdesi, që besoj është bërë në drejtim të transparencës, duke krahasuar projektligjin e ri me ligjin aktual dhe konkretisht me ndryshimet e bëra me ligjin 9673, datë 29.12. 2006 në ligjin Nr 8551, datë 18.11.1999 "Për Avokaturën e Shtetit", që është ende në fuqi. Konkretisht: Në nenin 16 të ligjit në fjalë "Pajtimi i avokatëve në profesion të lirë", në vitin 2006 u shtua dhe një pikë që konfirmon se, "Avokatura e shtetit përgatit buletine të rregullta periodike çdo gjashtë muaj, për listën e avokatëve të pajtuar, çështjet në ndjekje, shpërblimet përkatëse, të cilat i bënë publike për të tretë në faqen e saj të internetit". Në projektligjin e ri kjo pikë, e theksoj, e shtuar në vitin 2006 nuk gjendet e shkruar më në nenin 18 "Kontraktimi i shërbimeve të përfaqësimit

dhe të konsulencës" apo në ndonjë nen tjetër. Besoj që në diskutimin nen për nen kjo do të plotësohet.

Në funksion të sa më sipër përfitoj nga rasti t'ju kujtoj drejtuesve të institucionit të Avokaturës së Shtetit, të plotësojnë me informacionet e duhura në bazë të detyrimeve ligjore, përfshi dhe një vendim të veçantë të qeverisë Berisha, faqen zyrtare të internetit të institucionit, pasi shumica e rubrikave që tregojnë dhe dokumentojnë transparencën dhe veprimtarinë konkrete juridike, pra dhe rezultatet financiare (jo thjeshtë takimet apo aktivitetet) për një kohë të gjatë, gjenden nën shenjën "under construction". Qëllimin e idesë së mësipërme, më saktë e ilustron thënia e Profesorit të Ekonomisë Politike Ndërkombëtare, Francis Fukuyama, në veprën "Ndërtimi i Shtetit" se: "Një institucion i mirë shtetëror është ai që i shërben me transparencë dhe efikasitet nevojave të klientëve të tij – qytetarëve të shtetit". E pra, transparencë institucioni të pa dokumentuar në web-in zyrtar të tij apo buletine periodike (gjyqe, të humbura apo të fituara, si dhe vlerat financiare që derivojnë nga këto gjyqe) nuk ka dhe nuk është tregues i mirë për cilindo institucion e më tepër atë të Avokaturës së Shtetit që duhet të jetë në mbrojtje të interesave të shtetit, në mbrojtje të interesave publikë, nëpërmjet funksionimit të dyfishtë këshillimor dhe gjyqësor.

<u>Shënim</u>: Ky shkrim është pjesë e një materiali-diskutimi që kisha menduar ta mbaja në Kuvend ditën e hënë, datë 10.11. 2008 gjatë diskutimit në parim të projektligjit " Për Avokaturën e Shtetit", shoqëruar dhe me pjesë të tjera teknike në lidhje me projektligjin në fjalë. Situata e krijuar në Kuvend dhe etika e deputetit,sjellja reciproke me kolegët e tjerë të parlamentit, pavarësisht ngjyresave politike, respekti për ta, (një grup deputetësh të drejtuar nga Ilir Meta, filluan grevën e urisë), më detyroi që të mos diskutoja. Gjithsesi përsëris që projektligji i paraqitur dhe i votuar në Kuvend nga deputetët e mazhorancës është i arrirë dhe me vlera.

Diskutimi u botua në gazetën 55, dt. 13/11/2008 përfshirë dhe shënimin e mësipërm.

Shënim 1: *Nga Raporti i Legjislacionit, i cili paraqet një përmbledhje të veprimtarisë ligjvënëse veçojmë:*

"Ligji nr. 10.018, datë 13.11.2008 "Për Avokaturën e Shtetit".
Data e hyrjes në Kuvend 22.10.2008
Nismë e KM
Komisionet parlamentare që kanë shqyrtuar:

Komisioni për Çështjet Kushtetuese dhe Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut;

Shqyrtimi në seancë plenare: 13.11.2008

Ligji është miratuar me 73 vota pro, 0 kunder, 0 abstenime. Shumica e kërkuar: e thjeshtë

Ligji synon fuqizimin dhe modernizimin e këtij institucioni duke patur parasysh edhe zhvillimet e shpejta të vendit tonë gjatë kësaj periudhe si dhe problematikat e hasura gjatë veprimtarisë 9-vjeçare të këtij institucioni. Avokatura e Shtetit është struktura bazë për përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave pasurore të shtetit shqiptar brenda dhe jashtë vendit. Për hartimin e këtij ligji janë studiuar modele të ndryshme të shteteve evropiane. Modeli spanjoll është zgjedhur për t'u marrë si referencë pasi paraqet afërsi me modelin aktual shqiptar, si dhe është vlerësuar si një model me koeficient të lartë suksesi.

Ligji bën një ridimensionim të rolit të Avokaturës së Shtetit, nëpërmjet rritjes së kompetencës lëndore, riorganizimit të institucionit duke mundësuar dhënien e asistencës ligjore që në fazat fillestare të veprimtarisë së administratës publike, si dhe ndryshimin rrënjësor të kompetencave territoriale. Gjithashtu për sa i përket kompetencës lëndore, synohet që ajo të mos jetë e kufizuar, por të ketë karakter gjithëpërfshirës. Avokaturës së Shtetit me këtë ligj i jepet edhe kompetenca për përfaqësimin dhe mbrojtjen juridike të Shqipërisë përpara Gjykatës Evropiane për të drejtat e Njeriut. Ky ndryshim është bërë me synimin për një përfaqësim sa më dinjitoz dhe profesional përpara kësaj gjykate, duke pasur parasysh që edhe numri i çështjeve të paraqitura nga shtetasit shqiptarë përpara kësaj gjykate ka ardhur gjithnjë e në rritje."

I.28. Buxheti i kontinuitetit dhe stabilitetit makroekonomik

Diskutim në seancë plenare mbi projektligjin "Për buxhetin e shtetit të vitit 2009" (Në parim).

Tiranë, datë 20.11.2008

Diskutimet, shkrimet, apo analizat mbi projektbuxhetet e paraqitura nga qeveritë janë sot kudo nga diskutimet më të rëndësishme politiko- ekonomike. Edhe diskutimi sot në Shqipëri, për projektbuxhetin e vitit 2009, është më i rëndësishmi, për faktin se nga ky buxhet do të përcaktohet jo vetëm e ardhmja ekonomike për vitin e ardhshëm, por edhe do të shtrohet rruga për perspektivën e zhvillimit ekonomik të vendit, e cila merr më tepër peshë e rëndësi, kondicionuar nga zhvillimet jo optimiste të ekonomisë globale në këto kohë.

Projektbuxheti i vitit 2009 është një vazhdimësi e projekteve ambicioze të Qeverisë "Berisha" dhe mbas votimit në Parlament, natyrshëm mund të quhet buxheti i kontinuitetit progresist të kësaj Qeverie dhe kësaj maxhorance. Ky projekt ruan stabilitetin makroekonomik të vendit, duke garantuar një rritje ekonomike prej 6%, për më tepër e shoqëruar kjo me normë inflacioni të ulët e të kontrolluar dhe deficit të përcaktuar buxhetor, tregues sinjifikativ, po të kemi parasysh dhe situatën aktuale botërore, apo edhe ekonomike të vendeve të tjera të ngjashëm në pozicione, ose shumë më të zhvilluar se ne.

Kontinuiteti i këtij projektbuxheti garantohet nga politikat rregullatore e koordinuese të Qeverisë në fushën fiskale e monetare, të cilat, përmes vazhdimësisë së uljes së barrës fiskale, luftës kundër evazionit fiskal e informalitetit, vëmendjes së plotë ndaj normave të interesit, duke kontrolluar inflacionin dhe duke progresuar rritjen e pagave e pensioneve, kanë mundësuar e forcuar rritjen e investimeve të brendshme dhe kanë lejuar biznesin privat të disponojë më shumë

fonde financiare për investime dhe punësim, duke ushtruar në këtë mënyrë ndikime të rëndësishme mbi alokimin e burimeve.

Ashtu si dhe në tre vjetët e mëparshme të kësaj Qeverie, ky projektbuxhet ka parashikuar nivele të rritura të investimeve publike, sidomos një rritje të investimeve në infrastrukturë. Me një total të shpenzimeve kapitale, prej mbi 90 miliardë lekë ose 930 milion dollarë, sa 7,6 % e PBB-së, projekti 2009 parashikon mbi 80% më shumë investime sesa buxheti i Qeverisë socialiste, hartuar për vitin 2005, në të cilin ishin parashikuar 50 miliardë lekë investime ose 519 milion dollarë. E bëra këtë krahasim, jo për të bërë fushatë elektorale, se ajo nuk ka filluar, por për të theksuar atë që ka qenë kryefjala e buxheteve të Qeverisë "Berisha" - Investimet.

E theksoj këtë pasi ndodh rëndom dhe kjo praktikë po duket edhe sot, që projektbuxhetet që i takojnë një viti zgjedhjesh të quhen projekte elektorale. Në fakt, diçka e tillë ka ndodhur në të kaluarën me ju, të nderuar zotërinj të minorancës, pasi buxheti i një viti elektoral stononte dukshëm nga buxhetet e viteve të mëparshme. Etiketime të tilla mund të dëgjosh sot nga politikanë ose analistë të paguar edhe për këtë projektbuxhet, që e shikojnë vetëm me syze rozë apo zi realitetin. Por, për mendimin tim, projektbuxheti i 2009-ës, faktet e tregojnë këtë, në të vërtetë nuk synon të krijojë iluzione për zgjedhësit gjatë fushatës elektorale që do të mbahet gjatë këtij viti, por konfirmon realitete makro e mikroekonomike. Mbi të gjitha, ky projekt ambicioz nuk stonon, por është vazhdimësi i buxheteve të viteve të kaluara, më qëllim përmbushjen e premtimeve elektorale të Qeverisë demokratike të bëra gjatë fushatës së vitit 2005.

Që prej ardhjes në pushtet, Qeveria demokratike e ka vënë theksin në ngritjen dhe përmirësimin e infrastrukturës rrugore, si një mjet i rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendit. Rruga Durrës-Kukës pritet të përfundojë me sukses brenda vitit të ardhshëm, duke shënuar një ngjarje historike për Shqipërinë, Kosovën dhe më gjerë në rajon. Përfitoj nga ky rast të përsëris thënien e jo të ndonjë deputeti të maxhorancës, por të Kryeministrit të Kosovës, personalitetit politik Hashim Thaçit, për Kryeministrin Berisha se: "**Kombi do t'i jetë mirënjohës për këtë rrug**ë".

Njëkohësisht me këtë është duke avancuar dhe do të avancojnë punimet dhe projektet për rrugën Lushnjë-Vlorë, një rrugë që do të ndihmojë zhvillimin e turizmit vendas dhe të huaj në jug të Shqipërisë, Rruga e Arbrit apo shumë rrugë e investime të tjera.

Duke u ndalur te premtimet e vitit 2005, të deklaruara nga kryetari i PD-së në prill të 2005-ës në dokumentin programatik

"Koha për ndryshim", të noterizuara në shtator 2005, në programin e Qeverisë 2005-2009 në Kuvendin e Shqipërisë dhe duke iu referuar shifrave që janë arritur nga realizimet e deritanishme dhe ato që priten të realizohen nga ky projekt, konstatohet se Shqipëria po bëhet gjithnjë e më tepër një vend në të cilin rritja ekonomike është trend rritës, stabiliteti makroekonomik është i garantuar dhe ku ulja në mënyrë të ndjeshme e barrës fiskale, për të gjithë individët e bizneset, rënia e ekonomisë informale dhe mbi të gjitha rregullimi më i mirë i konkurrencës kanë rritur besimin e investitorëve të huaj.

Një kontribut të rëndësishëm në këtë drejtim ka dhënë përmirësimi i infrastrukturës në përgjithësi dhe asaj ligjore në veçanti, i cili është një premtim tjetër i rëndësishëm i mbajtur prej nesh dhe i evidentuar gjerësisht në raporte, analiza e sondazhe të ndryshme vendase e ndërkombëtare të institucioneve autoritare të fushës. Ekonomia shqiptare po shkon përfundimisht drejt një ekonomie të tregut të lirë, ku shteti luan rolin e rregullatorit, duke hequr dorë nga menaxhimi i ndërmarrjeve. Kjo po realizohet nëpërmjet vazhdimit të privatizimit të plotë dhe të shpejtë të disa sipërmarrjeve të mëdha shtetërore dhe privatizimet e ardhshme të sipërmarrjeve të tjera, ku shteti ka aksione të tilla, si: AMC, INSIG, OSSH etj.

Biznesi i vogël është shpirti i ekonomisë së një vendi dhe mbështetja ndaj kësaj shtrese është jetike për ekonominë e tij. Tashmë, ajo që është premtuar në lidhje me taksën e biznesit të vogël është realizuar. Biznesi i vogël paguan një taksë të përgjysmuar, e cila i ka dhënë më shumë frymëmarrje kësaj kategorie, duke sjellë më shumë të ardhura dhe më shumë vende pune.

Aplikimi i reformës fiskale u krye e po vazhdon hap pas hapi, pa teprime demagogjike e trauma, duke operuar si në drejtimin vertikal drejt uljes së taksave e marrjes së kuotave të arsyeshme, ashtu edhe atë horizontal drejt zgjerimit të bazës së tatimpaguesve, por, mbi të gjitha, konform parimeve me të mira të financave publike, të raporteve të drejta ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve publike, duke i kthyer këto të ardhura, të rritura në këto 4 vjet me 22%, në resurse për shlyerjen e detyrimeve kolektive për investime në infrastrukturë, në më shumë rrugë, ujësjellës, furnizime e shërbime të ndryshme ndaj qytetarëve.

Buxhetet e tre vjetëve të mëparshëm, sidomos ky projektbuxhet, po japin një kontribut të rëndësishëm në mbështetje të qeverisjes vendore, duke suportuar financiarisht politikat e drejta decentralizuese të pushtetit nga ai qendror drejt vendorit, të

marra prej të parit. Nga 7,3 miliardë lekë, ose 75 milionë dollarë, që akordonte Qeveria socialiste në vitin 2005, tashmë, sipas projektit të vitit 2009, parashikohet që kjo shifër të rritet me mbi 150%, duke kapur nivelin e 18,4 miliardë lekëve ose 190 milionë dollarëve. Ky decentralizim i buxhetit dhe ndarja e drejtë e tij mes komunave dhe bashkive të ndryshme, shpërndajnë zhvillimin ekonomik të vendit në mënyrë më të drejtë në të gjithë territorin, duke ndihmuar në zhvillimin jo vetëm të qendrave urbane, por dhe të zonave rurale, të cilat shpesh kanë qenë në rrezik të shpopullimit të tyre. Përpos të tjerave, vetë shifrat, për shembull, theksoj fondin e transfertave të pakushtëzuara për bashkinë e qytetit tim, Vlorës, i cili është 314 milionë lekë, të Shkodrës 340 milionë lekë, të Korçës 186 milionë lekë apo të Durrësit 400 milionë lekë dhe shpërndarja është tregues i suportit financiar nga pushteti qendror demokrat, pavarësisht ngjyrës politike të drejtuesve të pushtetit vendor.

Po kështu pritet të ketë përmirësim të pagave për të gjitha kategoritë e buxhetorëve. Shifrat në këtë drejtim flasin vetë. Këto shifra, duke pasur parasysh që nga një administratë shtetërore prej 110 mijë punonjësish kemi kaluar në 107 mijë punonjës, fondi i pagave i parashikuar për këtë administratë është rritur, duke kapur nivelin e 51,8 miliardë lekëve ose rreth 535 milionë dollarë, duke shënuar një rritje prej rreth 23%. Ndërsa për çdo punonjës të administratës shtetërore rritja e pagës është 67%, krahasuar me vitin 2005.

Një mbështetje të theksuar dhe në rritje jep ky projektbuxhet për arsimin. Me mbi 41 miliardë lekë të parashikuara për këtë sektor buxheti 2009 shënon një rritje prej 16 miliardë lekësh ose 65% më shumë fonde për arsimin, krahasuar me vitin 2005. Rritja vit pas viti e fondeve në arsim, gërshetuar me politikat liberalizuese të tregut të arsimit të lartë kanë ndikuar në dyfishimin e numrit të studentëve dhe kanë shtuar premisat për rritjen e investimeve në këtë sektor jetik të zhvillimit të vendit, në funksion të produktit final që nxjerr: nxënës, student universitar e pasuniversitar, doktorant të një vendi evropian, që aspiron t'i bashkohet vendeve të BE-së, i aftë të përballojë sfidat e së ardhmes.

Rritja e të ardhurave nga privatizimi dhe përdorimi i tyre në masën 50 % për rritjen e shpenzimeve për investime ndihmon në shtyrjen para të projekteve të nisura për modernizimin e infrastrukturës së vendit. Por mendoj se në këtë pikë duhen parë hapësirat për përmirësim, me qëllim përdorimin sa më me efiçiencë dhe drejtësi të këtyre të ardhurave. Mendoj se duhen parë hapësirat që një pjesë e tyre të përdoren për dëmshpërblimin

e ish të përndjekurve politikë të diktaturës. Sipas të dhënave të projektbuxhetit është parashikuar që për dëmshpërblimin e tyre të vihen në dispozicion 2 miliardë lekë ose rreth 21 milionë dollarë, ose 0,2% e PBB-së.

Duke pasur parasysh pamundësinë e lëvrimit të fondit gjatë viteve të kaluara mendoj dhe propozoj që të rishikohet shpërndarja e të ardhurave nga privatizimi. Në këtë pikë do të propozoja një ndërhyrje në nenin 8 të projektligjit "Për buxhetin e vitit 2009", që 20% e të ardhurave nga privatizimi të përdoren për dëmshpërblimin e ish të përndjekurve politikë dhe pjesa tjetër, ashtu siç është parashikuar e kornizuar nga marrëveshja me FMN-në, për financimin e deficitit 50% dhe për investimet 30%. Kjo pagesë shtesë nuk do ta privilegjonte këtë shtresë, por thjesht do të kompensonte pagesat e munguara gjatë viteve të kaluara dhe, mbi të gjitha, do të tregonte koherencën tonë dhe seriozitetin e kësaj maxhorance në përmbushjen e detyrimeve ligjore e politike. Për këtë sot është çudi që për herë të parë edhe një deputet i minorancës, kolegu Harasani, në pikën 11 të propozimeve të tij, propozon diçka të ngjashme.

Së fundi, dua të theksoj dhe të kujtoj se projektligji "Për buxhetin e vitit 2009" , që kemi sot për shqyrtim dhe miratim, është një dokument që duhet vlerësuar me seriozitet, maturi e profesionalizëm jo vetëm për rëndësinë e tij, por edhe për situatën ekonomike në të cilën po kalon rajoni dhe vendet e zhvilluara. Duhet të jemi të ndërgjegjshëm se kriza financiare botërore është një epidemi nga e cila ne nuk jemi të imunizuar, pavarësisht prapambetjes që ne kemi në tregjet dhe instrumentet financiare. Ekonomia shqiptare dhe në veçanti sistemi financiar shqiptar tashmë janë të hapur dhe të lidhur ngushtë me sistemet financiare të vendeve të rajonit dhe ato evropiane, duke na ekspozuar dukshëm ndaj çdo rreziku rajonal apo botëror. Çka është më e rëndësishmja, nuk duhet të harrojmë se kjo krizë nuk ka mbaruar, por zgjidhja e saj do të zgjasë dhe pasojat kanë për t'u ndier jo vetëm gjatë këtyre muajve, por dhe gjatë vitit apo viteve të ardhshëm. Kjo nxjerr para Qeverisë dhe gjithë institucioneve mbikëqyrëse të tregut nevojën për rritje të vigjilencës dhe ndërmarrjen e hapave që do të nevojiten për të ruajtur paprekshmërinë e Shqipërisë nga kjo krizë që ka prekur jo vetëm vende me ekonomi shumë më të fuqishme se Shqipëria, por, ç'është më e rëndësishme, ka prekur vendet fqinje dhe partnerët tanë kryesore tregtare.

Meriton të theksohet se ky buxhet i vitit 2009 do të krijojë një frymëmarrje financiare të mjaftueshme për institucionet mbikëqyrëse të sistemit financiar të tilla, si: Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Autoriteti i Konkurrencës etj.

Këtë shkrim dhe diskutim modest për projektbuxhetin e vitit 2009 edhe për efekt të kohës kisha menduar ta mbyllja me një deklarim të Kryeministrit Berisha të para dy ditëve, por ai foli shumë mirë vetë në këtë sallë pak më parë, prandaj dua ta mbyll me një tekst që kam nxjerrë nga një tekst makroje: "Qeveria është si një kompjuter i madh, që tërheq nga qytetarët preferencat e tyre dhe e përdor këtë informacion për të ndërmarrë vendime sociale. Shteti nuk ka interesa vetjake, ai është neutral dhe i mirë për të gjithë".

Pra, Qeveria "Berisha", si një kompjuter i madh e i mirë, me një programues të saktë serioz, po tregon që është një Qeveri për të gjithë qytetarët shqiptarë.

Diskutimi u botua në gazetën Rilindja Demokratike, dt. 20.11.2008 dhe në gazetën 55, me titull "Qeveria Berisha – kompjuter i madh me programues të madh e të mirë për të gjithë Shqipërinë"

I.29. Pakti, 7 kompani zotërojnë 86 % të tregut të naftës

Diskutimi në seancë plenare, jashtë rendit të ditës

Tiranë, datë 26 Nëntor 2008,

Pak histori:

Tradicionalisht tregtarët kryesorë të hidrokarbureve në botë kanë qenë shtatë kompani të etiketuara si "shtatë motrat". Gjysmë shekulli më parë, shtatë motrat, Standard Oil i New Jersey-it, Royal Dutch Shell, Texaco dhe kolosë të tjerë të naftës, mbisunduan të gjithë skenën botërore të naftës. Këtu përfshihen edhe tri kompani të prejardhura nga shpërbërja e kompanisë Standard Oil, e cila ka qenë kompani mbizotëruese e prodhimit, transportimit, rafinimit dhe tregtimit të naftës në SHBA. E themeluar që në vitin 1870, ajo ka vepruar si një trust dhe ka qenë një ndër multinacionalet më të mëdha në botë. Ka qenë Gjykata e Lartë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e cila në vitin 1911, afro 1 shekull më parë ndau këtë kompani në 34 pjesë në detyrim të ligjeve antitrust të miratuar për këtë qëllim. Në këto kohë mundësia e përcaktimit të çmimeve mbetej në duart e amerikanëve (fillimisht në duart e kompanisë së naftës dhe më vonë në komisionin e hekurudhave të Texas-it). Është një nga paradokset historike që një komision i hekurudhave arriti të arbitrojë ekuilibrimin e ofertës dhe kërkesës së naftës.

Këto kompani në rrjedhën e mëtejshme të kohës kanë qenë pjesë e grupeve qeveritare apo dhe të bizneseve të fuqishme kanë arritur që të mirë organizohen dhe të futen në marrëveshje me prodhuesit e botës së tretë në formën e një karteli, gjë që u siguronte fitime të mëdha. Kjo ka qenë ajo që ka ndodhur në të kaluarën e afërt (vitet '60).

Më konkretisht "shtatë motrat" kanë qenë:

(Standard Oil of Neë Jersey), e cila u bashkua me kompaninë Mobil pp të formuar grupin Exxon Mobil. Royal Dutch Shell (Dutch /British), Anglo-Persian Oil Company (APOC) (British). Kjo kompani më vonë u shndërrua në Anglo-Iranian Oil Company (AIOC), dhe

më tej në British Petroleum, dhe pas kësaj në BP Amoco, duke u shkrirë në fund me Amoco. Standard Oil Co. of New York ("Socony"). Kjo kompani më vonë u quajt Mobil, dhe nga bashkimi me Exxon formuan Exxon Mobil. Standard Oil of California ("Socal"). Kjo kompani u shndërrua fillimisht në Chevron, më tej nga shkrirja me kompaninë Texaco, krijuan ChevronTexaco.

Gulf Oil. Në vitin 1985 pjesa më e madhe e kësaj kompanie u bë pjesë e Chevron, dhe pjesët e tjera u bënë pjesë e BP dhe Cumberland Farms, e cila kulmoi me shkrirjen më të madhe në histori mes dy kompanive të naftës. Texaco. Në vitin 2001 kjo kompani u shkri me Chevron duke marrë emrin Chevron-Texaco, por në 2005 e ndryshuan emrin përsëri, duke e rivendosur Chevron. Texaco mbeti një emër i markës Chevron.

Roli historik i naftës të SHBA mbaroi në 1971, kur rritja e kërkesës botërore tejkaloi aftësitë prodhuese të SHBA-së. Sot kompanitë private ndërkombëtare përfaqësojnë një hije të së kaluarës së vjetër të tyre.

"Shtatë motrat" shqiptare?

Sipas një vështrimi të kompanive që tregtojnë naftë në Shqipëri, mund të konstatojmë se për koincidencë janë shtatë shoqëri të cilat zënë përkatësisht 84% të tregut në vitin 2005, 86% në vitin 2006 dhe 85.9% të tregut të hidrokarbureve në vitin 2007. Kjo është pamja e tregut sot. Nuk mund të them se është ajo që do donim të ishte. Por duhet të jemi të ndërgjegjshëm se është rrjedhojë e një deformimi disavjeçar 1998-2005, periudhë gjatë të cilës tregu i ishte lënë në dorë 2-3 kompanive.

Por, ndërkohë që tregu ndërkombëtar i mbizotëruar nga "shtatë motrat" përsonluhatjetë theksuartëçmimittënaftëssipasndërveprimit klasik të kërkesës dhe ofertës dhe rregullohet sipas së famshmes "dorë e padukshme" e Smithit, tregu shqiptar i mbizotëruar nga "7 motrat shqiptare" (të cilat të cituara akronomikisht janë: T.K.V.E.M.G.R) nuk arrin t'u bindet këtyre mekanizmave duke abuzuar nëpërmjet veprimit të "dorës së pandershme" të spekulimit, spekulimit tregtar. Ku duket spekulimi?

Mjafton një krahasim për të kuptuar nivelin e spekulimit në tregun shqiptar. Janë dy faktorët që ndikojnë në çmimin e naftës në tregun shqiptar:

1- çmimi i naftës në tregjet ndërkombëtare,

2- kursi i këmbimit të lekut me dollarin.

Bazuar në këto dy faktorë, nëse do të bëjmë krahasimin e çmimit të naftës me vitin 2003, mund të arrijmë në përfundimin se abuzimi është në nivele të larta. Kështu në janar të vitit 2003, çmimi i

naftës bruto në botë ka qenë mesatarisht 32 dollarë për fuçi. Sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë, kursi zyrtar i këmbimit në janar të vitit 2003 ka qenë *1 USD = 133,72 ALL*. Po të bëjmë llogaritë, çmimi i një fuçie nafte të konvertuar në lekë është *32 USD x 133,72 = 4279 ALL* për fuçi. Rritja e çmimit të naftës në tregjet ndërkombëtare u reflektua në mënyrë të drejtpërdrejte dhe menjëhershme në tregun shqiptar. Aktualisht, çmimi i një fuçie në tregjet ndërkombëtare ka shkuar mesatarisht në 52 dollarë për fuçi. Kursi i këmbimit sot lek-dollar është *1 USD = 95,09 lekë*. Si pasojë, çmimi i një fuçie nafte e tregut ndërkombëtar e shprehur në lekë është *52 x 95,09 = 4945 lekë* për fuçi. Sipas llogarive, çmimi i një fuçie nafte në këtë treg, gjatë 5 viteve të fundit është rritur nga 4279 lekë në 4945 lekë, duke shënuar një rritje prej 15,5%. Nëse tregu do të kishte qenë normal dhe konkurrent çmimi i naftës duhet të ishte rritur me 15.5% në tregun shqiptar krahasuar me vitin 2003. Në fillim të vitit 2003 një litër naftë shitej mesatarisht 65 lekë për litër. Një litër naftë sot duhej të shitej mesatarisht 75-90 lekë për litër. Situata në treg është ndryshe: një litër naftë shitet për 130 lekë për litër. Kjo na bën që të dyshojmë (theksoj se, atributin e pohimit e kanë institucionet përkatëse shtetërore) se tregu i naftës në Shqipëri ka trajtën e një karteli, rrjedhojë e një marrëveshje të fshehtë midis firmave oligopoliste që kontrollojnë sot tregun. Jam i detyruar të përsëris përkufizimin e kartelit: një numër i kufizuar firmash që merren vesh midis tyre në mënyrë të fshehtë për të kufizuar produktin, paracaktimin e çmimit për njësi dhe për të maksimizuar fitimin e tregut duke u sjellë si monopolist i vetëm. Në rastin e Shqipërisë këto shtatë firma nëpërmjet çmimit spekulativ maksimizojnë fitimin e tyre në dëm të drejtpërdrejtë të konsumatorit shqiptar, biznesit të lidhur indirekt me to dhe ekonomisë në tërësi (padyshim edhe në dëm të imazhit të kësaj qeverie, e cila ka qenë dhe është politikisht e distancuar nga këto politika tregu).

Për të kuptuar këtë nuk është e nevojshme të hetojmë nëse ka apo jo një marrëveshje të shprehur mes grosistëve, por mjafton një analizë e thjeshtë ekonomike si kjo më sipër, që jam i bindur e ka bërë pjesa më e madhe e qytetarëve shqiptarë. Përveç të tjerash, rënia e çmimeve në tregun ndërkombëtar do të ndizte luftën për përfitim midis grosistëve shqiptarë. Ky përfitim do të reflektohej në zënien e pjesëve të tregut nëpërmjet uljes së çmimeve. Sot asnjë kompani nuk synon pjesë tregu, por thjesht synojnë përfitime nëpërmjet mbajtjes së çmimeve në nivele të larta. Por sot është shumë i dukshëm reagimi në bllok i këtyre kompanive. Kur çmimet rriten të gjithë tregtarët i rrisin menjëherë dhe pak a shumë në të njëjtën masë. Po njësoj, kur

çmimet bien të gjithë reagojnë në bllok, duke mos i ulur ose duke bërë ulje të papërfillshme pothuajse në të njëjtën kohë.

Pra, performanca nga këto kompani në tregun e hidrokarbureve që nënkupton fitimin dhe mirëqenien sociale që rezulton nga aktiviteti në këtë degë të tregtisë rezulton performancë e shëmtuar.

Çfarë duhet bërë?

Duhet të jemi të ndërgjegjshëm që tregu i hidrokarbureve në Shqipëri është krijuar i deformuar dhe është ruajtur i tillë nga qeverisja socialiste në periudhën 1998-2005. Ky deformim i përforcuar pikërisht atëherë kur duheshin hedhur bazat e një tregu konkurrencial, krijoi një strukturë tregu duopolistike e vështirë për t'u shembur. Këtu janë për t'u përshëndetur dhe lavdëruar përpjekjet e qeverisë gjatë vitit 2005 e në vazhdim, dhe veçanërisht Ministrisë së Ekonomisë, në drejtim të liberalizimit të licencave të tregtimit, privatizimit me sukses të ARMO-s, eliminimin e barrierave burokratike, afrimin e investitorëve të huaj në këtë sektor, përmirësimin e kuadrit ligjor etj. Por përsëri mos ndryshimi i kësaj situate duhet të na bëjë të pakënaqur e kërkues për më tej. Nisur nga situata shqetësuese e tanishme me këto deformime flagrante, të cilat në finale dëmtojnë konsumatorin shqiptar dhe ekonominë, mendoj se duhet të ndërhyjmë në tre drejtime:

E para, është detyrë e organeve tatimore dhe doganore pranë Ministrisë së Financave që këtë çështje mos ta shohin ngushtësisht në faktin e plotësimit apo realizimit të planit të tyre të të ardhurave, por ta shohin më gjerë në impaktin që kanë këto çmime në ekonominë shqiptare. Këtu nuk do justifikoja asnjë mbrojtje apo justifikim që përfaqësues të lartë të organeve doganore, të cilët në ndonjë rast kanë bërë avokatin e grosistëve të naftës. Administrata fiskale dhe doganore duhet të ndjehet pjesë e një ekipi të gjerë qeverisës, që ka si qëllim jo thjesht e vetëm mbledhjen e të ardhurave me çdo çmim, por të ushtrojnë politika për zhvillimin perspektiv të ekonomisë që gjeneron konkurrencë të ndershme në luftë me çdo operator që tenton deformimin e tij.

E dyta, duke vlerësuar punën e mirë të Ministrisë së Ekonomisë dhe qeverisë në përgatitjen e ligjit nr. 9902, datë 17/04/08 "Për mbrojtjen e konsumatorëve" në përmbushjen e qëllimeve të këtij ligji që është mbrojtje e interesave të konsumatorëve në treg, si dhe përcaktimi i rregullave dhe ngritja e institucioneve përkatëse për të mbrojtur të drejtat e konsumatorëve do të kërkoja ekzigjencë të lartë, rrjedhojë e detyrimeve të nenit 50 të ligjit në fjalë, nga institucioneve të tilla si Këshilli Bashkërendues apo Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve (agjenci këto nën kontrollin qeveritar) që në

bashkëpunim me shoqatat vullnetare të konsumatorëve e cilindo konsumator qytetar shqiptar të marrin masa bashkërenduese për mbrojtjen e konsumatorëve, apo për hartimin e kodeve të sjelljes ose kontratave standarde në bashkëpunimin me operatorët ekonomikë (detyrim ky i shprehur qartë dhe në neni 45). Operatorët shqiptarë kanë nevojë të disiplinohen, të përmirësojnë rrënjësisht KODIN E SJELLJES me konsumatorët, i cili në thelb nuk është gjë tjetër veçse (citoj përkufizimin e dhënë në nenin 3) "një marrëveshje ose paketë rregullash të sanksionuara në ligje, rregullore apo dispozita administrative që marrin përsipër t'i binden kodit për një ose më shumë praktika të veçanta tregtare ose sektorë biznesi".

Së treti, deputetët e Kuvendit të Shqipërisë, si përfaqësues më të lartë të interesave të publikut, duke vlerësuar pozitivisht punën e deritanishme profesionale, ekipin drejtues të komisionerëve të Autoritetit të Konkurrencës, edhe në hetime të mëparshme në raste të ngjashme duhet t'iu japim mbështetjen tonë të plotë parlamentare në përfundimin në kohën e përshtatshme të hetimit, që prej muajsh me të drejtë ky institucion ka hapur për tregun e hidrokarbureve në Shqipëri, për ato firma që qytetarët shqiptarë dyshojnë se operojnë në bazë të marrëveshjeve të fshehta në dëm të konsumatorëve, të biznesit, të kësaj qeverie dhe të krejt ekonomisë. Personalisht kam besimin se Autoriteti do të zbatojë me korrektesë e profesionalizmin që ka treguar këto dy vitet e fundit, kërkesat e ligjit nr. 9121, datë 28/07/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", si një ligj antitrust me tri shtylla kryesore: papajtueshmëri me abuzimin me pozitën dominuese; moslejimin e krijimit të karteleve; dhe kontrollin e përqendrimeve.

A duhet apo a ka të drejtë Qeveria të mbrojë të drejtat e konsumatorëve në tregun e hidrokarbureve. Fareed Zaharia në veprën e tij "E ardhmja e Lirisë" pohon: "Në fund të fundit, pa një qeveri të zonjë për të mbrojtur të drejtat mbi pronën dhe të drejtat e njeriut, lirinë e shtypit dhe kontratat e biznesit, ligjet antitrust dhe kërkesat e konsumatorit, shoqëria nuk do të ketë sundim të ligjit, por ligjin e më të fortit". E ne duam një shoqëri që të sundojë ligji edhe në mbrojtjen, prosperitetin e konsumatorit-qytetarëve shqiptarë, një shoqëri që zhvillon karakteristikat më të mira të demokracisë liberale.

Diskutimi (me disa materiale shtesë) u botua në gazetën Panorama, datë. 28.11.2008

I.30. Nevoja për mesazhe të qarta të Bankës së Shqipërisë

Diskutimi në seancë plenare mbi projektligjin "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9630, datë 30.10.2006 "Për faktoringun"

Tiranë, datë 11.12 .2008

Plotësimi me ekzigjencë të lartë i objektivit kryesor të Bankës së Shqipërisë në ligjin "Për Bankën e Shqipërisë", në: "…arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve", si dhe objektivat e tjerë shoqërues të Bankës së Shqipërisë, si p.sh: "nxit dhe mbështet tregun e brendshëm financiar, si dhe ndihmon në përmirësimin e kushteve monetare e kredituese, në mbështetje të stabilitetit dhe të zhvillimeve ekonomike të vendit" apo të tjera, që nuk po i përmend, të shoqëruara me kërkesat e ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", kërkon e përcakton edhe zgjerimin e thellimin e mbikëqyrjes së veprimtarisë bankare, si atribut i ushtruar nga Banka e Shqipërisë.

Pikërisht, ndryshimi i paraqitur në projektligjin "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9630, datë 30.10.2006 "Për faktoringun"" e shtrin mbikëqyrjen e veprimtarisë financiare të faktoringut jo vetëm mbi bankat, si deri më sot, por edhe mbi shoqëritë tregtare, që funksionojnë si institucione financiare jo bankare. Ky fokusim i veprimtarisë financiare të faktoringut, nën kontrollin e Bankës së Shqipërisë, edhe kur zhvillohet nga shoqëri tregtare jo bankare, jo vetëm shmang çdo tentativë apo mundësi të këtyre shoqërive për qëllime të paligjshme, por, çka është më e rëndësishme, është edhe një faktor plus për stabilitetin financiar, i cili, ligjërisht, garantohet dhe, me të drejtë, i kërkohet institucionit kryesor monetar në vend, Bankës së Shqipërisë.

Ndryshimi i sotëm, parë në kuptimin e ngushtë, i kontribuon zgjerimit të sferës së mbikëqyrjes, duke përfshirë dhe institucione jo bankare, të cilat realizojnë ndërmjetësim financiar. Por, në një këndvështrim më të gjerë, është edhe një dëshmi e forcimit të

pavarësisë ligjore dhe reale të Bankës Qendrore, për të cilën (pra, për pavarësinë e bankës), me të drejtë sot theksohet se, krahas me transparencën dhe, çka është më e rëndësishme, besueshmërinë e saj, është i rëndësie themelore si për hartimin dhe zbatimin e politikës monetare, ashtu edhe për stabilizimin e sistemit financiar.

Ndërkohë, duke përfituar nga ky ndryshim të dobishëm që po konfirmojmë sot në ligjin "Për faktoringun", i cili, si pjesë e një kornize të plotë ligjore, së bashku me ligjin ekzistues " Për Bankën e Shqipërisë", atë "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" e ndonjë tjetër, garanton ligjërisht një pavarësi relativisht të lartë në hartimin dhe zbatimin e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë, do të përpiqem, shkurtimisht, të theksoj disa hapësira ose segmente për përmirësime të mëtejshme në drejtim të thellimit të pavarësisë, asaj reale, deklarimit apo tejçimit të saj të plotë te publiku, veçanërisht tek agjentët që veprojnë në tregun e madh monetar shqiptar, në përpjekje për një përshtatje sa më të plotë me praktikat dhe rregullimet ligjore të Bankës Qendrore Evropiane dhe të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore.

Sot mund të pohojmë se politika monetare ka arritur objektivin e saj, por duhet të vazhdojë ende në një zhvillim e përmirësim të mëtejshëm, për t'u konturuar qartë dhe të plotësohet si një politikë monetare moderne, veçanërisht e rëndësishme në një situatë të tillë financiare globale.

Me të drejtë, sot, nga politik-bërësit dhe drejtuesit e politikës monetare pohohet fakti i pranuar edhe nga ligjvënësit dhe drejtuesit e ekzekutivit dhe politikës në tërësi, se: "Në një shoqëri demokratike, shkalla e lartë e transparencës dhe e përgjegjshmërisë në realizimin e politikës monetare forcon ligjshmërinë e Bankës Qendrore dhe konsolidon mbështetjen publike për mandatin e stabilitetit të çmimeve."

Kërkesat e anëtarësimit në BE kërkojnë që Qeveria dhe Kuvendi, jo vetëm direkt por edhe indirekt të mos ndërhyjnë në pavarësinë politike dhe financiare të Bankës Qendrore të vendit. Hapësirat, segmentet, që kërkojë përmirësim në plotësime apo rregullime të ligjit ekzistues të Bankës së Shqipërisë apo, çka është më tepër e detyrueshme, zbatimin e atyre detyrave, ndaj të cilave janë obliguar prej vitesh, ligjërisht, konstatojnë në:

Së pari: përjashtimin e mundësisë së financimit direkt të deficitit buxhetor. Roli i agjentit fiskal të Bankës së Shqipërisë për Qeverinë nuk është saktësisht i përcaktuar dhe marrëdhëniet midis tyre duhet të inkurajohen, që të vazhdojnë të ndërtohen mbi bazën e një banke qendrore të pavarur (ndërhyrja me kredi nga Banka Qendrore

duhet të bëhet e fundit në radhë dhe vetëm atëherë kur aktorët e tjerë të tregut e kanë të pamundur).Kodi i praktikave më të mira të FMN sugjeron që të bëhen publike detajet e plota në marrëdhëniet që banka qendrore ka me buxhetin, si në kredi-marrje ashtu dhe në bono thesari, depozitimet që qeveria bën në bankën qendrore. Banka e Shqipërisë, si bankë e bankave dhe njëkohësisht agjenti fiskal i qeverisë, duhet të kërkoj hapësirat për një ekuilibër më të mirë midis këtyre dy funksioneve të rëndësishme. Nëse do të vlerësoja të arritur funksionin si bankë e bankave, për shkak të kontributit të saj në ruajtjen e shëndetit të sistemit bankar shqiptar gjatë krizës së fundit që po kalon pjesa më e madhe e vendeve perëndimore, do të vlerësoja jo efiçente rolin e saj si agjenti i qeverise dhe konkretisht organizatore e ankandeve të bonove të thesarit. Është jonormale që norma e interesit e bonove të thesarit të jenë të larta, madje më të larta se sa normat e interesit të depozitave bankare të të njëjtit afat. Madje nuk e vlerësoj pozitiv faktin që në një situatë të rënies globale të normave të interesit tendenca e tregut shqiptar është në drejtim të kundërt, pra rritje (norma e interesit për bonot njëvjeçare shkoi në 8.46% në 2 dhjetor nga 8.24% që ishte dy javë më parë, në 18 nëntor). I del detyrë Bankës së Shqipërisë që, si organizatore ekskluzive e këtij tregun të liberalizojë këtë treg, një proces ky që jo vetëm do të ulë koston e borxhit për qeverinë por do të transferoj fitimet që vijnë nga bonot e thesarit drejt qytetarëve, theksoj qytetarëve interesat e të cilët deri më tani janë të harruara.

Së dyti: me zgjidhjen përfundimisht të çështjeve të mbetura pezull të buxhetit të Bankës së Shqipërisë. Nga drejtuesit e bankës duhet të kuptohet se tashmë dihet nga një pjesë e mirë e publikut që të ardhurat, për rrjedhojë, fitimi i Bankës Qendrore, është, në një pjesë të qenësishme, rrjedhojë e të drejtës monopol që ka banka për hedhjen e parasë në qarkullim dhe administrimin e rezervës valutore. Është kërkesë edhe nga ekspertët ndërkombëtarë, që publiku të njihet me buxhetin e Bankës së Shqipërisë, ende ky nuk publikohet, një institucion ky që tek e fundit mbetet publik, pavarësisht pavarësisë së pamohueshme të tij.

Së treti: Rritjen e profilit profesional e publik të Këshillit të Mbikëqyrjes si organizmi përgjegjës për hartimin e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë. Pavarësisht se kapacitetet drejtuese dhe analizuese të drejtuesve, veçanërisht specialistëve të Bankës janë të niveleve të larta profesionale, ende mbetet për t'u bërë. Kjo kërkesë nuk është kritikë për ndokënd, por theksohet në kuadër të nevojave në rritje të kësaj fushe që kushtëzohen nga zhvillimi dhe lidhja gjithnjë e më e fortë e sistemit financiar shqiptar

me tregjet ndërkombëtare. Këta faktorë, segmente, më mirë dhe më qartë mund të shpjegohen në salla të tjera, jashtë kësaj salle të nderuar të Kuvendit, edhe nga specialistë, ekspertë të profilit të lartë të politikave dhe teorive monetare, të cilët, edhe pse të paktë, janë aktivë, të tillë, si: profesorë të nderuar të ekonomisë monetare e të makroekonomisë, dekanë e ish-dekanë të Fakultetit të Ekonomisë Tiranë, ish-guvernatorë e ish-anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, pavarësisht bindjeve të tyre politike, profesorë të ndryshëm dhe drejtuesit aktualë të Bankës Qendrore e të financave publike në vend apo gazetarë të mirë formuar të profilit bankar në fushën e ekonomisë, të cilëve, përfitoj nga kjo tribunë t'u shpreh respektin tim.

Unë, në fakt, dua të theksoj si një faktor tjetër shumë të rëndësishëm, atë të transparencës, llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë reale të Bankës së Shqipërisë, e veçmas, përpjekjet e bankës për edukimin monetar të publikut. Për më tepër, siç vërehet nga studiuesit: "Transparenca imponon disiplinë te politik-bërësit dhe është një mënyrë për të siguruar të kuptuarit në masë të strategjisë së politikës monetare." Kjo mund të rrisë kredibilitetin, dhe si rrjedhojë efektivitetin e politikës monetare, duke lehtësuar kështu përpjekjet e Bankës Qendrore për të arritur objektivin e përcaktuar në ligj".

Hartimi dhe zbatimi i politikës monetare duhet të jetë një proces transparent për publikun, pasi kështu mund të shmanget problemi i inkonsistencës kohore të saj. Transparenca e politikës monetare nënkupton ekzistencën e një regjimi të qartë funksional të politikës monetare, përshtatjen e ankorave nominale të besueshme dhe miratimin e zbatimit transparent të politikës monetare duke zbatuar një regjim të kësaj transparence deri në detajet më të vogla si Objektivat dhe instrumentet e tij, procedurat vendim-marrëse, analizat makroekonomike, modelet analitike, supozimet e përdorura dhe bazën e të dhënave. Çdo parashikim i Bankës Qendrore duhet të jetë i replikueshëm nga kushdo që ka dëshirën të kuptojë dhe pse jo të kontribuojë në arritjen e objektivave të politikave të saj monetare, duke mos ndërhyrë në pavarësinë e institucionit. Ekonomistët pranojnë se transparenca është e rëndësishme për politika monetare në dy drejtime kryesore: rritjen e përgjegjshmërisë dhe rritjen e efektivitetit të politikës monetare. Meqenëse raportet dhe paraqitjet në publik të drejtuesve të Bankës së Shqipërisë formalisht janë të rregullta duke evidentuar një transparencë të kënaqshme në formulimin dhe raportimin e vendimeve të politikës monetare fakti evident i një rutine në mesazh dhe i një strategjie të dobët

në komunikimin me publikun më ngacmon t'u kujtoj drejtuesve të Bankës një përkufizim bashkëkohor në përcaktimin e transparencës nga vepra e Winklerit: "Shkalla e të kuptuarit të procesit të politikës monetare dhe vendimeve të saj nga publiku". Sipas tij, vetëm dhënia e informacionit, nuk është transparencë. Winkler plotëson përfundimisht konceptin e dhënë nga të tjerë para tij, që e përkufizon transparencën e Bankës Qendrore si shkallë të dhënies së informacionit mbi procesin e politikës monetare. Publiku duhet të zotërojë të njëjtin informacion që përdor edhe Banka Qendrore për realizimin e politikës monetare. Sipas këtij përcaktimi, sa më shumë informacion të japë një bankë, aq më transparente është ajo. Duke pohuar se vetëm dhënia e informacionit nuk është transparencë, Winkler thekson se ajo arrihet vetëm atëherë kur publiku e kupton informacionin e dhënë nga Banka Qëndrore. Në këtë aspekt, futet nga Winkleri dhe veprimtaria e Bankës Qendrore, për të nxitur edukimin e publikut.

Pikërisht këtu dua të ndalem. Realiteti ynë nuk flet pozitivisht në këtë drejtim. Në rast se, mbështetur në sa më sipër, dallojmë qartë tri aspekte të transparencës: së pari, vërtetësinë e informacionit të dhënë; së dyti, qartësinë e tij dhe, së treti, të kuptuarit e njëjtë të informacionit nga publiku dhe Banka Qendrore, ne mund ta vlerësojmë realitetin, pra, transparencën e Bankës sonë Qendrore si të tillë: jemi shumë mirë, sipas aspektit të parë; mirë, sipas aspektit të dytë; dhe dobët, për të mos thënë shumë dobët, në këndvështrimin e tretë, pra, atë të të kuptuarit të njëjtë të informacionit nga publiku dhe Banka Qendrore. Të kuptuarit e njëjtë të informacionit presupozon që informacioni i dhënë nga banka, në mënyrë që të jetë efektiv, duhet të kuptohet dhe interpretohet nga publiku ashtu siç kuptohet dhe interpretohet nga vetë Banka Qendrore, apo bankat e nivelit të dytë. Kjo kërkon që banka nëpërmjet veprimtarisë së saj të nxisë edukimin e publikut në këtë fushë.

Publiku duhet të dijë jo vetëm se cilat janë objektivat e Bankës Qendrore, strategjia e politikës monetare, për të arritur këto objektiva, por, mbi të gjitha, si dhe pse merren vendimet mbi veprimet e bankës dhe cili është impakti i tyre mbi të gjithë agjentët e tregut.

Duke qenë se përqindja më e madhe e publikimeve dhe njoftimeve për shtyp apo prezantimeve në media në vendin tonë janë vizita apo takime rutinë të guvernatorit, që nuk përcjellin mesazhe me interes për agjentët e tregut dhe publikun, tashmë ka ardhur koha që strategjia e komunikimit me publikun në Bankën e Shqipërisë të ndryshojë kurs dhe, për rrjedhojë, të thellohet transparenca në

kuptimin e plotë të saj, siç përmenda më sipër. Komunikimi me publikun, vetëm i Guvernatorit edhe për më tepër edhe kur nuk ka mesazh të plotë, të vlefshëm e shpjegues përmes debatesh duke i bërë administratorët dhe drejtuesit e tjerë të bankës inekzistent për publikun është praktikë jo e mirë dhe jo e dobishme.

Takimet me grupet e interesit, agjentët e tregut, apo debatet profesionale me akademikë dhe studentë janë në minimumin e vet. Këto i ka parashikuar banka edhe në një marrëveshje të vitit 2005 ose 2006, në mos gaboj, me Ministrinë e Arsimit, e cila, në nenet 4, 7 dhe 8, lë shumë për të dëshiruar. Ato nuk duhet të jenë të vetmuara dhe vetëm të karakterit informues, pa iu nënshtruar diskutimeve, debateve, analizave e sqarimeve të vlefshme për të dy palët: drejtuesit e bankës dhe publikun.

Si përfundim, duke shprehur respektin tim për Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë dhe drejtuesit e saj, më duhet të theksoj se, për mendimin tim, ai nuk duhet të bëjë vetëm monolog apo monologë, në shumës siç mund të thoshte Molieri në kohën e tij, por Guvernatori dhe drejtuesit e Bankës së Shqipërisë të zhvillojnë debate, të zhvillojnë një dialog të gjerë me publikun, të zhvillojnë dialogë me përfaqësues të studentëve, të mendimit ekonomik dhe monetar, që është i dukshëm në vendin tonë.

Përpos të tjerash, duke ju falënderuar për vëmendjen, përfitoj nga ky rast të theksoj se publiku ka perceptuar si mangësi në transparencën e tregut bankar edhe një mori marrëdhëniesh klient-banka tregtare. Banka e Shqipërisë duhet të riformatojë marrëdhëniet e saj me bankat, jo vetëm në imponimin e tyre për më tepër transparencë me klientët dhe biznesin, por edhe të marrë rolin pohues në favor të kreditimit të biznesit, kreditimit lehtësues e transparent, duke inkurajuar ekonominë e firmave apo individëve të ndryshëm drejt investimit, për shëndoshjen e ekonomisë, për më tepër, në këto ditë të vështira që po kalojnë ekonomia globale dhe institucionet financiare bankare dhe jo bankare.

Jo më larg se dje, Guvernatorit dhe drejtuesit të bankës iu dha një shembull pozitiv, kur dy anëtarë nga më të rëndësishmit e këtij kabineti, me format të lartë profesional, ministri i Financave, Bode, dhe ministri i Ekonomisë, Ruli, debatuan dhe sqaruan përfaqësuesit e Dhomës së Tregtisë së Tiranës, një organizatë nga më përfaqësueset dhe më dinjitozet në vend.

Diskutimi (me disa materiale shtesë) u botua në gazetën Shqip dt. 08.12.2008, dhe gazetën Ekonomia, dt. 12.12.2008

I.31. Forcimi i shtetit demokratik përmes lustracionit

Ky ligj është gracka që politikën e re të PS-së do ta zërë brenda si laraska.

Diskutimi në seancë plenare mbi projektligjin: "Për pastërtinë e figurave të zyrtarëve të lartë të administratës dhe të të zgjedhurve"

Tiranë, datë 15.12.2008

Pati dy pasaktësi në fjalën e saj, kryetarja e grupit parlamentar të PS, zonja Leskaj:

Së pari, "harroi" pikën 11 të rezolutës së 30 tetorit të vitit 2006 të këtij parlamenti për dënimin e krimeve të kryera nga regjimi komunist në Shqipëri, e cila shprehimisht citon: "Kuvendi i Shqipërisë kërkon hapjen e dosjeve të ish-bashkëpunëtorëve të sigurimit të shtetit për politikanët, drejtuesit e institucioneve kushtetuese, atyre të sistemit të drejtësisë, të administratës publike qendrore e vendore, si dhe të mediave kombëtare audiovizive dhe të shkruara." Këtë e kemi votuar të gjithë ne tetor të vitit 2006. Nga ana tjetër një pasaktësi tjetër e kryetares së grupit parlamentar socialist është spekulimi me rezolutat e vitit 1996 dhe 2006 të Asamblesë Parlamentare të Evropës, po citoj këtu rezolutën nr 1096 e vitit 1996, e cila në fakt është rezoluta që merret mbi masat për të çrrënjosur trashëgiminë e sistemeve ish-komuniste totalitare dhe ka qëllim kryesor ndëshkimin në nivel kombëtar të krimeve të kryera gjatë regjimeve totalitare komuniste, në lidhje me dhunimin e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut. Sipas pikës 7, të rezolutës në fjalë, Asambleja rekomandon procedim penal të akteve kriminale të realizuara nga individë të veçantë gjatë regjimeve komuniste totalitare dhe ndëshkimin e tyre, sipas Kodit penal në fuqi të shtetit përkatës. Procedimin dhe ndëshkimin e ndonjë personi, për ndonjë veprim ose mosveprim që megjithëse, theksoj, në kohën e kryerjes

nuk ka përbërë ndonjë vepër penale sipas ligjit kombëtar, në fakt ka qenë konsideruar e penalizueshme sipas parimeve të përgjithshme ligjore të miratuara nga kombet e qytetëruara. Këtu pa dyshim rezoluta e Asamblesë Parlamentare bën fjalë për deklaratat dhe rezolutat e ndryshme ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Megjithatë, përpara se të kaloj te diskutimi im, që për hir të së vërtetës e kam pak të gjatë, por natyrisht që do ta shkurtoj, duke respektuar kohën, sepse përpara se të filloj fjalën mu kujtua që këtu e 400 vjet më parë në vitin 1600 në mos gaboj, dramaturgu i madh Shekspir në tragjedinë "Hamleti" vë te goja e heroit kryesor të veprës, pasi një tentativë për të provokuar mbretin për të pranuar krimin e kryer, (Hamelti kërkon të realizojë këtë pohim përmes një dramë ose shfaqje), vë fjalët: "shfaqja është gracka ku shpirti i mbretit do të ngecet si laraska." Dhe unë duke perifrazuar Shekspirin e madh, po them që ky ligj për pastërtinë e figurave është gracka që politikën e re të PS-së do ta zërë brenda si laraska. Kjo nuk ka nevojë për komente të tjera, se u provua nga diskutimi i kryetares së grupit, u provua nga qëndrimi që po mbajnë deputetët e këtij grupi në fjalë duke u larguar nga salla, u provua nga ajo tentativë që kanë këta, Partia Socialiste, për ta kaluar këtë ligj në kalendat greke. Në funksion të kësaj do të më lejoni të nderuar deputetë, që të bëj një rezyme të shkurtër të historikut të kësaj çështjeje, duke qenë të vetëdijshëm të gjithë ne, se hapja e dosjeve në fakt vetëm lustracioni për zyrtarët e politikanët e lartë të zgjedhur e të emëruar, është kushti i nevojshëm, por jo i mjaftueshëm për dekomunistizimin e shoqërisë shqiptare, i cili edhe sot 18 vjet pas diktaturës rezulton jo i plotë. Ky proces 18 vjeçar mund të ndahet në tri periudha: vitet '92-'96, vitet '97-2001 dhe nga viti 2001 e deri më sot. Kjo e fundit, ka edhe një nënndarje nga viti 2005 e deri më sot. Në periudhën e parë '92-96 kur ky proces po shkonte në hullinë e duhur, në rrugën e duhur, falë vullnetit të PD-së dhe presidentit të asaj kohë, Sali Berisha, përmes ligjit nr. 8043, datë 30.11.1995 Parlamenti shqiptar, politika shqiptare filloi punën, që ishte nisur me akte normative nga Qeveria "Meksi", e pastrimit të shoqërisë, të administratës e të politikës shqiptare. Kjo falë edhe punës serioze të Komisionit të verifikimit të figurave, i drejtuar me kompetencë, me dashuri dhe me qetësi nga i ndjeri Hajri Mezini. Kjo punë për hir të së vërtetës u ndërpre në mënyrë zyrtare në vitin 1997 dhe vetë kryetari i komisionit të mëparshëm, i zgjedhur në gusht 1997 nga socialistët, avokat Nafiz Bezhani, pohon në kujtimet e tij "Mëkatarët" se "kryetari i komisionit zoti Mezini është nxjerrë përdhunshëm nga zyrat e Ministrisë së Brendshme dhe dosjet, arkivat për një kohë të gjatë ngelën në

mëshirë të fatit". (Kureshtarët të lexojnë "Mëkatarët" e Nafiz Bezhanit, faqja 8 dhe 9). Në periudhën e dytë, gusht '97 dhe deri në vitin 2001 kur ky proces u deformua për mendimin tim jo për fajin dhe përgjegjësinë e avokatit Bezhani por për atë reduktim dhe deformim të ligjit për arsye politike nga socialistët nëpërmjet amendamenteve të janarit '98, që ligji në fjalë pësoi. Pra ligji u reduktua djallëzisht, duke e kaluar, mbartur në thelb problemin e krimit shtetëror të diktaturës komuniste dhe të drejtuesve të lartë të sigurimit të shtetit, përmes vetëm dosjeve të bashkëpunëtorëve, duke arritur kryesisht, që nomenklatura e lartë kriminale e Partisë së Punës dhe sigurimi të ishin prezent në demokraci, këtë herë të frikshëm përmes mjegullës së fshehtësive dhe pisllëqeve. Çka është thelbësore, ta transformonte krimin drejt bashkëpunëtorëve të cilët, gjithsesi për mendimin tim, fatkeq ose jo të detyruar në shtrëngesa, terror psikologjik, asnjëherë nuk janë pa faj, më saktë, pa një pjesë fundore të tillë. Nisur nga vetë deklaratat, pohimet e zotit Bezhani, kushtet jo të plota të punës, ky proces "përfundoi" me verifikimin e dokumentacioni përkatës të 6 mijë zyrtarëve, nga të cilët figura të penalizueshme sipas ligjit tashmë të deformuar nga socialistët rezultuan 104 vetë. Ç'ironi, ç'maskarallëk, do të thoshte ndonjë tjetër. Një ligj i deformuar në vitin 1998, automatikisht pastroi qindra mëkatarë drejtues së lartë të strukturave të hartimit e të zbatimit të dhunës komuniste të sigurimit të shtetit etj. Periudha e tretë, 2001 e deri më sot, që ndahet 2001-2005 dhe 2005 e deri në momentin që po flasim, për mendim tim flasin për paaftësi, miopi ose dashakeqësi e mirëkuptim të politikës, që bëri që ky problem të harrohet dhe u la heshtje, të ndërgjegjshëm të gjithë autorëve dhe aktorët e politikës qendrore ose periferike në parti politike ose OJQ, zyrtarë e gazetarë, që kjo heshtje, harresë vetëm shëndoshjes së demokracisë, konsolidimit të saj përmes institucioneve dhe individëve të pastër nuk u shërben përkundrazi e dëmton rëndë atë. Pikërisht këtu është i rëndësishëm ai mirëkuptim, kjo pritje e dobishme për të pasur rezultate ky ligj, që këto tre vjet PD-ja bëri në pritje të konsensusit të PS, pavarësisht që kishte kartonët e duhur, duke depozituar ligjin dhe duke kërkuar një marrëveshje xhentëlmenësh me drejtuesit e lartë të PS-së, me qëllimin e vetëm që përmes këtij ligji të prodhojmë një politikë të fortë kombëtare. Ne të gjithë duhet të jemi të ndërgjegjshëm që pa politikë të fortë kombëtare, asnjëherë nuk do të ndërtojmë institucione të konsoliduara demokratike në legjislativ, ekzekutiv e gjyqësor. Pikërisht ky problem tani realizohet përmes këtij ligji i cili nga pengesat e drejtuesve të lartë socialistë është vonuar mbi dy vjet ose tri vjet në Parlament. Tashmë qëllimi i ligjit

që reflektohet edhe në nenin 1, i cili është të kontrollojë pastërtinë e figurës të çdo funksionari politik, të zgjedhur ose të emëruar, lidhur me pjesëmarrjen e tyre në strukturat politik-bërëse dhe zbatuese të dhunës së diktaturës së proletariatit, si dhe në strukturat e ish-sigurimit të shtetit për periudhën 29 nëntor '44 deri në 8 dhjetor të vitit 1990, tashmë do të realizohet. Ne të gjithë jemi të vetëdijshëm që dekomunistizimi si proces politik shoqëror përfshin para së gjithash vënien para përgjegjësive për krimet e kryera në të shkuarën, abuzimin me pushtetin, si dhe pasojat e padrejtësitë që janë bërë direkt ose indirekt edhe nëpërmjet mënjanimit, largimit nga pozitat drejtuese të titullarëve të ndryshëm të lidhur me krimin, ose me sigurimin para vitit 1990 në politikë, administratë, prokurori, gjyqësor e kudo që janë. Shumë bukur e konçize e theksoi lideri i maxhorancës Berisha pak minuta më parë, se: "Lustracioni nuk synon hakmarrje, por ndarje nga sistemi komunist". Për ne sot garanci është që tashmë ky proces kërkohet edhe për integrimin evropian ku ne të gjithë kërkojmë të aspirojmë të cilin do ta realizojmë edhe përmes këtij katarsisi. Asnjë nuk mund ta quajë tani kërkesë atavike, ose kërkesë folklorike të politikës së djathtë, për sa kohë që ky ligj, ky produkt i nxjerrë nga mendimi politik i drejtuesve të lartë të PD-së shkon në sinkron me rezolutën e vitit 1996 dhe me rezolutën nr1481 të vitit 2006 për domosdoshmërinë për dënimin ndërkombëtar të krimeve të regjimeve totalitare komuniste. Ishte pikërisht pika 11 e rezolutës së Kuvendit që kërkon në tetor të vitit 2006, ku as kishte e as mendohej Gërdec, nuk kishte short as me gogla, as pa gogla në Gjykatën e Lartë, ku me të drejtë theksohej edhe kërkohej kjo gjë, ky pastrim politik, administrativ e gjyqësor, nga PD-ja përmes paraqitjes dhe aprovimit në këtë Kuvend të rezolutës në fjalë. Mua më vjen keq për një pjesë të deputetëve të rinj të PS-së që nuk i lidh asgjë me të shkuarën, me sigurimin e shtetit, që po detyrohen edhe këta deputetë sot të lënë sallën bosh, që të kalojnë në llogore të vjetra të politikës. Këta mbrojtës po e shfrytëzojnë këtë situatë sot dhe me sofizmat e tyre për ta kaluar këtë ligj për në kalendat greke. Ne duhet të jemi të gjithë të ndërgjegjshëm që lustracioni i zyrtarëve të zgjedhur dhe të emëruar, largimi i ideatorëve, i ekzekutorëve në radhë të parë, por edhe i bashkëpunëtorëve të sigurimit nga institucionet publike, përfshi rendin dhe ushtrinë i forcon këto struktura i fut natyrshëm në NATO ose në institucione të tjera. Për një sy të vëmendshëm, për një sy që di të lexojë e të kuptojë, të shikojë zhvillimet e këtij shteti, mund ta ketë të lehtë të dallojë që edhe te Gërdeci dhe te ish-drejtuesit e lartë të MEICO-s, ose të Shtabit të Përgjithshëm kishte ose edhe mund të ketë ish-

bashkëpunëtorë të sigurimit të shtetit, që përveçse e kanë penguar nuk kanë bërë gjë tjetër, këtë afirmim që kërkojmë ne, pavarësisht se këtë e arriti e realizoi, doni ose nuk doni ju, të nderuar socialistë, politika e djathtë e PD-së, politika e anëtarësimit në NATO. Në këtë kontekst dua të theksoj atë që qytetarët shqiptarë të jenë të ndërgjegjshëm se ky ligj do të rregullojë moralin e institucioneve të ushtrisë, policisë dhe gjyqësorit. Me këtë ligj që ne po kalojmë sot, ne dëshmojmë si maxhorancë e djathtë përpara qytetarëve shqiptarë se dënimin e të shkuarës së komunizmit nuk e kemi pasur dhe nuk e kemi as për sy e faqe, por e kemi dëshmi dhe dëshirë të fortë për institucione të forta për politikë evropiane, për demokraci liberale. Ky ligj vjen sot si dëshmi e seriozitetit të politikës shqiptare. Në mënyrë simbolike, unë kisha një kërkesë që te nenet 6, 7 dhe 8 ku flitet për përbërjen e autoritetit të verifikimit në mënyrë simbolike anëtarë të këtyre komisioneve, pse jo edhe drejtues të tyre, të jenë njerëz që kanë vuajtur burgun politik. Personalisht do të mbështesja çdo veprim të kësaj maxhorance, që nga drejtuesit e kryengritjes së Spaçit, (e cila është krenari kombëtare) e 21 majit dhe 23 majit të vitit 1973 të zgjidhen këta anëtarë, pse jo edhe drejtuesi i tyre. Si përfundim, për të mos u zgjatur, këtu kisha ndër mend të flisja edhe për 21 majin- Ditën e kujtesës historike dhe për ato që kryeministri Berisha ka premtuar në Konventën e Shoqatës Mbarëkombëtare të ish të përndjekurve politikë në qershor 2006, planet që ne nisëm për memorialin në qendër të Tiranës dhe muzeun historik të kujtesës së krimeve të komunizmit në Shkodër apo vendosjen e përmendores së Azem Hajdarit, Arben Brocit dhe heronjve të tjerë. Këto të përfundojnë brenda këtij mandati, si dëshmi e konsekuencës sonë politike. Në mbyllje, në mënyrë simbolike do të thosha një citim të njërit prej heronjve të mendimit politik antikomunist përpara togës së pushkatimit, i cili deklaronte: "Rrnoftë Shqipnia edhe pa ne". E citoj në gegnisht (gegërisht), sepse ai ishte nga Veriu, megjithëse nacionalistë dhe antikomunistë të spikatur dhe të shumtë ka pasur edhe nga Jugu. Do t'u sugjeroja këtyre ish-sigurimsave që kanë lyer duart me gjak, atyre njerëzve që direkt apo indirekt, për hir të veprimtarisë së tyre, janë përzier dhe pozicioni i tyre është në papajtueshmëri me këtë ligj, detyrimisht ata të largohen nga administrata, nga politika, nga të gjitha. Atyre u përshtatet shprehja, le ta deklamojnë për vetveten: "Rroftë administrata. Rroftë politika shqiptare. Rroftë gjyqësori. Rroftë prokuroria edhe pa ne". Le të vazhdojnë në punët e tyre private. Administrata, politika, gjyqësori, ushtria dhe prokuroria pastrohen dhe njëherësh forcohen përmes këtij ligji lustracioni demokratik.

Diskutimi u botua në gazetën 55, dt. 18.12.2008

Shënim: Nga R*aporti i Legjislacionit, i cili paraqet një përmbledhje të veprimtarisë ligjvënëse për këtë legjislaturë, veçojmë:*

"Ligji nr. 10034, datë 22.12.2008 "Për pastërtinë e figurave të zyrtarëve të lartë të administratës dhe të zgjedhurve".

Data e hyrjes në Kuvend 25.10.2006

Nismë e deputetëve: PD, PDK, PS

Komisionet parlamentare që kanë shqyrtuar:

Komisioni për Çështjet Kushtetuese dhe Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut;

Shqyrtimi në seancë plenare: 22.12.2008

Ligji është miratuar me 74 vota pro, 2 kundër, 1 abstenime.

Shumica e kërkuar: e thjeshtë

Ligji ka për qëllim të kontrollojë pastërtinë e figurës së çdo funksionari publik të zgjedhur apo të emëruar, lidhur me pjesëmarrjen e tyre në strukturat politik-bërëse dhe zbatuese të dhunës së diktaturës së proletariatit, si edhe në strukturat e ish Sigurimit të Shtetit për periudhën 29 nëntor 1944 deri në 8 dhjetor 1990. Objekti i këtij ligji është përcaktimi i subjekteve dhe funksioneve të larta shtetërore të cilat janë të papajtueshme me veprimtarinë publike të zyrtarit për shkak, të qenies si anëtar, drejtues, apo bashkëpunëtor në strukturat politik-bërëse dhe zbatuese të dhunës së proletariatit apo të ish Sigurimit të Shtetit për periudhën 29 nëntor 1944 deri më 8 dhjetor 1990, rastet e papajtueshmërisë dhe procedurat e verifikimit dhe pasojat e këtyre procedurave.

Deputetët e opozitës nuk e votuan këtë projektligj.

I. 32. Ratifikimi i marrëveshjeve ndërmjet Qeverisë dhe Komuniteteve Fetare

Diskutimi në seancë plenare

Tiranë, datë 22 Janar 2009

Për të qenë i sinqertë unë nuk kisha ndërmend të diskutoja se mendoja që do ta merrnin fjalën shumë parlamentarë të krahëve të politikës; parlamentarë të vjetër, të majtë, të djathtë, historianë, mësues, politikanë të pas viteve `90 në respekt të Kushtetutës, të nenit 10 të saj, në respekt të komuniteteve fetare, në respekt të besimtarëve në Shqipëri, por edhe në respekt të vetvetes. Sa për kuriozitet po ju kujtoj që ligji i parë për fenë në Shqipëri është miratuar në vitin 1923, ligji i dytë për fenë është miratuar në vitin 1929 dhe në të dyja këto raste, në Parlamentin e asaj kohe ka pasur diskutime shumë të zjarrta, diskutime të gjata, teorike, që në mënyrë të sintetizuar, historiani Kastriot Dervishi i ka evidentuar edhe në librin e tij "Historia e Shtetit Shqiptar". Për hir të së vërtetës duhet të them që është e pakuptimtë, që ne sot të kalojmë tri marrëveshje me komunitetet fetare dhe të mos flasë asnjë person këtu. Për hir të së vërtetës, opinionit publik duhet t'i bëhet me dije që ju socialistët në 8 vjet pushtet, pas miratimit të Kushtetutës, në vitet 1998- 2005 keni miratuar vetëm një marrëveshje me Selinë e Shenjtë me një ligj të vitit 2002.

Këto marrëveshje, për hir të së vërtetës, vijnë me një vit vonesë, pasi urdhri nr. 73, datë 25 prill 2006 i Kryeministrit, për hartimin e projektmarrëveshjeve midis Këshillit të Ministrave dhe bashkësive fetare, rrjedhojë e nenit 10 të Kushtetutës e presupozonte këtë gjë që kjo duhej realizuar në vitin 2007. Megjithatë dhe në 2008-ën Qeveria, drejtuesit e institucioneve të kulteve, si dhe drejtuesit e komitetit shtetëror janë për t'u përgëzuar. Ndoshta dhe në këto marrëveshje ishte parashikuar një projektligj që rregullonte marrëdhëniet financiare me komunitetet fetare, të sjellin në një kohë të përshtatshme, konform dhe detyrimeve që rrjedhin nga

matrica, nga objektivat që ka pasur në 2007-ën, projektligjin për fenë. Është për tu përgëzuar e theksoj për këto 3 marrëveshje, pasi me këto tre dhe një marrëveshjen tuaj të vitit 2002, përfundimisht politika shqiptare, shteti shqiptar, plotëson detyrimet e nenit 10 të Kushtetutës. Unë të tria këto marrëveshja, do t'i votoj me kënaqësi, me vlerësimin më të madh për Qeverinë, për këto komunitetet fetare, duke përjashtuar një abstenim për projektligjin "Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Shqipërisë dhe Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella", për një paqartësi që kam personalisht te neni 11.

Shënim: *Nga Raporti i Legjislacionit, i cili paraqet një përmbledhje të veprimtarisë ligjvënëse, veçojmë:*

"Ligji nr. 10056, datë 22.01.2009 "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Mysliman të Shqipërisë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella".

Ligji nr. 10057, datë 22.01.2009 "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella".

Ligj nr. 10058, datë 22.01.2009 "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kryegjyshatës Botërore Bektashiane të Shqipërisë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella".

Data e hyrjes në Kuvend 05.01.2009

Nismë e KM

Komisionet parlamentare që kanë shqyrtuar:

Komisioni për Çështjet Kushtetuese dhe Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut;

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

Shqyrtimi në seancë plenare: 22.01.2009

Shumica e kërkuar: e thjeshtë

Këto tre marrëveshje kanë për qëllim rregullimin e çështjeve të marrëdhënieve të bashkëpunimit, ndërmjet shtetit shqiptar dhe Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë si dhe Kryegjyshatës Botërore Bektashiane të Shqipërisë, në përmbushje të parimeve kushtetuese që garantojnë lirinë e shfaqjes dhe të ushtrimit të besimit fetar. Objektivat kryesore të marrëveshjeve janë njohja dhe garantimi i paprekshmërisë së institucionit të kultit, për aq sa veprimtaritë e tyre nuk bien në kundërshtim me kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi,

garantimin e lirisë së individit për tu zgjedhur individualisht ose kolektivisht në institucionet fetare ose jashtë tyre si dhe mbrojtja e bashkëjetesës fetare nga shteti.

Marrëveshjet u votuan nga të gjithë deputetët e pranishëm. Personalisht votova pro për marrëveshjet ndërmjet shtetit shqiptar dhe Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, Kryegjyshatës Botërore Bektashiane të Shqipërisë si dhe votova kundër marrëveshjes ndërmjet shtetit shqiptarë dhe Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë.

I.33. Një demokraci pa kujtesë, e sheh veten në vuajtje

Diskutimi në seancë plenare, jashtë rendit të ditës

Tiranë, datë 29.01.2009

Në një roman të shkruar bukur të realizmit socialist të para viteve '90-të, një roman përmbajtësor, është një anekdotë e tillë, që e tregonin djemtë e Rrugës së Dibrës: "Çfarë del nga martesa e iriqit me gjarprin? Një metër tel me gjemba". Pikërisht nga martesa e një pjese të Gjykatës Kushtetuese me kupolën e PS-së del një gardh me gjemba, del një perde me gjemba për krejt demokracinë në Shqipëri, për lustracionin dhe dekomunistizimin e vendit dhe për integrimin e tij në BE. Kjo kompromotohet nga një deklaratë e dy ditëve më parë e një zyrtari të lartë të PS-së, e cila e kompromoton vendimin e sotëm antikushtetues të Gjykatës Kushtetuese, si vendim të marrë në cenim të plotë të parimeve të së drejtës, të barazisë dhe të integritetit, në një konflikt të hapur interesi të një numri të madh të anëtarëve të kësaj gjykate. PS-ja, përmes eksponentit të saj të lartë, deklaron se ajo e konsideron detyrë historike dhe mision kushtetues e kombëtar të ndalojë zbatimin e ligjit të lustracionit për dekomunistizimin e shoqërisë, duke konkretizuar haptas apologjinë e krimit 45-vjeçar të diktaturës. Për fat të keq, Gjykata Kushtetuese iu bashkua PS-së, u nënshtrua nga PS-ja, "u martua", do të thoshte ndokush, me PS-në, në mbrojtje të atyre që kontribuan për mbijetesën e diktaturës. Kjo është anti humane, antidemokratike, jo e moralshme. Socialistët, me një politikë të deklaruar tashmë "përtej së majtës dhe së djathtës", por të dirigjuar dhe të urdhëruar mjeshtërisht nga eksponentët e Partisë mëmë të Punës dhe institucionet famëkeqe të diktaturës: ish-Sigurimi i Shtetit, ish-Gjykata e Lartë, ish-hetuesia, ish-prokuroria etj., tashmë kanë hipotekuar edhe zyrtarisht në vitet e demokracisë barrën dhe mëkatet e trashëgimisë kulturore, ekonomike, politike, diktatoriale, antikombëtare, të para viteve '90, që, siç shkruan Koço Kosta në romanin e tij të fundit "Absurdi": "*Do të triumfojë i plotë, i patundur,*

socializmi i komunizmit tonë". Kjo e vënë në gojën e Peposh Buzbatit, që ngjan me një pjesë të madhe prej jush. Tashmë, socialistët, duke tentuar, nëpërmjet dhunimit të Kushtetutës, demokracisë dhe institucioneve në Shqipëri, të ruajnë të paprekur ngrehinën e vjetër diktatoriale, ideatorët dhe ekzekutorët e saj, nëpërmjet ndërtimit të "demokracisë të socializmit të komunizmit", pra, të demokracisë që kërkon Partia Socialiste, duke iu shmangur parimeve klasike të demokracisë dhe të qeverisjes, sintetikisht të dhëna qysh në lashtësi përmes sentencës aristoteliane "Qeverisje nëpërmjet ligjeve dhe jo nëpërmjet njerëzve", me anë të gjyqtarëve të sotëm abdianë e personalizuan çështjen, për të mbrojtur kriminelët dhe krimin e djeshëm diktatorial, duke cenuar rëndë parimet e shtetit të së drejtës, kodin etik të gjyqtarit dhe gjyqësorit, në mbrojtje të së djeshmes së tyre, të së djeshmes personale dhe familjare, për të deformuar ndërtimin e sotëm dhe të nesërm në kurriz të demokracisë. Por PD-ja, e cila ka misionin e vijimit dhe të ndërtimit të demokracisë, jo të goditjeve, do ta dhe duhet ta vazhdojë patjetër detyrën e re historike të dekomunistizmit të vendit dhe të ndërtimit të shtetit të së drejtës përmes një kujtese të thellë historike. Shumë herë është thënë shprehja "Një demokraci pa kujtesë e sheh veten në vuajtje". Ne asnjëherë nuk duhet të harrojmë të flasim dhe të riflasim në respekt të veprës, të jetës, të qëndresës antikomuniste të 6 mijë të vrarëve, të pushkatuarve nga diktatura, të vdekurve në burgje, 34 mijë vetave të burgosur, mbi 90 mijë të internuarve e qindra mijëra të tjerëve. Ne nuk duhet të flasim dhe të mendojmë për Fehmi Abdiun dhe interesat e Fehmi Abdinjve, por të flasim dhe të mendojmë për jetën, veprën dhe qëndresën e martirit Havzi Nelaj, vëllezërve Blloshmi, Genc Lekës dhe shumë të tjerëve. Ligji që ne votuam dhe që u godit me një antikushtetutshmëri të plotë nga një gjykatë, që e quan veten Gjykatë Kushtetuese, është një ligj që do të finalizojë një proces, një aktivitet të ndërtimit të kombit, përmes drejtësisë që vendos. Është një proces dhe aktivitet që fuqizon institucionet ekzistuese të administratës publike dhe gjyqësore, pra, në thelb i shërben ndërtimit të shtetit. Po perifrazoj profesorin e ekonomisë politike Frensis Fukujama: "Ndërtimi i shtetit është krijimi i institucioneve të reja dhe fuqizimi i atyre ekzistuese". Është dhe një thënie e Bedri Spahiut, ish-prokurorit dhe ish-të persekutuarit nga diktatura, që ndoshta është e rëndë për një pjesë prej jush, por e meritoni (nuk po e citoj sot për efekt kohe). Desha të theksoj se për këtë ligj kemi nevojë të gjithë: ish të burgosurit politikë, ish-gardianët e diktaturës komuniste, antikomunistët dhe ndoshta kanë nevojë më tepër komunistët, demokratët dhe socialistët, ka nevojë ndërgjegjja,

kujtesa dhe e ardhmja jonë. Është parim politik i rëndësishëm qëndrimi i gjithsecilit ndaj kujtimit të së kaluarës, parim të cilit nuk mund t'i iket. Ç'duhet të bëjmë ne si PD? Ne duhet të vazhdojmë një analizë rigoroze të përbërësve të sistemit totalitar, të analizës së institucioneve kryesore që e mundësuan këtë tragjedi dhe personave të implikuar në këtë sistem dhe të vazhdojmë paralelisht në tri shtylla, në tri fondamente: dëmshpërblimin e ish të përndjekurve politikë, institucionin e kujtesës historike dhe ripunimin e këtij ligji dhe dërgimin përsëri në Gjykatën Kushtetuese. Detyra historike e Sali Berishës, por jo vetëm e tij, është t'u kthejë besimin njerëzve në virtytet e demokracisë dhe duke fuqizuar dhe përkrahur institucionet shqiptare, përpjekje që duhet të kenë një fondament të fortë edhe në këtë ligj lustracioni. Po të jetë nevoja, ne duhet të kërkojmë edhe aktivizimin e nenit 128 të Kushtetutës. Në këto shënime kam një thënie të bukur, të nxjerrë nga arkivi "Mitrochin", është një telegram urimi që kryetari i Gjykatës së Lartë të BS-së ia dërgon shefit të KGB-së, Andropovit, i cili ju përshtatet juve më së miri, pra Gjykatës së Lartë të Shqipërisë, Sigurimit shqiptar dhe PS-së (edhe këtë për efekt kohe nuk po e citoj). Por po e mbyll me një citim që At Zef Pllumi e ka bërë në vitin 1994. Pas pyetjes së gazetarit: "Çfarë do të thoni për përgjegjësitë morale dhe juridike të këtyre dhe ç'dënim do të kërkonit për ta?", ai përgjigjet: "*Unë kërkoj që këta njerëz të dënohen moralisht, të shpallen si përgjegjës për krime te kryeme kundër Shqipërisë, kundër kulturës dhe kundër njerëzisë. Por vetëm kaq. Ata, mbasi të marrin këtë verdikt nga gjykata, duhet të kthehen ndër shpia t'veta, të rilirohen nga të gjitha aktivitetet politike*".Kurse më bukur artistikisht, në kuptim figurativ, e jep shkrimtari i madh Koço Kosta, njeriu antikonformist i të gjitha pushteteve, në romanin e tij më të fundit "Absurdi" dhe një pjesë prej jush, në mendimin tim, ngjajnë me fjalën me të cilën quhet ***misri i zier****)* në Përmet dhe në Lunxhëri, kurse pjesës tjetër do t'i rekomandoja të lexonte faqet 278 dhe 279 të librit në fjalë.

*) Sipas K. Kostës, misrit të zier në Përmet i thonë boles, ndërsa në Lunxhëri nënkuptohet bole bole.

I. 34. Reforma rregullatore e regjistrimit dhe licencimit të biznesit

Diskutimi në seancë plenare mbi projektligjin "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë"

Tiranë, datë 23.02. 2009

Një nga deklarimet e rëndësishme për kohën, në Kuvendin e fundit të Partisë Demokratike, atë kohë në opozitë, në prill 2005, në programin politik "Koha për ndryshim" e kryetarit të partisë, sot Kryeministër ishte: "Përgjegjësia për premtimin do të jetë përgjegjësia e parë për të cilën do të përgjigjet Qeveria e ardhshme" Premtimi për "thjeshtimin e të gjitha procedurave ligjore, administrative dhe instalimi i politikës një ndalim në një sportel për regjistrimin e bizneseve" është funksionale prej shtatorit 2007, kur Qendra Kombëtare e Regjistrimit (Q.K.R) ofron këtë shërbim regjistrimi të saktë, transparent, të shtrirë territorialisht e mbi të gjitha që kryhet brenda një dite. E shkruaj këtë jo vetëm për faktin e premtimit të mbajtur apo përmirësimit te klimës administrative ndaj biznesit, çka shërben për një vlerësim, klasifikim pozitiv të Shqipërisë në studimin prestigjioz të përvitshëm të Bankës Botërore, " të bësh biznes" duke filluar nga 2008, për Shqipërinë, por për arsyen që kjo veprimtari, së bashku me reduktimin dhe thjeshtimin në shumë sektorë të numrit të licencave, lejeve apo autorizimeve, nga rreth 300 në 2005 në 160 të tilla në vitin 2008, është konsideruar e vlerësuar tashmë si hapi i parë i reformës rregullatore të regjistrimit dhe licencimit të ndërmarrë suksesshëm nga kjo Qeveri. Projektligji që pritet të konkretizohet së shpejti në Kuvend, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", është hapi përmbyllës i kësaj reforme rregullatore të biznesit, i këtij premtimi të madh elektoral tashmë të mbajtur. Ky projektligj vjen përmes një procesi përgatitjeje transparent e gjithëpërfshirës ndërmjet faktorëve të tillë të jetës ekonomike të vendit si Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli Konsultativ i Biznesit, ekspertë të GTZ-së

e Institutit të Studimeve Bashkëkohore, dhoma e shoqata të ndryshme biznesi etj, duke konsoliduar njëherazi reformën agresive pozitive që kjo qeveri ka marrë për reduktimin e barrierave administrative ndaj biznesit si pjesë e një reformimi tërësor të rregullave dhe institucioneve të tregut. Institucioni që do të krijohet, si detyrim ligjor, Qendra Kombëtare e Lejeve dhe Licencave, veprimtaria e kësaj Qendre dhe sistemi rregullator ligjor dhe kornizat që ligji përcakton është një pjesë fondamentale e Reformës së Reduktimit të Barrierave Administrative, e cila në vetvete është një nga reformat më të rëndësishme të ndërmarrë nga Qeveria që në fillimet e vitit 2006, e dokumentuar kjo edhe në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim. Mjedisi pro-biznes që është kthyer me të drejtë në fokusin e politik- bërjes qeveritare edhe si një nga komponentët kryesor të reformës rregullatore të reduktimit të barrierave kërkonte prej vitesh si domosdoshmëri edhe rishikimin e sistemit të licencave dhe lejeve. Drejtimet kryesore të këtij rishikimi tashmë të konkretizuar në këtë projektligj janë:

1. Reduktimi masiv i numrit dhe llojeve të licencave dhe lejeve si dhe thjeshtëzimi e qartëzimi i kritereve për dhënien e tyre, të dokumentacionit apo metodave që përdoren për vërtetimin e kënaqjes së kritereve.

2. Ngritja e një sistemi institucional të pranimit të kërkesave, përpunimit dhe lëshimit të tyre bazuar në modelin e Qendrës me një ndalesë [Në terminologjinë evropiane ky koncept quhet "pika e vetme e kontaktit" (single point of Contact" Direktiva 2006/123/EC, 12.11.2006) Në literaturën e kësaj fushe përdoret "One stop shop"], kjo përfshirë edhe aplikimin e parimit të "miratimit në heshtje" si dhe bazuar në teknologjinë e avancuar të informacionit dhe komunikimit.

Në drejtimin e parë, (mbas thjeshtimit në të dy vitet 2006-2008 nga 300 leje në 180) Qeveria ka vendosur objektiv reduktimin e tyre me 2/3, pra do të mbeten 65 leje. Njëkohësisht thjeshtohen kriteret, qartësohen, shndërrohen në format vetë deklarimi apo në një proces verifikimi të posedimit dhe vërtetësisë së dokumenteve që vërtetojnë kënaqjen e kritereve të licencimit nga subjektet aplikuese.

Gjithashtu parimi i "miratimit në heshtje" kombinohet dhe mbështetet nga përdorimi i teknologjisë së informacionit. Në fakt, pa teknologjinë moderne të informacionit, parimi i "miratimit në heshtje", nëse do të zbatohej në kushtet e komunikimit shkresor jo elektronik do të ishte thuajse i pa aplikueshëm. Këtë e përmenda edhe për faktin që do të shërbejë si nxitës për t'u thelluar në e-goverment, e-business etj, përgjithësisht në komunikime elektronike (tipar bashkëkohor).

Të dyja drejtimet që përmenda më sipër janë sa të lidhur aq dhe të pavarur nga njëri-tjetri. Në fakt një sistem licencash dhe lejesh është derivat i filozofisë politike të mazhorancave qeverisëse. Kjo pranohet gjerësisht kudo në botë. Duke ditur se eksperienca ndërkombëtare lidhur me regjistrimin e biznesit është përgjithësisht e suksesshme duhet pranuar se reforma e parë e ndërmarrë nga ne, ajo e regjistrimit "one stop shop" ishte e thjeshtë në koncept dhe e lehtë për tu zbatuar, siç dhe po zbatohet, me sukses. Ndërsa për reformën e dytë duhet pohuar se eksperienca ndërkombëtare lidhur me licencimin e biznesit njeh raste suksesesh dhe dështimesh në masë të barabartë, pra gjysmë për gjysmë. Arsyet e dështimeve janë kur qendrat e licencimit tentojnë t'u afrohen ekstremeve të modeleve, pra modeleve që kanë risk të lartë dështimi. Ekstremet e modeleve janë një mega qendër që bën gjithçka, apo ekstremi tjetër është një proces i tëri fluid. Ekspertët që kanë përgatitur projektligjin e paraqitur, nisur edhe nga politik-kërkesa qeveritare janë treguar tepër të kujdesshëm duke parashikuar nëpërmjet 56 neneve të këtij projektligji (përmend Kreu IV: Licencat dhe lejet e institucioneve qendrore, Kreu V: Licencat, lejet dhe autorizimet që trajtohen nga ose nëpërmjet QKL, Kreu VI: Krijimi, organizimi dhe funksionimi i QKL) një model Qendre, një sistem procedimi, i cili diversifikon portofolin e procedurave dhe realizon me procedura të caktuara ato lloj lejesh dhe licencash të cilat i përshtaten modelit që fillon dhe mbaron në Qendër. Gjithashtu, parashikohet dhe raport dinamik mes Qendrës dhe Institucioneve Administrative për kategori të caktuara ashtu siç do të ketë dhe licenca që s'ka lidhje me Qendrën por do të vazhdojnë sipas procedurave (Kreu IV/neni 15: Kompetenca për trajtimin e licenscave, autorizimeve, lejeve; si dhe Kreu V: Procedurat e Licencimit, autorizimit, lejimit nga apo nëpërmjet QKL). Rëndësia e kësaj dhe vlerësimi për përgatitësit, ekspertët është korrekt duke besuar se ata kanë përgatitur tashmë një model të ri, i cili shfaqet me portofol të diversifikuar, procedura transparente e të thjeshta dhe si rrjedhojë minimizon riskun e dështimit. Pavarësisht sistemit të lejeve dhe licencave në një moment kohe të dhënë, ngritja e një qendre "one stop shop", (pika e vetme e kontaktit) me teknologji moderne që lehtëson aksesin, rrit transparencën dhe redukton kohën e procedimit, mbetet në çdo kohë një model i lavdërueshëm. Në fakt një qendër e tillë do të jetë e aftë që t'i përshtatet qoftë një sistemi me natyrë të dobët rregullimi e qoftë një sistemi me natyrë të fortë rregullimi. Vlen të theksohet se ky projektligj është bazuar dhe ka siguruar përputhje principale me Direktivën 2006/123/EC e 12.12.2006 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian "Për shërbimet

në tregun e brendshëm". Megjithëse kjo direktivë ka për qëllim kryesor eliminimin e barrierave diskriminuese të lëvizjes dhe aksesit brenda BE-së, shërben si referencë, jep rekomandime kyçe lidhur me thjeshtëzimin dhe lehtësimin e procedurave administrative, kritereve, kushteve për aplikimin dhe dhënie licencash e lejesh. Pra nuk mund të flitet për një përputhje nen për nen, por për një përputhje në princip, me parime të tilla si përdorimit të Qendrës me një ndalesë; heshtja deri në një afat është miratim; përdorim kushtesh e kufizimesh vetëm kur është e nevojshme, përdorimin e teknologjisë së informacionit në komunikim etj. E theksova në fund këtë përputhje sepse dëshmon faktin që kjo reformë është pjesë e përafrimit të legjislacionit me *acquis communautaire*. Sfida e sistemit të ri rregullator për veprimtarinë ekonomike të biznesit është që, duke adoptuar standardet e detyrueshme evropiane, të cilët në disa fusha përmbajnë kosto të pandryshueshme për biznesin, të bëhet dhe të mbetet njëkohësisht një sistem rregullator fuqimisht pro-biznes. Duke përfunduar dëshiroj të besoj që ky projektligj, i cili do të votohet së shpejti në Kuvend, konsolidon një reformë të plotë rregullatore të regjistrimit dhe licencimit duke vulosur një premtim të mbajtur elektoral të tre vjetëve më parë, ideuar qartas nga këndvështrimi i politikës së Qeverisë, profesional nga këndvështrimi teknike dhe i mirëpritur nga grupet e interesit. Garancia për zbatimin e këtij ligji, ngritjen dhe mirëfunksionimin e kësaj Qendre është dhe fakti që Projekti i Sfidës së Mijëvjeçarit, faza dy, i Qeverisë së Shteteve të Bashkuara do të mbështet fazën e ngritjes së Q.K.L-s me asistencë teknike dhe financiare për përgatitjen e sistemit softe të QKL-s, instalimin e pajisjeve hard të lidhura me këtë sistem, shërbime të ekspertizës IT dhe asaj ligjore e rregullatore.

Diskutimi u botua në gazetën RD, datë 22.02.2009 dhe në gazetën 55, datë 24.02.2009

Shënim: *Nga Raporti i Legjislacionit, i cili paraqet një përmbledhje të veprimtarisë ligjvënëse për këtë legjislaturë, veçojmë:*

"Ligj nr. 10.081, datë 23.02.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë".

Data e hyrjes në Kuvend 09.01.2009
Nismë e KM
Komisionet parlamentare që kanë shqyrtuar:
Komisioni për Ekonominë dhe Financat
Shqyrtimi në seancë plenare: 23.02.2009
Ligji është miratuar me: 70 vota pro, 9 kundër, 20 abstenime.

Shumica e kërkuar: e thjeshtë

Hartimi i ligjit për licencat, autorizimet dhe lejet është hapi i mëtejshëm për realizimin e një nga reformave më të rëndësishme të ndërmarra nga qeveria shqiptare, për reduktimin e barrierave administrative. Ligji ka për qëllim përmirësimin e klimës së biznesit nëpërmjet reduktimit të barrierave administrative ndaj nismës së lirë në kryerjen e veprimtarive ekonomike e tregtare, apo në përdorimin e të mirave publike duke garantuar mbrojtjen e interesit publik.

Ligji është në përputhje me direktivat e Bashkimit Evropian që përcaktojnë parimet kryesore në ofrimin e shërbimit ndaj publikut në tregun e brendshëm evropian dhe me përvojën e përparuar të vendeve të tjera të rajonit".

I.35. Porti i Shëngjinit – Porti i integrimeve shqiptare

(Racionaliteti ekonomik dhe racionaliteti politik në një kahe të përbashkët për integrime shqiptare, për mirëkuptim ndër shqiptarë e prosperitet kombëtar, përmes dhënies në përdorim të Portit të Shëngjinit, Qeverisë së Kosovës, në funksion të ekonomisë dhe biznesit kosovar)
Diskutimi në seancë plenare, jashtë rendit të ditës

Tiranë, datë 02.03.2009

Në raportin vjetor të Punës së Qeverisë Thaçi, (Prishtinë dhjetor 2008), theksohet se: "Prioritet parësor i Qeverisë së Kosovës vazhdon të jetë intesifikimi i zhvillimit ekonomik. Rritja ekonomike do të realizohet përmes intesifikimit të investimeve, privatizimit të mëtejshëm dhe ristrukturimit të ndërmarrjeve publike, shtimit të aftësisë konkurruese të ekonomisë dhe rritjes së eksportit. Qeveria e Kosovës ka aplikuar politika që synojnë: rritje ekonomike, uljen e shkallës së papunësisë, përmirësimin e kushteve sociale dhe zvogëlimin e varfërisë, në mënyrë që të jetë konkurruese me vendet e rajonit për tërheqjen e investimeve të huaja direkt".

Ministrat e Kosovës, në emër të Kryeministrit Thaçi shprehën, ditë më parë, tek Qeveria jonë, një kërkesë strategjikisht sinjifikative, se: "Në emër të Qeverisë së Kosovës do të kërkonim që të na krijohej hapësira për të pasur një pjesë në këtë Port (Portin e Shëngjinit) dhe për të bërë investime si Qeveri, me qëllim rritjen e qarkullimit të mallrave dhe qytetarëve nga porti i Shëngjinit, pra mundësive të reja që do të krijohen me inagurimin e rrugës Durrës-Kukës-Prishtinë".

Në cilësinë e deputetit të Vlorës, mendoj që kjo kërkesë e para orientuar, mirëpritur dhe e mbështetur nga Kryeministri i Qeverisë së Shqipërisë, Z. Sali Berisha, vjen në kohën e duhur si një pjesë thelbësore e Platformës së Veprimit Ndër shqiptarë, ndërmjet dy shteteve shqiptare, të pavarura në Rajon, Kosovës dhe Shqipërisë e më gjerë.

Aorta e kombit, rruga Durrës-Kukës-Prishtinë dhe Porti i Shëngjinit, për biznesin Kosovar dhe Qeverinë e Kosovës si dhe për biznesin shqiptar dhe Qeverinë shqiptare janë dy trasetë e hekurudhës së përbashkët integruese në ekonomi, politikë dhe kulturë.

Këto investime madhore kombëtare ekonomike e politike do të dhe po shoqërohen me veprime të tjera që sinergjizojnë përpjekjet integruese të dy vendeve tona në të gjitha fushat e zhvillimit ekonomik e shoqëror: në arsim, (me kurrikula të përbashkëta në program, jo vetëm në letërsi shqipe e histori Shqipërie, por edhe në marrëveshje universitetesh shqipfolëse në rajon, këmbime pedagogësh dhe studentësh, konferenca shkencore të përbashkëta etj), kulturë [(projektet e përbashkëta duhet të shtrihen jo më në dy , tre muaj por në vit të plotë, siç dhe kemi deklaruar që do kryenim për 2008), le ta kryejmë që këtë vit], infrastrukturë [(Rruga e Kombit Durrës-Prishtinë do të shoqërohet në një të ardhme të afërt nga rruga e Arbrit, ajo Prishtinë-Pukë-Shkodër, hekurudha Prizren-Kukës-Tiranë-Durrës (shpresuar kjo për optimistët në dekadën që vjen), aeroporti i Kukësit etj], energjetikë (duhet të shfrytëzojmë dhe të alternojmë burimet hidrike dhe termike të të dy vendeve), politika të përbashkëta tregtare, tregje difuzive turistike apo shprehur thjeshtë e saktë, Konsolidimit të Hapësirës Kulturore Shqiptare, Hapësirës Ekonomike e pse jo Politikë Kombëtare konkrete.

Shqipëria është vendi i parë që ka nënshkruar Marrëveshjen për Tregti të Lirë me Kosovën (tetor 2003), duke eliminuar taksat e dyfishta, ashtu si ka nënshkruar edhe me vendet e tjera të Rajonit. Por 6 vjet mbas nënshkrimit të marrëveshjes, ende shkëmbimet tregtare mes Kosovës dhe Shqipërisë janë të ulëta në volum, (shkëmbimet tregtare me Kosovën sipas të dhënave të INSTAT-it dhe Entit të Statistikave të Kosovës, vitin e kaluar arritën 9.97 miliard lekë, eksportet nga Shqipëria janë tepër modeste, vetëm 2% të totalit të importeve kosovare, në një kohë kur ato serbe arrijnë 15% dhe maqedonase 20 %), edhe pse potencialet për këmbimin e mallrave dhe shërbimeve Shqipëri – Kosovë janë të larta, por qartas të pa shfrytëzuara mirë. Problemi më i madh vjen nga infrastruktura e keqe e cila në veçanti gjatë muajve të dimrit është pengesë e plotë. Përfundimi i rrugës Durrës-Kukës dhe angazhimi i Qeverisë Kosovare për ta vazhduar deri në Prishtinë është eliminimi përfundimtar i kësaj pengese infrastrukture, mbi të gjitha, duke krijuar një mundësi shumë të mirë për shkëmbime me një fluks shumë të shtuar dhe përfitime të dyanshme në një treg me 7 milion konsumatorë.

Zgjerimi i aftësisë përpunuese të Portit të Shëngjinit dhe vendosja në funksion të ekonomisë Kosovare, qeverisë së Kosovës

dhe biznesit kosovar do të krijonte, hipotekonte, një portë shumë të mirë gjeo-ekonomike ndërmjet Kosovës dhe Perëndimit, Evropës. Kjo do të sjellë përfitime ekonomike dhe politike të dyanshme si për Kosovën dhe Shqipërinë. Kosova do të ulte varësinë tregtare me vendet fqinje sidomos Serbinë dhe Maqedoninë dhe do ta orientonte Kosovën në volumet tregtare drejt vendeve të BE-së. Këtu nuk është fjala për të dëmtuar ekonomikisht Serbinë apo për më tepër Maqedoninë (fqinjë ky që ka njohur pavarësinë e Kosovës ashtu si dhe Mali i Zi), por për t'i krijuar oportunitet Kosovës të konkurrojë direkt në tregjet ndërkombëtare dhe biznesi kosovar të mos jetë dorë e dytë apo e tretë në blerjen e mallrave e për më tepër në kushtet të ardhshme kur edhe kostoja e lartë e transportit do të reduktohet ndjeshëm.

Sa i përket fitimeve politike, përpos të tjerash, Kosova do të ishte më pak e kërcënuar nga presionet ekonomike shpesh absurde të shtetit Serb. Kujtoj këtu "bllokadën" që Serbia i shpalli Kosovës pas shpalljes së Pavarësisë. Kjo bllokadë edhe pse në nonsens ekonomikë për Serbinë më shumë, se sa për Kosovën, përsëri ishte dhe është një formë presioni ekonomik dhe politik ndaj shtetit kosovar.

Porti i Shëngjinit, i administruar si port i Kosovës dhe për ekonominë kosovare, do ta pavarësonte më shumë ekonomikisht shtetin e ri, Republikën e Kosovës, duke i dhënë një liri të dimensionit ekonomiko-politik, një dalje të ëndërruar në Adriatik. Për sa i përket Shqipërisë, porti i ri do të rriste investimet në vend të inkuadruara si investime të huaja apo vendase. Për më shumë këto do të realizoheshin në një zonë deri tani me zhvillim mesatar duke i dhënë një impuls të fuqishëm zhvillimit ekonomik të zonës. Pra, ky port nën një administrim të ri, të një vendi fqinjë si Kosova, jo vetëm do të sillte përfitime ekonomike për të, por do të ishte një mundësi e mirë për zhvillimin e pjesës veriperëndimore e verilindore të Shqipërisë.

Përveç ekonomikisht dhënia e Portit nën administrimin e drejtpërdrejt Qeverisë Kosovare do ta kthente Shqipërinë jo thjesht në burim emancipimi, por çka është më thelbësore në një burim stabiliteti dhe zhvillimi në Ballkanin Perëndimor e më gjerë, duke u bërë një faktor potent stabilizues ekonomik e politik. Në këtë rast racionaliteti ekonomik dhe racionaliteti politik shkojnë në kahe të përbashkëta pozitive për të dy vendet veçmas e së bashku. Anëtarësimi së shpejti i Shqipërisë në NATO dhe aspirata e Kosovës për anëtarësim në të ardhmen në këtë organizatë, ashtu si ambicia e njëjtë e të dy vendeve për t'u integruar në Bashkimin Evropian, e bëjnë edhe më të dobishme e kuptimplotë këtë veprim, sa ekonomikë aq dhe politikë, sa kombëtarë aq dhe evropian. Objektivat e njëjtë

që ne kemi (si dy vende të pavarura) kanë nevojë për vështrim të përbashkët, për çështje të interesit të ndërsjellët. Ashtu si investimi madhor Durrës-Kukës-Prishtinë dhe dhënia në administrim e Portit të Shëngjinit, Qeverisë së Kosovës, dëshmon për një sinergjizim të politikave ekonomike të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Kosovës, si detyrime politike ndaj interesave të përbashkëta të kombit si një tërësi dhe të komplementaritetit (plotësimit) në fushat ekonomike. Sot marrëdhëniet ekonomike ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës zhvillohen nëpërmjet 35 marrëveshjeve dhe memorandumeve të bashkëpunimit ekonomik, por theksoj me bindje që ajo për dhënien në dispozicion të Portit të Shëngjinit, për Kosovën, do të jetë një nga më të rëndësishmet politikisht e me efiçencë të plotë ekonomikisht. Përveç se mazhorancës së djathtë që do ta votojë në Parlament projektligjin që konfirmon këtë marrëveshje, jam i bindur se, dhe një pjesë e së majtës do t'i bashkohen kësaj nisme të ideuar nga Kryeministrat Berisha dhe Thaçi. Shqipëri-Kosovë drejt një Tregu të Përbashkët, drejt një tregu unik, realizohet dhe do të realizohet vetëm me nisma të përbashkëta politike dhe ekonomike të këtij rangu.

Në mbyllje të këtij shkrimi modest, në përkrahje të kësaj nisme të madhe, për dhënien në përdorim, në administrim Qeverisë së Kosovës, të Portit të Shëngjinit, dëshiroj të kujtoj një deklaratë, të 1 shtatorit të 1995, të Presidentit Rugova, në Tiranë në bisedën me Presidentin Berisha për fillimin e projektit për ndërtimin e Autostradës në rrugën e vjetër Lezhë-Prizren-Prishtinë: "Kjo është një arterie kryesore që tradicionalisht ka lidhur Kosovën me bregdetin. Realizimi i këtij projekti kërkon kohë, por duhet të mendojmë për të tashmen dhe të ardhmen". Lidhja e Kosovës me bregdetin, një ëndërr e kahershme shqiptare bëhet realitet me rrugën e madhe Durrës-Kukës-Prishtinë dhe me Portin e Shëngjinit në dispozicion të ekonomisë kosovare tërësisht. Mbi të gjitha është detyrë e politikës moderne që aktivitetin ekonomik e drejtimet politike t'i orientojë drejt objektivave të gjykuara të ligjshme nga qytetarët, të objektivave kombëtarë, të inkurajimit të fqinjësisë së mirë, e stabilitetit në vend dhe Rajon. E pikërisht këtë detyrë Qeveria Berisha (e cila e ka inspiruar) dhe ne si deputet, pavarësisht kaheve politike duhet dhe do ta plotësojmë, me një qëllim të vetëm: Për integrime shqiptare, për mirëkuptim mbarëshqiptarë e ndërnjerëzor. (Shprehja-Për integrime shqiptare, për mirëkuptim mbarëshqiptarë e ndërnjerëzor është deklamuar nga Presidenti Rugova në Tiranë 2004 kur u shpall Doktor Honoris Causa i Universitetit të Tiranës).

I.36. Shoqëria civile dhe mbështetja e saj nga qeveria

Diskutimi në seancë plenare mbi projektligjin "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për mbështetjen e Shoqërisë Civile".

Tiranë, datë më 02.03.2009

Në fakt, zbrazëtia e lozhës apo mungesa e përfaqësuesve të shoqërisë civile nuk të lë përshtypje të mirë, në një kohë kur ne diskutojmë për këtë ligj. Por ndoshta ky mund të jetë edhe defekti ynë në raport me ta ose mosvëmendje e tyre ndaj këtij ligji, i cili është një ligj shumë i rëndësishëm, kurajoz dhe emancipues, që Qeveria shqiptare e sjell përmes këtij projektligji, i cili nga votimi ynë do të shndërrohet në ligj. Jam i bindur për këtë. Sot, ndërtimi i shoqërisë civile në botë është kthyer në ideal për qindra e mijëra qytetarë, organizata joqeveritare, parti politike, qeveri dhe shtete të ndryshme, ku çdo aktor dhe faktor punon që të japë kontributin e tij. Vlerat e shtuara dhe dobitë e projektligjit për organizimin dhe funksionimin e agjencisë për mbështetjen e shoqërisë civile, janë qartazi të dukshme në disa aspekte të inkurajimit e të zgjerimit, të organizimit të shoqërisë civile, e cila, tashmë, është realitet pozitiv i viteve të tranzicionit në Shqipëri përmes një rrjeti të gjerë shoqatash. Mendohet se në Shqipëri funksionojnë rreth një mijë të tilla, organizime të larmishme qytetare, grupe interesi apo të mendimit teorik etj. Unë mendoj se dy janë aspektet dhe vlerat kryesore të këtij projektligji. Së pari, thellimi i vazhdueshëm i kësaj demokracie përmes gjallërimit të demokracisë, inkurajimit dhe suportit të kontrollit të qytetarëve, shoqërisë civile mbi aktivitetin normativ të sistemit, përmes veprimit të të drejtave të qytetarëve në hapësirën publike dhe proceseve vendimmarrëse. Së dyti, përmirësimi dhe përforcimi jo vetëm i trashëgimisë së deritanishme të shoqërisë civile në Shqipëri (duhet të pranojmë që është në kohë të shkurtër), por edhe realizimi i bashkëpunimit të partneritetit shtet-shoqëri civile përmes veprimeve intensive dhe ekstensive. Edhe përmes kësaj kornize ligjore, krijimit të një enti që do të suportojë financiarisht

OJF-të, në mënyrë të paanshme, me liri të pjesëmarrësve dhe me transparencë e mosdiskriminim për çfarëdolloj arsye politike, fetare a krahinore, Qeveria i garanton shoqërisë civile në Shqipëri hapësirën e domosdoshme publike për veprimtarinë e saj. Ndërsa në vetëveprimin e në përputhshmërinë me objektivat e saj, shoqëria civile bën që qeverisja të bëhet më e prekshme, më e kontrollueshme dhe të ushtrohet në përputhje me parimet dhe rregullat bazë të demokracisë. Kjo shikohet në kreun 6: "Procedurat e përzgjedhjes e të vendimmarrjes". Shoqëria civile është një koncept që ka hyrë në fjalorin dhe në veprimin e shqiptarëve, ashtu siç e përmendi edhe Zëvendëskryeministri Pollo, së bashku me tranzicionin, jo vetëm si domosdoshmëri për të shkuar drejt demokracisë, por edhe si një kundërpeshë pozitive e pushtetit, pavarësisht se forcat politike shqiptare, në disa raste, e kanë trajtuar atë si një rezervë bankare të vetën, të cilën e hedhin në treg sa herë që ndiejnë zhvlerësim të monedhës së tyre politike. Theksoj këtu se, personalisht, në këtë proces dhe në këtë veprim politik nuk shoh ndonjë të keqe, për sa kohë ata mbështeten në parimet e drejta dhe të ndershme në kohë dhe në hapësirë të të gjithë aktorëve. Ky ligj, duke inkurajuar e suportuar shoqërinë civile në substancën e vet (dhe kjo është meritë e Qeverisë përmes këtij ligji), plotëson njëherazi edhe indirekt kriteret e Kopenhagës, që konfirmojnë kushtet themelore që duhet të plotësojnë vendet që aspirojnë në BE, të përcaktuara në vitin 1993. Dhe ato janë:

1. Institucionet e qëndrueshme që sigurojnë demokraci, garancinë e veprimit të ligjit e të respektimit të të drejtave të njeriut, të minoriteteve etj., që realizohen edhe përmes këtij ligji.

2. Ekonomi funksionale tregu.

3. Pjesëmarrje dhe pranim të arritjeve të vendeve të BE-së në këto momente.

Pra, ky ligj suporton, inkurajon dhe përdor këto kritere. Nuk duhet harruar se edhe vetë Evropa, historikisht shteti dhe tregu, në një lloj kuptimi, e krijuan shoqërinë civile nga vetja dhe për veten. "Në emër të progresit dhe të prosperitetit, të paktën që nga Rilindja evropiane, ata kanë bashkëpunuar jo duke e parë njëri-tjetrin si armiq". Këtë thënie të fundit e kam shkëputur nga një studim i plotë i intelektualit të nderuar, doktor Përparim Kabo, "Autoritarizmi në tranzicion - Antropologjia shqiptare përmes globalizmave".

Ky lloj bashkëpunimi në ditët tona quhet demokratizim i dyanshëm. Ligji në fjalë, përpos të tjerave, i shërben edhe rritjes së rendimentit social të të dyja palëve, transparencës së pushteteve dhe asaj të shoqërisë civile.

Ky ligj sinergjizon përpjekjet e Qeverisë me ato të qytetarëve, si një mekanizëm më solid i progresit. Duhet të jemi të vetëdijshëm

se shoqëria civile vepron me filozofinë qytetare. Ajo nuk është dhe nuk ka qëllim të shërbejë si faktor i drejtpërdrejtë pushteti. Në rast se ndodh një gjë e tillë, ajo denatyrohet. Duhet të kuptojmë edhe se opozita në kuadrin politik si parti politike apo konkurrenca alternative dhe opozicioni që vjen nga shoqëria civile, nuk është e njëjta gjë, dhe çdo abuzim, përpjekje e spekulim, në thelb, për minim të kësaj jongjashmërie, e dëmton shoqërinë civile, çka ka ndodhur edhe në Shqipëri. Në disa raste kjo sjell teatralizëm, ashtu si kur mbartësit e saj, personalitetet e spikatura të shoqërisë civile, alternohen herë këtu e herë në politikë, kur nuk lëvizin në parametra koherentë dhe transparentë, veniten shpejt dhe hedhin ide absurde, si "përtej së majtës dhe së djathtës", duke ofenduar, në radhë të parë, përfaqësuesit e forcave të tyre politike.

Agjencia për mbështetjen e shoqërisë civile, që lind si detyrim i këtij ligji (nenet 2, 4 në ligj), me misionin e saj themelor për nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë civile dhe krijimin e kushteve të favorshme për nisma civile në të mirë dhe në interes të publikut, mendoj se do të shërbejë si një ent i mirë në ushtrimin e politikave publike dhe të kujdestarisë së shtetit dhe si një ndihmesë e vlefshme që shoqëria civile në Shqipëri, si civilizim dhe moral, të vazhdojë të ecë në rrugën e progresit, duke e parë edhe si zhvillim, edhe si detyrë e rëndësishme e integrimit evropian dhe edukimit me parimet dhe normat e globalizmit. A duhet të kemi ne kujdes me kalimin e këtij ligji? A duhet të ketë kujdes Bordi Mbikëqyrës i Agjencisë, drejtori ekzekutiv i saj dhe Qeveria, shqetësim, që në një formë e ngriti edhe kolegu Xhufi? Pa dyshim që po! Drejtuesit e agjencisë duhet të jenë të vëmendshëm të mos përkrahin OJF(organizata jofitimprurëse) të pavarura në dukje dhe të varura në realitet, shërbyese të Qeverisë apo të ndonjë formacioni politik, OJF të hapura në të shprehur dhe të penguara me qëllim në thënien e së vërtetës dhe të realitetit, OJF në dukje të çliruara nga buxheti i shtetit apo donatorë, por të nënshtruara e të mposhtura nga tundimi e interesi për të bërë pasuri e para me këto organizata jofitimprurëse, duke shfrytëzuar paratë që vijnë qoftë nga taksapaguesit shqiptarë, qoftë nga ata të huaj. Megjithatë, unë besoj te drejtuesit e kësaj agjencie që do të emërohen. Në mbyllje të këtij diskutimi për këtë projektligj, të cilin e rikonsideroj të rëndësishëm dhe të dobishëm për vendin, dëshiroj të kujtoj një thënie që një studiues i pasionuar, një politolog-sociolog shqiptar e ka në veprën e tij të plotë studimore për shoqërinë civile në Shqipëri. "Që nga udhëtimi i tij në shekullin e 19-të, në vitet 1831-1832, i riu aristokrat francez, Aleksi D. Tokvill shkoi në SHBA për të studiuar burgjet amerikane, por vuri re një shoqëri të re të njerëzve të lirë e të barabartë. Duke filluar nga Tokvilli e deri në ditët tona është folur e shkruar shumë për shoqërinë civile. Ajo konsiderohet si

element thelbësor i qytetërimit perëndimor dhe bazë e një shoqërie që vendos hapësira lirie mes qeverive dhe qytetarëve". Citimi është nga studimi i Gëzim Tushit: "Shoqëria Civile".Dhe së fundi, në rast se shikohet e arsyeshme nga komisioni dhe nga hartuesit e saj, në nenin 3 te pika 3 e projektligjit në fjalë, kur flasim për misionin dhe objektivat e agjencisë: "në ushtrimin e veprimtarisë agjencia udhëhiqet nga përparësitë strategjike të Qeverisë për zhvillimin e shoqërisë civile", mendoj që do të ishte më e plotë në rast se do të përcaktojmë: "përparësitë strategjike kombëtare për zhvillimin e shoqërisë civile". Përparësitë strategjike kombëtare për zhvillimin e shoqërisë civile përfshin edhe përparësitë e Qeverisë. Gjithsesi, kjo ngelet në seancë për t'u votuar.

Diskutimi u botua në gazetën Rilindja Demokratike, dt. 13.03.2009 me titullin "Nxitje për zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë civile".

Shënim: *Nga Raporti i Legjislacionit i cili paraqet një përmbledhje të veprimtarisë ligjvënëse për këtë legjislaturë, veçojmë:*

"Ligj nr. 10093, datë 09.03.2009 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile".

Data e hyrjes në Kuvend 22.01.2009
Nismë e KM
Komisionet parlamentare që kanë shqyrtuar:
Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.
Shqyrtimi në seancë plenare: 09.03.2009
Ligji është miratuar me 73 vota pro, 6 kundër, 19 abstenime.
Shumica e kërkuar: e thjeshtë

Ligji propozon krijimin e një Agjencie si ent publik qendror, buxhetor, misioni i së cilës është mbështetja e nismave të shoqërisë civile në përputhje me përparësitë e programeve/strategjive të institucioneve publike.

Ligji përcakton si "autoritete financuese" Agjencinë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile dhe çdo ent tjetër publik, që do të japë fonde në formë granti, për mbështetjen e nismave të shoqërisë civile, për tu dhënë mundësi ligjore agjencive, qendrore dhe vendore, për të planifikuar dhënien e granteve. Ligji përcakton edhe parimet e përzgjedhjes të cilat janë:

Liria e pjesëmarrjes, mosdiskriminimi, transparenca, përputhshmëria me objektivat dhe efektiviteti në përdorimin e grantit, bashkëfinancimi, paanshmëria, mungesa e prapaveprimit, mënjanimi i mbivendosjes me financime paralele etj.

I. 37. Pallati i Kulturës – tërësisht për Bibliotekën Kombëtare dhe Teatrin e Operës

Diskutim në seancë plenare mbi projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004, "Për kthimin dhe kompensimin e pronës" të ndryshuar".

Tiranë, datë 21.03.2009

Sikurse shihet në këto ndryshime, që parashikon projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004, "Për kthimin dhe kompensimin e pronës" të ndryshuar", konkretisht, në shtesën e nenit 8/2 dhe në ndryshimin e nenit 23, në relacionin shoqërues të Këshillit të Ministrave apo dhe në shpjegimet profesionale që përfaqësuesit e Ministrisë së Ekonomisë dhanë në Komisionin e Ekonomisë, në projektligj nuk kemi vetëm rregullimin e marrëdhënieve me shoqëritë tregtare të krijuara në fillim të viteve '90, kur ekonomia shqiptare ishte nisur drejt ekonomisë së tregut, për faktin se shteti në atë moment e ka dhënë tokën në përdorim të këtyre kompanive. Duhet theksuar se edhe vetë shteti nuk ka pasur dhe nuk e ka shumicën e kapitalit, por ka një iniciativë ligjore të dobishme që, duke marrë shkas nga kërkesat e ish-pronarëve, ofron një zgjidhje që nuk çon drejt konflikteve gjyqësore, por rregullon, në radhë të parë, të drejtën kushtetuese të ish-pronarëve për të marrë në zotërim ish-pronat e tyre ose për të marrë kompensim financiar për to.

Unë mendoj se ky ndryshim ligjor, megjithëse është për rreth 100 shoqëri të tilla të krijuara në Shqipëri me kapital privat, kryesisht të huaj dhe shtetëror, është një përpjekje nxitëse për aktivizimin e plotë të këtyre kapitaleve që, në mënyrë figurative, në gjendjen e sotme, mund t'i quajmë edhe kapitale të vdekura ose të fjetura.

Vetë raportet e deritanishme në këto shoqëri, raportet ndërmjet aksionerëve të tyre apo pronarëve të vjetër, që me të drejtë pretendojnë për pronësi, ka sjellë situata apo bllokime, të cilat mund t'i karakterizojmë sipas një konstatimi të përgjithshëm të profesorit

të këtyre problemeve Hernando de Soto te "Misteri i Kapitalit". Ai shkruan: "Në këto raste apo në raste të tjera të ngjashme, si rezultat, ndërtesat dhe tokat nuk mund të përdoren për të garantuar kreditë dhe kontratat. Pronësia e një biznesi nuk mund të ndahet dhe të paraqitet në pjesë, të cilat mund të blihen nga investitorë të ndryshëm, pa ligje dhe institucione. Kapitali, në vetvete, e ka të pamundur të rikrijojë mirëqenie dhe pasuri, pasi instrumentet që shërbejnë për të depozituar dhe transferuar vlerën, janë të gjitha të përcaktuara nga arkitektura e marrëdhënieve ligjore, mbi të cilat është ndërtuar një sistem pronësie", përfundon De Soto.

E përmenda këtë për të thënë se edhe në fushën e ekonomisë gjërat e mençura janë thënë nga të tjerët më parë. Ne thjesht përshtatim. Të gjithë ne, pavarësisht ngjyresave politike, duhet të kuptojmë se legjislacioni për evidentimin dhe inkurajimin e vënies në lëvizje të bizneseve, përfshirë edhe pasuritë e paluajtshme, është thelbësor për prosperitetin e vendit, zhvillimin e ekonomisë dhe rritjen ekonomike. Edhe në ekonomi si kjo e jona, me 10 apo 15 vjet ekzistencë, ne duhet të zgjerojmë mundësitë për rritje, duke kaluar nga një karakter statik i pronës, që dokumenton një kapital të fjetur, në një aspekt dinamik të pronësisë së këtyre shoqërive, çka vendoset drejtpërdrejt në funksion të rritjes ekonomike, e theksuar kjo dyfish si kërkesë në situatën e vështirë që po kalon ekonomia globale.

Qeveria, e qartë në strategjinë e vet politike, në zhvillimin e reformave, duke identifikuar një problem, përpiqet ta kurojë atë, duke identifikuar një kontratë sociale pronësie të vendosur që në vitet 1992-1995, kur baza ligjore nuk ishte kaq e detajuar sa sot. Qeveria e integron këtë problem në një maksimizim të dobishëm për të gjithë, si për ata që kanë krijuar SHPK-të në këto vite, ashtu edhe për ish-pronarët e vjetër, përmes kompensimit të tyre fizik apo monetar.

Te ne, çështja e së drejtës së pronës nuk është vetëm problem madhor kushtetues, por është edhe problem politik e financiar apo moral dhe shtet-ndërtues. Për mendimin tim, nordi i veprimet tona, si një maxhorancë e qendrës së djathtë apo edhe e qendrës, duhet të jetë njohja, kthimi dhe kompensimi i pronave ish–pronarëve. Pra, zgjidhja e problematikës së krijuar gjatë së kaluarës komuniste. Nuk bëhet fjalë që të ngatërrohet periudha para viteve '90, me vitet 1992-1993, e cila rezulton ende e pazgjidhur në tranzicionin e sotëm, nga dashakeqësia ndaj pronës dhe pronarëve të vjetër, apo nga mosdija dhe vendosja e kësaj prone në funksion të zhvillimit të kapitalit dhe të ekonomisë së tregut.

Problemet e pronësisë duhet të zgjidhen në dobi të dinamizmit të ekonomisë, mbi bazën e respektit ligjor për ish-pronarët e vjetër

dhe jo në aspektin e pragmatizmit elektoral apo premtimeve të pambajtura, siç ka ndodhur rëndom deri më sot. Ato duhet të shihen si një nevojë jetike për të tashmen dhe të ardhmen e ekonomisë sonë drejt ringjalljes e aktivizimit të kapitaleve të fjetura.

Ne jemi të ndërgjegjshëm që në problematikën e gjerë të këtij procesi, mungesa e një sistemi administrimi të pronës shtetërore apo private me shumë pretendentë, të ligjshëm apo të paligjshëm, të vjetër apo të rinj, ka sjellë një degradim dhe mosvlerësim të pronës së paluajtshme. Vetëm një sistem i përgjegjshëm dhe operativ i pasurive të paluajtshme, sinergjizimi i kapitalit dhe tokës nga njëra anë, dhe punës nga ana tjetër, garantojnë një rritje ekonomike për të gjithë, mbështetur mbi një ekonomi funksionale dhe të qëndrueshme tregu.

Edhe unë bashkohem me shqetësimet e sinqerta që Qeveria dhe agjencitë që varen prej saj duhet të bëjnë më shumë për të pasur një zgjidhje racionale të kthimit të pronës tek i zoti dhe jo trajtime të fragmentizuara të këtij problemi madhor social, politik, ekonomik, moral dhe kombëtar.

Në mbyllje të këtij diskutimi, të cilin për hir të së vërtetës, jam përpjekur ta nxjerr atë jashtë çdo kornize politike, përfitoj nga rasti të theksoj se, Qeveria duhet të tregohet e kujdesshme që të gjitha ambientet e Pallatit të Kulturës (ku për fatin tonë ironik apo jo, tullën e parë të tije e ka vënë Nikita Hrushovi), të jenë në dispozicion të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë dhe të Teatrit të Operës dhe Baletit. Pra, kjo paketë ligjore duhet t'i bëjë Qeverinë, Ministrinë e Ekonomisë dhe ministritë e tjera që kanë lidhje me këtë problem, të ndërgjegjshme që të gjitha hapësirat e këtij institucioni të jenë në dobi të këtyre dy institucioneve të rëndësishme të kulturës kombëtare.

Shënim 1: *Nga Raporti i Legjislacionit. I cili paraqet një përmbledhje të veprimtarisë ligjvënëse për këtë legjislaturë, veçojmë:*

"Ligji nr. 10095, datë 12.03.2009 "Për disa shtesa në ligjin nr. 9235, datë 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës" të ndryshuar".

Data e hyrjes në Kuvend 17.02.2009

Nismë e KM

Komisionet parlamentare që kanë shqyrtuar:

Komisioni për Çështjet Kushtetuese dhe Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut;

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Shqyrtimi në seancë plenare: 12.03.2009

Ligji është miratuar me 63 vota pro, 41 kundër, 2 abstenime.

Shumica e kërkuar: e thjeshtë

Ligji synon të rregullojë një marrëdhënie e cila u referohet kompanive të përbashkëta me kapital shtetëror dhe privat, të krijuara gjatë viteve të para të zhvillimit të ekonomisë së tregut. Në këtë periudhë për shkak të mungesës së legjislacionit të qartë dhe përvojës u zhvilluan kompani ku zhvillimi i veprimtarisë së tyre kishte nevojë të sqarohej dhe të vihej mbi baza të rregullta ligjore. Këto deri përpara miratimit të këtij ligji kontrolloheshin nga investitorë privatë. Në pjesën më të madhe tokat nuk ishin në pronësi të kompanive por në përdorim. Por duke mos pasur tokën në pronësi kompanitë në një farë mase pengoheshin për ta zhvilluar më tej biznesin e tyre për shkak të pasigurisë që krijonte kjo gjendje.

<u>Shënim 2:</u> Është për të ardhur keq që nga ky ligj pavarësisht qëllimeve të mira dhe hapësirave pozitive por biznesit, përfituan edhe njerëz të pandershëm, grabitës të pronave publike ose private.

I. 38. Të shpejtohen ritmet e dëmshpërblimit të ish të përndjekurve politikë

Diskutimi në seancë plenare mbi projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin "Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve nga regjimi komunist"

Tiranë, datë 02.04.2009

Në mos gaboj, e kam përmendur në këtë sallë thënien e Weberit: "Politika bëhet me kokë dhe jo me pjesët e tjera të trupit dhe të shpirtit". Zotërinj socialistë, një pjesë juaja në disa diskutime që mbajnë këtu në Parlament, më ngjajnë shumë të zinj, tmerrësisht të zinj, kur trajtohen tema të tilla. Më 12 nëntor të vitit 2007 ne diskutuam dhe votuam ligjin nr. 9831, datë 12.11 2007 "Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist", me objekt përcaktimin e përfituesve, masës, kritereve dhe procedurës së përfitimit të dëmshpërblimit financiar për ish të dënuarit politikë, të cilët kanë vuajtur persekutimin e drejtpërdrejtë në regjimin komunist nëpërmjet kryerjes së dënimeve penale të padrejta si pasojë e vendimeve penale të gjykatave të zakonshme, gjykatave speciale apo urdhrave të paligjshëm të organeve të hetuesisë gjatë periudhës 30.11.1944 - 01.10.1991. Objektivi i ligjit në fjalë ishte dhe është dëmshpërblimi i familjarëve të viktimave të ekzekutuara apo të pushkatuara me dhe pa gjyq. Qëllimi i ligjit është dhënia e dëmshpërblimit financiar si një angazhim i shtetit demokratik në dënimin e krimeve të regjimit totalitar komunist, për të cilat sot e 19 vjet të gjithë ne thurim retorika. Iniciativa legjislative për plotësimin e ligjit në fjalë e deputetit të Shkodrës zotit Astrit Bushati, e iniciuar nga Kryetarja e Kuvendit, zonja Topalli, të dy deputetë të nderuar të Shkodrës, është për t'u përshëndetur moralisht, juridikisht dhe politikisht. Më mirë se këtyre deputetëve nuk i takonte kujt tjetër. Interpretimi logjik dhe sistematik i ligjit "Për dëmshpërblimin financiar" ka si zanafillë nenin 44 të Kushtetutës, ku thuhet: "Kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose të zhdëmtohet në përputhje

me ligjin, në rast se është dënuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore". Me këtë ligj bazë dhe me këto ndryshime të nevojshme ne plotësojmë përpjekjet tona jo thjesht për të dëmshpërblyer financiarisht këtë shtresë fisnike, çka është plotësisht e drejtë dhe e ligjshme, por mbi të gjitha dëshmojmë respektin tonë për shtetin e së drejtës që ne po ndërtojmë, duke garantuar në këtë mënyrë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Një interpretim në historinë e afërme në kohë na sjell në vëmendje ligjin nr 7514, datë 30.09.1991 i ashtuquajturi ligji për pafajësinë e kësaj kategorie të Kuvendit të parë pluralist të Shqipërisë, i cili në nenin 1 thoshte: "Janë të pafajshëm dhe quhen të padënuar për efekte moshe, politike, sociale dhe ekonomike të gjithë personat që janë dënuar për agjitacion e propagandë kundër shtetit, arratisje, sabotim, pjesëmarrje në organizatat politike etj". Në këtë kohë, pra në vitin 1991 paraardhësit tuaj, të nderuar zotërinj socialistë, nuk kishin as guximin dhe as kurajën ta kundërshtonin këtë ligj. Neni 18 i Kushtetutës dhe neni 57 i Kodit Penal janë burimet e së drejtës për dëmshpërblimin e ish të përndjekurve politikë, të parashikuar në ligjin aktual apo edhe në plotësimet që do të votohen sot. Ndryshimet e kërkuara forcojnë akoma më tepër dy parimet bazë të logjikës së ndërtimit të këtij ligji, pra parimin e drejtësisë dhe atë të barazisë. Personalisht, duke kaluar tek afatet dhe te shqetësimet që u shprehën edhe në pyetjet tuaja, do ta mbështesja dhe e mbështes idenë, jam i bindur se do të vijë koha kur kjo do të kalojë edhe në Parlamentin e ardhshëm, që ligji të përfshinte periudhën nga 2 gushti i vitit 1943 deri në tetor të vitit 1991 dhe jo siç është tani, nga 30 nëntori i vitit 1944. Këtë po e theksoj këtu në respekt të atyre që na dëgjojnë, për arsye se të gjithë ju, të nderuar kolegë të pozitës dhe të opozitës, duhet ta kuptoni se prishja e Marrëveshjes së Mukjes e gushtit të vitit 1943 solli luftë civile në Shqipëri, solli goditje politike nga komunistët që e kthyen Luftën Nacionalçlirimtare në luftë civile.

Kjo është një ndër kërkesat e bëra edhe nga Shoqata Kombëtare e Trashëgimtarëve të të Pushkatuarve Politikë të Shqipërisë, meqenëse rrallëherë amatorë të historisë, politikanë të pjekur apo të papjekur, të majtë apo të djathtë, komunistë apo socialistë, të maskuar apo të pamaskuar shprehen për këtë periudhë të historisë. E kam në nderin të tim të pohoj se prishja e njëanshme e Marrëveshjes së Mukjes nga Enver Hoxha, nën urdhrat e serbëve Popoviç, Dushan Mugosha dhe Tempo, ishte akti i madh i tradhtisë kombëtare dhe i vrasjeve politike komuniste që ju edhe sot në vitin 2009 nuk e keni kuptuar. Historiani i nderuar Uran Butka do të

shprehej: "U zhbë një marrëveshje, një besë kombëtare; u prish një institucion themelor i qëndresës". Mund t'ju citoja edhe një thënie të Popoviçit, kur e grisi atë në fytyrë të Enver Hoxhës dhe ju këtë e dini më mirë se unë, zotërinj të së majtës, por nuk doni ta pranoni. Megjithatë, kalojmë te plotësimet e ligjit në fjalë. Dëmshpërblimi financiar dhe plotësimet e sotme janë një faturë financiare jo vetëm e përballueshme prej shtetit shqiptar, por edhe një detyrim, plotësimi i së cilës e nderon shtetin e së drejtës që ne po ndërtojmë, për faktin e pamohueshëm se mbi këtë faturë dëmshpërblimi rëndojnë disa tonelata gjak, mijëra vite burg dhe vuajtje pa fund të antikomunistëve natyralë shqiptarë të viteve 1944-1991. E parë nga një aspekt tjetër, kjo është një faturë e balancuar nga mijëra hektarë tokë të thara, nga kënetat e moçalet, nga qindra vepra industriale të ndërtuara, nga mijëra apartamente banimi, nga miliona tonë minerale të nxjerra nga ish të burgosurit politikë në Shqipëri dhe shumë e shumë vlera materiale, morale dhe kulturore të prodhuara prej tyre në këto vite. Këto vlera natyrshëm kanë kërkuar dhe kërkojnë drejtësi dhe paqe sociale. Unë këtu kam të dhëna edhe nga Shoqatat e të Përndjekurve Politikë, por më lejoni të rikujtoj ligjin nr. 7514 të 30 shtatorit 1991, ku në nenin 5 të tij thuhet se personave që përfitojnë nga neni 1 u njihen të drejtat e kompensimit për të gjitha dëmet e shkaktuara. Ndërsa ligji nr. 7598 i 1 shtatorit të vitit 1992 "Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish të dënuarit dhe ish të përndjekurit politikë" parashikonte të krijohej një fond monetar, i cili, çuditërisht, në vitin 1997 u zhbë si ligj, ashtu si shumë e shumë ligje apo vendime Qeverie që janë harruar dhe nuk u zbatuan nga qeverisja socialiste në vitet 1997-2005, prandaj për këtë arsye edhe ky problem është mbartur. Këto ligje nuk u zbatuan për arsye se juve ju errnin sytë, ishin hartuar nga ish-Presidenti Berisha, nga ish-Kryeministri Meksi dhe nga pjesa tjetër e maxhorancës së djathtë demokratike në ato vite. Ligji dhe plotësimet e tij, përveç të tjerash, garantojnë edhe një nga elementet esenciale të parimit të shtetit të së drejtës, siç është ai i sigurisë juridike, që në vetvete kërkon përmbajtje të qartë e të kuptueshme, megjithëse ai i përcakton qartë subjektet që u drejtohet. Në raportet e caktuara të institucioneve të ndryshme, ne duhet të ishim treguar më të kujdesshëm me atë procedurë herë-herë rraskapitëse, që u vendosëm ish të përndjekurve politikë apo familjarëve të tyre për të plotësuar dosjen e dëmshpërblimit, ne mund dhe duhet ta kishim mënjanuar idenë e informacionit të kryqëzuar. Ministri i Drejtësisë e ka për detyrë të vazhdojë ta ndjekë akoma më thellë këtë problem. Ky ligj, përveç sigurisë juridike, plotëson edhe elemente të tjera të shtetit të së drejtës si:

mbrojtja nga arbitrariteti shtetëror dhe garantimi i lirisë e barazisë së të drejtave përmes ligjit. Nga këndvështrimi i interesave të qytetarëve, përfitues të këtij ligji, organizimi dhe bashkërendimi i institucioneve të ndryshme të administratës do të thotë qartësi dhe ndarje të kompetencave e përgjegjësive në shtet, ku përfshihet edhe sistemimi i dokumentacionit të nevojshëm, që konfirmon dënimet e mëparshme politike dhe garanton një dëmshpërblim të drejtë të tyre pa i lodhur ata fizikisht. Në këtë kontekst shtohet edhe propozimi që paraqet Ministri i Financave, zoti Bode, që është për t'u përgëzuar për këtë propozim në cilësinë e deputetit të këtij Parlamenti. Vetëm kështu administrata mund të bëhet më e kapshme dhe më e vlefshme për individët, me qëllim që ajo t'i zgjidhë sa më shpejt dhe sa më mirë problemet dhe shqetësimet e tyre në vendin dhe në kohën e duhur.

Personalisht, mua ma vret veshin dhe syrin fakti që në harkun kohor të një viti janë përfunduar shumë pak, rreth 1400 dosje të gatshme, që personat e interesuar të marrin dëmshpërblim dhe i bie që të jenë rreth 4 dosje në ditë. Administrata e Ministrisë së Drejtësisë duhet të punojë shumë shpejt dhe me korrektësi me këta qytetarë jo me këtë ritëm, ritëm i dobët

Shënim: *Nga Raporti i Legjislacionit i cili paraqet një përmbledhje të veprimtarisë ligjvënëse për këtë legjislaturë, veçojmë:*

"Ligji nr. 10111, datë 02.04.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9831, datë 12.11.2007 "Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve nga regjimi komunist". *Data e hyrjes në Kuvend 15.01.2009*

Nismë e KM

Komisionet parlamentare që kanë shqyrtuar: Komisioni për Çështjet Kushtetuese dhe Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut;

Shqyrtimi në seancë plenare: 02.04.2009

Ligji është miratuar me 71 vota pro, 30 kundër, 1 abstenime.

Shumica e kërkuar: e thjeshtë

Ligji bën një plotësim të ligjit ekzistues pasi zgjidh problemet që kanë dalë për shkak të kufizimeve për disa kategori personash të persekutuar nga regjimi komunist dhe të dënuar nga ligjet speciale të vitit 1945 dhe 1946. Ligji u mundëson familjarëve të personave të dënuar apo pushkatuar që nuk kanë qenë të martuar për të përfituar nga ky ligj. Duhet theksuar se këta familjarë, pavarësisht nga persekutimi I veçantë që kanë pësuar për këtë shkak dhe përkujdesja e posaçme për të afërmit e tyre të pamartuar gjatë gjithë periudhës të persekucionit të tyre nga regjimi komunist nuk kanë përfituar nga ligji i miratuar në vitin 2007.

I.39. Të jemi seriozë me historinë

(Replikë në sallën e Kuvendit me deputetin Pandeli Majko)

Është për të ardhur keq që ne e fillojmë fushatën politike tre muaj para. Është për të ardhur keq që edhe politikanë seriozë apo individë të ndershëm, të përgjegjshëm, që kanë drejtuar edhe lëvizjen studentore në vitin '90, si zoti Majko, flasin në komisionet parlamentare me gjuhën e kriminelit Kristo Themelko, të vitit '44. Zoti Majko, miqësisht, (nuk kam asgjë me ju, përveçse respektit, pavarësisht antipatisë së thellë që më keni lënë këto ditë, për çka kemi deklaruar), do t'ju sugjeroja që, përveç veprave të kriminelëve Enver Hoxha, Mehmet Shehut, Kristo Themelko apo të ndonjë agjenti të vjetër serb, që del ndoshta dhe në ndonjë media, të lexoni edhe libra që flasin për nacionalizmin. Lexoni Uran Butkën, Mit'hat Frashërin, lexoni për ato krime që Shulja juaj bënte në tetor-nëntor të vitit '44 në Tiranë, kur shkatërronte inteligjencën tiranase. (Seancë parlamentare - 21 mars 2009).

E kam në nderin të tim të pohoj se prishja e njëanshme e Marrëveshjes së Mukjes nga Enver Hoxha, nën urdhrat e serbëve Popoviç, Dushan Mugosha dhe Tempo, ishte akti i madh i tradhtisë kombëtare dhe i vrasjeve politike komuniste që ju edhe sot në vitin 2009 nuk e keni kuptuar. Historiani i nderuar Uran Butka do të shprehej: "U zhbë një marrëveshje, një besë kombëtare; u prish një institucion themelor i qëndresës". Mund t'ju citoja edhe një thënie të Popoviçit, kur e grisi atë në fytyrë të Enver Hoxhës dhe ju këtë e dini më mirë se unë, zotërinj të së majtës, por nuk doni ta pranoni. (Seancë parlamentare - 2 prill 2009).

I nderuar zoti Majko, ish-Kryeministër i Qeverisë së Shqipërisë, kur flet për periudhën 1939-1944, duhet të ndash veprimtarinë e atyre që ishin në qeveri, në bashkëpunim me pushtuesin nga ata që themeluan organizatën patriotike të Ballit Kombëtar, e cila është krijuar në vitin 1939. Sa për ato fakte që më përmende ti, harrove që në muajt e fundit pushtuesit gjermanë në Vlorë kanë pushkatuar Skënder Muçon, avokatin Skënder Muço, anëtar i Komitetit Qëndror

të Ballit Kombëtar. Komandati i forcave të Ballit në Jug, Hysni Lepenica është vrarë në Grëhot të Gjirokastrës në vitin 1943, është spiunuar dhe futur në kurth nga Bedri Spahiu dhe nga shokët e tjerë të tij, paraardhësit e tu. Unë mund të vazhdoj këtu me fakte historike edhe për atë që tregove ti për prillin, pasi nuk mban mend as emrat e të ashtuquajturve dëshmorë dhe heronj, por insistoj që të mos e kthejmë në seancë me deklamime false nga ju. Duhet të kuptojmë ndarjen me thikë që solli prishja e Marrëveshjes së Mukjes. Luftën civile në Vlorë e ka drejtuar Dushan Mugosha me pseudonimin "Çalamani" dhe kriminelja Liri Gega, që futën djemtë dhe burrat e Vlorës së asaj kohe në vëllavrasje. Luftën e famshme të Gjormit, të Drashovicës, në 1943 dhe beteja të tjera antifashiste në Vlorë, i kanë drejtuar Hysni Kapo dhe Hysni Lepenica. Ka shumë e shumë ngjarje të tjera, për të cilat unë mund të flas këtu, por koha dhe vendi nuk ma lejon, edhe për ta mbyllur këtë replikë të shkurtër, e për të qeshur edhe gazetarët e rinj, duhet të dish, zoti Majko, se Vlora "u çlirua" nga forcat partizane kur gjermanët kishin ikur në Fier.

I. 40. Rritje e ndjeshme e nivelit të sigurimit bankar

Diskutimi në seancë plenare mbi projektligjin "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin "Për sigurimin e depozitave""

Tiranë, datë 30.03.2009

Ndryshimet dhe shtesat e propozuara në ligjin "Për sigurimin e depozitave" përbëjnë një hap të kujdesshëm, të hedhur në momentin e duhur. Dua të theksoj se ky ligj është një hap normal që hidhet jo për shkak të krizës bankare që ka kapur vendet evropiane dhe SHBA-në, por në zbatim të angazhimeve që Shqipëria ka ndaj partnerëve të saj evropianë, angazhime këto të marra në Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit, të nënshkruar mes Shqipërisë dhe BE-së. Shtytja para që projekti i bën përmbushjes së detyrimeve të Shqipërisë drejt BE-së është, përpos të tjerave, një dëshmi e stabilitetit financiar që vendi ynë ka arritur të ruajë në këtë situatë krize, në këtë destabilitet që ka kapur financat globale në përgjithësi dhe në rajon. Diskutimi i këtij projektligji dhe sjellja e tij në Kuvend janë produkt i bashkëpunimit dhe i respektimit nga ana e Qeverisë dhe e komisionit parlamentar të kërkesave dhe sugjerimeve të Bankës së Shqipërisë, ekspertëve dhe institucioneve ndërkombëtare. Janë për t'u përmendur vlerësimet e ekspertëve të opozitës, të medias dhe të analistëve ndaj këtij projekti, dëshmi këto të përparësive që ky projekt sjell në sistemin bankar.

Miratimi i këtij projektligji forcon ndjeshëm pozitat e ASD-së qoftë nga ana institucionale, qoftë nga ana financiare. Kjo mundëson kthimin e këtij institucioni në një aktor me peshë të shtuar në mbikëqyrjen e veprimtarisë bankare jo vetëm në situata vështirësish, por mbi të gjitha në kushtet normale të zhvillimit të veprimtarisë bankare në Shqipëri. Ky ligj rrit ndjeshëm kompetencat e Këshillit Drejtues të ASD-së, si dhe njëkohësisht rrit mbrojtjen ligjore të anëtarëve të saj, duke rritur në këtë mënyrë edhe pavarësinë e këtij institucioni në marrjen e vendimeve, derivim ky edhe nga neni 22 i ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" që konfirmon

se "ASD siguron që bankat kanë plotësuar kushtin e sigurimit të depozitave".

Rritja e ndjeshme e nivelit maksimal të sigurimit nga 700 mijë lekë në 2.5 milionë lekë është një domosdoshmëri që buron nga evoluimi i tregut bankar shqiptar që prej vitit 2002 kur ka dalë ligji "Për sigurimin e depozitave". Kjo masë më e lartë ofron garanci për një numër më të madh depozituesish dhe përfitime për një nivel më të lartë depozite. Me rritjen e këtij kufiri Shqipëria është konform direktivave të BE-së dhe mendoj se ky është një hap i ndërmjetëm për një rritje të mëtejshme të këtij kufiri në të ardhmen duke u përshtatur kështu plotësisht me nivelet e sigurimit që sugjerojnë direktivat e BE-së. Rikujtoj këtu që, sipas direktivave të BE-së, në dhjetor të vitit 2010 niveli maksimal i depozitave të siguruara në bankat e BE-së kërkohet të jetë ndjeshëm më i lartë.

Eliminimin e bashkësigurimit, pra sigurimin në masën 100% të depozitave e vlerësoj si një hap i cili jo vetëm përshtat ligjin shqiptar me direktivat e Bashkimit Evropian, por rrit edhe efektshmërinë e ligjit në tregun bankar. Sigurimi i plotë (100%), për depozitat nën 2.500.000 lekë të rinj, e bën më të qartë për depozituesit nivelin e garancisë. Kjo përbën avantazh krahasuar me skemën e deritanishme. Edhe pse sigurimi i depozitave në bankat shqiptare ka hyrë në fuqi që prej vitit 2002, pjesa dërrmuese e depozituesve nuk e kanë pasur të qartë nivelin e depozitave që u garantoheshin nga ASD-ja. Një garanci në masën 100% nuk ka nevojë për llogaritje dhe i bën më të qartë depozituesit për shumat që kanë të garantuara. Kjo, përveç garancisë më të madhe nga pikëpamja financiare, ofron edhe një qetësi psikologjike për depozituesit dhe nuk lë shteg që informacione abuzive të dëmtojnë tregun bankar.

Në përparësitë e këtij projektligji, në formën e tij fillestare, do të veçoja përfshirjen e SHKK-ve (Shoqërive të Kursim-Kreditit) dhe Unioneve të Kreditit në skemën e sigurimit. Kjo do të garantonte:

1. Sistem financiar të qëndrueshëm.
2. Mbrojtje të kursimeve të çdo shtetasi.

Por, meqenëse pas kërkesës së Bankës të Shqipërisë sigurimi i depozitave në këto institucione u përjashtua, atëherë më mbetet të propozoj përfshirjen e kësaj fryme që ky projektligj sjell në projektligjin e ri që Banka e Shqipërisë ka paralajmëruar se do të hartojë për SHKK-të dhe Unionet e Kreditit. Në këtë pikë do të jepja disa rekomandime që i gjykoj se janë të vlefshme të merren në shqyrtim gjatë hartimit të projektligjit:

Së pari, është e nevojshme që statusi dhe detyrimet e SHKK-ve të shqyrtohen në mënyrë të tillë që të ofrojnë siguri për depozituesit

e tyre. Duhet të kemi parasysh faktin që nga këndvështrimi i qytetarëve, depozitat janë të njëjta si kur i çojnë në një bankë, ashtu dhe kur i derdhin në një SHKK. Për më shumë, duke iu referuar praktikave të funksionimit të SHKK-ve, sipas të cilave depozitat e anëtarëve të tyre grumbullohen në një llogari bankare, kjo krijon perceptim të njëjtë për qytetarët si për depozitat në SHKK edhe për depozitat bankare. Një diferencim në nivelin e sigurisë për anëtarët e SHKK-ve do të krijonte një ndjenjë diferencimi, e cila ndikon negativisht në funksionimin e këtyre institucioneve.

Së dyti, Banka e Shqipërisë, si mbikëqyrëse e tregu bankar, e tregut të depozitave dhe e tregut të huas në përgjithësi, duhet të krijojë kushte të njëjta funksionimi duke ofruar barazi për institucionet që veprojnë në të njëjtin segment tregu.

Së treti, duhet të kryhet paraprakisht një studim i kushteve të funksionimit të SHKK-ve, në mënyrë që funksionimi i tyre të jetë më pranë përcaktimit ligjor. Këtu u referohem edhe favorizimeve që drejtuesit e SHKK-ve mund të krijojnë për anëtarë të veçantë të saj, duke bërë që përfitimet të jenë të ndryshme për anëtarë me kontribute të njëjta.

Së katërti, të marrë për bazë rekomandimet e ekspertëve të FSVC, të cilët sugjeruan përfshirjen e SHKK-ve në skemën e sigurimit të depozitave. Argumentet që kanë mbështetur sugjerimet e këtyre ekspertëve duhet të merren në konsideratë, me qëllim përcjelljen e frymës së këtyre ndryshimeve ligjore edhe në veprimtarinë e SHKK-ve. Forumi i Stabilitetit Financiar (Mbledhja e G7, prill 2008) ka theksuar se "Është e domosdoshme për t'u riparë marrëveshjet ndërinstitucionale për sigurimin e depozitave".

Shënim: *Nga Raporti i Legjislacionit, i cili paraqet një përmbledhje të veprimtarisë ligjvënëse për këtë legjislaturë, veçojmë:*

"Ligji nr. 10106, datë 30.03.2009 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8873, datë 29.03.2002 "Për sigurimin e depozitave".

Data e hyrjes në Kuvend 19.03.2009
Nismë e KM
Komisionet parlamentare që kanë shqyrtuar
Komisioni për Ekonominë dhe Financat
Shqyrtimi në seancë plenare: 30.03.2009
Ligji është miratuar me: 92 vota pro, 0 kundër, 0 abstenime.
Shumica e kërkuar: e thjeshtë
Ndryshimet që propozohen synojnë përmirësimin e skemës së sigurimit të depozitave, në përputhje me zhvillimet financiare në vendin tonë që nga koha e miratimit të ligjit nr. 8873, datë 29.03.2009 harmonizimin e

legjislacionit tonë me direktivat e BE-së e kuadrin rregullator të përparuar të vendeve të tjera, si dhe respektimin e detyrimeve të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit.

Ligji do të ndikojë në forcimin e stabilitetit të sistemit bankar e financiar, rritjen e kredibilitetit të tij dhe mbrojtjen e kursimeve të shtetasve. Ai do të japë impakt në rritjen e nivelit të depozitave, reduktimin e nivelit të parasë që qarkullon jashtë sistemit bankar si dhe zvogëlimin e mundësisë së transferimit të parave për tu depozituar jashtë vendit.

I. 41. Privatizim, Efiçencë dhe Transparencë në tregun e Energjisë

Konturimi i Modelit Shqiptar të Tregut të Energjisë Elektrike

Diskutim mbi projekt-ligjin "Për miratimin e kontratës së shitjes së 76% të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (O.S.SH), SHA –së, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, së Republikës së Shqipërisë, dhe "ÇEZ", A.S –së"

Tiranë, datë 23.04. 2009

Privatizimi i ndërmarrjeve shtetërore është sigurisht objektivi i duhur i reformave ekonomike, por ai kërkon një shkallë të lartë aftësish institucionale për ta zbatuar si duhet, aftësi të cilat në rastin e privatizimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) shfaqen me efikasitet të plotë.

Milton Friedman, dekani i ekonomistëve të tregut të lirë, në vitet '90 për vendet që kryenin tranzicionin nga socializmi në kapitalizëm tha vetëm tre fjalë: "PRIVATIZONI, PRIVATIZONI, PRIVATIZONI".

Por e kisha gabim, shton ai në një intervistë ne vitin 2002 duke theksuar: "Doli se shteti ligjor është më i domosdoshëm se Privatizimi", e ky i sotmi, privatizimi në sektorin energjetikë të shpërndarjes është Privatizim në një Shtet Ligjor, Privatizim në transparencë të plotë, Privatizim në konsulencë të plotë me Institucione të rëndësishme financiare ndërkombëtare. Korporata Elektro-Energjetike Shqiptare, K.E.SH - u krijua me VKM nr. 340 datë 12.08.1992, si një ndërmarrje shtetërore me funksione të gjenerimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike si një strukturë vertikalisht e integruar. Në vitin 1995 në zbatim të ligjit "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare" dhe ligjit "Për energjinë elektrike" KESH-i kaloi në një shoqëri aksionere, aksionet e së cilës ishin 100% pronë e shtetit, pra filloi të funksiononte si një shoqëri tregtare në përputhje me legjislacionin e

shoqërive tregtare, si një operator i vetëm në sektorin e energjisë. Në dhjetor 2003 Qeveria krijoi Operatorin e Sistemit të Transmetimit (O.S.T), për menaxhimin dhe operimin e sistemit të transmetimit. Pra u nda O.S.T nga K.E.SH-i. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, O.S.SH është krijuar me VKM nr. 862 datë 20.12.2006 "Për krijimin e shoqërisë "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" sh.a. Tiranë" dhe funksionon prej afro dy vjetësh. Me ligjin nr. 9889 datë 20.03.2008 "Për përcaktimin e formës dhe strukturës së privatizimit" të O.S.SH", të miratuar në këtë Parlament, ne hodhëm një tjetër hap që lejonte/ detyronte Qeverinë të privatizonte O.S.SH (kuota aksionesh 51-76% me konsultimin e Bankës Botërore). Këto hapa, të finalizuara sot, përbëjnë dokumente serioz të angazhimit të Qeverisë përkundrejt obligimeve me direktivat e Bashkimit Evropian, MSA-së dhe Traktatin e Energjisë. Traktati i Athinës, firmosur në tetor 2005, që ka hyrë në fuqi në korrik 2006, inkurajon krijimin dhe integrimin e tregjeve te energjisë elektrike dhe të gazit në rajon (vendet e Evropës Jug-Lindore) nën Tregun e Brendshëm Energjetik të Komunitetit Evropian. Hapja e tregut të brendshëm të energjisë elektrike dhe pjesëmarrja aktive në tregun rajonal bazohet në Direktivën 54/2003 të BE-së. Ky privatizim i sotëm është pjesë thelbësore e prioriteteve që shtron vizioni i Strategjisë Kombëtare të Energjisë që ka si kryefjalë të saj: ristrukturimin e sistemit energjetik shqiptar, bazuar në parimet e ekonomisë së tregut dhe zhvillimin e një politike bashkëkohore energjetike. Privatizimi i sektorit të shpërndarjes si dhe inkurajimi i investimeve private në gjenerimin e energjisë elektrike janë dëshmi të pakontestueshme të suksesit të reformave në energjetikë. Metoda e privatizimit, përmes një procesi tenderimi ndërkombëtar dhe transparent, në bashkëpunim me Bankën Botërore, e cila e këshilloi privatizimin përmes Korporatës Financiare ndërkombëtare (I.F.C), (dhe kontribuoi si kompani ndërkombëtare vlerësimi KPMG), ishte një proces i hapur për publikun, ekspertët në veçanti, investitorët potencialë e më gjerë dhe që kaloi përmes një vështirësie të madhe, konstante në këto vite siç ishin humbjet e mëdha të Korporatës. Ky privatizim për konsumatorin shqiptar në të ardhmen përmirëson cilësinë dhe garanton siguri në furnizim të vazhdueshëm me energji elektrike, por për vetë kontributin në vlerë monetare 100 milion Euro (që Kompania "ÇEZ", A.S paguan në këtë blerje aksionesh) njëherësh nxit përfitimet për qytetarët shqiptarë e shërben si faktor plus për nxitjen e rritjes ekonomike në përgjithësi edhe përmes menaxhimit privat e teknologjisë moderne në këtë sektorë. Ekonomia shqiptare nuk mund të shkojë përpara pa zhvillimin e sektorit energjetik si një pjesë e rëndësishme e infrastrukturës.

Shitja e aksioneve në O.S.Sh, privatizimi i këtij shërbimi do krijojë oportunitete për futjen e burimeve të reja të kapitalit, menaxhimit bashkëkohor dhe teknologjisë moderne duke sjellë dhe përfitime dytësore përmes çlirimit të fondeve shtetërore për probleme të tjera zhvillimi, inkurajimi ekonomik. Ky sektor do të ecë krahas vendeve të rajonit, pasi me këtë strukturë aktuale ishte e pamundur që Shqipëria të ecte me të njëjtin hap me vendet e rajonit. Kur flas strukturë aktuale kam parasysh edhe legjislacionin përkatës. Privatizimi shpërndarjes të energjisë elektrike gjithashtu shërben si nxitës për tërheqjen e investimeve private në projekte gjeneruese të mëdha dhe të vogla si dhe do të integrojë më tej sistemin shqiptarë të energjisë në sistemet rajonale dhe evropiane, duke përmbushur dhe angazhimet që Shqipëria ka ndaj sistemit në tërësi, rrjedhojë e ratifikimit të Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

Humbjet në shpërndarje sipas E.R.E janë 2 miliardë në vit, nga të cilat mbi gjysmat janë humbje jo teknike. Privatizimi i O.S.SH do të implementojë indirekt dhe politikat e Qeverisë, që konsumatorët duhet dhe do të paguajnë për energjinë që ata konsumojnë, siç bën pjesa më e madhe qytetare sot. Asnjë prej qytetarëve dhe shoqëria në tërësi nuk përfitojnë prej atyre që vjedhin energjinë elektrike, as edhe këta të fundit vetë. Përkundrazi! Ne të gjithë, si subjekte privatë apo publikë, familjar apo tregtar kemi nevojë të plotësojmë detyrimet ndaj sistemit të ekonomisë së tregut, që kemi marrë përsipër të ndërtojmë dhe përmes, dhe patjetër të pagimit të plotë të kostove të drejta të shërbimeve të përdorura.

Mospagesa, vjedhjet e pjesshme dhe mungesa e luftës efektive ndaj tyre kanë inkurajuar korrupsionin në drejtues të veçantë të nivelit të ulët, të mesëm pse jo dhe të lartë të kompanive energjetike duke krijuar një percepsion për KESH-in, O.S.SH-në apo të tjera institucione të këtij lloji si institucione të korruptuara. Nuk mund të ecim drejt zhvillimit në energjetik e kudo në ekonomi me perceptim për kompani të tilla shtetërore, si kompani të korruptuara.

Vëmendje të veçantë Qeveria i ka kushtuar dhe duhet t'i kushtojë rakordimit të politikave të drejta për të balancuar shndërrimin e drejtë të sektorit energjetik të shpërndarjes e të prodhimit drejt privatizimit të suksesshëm e me rentabilitet teknik e ekonomik me mbrojtjen e interesave të qytetarëve, (gjë e cila është detyrë parësore e çdo qeverie).

Qeveria duhet, dhe unë kam besim për këtë, të zhvillojë politikën e zhvillimit të mekanizmave dhe kapaciteteve efektive rregullatore për të mbrojtur si të licencuarit në sektorin elektrik, ashtu edhe konsumatorët e energjisë elektrike. Gjithashtu është për tu

përshëndetur në këtë privatizim fakti i vëmendjes ndaj punonjësve aktualë të kompanisë për të zgjidhur çështjen e punësimit, gjatë ristrukturimit dhe transaksioneve ndërmjetëse të privatizimit.

Qeveria përjashtoi elementët që në mënyrë automatike mund të rëndonin mbi kurrizin e qytetarëve shqiptarë dhe kjo është merita e dytë e madhe e këtij privatizimi. Bazuar në vlerësimin e KPMG-së dhe që është i vetmi vlerësim që konkurrenca ndërkombëtare merr parasysh, kompania Çeke ka ofruar dyfishin e vlerës dhe është përjashtuar çdo element (përmes një viti negociatash me I.F.C) që të jepte një formulë privatizimi përmes përballimit nga qytetarët të këtij privatizimi, të këtij shërbimi, furnizimi jetik për popullsinë por debitor financiarisht për kompaninë shërbyese dhe shtetin deri më sot.

Me të drejtë Kryeministri ka përmendur, (më 29.10.2008), se: "Me privatizimin e KESH-it mbyllet seriali i privatizimeve të sipërmarrjeve të mëdha shtetërore, të cilat duhet ta pranojmë, kanë qënë të shndërruara në kompani thellësisht problematike në menaxhim dhe palcërisht të korruptuara. Duke i kaluar në pronësi e menaxhim privat, nuk ka mëdyshje se shërbimet ndaj qytetarëve shqiptarë përmirësohen ndjeshëm. Shërbimet që ofrojnë këto sipërmarrje janë shumë të rëndësishme dhe në mënyrë të padiskutueshme rritet eficensa dhe hapet plotësisht prespektiva e tyre për modernizim". Me këtë privatizim konturohet Modeli Shqiptar i Tregut të Energjisë Elektrike, i cili parashikon zhvillimin mbi baza më të konsoliduara të tregut të energjisë elektrik, dhe përputhshmëri më të plotë me Direktivat e BE-së. Pra tashmë tregu shqiptar paraqitet me këto tipare:

1. Nga një strukturë vertikale e integruar e sektorit elektro-energjetik, e ngurtë, 15 vjet më parë në një strukturë me veprimtari gjenerimi/transmetimi/ dhe shpërndarje/ligjërisht, funksionalisht dhe financiarisht të ndara.

2. Konkretizimi i privatizimit të sektorit të shpërndarjes të sistemit në fjalë.

3. Përshtatje të legjislacionit të energjisë elektrike me atë të Bashkimit Evropian.

4. Përfitime për klientët në drejtim të sigurisë të furnizimit me energji elektrike dhe shërbim cilësor e të qëndrueshëm.

5. Vendosje aksesi për palët e treta, për të marrë pjesë në tregun e energjisë elektrike, në një treg transparent dhe jo diskriminues.

6. Përpjekje të vazhdueshme për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike duke krijuar një strukturë tregu që rrit interesin dhe numrin e pjesëmarrësve në të.

Shprehur në një fjali të vetme, me të drejtë nga specialistët theksohet fakti që: privatizimi i O.S.SH-së sjell rritje të cilësisë dhe sigurisë së operimit në rrjet, tërheqje të kapitalit të huaj në investime e nevojshme në rrjet duke sjellë përfundimisht eliminimin e efekteve negative të sektorit të energjisë elektrike në buxhetin e shtetit. Njëherësh ky privatizim është dhe sukses për politikat dhe reformat e ndërmarrë nga Qeveria Berisha dhe posaçërisht Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE). Teorikisht sot në botë pranohet se, privatizimi pashmangshmërisht krijon asimetri të mëdha informacioni dhe është puna e qeverisë t'i korrigjojë ato. Në këtë privatizim Qeveria ka vepruar drejt duke i identifikuar, vlerësuar dhe transferuar në mënyrë transparente asetet dhe të drejtat e pronësisë, duke marrë maksimumin e vlerës financiare e çka është më e rëndësishme duke krijuar stabilitet e siguri për të ardhmen.

Diskutimi u botua në gazetën "Rilindja Demokratike", dt. 24 prill 2009

Intermexo I

Shënime mbi romanin ABSURDI i autorit Koço Kosta

Shkrim nga Bujar LESKAJ në gazetën Shqip, datë 26 Mars 2009

Dikush, duke dëgjuar një referimin tim në Kuvend të romanit ABSURDI të K. Kostës mund ta ketë menduar thjesht si mani të referuesit për të cituar një vepër a diçka tjetër në funksion të asaj që do të argumentojë, pavarësisht sa lidhet argumenti në fjalë me veprën e cituar. Por nuk është kështu. Qëllimi im ishte i plotë dhe në përputhje me mbresat që më la Absurdi. Sa e vërtetë është kjo, unë edhe njëherë, siç e bëra në sallën e Kuvendit do ta këshilloja të lexohej ky roman, se do të ishte absurde nga ana ime që të kuptohej Absurdi i Koços në këtë shkrim modest. Megjithatë nuk është ky qëllimi im në këto dy rreshta që po marr përsipër të shkruaj. As të nxisë të tjerët të lexojnë atë që dua unë, për të kuptuar atë që kam dashur të them. Jo, sinqerisht, jo. Unë do të dëshiroja të shprehja mbresat e mia, thjesht si një lexues që vepra në fjalë, e tundoi të shpreh lirshëm dy-tre mendime, pa pretenduar për një shkrim profesional të karakterit të kritikës letrare. Duke qenë një lexues i shumë veprave të K. Kostës, do të nënvizoja që në fillim se duke shkruar këto mendime nuk kam ndërmend të bëj avokatin e vlerave të prozës së tij, (ky autor i madh i prozës shqiptare nuk ka fare nevojë për të), pasi ato e kanë kaluar provimin e guximit artistik që në atë kohë kur ky guxim fshihej nën jorgan, duke qëndruar si vepër monumentale në kohë, dhe jo më tani kur liria e të shkruarit në disa raste është kthyer në bumerang të vlerave artistike e që ka nxjerrë, zbuluar shumë autorë të tjerë. Në këtë këndvështrim, në kuadër të analizës që dua të bëj, mund të qëndronte çdo roman i tij, por unë zgjodha pikërisht Absurdin dhe për një arsye të thjeshtë. Përpos vlerave, për të cilat do mundohem të them diçka, është pikërisht

titulli nga e cila më bën të filloj përshtypjet e mia. Përveç idesë që autori hedh nëpërmjet absurdit të tij, jo vetëm duke argumentuar këtë nëpërmjet titullit, por përmes përshkrimit të një absurditeti të përshkruar me kaq mjeshtëri në këtë roman, që do t'ju bënte mirë ta lexonin, si atyre të rinjve që nuk e kanë njohur këtë kohë absurde, dhe ju duket akoma më absurde si mund të ketë jetuar një absurditet i tillë, si atyre të tjerëve që e kanë jetuar dhe e kujtojnë me neveri si një pjesë të neveritshme të jetës së tyre...por, më shumë me atë kategori njerëzish, që ndonëse e kanë jetuar, kështu dhe më keq, mohojnë ekzistencën e këtij absurdi kaq të egër dhe mizor, që shkatërroi mijëra jetë, që vrau Gavrilët me shokë, që bëri që nënat e tyre të enden të marrosura në kërkim të sandaleve të varura të bijve të tyre, që me mijëra Shosho e të tjerë të degjenerohen deri në atë shkallë, sa të spiunojë vëllai vëllanë, gruaja të shoqin, miku mikun e tij dhe mbi të gjitha këto të ngrenë në piedestal atë që autori e thotë me forcë: *Krijimin e njeriut të ri, fabrikimin e Peposhëve, të cilët për shumë vjet mbretëruan mbi fatet e shokëve të tyre dhe pse jo enden dhe sot krenar në Peposhezimin e tyre.* Dhe pikërisht për sa thashë më sipër, do të filloja të rendisja disa nga përshtypjet e mija personale për këtë roman duke filluar pikërisht me figurën e Peposh Buzatit. Natyrisht një lexues i romanit do të më tërheq vëmendjen, duke më kujtuar se heroi kryesor është vetë autori me jetën e tij po kaq absurde sa gjithë absurditeti i shkruar në 289 faqet e tij. E pranoj këtë, por nuk e di pse, më pëlqen ta filloj pikërisht nga Peposh Buzati. Jo aq për vendin që zë në roman, që natyrisht autori e ka vënë në qendër të të gjithë absurditetit që ai merr përsipër të paraqes, por më shumë për vendin që Peposhët dhe shokët e tij, zënë në jetën e secilit prej nesh, jo vetëm atëherë kur kishin rrufetë e Zeusit në dorë, por dhe tani kur ndoshta enden rrugëve të Tiranës (pse jo dhe të pushtetit dhe të politikës) duke kronikuar të shkuarën e tyre, jo vetëm pa një ndjenjë turpi dhe përgjegjësie apo të një kërkimi falje publike, por në ndonjë rast dhe duke mbrojtur me një krenari të nënujshme të shkuarën e tyre kur të bënin gjëmën. Sepse është pikërisht Peposhi me shokët e tij një nga mbresat më të forta që më la ky roman që më detyroi dhe për atë thirrje (provokim miqësor) për lexim që ju bëra kolegëve të mi në Kuvend apo në Grupin parlamentar. Peposh Buzati është një figurë më se reale, e qëmtuar me mjeshtërinë e autorit deri në hollësi, është pikërisht pjella e asaj shoqërie perverse që krijoi figurën më perverse, që kurrë ndonjëherë shoqëria shqiptare nuk e kish jetuar, njeriun e ri, qenien e re, hidrën e nënujrave. Që kur kërkonte të drejtën e studimit, që kur ishte student, që kur mohoi të shpëtonte shokët e tyre që po mbyteshin, që me vështrimet

epshore që i hidhte shoqes së klasës e deri sa u bë i madh dhe i plotfuqishëm, kur përdhunonte me moralin e tij të përdhunuar këdo që i dilte përpara ai u fabrikua si një qenie pa moral, pa fytyrë, pa trup, pa gjymtyrë, por thjesht si një Peposh, që si e thotë autori: *u fry, u bë i madh, sa dhuna dhe paturpësia.* Ideja që të rrëqeth është se kjo ushtri e fabrikuar njerëzish të rinj, po rritej, po zmadhohej, po zaptonte gjithçka njerëzore e të bukur në jetën e rinisë, po shumohej si kubikët e shpikur të asaj kohe të shpikur. Disa i bënin Peposh dhe të tjerët ushtarë peposhash, të cilët mbanin nën thundër me mijëra të tjerë me teorinë e Abelit e të Kainit, si Shoshoja me shokë, apo stomatologia e bukur, apo Beta e përfunduar nën shfryrjet e ushtarëve të Peposhit...

Ajo që autori nëpërmjet Absurdit të tij e jep të qartë dhe pa ekuivoke është se kjo shoqëri e re, që në pamje të parë të duket e shthurur, perverse, që përdhunon, që vret, që internon (dukuri këto që i sheh sot nën këndvështrimin e absurditetit të asaj kohe) e parë në syrin e kohës që është jetuar, është dhënë plot vërtetësi dhe e shkruar bukur dhe drejtpërdrejt të jepet si një gjë normale, e ndërtuar me mjeshtëri, me cinizëm njëkohësisht, me atë që lufta e klasave të bëhej moto e jetës, që peposhët ti mbajë në qafë, që leja që duhej të merrje nga kryetari i këshillit të të dukej normale: Pra gjithçka e studiuar, gjithçka e ndërtuar, gjithçka e fabrikuar që njeriu i ri i peposhëve të të sundonte deri në ndjenjat e tua, qofshin dhe këto sekuale. Në synim të kësaj zhveshje morale dhe njerëzore është pikërisht dhe zhveshja ekonomike që ju bë fshatarit tonë me tufëzimin. Një nga pikat që autori e përshkruan me forcë, me dhimbje që e kthyen një vend me ulçer. Pra ajo kohë që sot duket absurde po ndërtonte njeriun e ri, të shkishëruar nga shokët e vet, pa pronë e brekë në bythë, po me moral të lartë, me frikën e spiunimit nga shoku që kishe pranë, me të fejuarën që nuk të lënë ta takosh deri sa ta përdhunojnë, duke të shkruar dhe letra me gabime ortografike, me sandalet e Gavril Beshos të varura nën një pemë, që duke u dridhur nga era të dukej se të pëshpëritnin: kështu do e pësojnë të gjithë ata që dalin kundra këtij pushteti, apo me vet personazhin kryesor, që të gjitha ndjenjat e tija i kishte të fshehura, qoftë dashuritë (Gavrilin, Betën, Suzin) apo urrejtjet (Peposhtë dhe shokët e tij) dhe gjithë mllefin e tij e shfryn me disa poezi të pa botuara dhe me Katrinën që i erdhi në derë. Tek të gjithë këta Soshot, stomatologen, Betën, Katrinën apo të shoqin e të tjerë e të tjerë ndjen dhimbshëm atë që një nga personazhet e thotë plot dhembje... *Popullit po i mësojnë poshtërimin*... E gjitha kjo jepet dhe njëherë në figurën episodike të profesorit gjatë mbledhjes për arratisjen e Gavrilit... Ajo fytyrë do të ishte gravurë e një epoke.

E një Regjimi Komunist të papërfytyruar.. .Dhe jo pa qëllim herë pas here dhe në mënyrë të përsëritur (gjë që autori e përdor shpesh dhe synim të përcaktuar) jepet dhe ajo fabrikuesja e njeriut të ri, mësuesja e këtij populli të poshtëruar, projektuesja dhe ndërtuesja e këtij ABSURDI të madh, e pakrahasueshme dhe e vetmja në llojin e saj. Në këtë pikë do të nënvizoja diçka. Është meritë e K. Kostës, një term të ri: *Partia e komunistëve* thotë ai që trumpeton "*se do të triumfoi i plotë Socializmi i Komunizmit tonë*". Pikërisht ky ndryshim gramatikor jo i paqëllimte i Koços shpreh në thelb atë falsitet të propagandës së asaj kohe, të Partisë së gjithë popullit, duke reduktuar atë dhe duke e përsëritur herë pas here, si një parti të disa peposhëve, si një parti e asaj pakice që me dhunë, terror fizik e psikik, me fabrikime spiunësh dhe njerëzish të rinj, me fishekzjarrët e gënjeshtra të shkëmbit të granitit mbi Adriatik, me Burrel e Spaç çadra plazhesh të ngritura mes bunkerësh, me këngë e valle që hidhnim në gojë të ujkut, me vila të bukura buzë detit që ishin vetëm për ata, me dy pula por pa gjel që të mos i jepej fshatarit as kokrra e vezës...me të gjitha këto dhe absurditete të tjera të këtij lloji, të mbanin për shumë dekada këtë popull nën thundër dhe kërbaç... Dhe siç e thotë dhe vet autori, jo pa dhimbje: Megjithëse "*Një komb i tërë jetëmot bark bosh. Ne të tërë heshtnim diçka si aploplektike: si të dambllosur; krejt të paralizuar... Kjo shoqëri e tillë ngriti në art spiunët dhe fabrikimin e tyre.* Në këtë këndvështrim vepra në fjalë bën një "Autopsi' të spiunit, e spiunimit përmes vlerësimit dramatik, se "Spiunimi *është bërë dobësi kombëtare tek ne*" Ajo jep të qartë, si në një peizazh ku përshkruhet gjithçka me hollësi, se deri ku shkonte ky lloj absurditeti, deri në çfarë shkalle tentakulat e "nënës" që polli njeriun e ri shkonin në popull, duke prekur të gjitha shtresat, që tek ata të zellshmit, shokët e peposhëve, apo të atyre që merrnin rrogën për këtë punë e deri tek ata...turma...stomatologia etj, duke shkuar deri tek Shoshoja, një nga figurat më të realizuara artistikisht. Shoshoja i penduar, i vrarë shpirtërisht për gjithçka që ka bërë në jetë, i vetëvrarë fizikisht, por i vrarë në psikologjinë e tij vite më parë është mishërim i ati cenimi të rëndë moral, njerëzor, fizik që ju bë deri në bërthamë, popullit të thjeshtë, atij që e duartrokiste në marshimet e një majit, pjellën e fatkeqësisë së tij, një Shosho i detyruar të spiunojë vëllain e tij, i urtë në mendimet e veta, vëzhgues i imët jetës që e rrethon, kritik i shpikjes më të madhe të vetëvrasjes së një populli: tufëzimit, një Shosho që në fund të fundit mbeti siç kishte qenë gjatë gjithë jetës së tij, i pafuqishëm të shkojë kundër dhunimit të vetvetes duke e mbyllur këtë jetë të sunduar nga të tjerët me vetëvrasjen, që përsëri ishte akti i tij i fundit i nënshtrimit të tij, nënshtrimi ndaj fatit,

nënshtrimi ndaj një pamundësie tjetër jetese veç asaj që e shtyn peposhët dhe shokët e tij. Një dyshe që do ti shikoja të pandarë, pavarësisht që njëri tregon në kohë reale historinë e tij, ndërsa tjetri vjen nëpërmjet revokimit të jetës së tij, tashmë të shuar, është dyshja e personazhit kryesor që tregon dhe Gavrilit. Personazhi kryesor ose autori i tregimit, në qoftë se do ta quajmë të tillë, nëpërmjet gjuhës që ka zgjedhur autori, të rrëfimit në vetën e parë, vjen i afërt dhe i plotë në autorrëfimin e asaj cope jete që e lidh me Gavrilin, por dhe me Peposhin. I sinqertë në pastërtinë e tij, nuk arrin të besoj tek e keqja e Peposhit, deri sa ai ja pohon cinikisht hapur dhe aty ai shpërthen, thyhen kufijtë e dyshimit brenda vetvetes, urren, mohon, vëzhgon... por si shumë të tjerë, i pafuqishëm të kundërshtojë, hesht, pret lejen e kryetarit të këshillit për të takuar të fejuarën, shkruan ndonjë poezi, thyhen pa dashur portretin e udhëheqësit dhe i tromaksur fsheh copat e thyera deri sa i japin fshehurazi një tjetër. Ne figurën e tij shohim fatin e shumë të tjerëve, që vërtet nuk u bënë spiunë, as provokatorë, por të trembur shtynë jetën e tyre nën peposhët. Nuk i duartrokitën, por as i kundërshtuan. Dëgjonin me respekt mendimet rebele të Gavrilit, por nuk i thanë hapur ato, shkruanin poezi fshehurazi dhe nuk i botonin. Në fund ai vetë pohon: *Mjerë populli i nënshtruar, thashë me vete. (përsëri me vete)... I përulur, mendova me dhimbje.* Në vazhdim të kësaj ideje, ndaj nënshtrimit të një pjese të popullsisë vjen dhe thirrja që bën nëna e Gavrilit para pemës ku vareshin sandalet e birit të saj të zhdukur nga peposhët. Ajo brenda marrosjes së saj akuzon: Ju të goditur dhe unë e marrë! Dhe me urtësinë e të marrit thërret përsëri: *Jo sot e marrosur, jooo*!

Që atëherë që s'dija të shihja. Që s'ditëm.

Në anën tjetër Gavrili me sandalet e tij të varura në një pemë. Një simbolik tepër e bukur dhe e dhënë me zgjuarsi nga autori. Sandale që lëkunden nga era, sandale që flasin, sandale që duan ti tregojnë të gjithëve për të zotin e tyre, sandale njerëzore që nëna i shkul nga pema për ti puthur djersën e të birit, sandale që peposhët i varin nëpër pemë për të mbjellë frikën e të tjerëve ndaj fatit të atij që ngre krye, sandale që binin në fshat dhe thashethemet e rastit, për Gavrilin e vrarë te Mali me Guva, apo Gavrilin e pavrarë që do e binin në fshat të fliste. Një makinë e rëndë propagande që thyente eshtra të vdekurish, zemra nënash, shpirtra fshatarësh të rrënuar nga tufëzimi, tru të qullosur nga ideja krijimit të njeriut të ri, trupa të përdhunuar mësuese fshati të frikësuar nga thirrjet e kukuvajkave... Një vlerë e rëndësishme e këtij romani, për mua, qëndron dhe në faktin se autori është shumë i drejtpërdrejtë në ato që shkruan, pa ekuivoke dhe dyshime, i qartë në idetë dhe i thjeshtë në mënyrën

se si ti servir ato. E shkruar në formën e një autotregimi, ai bie shumë mjeshtërisht në rrëfimin e tij gjithçka të ndodhur në kohë dhe vende të ndryshme, apo me personazhe të ndryshme (gjë që në pamje të parë të duken të palidhur). Me filozofinë e përgjithësimit të së mirës apo të keqes, Gavril Beshua vjen nga personazhe të ndryshëm, por që i lidh e përbashkëta e Gavrilit. Ashtu si Peposh Buzatin, që jo pa qëllim e sjell Shoshoja, Katerina, apo shoku i tij i fëmijërisë, tani montator. Kjo lidhje vendngjarje, kohë, ngjarje e personazhe të ndryshëm për mua është në funksion të konsolidimit të gjithë idesë së romanit, që jo më kot lidhet dhe me titullin, të paraqitjes të një absurdi të madh, të ngritur e të konsoliduar në një kohë absurde, por me sa gjykoj unë, do të ishte akoma më absurde, që e parë nga këndvështrimi i sotshëm, ajo kohë të quhej thjesht një absurditet tashmë i kaluar. Mbështetur në vetë stilin e autorit që me qëllim i përsërit ato që shkruan disa herë dhe unë, edhe njëherë do të përsërisja atë që thashë në fillim të këtyre rreshtave, urimin që të lexohet ky roman si për mesazhet e sipër shkruara por dhe për faktin e thjeshte: Është një roman që të tërheq që në faqet e para dhe patjetër të bën të shkosh me shpejtësi deri në fund duke bërë, për ata që nuk i kanë lexuar, të vihen në kërkim dhe të romaneve të tjera të K. Kostës, (paraardhës i Absurdit është "Nata e Sofie Kondilit"), të cilat, unë edhe njëherë nënvizoj, përbëjnë një vlerë të madhe, të veçantë, të lartë artistike për letërsinë tonë kombëtare. Nga ana tjetër kritika letrare dhe politika postdiktatoriale i ka një borxh të madh kësaj vepre dhe këtij autori, për të cilat personalisht do të shprehem në promovimin e romanit NATA E SOFIE KONDILIT, (80 kopje të të cilit i kam dhuruar te dashamirësit e librit në Vlorë), që së bashku me një grup shkrimtarësh e lexuesish vlonjatë do të zhvillojmë së shpejti.

KREU II

Diskutime në grupin parlamentar të PD-së, shkrime, intervista dhe komente te medias rreth tyre

(Maj 2007 – Maj 2009)

II.1 Refleksion politik mbi një datë që nuk duhej harruar!

21 Maj - Dita e Kujtesës Historike për Viktimat e Krimeve të Komunizmit

(Shkrim i botuar nga Bujar Leskaj, në gazetën 55 dhe gazetën Panorama (me titull "Harresa e Pafalshme!"), dt. 23/05/2007)

Dje ishte një ditë e shënuar, ditë përkujtimi publik. Zyrtarisht 21 Maji quhet Dita e Kujtesës Historike për Viktimat e Krimeve të Komunizmi por asaj ngjarje dhe kësaj dite mund ti vëmë edhe të tjera emërtesa e valenca, mund ta thërrasim pa frikë ditë e krenarisë kombëtare, ditë e lirisë…! Disa shqiptarë nuk pyetën se çfarë çmimi ka liria dhe kur nuk e patën atë i lanë jetën peng dëshirës për liri. Sakrifica për liri është e shenjtë. Ditë përkujtimi publik në bazë të protokollit zyrtar janë 5 maji - Dita e Dëshmorëve, 21 maji, 4 dhjetori - Dita e Forcave të Armatosura dhe 8 dhjetori, Dita e Rinisë. Dje kombi shqiptar duhej të ishte në një procesion shenjtërimi, tubime përkujtimi heronjsh e ngjarjesh, por ajo që fatkeqësisht dje ra në sy ishte harresa e politikes zyrtare, institucioneve për ta përkujtuar këtë datë ashtu si e meriton,

harresë e pafalshme. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 754, datë 9.11.2006, për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 229, datë 23.4.2004 të Këshillit të Ministrave "Për Miratimin e Ceremonialit Zyrtar të Republikës së Shqipërisë të ndryshuar", për herë të parë me propozim të autorit të këtij shkrimi dhe përkrahjes së Kryeministrit Sali Berisha e shënoi 21 Majin Ditë Përkujtimore Publike. Si përcaktohet edhe në vendimin në fjalë, e si janë rregullat zyrtare në të gjithë botën që njeh ligjin, heronjtë dhe ditët e shenjta në selinë e institucioneve shtetërore dhe private, vendosen flamuri kombëtar dhe shenjat dalluese të institucioneve apo enteve përkatëse. Në këto ditë merren masa të veçanta për zbukurimin e shesheve qendrore të qyteteve. Në nenin 7.b të vendimit në fjalë përcaktohet "Në përkujtim të mijëra viktimave të pafajshme të regjimit totalitar komunist, të cilët u vranë u burgosën , u dhunuan dhe u denigruan, në mënyrë të organizuar shtetërore, për shkak se besonin në lirinë e ndërgjegjes, të pronës, lirive politike, aspironin përparim, me 21 maj të çdo viti, do të përkujtohet 'Dita e kujtesës historike për viktimat e krimeve të komunizmit'. Ceremonia do të organizohet nga Ministria përgjegjëse, ku do të marrin pjesë personalitetet më të larta të shtetit, e ku Protokolli i Shtetit përfshihet në përgatitjen e programit dhe në ndjekjen e anës së tij protokollare". Por përveç një pritjeje modeste (ku mori pjesë vetëm z Bamir Topi, Znj Jozefina Topalli dhe pak deputetë të djathtë) të shoqatës së të përndjekurve politikë, nuk pamë asgjë të tillë, asnjë ceremonial i cili (moskremtim) komprometon rëndë institucionet përgjegjëse të drejtuara nga kjo qeveri e djathtë. Për maxhorancën e djathtë e cila më shumë se kushdo tjetër është e lidhur me ish të persekutuarit politikë dhe detyrimi ndaj tyre nuk është thjesht pragmatizëm por logjike dialektike, kjo harresë është shenjë e mjegullimit të vetëdijes politike, kjo është harresë e rrezikshme për identitetin e saj si e djathtë.

Pas rezistencës së viteve 1944-1946, protesta e Spaçit e 21 Majit 1973 është momenti dhe monumenti më sublim i qëndresës dhe i vetëflijimit në emër të një besimi, të një besimi antikomunist. Në dhjetor të vitit 1990 ata që rendën të parët tek PD ishin pikërisht shtresa e të persekutuarve politikë të cilët asnjëherë nuk kërkuan revansh apo hakmarrje por dhanë një leksion historik fisnikërie dhe kërkimi të drejtësisë. Si thotë Bedri Çoku, një nga heronjtë e gjallë të Spaçit, "Krijimin e Partisë së parë opozitare, atje në burgun e Burrelit, ne të burgosurit politikë, e pritëm si ditën e çlirimit të vërtetë të Shqipërisë nga regjimi i egër komunist. Madje dërguam edhe një promemorie në Tiranë, personalisht për zotin Sali Berisha, i cili në atë kohë, ishte i vetmi intelektual që na kishte bërë përshtypje

me artikujt e tij, për frymën kombëtare dhe dëshirën për ta parë Shqipërinë ndryshe nga ç'ishte" dhe rruga më e natyrshme për të provuar idealet janë sprovat historike. Ato nuk munguan ndonëse u shfaqën në formë tragjike me kundër revolucionin e '97 apo gjatë 8 viteve të vështira të opozitës dhe mbështetja që kurrë nuk i mungoi PD erdhi nga pasardhësit e revoltës së Spaçit bashkëkohësit e saj, adhuruesit dhe pasuesit e Vilson Blloshmit, Genc Lekës e qindra mijëra të tjerëve, nga platforma e tyre e mendimit dhe shoqërisë së lirë.

Unë jam i bindur që në këtë maxhorancë jo të gjithë kanë të njëjtën ndjeshmëri, vlerësim dhe respekt ndaj tyre por për PD-në sot në pushtet ajo është obligim moral, politik e historik, sepse është në dinjitetin e historisë së saj, si forcë e djathtë politike apo e qendrës së djathtë të filozofisë së saj qeverisëse e elektorale.

Të harrosh këtë ditë është njësoj sikur të harrosh të kaluarën diktatoriale dhe ndonëse pa dashje është shërbim ndaj persekutorëve të djeshëm e jo të largët. Po e lë mënjanë për pak gjykimin tim dhe për të shmangur ndonjë keqkuptim po kujtoj Kryeministrin Sali Berisha, i cili duke folur për projektligjin për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politik të regjimit komunist më 25 prill 2007, padyshim besoj të përgatitur nga ai vetë, në ligjëratë të drejtë shprehet: "Unë ftoj qytetarët shqiptarë të mos harrojnë për asnjë moment se vepër e këtyre të përndjekurve e të burgosurve politik janë miliarda e miliarda vlera të krijuara në shoqërinë shqiptare. Lagje të tëra të Kryeqytetit të Shqipërisë, por edhe të qyteteve të tjera të vendit, janë ndërtuar prej tyre në rrethimet me tela më gjemba. Janë qindra e mijëra hektarë këneta të thara me muskujt e tyre, janë miliona tonë minerale të nxjerra nga galeritë më të thella të vendit, nga të cilat ata përfitonin vetëm 400 gramë bukë dhe supën me karota, mplakjen e parakohshme dhe të sigurt. Askush nuk ka detyrim më madhor sesa shoqëria shqiptare ndaj kësaj shtrese. Unë jam i bindur se shpirti i shoqërisë nuk mund të prehet dhe të jetë i qetë, nuk mund të ketë drejtësi sociale të vërtetë dhe as paqe sociale pa dëmshpërblyer viktimat e një sistemi barbar, nuk mund konsolidohet liria aq e çmuar për të gjithë në rast se nuk dëmshpërblehen ish të përndjekurit e regjimit". Ky paragraf i cituar pak gjatë jo rastësisht nuk është një thënie e thjeshtë por sintezë e mendimit dhe veprimit politik të Liderit të padiskutueshëm të së djathtës së re shqiptare, themeluesit të PD-së Sali Berisha si dhe e pasuesve të tij në PD që në këtë drejtim janë të orientuar qartë. Reflektimi mbi këtë sintezë dhe mbi projekt ligjin e paraqitur nga qeveria na ekspozon tre ide madhore që ftoj pikësëpari të gjithë kolegët e mi deputetë të reflektojnë:

1) dëmshpërblimi i tyre pa ekuivok duke shtuar në këtë projekt ligjit edhe të vrarët pa gjyqe deri në vitin 1991; 2) dëmshpërblimi për të gjithë, pa kushte. Përpara së të kërkojmë hapjen e dosjeve për ish të përndjekurit politik (e t'i përjashtojnë ata nga ky dëmshpërblim sipas neni 6 të projektligjit në fjalë) parlamenti shqiptar, politika shqiptare, shoqëria mediatike shqiptare duhet të hapë dosjet e veta. 3) dënimi i persekutorëve të tyre në zbatim të Rezolutës së Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës e vitit 2006 që dënon krimet e komunizmit (jo dënime qesharake për kafet e pira).

Për vetë deklarimet sintezë të Kryeministrit bazuar në programin politik, por edhe duke reflektuar nga kjo harresë e pafalshme maxhoranca e djathtë duhet që brenda këtij sesioni, në muajin korrik 2007 të miratojë projektligjin për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politik të regjimit komunist dhe ligji i ardhshëm duhet të jetë sa më dinjitoz, të reflektojë kërkesat e tyre dhe të zgjidhë përfundimisht problemet materiale dhe morale me këtë shtresë fisnike të shoqërisë, me këtë shtresë që edhe me këto 16 vjet tranzicion nuk ka fituar të drejtat e veta apo i ka fituar pjesërisht ato vetëm kur ka qeverisur Partia Demokratike. Tani jemi në prag të një prove të madhe të seriozitetit të politikës shqiptare, të respektimit të kushtetutës dhe institucioneve, parime për të cilat u persekutuan mijëra shqiptarë. Zgjedhja e Presidentit të Republikës është orë prove për të djathtën shqiptare dhe demokracinë tonë. Dhe jo rastësisht kjo shtresë fisnike në atë pritje modeste të 21 Majit i dha mbështetje të plotë kandidaturës së maxhorancës së djathtë për president republike Z. Bamir Topi

Jam i bindur që puna e nisur vitin e kaluar për të ngritur muzeun e kujtesës antikomuniste në qytetin e Shkodrës do të përfundoj brenda këtij viti, gjithashtu edhe memoriali në nderim të të persekutuarve politikë i planifikuar tashmë në buxhetin financiar të këtij viti të MTKR-së për tu vendosur në qendër të Tiranës të realizohet këtë vit. Të persekutuarit politik të diktaturës janë nderi i këtij kombi, kujtesa për ta është nderim për moralin tonë politik e shoqëror, harresa për ta nga institucionet zyrtare tjetër herë do të jetë faji i madh, harresë e pafalshme për të gjithë ne.

II.2. Nuk kam inate me Berishën

Intervistë tek revista Klan- Date 24.06.07

(Intervistoi Renato Kalemi)

Kritikat e tij ndaj disa nismave ligjore të shumicës, nuk kanë asnjë lidhje me marrëdhënien me kryeministrin Berisha. Paçka se Bujar Leskaj nuk është më pjesë e kabinetit. Por për deputetin e Vlorës, të gjitha janë spekulime, ndërsa Fatos Nano mbetet gjenerator i përhershëm i konfliktit...

- Zoti Leskaj, pas largimit nga posti i ministrit të Kulturës, ju jeni shfaqur kritik ndaj disa nismave ligjore të qeverisë. Këto kritika janë komentuar si shprehje e pakënaqësisë për largimin nga posti. Si do t'i komentonit qëndrimet tuaja kritike për ligje si ai për bizneset apo transmetimet dixhitale?

Kohët e fundit ka pasur një qëndrim jo shumë dashamirës, në shumë raste spekulativ, lidhur me qëndrimet që kam mbajtur në miratimin ose jo të ndonjë ligji në Parlament. Më duhet të pohoj se "lidhja e shkurtër", që bëhet midis qëndrimit kritik për ndonjë ligj që kam kontestuar, me faktin e largimit tim nga detyra e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, nuk i përgjigjet të vërtetës. Unë e vlerësoj si arritje të veçantë në karrierën time politike, faktin që kam qenë ministër në qeverinë e zotit Berisha për një vit e gjysmë. Kjo periudhë më shërbeu jo vetëm politikisht, por dhe si shans për të qenë më afër tij e për të punuar "sipas ritmit të tij". Largimi im nga Qeveria, i kërkuar nga Kryeministri, i dëshiruar shumë nga qarqe afër tij, është mirëpritur nga unë dhe nuk ka sjellë asnjë "hije" në marrëdhëniet e mia me Berishën. Pra, qëndrimi im kritik si deputet nuk është fare i lidhur me faktin e largimit tim nga kabineti Berisha. Më vjen keq për ata që përpiqen të bëjnë "interpretime të sforcuara" të fakteve, apo për ata që duan të spekulojnë me vendimet dhe veprimet e mia në votime të ndryshme.

- Gjithmonë keni qenë kritik ndaj mos artikulimit në strukturat e PD të mbështetjes për kandidaturën presidenciale të Bamir Topit, duke lënë të kuptohet lënien në baltë apo lojë me dy standarde ndaj nënkryetarit. Realisht, sa të mundshme e shihni emrin e zotit Topi në Presidencë?

Qëndrimin tim si mbështetës i kandidaturës së zotit Topi e kam shprehur mbas vendimit politik të grupit parlamentar të PD. Për këtë zgjedhje të PD-së jam i vendosur dhe nuk kam asnjë ekuivok. Por, nuk kam qenë dakord dhe kam kundërshtuar qëndrimin jo shumë luajal, të disa partive aleate të koalicionit, të cilat kanë bërë "politikën e dyfishtë" të "paralelizmit presidencial". Nuk bëhet politika e ndershme duke qenë në të njëjtën kohë "aleat" e konkurrent për postin e Presidentit, duke nxjerrë padrejtësisht emra të tjerë kandidatësh, duke krijuar kështu një kaos politik të papranueshëm, të patolerueshëm të krahut të djathtë. Nuk kam qenë e nuk jam dakord që politika e krahut të djathtë të krijojë brenda vetes "skepticizëm të panevojshëm", për një figurë të tillë politike si Bamir Topi, statura e të cilit është më e mira, më e plota dhe më e gjetura, për të qenë në të njëjtën kohë Presidenti që i duhet vendit në këto momente. Sipas meje ai është kandidati që plotëson të gjitha parametrat për të qenë alternativa më e mirë dhe e vetmja e të djathtës, që mund të jetë figurë politike konsensuale dhe Kryetar Shteti i duhur për politikën tonë.

- Keni qenë aktiv në mbledhjet e fundit të grupit parlamentar, duke akuzuar njerëz të lartë të PD (sekretarin e përgjithshëm Bode) për takime të fshehta me kandidatin për president, Fatos Nano, duke kritikuar kështu, edhe kryetarin Berisha. Çfarë reagimesh keni marrë?

Në jetën time politike unë udhëhiqem nga parimi që problemet, debatet dhe kritikat që bëhen në "familjen time politike", nuk janë të dobishme për t'i nxjerrë në "tregun e hapur", politik dhe mediatik. I qëndroj rregullit tim etik dhe moral që ato çka shpreh në mbledhjen e grupit parlamentar të mos t'i bëj publike. Nuk kam bërë insinuata nominale, por kam insistuar që për hir të politikës transparente dhe shmangien e "dubëlqëndrimit" të ndonjë njeriu, që mund të ketë funksione politike të caktuara në PD, nuk kam qenë dhe nuk jam dakord as për zgjidhjen e "problemit", apo ndoshta edhe të krizës presidenciale me manovrime e kombinatorika politike jo të moralshme, me biseda kulisash, që kanë kosto të madhe për autoritetin e PD dhe deputetëve të saj, dhe pse jo dhe të liderit Berisha. Aq më keq pastaj nëse kjo kombinatorikë shkon në favor të kundërshtarit të vjetër politik të PD, njeriut që ka qenë një nga gjeneratorët permanentë të konfliktit politik në këtë vend, siç është

zoti Fatos Nano, ambicia e të cilit për të qenë president, jo vetëm që nuk duhet të ketë përkrahjen tonë politike, por përkundrazi duhet të ketë refuzimin politik kategorikisht kundër. Askush nuk ka të drejtë të spekulojë me vullnetin politik tonin. Aq më pak ndonjë funksionar i PD, i cili nuk ka "asnjë mandat politik", për të negociuar gjetje zgjidhjesh që janë në kundërshtim me vullnetin politik të shprehur në forumet tona, në mbështetje të vendosur për zotin Topi. Jam në mbështetje të gjetjes së një zgjidhjeje të ndershme konsensuale që i shërben stabilitetit politik të vendit, shpejtimit të ritmeve të integrimit evropian, anëtarësimit në NATO, forcimit të qeverisjes dhe rezultateve sa më pozitive të saj. Por, zgjidhje të mira janë ato që sigurohen përmes politikës transparente që respekton vullnetin e strukturave politike legale të PD dhe deputetëve të saj, janë ato nisma të guximshme, të qarta të kryeministrit Berisha, i cili po punon që t'i japë vendit zgjidhjen më të mirë.

- A do të votonit për një kandidaturë të imponuar nga partia, nën argumentin se kështu kanë vendosur strukturat e saj?

Natyrisht edhe pyetjeve "djallëzore" mund t'u gjendet përgjigja e duhur. Megjithatë unë nuk jam veç e as i ndarë nga partia. Këtë nuk kuptojnë ca njerëz që nuk e njohin PD ose që nuk janë dashamirës ndaj saj. Unë jam anëtar i PD dhe di të "mendoj i lirë" nga njëra anë dhe të "respektoj rregullat konsensuale" nga ana tjetër. Këto dy parime nuk janë të ndara as në PD, por as në personalitetin tim politik. E drejta ime politike, për të gjykuar, debatuar dhe kundërshtuar përfundon atje ku fillon e drejta e pranimit konsensual të vendimeve dhe zgjidhjeve të gjetura apo të ofruar nga forumet e partisë. Edhe ndonjë kritikë dashamirëse e konstruktive e bërë nga unë ka pasur synimin racional të kontributit për të gjetur "zgjedhjen dhe zgjidhjen" më të mirë të mundshme, në dobi të forcimit të një morali dhe karakteri politik që me sa shihet është i pakët në politikën tonë dhe tek një pjesë e politikanëve tanë të vjetër me shumicë te PS dhe pakicë te PD. Ndërkaq, politikisht unë jam politikan, deputet që respektoj të drejtën vendimmarrëse të forumeve dhe natyrisht që i bindem patjetër vullnetit të tyre. Ndryshe çfarë kuptimi ka që jemi në një parti ku militojnë njerëz me të njëjtin ideal?

- Cilat janë marrëdhëniet tuaja aktuale me kryeministrin Berisha?

Me Kryeministrin Berisha nuk jam lidhur as sot, as dje, por më herët, në kohëra të vështira për të e Partinë Demokratike, dhe aq më pak për përfitime personale politike pragmatiste të miat. Ndaj tij kam pasur dhe kam një vlerësim të veçantë, si burrë i madh shteti,

si shqiptari që mori përsipër dhe po e udhëheq "trenin politik" të transformimit demokratik të Shqipërisë. Koha dhe përpjekjet e tij e sollën që zoti Berisha të jetë shqiptari që po punon të realizojë idealet më të mira politike dhe historike jo vetëm të Shqipërisë, por të gjithë kombit shqiptar. Kreditet historike që Presidenti Bush dhe ish Presidenti Klinton i dhanë liderit Berisha është një nder dhe barrë e rëndë për të. Si deputet i Vlorës mendoj se është një detyrim më i rëndësishëm se posti i një ministri që më mban të lidhur pazgjidhshmërisht me Berishën. Është ideali i përbashkët, synimi i njëjtë për të çuar përpara ambicien demokratike të pakthyeshme të këtij populli, si dhe detyrimet që kemi ndaj demokratëve e sakrificave të tyre nga 1997 e zezë në veçanti. Qëndrimet, problemet e ngritura nga ana ime në këtë periudhë apo dhe ndonjë votim kundër, nuk e zbehin apo cenojnë respektin dhe marrëdhëniet tona reciproke. Këtë duhet të kuptojnë të gjithë ata, që duan të spekulojnë me realitetet për të cilat nuk kanë forcë as t'i ndryshojnë, e as t'i prishin, pavarësisht shpifjeve të momentit me të cilat ata përpiqen të spekulojnë me qëndrimet e mia momentale për të nxjerrë përfitime për vete, apo mbuluar ato abuzime të cilat unë nuk do të hezitoj t'i bëj publike në kohën e duhur. Koha është e gjatë dhe ajo është gjykatësja më e paanshme dhe më e mirë.

- Cili është vlerësimi juaj për punën e deritanishme të pasardhësit tuaj në ministrinë e Kulturës?

Është në natyrën time që për cilindo që do të ulej pas meje në "karriken" e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve do t'i uroja vetëm suksese!

II.3. Me Berishën takohemi në shtator[*)]

Me Berishën takohemi në shtator
E Martë, 7 Korrik 2007
Botuar tek revista MAPO nga Lorenc Vangjeli

Nga bari ku është ulur bashkë me grupin e ngushtë të kolegëve që mendojnë njëlloj si ai vetë, Bujar Leskaj, ish-ministër i Kulturës dhe përkrahës i deklaruar i Bamir Topit, duket qartë pjesa anësore e godinës së Kuvendit të Shqipërisë. Godina që Leskaj beson se do të bëhet shpejt arenë e surprizave të cilat do të prekin jo vetëm partinë e tij apo atë socialiste, por do të ndikojnë në të gjithë politikën shqiptare. "Jeta politike duhet pastruar", thotë Leskaj që nuk ja ndan vështrimin një pakete me cigare mbi tavolinë. Nuk e pi duhanin, për më tepër që ligji e ka bërë atë mysafir të ndaluar në baret e kryeqytetit. "Kush e mban përgjegjësinë që janë ç'doganuar një mijë ton më pak cigare këtë gjashtëmujor sepse fajtorët janë vetëm dy, ose ministri i financave, ose drejtori i përgjithshëm i doganave?"[**]), lëshon shigjetën e parë Leskaj, për të cilin, si duket, në heshtje, nuk ka dyshim për emrin e fajtorit të vërtetë. Ai është Bode, një nga njerëzit e fuqishëm në PD dhe që konsiderohet armik direkt i këtij grupimi deputetësh që synonin

---

***) Shënim i qershorit 2009:** Eqerem bej Vlora në kujtimet e tij historike ndërmjet të tjerave sjell dhe një shprehje latine: "*Quidquid agis, prudenter agas et respice finem!*" *(Kushdo që vepron, të veprojë me maturi dhe të ketë parasysh fundin)*. – Eqerem bej Vlora, Kujtime, vëllimi I dytë 1912-1925, Tiranë 2001,F. 217.

Këtë mësim filozofik harrova unë dhe disa kolegë të tjerë në këtë periudhë, që dëshmohet në intervistën e mëposhtme dhe në disa veprime të kësaj periudhe gjatë procesit të përzgjedhjes dhe zgjedhjes së Presidentit të Republikës.

****) Shënim i qershorit 2009:** *Pavarësisht rezultateve të 6-mujorit të parë të vitit 2007, më duhet të pohoj punën e suksesshme dhe performancën e Ministrisë së Financave dhe organeve të fiskut (drejtuar me kompetencë nga Z. Bode) për periudhën shtator 2005 – shtator 2009, në mbledhjen e të ardhurave në dogana e tatime, duke përmbushur me sukses detyrat e buxhetit dhe realizimin e reformave fiskale.*

presidencën nën emrin e Topit. Ose të paktën kështu dukej deri në fillim të kësaj jave, kur ata ngjajnë se kanë kaluar në planin B. Atë të faktorizimit në mënyrë të fortë brenda vetë PD-së dhe imponimit me rregullat e lojës së shifrave në gjirin e maxhorancës.

Leskaj, deputeti ish-ministër, konsiderohet rebel brenda PD-së; organizator i një lëvizjeje sfidë pikërisht në Vlorë me një numër kuptimplotë deputetësh, 20 vetë, në fundjavën e kaluar, flet për MAPO-n për zhgënjimin e thellë që pësuan nga detyrimi që ju bë Topit për t´u tërhequr nga gara presidenciale, për marrëdhëniet me Berishën, për njerëzit që i kanë imponuar qëndrimet e tyre kryeministrit duke e shkëputur nga realiteti, por sidomos flet duke heshtur për të ardhmen. Atëherë kur grupi ku bën pjesë me 20 deputetë të maxhorancës mund të rritet dhe më tej për të afruar ndoshta në vjeshtën e këtij viti surpriza të pamenduara më parë.

"Të burgosurit"

"Edhe Berisha, edhe Topi ndodhen në atë pozicion që në teorinë e lojërave njihet si "dilma e të burgosurve". Ata janë aktorët (lojtarët) e administrimit të pushtetit". Bujar Leskaj, ish-ministër i kulturës dhe një nga mbështetësit e deklaruar të nënkryetarit të Partisë Demokratike Bamir Topi, në këndvështrimin e tij nuk ka dilemë të shpallur. Sipas tij, dy njerëzit e fuqishëm të PD-së janë të detyruar të bashkëjetojnë, sepse në të kundërt, lufta dhe kundërshtia mes tyre do të ishte njëlloj e dëmshme për të dy politikanët demokratë. Pak orë mbas tërheqjes së kandidaturës për postin e Presidentit të Republikës nga Topi, Leskaj shpërthen. Ai nuk e shikon ose më mirë, nuk pranon për momentin ta shohë drejtpërdrejt Berishën si faktorin kryesor që shkaktoi këtë tërheqje, por konsideron se kryeministri i vendit po mbahet peng nga një bërthamë prej katër-pesë vetësh brenda e jashtë qeverisë, që diktojnë veprimet e tij dhe për më shumë, përfitojnë prej kryeministrit. "Janë pikërisht këta individë që kanë vrarë kalin e luftës së kryeministrit Berisha, me të cilin ai erdhi në pushtet. Lufta kundër korrupsionit është vetëm një kujtim i të shkuarës së afërt së para dy vjetëve. Mjafton të kujtojmë vetëm shembullin e ç'doganimit të cigareve. Ata që dikur i konsideronim si kontrabandistë të cigareve sot janë në burg. Kush i ka zëvendësuar ata dhe kush është direkt përgjegjës për këtë kontrabandë?", pyet duke u përgjigjur po vetë Leskaj. Përgjegjësia në këtë rast ngushtohet tek dy emra, tek ministri i financave apo drejtori i përgjithshëm i doganave", thotë Leskaj. Në fakt ai e ka një emër fajtori: ministri i financave, njëkohësisht sekretar i përgjithshëm i selisë blu dhe një nga njerëzit më të besueshëm të vetë kryeministrit.

Leskaj

Deputeti vlonjat mban të veshur një këmishë me ngjyrë blu të thellë dhe rithekson se nuk ka asgjë që ta ndajë nga PD-ja. I zhveshur nga interesa direkt personale, sikundër kërkon të theksojë vazhdimisht, Leskaj thotë se PD-ja që ai mendon është ndryshe nga ajo që është në realitet. Por nga bari përkundrejt godinës së Kuvendit të Shqipërisë, Leskaj pranon se flet shumë më pak sesa mendon. Disa votime kundër vullnetit politik të maxhorancës që ai përfaqëson, sidomos për ligjin e gjobave dhe atë të transmetimeve dixhitale, e kanë bërë atë të identifikohet si deputet i "vështirë". Replikat e tij të vazhdueshme në mbledhjet e grupit parlamentar, kundërshtitë e tij deri dhe me vetë kryeministrin, edhe pse nuk janë bërë publike, kanë mjaftuar që ai të tregojë se brenda korit të maxhorancës blu, është një zë ndryshe.

Një emër surprizë kur në shtator 2005 mori postin e ministrit të kulturës, ai tashmë demonstron dukshëm se ka përvetësuar më së shumti aksiomën e kulturës politike moderne: fjala rrallë duhet të paraprijë veprimin. Por surprizat e deputetit vlonjat as nuk kanë filluar në këto javë të fundit dhe me të gjitha gjasat do të vazhdojnë dhe më gjatë. Të shtunën e kaluar, ai ishte organizatori i një "dreke pune" me një shifër domethënëse prej 20 deputetësh në Vlorë, mes të cilëve dhe lideri moral i grupimit të tyre, Bamir Topi. "Mund të ishim takuar kudo, ndoshta dhe në Durrës, por Vlora është tjetër gjë. Sa për veten time, mandati që kam marrë në qytetin tim, është një mandat që unë e kam marrë për PD-në dhe ja kushtoj këtij qyteti", thotë Leskaj. Ai nuk preferon të përdorë fjalën "sfidë" ndaj kreut të PD-së për të treguar se çfarë ka ndodhur në këtë drekë të bërë enkas publike, por e ka të pamundur t´i shpëtojë pikërisht numrit "20", po aq sa do të ishin të nevojshëm për të zyrtarizuar kandidaturën e Bamir Topit si President i Republikës. Vetë Leskaj thotë se ky mund të ishte dhe një numër më i madh se kaq dhe se e nesërmja do të afrojë vërtet të papritura. Ndoshta dhe luftën brenda PD-së, e cila mbas koagulimit maksimal përpara zgjedhjeve të korrikut 2005, ngjan se ndodhet përballë shfaqjes së dy rrymave që kundërshtojnë njëra-tjetrën. Për motive që nuk fillojnë dhe mbarojnë me rrëzimin e kandidaturës së Topit, por synojnë deri dhe vetë qeverisjen dhe tentativën për përmirësim të saj, pikërisht sipas optikës së këtyre 20 deputetëve blu, të tradhtuarit e minutave të fundit nga kolegët e tyre.

Rrethimi i kryeministrit

Në mbledhjen e gjatë në mesnatën e të hënës, deputeti i zonës 94 në Vlorë, ka replikuar me Berishën, duke i kujtuar atij metodën

klasike të hetimit të të burgosurve. "Ata asnjëherë nuk vihen që në fillim në një qeli të përbashkët. Secili pyetet veç e veç dhe nga rezultati i përgjigjeve të pyetjeve, varet në një masë të konsiderueshme dhe "dënimi" që ata do të marrin", parabola e vlonjatit rebel kërkoi t´i tregojë mikut të tij kryeministër, pikërisht këtë lidhje të pazgjidhshme që fati i tij ka me atë të nënkryetarit Topi. Por kryeministri e kishte marrë vendimin e tij, ndarjen me Topin që vetë, në mënyrë të papritur, muaj më parë, e hodhi në treg si kandidaturën e vetme, më të mirë dhe më konsensuale të maxhorancës për erën postMoisiu. I gjendur në mes të ndoshta premtimit që i ka bërë Nanos për ambicien e tij presidenciale, presionit të opozitës dhe pamundësisë për të siguruar shifrën e 84 votave, po të hënën në mesnatë, Berisha e shtyu Topin drejt vendimit të tij për t´u tërhequr. Atëherë kur u propozua që lista e maxhorancës të mos kishte vetëm emrin e Topit si alternativë të vetme drejt Presidencës. "Janë katër-pesë anëtarë qeverie të cilët e kanë rrethuar Berishën, e kanë shkëputur krejtësisht nga realiteti dhe e kanë izoluar atë", thotë Leskaj duke bërë të qartë, pavarësisht se nuk përmend emra, se e ka fjalën për ministrin e drejtësisë Rusmajli, atë të financave Bode. Propozimi për një listë emrash dhe jo emrin e Topit si të vetmen alternativë të maxhorancës, e hodhi pikërisht Ruli, tashmë edhe ky një nga kandidatët e mundshëm të djathtë.

Topi "Nuk mund të talleni me emrin tim", Topi në fakt e ka kuptuar i pari se në mos tallje në kuptimin klasik të kësaj fjale, emri dhe aksionet e tij politike ishin vënë në lojë llogarish nga Berisha e ky grup ministrash.

Në mbledhjen e grupit parlamentar të PD-së, të hënën, ndryshe nga sa pritej, kandidatura e Topit nuk mundi të ishte e vetmja që maxhoranca do të paraqiste për postin e Presidentit të Republikës. Kushti i vënë nga socialistët, tërheqja pa kushte e kësaj kandidature, diskutohej të ishte një motiv më shumë për ta mbajtur së paku në listë nënkryetarin e PD-së. Por kundërshtinë e zgjidhi vetë Topi: Unë iki! Nënkryetari demokrat e lidhi vendimin e tij përpara një salle të heshtur me dy motive, së pari me faktin që ai nuk do të pranonte kurrsesi që me emrin e tij dhe për shkak të emrit të tij, vendi të rrëshqasë në zgjedhje të parakohshme dhe destabiliteti i mundshëm i vendit të dëmtonte çështjen e Kosovës dhe atë të integrimit në NATO dhe së dyti, sepse besonte që demokratët nuk e meritonin një gjë të tillë mbas tetë vitesh pritjeje në opozitë. Dhe që zgjedhjet e parakohshme rrezikojnë seriozisht t´i nxjerrin në opozitë. "Nuk mund të tallesh me emrin tim", i është drejtuar Topi në fund të fjalës së tij Berishës. "Zoti kryeministër, konspektojeni këtë fjalim!", i është

drejtuar gjithashtu kryeministrit nga vendi Bujar Leskaj, por duke marrë njëlloj si i pari, edhe ai heshtjen si përgjigje nga kryeministri i vendit. Gjithashtu dhe heshtjen e sallës. Që në fakt kishte mbetur e surprizuar. Sidomos mbështetësit e Topit, ata gjykohet se janë mbi 20 deputetë, ishin përgatitur që sulmin e tërthortë ndaj tij ta merrnin nga dyshja Rusmajli-Bode, por në fakt u befasuan nga propozimi i Genc Rulit, që insistoi që maxhoranca të kishte gjithashtu disa emra kandidatësh dhe jo vetëm atë të Topit në listë.

Katarsisi blu

Ish-ministri i kulturës nuk parapëlqen të përdorë termin "katarsis", ish-kalin e betejës së 2001 të Fatos Nanos në partinë e tij, por ai ngul këmbë në "pastrimin" e PD-së nga ministrat e shkëputur nga realiteti, "uzurpuesve të pushtetit të cilët as nuk i hapin telefonin deputetëve të partisë së tyre". Nuk tregon se në çfarë mënyre do ta realizojnë një gjë të tillë, por ndërkohë që targetet e tyre lihet të kuptohen, Leskaj ka sigurinë e njeriut që ka një kartë në xhep. Dhe kjo kartë, që nuk qëndron vetëm në xhepin e tij, është një numër që minimumi shkon deri në 20 vota të deputetëve të PD-së. "Po, ne do të imponohemi edhe me votë", paralajmëron frikshëm Leskaj, pa treguar më shumë detaje për hapat e mëtejshme të njerëzve të cilat tashmë janë bashkuar rreth pakënaqësisë së Topit. Sipas tij, trinomi qeverisës Berisha, Bode, Rusmajli nuk është më i përshtatshëm dhe se në vend të tij, do të ishte e udhës të krijohej binomi Berisha-Topi. Por për të mbërritur në këtë ndryshim, janë shumë hapa që duhet të merren, për të cilët, Leskaj preferon që të mos flasë. "Ne do të imponohemi edhe me votë", është një fjali që vërtet mund ta frikësojë maxhorancën në një diapazon vërtet të gjerë, që shkon që nga mos votimi i ligjeve kryesorë të paraqitur nga qeveria në Kuvend, e deri dhe në një abstenim të mundshëm në një mocion të mundshëm mosbesimi për qeverinë në Kuvend nga ana e opozitës.

Në të njëjtin bar përballë godinës së Kuvendit, afrohet dhe Topi. Me të edhe shtatë deputetë të afishuar si përkrahës të tij dhe pjesëmarrës në drekën-sfidë në Vlorë. I konsideruar lider i këtij grupimi, Topit i lirohet karrigia kryesore e tavolinës. Është dhe formalisht lider i deputetëve përkrahës të tij. Pak orë më pas, në pasditen e së martës ai do të fliste për Zërin e Amerikës. Agresiv në maksimum ndaj Edi Ramës, që e quan "xhelat politik", ai sulmon gjithashtu ashpër qeverisjen e partisë së tij. "Do të zhvilloj të gjithë debatin e brendshëm dhe do të mbështes ato linja për të cilat gjithë kolegët e mi janë koshientë dhe në mënyrë absolute, nuk do të lejojnë që interesat meskine të disa njerëzve të dominojnë

interesat madhore sidomos të misionit të të djathtës demokratike në Shqipëri e cila sot gradualisht ka ardhur në një stad ku nuk ka më identitet", shpërthen ai. Për të vazhduar më pas po me sulm dhe një paralajmërim të qartë për të gjithë ata individë me mentalitet të majtë e dyshimtë të integruar në PD duke shpallur luftën e tij me atë psikologji materialiste të këtyre individëve që nuk kanë "ardhur në qeveri për të kontribuar për sfidat e perspektivës, por për të joshur interesat e një grupi të vogël njerëzish. Kjo është sfida ime kryesore", thotë Topi. Dhe nëse kujtohen dhe deklaratat e forta të Leskajt, një nga mbështetësit e tij kryesorë, kjo do të thotë se në shënjestër do të jenë pikërisht ata katër-pesë vetë që kanë rrethuar Berishën. Domethënë qeveria. Kjo duket se do të jetë dhe surpriza që pritet të ndodhë në vjeshtën e këtij viti*).

*) ***Shënim i qershorit 2009:*** *Nënkryetari i PD-së z. Bamir Topi, u zgjodh President i Republikës nga grupi parlamentar i Partisë Demokratike dhe nga mbështetja e fuqishme e Kryeministrit z. Sali Berisha, i cili ideoi dhe drejtoi një proces të vështirë, por transparent, ligjor e demokratik negociatash për zgjedhjen e Presidentit.*

II. 4. Dëmshpërblimi i ish të përndjekurve politikë

II. 4.1 Leskaj: Të rishikohet ligji për të përndjekurit

11.09. 2007, Gazeta Shqiptare (nga Gilmana Bushati)

Të mërkurën në komisionin e ligjeve pritet të kalojë për diskutim projektligji për dëmshpërblimin e ish të persekutuarve politikë, që tashmë është miratuar nga qeveria. Deputeti Leskaj, gjatë mbledhjes së grupit parlamentar, sipas burimeve, i ka bërë disa propozime konkrete Berishës në lidhje me këtë projektligj. Burimet theksojnë se Leskaj ka kërkuar që kompensimi për të pushkatuarit të mos jetë aq sa ka përcaktuar qeveria, pra pushkatimi i barabartë me 8 vite burg dëmshpërblim. Ai ka propozuar që ata të dëmshpërblehen për 20-25 vite burg. Një propozim tjetër i deputetit të Vlorës, theksojnë burimet, është edhe që ata që janë detyruar të spiunojnë shokët e burgut, si pasojë e presionit të strukturave të regjimit, nuk duhet të shpallen publikisht, por të jenë vetë të persekutuarit që ta bëjnë këtë transparence. Të persekutuarit kanë gati propozimin, që do ta paraqesin në komisionin e ligjeve, që kjo kategori të dëmshpërblehet si të burgosurit e tjerë dhe nëse do të bëhet hapja e dosjeve për këtë pjesë, atëherë të hapen të gjitha dosjet e spiunëve të regjimit komunist.

II. 4.2 Ish të përndjekurit: Bien kërkesat e Leskaj dhe Çelës së PD-së

(Komisioni i Ekonomisë)

16.10.2007, Gazeta Panorama (nga Fabiola Çela)

Komisioni parlamentar i Ekonomisë gjatë shqyrtimit të këtij projektligji ka rrëzuar tre amendamentet e paraqitura nga ana e dy deputetëve të PD-së, Bujar Leskaj dhe Blerim Çela. Ish-ministri i Kulturës propozoi në komision që fusha e veprimtarisë të fillonte nga gushti i vitit 1943, por deputetët e maxhorancës dhe të opozitës

nuk kanë e pranuar një gjë të tillë. Gjithashtu Leskaj propozoi që në këshillin që do të krijohet Instituti i të Përndjekurve Politikë të jetë partner në mënyrën e ndarjes së fondit, por një gjë e tillë nuk është pranuar. Propozimi tjetër i deputetëve Çela e Leskaj, që u rrëzua nga komisioni ishte që "familjarët e të pushkatuarve të përfitonin dëmshpërblim financiar që konvertohet në masën e 20 vjet burg". Amendamenti i tij u kontestua me argumentim se ka një faturë të madhe financiare.

Komisioni i Ligjeve ka rrëzuar gjithashtu edhe kërkesën e bërë që të jetë Instituti i të Përndjekurve Politikë në procesin e dëmshpërblimit të ish-të përndjekurve. Komisioni i Ligjeve vendosi gjithashtu që të gjithë ish-të përndjekurit që kanë përfituar ndër vite duhet t'u zbritet masa e dëmshpërblimit që do të marrin me zbatimin e ligjit të ri. Ky ligj hyn në fuqi, nis nga zbatimi vetëm pas një viti.

II. 4.3 Të përndjekurit, sherr PR-PD

Kryekomisioneri Spaho rrëzon kërkesën e Bujar Leskaj

01.11.2007, Gazeta Panorama (nga Fabiola Çela)

Amendamentet e republikanëve për ish-të përndjekurit përçajnë maxhorancën në komisionin parlamentar të Ekonomisë. Shqyrtimi i 10 neneve të propozuara nga ana e republikanit Artur Hasanbelliu risolli edhe njëherë përplasjet brenda PD-së për çështjen e dëmshpërblimit të ish-të përndjekurve. Shkak i kësaj përplasjeje është propozimi për ndarjen në kategori të skemës së dëmshpërblimit ish-të përndjekurve. Kryekomisioneri Edmond Spaho u shpreh kundër skemës së kategorizimit të ish-të përndjekurve, si dhe të dëmshpërblimit të atyre personave që janë vrarë përpara 1944. "E kam thënë edhe një herë se për këtë kategori personash, se ligji synon të dëmshpërblejë ata persona që janë dënuar nga shtetit, por për përpara 1943 nuk ka pasur shtet", theksoi deputeti i PD-së, Spaho. Ai hodhi idenë e dhënies së statusit të dëshmorit të këtyre personave. "Më vjen mirë që e propozoni ju këtë nismë, por le ta marrë Ministria e Mbrojtjes të propozojë shpalljen e statusit të dëshmorit, pasi në këto kushte nuk mund t'i përfshijmë ata", theksoi Spaho. Por deputetët demokratë Bujar Leskaj dhe Blerim Çela ishin pro përfshirjes së tyre. Këta dy deputetë votuan pro kësaj skeme. Për nenin nëntë, ku kërkohet kategorizimi sipas moshave, Spaho theksoi se "ka biseduar me shoqatat dhe janë kundër zgjidhjes në bazë të kësaj forme". Pro variantit të paraqitur nga republikanët u shprehën

deputetët Leskaj, Metalla dhe Çela. "Ne duhet t'i japim mundësi që personat në moshë të thyer mbi 70 vjeç t'i gëzojnë këto para. Mendoj nga shifrat janë rreth 4 mijë ish-të dënuar që janë gjallë dhe mendoj se duhet të zgjidhet t'i jepet përparësi mosha mbi 70 vjeç", u shpreh Hasanbelliu. Socialistët theksuan se skema e paraqitur ka një kosto financiare dhe se qeveria duhet të përcaktojë faturën. "Shoqatat duhet të jenë dakord për këtë skemë. Varianti i PR-së është më i plotë dhe duhet të gjeni mirëkuptim me shoqatat", theksoi Leskaj. Komisioni më pas vendosi që këtë variant të republikanëve ta paraqesin në seancë dhe në të njëjtën kohë qeveria dhe ministri i Financave të japë mendim për koston financiare të kësaj skeme. Ndërsa demokratët rrëzuan amendamentin e paraqitur nga deputeti i partisë së tyre, Bujar Leskaj. Ai kërkonte që "familjarët e viktimave, të ekzekutuara, të pushkatuara, me dënim politik të padrejtë, për vuajtjen e persekucionin përfitojnë një dëmshpërblim financiar të barabartë gjithsej në masën e 20 viteve të kompensimit dënimi me burgim. E drejta e familjarëve për të kërkuar dëmshpërblim është e drejtë pasurore jo vetjake". Për këtë Spaho e rrëzoi duke theksuar se "kjo kërkesë rrit me 2,5 herë faturën financiare të shtetit".

II. 4.4 Leskaj: Shpresoj ende te PD

01.11.2007, Gazeta Panorama

Deputeti demokrat, Bujar Leskaj, kërkoi me insistim votimin e amendamentit të tij, por që u rrëzua nga pjesa më e madhe e kolegëve të partisë së tij. Ai kërkoi që personat e pushkatuar të dëmshpërblehen jo me tetë vite burgu, por me 20 vjet burg. "Është e drejtë e morale dëmshpërblimi i kësaj shtrese. Unë ende besoj dhe shpresoj se PD-ja do të gjejë mirëkuptimin tim për ta miratuar këtë amendament, nëse nuk bie dakord unë do të kërkoj që të votohet në seancën parlamentare", deklaroi Leskaj.

II. 4.5 Leskaj: Nuk ka faturë që dëmshpërblen të përndjekurit

Deputeti i PD-së përshëndet dekretin e Topit

01.12. 2007, Gazeta Shqiptare (nga Gilmana Bushati)

Një nga deputetët e maxhorancës që mbështeti kërkesat e shoqatave të ish të dënuarve të regjimit komunist, Bujar Leskaj, theksoi dje se dekretimi i ligjit në fjalë nga ana e presidentit është detyrimi ligjor, politik dhe moral që ka jo vetëm partia në pushtet,

por e gjithë shoqëria shqiptare ndaj kësaj shtrese fisnike. “Në këto momente paraqet një rendësi të veçantë implementimi dhe zbatimi i këtij ligji dhe unë kam besim që institucionet qeveritare, krejt qeveria do të realizojnë përmbushjen e atyre detyrimeve financiare që ky ligj parashikon në vlerë edhe në kohë”, - u shpreh dje Leskaj. Sipas tij, të gjithë duhet ta kuptojnë se ky ligj çdo faturë financiare sado e madhe që të jetë nuk dëmshpërblen dot ato vuajtje të pafund, atë qëndresë demokratike, antikomuniste që ato kanë bërë. “Kemi një dëmshpërblim ligjor, një faturë financiare për të paguar për veprimet arbitrare, antiligjore për veprimet e qeverisjes së 50 viteve të sundimit komunist ndaj kësaj shtrese duke respektuar Kushtetutën e nenin 44 të saj si dhe dispozitat e Kodit Penal dhe dispozitat ligjore”, - theksoi më tej deputeti Leskaj. Sipas tij, “Dekretimi i këtij ligji nga ana e Presidentit të Republikës do të mirëpritet nga shoqatat e ish-të përndjekurve dhe persekutuarve politikë, edhe pse marrja e këtij dëmshpërblimi është i vonë në kohë përsëri është tepër i domosdoshëm”.

II.5. Hapja e dosjeve të politikanëve e domosdoshme

14.10.2007, Gazeta Shqiptare, koment sipas deklarimit në TV Alsat

Deputeti i Partisë Demokratike, Bujar Leskaj, u shpreh dje, se me të vërtetë është vonë për t'i hapur dosjet e politikanëve, por më mirë vonë se sa kurrë. "Është e nevojshme për këtë tranzicion të zgjatur të vendit tonë duke reflektuar mbi atë të kaluarën diktatoriale që kemi kaluar të gjithë, duke parë dhe çfarë ka prodhuar politika shqiptare në këto 16 vite, urgjentisht dhe në zbatim edhe të rekomandimeve të Asamblesë Parlamentare të KE-së duke reflektuar dhe veprimet e shteteve të ndryshme demokratike ish-komuniste për këtë problem, duhet që edhe në Shqipëri të hapen dosjet e politikanëve pa përjashtim", - tha dje deputeti i Vlorës. Sipas tij, ky proces të realizohet jo për të denigruar njeri, por për ta pastruar politikën shqiptare, si nga ata që kanë persekutuar, oficerët madhorë që kanë persekutuar shoqërinë shqiptare dhe segmente të caktuara të saj, "ashtu dhe nga ata persona që aksidentalisht janë viktimizuar". Leskaj, thekson se është e shumë e rëndësishme që kjo kategori njerëzish, qoftë në politikë, qoftë në administratën shtetërore të mos merren me politikë aktive apo me drejtime të atyre posteve që ata mbajnë aktualisht. "Të mos merren me politikë aktive, të mos trysnohen nga politikanët e ditës. Le të vazhdojnë të shkruajnë romane, poezi, kujtime, por jo të merren me politikë aktive", - u shpreh dje Leskaj.

I pyetur nëse Partia Demokratike duhet të kërkojë falje për përfshirjen e disa prej ish-sigurimsave si në politikë ashtu dhe në administratë, ai përgjigjet se PD-ja ishte e para që e ndërmori një iniciativë të tillë, pra për ta pastruar politikën nga këta njerëz në vitin 1996. Por kjo nismë, sipas Leskajt, u ndërpre keqas nga revolucioni i vitit 1997, i cili e regresoi shoqërinë shqiptare. Deputeti i PD-së, theksoi dje se tashmë ka ardhur koha që parlamenti shqiptar me guxim ta hedhë këtë hap drejt zbardhjes së vërtetë të çështjes së

dosjeve të spiunëve të sigurimit të shtetit. “Parlamenti me guxim duhet të miratojë ligjin për këtë çështje, pa cenuar njeri, në mënyrë që politika dhe administrata të pastrohen nga persekutorët e atyre persekutorëve dhe prej atyre që kanë bashkëpunuar me sigurimin e shtetit, sado e dhimbshme të jetë kostoja. Nga ky pastrim fiton vetëm e ardhmja e vendit”, - u shpreh Leskaj lidhur me çështjen e debatueshme të përfshirjes së ish-sigurimsave në politikë madje dhe në poste drejtuese të shtetit shqiptar. Ai thotë, Shqipëria duhet ta realizojë edhe pse ish-vendet e tjera komuniste këtë proces e kanë kryer me kohë.

II.6. Berisha t'i kalojë në skaner gjithë zyrtarët e lartë

Intervistë dhënë Gazetës Shqip.
Tiranë më 17 Nëntor 2007 (intervistoi Erjon Ajazi)

Ish-ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, aktualisht deputet i PD-së në Vlorë, Bujar Leskaj, ka përgëzuar betejën që Kryeministri Berisha ka nisur kundër korrupsionit. Në një prononcim për "Shqip", deputeti Leskaj ka kërkuar nga kreu i qeverisë që të vazhdojë pa asnjë pikë mëshire betejën kundër korrupsionit me kushtet e vetme, çlirimin e vendit nga drejtuesit e korruptuar dhe integrimin e tij në NATO e BE.

Pa preferuar të specifikojë emra të veçantë, deputeti Leskaj është shprehur se "në skanerin e kësaj lufte, Kryeministri Sali Berisha duhet t'i kalojë të gjithë, duke filluar nga anëtarët e qeverisë, ish-anëtarët e saj, për të përfunduar edhe te deputetët, madje edhe te të gjithë drejtorët e niveleve më të larta". Deklarata e deputetit të PD-së lë të kuptohet se brenda partisë më të madhe të Parlamentit ekziston ndarja në dy kampe, të cilat tashmë janë të shfaqura qartë pas debatit të ashpër që tronditi kabinetin qeveritar mes ish-ministrit Ilir Rusmali dhe ish-shefit të Burgjeve, Sajmir Shehrit. Partia Demokratike pranon problemet që ekzistojnë tek e djathta dhe kërkon që në këtë mënyrë të thellohet lufta kundër korrupsionit, duke mos privuar askënd, kushdo qoftë ai, ministër, deputet apo zyrtar i lartë i administratës shtetërore.

Përgjigjja ndaj Gjinushit

Partia Demokratike, kryesisht njerëzit më të besuar të Presidentit Bamir Topi, u janë përgjigjur dje thirrjeve të kryetarit të PSD-së, Skënder Gjinushit, që mbështetësit e Topit t'i bashkohen mocionit që do kërkojë opozita ndaj kabinetit "Berisha". Deputeti Bujar Leskaj e ka etiketuar kreun e PSD-së si "dashamirësin" e PD-së. "Tentativat e 'dashamirësit' të madh të Partisë Demokratike, Gjinushit, për të krijuar aleanca fluide, i bën deputetët e PD-së

të jenë më të vëmendshëm në prononcimet e tyre", tha ai. Sipas Leskajt, PD-ja do ta mbështesë pa asnjë kusht Kryeministrin Berisha dhe ministrat e tij, pavarësisht ndonjë objeksioni ose vërejtjeje që ajo mund të ketë ndaj ministrave. Leskaj bëri me dije se të tilla vërejtje nuk janë penguar të ngrihen në grupin parlamentar të PD-së dhe kritikat në adresë të qeverisë do të bëhen vetëm në mbledhjet e grupit të PD-së, pa praninë e mediave.

Ndryshimet në kabinet

"Nisur nga fakti që Kryeministri Berisha ka deklaruar se për momentin nuk pranon të bëjë ndryshime në kabinet, atëherë çdo koment i yni është i tepërt", është shprehur deputeti demokrat i Vlorës. Leskaj theksoi se Kryeministri do të gjejë mbështetjen e grupit të PD-së për çdo deklaratë të lëshuar prej tij lidhur me ndryshimet në qeveri. Mendimi personal i deputetit Leskaj është që qeveria t'u nënshtrohet disa ndryshimeve në kabinet, por të drejtën ekskluzive e ka vetëm kreu i ekzekutivit. Ndonëse deputetët e PD-së nuk preferojnë të deklarojnë hapur ndryshimin e kabinetit, pas perdes blu të Partisë Demokratike janë duke u përgatitur analizat e punës së bërë për secilin ministër dhe ndryshimin e kabinetit pas miratimit të buxhetit në Kuvend.

Për Kryeministrin

"Lideri i PD-së përkrahet nga të gjithë deputetët e tij dhe situata në gjirin e PD-së është si nata me ditën krahasuar me atë çfarë po ndodh brenda PS-së", shprehet ish-anëtari i kabinetit qeveritar, që prej shtatorit 2005 deri në mars të 2007. Sipas tij, Kryeministri Berisha gjen përkrahje edhe nga opinioni i shëndoshë demokrat dhe inkurajohet për ta vazhduar dhe thelluar luftën ndaj korrupsionit. "Lufta ndaj korrupsionit ka qenë edhe lajtmotivi i Kryeministrit, i cili shoqëruar me sloganin 'duart e pastra' jam i sigurt që s'do të ngelet vetëm një slogan, por më shumë se aq", tha Leskaj, duke u shprehur bindshëm se Kryeministri do ta vazhdojë betejën ndaj korrupsionit.

"Duart e pastra"

Deputeti Bujar Leskaj kërkon nga Kryeministri Sali Berisha që lufta ndaj korrupsionit të bëhet me çdo kosto dhe pa asnjë kompromis. "Kjo luftë ka koston e saj, por Kryeministri Berisha është i ndërgjegjshëm jo thjesht si Kryeministër për detyrimet e veta, por edhe si lider i së djathtës", tha ai. Leskaj kërkon që slogani "Duart e pastra" që sollën dy vjet më parë Partinë

Demokratike në pushtet pas tetë vjetësh të vështira në opozitë, që pas ngjarjeve të 1997-ës, të bëhet kryefjala e qeverisë demokratike. "Kjo luftë duhet bërë me çdo kosto dhe pa kompromis. Në skanerin e kësaj lufte, kreu i qeverisë, Sali Berisha, duhet t'i kalojë të gjithë, duke filluar nga anëtarët e qeverisë, ish-anëtarët e saj, për të përfunduar edhe te deputetët, edhe te të gjithë drejtorët e niveleve më të larta", theksoi Leskaj.

II.7. Pengu im që nuk pastrova FSHF-në

02.12.2007, Gazeta Panorama

Ish-ministri i Turizmit dhe Kulturës, Bujar Leskaj, tha dje në një prononcim për gazetën "Panorama", se dy humbjet e fundit të kombëtares kanë nxjerrë parashikimet e tij lidhur me shitjen e mundshme të këtyre dy ndeshjeve. Ndonëse nuk ka pranuar të komentojë deklaratat e kryeministrit të një dite më parë, ai theksoi, se pengu i vetëm që i ka ngelur nga koha që ka qenë ministër është fakti që nuk ka mundur të pastrojë dot FSHF-në dhe kjo sipas tij, për efekt kohe. "Në qoftë se kam ndonjë peng në punën time si ministër i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, kam pengun që nuk pastrova Federatën Shqiptare të Futbollit, kjo jo për dobësinë time, pasi të gjitha përpjekjet tona u fituan edhe në rrugë gjyqësore, por për efekt kohe. Në këtë federatë duhet transparencë financiare, transparencë zgjedhore, transparencë në raportet mes federatës dhe klubeve dhe transparencë me kombëtaren. Kjo duhet bërë për hir të tifozëve kuqezi", u shpreh Leskaj. Më tej deputeti i PD-së thotë, se këto që po ndodhin tani me kombëtaren e futbollit dhe akuzat e shumta për shitje ndeshjesh, konfirmojnë parashikimet e tij të një viti e gjysmë më parë. "Të gjitha përpjekjet tona ishin për transparencë në federatë dhe në futboll. Betejën nga ana ligjore e fitoi ministria kundër drejtuesve të federatës. Më vjen keq që parashikimet e mia po dalin, për të vetmen arsye që futbolli është i të gjithëve dhe nuk ka të drejtë ligjore asnjë titullar institucioni të qëndrojë indiferent. Jam i bindur se futbolli i pastër një ditë do të triumfojë. Mbi çdo pavarësi institucionesh që pretendohet është pastërtia", thotë më tej Leskaj, teksa shton, se akoma vazhdon të mendojë se 30% e drejtuesve të klubeve janë mafiozë.

II.8. Imazhi Shqiptar i Politikanit të Ri

Në ambientet e Qendrës Ndërkombëtare të Kulturës "Pjetër Arbënori" më 29 dhjetor 2007, u zhvillua Festivali i II-të Ndërkombëtar "IMAZHI SHQIPTAR".

Në këtë aktivitet morën pjesë personalitete të ndryshme shqiptare dhe figura të tjera publike nga fusha të ndryshme të jetës. Forumi Imazh & Media ka për qëllim evidentimin e individualiteteve, personaliteteve dhe figurave publike Shqiptare të cilat kanë rritur dhe rrisin imazhin e Shqipërisë në botë. Në këtë festival vlerësohet puna e madhe që kanë bërë këto personalitete të artit, kulturës, diplomacisë, ushtrisë, sportit dhe politikës ndjekës të përfaqësuesve më të denjë të shqiptarëve në botë si figura të mëdha Perandorë e Papë, që nga Skënderbeu, Ismail Qemali, Gjergj Fishta, Nënë Tereza, Ibrahim Rugova e deri tek Ismail Kadare etj.

Çmimet e mëdha të vitit 2007 "Imazhi Shqiptar" u ndanë për:

z. Bujar Leskaj me çmimin "Imazhi i Politikanit të Ri",

z. Bashkim Hoxha me çmimin "Emisioni më i mirë Televiziv i Vitit",

z. Vaid Vaidillahu me çmimin "Ambasadori i Imazhit Shqiptar në Botë",

z. Ilia Terpini me çmimin "Syni i Shqiponjës",

z. Thoma Nini me çmimin "Imazhi Diplomacisë Shqiptare në Botë",

z. Kreshnik Qato me çmimin "Imazhi Shqiptar në Sport",

z. Bardhyl Mahmuti nga Maqedonia me çmimin "Imazhi i Politikanit Vizionar",

Prof. Dr. Enver Hasani nga Kosova me çmimin "Imazhi Shqiptar në Arsim",

z. Vesel Sinishta nga Mali I Zi me çmimin "Imazhi i Politikanit Integrues",

z. Nazmi Hoxha me çmimin "Imazhi Shqiptar në Pikturë",

z. Fadil Kraja me çmimin "Imazhi Shqiptar në Letërsi",

kolonel Ndrea Prendi Komandant i Gardës së Republikës me çmimin "Imazhi në Forcat e Armatosura" …

Në Festivalin e I-rë çmimet në fushën e politikës i kanë marrë: Dr. Ibrahim Rugova "Imazhi Kombëtar i Politikanit", Ali Ahmeti "Imazhi i Politikanit të Ri Vizionar", Lutfi Haziri "politikani i Ardhmërisë".

Në festivalin e III-të u nderuan me çmime znj. Liri Berisha "Për kontributin e saj si intelektuale, si nënë dhe si mjeke ndaj fëmijëve në nevojë jo vetëm në Shqipëri, por edhe jashtë saj", z. Arbën Xhaferi "Imazhi i Politikanit Vizionar", z. Ramush Haradinaj "Imazhi i Luftëtarit të Lirisë" etj…

Forumi **"IMAZH & MEDIA"**
Tiranë, më 29 dhjetor 2007

Forumi "Imazh & Media" në çmimet vjetore që jep për njerëzit dhe personalitet më të spikatura, që i kontribuojnë imazhit shqiptar në të gjithë trevat shqiptare dhe në botë, më 29 dhjetor 2007, i ka akorduar Çmimin "Imazhi i Politikanit të Ri" z. Bujar Leskaj me motivacionin:

"Për promovimin e vlerave kombëtare, në kushtet e një bashkëpunimi jetik në bashkëpunimin mes Shqipërisë dhe Kosovës, përballë zhvillimeve Euro-Ballkanik, në kushtet e promovimit, të evidentimit të vlerave historike të kombit dhe ato të zhvillimeve në epokën e Rendit të Ri Botëror, si njëri nga politikanët e spikatur dhe iniciator, në pozicionin e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për t'i shndërruar këto vlera në pjesë të integrimit dhe të një imazhi real integrues kombëtarë.

Z. Bujar Leskaj, ka orientuar strategjikisht dhe ka inspiruar lëvizjen intelektuale, kulturore, impulset dhe kontributet e njerëzve kontributor në të gjithë nivelet e shoqërisë shqiptare dhe atë të huaj, për t'i kontribuar faktorit shqiptar në Ballkan dhe më gjerë, në përshtatje me strategjinë e qeverisë demokratike, të ardhur me votë të lirë në vitin 2005 dhe në bashkëpunim me kryeministrin e Shqipërisë z. Sali Berisha, Kryeministrit të Kosovës z. Agim Çeku dhe të Ministrit të Kulturës së Kosovës z. Astrit Haraçia.

Z. Bujar Leskaj ka treguar një angazhim atdhetar dhe intelektual, në të gjithë pozicionet e tij, për të shpalosur performancën më të duhur dhe më të nevojshme të shqiptarëve në të gjithë dimesionet e saja, jo vetëm në rrugën qeveritare, që i ka afruar drejtimi i njërit prej institucioneve më të rëndësishme të Shqipërisë, por edhe aksesorëve të tjerë, veçmas të Forumit "Imazh & Media", i cili iu kontribuon vlerave të imazhit shqiptarë që prej thellësive tona historike dhe në ditët tona, duke aplikuar një angazhim elitar, për të cilin ka nevojë imazhi shqiptar. z. Bujar Leskaj është pjesë e rëndësishme e të gjithë këtij angazhimi, që në momentet kur ai është bërë prezent në jetën politike, kulturore dhe sociale të vendit."

Tiranë, më 29 dhjetor 2007
Për forumin Imazh & Media
Kryetar
Dr. Astrit Memia

II.9. Ligji i Gjobave ndez debatin në kuvend

(Ministri i Financave në Komisionin e Ekonomisë dhe Ligjeve)

27.03.2008, Gazeta Panorama

Rikthehet debati për Ligjin e Gjobave ndaj biznesit. Kreu i Ministrisë së Financave Ridvan Bode ka prezantuar dje në kuvend projektligjin e ri për procedurat tatimore. Por ndryshe nga më parë këtë herë projektligji i ri është kundërshtuar edhe nga vetë deputetët e opozitës. Pika më e debatuar e këtij projektligji është neni që i detyron bizneset të parapaguajnë 15 për qind të gjobës. Ky nen është kundërshtuar ashpër nga deputetët e opozitës dhe sidomos nga sipërmarrësit. Gjatë debateve të djeshme ministri i Financave Bode është shprehur se është i gatshëm të pranojë heqjen e tij por vetëm me një kusht. "Atëherë le ta bëjmë një ligj që të detyrojë gjyqësorin të mos bllokojë aktet administrative siç e ka gjithë bota. Por për këta na duhen votat e opozitës sepse i kemi të gjitha vendimet të bllokuara", ka thënë ministri. Por nuk ka ndarë të njëjtin mendim me të deputeti demokrat Bujar Leskaj, madje gjatë diskutimeve ai propozuar të gjendet një zgjidhje tjetër. "Le të bëjmë një ligj ku të dënojmë, penalizojmë gjykatësit kur abuzojnë, s'kemi pse rëndojnë bizneset", është shprehur Leskaj. Ligji i parapagimit të gjobave është miratuar vitin e kaluar, por duhet kujtuar që deputeti i PD e ka votuar kundër edhe atëherë. Bizneset e kanë kundërshtuar ashpër atë. Aktualisht është Gjykata Kushtetuese ajo që ka marrë në shqyrtim vlefshmërinë e këtij ligji.

II.10. Përgjegjësi e njëjtë për të gjithë

Nuk do ta votoj heqjen e imunitetit të Mediut
Berisha: Burrë shteti apo burrë pushteti?!

Intervistë: Gazeta Korrieri datë 03.04.2008
(intervistoi Kreshnik Kuçaj)

Si i shikoni zhvillimet e fundit politike dhe kërkesat e përsëritura të opozitës për dorëheqjen e kryeministrit Berisha? A vihet në dyshim bashkëpunimi mes dy forcave kryesore politike?

Zhvillimet e fundit politike në vend karakterizohen nga një kompleksitet dhe paqëndrueshmëri për vet fatin e keq që një proces madhor si është marrja e ftesës për anëtarësim në NATO u shoqërua nga një tragjedi si ajo e Gërdecit. Përpara se të bëjmë rolin e prokurorit dhe të gjykatësit personalisht mendoj që ne deputetët e parlamentit shqiptar, partitë politike të pozitës apo opozitës, të mëdha ose të vogla të shohim përgjegjësitë tona në funksion të detyrimeve ligjore ndaj qytetarëve të Shqipërisë, bizneseve, sigurisë në vend e rajon, të sotmes dhe të ardhmes së vendit. Duke mos përjashtuar në asnjë moment përgjegjësinë e Qeverisë, Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, mendoj që mbas fatkeqësisë Qeveria ka reaguar dhe po vepron me shpejtësi për ristabilizimin e gjendjes. Natyrisht përgjegjësia jonë është politike, ligjore dhe morale dhe ne si maxhorancë po e marrim dhe do ta marrim hap pas hapi. Por është e pakuptimtë, tendencioze politika e PS për të përfituar e abuzuar me këtë fatkeqësi. Një sy i vëmendshëm shikon një politikë Janusjane (me dy fytyra), të opozitës së majtë. Nga njëra anë PS në përkrahje të procesit të anëtarësimit në NATO, zhvillon përveç të tjerash dhe një tryezë të vlerësuar me Ambasadorët e vendeve të NATO s në Shqipëri, nga ana tjetër segmente të caktuara të deputetëve të majtë përpiqen të bllokojnë Parlamentin. Sigurisht që deputetët do të shprehin mendimet dhe vlerësimet për çdo proces a ngjarje, por nuk është e drejtë e asnjë force politike, e asnjë deputeti të bllokojë këtë forum të lartë. Çdo

zhvillim integrues në BE e NATO duhet të kuptohet mbi të gjitha si detyrim i mëtejshëm për të zhvilluar më tej shtetin e së drejtës, për të forcuar elementët e ekonomisë së tregut për zhvillim e progres kombëtar, e në radhë të parë këto detyrime janë për deputetët e forcat politike. Secili duhet të prodhojë stabilitet e jo destabilitet, shtet ligjor e jo shtet partiak, progres dhe jo regres.

A mendoni se pas samitit të NATO-s mund të rinisë bashkëpunimi mes dy forcave politike për reformat në vend, duke parë që situata politike është rënduar shumë? Si i vlerësoni kërkesat e përsëritura të opozitës për dorëheqjen e kryeministrit Z. Berisha?

Unë jam optimist që arsyeja e shëndoshë do të triumfojë dhe në radhët e opozitës. Pas marrjes së ftesës ne Bukuresht për shoqërinë, shtetin e në veçanti politikën shqiptare rriten detyrimet për bashkëpunim e reforma. Në këtë suazë dy forcat politike kryesore mendojë që do të dinë të bashkëpunojnë. Në një situatë politike të rënduar dallohen dhe drejtuesit e politikanët e matur dhe të përgjegjshëm, që nuk mungojnë në këto forca politike, pavarësisht defekteve të përgjithshme që kemi. Kërkesa e opozitës për dorëheqjen e kryeministrit është kërkesë e pakuptimtë, absurde.

Ai nuk është thjeshtë kryeministri i një maxhorance i zgjedhur në kalkulime partiake, por është Kryetari i Partisë më të madhe që e ka drejtuar këtë maxhorancë drejt fitores në vitin 2005 mbas 8 viteve të vështira në opozitë. Krahas programit elektoralë, premtimeve e marrëveshjeve të ndryshme paraelektorale të gjithë forcat politike të djathta kanë dalë në zgjedhjet e vitit 2005 me deklarimin eksplicit që Sali Berisha do të jetë Kryeministër, nëse e djathta fiton. Pra problemi i kryeministrit është problem i maxhorancës, është problem i Partisë Demokratike, i përcaktuar qartë pa ekuivoke, ku më duhet të theksoj që ky kryeministër gëzon mbështetje të plotë, edhe nga të gjithë ato të themi, linja apo segmente të vogla, brenda të djathtës, që në momente të caktuara mund të jenë në diskordancë me mendime apo veprime të caktuara të qeverisë. Tani që ju po më merrni këtë intervistë unë sapo kam dalë nga një mbledhje e Komisionit Parlamentar të Ekonomisë me përfaqësuesit e biznesit. Ne diskutuam për projektligjin për "procedurat tatimore" ku unë personalisht vazhdoj të jem koherent në atë qëndrimin tim të shprehur me votë një vit më parë që atë pjesë ku e rëndojmë biznesin, problemin e shumë përfolur të parapagimit të gjobave, që u miratua nga parlamenti para një viti, unë them se qeveria duhet të tërhiqet dhe t'i lerë më shumë hapësirë biznesit. Ne duhet ti inkurajojmë e përkrahim bizneset vendase dhe të huaja. Një qeveri e mirë, një

maxhorancë efikase është ajo që e inkurajon biznesin në të gjithë kuadrin ligjor e veprimtarinë administrative e fiskale të saj.

Si i shikoni ndryshimet që priten të bëhen pas Samitit të NATO-s?

Personalisht ato ndryshime i shoh me shumë qetësi, larg çdo pasioni. Patjetër ato ndryshime janë të nevojshme dhe në rast se zërat brenda Partisë Demokratike shpreheshin më parë që ndryshimet janë në dorën dhe i di kryeministri, tashmë mund të them me plot gojën që ka ardhur koha për ndryshime të qenësishme në Qeveri e përmirësim të metodave qeverisëse. Ndryshimet do të iniciohen sigurisht nga kryeministri Sali Berisha dhe do të mbështeten nga grupi parlamentar, duke synuar së pari mbajtjen e premtimeve të 2005 dhe largpamësi për 2009, vlerësim për çka është arritur dhe intrasigjencë për çka duhet të arrihet e mbi të gjitha plotësimin e detyrimeve ligjore që Qeveria e maxhoranca ka ndaj shqiptarëve dhe Shqipërisë.

Keni qenë edhe vetë pjesë e kabinetit qeverisës. Mendoni se Partia Demokratike, si forcë qeverisëse i ka realizuar premtimet që dha në vitin 2005?

Mendoj që ka vend për të thelluar punën e Qeverisë dhe maxhorancës, për prosperitet kombëtar e integrim në BE dhe NATO. Kryeministri Berisha duhet të vazhdojë të tentojë ti drejtojë të gjitha institucionet, ministritë drejt një transparence të plotë, të cilën e kam theksuar disa herë në diskutimet e mia në parlament, duhet të vazhdojmë të thellojmë luftën ndaj korrupsionit, duke qenë të ndërgjegjshëm se korrupsioni nuk është as i kuq e as blu, por një gangrenë e keqe për shoqërinë dhe ekonominë. Padyshim, me këmbë në tokë, duke parë realitetin në sy e jo atë të projektuar nga analistët apo "bosët e mediave" që i kanë lustruar këpucët e lajkatuar çdo kryeministër në detyrë, tash 15 vjet, kryeministri Berisha duhet të analizojë efikasitetin e qeverisë dhe punën e ministrave të tij në zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, në rezultatet konkrete në mirëqeverisje drejt qeverisjes me duar të pastra e në shërbim të popullit e jo në qeverisje që e mat efektivitetin me daljet në televizion të Ministrave. Unë si deputet i Vlorës kam bindjen e plotë që Kryeministri Berisha është burrë shteti dhe jo burrë pushteti. Si i tillë mendoj që ka detyrimin ndaj shqiptarëve që e kane votuar dhe nuk e kanë votuar, ndaj demokratëve që e kanë mbështetur 8 vjet në opozitë, ndaj ish të përndjekurve politikë që kanë sakrifikuar për këtë komb, ndaj pronarëve të vjetër që kërkojnë shtet ligjor, ndaj shqiptarëve të shtetit më të ri në Evropë – Kosovës, që të mbaj e finalizojë premtimet e bëra në fushatën e 2005 e më

gjerë premtimet e tija në politikë nga 1990 e sot. Megjithatë më gjerë do të shprehem në grupin parlamentar të PD.

Si e shihni rikthimin e deklaruar të Fatmir Mediut në kabinetin qeveritar, pas zbardhjes së akuzave?

Unë personalisht e vlerësoj dorëheqjen e zotit Mediu, si reflektim i një politikani të përgjegjshëm, mbas ngjarjes së rëndë të ndodhur në Gërdec ku Ministria e drejtuar prej tij dhe Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë i drejtuar nga Shefi i Shtabit kanë përgjegjësi. Ngjarja e Gërdecit është një ngjarje e rëndë për secilin prej nesh. Akuzat Penale ndaj tij nuk i besoj. E vlerësoj zotin Mediu si politikan, në drejtimin e Partisë Republikane dhe për atë punë të mirë integruese euro-atlantike që ka bërë, për marrjen e ftesës për anëtarësim në NATO, por nuk do ia këshilloja rikthimin e tij në kabinet në këto momente si reflektim moral politik. Gjithsesi ky është problem i Partisë Republikane dhe Kryeministrit Berisha.

Vetë Fatmir Mediu ka deklaruar se është i gatshëm që të lerë imunitetin që tu lerë rrugë të hapur hetimeve. Nëse ka një kërkesë për heqjen e imunitetit të Mediut, ju si do ta votoni?

Unë e vlerësoj gatishmërinë e tij për tu lënë rrugë të hapur hetimeve. Nuk mendoj se zhvillimi i mëtejshëm i këtyre hetimeve ngelet në faktin që ne duhet ti heqim apo jo imunitetin. Vetë zoti Mediu është shprehur i gatshëm për institucionet ligjore dhe prokurorinë, ky proces do të vazhdojë natyrisht derisa të dalin përgjegjësitë ligjore. Heqja ose mos heqja e imunitetit të Mediut nuk ndikon në këtë drejtim dhe drejtësia nuk pengohet që të bëjë punën e saj. Personalisht nuk do të votoj një heqje të imunitetit të deputetit Fatmir Mediu, pasi përpara se të heqim imunitetin ne, maxhoranca, Kryeministri por edhe Presidenti duhet edhe nga ana administrative të thellohemi në tërë përgjegjësit ligjorë dhe administrative, të faktorëve civilë, politikë dhe ushtarakë të kësaj tragjedie që ndodhi. Përveç të tjerave, Partia Demokratike duhet të mbaje premtimin e saj, të "Duarve të Pastra", të goditjes së korrupsionit, premtimin për të kaluar në skaner ato zhvillime politike dhe ekonomike korruptive të para 2005. Para heqjes së imunitetit të zotit Mediu apo të ndonjë deputeti tjetër të PD-së, ne kemi detyrë morale para shqiptarëve, para atyre që na votuan në korrik 2005 të merremi me imunitete të tjera ish-qeveritarësh socialistë. Asnjë proces apo zhvillim nuk duhet kthyer në "gjueti shtrigash" politike por askush nuk ka të drejtë apo monopol të zerojë, të harrojë shkelje të ligjit dje, sot , përpara apo pas vitit 2005.

Si e shihni takimin e disa deputetëve të maxhorancës me Fatmir Mediun, disa ditë më parë në një nga lokalet e kryeqytetit?

Unë personalisht nuk kam qenë në atë kafe të përfolur. Nuk jam pjesë e këtyre kafeneve, e këtyre bisedave politike që zhvillohen në zyra, nuk më pëlqen. Problemi i grupimeve të deputetëve ka funksionuar vetëm një herë, për sa i përket zhvillimeve të brendshme në Partinë Demokratike, kur ishte në diskutim kandidatura e kryetarit të grupit parlamentar zotit Bamir Topi për president republike. Çdo imitim i asaj tavoline unë mendoj se është i dështuar si krejt imitimet në përgjithësi. Megjithatë çdo deputet është përgjegjës për veprimet e tij dhe mosveprimet e tij dhe nuk më takon mua të gjykoj kolegët deputetë.

II.11. Mbi ndryshimet në Kushtetutë

Ish ministri i Kulturës: Dekretet e Topit nuk mund t'i firmosë Xhuveli
Bujar Leskaj: Presidenti nuk është ndërtim pa leje "s'mund të miratohet si ligji i Shabanit".

14.04.2008, Gazeta Shqiptare, (intervistoi Gilmana Bushati)

Deputeti i PD-së, Bujar Leskaj, i cili që ditën e parë kritikoi ashpër disa propozime për ndryshime kushtetuese të paraqitura nga deputetja Trashani në komisionin e ligjeve, shprehet se është kundër faktit që zgjedhja e kreut të shtetit të përfundojë të zgjidhet me aq vota sa kaloi ligji i legalizimeve. Sa i takon ndryshimeve në Kushtetutë për mocionin e besimit të kryeministrit, ai e përkrah variantin e paraqitur duke shtuar se shpreson në thellimin e luftës kundër korrupsionit nga ana e Berishës.

Zoti Leskaj, grupi i PD-së ka bërë disa propozime për mënyrën e zgjedhjes së presidentit dhe për kompetencat e tij, ju si i keni vlerësuar ato?

Ndërhyrja në kompetencat e presidentit, më duket naive, e pakuptimtë, që të mos e cilësoj me ndonjë fjalë tjetër. Nuk mendoj se kreu i lartë i shtetit duhet të zgjidhet me aq vota sa ç'u votua ligji i Shaban Memisë, ligji i legalizimeve, me 50 deputetë. Sa për dekretet është krejt e pakuptimtë që dekretet e presidentit të kundër firmosen nga dy kryetarët e partive si Lufter Xhuveli dhe Genc Pollo.

Po ju me cilin variant jeni që presidenti të zgjidhet nga parlamenti apo nga populli?

Është e nevojshme që zgjedhja e presidentit të shkojë drejt një demokracie të drejtpërdrejtë, pra që të zgjidhet nga populli.

Po në rast se grupi i PD-së vendos propozimet e Trashanit?

Jo, e prerë.

Po për ndryshimet në Kushtetutë për çështjen e mocionit të besimit apo të mosbesimit të kryeministrit?

Unë insistoj në faktin se ndryshimet Kushtetuese nuk janë tabu, por ato të bëhen në kuadër të mirëqeverisjes dhe stabilitetit në qeverisje. Sa i takon propozimeve për mocionin e besimit dhe mosbesimit të kryeministrit them që janë interesante, duhen parë me vëmendje dhe personalisht do i përkrah në mënyrë që kryeministri Berisha të thellojë luftën kundër korrupsionit.

Cili është pozicioni juaj për propozimet e PS-së sa i takon reformës zgjedhore?

Për etikë ne duhet të vlerësojmë propozimet e PS-së, por edhe ato të zonjës Trashani. Për sa i përket propozimit të PS-së unë si deputet i Vlorës do të mbështes vendimin që do të marrë grupi parlamentar i PD-së. Jam i hapur për një sistem zgjedhor që i shërben stabilitetit dhe klimës së konsensusit për të ardhmen e vendit tonë.

Pra jeni dakord për një sistem zgjedhor proporcional rajonal?

Në rast se zgjidhet sistemi proporcional, pavarësisht se cili proporcional do të caktohet, mendoj se kjo është një oportunitet dhe përgjegjësi për kryetarët e partive të mëdha, pasi koalicionet apo partitë do të hynë në garë me emrin e kandidatit për kryeministër.

II.12. Kushtetuta, PD merr votat e aleatëve

22.04.2008, Gazeta Panorama (marrë me shkurtime)

PD-ja shmang përplasjet me aleatët dhe njerëzit kundër saj, duke bërë që ndryshimet kushtetuese të votohen pro nga 115 deputetë gjithsej. Votat kundër ndryshimeve kushtetuese kanë qenë të 17 deputetëve dhe abstenuese katër prej tyre. Seanca maratonë për ndryshimet kushtetuese ka bërë që PS-ja dhe PD-ja, së bashku me një pjesë të aleatëve si demokristianët, republikanët dhe reformatorët të realizojnë votimin për ndryshimet kushtetuese në vend. Ndërsa jo të gjithë të deklaruarit si mbështetës të presidentit Topi i kanë qëndruar në krah atij, për sa i përket ndryshimeve kushtetuese. Neni shumë i debatuar, "Për ndryshim e procedurave të zgjedhjes së presidentit" ka marrë më shumë vota kundër se të gjithë të tjerët gjatë këtij votimi. Ndërsa në të gjitha votimet e neneve PSD-ja dhe LSI-ja kanë votuar kundër ose kanë abstenuar me votën e tyre. Kreu i LSI-së, Ilir Meta, edhe pse i pranishëm nuk ka marrë pjesë në asnjë votim të 10 neneve për ndryshimin e Kushtetutës. Gjatë votimit në tërësi nga grupi i PS-së, vetëm Luan Memushi dhe Petro Koçi votuan kundër. Ata votuan kundër gjatë gjithë kohës kur u krye dhe votimi nen për nen.

Neni 87

Kundër këtij neni votuan kundër 24 deputetë të kampeve të ndryshme politike. Vetëm katër mbështetës të Topit brenda grupit PD-së votuan hapur kundër nenit 87. Ndërsa ra në sy mos votimi i këtij neni nga Nard Ndoka i PDK-së dhe Fatmir Mediu i PR-së, të cilët janë edhe firmëtarët e nismës për zgjedhjen e kreut të shtetit nga populli. Mbështetësit e Topit brenda gjirit të së djathtës që votuan kundër janë Sami Gjergji, Rexhep Uka, Spartak Ngjela, Nikollë Lesi, Bujar Leskaj, Dashnor Sulaj, Arian Madhi, Spiro Peçi. Ndërsa deputetët e tjerë pro Topit, votuan pro nenit 87, që presidenti të zgjidhej me shumicë të thjeshtë, me 71 vota në raundin e katërt dhe të pestë. Nga të majtët që votuan kundër këtij neni mund të

përmendim Bejtja, Ceka, Çuli, Dedja, Divjaka, Gjinushi, Koçi, Kola, Lamaj, Legisi, Memushi, Milo, Neranxi, Prifti dhe Xhufi. Ndërsa mbështetësit e tjerë pro Topit dhe nismës për president nga populli si Sali Shehu, Besnik Mustafaj, abstenuan me votat e tyre.

Sistemi proporcional

Sistemi proporcional rajonal mori më pak vota kundër, pasi një pjesë e aleatëve të PD-së votuan pro këtij sistemi dhe pse i eliminon ato politikisht. Kështu drejtuesit e koalicionit qeveritar, të partive të vogla, Fatmir Mediu i PR-së, Lufter Xhuveli i PAA-së, Nard Ndoka i PDK-së, Vangjel Dule i PBDNJ-së dhe Genc Pollo i PDR-së votuan pro sistemit spanjoll rajonal, edhe pse e ardhmja politike e partive të tyre mund të vihej në rrezik. Pro ndryshimit të nenit 64, votuan 118 deputetë, 13 deputetë të tjerë votuan kundër dhe një prej tyre abstenuan. Ndërsa për nenin që pëson ndryshime me lista të mbyllura zgjedhore votuan pro 112 deputetë, kundër 18 deputetë dhe abstenoi vetëm 1 deputet. Ngjela, Ceka, Koçi, Legisi, Braho, Peçi, Prifti dhe Xhufi janë deputetët që kanë votuar kundër në të gjitha nenet për ndryshimin e Kushtetutës. Ndërsa në këtë seancë nuk kanë marrë fare pjesë Fatos Nano i PS-së dhe Hajrulla Paturri i PR-së. Gjatë votimit të neneve të tjera mbështetësit e presidentit Topi votuan njësoj me grupin e PD-së.

II.13. Këtë radhë do të jem i kujdesshëm në votim

02.05.2008, Gazeta Shqiptare. (G. Bushati)

Bujar Leskaj, deputeti i Vlorës, shprehet lidhur me kthimin në parlament të amendimeve të ligjit të legalizimit nga ana e presidentit. Sipas tij, kësaj radhe duhet jetë i kujdesshëm në votim, që as mos të bashkojë votën me PS-në, por vota të jetë pjesë e një sere detyrimesh që ai ka si përfaqësues i zgjedhësve apo si mbështes i disa institucioneve, si ai i presidentit, por edhe i kryeministrit. Votimi i dekretit të presidentit do të vërë para provës edhe deputetë të tjerë të maxhorancës, që konsiderohen si "grupi i deputetëve të Topit". Presidenti Topi në fund të prillit ktheu në parlament dekretin e tij të pare, siç janë amendimet sa i takon ligjit të legalizimeve. Arsyetimet e tij kryesore ishin cenimi i pronarëve të ligjshëm dhe marrja e kompetencave të pushtetit lokal nga ana e ALUIZN-it. Sipas deputetit tjetër të PD-së, Rexhep Uka, ky kthim i amendimeve ishte në vijimësi të qëndrimeve që ka mbajtur Topi, edhe kur ka qenë deputet për ligjin në fjalë. Por duket kësaj here grupi i Topit, nuk do të jetë aq i madh në numër sa ishte gjatë votimit të ndryshimit të nenit kushtetues lidhur me zgjedhjen e presidentit nga parlamenti.

Zoti Leskaj, së fundmi presidenti ktheu amendimet e ligjit të legalizimeve, të cilat, për hir të së vërtetës, ju e keni votuar kundër me 10 prill. Si do ta votoni dekretin e presidentit kur ai të kalojë në parlament?

Në bindjet e mia do të ishte mire që dekreti i presidentit të votohej pro, pra që ligji të rikthehet për plotësim në komisionet parlamentare.

A mendoni se përveç jush do ta votojnë pro edhe deputetët e tjerë të maxhorancës?

Ekziston një rrezik që na bën neve, si deputetë "të veçuar" në maxhorancë, që të mendohemi mire përpara se vota të shkojë në një linjë me deputetët e PS-së, të cilët në opinionin tim nuk kanë as shqetësimin ligjor për ligjin në fjalë, as dashamirësinë politike për ta

zgjidhur njëherë e mire problemin e legalizimeve të mijëra qytetarëve shqiptarë, s'kanë as respektin për institucionin e presidentit (pasi këtë mungesë respekti për presidentin e kanë treguar në momente kyçe), por kanë vetëm problemin e destruktivitetit ndaj qeverisë së djathtë, provokimeve të raporteve të shëndosha të grupit parlamentar të PD-së, të maxhorancës, Qeverisë dhe presidentit.

Edhe pse keni votuar kundër këtyre amendimeve, nuk do ta bashkoni votën me socialistët si pjesë e bashkëpunimit me maxhorancën?

Në një situatë kur një kërkesë e drejtë ligjore e shprehur me dekretin e presidentit kërkohet të shfrytëzohet nga PS-ja për goditjen e qeverisë dhe për një tymnajë në publik, votimi im pro ose kundër dekretit këtë here do të varet nga vendimi politik i grupit parlamentar të PD-së, ose për të qenë i sinqertë do të jetë i kujdesshëm.

Pse do të jetë i kujdesshëm zoti Leskaj?

Do të jetë i kujdesshëm duke u përpjekur që nën peshën e detyrimeve në radhë të parë ndaj zgjedhësve të qytetit të Vlorës (një pjesë e konsiderueshme e të cilëve presin legalizimet) në radhë të dytë ndaj pronarëve të vjetër, të cilët janë në të drejtën universale të pronës (detyrim kushtetues për të gjithë ne) si dhe detyrimeve morale ndaj institucionit të presidentit dhe respektit për qeverinë (kryeministrin e së cilës vazhdoj ta vlerësoj maksimalisht) dhe në kujdes të sistemit të ri zgjedhor që sapo kemi miratuar, vota ime Pro ose Kundër dekretit do të jetë e drejtë dhe e arsyetuar.

II.14. Turi "Shqipëria në NATO" – Test elektoral

09.05.2008, Koment nga Gazeta Shqiptare, sipas prononcimit në TV Alsat

Deputeti i Vlorës Bujar Leskaj, për turin "Shqipëria në NATO", të ndërmarrë nga kryeministri shprehet se do të jetë një "test elektoral" për vetë Berishën për reformat që ka ndërmarrë që nga 2005 e deri më tani. Sipas tij, ka ardhur koha për të bërë ndryshime në qeveri, në mënyrë që PD-ja të jetë sa më përfaqësuese gjatë këtij viti të fundit të mandatit qeverisës. "Ka ardhur koha për ndryshime në qeverisje dhe që në këto ndryshime të gjejnë vendin e duhur përfaqësuesit e Partisë Demokratike. Berisha duhet të lërë në dispozicion më shumë poste për demokratët dhe të shmangë aleatët në sektorët kyç, siç janë shëndetësia dhe arsimi", - u shpreh dje ai. Leskaj e vlerësoi angazhimin e qeverisë në reformat e ndërmarra si pjesë e angazhimit ndërkombëtar të Shqipërisë por "duhet që qeverisja të punojë më shumë për sa i takon luftës kundër korrupsionit për të rifituar besimin në elektorat për zgjedhjet e vitit 2009-s". Deputeti demokrat ia ka bërë të ditur këtë qëndrim Berishës me kohë, në mbledhjet e grupit parlamentar, pasi, sipas Leskaj, i cili mbështetet nga shumë deputetë të tjerë, duhet një qeveri më përfaqësuese dhe më e denjë që PD-ja të marrë një mandat tjetër.

II.15. Leskaj: Ish-të përndjekurit politikë të futen në administratë

Koment i datës 03.06.2008, Gazeta Panorama dhe Gazeta Shqiptare

Deputeti i PD-së, Bujar Leskaj, ka kërkuar dje në mbledhjen e grupit parlamentar që të gjithë ish të përndjekurit e regjimit komunist të punësohen në administratë si dhe të rifillojë dëmshpërblimi i tyre. Sipas tij, "Partia Demokratike me gjithë veprimet, lëvizjet dhe personat që ka përkrahur këto vite duhet të bëjë shumë më tepër, si në drejtim të implementimit të ligjit për dëmshpërblimin e ish të përndjekurve politikë, ashtu edhe në drejtim të pozicionimit në poste të personave të kësaj shtrese, të atyre personaliteteve simbol të pozicionuar qartas si antikomunistë, duke filluar nga heronjtë e Spaçit 1973", është shprehur Leskaj. Njëkohësisht deputeti i PD-së, ka kërkuar nga kryeprokurorja Ina Rama të zbardhë dosjet e korrupsionit të depozituara nga ministrat e PD-së si dhe denoncimet e Berishës gjatë kohës që ka qenë në opozitë.

*Ndërsa **"Gazeta Shqiptare"** e po kësaj dite në komentin e gazetares G. Bushati ndër të tjera shkruan*:

Deputeti tjetër demokrat Bujar Leskaj, i cili njihet gjithashtu si mbështetës i presidentit Topi, në fjalën e tij ka mbështetur kryetaren e Kuvendit në këtë nismë të fundit të PS-së për mocionin e shkarkimit. Burimet bëjnë të ditur se Leskaj ka kërkuar nga kryeministri që në Gjykatën e Lartë të emërohen gjyqtarë të shtresës së demokratëve, ose të të persekutuarve. Bëhet e ditur se Leskaj e ka konsideruar jo shumë korrekt qëndrimin e presidentit në rastin e mos emërimit në Gjykatën e Lartë dhe gjykatësit të nderuar Artan Brocit, një nga themeluesit e PD-së dhe dëshmorët e pare të demokracisë, rënë më 2 prill 1991 në Shkodër. Duket që nuk është e vetmja kandidaturë që nuk është marrë parasysh nga Topi, që duket në tryezë do të ketë pasur propozime të tjera nga "demokratët". Për ta përforcuar "gabimin" e Topit në përzgjedhjen e tij, disa deputetë kanë hedhur hije dyshimi për një nga anëtarët e emëruar nga Topi në gjykatën e lartë që ka punuar si prokuror në kohën e diktaturës. Këtë dyshim e ka përforcuar Berisha, i cili gjatë fjalës së tij, pa përmendur me emër personin që akuzohet është shprehur "të paktën të mos jenë xhelatët e djeshëm".

II.16. Jo mocionit ndaj kryetares Topalli

Berisha sulm Topit, mbron Topallin
Bujar Leskaj: Aleatët pro Topallit, ose riformatim te Qeverisë.

03.06.2008, Gazeta Panorama (nga Adi Shkëmbi)

Kryeministri Sali Berisha ka sulmuar dje para deputetëve demokratë Presidentin Topi lidhur me procedurën që ky i fundit zgjodhi për të dërguar në Kuvend pesë dekrete në Gjykatën e Lartë. Në mbledhjen që ka zgjatur rreth 60 minuta, pasi janë larguar mediat, Kryeministri është shprehur se nuk ka ndodhur asnjëherë më parë që Presidenti të mos konsultohet paraprakisht me partitë politike për emrat që ka çuar për votim në Parlament. "Në vendimin për dekretet e presidentit, maxhoranca duhet të udhëhiqet nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese, që kërkon konsultimin e Presidentit me Kuvendin. Nuk ka ndodhur asnjëherë dhe kjo është hera e parë që Presidenti të mos konsultohet më parë me maxhorancën dhe opozitën lidhur me dekretet", është shprehur Kryeministri Berisha. Sipas tij, "edhe gjatë kohës që ka qenë zoti Moisiu janë bërë negociata me kryetarët e grupeve parlamentare dhe në raste të veçanta edhe me kryetarët e partive". Në të njëjtën kohë, Berisha ka lënë të kuptohet se është kundër figurave që propozohen dhe që kanë mbajtur funksione të larta në gjyqësor gjatë periudhës së komunizmit. Burime nga grupi bëjnë të ditur se edhe deputeti Bujar Leskaj ka theksuar se, maxhoranca e djathtë s'duhet të përkrahë prokurorë e gjyqtarë që kanë dhënë vendime politike para viteve '90. "Prokurorët dhe gjyqtarët që kanë dhënë vendime politike para viteve '90, kjo maxhorancë s'duhet t'i pranojë dhe nëse ka të tillë nëpër institucione duhet të largohen, apo ç'është dhe më seriozja s'duhet të kandidojnë për pozicione të larta në gjyqësor", mësohet të ketë thënë Leskaj në mbledhjen e grupit. Grupi i PD-së vendosi gjithashtu që të mandatojë kryetarin e grupit, Astrit Patozi dhe nënkryetarin Ilir Bano, për t'i bërë të ditur kreut të shtetit qëndrimin zyrtar të maxhorancës lidhur me këto dekrete.

Mocioni ndaj Topallit

Një tjetër çështje e prekur dje në mbledhjen e grupit, pa praninë e mediave, ka qenë ajo e mocionit ndaj Kryetares së Kuvendit, Jozefina Topalli. Ka qenë deputeti Luan Skuqi, i cili ka ngritur këtë çështje, vetëm pak orë pasi kryesia dhe grupi parlamentar i PS-së kishin marrë vendim për të çuar deri në fund nismën e tretë brenda kësaj legjislature ndaj kryeparlamentares. Kryeministri Berisha është shprehur se mocioni është ndaj qeverisë dhe jo ndaj Topallit. "Tashmë është e qartë që ky mocion shkarkimi është ndaj qeverisë dhe jo ndaj zonjës Topalli. Por unë nuk pranoj që maxhoranca të shkelet me këmbë", mësohet të ketë thënë Kryeministri Berisha. Ndërkohë, deputeti Leskaj i ka kërkuar Kryeministrit Berisha gjatë mbledhjes së djeshme që t'u kërkojë aleatëve të PD-së, shumica e të cilëve janë ministra në kabinetin qeveritar, të dalin publikisht kundër shkarkimit të kryeparlamentares, duke shtuar se nëse një gjë e tillë nuk bëhet, duhet të ketë riformatim të qeverisë. "Duke vlerësuar Kryetaren e Parlamentit ne vlerësojmë veten, vlerësojmë se sa maxhorancë solide dhe e qenësishme jemi. Në këtë kontekst jo vetëm që mocionin kundër kryetares s'duhet ta pranojmë, por ju si kryeministër, pra si lider i kësaj maxhorance keni përgjegjësinë që kryetarët e partive në koalicion (një pjesë e të cilëve janë ministra) të pozicionohen qartas dhe haptas pro nesh, në të kundërt riformato koalicionin", mësohet të ketë thënë Leskaj në këtë mbledhje.

II.17. Zgjedhjet, PS-PD marrin veton

01.07.2008, Gazeta Panorama (botohet me shkurtime)

Komisioni i posaçëm për Reformën Zgjedhore do të zhvillohet mbi bazën e vetos së dy partive të mëdha, PS dhe PD. Dy partitë e mëdha kanë ndryshuar në momentin e fundit draftin përfundimtar për mënyrën e funksionimit të këtij komisioni, duke realizuar që përbërja të jetë vetëm mbi bazën e grupeve parlamentar dhe jo mbi bazën e partive parlamentare. Ndryshimi i draftit ka ndodhur përpara nisjes së seancës parlamentare, ku dy palët, demokratë dhe socialistë, kanë dhënë mendimin përfundimtar mbi përbërjen e funksionimit të Komisionit parlamentar për Reformën Zgjedhore. Seanca ka nisur me një orë e gjysmë vonesë, e cila ka shërbyer edhe në zhvillimin e negociatave PS-PD. Kryetarja e Kuvendit nuk e ka shpërndarë për deputetët draftin final mbi përbërjen dhe afatet e komisionit, por është detyruar ta lexojë përpara marrjes së vendimit. Kuvendi e miratoi seancën me 97 vota pro dhe një kundër, duke përcaktuar se afati i këtij komisioni do të jetë një muaj. Ndërsa e vetmja votë kundër vjen nga PD-ja, nga Bujar Leskaj. "Mjafton Fatmir Xhafaj për reformën, s'ka pse të jetë edhe Ilir Rusmajli, janë të dy nga e njëjta familje", deklaroi Leskaj për "Panorama" duke shpjeguar se pse votoi kundër.

Përbërja dhe vetoja

Komisioni do të ketë dy bashkëkryetarë dhe do të ketë gjithsej 9 anëtarë, sipas numrit të grupeve parlamentare në Kuvend. Ilir Rusmajli nga PD-ja dhe Fatmir Xhafaj nga PS-ja do të jenë dy kryetarët e komisionit. Ndërkohë që në bazë të vendimit të marrë nga deputetët, asnjë vendim i marrë nga komisioni nuk do të jetë i vlefshëm nëse nuk do të ketë bekimin e dy partive të mëdha. "Mbledhjet e komisionit janë të vlefshme kur anëtarët që marrin pjesë në to përfaqësojnë shumicën e vendeve të Kuvendit. Vendimet në komision merren kur vota pro përfaqësojnë shumicën e vendeve në Kuvend, kur në çdo rast kanë votuar pro, me unanimitet dy

bashkëkryetarët e komisionit", thuhet në pikën gjashtë të vendimit. Mbi bazën e këtij formulimi, i bie që partitë e tjera të pranishme të jenë thjesht garniturë, nuk e gëzojnë më veton si më parë, si dhe nëse realizojnë shumicën me njërën prej partive PS apo PD, nuk ka vlerë nëse demokratët e socialistët nuk bien dakord.

II.18. Potenciali i Industrisë së Turizmit dhe impakti në ekonominë e Vlorës

Nga Bujar Leskaj
Diskutim i mbajtur në Forumin e Politikave në Vlorë, Korrik 2008-Organizuar nga OSBE, Lëvizja Evropiane e Shqipërisë dhe Komisioni i Integrimit i Kuvendit, nën kujdesin e Z. Ilir Meta

Diskutimi u botua në gazetën 55, datë 13.07.2008

II.18.1 MSA-ja, Standardet e BE-së dhe Kuadri Ligjor në Shqipëri për Turizmin

Neni 57 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit të BE-së me Shqipërinë përcakton në mënyrë të qartë ofrimin e shërbimeve të kompanive shqiptare dhe atyre komunitare. Ky nen nxit dhe promovon zhvillimin e këtyre shërbimeve. Ndër shërbimet bazë të cilat mbulon ky nen është edhe turizmi. Ky sektor në vendet e BE-së përfaqëson një industri në rritje, me 860 milion net qëndrimi të turistëve në BE për vitin 2007. Turizmi jep 4% të GDP-së së BE-së dhe ka rreth 2 milion ndërmarrje që punësojnë rreth 4% të fuqisë së punës (duke përfaqësuar afërsisht 8 milion vende pune). Nëse merren parasysh sektorët e tjerë që funksionojnë në bazë të turizmit, kjo industri në BE jep rreth 11% të GDP-së dhe punëson rreth 24 milion vetë. Turizmi i qëndrueshëm luan një rol madhor në ruajtjen dhe përmirësimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore, duke filluar nga artet tek gastronomia lokale, nga zejtarët tek ruajtja e biodiversitetit. Që nga viti 2002 BE zhvillon Forumin e Turizmit Evropian duke u përpjekur të integroj turizmin në politika komunitare. Strategjia e Lisbonës në 2005 e pa turizmin si një industri konkurruese që synon të ruajë Evropën si destinacionin numër një të turizmit në botë. Kjo e ka çuar Komisionin Evropian që të përgatisë në vitin 2006 Axhendën e 21 Evropiane për Turizmin. Nga ky dokument u krijua Grupi i Qëndrueshëm për Turizmin (Tourism Sustainnability Group-TSG),

me 21 anëtarë, i cili i formuloi qëndrimet dhe rekomandimet e tij në formën e një raporti në shkurt 2007, që reflektonte vështrimin e ri evropian për qëndrueshmërinë ekonomike, sociale e mjedisore. Qeveria jonë ka ndjekur me vëmendje zhvillimet evropiane në turizëm dhe ka ndërmarr që në Dhjetor 2005 lëvizjen e parë, duke përgatitur në bashkëpunim me ekspertët e PNUD-it Strategjinë e Zhvillimit të Turizmit Kulturor, me bazë natyrën. Në janar 2007, si rezultat i punës së një projekti të Organizatës Botërore për Turizmin në Shqipëri, projekt i fituar nga Ministria e Turizmit në bashkëpunim me SNV, Këshilli i Ministrave aprovoi draft-ligjin e ri për turizmin, dhe në maj 2007 Parlamenti e ktheu atë ne ligj. Ligji i ri është zbatim në praktikë i rekomandimeve të MSA-së, të përmbajtura në nenet 57-59 të saj. Ligji i Turizmit ka përputhshmëri me dy direktivat e BE-së që veprojnë në turizëm: 1-Direktiva e KE-s nr 95/57/BE e datës 23 Nëntor 1995 "Mbi mbledhjen e statistikave në sektorin e turizmit" dhe 2-Direktiva e KE-s nr 90/134/EEC 13 Qershor 1990 "Mbi paketat e udhëtimeve paketat e pushimeve dhe paketat e tureve".

Neni 94 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit shprehet "*Turizmi: Bashkëpunimi mes palëve në fushën e turizmit kryesisht ka si synim përmirësimin e informacionit mbi turizmin (nëpërmjet rrjeteve ndërkombëtare, bazave të të dhënave) dhe transferimin e ekspertizës (nëpërmjet trajnimeve, shkëmbimeve, seminareve) bashkëpunimi do të marrë në konsideratë pjesën e duhur nga acquis communautaire. Bashkëpunimi mund të integrohet në një kuadër rajonal të integrimit*". Gjithashtu Ministria e Turizmit lançoi dhe bëri të njohur, në vitin 2006, në Komunitetin Shqiptar të biznesit turistik, Kodin e Etikës në turizëm të përgatitur nga OBT-ja. Pikërisht një nen të këtij kodi që ndalon ushtrimin e turizmit me qëllim shfrytëzimin seksual apo të fëmijëve ka promovuar më shumë sukses në një sërë aktivitetesh edhe OSBE-ja në Shqipëri, në kuadër edhe të marrëveshjes së bashkëpunimit të vitit 2006 të OSBE-s me MTKR-n në këtë fushë. Turizmi në Shqipëri përfaqëson sot industrinë e dytë të vendit.
MTKRS, si Ministri përgjegjëse për zhvillimin e politikave në turizëm vazhdon edhe në këtë vit, 2008 të zbatojë me suksese dokumente të tillë strategjikë si VKM nr. 395, datë 21/06/2005 "Për miratimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Zhvillimin e Turizmit Kulturor e Mjedisor" si dhe ligji nr. 9734 datë 14.05.2007 "Për Turizmin" (Projekti i të cilit nga qeveria u dorëzua në parlament në janar 2007). Industria turistike kontribuon me 12.2% në GDP-në e vendit (jep rreth 1 miliardë euro në vit në një total prej 9 miliardësh), duke ia kaluar pak vetëm industria e ndërtimit. Ndërkohë punëson rreth 5 % të popullsisë. Shumë shpejt turizmi, me këtë ritëm rritjeje që njeh,

do t'ia kalojë ndërtimit. Ndoshta ai do të kthehet në industrinë e parë të vendit që në fillim të vitit të ardhshëm. Orientimet e Qeverisë qendrore për turizmin janë zhvillimi i tij i shtrirë gjatë gjithë vitit dhe jo vetëm në zonat bregdetare, por në brendësi të vendit. Një punë të mirë për zhvillimin e turizmit kulturor, atij me bazë natyrën, e turizmit të aventurës dhe atij alpin kanë bërë organizata ndërkombëtare si GTZ në Theth dhe në Korçë, EDEM në shumë krahina të vendit, SNV, etj.

II.18.2 Turizmi në Vlorë, E Sotmja dhe E Ardhmja

Ka shumë njësi vendore që dallohen për një menaxhim të mirë të burimeve dhe destinacioneve të tyre turistike. Ne të gjithë jemi në një mendim që Bashkia e Vlorës renditet ndër të parat njësi vendore për punën e saj në njohjen dhe promovimin e turizmit vlonjat dhe produktin e arritur. Vlora ndoshta përbën potencialin rajonal më të madh të vendit, të shprehur dhe në numër hotelesh dhe krevatesh fjetjeje, por dhe në numër të turistëve që kalojnë pushimet në këtë qark. Bashkia e Vlorës ka punuar mirë, por tani është koha që vëmendja në planet turistike për rajonin të përqendrohet në boshtin Vlorë-Llogora dhe Vlorë-Parku i Amantias dhe Orikut drejt zhvillimit të një turizmi të rërës dhe të detit të shoqëruar me turizmi kulturor. Si qark Vlora ka numrin më të madh të turistëve në vit, rreth 380 mijë. Politika e zgjuar e pronarëve vlonjatë të akomodimeve turistike dhe restoranteve, duke ulur disi çmimin ka sjellë shtimin e numrit të pushuesve. Po ashtu në Vlorë vërehet një kulturë tjetër shërbimi ndaj turistëve. Ndërsa ndikimi i turizmit në ekonomin e Qarkut të Vlorës duhet thënë se është në rritje. Me turizëm merret një pjesë e konsiderueshme e popullsisë së zënë me punë në këtë qark. Por ende këto aktivitete nuk janë të mirë organizuara dhe koordinuara. Lind nevoja për një plan strategjik të zhvillimit të turizmit si në qytet ashtu dhe në Qarkun e Vlorës, i cili do të thellojë atë punë të nisur të dokumentuar në strategjinë lokale të viteve 2004-2008 në bashkinë e Vlorës.

Resurset e Vlorës (burimet njerëzore, pozita gjeografike, pasuritë natyrore e kulturore) si qytet dhe rajon janë të shumta. Ato renditen nga dhjetëra kilometra bregdet i mrekullueshëm në rivierën shqiptare, tek brendësia e tokës vlonjate me lumenj e përrenj të rrëmbyeshëm e me shpatë, gryka e lëndina me një bukuri mbresëlënëse. Ato renditen po ashtu në pasurinë e pashoqe të objekteve e siteve antike (Oriku, Amantia, etj) dhe ne folklorin e gjallë vlonjat, në këngën dhe vallen popullore labe. Si qytetar i Vlorës jam i bindur që në vitet që do të vijojnë nuk do të kemi më si

karakteristikë "mburrjet" tona në histori e politikë, por produktin turistik që ne do ta ofrojmë.

Në këtë forum politikash do të rekomandoja:

Autoritetet vendore në Vlorë të interesohen pranë Ministrisë sonë të Integrimit, pse nga BE-ja po vijnë shumë programe binjakëzimi dhe shkëmbimi eksperiencash, si "Twinning" dhe "Twinning Light". Edhe pse bashkia apo OJF-të vlonjate mund të përfitojnë prej secilës prej tyre një shumë minimale mbështetje (deri në 20 mijë euro), sërish mund të jetë një fillim i mirë për të përgatitur atë që do ta quaja rekomandim kryesor të diskutimit tim. Dhe pikërisht, përgatitjen e një Plani Strategjik për zhvillimin e Turizmit në Qarkun e Vlorës 2009-2018. Vlora ka pasur deri tani një plan afatmesëm zhvillimi 2004-2008 por ajo tashmë ka nevojë për një vështrim më të largët, për plane më ambicioze. Turizmi kërkon angazhimin e të gjithëve, të pushtetit lokal, biznesit privat, mendimit të kualifikuar intelektual të Vlorës veçanërisht atij të pedagogëve të universitetit "Ismail Qemali", OJF-të e ndryshme që fokusohen direkt ose indirekt në turizëm, etj. Ai nuk mund të shihet më si një aktivitet i veçuar apo si një dëshirë e mirë e dy-tre qeveritarëve të ndershëm vendor. Turizmi kërkon angazhim maksimal dhe kërkim të palodhur për fonde nga qeveria qendrore. Turizmi përfaqëson në radhë të parë për vlonjatët atë Levë të Arkimedit që do t'u ngrejë ndjeshëm mirëqenien e tyre ekonomike. Ka perënduar tashmë epoka e emigracionit dhe ka filluar ajo e turizmit, për Vlorën.

Për të realizuar këtë Vlora duhet të gëlojë nga diskutimet dhe përgatitjet për projektet lokale për zhvillimin e turizmit. Mund të kërkohen fonde nga Fondi i Zhvillimit të Turizmit që parashikohet të ngrihet në ligjin e turizmit dhe që qeveria nuk duhet të vonoj ta ngrejë. Por mund të merren fonde për projektet e turizmit të qëndrueshëm dhe që synojnë zënien me punë të njerëzve edhe nga programi IPA (Instrumenti për Para-Anëtarësimin në BE) për vitet 2009-2013. Janë me dhjetëra miliona euro të destinuara për programet IPA dhe shumë shpejt ato do të shohin rajone me potencial më të lartë zhvillimi në Shqipëri. Pa dyshim që Vlora duhet dhe meriton të jetë në vend të parë, për nga resurset natyrore dhe njerëzore që ajo ofron. Duke vlerësuar punën e mirë e bërë në këto vite nga drejtuesit e Bashkisë së Vlorës për turizmin si dhe moralin dhe përgjegjësinë e tyre në zhvillimin urbanistik të qytetit nga paneli i këtij forumi jopartiak do ti kërkoja kryetarit të bashkisë e anëtarëve të këshillit të rregullimit të territorit të qytetit të jenë në maksimum ekzigjentë për mbrojtjen e bregdetit nga betonizimi, për ruajtjen e pasurive natyrore duke mos toleruar askënd.

Dy tre ndërtime jo të rregullta në këtë vit të fundit në bregdetin e Vlorës me lejen e bashkisë duhet të na shqetësojnë të gjithëve për të ardhmen dhe të na bëjnë që apeli ynë qytetar të shihet me dashamirësi, larg çdo politizimi me atë dëshirë që për sa i përket ndërtimeve në bregdet Vlora të mos dëmtohet si fjala vjen Golemi, Durrësi e Saranda.

II. 18.3 Planifikimi i Qëndrueshëm dhe Axhenda 21

Në funksion të rëndësisë së rekomandimeve modeste të sipërpërmendura më lejoni që edhe një herë në një tjetër këndvështrim në këtë temë mbi potencialin e industrisë së turizmit dhe kërkesat për një turizëm të qëndrueshëm t'u kthehem e shtjelloj disa koncepte të turizmit të qëndrueshëm e Axhendës 21. Sigurimi i qëndrueshmërisë në turizëm, është kthyer në një ndër sfidat kryesore në zhvillimin dhe menaxhimin e këtij sektori, i cili si në nivel global ashtu edhe nacional, ka tendencën të shikojë drejt rritjes. Kjo rritje në vazhdim, e shoqëruar me tendencën e mbipopullimit, shkon paralelisht me rritjen e ndërgjegjësimit mjedisor të konsumatorit, i cili kërkon vazhdimisht destinacione me mjedis të pastër e të sigurt. Këto dy prirje, si sasiore dhe cilësore bëjnë të rëndësishme zhvillimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të kësaj industrie. Megjithëse sektori turistik, në pjesën më të madhe zhvillohet, financohet dhe menaxhohet nga individë dhe kompani private, përgjegjësia e sektorit publik është po kaq e rëndësishme në sigurimin e një qëndrueshmërie afatgjatë të këtij sektori.

Kjo, së pari, pasi një pjesë substanciale e shërbimeve turistike furnizohet nga institucionet kombëtare, rajonale dhe lokale publike.

Së dyti, Qeveria qendrore dhe lokale vendosin, rregullat e lojës, për mënyrën sesi do të zhvillohet turizmi në të gjithë vendin apo në një lokalitet të caktuar,si dhe garanton një koordinim të këtyre rregullave për të siguruar një zhvillim ekonomik dhe mjedisor të qëndrueshëm.

Së treti, mbetet përgjegjësi e sektorit publik, kontrolli i zbatueshmërisë së ligjeve e rregulloreve nga të gjithë aktorët e përfshirë në zhvillimin dhe menaxhimin e turizmit. Autoritetet vendore të qytetit të Vlorës, por edhe të Qarkut të Vlorës janë duke u bërë gjithnjë e më shumë përgjegjëse në zhvillimin dhe menaxhimin e shume aspekteve të turizmit. Këto autoritete njohin me mirë çfarë është në interesin e tyre, për të arritur objektivat e zhvillimit lokal. Komuniteti lokal është e rëndësishme të përfshihet në procesin e planifikimit dhe zhvillimit të turizmit, në mënyrë që ai të përfitojë

prej tij nëpërmjet punësimit e rritjes së të ardhurave, pra ta mbështesë atë. Një planifikim i përshtatshëm, zbatim efiçent i zhvillimit dhe menaxhim i vazhdueshëm efektiv i turizmit janë esenciale për të rritur përfitimet dhe për të minimizuar problemet e këtij sektori. Rëndësia e zhvillimit të qëndrueshëm dhe drejtimet për zbatimin e një zhvillimi të tillë në të gjithë sektorët është pranuar tashmë në nivele globale, por jo gjithnjë e praktikuar si duhet. Qëndrueshmëria bazohet në politikat globale të vendosura si Axhenda 21 për Udhëtimin dhe Turizmin. Ajo vendos zonat prioritare dhe veprimet .Kështu zona prioritare IV është rreth planifikimit të qëndrueshëm turistik.

***Axhenda 21, Objektivi**: Zhvillimi dhe Zbatimi i masave për një plan efektiv të përdorimit të tokës, që maksimizon potencialin mjedisor dhe përfitimin ekonomik nga udhëtimi dhe turizmi, ndërsa minimizon dëmtimin mjedisor ose kulturor. Turizmi ka potencial të madh të sjell përfitim ekonomik dhe përmirësim të mjedisit të destinacionit në të cilin ai vepron. Nëse planifikohet dhe menaxhohet keq turizmi mund të dëmtojë burimet mbi të cilat ai bazohet, pra të sjellë degradim dhe konsum të burimeve të kufizuara, me kosto të lartë rikuperimi apo rigjenerimi*.

Degradimi mjedisor dhe kulturor mund të shmanget vetëm nëpërmjet forcimit të ligjit, adaptimit dhe aplikimit të masave të planifikimit. Nëse turizmi nuk është i planifikuar, zhvilluar dhe menaxhuar mirë ai mund të rezultojë në një mbipopullim, ndotje dhe probleme të tjera mjedisore.

Përdorimi i pakontrolluar i zonave të mbrojtura natyrore, zonave historike ose mbikomercializimi i traditave kulturore, çon në degradim të këtyre zonave dhe traditave kulturore. Nëpërmjet një planifikimi, zhvillimi dhe menaxhimi të kujdesshëm, përfitimet nga turizmi mund të rriten dhe problemet të minimizohen. Diskursin po e mbyll me një thënie të poetit të Vlorës e të Shqipërisë, ekonomistit erudit Fatos Arapi, marrë nga diskutimi i tij "Ka disa Vlora", në konferencën shkencore "Vlora në rrjedhat e kohës" organizuar në vitin 2001. Studiuesi sintetizon: "*Nga vetë pozita e saj gjeostrategjike Vlora është e përcaktuar të zhvillohet si një Port i Madh Mesdhetar, qendër e rëndësishme ekonomike e kulturore, ku takohen jugu e veriu, perëndimi e lindja. Sa më shpejt të nis ky ndërtim i domosdoshëm i kryeqendrës sonë të Jugut, aq më dobi sjellës do të jetë për të gjithë, për popullin tonë e gjithë popujt fqinjë*".

II.19. Ministrat me dosje të largohen me turp

Gazeta Panorama, dt. 07/07/2008, (koment nga Adi Shkëmbi mbi bazën e një prononcimi në TV Vizion +)

Nëse në qeveri ka ministra me dosje, ata duhet të lënë urgjentisht postet që mbajnë. Deklarata është bërë dje nga deputeti i Partisë Demokratike, Bujar Leskaj, sipas të cilit, në politikë ka bashkëpunëtorë të ish-Sigurimit të Shtetit. Duke folur për debatin e fundit lidhur me hapjen e dosjeve të ish-bashkëpunëtorëve të Sigurimit të Shtetit, ish-ministri demokrat thotë se, "nëse ekzistojnë në kabinetin qeveritar, duhet të largohen dhe të largohen me turp. Pasi ky ligj të kaloj në Parlament, është detyrim ligjor. Është edhe detyrim moral i çdo drejtuesi institucioni që në rast se këta persona kanë pasur dijeni, nuk kanë pse t'i punësojnë. Pastrimi nga këta individë në drejtësi dhe institucione të tjera të administratës e forcon administratën publike, forcon gjyqësorin, policinë, ushtrinë etj", theksoi Leskaj. Sipas deputetit të PD-së, zyrtarët që kanë qenë bashkëpunëtorë të Sigurimit të Shtetit janë lehtësisht të shantazhuar dhe për këtë arsye ata duhet të largohen. "Për fatin e tyre të keq që në momentin që këta persona kanë bashkëpunuar me Sigurimin e Shtetit në mënyrë vullnetare, apo në mënyrë të detyruar, për mua ata janë lehtësisht të shantazhuar, janë persona që në politikë nuk ndreqin punë, janë persona që edhe në momente të rëndësishme politike janë lehtësisht të atakueshëm", u shpreh Leskaj. Sipas tij, "hapja e dosjeve është kusht i nevojshëm, por jo kusht i mjaftueshëm për dekomunistizimin e shoqërisë shqiptare. Të gjithë ata nuk e meritojnë të jenë në politikën shqiptare, për ata ne nuk duhet të kemi asnjë sentiment. Këtu nuk është problemi as për të marrë ndonjëri flamurin e kësaj lufte, këto janë parime thelbësore që duhet të funksionojnë në shoqëritë e vendeve ish-komuniste".

II.20. I papranueshëm ultimatumi i Godos

21.07.2008, Gazeta Panorama, intervistoi Adi Shkëmbi

Ultimatumi i republikanëve për rifutjen e tyre në qeveri nuk pritet mirë në PD. Deputeti demokrat Bujar Leskaj thotë në një intervistë për gazetën "Panorama" se thirrja e fundit e Godos është e papranueshme. Ish-ministri flet edhe për hapjen e dosjeve ku thotë se nëse ka ministra me dosje të ikin me bisht në shalë.

Prej disa javësh është duke u diskutuar ligji "Për hapjen e dosjeve të Sigurimit të Shtetit". Më parë ka pasur një ligj të PD-së në vitin 1995 dhe një komision të verifikimit të figurave që ka ekzistuar deri në vitin 2000. Këto dy ligje të mëparshme a e kanë zgjidhur përfundimisht këtë çështje, apo do të duhet sërish miratimi i një ligji për pastërtinë e figurës?

Ndonëse p/ligji "Për hapjen e dosjeve të sigurimit", siç e përkufizoni ju në pyetjen tuaj, apo më saktë "Për verifikimin e figurës (pastërtinë) së të zgjedhurve në organet e larta legjislative a gjyqësore, e zyrtarëve në organet e larta të emëruar në administratë" ka 2-3 javë në diskutimin publik si problem, si dhe mbi 15 vjet që diskutohet në shoqërinë shqiptare dhe është ende i pazgjidhur për arsye nga më të ndryshme të udhëhequra nga mungesa e dashjes/vullnetit politik të segmenteve të caktuara (për fatin tonë të keq me peshë) të politikës shqiptare. Ne sot jemi ndërgjegjësuar se hapja e dosjeve (në fakt vetëm lustracioni për zyrtarët e politikanët e lartë të zgjedhur e të emëruar) është kusht i nevojshëm, por jo i mjaftueshëm për dekomunistizimin e shoqërisë shqiptare, i cili edhe sot 18 vjet pas diktature rezulton jo i plotë. Ky proces 18-vjeçar ndahet në tre periudha: Vitet "'92-'96", vitet "'97-2001" dhe vitet mbas 2002-it.

Periudha e parë: 1992-1996, kur ky proces po shkonte në hullinë e duhur falë vullnetit të PD-së në pushtet përmes ligjit nr. 8043, datë 30.11.1995 dhe punës serioze të Komisionit të Verifikimit të Figurave që drejtohej nga i ndjeri Hajri Mezini. Gjatë kësaj kohe u mënjanuan nga politika apo u larguan nga administrata publike, policia, drejtësia etj., të gjithë ata që rezultuan të përfshirë në veprimtarinë

e errët e antishqiptare të Sigurimit të Shtetit përpara vitit 1990 si drejtues, ekzekutorë apo bashkëpunëtorë (pa dallim ngjyre politike të marrë pas vitit 1990). Për fat të keq veprimtaria e këtij komisioni u ndërpre brutalisht nga ata që realizuan dhe erdhën në fuqi në vitin 1997. Kryetari i këtij komisioni z. Mezini është nxjerrë përdhunshëm nga zyrat e Ministrisë së Brendshme dhe dosjet, arkivat, për një kohë ngelën në mëshirë të fatit. (Kureshtarët të lexojnë dëshmitë e avokatit Nafiz Bezhani, kryetarit të Komisionit Shtetëror të Kontrollit të Figurës së Zyrtarit të zgjedhur më 18 gusht 1997 nga maxhoranca e majtë e asaj kohe (N. Bezhani, libri "Mëkatarët" fq. 8-9).

Periudha e dytë: gusht 1997-2002, kur ku proces u deformua, jo për fajin apo përgjegjësi të z. Bezhani, por për atë reduktim dhe deformim të ligjit, për qëllime politike nga socialistët, nëpërmjet amendamenteve të janarit 1998 që ligji në fjalë pësoi. Pra, ligji u reduktua djallëzisht, duke e kaluar, mbartur në thelb problemin e krimit shtetëror të diktaturës komuniste, përmes tashmë vetëm dosjeve të bashkëpunëtorëve duke arritur së pari që nomenklaturat e larta kriminale të PPSH-së dhe sigurimi të ishin prezent në demokraci (këtë herë të frikshëm përmes mjegullës së fshehtësive e pisllëqeve) dhe çka është thelbësore, ta transformonte krimin drejt bashkëpunëtorëve (të cilët gjithsesi për mendimin tim, fatkeq apo jo, të detyruar në shtrëngesë a terror psikologjik asnjëherë nuk janë pa faj, më saktë pa një pjesë fundore të tij). Nisur dhe nga deklaratat e vetë z. Bezhani, kushtet jo të plota të punës, pengesat ligjore, administrative e morale të drejtuesve të asaj kohe të shtetit ky proces "përfundoi" me verifikimin e dokumentacionit përkatës të 6000 zyrtarëve, nga të cilët figurave të penalizueshëm sipas ligjit, 104 vetë. (Mëkatarët, V. I – fq. 233). Ç'ironi! Një ligj i deformuar në 1998 automatikisht pastroi qindra mëkatarë, drejtues të lartë të strukturave të hartimit e zbatimit të dhunës komuniste, të Sigurimit të Shtetit etj. Periudha e tretë: 2002 e deri më sot që flasin për paaftësinë, miopi apo dashakeqësi e mirëkuptim të politikës ky problem u harrua, u la në heshtje të ndërgjegjshëm të gjithë autorëve apo aktorëve të politikës, qendrore apo periferike, në parti politike a OJF, zyrtarë a gazetarë që kjo heshtje, harresë, vetëm shëndoshjes së demokracisë, konsolidimit të saj përmes institucioneve e individëve të pastër nuk i shërben, por përkundrazi e dëmton atë më rëndë. Më rëndë sesa duket në vështrimin e parë. Kjo çështje është ai pengim i madh, filli ku thuret e shthuret jo pëlhura e Penelopës, por dekomunistizimi i shoqërisë sonë, ende i paarritur. Në rast se ky problem nuk zgjidhet përmes këtij projektligji sot asnjëherë ne nuk do të mundim të prodhojmë politikë të fortë kombëtare, asnjëherë

nuk do të ndërtojmë institucione të konsoliduara demokratike në legjislativ, ekzekutiv e gjyqësor.

Nëse ky problem nuk është zgjidhur në vitin 1995, çfarë garancie ka që do të zgjidhet tani. Apo është një çështje që do të shërbejë edhe këtë herë për të harruar disa ngjarje parandaluese si tragjedia e Gërdecit dhe çështja e trafikut të armëve?

Ky problem ka garanci që do të zgjidhet sepse opinioni i shëndoshë shqiptar që e sheh të ardhmen demokratike të vendit, duke mos harruar të kaluarën sado të hidhur të jetë (e për këdo) është shumë herë më i vetëdijshëm sot për negativitetet, pengesat që ka sjellë e sjell ky fenomen, ky kontingjent (ideator- ekzekutor e bashkëpunëtor) për të sotmen e Shqipërisë. Ligji është i nevojshëm sepse dekomunistizimi, si proces politik shoqëror përfshin, para së gjithash vënien para përgjegjësive për krimet e kryera në të shkuarën, abuzimin me pushtetin si dhe pasojat, padrejtësitë që janë realizuar direkt apo indirekt. Garanci tjetër është që tashmë kërkohet integrimi evropian edhe përmes këtij katharsisi. Asnjë nuk mund ta quaj këtë kërkesë atavike e folklorike për sa kohë që forumet evropiane miratojnë rezolutën të veçanta për këtë problem. Dihet se Rezoluta e Asamblesë Parlamentare e KE-së e vitit 1996 (nr. 1096) "Masat për të çrrënjosur trashëgimin e sistemeve totalitare komuniste" u shoqërua 10 vjet më vonë në 2006 me atë nr. 1481, "Domosdoshmëria për dënimin ndërkombëtar të krimeve të regjimeve totalitare komuniste". Kuvendi i Shqipërisë aprovoi një rezolutë të veçantë në rrjedhojë edhe të detyrimeve të rezolutave të sipërpërmendura "Domosdoshmëria për dënimin e krimeve të kryera nga regjimi komunist i Enver Hoxhës në Shqipëri". Një pikë e kësaj rezolute të Kuvendit kërkon shprehimisht: "Hapjen e dosjeve për politikanët, drejtuesit e institucioneve të rëndësishme, përfshirë edhe ato kushtetuese, drejtuesit e sistemit të drejtësisë, si dhe drejtuesit e mediave kombëtare audio-vizive dhe atyre të shkruara". E pra, kur është aprovuar kjo rezolutë, që ka shtruar dhe kërkesa të tjera për dekomunistizimin e shoqërisë, këto ngjarje si tragjedia e Gërdecit nuk kishin ndodhur, dhe nuk e besoj që të mendohet se ndonjë mendje diabolike e kishte projektuar edhe këtë. Mua më vjen keq që mbrojtësit e llogoreve të vjetra të politikës po e shfrytëzojnë edhe këtë tragjedi dhe me sofizmat e tyre kanë mbjellë këtë ide të pakuptimtë. Jo, zotërinj! Lustracioni i zyrtarëve e të zgjedhurve, largimi i ideatorëve, ekzekutorëve, bashkëpunëtorëve të Sigurimit famëkeq nga institucionet publike përfshi edhe rendin e ushtrisë, i forcon këto struktura, i fut natyrshëm në NATO a institucione të

tjera të sigurisë e rendit publik. Për ndonjë kritizer histerik që lexon këto rreshta do të pohoja që, Gërdeci ndodhi përmes të tjerash edhe për faktin se në radhët e drejtuesve të ndërmarrjes MEICO, por edhe të Forcave të Armatosura kishte dhe ka ish-bashkëpunëtorë të Sigurimit të Shtetit. E pikërisht ky ligj ashtu si do pastrojë politikën duhet dhe do të rregullojë moralin e institucioneve të ushtrisë, policisë, gjyqësorit (pse jo dhe medias). Ne të gjithë duhet të kuptojmë se pastërtia e drejtuesve të institucioneve të tilla është një kusht thelbësor për t'i ruajtur institucionet nga korrupsioni, kontrabanda e çdo lloji e dukuri të tjera kriminale.

Ju keni deklaruar se, nëse ka ministra me dosje të largohen me turp. Keni ndonjë informacion se ka ministra të tillë?

Deklarimin tim e kam bërë në kushtet e një interviste të shkurtër televizive, në përgjigje të pyetjes së gazetarit. E përsëris: "Nëse ka ministra me dosje, të largohen me turp". Reagimet e opinionit shoqëror e politik për hir të së vërtetës kanë qenë pozitive, por unë nuk kam pasur ndonjëherë detyrë politike apo administrative të merrem me këtë çështje. Unë di për ministrat aq sa di gjithë opinioni shoqëror, në veçanti ata që kanë pasion historinë, apo dinë të lexojnë nën rreshtat e çdo qëndrimi a deklarimi. Kështu që ne duhet të përsërisim më butë dhe pa ekuivokë "Nëse ka ministra me dosje të largohen me bisht në shalë". Në këtë kategori (për tu verifikuar) më duhet të fus dhe ish-ministrat. Shembulli bullgar flet vetë. Në këtë kontekst ndoshta për gjithë ish- ministrat e qeverisë shqiptare nga 1990 do të ishte e udhës të hapeshin dosjet, qoftë edhe thjesht për statistika e analiza që do t'i bëhen politikës 18-vjeçare, drejtuesve të tranzicionit në Shqipëri në një kohë të dytë.

Po qëndrimet më të fundit të PS-së si i komentoni?

Tentativa e PS-së për të shtyrë procesin është një veprim i qëllimshëm, i mirë menduar në variantin e parë për ta rishtyrë në "kalendat greke", apo në variantin e dytë që të vonohet në kohë me qëllim mos implementimin e tij. E në këto rrethana mendoj që PD-ja nuk duhet të tërhiqet. Koha për këtë p/ligj është e plotë për ta diskutuar e votuar këtë sezon. Koha e humbur, e çuar dëm për lustracionin në Shqipëri është e shumtë në këto 18 vjet. Ne kemi nevojë për forcimin, zgjerimin e kontrollit të figurës së zyrtarit në funksione të larta shtetërore nëpërmjet institucioneve të posaçme. (Në SHBA p.sh., kontrolli i figurës së zyrtarëve të lartë të shtetit bëhet nga një institucion i posaçëm nën juridiksionin e FBI-së. Dhe

objekti i kontrollit ka të bëjë me gjithçka të moralshme për personin, familjen dhe rrethin shoqëror).

Ditë pas dite, PR-ja është duke kërkuar rifutjen e saj në qeveri. E shikoni me vend këtë ngutje të kësaj partie për t'u rikthyer në kabinetin qeveritar, ndërkohë që ende nuk është sqaruar asgjë mbi Gërdecin?

PR-ja politikisht dhe numerikisht është aleati më i madh i PD-së në këtë koalicion me ngjyrë nga e majta e qendrës (Xhuveli), tek qendra apo qendra e djathtë. Si e tillë kërkesa e tyre për një post ministror është e drejtë. Është gabim të vendoset lidhja midis përfshirjes apo mos përfshirjes së PR-së në qeveri dhe Gërdecit. Kjo është një korrespondencë dashakeqëse pa argument politik. Gjithsesi ngutja e republikanëve personalisht më duket ashtu siç është dhe ju pyesni: ngutje, nxitim politik ndërsa ultimatum i fundit i republikanit Godo për kryeministrin më duket i papranueshëm. Kryeministri mund ta realizojë dhe në shtator apo në fund të këtij muaji, këtë pjesëmarrje të tyre në qeverisje, kondicionuar dhe nga rrethana të tjera dhe nuk paraqet problem.

Rikthimi i PR-ës në qeveri, pritet të shërbejë edhe si një indicie për një rikompozim të kabinetit në tërësi. Në cilat sektorë të qeverisjes ka më shumë nevojë? A mendoni se duhet të ketë ndryshime thelbësore apo ndryshime të pjesshme?

Si fillim për vetë atë çka ka praktikuar kjo qeverisje bazuar dhe në raportet më të fundit të institucioneve ndërkombëtare (po citoj nga raporti i fundit i BB-së) pas një stanjacioni disavjeçar në këto 2-3 vitet e fundit, pra vitet e qeverisë Berisha vërehet një trend pozitiv i rritjes në treguesit e mirëqeverisjes. Kështu p.sh., në lidhje me cilësinë e mjedisit rregullator (sistemi i rregullave mbi të cilin bazohet veprimtaria ekonomike dhe tregu) apo edhe efektiviteti i qeverisë ne kemi progres të dukshëm, duke arritur ritme të qëndrueshme të rritjes ekonomike (6 % në vit) me një inflacion nën kontroll (nën 4 %). Investimet në infrastrukturë janë rritur ndjeshëm pa harruar, ato në fusha të veçanta si shëndetësi, arsim, ushtri, kulturë etj. Edhe buxheti shtesë që kjo qeveri ka paraqitur në Kuvend këto ditë e konfirmon këtë arritje. Vazhdimësia e punës për plotësimin e kërkesave të MSA-së dhe marrja e ftesës për në NATO janë tregues sinjifikativ të politikës së jashtme e të brendshme të kësaj qeverie, në dobi e shërbesë të shtetasve të saj, interesave shtetërore e më gjerë ato kombëtare. Megjithatë nisur nga treguesit e dobët për sa i përket: a) forcës së ligjit dhe b) kontrollit mbi korrupsionin, duhet të bëjmë e të punojmë më shumë përgjithësisht si politikë e institucione

kushtetuese ku në veçanti qeveria, produkt i kësaj maxhorance ka barrën konkrete, detyrimin ligjor dhe përgjegjësinë e parë politike. Kjo përgjegjësi politike e shikuar në dy kënde që interferojnë me njëra–tjetrën (detyrimi i qeverisë ndaj shtetasve të një shteti, detyrimi i partisë fituese të mbajë premtimet ndaj elektoratit në tërësi dhe anëtarësisë së saj në veçanti), apo edhe nga fakti që zgjedhjet e ardhshme janë pas një viti e bëjnë të domosdoshëm procesin e ndërhyrjes në qeveri nga kryeministri. Në vendet në tranzicion si Shqipëria, qeveria si strukturë dhe qeverisja si proces gjithmonë ka nevojë për ndryshim, modernizim, përmirësim në përshtatje me nevojat aktuale të vendit pse jo dhe të ardhmen e formacioneve politike. Kabineti "Berisha" si një ekip integral është i realizuar me sukses për sa i përket ecjes në rrugën e duhur, në shinat e duhura po ndihet dukshëm në disa sektorë (për etikë nuk do t'i përmend) që shpejtësia evropiane e kryeministrit është larg, shumë përpara shpejtësisë butaforike të ndonjë ministri të kabinetit. Nuk po jap ministri konkrete pasi besoj se në intervista të tilla gjykime të lidhura me emra ministrash konsiderohen gjykime të bazuara në inate nominale dhe për më tepër në këtë situatë sjellin dëme dhe pengojnë proceset në qeveri. Unë besoj që Berisha jo thjesht si kryeministër i sotëm, por si lider i së djathtës dhe misionar i çështjes kombëtare do të realizojë ndryshime në qeveri (shpresoj brenda shtatorit) në emër të një mandati të dytë radhazi, që do t'u kërkojë shqiptarëve për të finalizuar projektet madhore për prosperitet kombëtar kudo, pse jo dhe për të ardhmen politike të Partisë Demokratike e të vetin si lider politik.

Nëse, si pasojë e balancave në PD, kryeministri Berisha nuk ndërmerr ndryshime rrënjësore në kabinet, e shikoni këtë përbërje si të gatshme të hyjë në fushatën elektorale dhe të fitojë mandatin e dytë qeverisës?

Teknikisht balancat janë në dorë të atij që ka peshoren, por dua të theksoj se ndryshimi i qeverisë në emër të arritjeve në të ardhmen, modernizimit dhe ekspansionit pozitiv politik të forcave që ajo mbart, në rast se bëhet mbi bazë të analizës, efikasitetit, produktit politik e teknik të nxjerrë nga ministra të veçantë dhe çka është më kryesorja kur ky ndryshim i ideuar dhe drejtuar nga vetë kryeministri në qetësi dhe në kohën e duhur padyshim i menduar për mirë në funksion të së ardhmes, është i dobishëm dhe i domosdoshëm. Pra, ndryshimet janë të dobishme dhe të domosdoshme!

II. 21. Skandali, Universitetit të Vlorës tentohet t'i hiqet emri "Ismail Qemali"

Reagojnë Leskaj, Rrokaj, Gaçe: Vendimi absurd
Leskaj i indinjuar: Qeveria të mos miratojë ndryshimin

28 korrik 2008, Gazeta Shqiptare (nga G. Bushati)

Skandal në Vlorë, tetë senatorë nga 14 të tillë, me votim i kanë hequr Universitetit të qytetit emrin Ismail Qemali, njeriu që shpalli pavarësinë e Shqipërisë më 1912. "Ismail Qemali s'ka asnjë lidhje me arsimin", ky ka qenë argumenti kryesor i këtyre senatorëve që në pak minuta, pa marrë mendimin edhe të vetë vlonjatëve, kanë vendosur heqjen e këtij emri. Propozimin i tyre pritet të dorëzohet pranë Ministrisë së Arsimit, e cila do t'i duhet të hartojë një projekt-propozim për të cilin merr vendim vetëm qeveria shqiptare, nëse do t'ia ndryshojë apo jo këtë emër universitetit të Vlorës. Burimet nga mbledhja e senatorëve, mbajtur më 26 korrik, pasdite, bëjnë të ditur se senatorët që votuan pro, janë shprehur se "prezantimi i këtij universiteti në botë të jetë thjeshtë Universiteti i Vlorës se sa me emrin e Ismail Qemalit përsipër". Por pa shpjeguar më tej se pse e thjeshtëzon këtë përfaqësim në botë heqja e emrit të Ismail Qemalit, emri i të cilit, në të gjitha enciklopeditë e botës, duke filluar nga ajo britanike njihet si lideri i parë i Shqipërisë së pavarur. Vendimi ngjalli menjëherë reagimin e menjëhershëm të pedagogëve të tjerë, historianëve, qytetarëve të thjeshtë të Vlorës, si dhe të deputetëve.

Leskaj

Deputeti vlonjat Bujar Leskaj u shpreh tejet i indinjuar me këtë vendim të senatit të Universitetit të Vlorës. "Emri i Ismail Qemalit për mua personalisht nuk është i njësuar me Vlorën, por me gjithë Shqipërinë, përfshi dhe Kosovën. Në këtë suazë dhe në atë të detyrimeve që shoqëria shqiptare shtron përpara arsimit në përgjithësi dhe atij universitar në veçanti, veprimi i fundit i senatit të Universitetit të Vlorës, mua si qytetar i këtij qyteti më ka lënë një

shije të hidhur si një veprim i pakuptimtë, veprim i nxituar, si një gafë fillestarësh, veprim i cili duhet të korrigjuar sa më shpejt, apo në variantin tjetër nuk duhet të marrë fuqi juridike", - u shpreh dje deputeti Leskaj, duke i bërë thirrje kështu qeverisë shqiptare për të mos e miratuar këtë propozim të senatit të këtij universiteti. Leskaj i indinjuar shprehet më tej se Universiteti i Vlorës nuk është pronë e senatorëve, nuk është institucioni vetëm i tyre, por i të gjithëve, prandaj drejtuesit e tij duhet të jenë më të përgjegjshëm kur marrin vendime të tilla. "Korrigjimi i kësaj pakujdesie na nderon ne të gjithëve, por më shumë nderon ata që gabuan", - tha dje deputeti i Vlorës. Sipas tij, nga çdo këndvështrim që ta shohësh këtë çështje, qoftë në planin partiak apo jo, "nga çdo kontakt arsimor dhe arsimdashës veprimi është i nxituar dhe i pakuptimtë, është gafë". Më tej deputeti i PD-së thekson se Universiteti i këtij qyteti ka sfida të tjera përpara, si rritja e nivelit dhe produktivitetit që ai nxjerr "të cilat unë besoj se Rektori Shaska dhe profesorati i universitetit do t'i kalojnë me sukses".

Prof. Dr. Shezai Rrokaj, Prof. Dr. Bardhosh Gaçe, gjithashtu reaguan ndaj këtij vendimi absurd të senatorëve të universitetit...

Shënim: *Të gjitha mediat e trajtuan me përgjegjësi e seriozitet këtë problem dhe në veçanti gazetarët e qytetit të Vlorës, ku mund të përmend: Gëzim Llojdia, Harilla Koçi, Vangjel Sako, Qemal Biraku, Ergys Alushi, Ornela Hila, Zenepe Luka, Enrik Mehmeti, Mikel Marsi, Anila Peçi, etj, si dhe të gjithë televizionet lokale në Vlorë.*

II.22. Maxhoranca konfirmohet pa PDK

Shkrim i datës 29/07/2008, Gazeta Panorama (marrë me shkurtime)

Maxhoranca rikonfirmon votat e saj, duke shtuar edhe votat pro deputetëve që njihen si mbështetës të ish-kryeministrit Fatos Nano. Ndryshimet e treta të qeverisë si rrallë herë kanë kaluar pa probleme për maxhorancën e djathtë, me gjithë luhatjet e demokristianëve. Deputetët e grupit të ri parlamentar "Qendra" e shpallën që paraditen e djeshme votimin, që do të bëhej në orën 22.45. Kështu, të njohur si mbështetës të ish-kreut të PS-së, Paulin Sterkaj, Durim Hushi, Bukurosh Stafa dhe Durim Lamaj votuan pro të gjitha propozimeve të Presidentit Topi si për emërimin, ashtu edhe për shkarkimin e ministrave. "Mendimi i grupit të Qendrës është numri i ministrave të zëvendësuar mund të ishte më i madh. Gjithsesi, grupi është i mendimit të përkrahë me votat e tij kryeministrin dhe dekretet përkatëse të presidentit", deklaroi dje kryetari i "Qendra", Paulin Sterkaj. Pro dekreteve të presidentit dhe propozimeve të kryeministrit Berisha votuan dhe tre deputetët e PBDNJ-së, Vangjel Dule, Leonard Solis dhe Spiro Peçi.

Shifrat e votimit

Ministri i Arsimit, Fatos Beja është dekreti më i votuar nga maxhoranca, i cili mori 81 vota pro. PDK-ja, e cila është lënë jashtë qeverisë ka abstenuar në të gjitha votimet e realizuara për dekretet e presidentit për katër anëtar e rinj të kabinetit qeveritar "Berisha 4".

I vetmi nga maxhoranca që ka votuar kundër në një rast ka qenë deputeti i PD-së, Bujar Leskaj. Ai shprehu votën e tij kundër caktimit si zv.kryeministër të Genc Pollos.

Votat në total pro Pollos janë 78 vota pro, 47 kundër dhe 8 abstenime. Ministrja e re e Shëndetësisë, Anila Godo ka dalë e dyta për numrin e votave pro, duke marrë 79 vota pro, numrin më të vogël të votave kundër 35 dhe 13 abstenime. Ndërsa për shkarkimin e Pollos nga posti i Ministrit të Arsimit u votua me 84 vota pro, 30 vota kundër dhe 13 abstenime. Gjithsej në seancë u realizua votimi i gjashtë dekreteve, ku dy prej tyre ishin për shkarkimin e ministrit të Shëndetësisë, Nard Ndoka dhe për ministrin e Arsimit, Genc Pollo.

II.23. Ndryshime në Komisionin e Ligjeve

29.07.2008, Gazeta Panorama (marrë me shkurtime)

Ilir Rusmajli do të jetë kryetari i ri i komisionit të Ligjeve. Deputeti demokrat mori shumicën e votave dje në kuvend dhe do të zëvendësojë në këtë post Fatos Bejën, i cili po gjatë seancës së djeshme u emërua ministër i Arsimit. Njëra prej tetë votave kundër ishte ajo e ish-ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Bujar Leskaj, i cili të njëjtën gjë kishte bërë edhe pak javë më parë kur Rusmjali propozohej bashkëkryetar i komisionit për Reformën Zgjedhore.

II.24. Falja e gjobave

12.09.2008, Gazeta Panorama (marrë me shkurtime)

Deputeti i PD-së, Bujar Leskaj, ka abstenuar gjatë votimit të këtij projektligji në tërësi. Ndërsa ka votuar kundër propozimit të bërë në Kuvend në nenin 9, i cili shkaktoi shumë debate në Kuvend. Ndërsa deputeti i PD-së, Leskaj, ka kërkuar heqjen e nenit 9, pasi kështu do të ketë pasoja ndaj biznesit dhe ngatërrime në zbatimin e tij. "Neni 9, ju vetë zoti ministër do shihni se do t'ju vendos në vështirësi. Këtu bëjmë fjalë për një falje të thjeshtë, nuk është një amnisti e plotë. Jo edhe ta falim, por ta dërgojmë në Prokurori. Nuk mendoj se janë 10 dosje, por janë me qindra dosje", theksoi Leskaj.

II. 25. Raporti i KLSH ndez debatin në Komisionin e Ekonomisë

Leskaj-Çekut: Nuk ke deklaruar shkeljet e Pangos

02.10.2008, Gazeta Panorama (marrë me shkurtime)

Raporti i Kontrollit të Lartë të Shtetit ka ndezur debate mes deputetëve të komisionit të Ekonomisë dhe zyrtarëve të qeverisë. Gjatë seancës së djeshme deputeti demokrat Bujar Leskaj i ka kërkuar kryetarit të KLSH-së se për çfarë arsye në raport nuk janë pasqyruar shkeljet financiare që janë kryer në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Sipas Leskajt, në këtë ministri janë kryer një sërë shkeljesh, gjatë vitit 2007, (prill-dhjetor), por çuditërisht këto shkelje nuk janë të pasqyruara në raportin e KLSH për buxhetin faktik të 2007-ës. Por sipas kreut të KLSH, Robert Çeku, ai ende nuk ka dhënë firmën përfundimtare mbi këtë raport. Sipas tij, do të shtohen edhe disa materiale të tjera dhe vetëm atëherë raporti do të jetë i plotë...

II.26. Aleatët, jo në listën e PD-së

Leskaj ironizon shkrirjen me PDR: Po kthehet Dushku

Tiranë më 07.10.2008, Gazeta Panorama (koment nga Adi Shkëmbi)

Për herë të parë, në mbledhjen e djeshme të grupit parlamentar të demokratëve është prekur çështja e listave të deputetëve për zgjedhjet e ardhshme parlamentare. Deputeti Bujar Leskaj ka kërkuar nga kryeministri Berisha që ndryshimet e miratuara të sistemit elektoral të mos pësojnë arnime të tjera që do të prishin në thelb sistemin. Sipas tij, partitë aleate po kërkojnë që të rikthejnë sërish sistemin e "Dushkut", duke tentuar të fusin emrat në listat e demokratëve. "Ne kur votuam ndryshimin e sistemit zgjedhor në Kuvend e votuam për të shmangur sistemin e "Dushkut" që u vërejt në zgjedhjet e mëparshme. Kryetarët e partive të vogla po bëjnë presion që ta dushkarizojnë këtë ndryshim të miratuar në Kuvend duke dashur të fusin emrat në listën tonë. As Ndoka, as Godo, as Mediu, as Pollo nuk kanë të drejtë të bëjnë presion mbi koalicionin", mësohet të ketë thënë Leskaj në pjesën me dyer të mbyllura të mbledhjes së grupit parlamentar të PD-së. Burimet bëjnë të ditur gjithashtu se, kryeministri Berisha e përkrahu në parim kërkesën e deputetit demokrat, por ka shtuar se do të vlerësohen edhe marrëdhëniet me partitë aleate. Në të njëjtën kohë deputeti Leskaj ka ironizuar edhe shkrirjen e Partisë Demokratike me Partinë Demokrate të Re. "Me shkrirjen e Partisë Demokrate të Re me Partinë Demokratike duhet të tregohemi demokratë deri në fund. Me futjen e tre anëtarëve të PDR-së në kryesinë e PD-së dhe katër anëtarë të tjerë në Këshillin Kombëtar, ngelin jashtë vetëm shoferi dhe sekretarja e Pollos", mësohet të jetë shprehur deputeti Leskaj. Por kryeministri Berisha, i cili prej kohësh e ka përkrahur këtë proces të shkrirjes së këtyre dy partive, e ka marrë kaluar vetëm me një të qeshur. Gjithashtu Leskaj ka kërkuar nga administrata që të thellojë transparencën në të gjitha drejtimet si dhe për ata zyrtarë të niveleve të dyta, që kanë rezultuar si shkelës të ligjit në raportet e auditimit të merren

masa disiplinore deri në shkarkimin e tyre nga postet që mbajnë. Në mbledhjen e djeshme kryeministri Berisha i është rikthyer sërish miratimit të reformave të rëndësishme në Parlament. Burime nga grupi pohojnë se, kryeministri Berisha ka deklaruar se reformat kryesore si ajo zgjedhore dhe ajo në drejtësi duhet të bëhen patjetër me konsensusin e opozitës. "Këto janë reforma që duan patjetër konsensusin e opozitës. Nëse miratojmë një ligj sot pa opozitën, nesër vijnë ata në pushtet dhe e zhbëjnë dhe miratojnë një ligj tjetër. Po ashtu edhe ne kur të vijmë sërish në pushtet do e zhbëjmë, duke mos arritur asgjë", është shprehur kreu i qeverisë në mbledhjen e djeshme.

Shënim: Ndërsa Gazeta Shqiptare, dt. 07.10.2008 e komentoi me titullin "Jo rikthimit të Dushkut". Përmendej edhe kërkesa për më tepër transparencë. Citojmë komentin e gazetës: "Deputeti i maxhorancës Leskaj i kërkoi dje kryeministrit Berisha shtimin e transparencës në institucionet qeveritare. Një gjë e tillë, sipas tij, do ta ndihmonte më së pari vetë qeverinë si dhe do të ishte në favor të maxhorancës".(gazetare Gilmana Bushati).
Koment të plotë mbi prononcimet në këtë mbledhje grupi përgatiti dhe revista Klan apo gazeta të tjera.

II. 27. Koalicion i përbashkët me lista të veçanta

Shkrim i datës 12/10/2008, Gazeta Panorama

Nga Bujar Leskaj

Ndryshimi kushtetues i sistemit të zgjedhjeve në Shqipëri nga maxhoritar në proporcional kishte dhe ka si synim (argument) kryesor vlerësimin e plotë të aspiratave të elektoratit, pra pasqyrimin e saktë të vullnetit të "sovranit", i cili përbëhet nga shumatorja e votave të lira të qytetarëve të lirë adresuar partive politike konkurruese. Synim i këtij ndryshimi ishte shpëtimi nëpërmjet ndërhyrjes në krye ligj, në Kushtetutë, i procesit zgjedhor nga alkimia politike e prodhuar nga partitë tona politike në disa legjislatura, ose thënë thjesht që elektorati dhe partitë të mos shijonin më lëndët e hidhura (apo të ëmbla) të pemës "Dushk". Kjo ishte në të mirë të demokratizimit të zgjedhjeve dhe demokratizimit të vetë shoqërisë, në të mirë të afrimit maksimal me standardet e BE-së, ku "pyjet e Dushkut" janë çrrënjosur me kohë.

Është e vetëkuptueshme se ky ndryshim i mekanizmit zgjedhor do shoqërohej me ndryshime përkatëse nga partitë politike, rimodelime të ndryshme, me krijimin e koalicioneve të reja politike në funksion të afrisë së kaheve dhe platformave politike apo forcimin e atyre ekzistuese (siç është rasti i koalicionit tonë qeverisës).

Faktikisht koalicioni është një mekanizëm demokratik, sipas të cilit partitë me synime dhe interesa të përbashkëta dhe platforma të përafërta ecin në grup në një drejtim, duke ndjerë ngrohtësinë e supit të njëra-tjetrës, duke mbështetur njëra-tjetrën dhe duke ndihmuar njëra-tjetrën, por gjithnjë për aq sa kjo përputhet me programin e tyre. Kjo është më se normale për zhvillimet e ndershme politike.

Ndërkohë konditë *sine qua non* për këta koalicione është implementimi sa më natyrshëm i vullnetit dhe aspiratave të lira qytetare të votuesve dhe shmangia e rreptë e deformimit të këtij vullneti. Shmangia e rrezikut që atributi kryesor i sistemit proporcional për t'ju larguar sa më tepër ballit të "pyllit të

dushkut" të mos sjellë pa e kuptuar rihyrjen nga shpina në "pyllin e dushkut".

Pikërisht kjo kërkon zbatimin e plotë të synimit themelor të sistemit të ri proporcional, pasqyrimin dhe vlerësimin real dhe jo virtual të peshës së partive në elektorat dhe eliminimin e aleancave fiktive, të cilat përcjellin gabuar në jetën politike parlamentare peshën reale të një partie.

Si i tillë pozicionimi parlamentar i partive duhet të jetë proporcional me peshën që ka një parti në një elektorat të caktuar, në përputhje të plotë me vullnetin e këtij elektorati të caktuar. Kjo peshë së pari është në funksion të besueshmërisë së platformës së partisë, të raportit midis premtimeve dhe mbajtjes së premtimeve nga një parti dhe *last but not list*- e fundit nga radha, por jo e fundit për nga rëndësia, nga besueshmëria e figurave kryesore të kësaj partie. Me një fjalë, nëse një parti e ka drejtuar ose e ka ndihmuar mirë elektoratin shpërblehet me besimin dhe votën e popullit.

Por sa qëndron kërkesa e drejtuesve të partive të vogla në aleancë me PD-në që lista e përbashkët e partive të shoqërohet me listat e përbashkëta të deputetëve të këtyre partive në një të vetme?

Personalisht, duke theksuar vlerat dhe vlerësimin tim maksimal për këtë koalicion dhe partitë pjesëmarrëse, më duhet të theksoj se, pavarësisht faktit që jam pro koalicionit të përbërë të djathtë, unë jam kundër listës së përbashkët të deputetëve nga parti të ndryshme të koalicionit, sepse kjo ia humbet individualitetin partisë dhe i bashkon virtualisht programet e tyre sado të ndryshëm që të jenë ata nga njëri-tjetri. Partitë e një koalicioni bashkohen në pikat kardinale, por ato ndahen nga një sërë elementesh të veçantë, si p.sh., duke përmendur vetëm njërin prej tyre, për pronësinë ndaj tokës. Kjo dhe i jep individualitetin partisë dhe tërheq simpatizantët, të cilët i japin votën asaj.

Nëse një votues i bashkohet një partie të djathtë për racionalitetin e programit dhe gjen në këtë program aspiratat e tij, ai fare bukur mund të mos ta gjejë veten në programin e partisë tjetër po të djathtë dhe do ndodhet para një udhëkryqi, ku nuk do të dijë nga t'ia mbajë. Nëse një klient shkon në një restorant që e frekuenton, ai zgjedh nga menyja atë që i pëlqen dhe nuk porosit të tërë menynë nga fillimi në fund.

Por nëse do supozonim se kjo listë e përbashkët u pranua, kjo supozon se fushata do të jetë e përbashkët dhe nëse dy ditë para një kandidat i PD-së i premton në emër të koalicionit zgjidhjen p.sh. të problemit të pronësisë në një mënyrë dhe pas dy ditësh kandidati tjetër i një partie minore i premton po atyre dëgjuesve zgjidhjen

e problemit në mënyrë krejt tjetër, kjo do sillte interferenca të dëmshme dhe çoroditje në elektorat.

Problemi tjetër, këtë herë etik, është se nëse gjatë rrugës një parti minore del nga koalicioni për shkaqe objektive, p.sh. mospërputhje, zbatim programi, apo thjesht subjektive, p.sh. për acarim personal të drejtuesve a drejtuesit, cilat vota do tërhiqte me vete deputeti i kësaj partie minore? Votat e PD-së për t'ia kundërvënë PD-së? Ndërkohë praktika parlamentare ka treguar se koalicionet e salduara nuk ekzistojnë.

Vlerat politike dhe etike që do prodhonte një koalicion me lista të përbashkëta deputetësh do rimbillte "filizin e Dushkut" dhe këtë herë paradoksalisht brenda një parcele, qëllimi i së cilit është eliminimi i "pemës së Dushkut". Pranimi i presionit të partive minore të djathta apo të qendrës së djathtë, pjesëtare të koalicionit aktual qeverisës, do të ishte një gabim për Partinë Demokratike, e cila ndërmori përsipër përgjegjësinë e ndërhyrjes në ligjin themelor të Kombit, në Kushtetutë, pikërisht për eliminimin e "Dushkut" apo çka më keq do hidhte dyshime mbi qëllimin e mirë të ndryshimeve të prillit 2008.

Si epilog do ripërsëris edhe më qartë, se ne duhet të ruajmë koalicionet me lista të përbashkëta partiake, por me lista të veçuara kandidatësh brenda partive, me synim maksimizimin e votave të koalicionit të djathtë. Përveç të tjerash kjo do të bëjë që këto parti të vazhdojnë të rriten, të mësohen të luftojnë, të forcohen në strukturë dhe përmbajtje dhe të mos kthehen në organizma simbiotikë, të cilët i bashkohen si bimë kacavjerrëse trungut të pemës së PD-së për të përfituar nga lëngjet që thith me rrënjë nga toka pema e PD-së. Kjo dhe do t'i shpëtonte zhvillimet e ardhshme politike nga virtualiteti, fiktiviteti dhe shija e hidhur e lëndës së dushkut.

II. 28. Ina Rama të heqë Shtyllën

II. 28.1 Sollaku depolitizoi Prokurorinë

17.10.2008, Gazeta Panorama

Deputeti i PD-së, Bujar Leskaj i kërkoi kryeprokurores Ina Rama të shkarkojë nga detyra Zamir Shtyllën, pasi ai është një nga njerëzit që ka punuar në kohën e regjimit komunist. Si një nga deputetët që ka votuar pro caktimit të Ina Ramës në postin e kryeprokurores, Leskaj i ka dhënë një këshillë asaj "Dua t'i kujtoj miqësisht zonjës prokurore të Përgjithshme, nëse ka kohë të lexojë një roman të Kadaresë "Jeta, loja dhe vdekja e Lul Mazrekut". Pse e them këtë? Në atë roman prokurorja e Përgjithshme do të shikojë se figura qendrore më e urryer e atij romani sot është në krah të djathtë të saj", theksoi Leskaj. Sipas tij, Rama duhet të shkarkojë prokurorin Zamir Shtylla. "E pra shqiptarët në 1990, 1992, 2002, 2005 nuk votuan që në Prokurorinë e Përgjithshme të jenë drejtues de facto, ata të kohës së diktaturës. Ne votuam për Ina Ramën, nuk votuam për Zamir Ramën, apo për Shtyllën e Ramës. Nuk votuam që ligjin, drejtimin në Prokurori ta ketë një njeri që ka shërbyer që ka nga koha e Kadri Hazbiut, Feçor Shehut, Simon Stefanit, apo nxënës i Aranit Çelës", theksoi Leskaj.

Ai dha vlerësime për punën e kryer nga Sollaku, duke qenë i pari përfaqësues nga maxhoranca, që vlerëson njeriun që ajo e shkarkoi një vit më parë. "Kryeprokurorja duhet të vlerësojë ato arritje, pavarësisht se ne si pozitë nuk ditëm t'ia njihnim prokurorit të mëparshëm, duam apo s'duam ne t'ja njohim si meritë, Z. Theodori Sollaku e depolitizoi Prokurorinë e Përgjithshme", theksoi Leskaj.

II. 28.2. Fushata e shpifjeve, sepse enveristët nuk e pranojnë dot qeverisjen e Berishës

17. 10. 2008 Gazeta 55, (nga Leonard Quku)

Deputeti demokrat Leskaj, deklaroi se Prokuroria e Përgjithshme drejtohet de facto nga një shërbëtor i komunizmit, që zonja Rama e ka kthyer në krahun e djathtë të saj, Zamir Shtyllën. Maxhoranca ka reaguar ashpër dje, ndaj inefiçiencës së organit të akuzës ndaj të gjitha akuzave që janë bërë publike ditët e fundit nga eksponentë të opozitës së majtë dhe një pjesë e shtypit majtist. Deputeti demokrat, Bujar Leskaj, ka deklaruar dje në kuvend, gjatë 60 minutave të diskutimit të lirë, se emërimi i zonjës Rama në postin e kryeprokurores është bërë me shumicë votash, duke marrë miratimin e pjesës dërrmuese, por ajo duhet ti shërbejë me paanësi institucionit që mbulon, duhet të thellojë hetimet për këdo dhe mbi cilin do, pa asnjë pengesë dhe asnjë problem politik. Deputeti Leskaj, solli në vëmendje se Prokuroria e Përgjithshme drejtohet de facto nga një shërbëtor i komunizmit, që zonja Rama e ka kthyer në krahun e djathtë të saj, Zamir Ramën. "I kujtoj miqësisht zonjës. Rama, se nëse ka kohë të lexojë një roman të shkrimtarit të madh Ismail Kadare "Jeta, loja dhe vdekja e Lul Mazrekut". Pse e them këtë? Në rast se ndonjëri nga ju dhe nga shoqëria civile do të jetë i interesuar, është e mirë që këtë roman ta përkthejë edhe në anglisht. Sepse në atë roman Prokurorja e Përgjithshme do të shikojë se figura qendrore më e urryer e atij romani, sot është në krah të djathtë të prokurores së Përgjithshme. E pra, shqiptarët në '90-tën, shqiptarët në '92-shin, shqiptarët në 2005-ën, nuk votuan që në Prokurorinë e Përgjithshme, të jetë drejtues de facto, në një kohë që ne këtu në parlament votuam për Ina Ramën, nuk votuam për Zamir Ramën, nuk votuam për shtyllën e Ramës, nuk votuam që ligjin, drejtimin e Prokurorisë ta bëjë një njeri që ka shërbyer që nga koha e Kadri Hazbiut, Feçorr Shehut, Simon Stefanit, Qemal Lames, nxënës i Aranit Çelës, drejton dhe komandon Prokurorinë e Përgjithshme", tha deputeti Leskaj. Ai u kujtoi deputetëve socialistë në kuvend, që të shikojnë CV-të e këtyre personave. "Të drejtojë një njeri armik i demokracisë, të drejtojë një njeri që është një soj i veçantë në specien e vet. Ka pasur shumë persona që kanë punuar në ato organe, para '90-ës dhe e kanë gjetur veten e tyre me shumë dinjitet, por nuk ka mundësi që një drejtues i tillë, një shërbëtor i shumë zotërinjve, që prokurorët e tjerë, pasi i ka mjelë, i ka shitur, dhe ai të njëjtën gjë do të bëjë edhe me zonjën Rama. Organi i akuzës, duhet të jetë

i varur nga ligji dhe vetëm nga ligji", theksoi deputeti Demokrat. Referuar akuzave të opozitës, Leskaj tha se e majta po demonstron një sjellje hipokrite, dhe moral të dobët, pasi kanë mbi një muaj që i servirin opinionit publik shpifje dhe gënjeshtra, për një aksident të një qytetari, të një biznesmeni, duke akuzuar për vrasje politike, e duke akuzuar për vrasje me prapaskena etj, por që asnjëri nuk u ngrit moralisht të paktën, që tu kërkojë ndjesë familjarëve të të ndjerit, tu kërkojë ndjesë popullit shqiptar për këtë shpifje që është në vazhdën e krejt shpifjeve që opozita po ndërton në këtë periudhë. "Për mendimin tim, kjo është kryqëzata e tretë që ju po ndërmerrni si e majtë agresive, kundër Partisë Demokratike dhe veçanërisht kundër kryeministrit Sali Berisha. Ju nuk mund t'ia falni faktin Berishës që në mars '92, Berisha erdhi si i pari President i zgjedhur, nga vota e lirë e popullit, erdhi në zyrën e Ramiz Alisë, që ju e keni fort për zemër. Erdhi si i pari President mbas Ismail Qemalit, që vinte në pushtet pa asnjë vrasje dhe pa asnjë krim në kurriz, përkundrazi për këtë ardhje të Partisë Demokratike në pushtet dhe të demokracisë në '92-shin dhanë jetën ndërmjet të tjerëve edhe heroi i demokracisë Arben Broci. Mbasi e mbyllët fazën e parë 89-92, me Partinë Demokratike dhe Sali Berishën, nisët fazën e dytë, 1992-2005, e cila për fatin e keq të popullit shqiptarë pati një kulm suksesi, ju fituat në betejë në '97-ën, e shfrytëzuat, e molët pushtetin, e gënjyet popullin shqiptar 8 vjet në pushtet dhe mbasi përsëri Partia Demokratike dhe Berisha vijnë në pushtet në korrik 2005, me votën e lirë, ju tashmë keni kaluar në atë që është sulmi i tretë frontal, ose kryqëzimi i tretë që ju doni të bëni, jo thjesht Sali Berishës si individ, pasi Sali Berisha është tërësisht i më se i realizuar si individ në jetë dhe karrierën e vet politike, por ju doni tu bëni dëm anëtarëve të Partisë Demokratike, doni ti bëni dëm Partisë Demokratike, partive të tjera të djathta dhe të qendrës dhe krejt demokracisë në Shqipëri", theksoi ndër të tjera deputeti demokrat Bujar Leskaj.

II. 28.3 Një mesazh në postën elektronike

Qytetari Genti Nushi për këtë çështje mban qëndrimin e mëposhtëm:
(të dërguar në adresën e postës të faqes së web-site www.bujarleskaj.com)

Tiranë më 21 Tetor 2008
Adresa Rr.Muhamet Gjollesha
Email nushig@yahoo.com

Mesazh Z Bujar Leskaj kam pasur një respekt dhe një simpati për ju, por me fjalimin në Kuvend dhe me shkrimin që bëtë te gazeta Panorama për Zamir Shtyllën unë dhe shumë miq të tjerë që jemi të djathtë kemi humbur respektin për ju. Në akuzat e juaja dhe një fëmijë i vogël e kupton se janë për të bërë një figurë të mirë tek kryeministri. Zamir Shtylla ka punuar 12 vjet në regjimin e kaluar dhe 18 vjet në demokraci dhe shquhet për një ndershmëri dhe profesionalizëm që nuk ka krahasim është një vlerë në prokurori dhe ka qenë krahu i djathtë, jo i vetëm prokurores Ina Rama, por të gjithë prokurorëve që nga koha kur Z.Berisha ka qënë President dhe vetë Berisha ka një respekt të madh për të, pavarësisht disa personave të korruptuar (nuk po flas për ju) që i vijnë dhe i flasin te veshi që të sulmojë Zamirin. Dhe ju siguroj që Zamir Shtylla është i depolitizuar në maksimum dhe më shumë miq ka nga e djathta se nga e majta dhe në kohën e Nanos e akuzonin se është i djathtë kurse tani e kundërta, e kuptoni! Për këtë mund të pyesni kolegun tuaj Z.Dashnor Sula! Zamir Shtyllën për ndershmërinë e tij është zgjedhur nga prokuroria italiane dhe se Drejtori i Antimafies për Shqipërinë. Po unë besoj që këto gjëra ju i dini dhe po përdorni emrin e tij thjesht për politikë. Zamir Shtylla ka qenë prokurori që është marrë me Ramiz Alinë etj që i çoi në burg dhe është po ai që Fatos Nanon e ka marrë në pyetje dhe është po ai që po ta lini të qetë do luftojë mafien dhe korrupsionin në Shqipëri. Por disa personave ndershmëria e tij dhe profesionalizmi i tmerron dhe provokojnë sherre pa lidhje.

Përshëndetje G. Nushi

II.29. Paratë e privatizimeve, 20 % për ish të përndjekurit

Tiranë më 8.11.2008 , Gazeta Panorama

Ish-të përndjekurit politikë ende nuk kanë marrë asnjë lek nga qeveria si dëmshpërblim për vitet që kanë kaluar në burg nga regjimi komunist. Por edhe pse fondi prej 2 miliardë lekësh në buxhetin e shtetit ekziston, shpërndarja e tij nuk ka nisur ende. Kjo për shkak se lista me emra e shoqatës së ish-të përndjekurve politikë nuk përputhen me atë të Ministrisë së Drejtësisë. Në një situatë të tillë, deputeti i PD-së, Bujar Leskaj, ka hedhur idenë e zgjidhjes së këtij problemi. Ai i ka kërkuar dje ministrit Bode që të shikojë mundësinë e zgjidhjes së këtij problemi në këtë mënyrë, që 40 për qind e parave të marra nga privatizimet të shkojnë për uljen e deficit buxhetor, 40 për qind për investime dhe 20 për qind për të përndjekurit politikë. Por ministri Bode është shprehur se parimisht është dakord me këtë ide, por sipas tij një alternativë e tillë nuk do të pranohej kurrsesi nga Fondi Monetar Ndërkombëtar. Madje, sipas Bodes, mundësia më e mirë do të ishte që nga fondi prej 2 miliardë lekësh, gjysma e tyre të përdorej për investime, në mënyrë që në fund të vitit ky fond të mos digjej. Dhe nga shuma e parave të privatizimit që do të arkëtohen në 2009-ën, 10 për qind e tyre të shkojnë për dëmshpërblimin e ish-të përndjekurve politikë. Por edhe pse kjo alternativë e ministrit duket e zbatueshme, përsëri ai u shpreh dyshues në marrjen e aprovimit të fondit për këtë pikë.

Shënim: *Më në fund në ligjin e buxhetit të shtetit për 2009-ën, u arrit që nga të ardhurat e siguruara nga privatizimet strategjike 10% të përdoren për dëmshpërblimin e ish të përndjekurve politik dhe 10% për kompensimin e ish pronarëve. Këtë çështje unë e kam trajtuar dhe në takimin e Komisionit të Ekonomisë të Kuvendit me përfaqësues të FMN-së.*
Në seancën plenare në Kuvendin e Shqipërisë ministri Bode ndër të tjera përmendi faktin që: "Qeveria dhe Ministria e Financave për këtë problem pranuan propozimin e deputetit Bujar Leskaj".

II. 30. 8 Dhjetori, Dita e Rinisë, Dita e Lirisë

Shkrim i datës 08.12.2008, Gazeta 55
Nga Bujar Leskaj

8 Dhjetori, Dita e Rinisë, do të konsiderohet si dita e lirisë ndoshta e ngjashme me 28 Nëntorin, ditën e madhe të lirisë kombëtare në raport me historinë tonë. Gjithmonë në këtë ditë, shqiptarët do të ndalen për një moment duke reflektuar për zgjedhjen që bënë studentët, intelektualët dhe punëtorët, në dhjetorin e 1990. Ata ndërmjet lirisë dhe tiranisë pa mëdyshje zgjodhën lirinë, sepse kjo vlerë është pasuria më e madhe e shoqërisë moderne. Ajo nuk implementohet në mënyrë mekanike, ajo ndërtohet. Studentët shqiptarë të dhjetorit 90 qenë punëtorët e saj të parë dhe dëshmorët e saj të mëdhenj, Arben Broci dhe Azem Hajdari (është detyrimi ynë moral, politik e historik të vendosim Përmendoren e Azem Hajdarit, e prodhuar 3 vjet më parë, si dhe të realizojmë përmendoren e Arben Brocit). Mposhtja e frikës dhe sfida që i bënë sundimit komunist gati 50 vjeçar diktatorial, studentët shqiptarë shënon atë moment të madh të ndërgjegjësimit të këtij kombi për të kaluarën e vet, por mbi të gjitha për të ardhmen e tij. Kjo lëvizje krijoi profilin e vet në një përballje dialektike të panjohur deri atëherë, ku kërkohej pluralizëm politik përballë një partie kriminale, kërkohej shtet ligjor përballë diktaturës që nuk njihte asnjë të drejtë themelore të njeriut, kërkohej ekonomi e lirë e tregut përballë centralizimit që solli urinë, kërkohej rikthimi i natyrshëm i Shqipërisë në arealin e saj natyral pra në Evropë me thirrjet e fuqishme "E duam Shqipërinë si gjithë Evropa" kur vendi ishte i rrethuar me tela me gjemba dhe i mbjellë me bunkerë.

Kishte kohë që heroizmi ishte vetëm pasuri individuale e të persekutuarve politikë antikomunistë, ndërsa me këtë lëvizje ajo bëhej një pasuri kombëtare. Lëvizjes së Postribes të 1946, Kryengritjes së Spaçit të 21-23 Majit 1973 (21 Maji është shpallur zyrtarisht në vitin 2006 si Dita e Kujtesës Historike për Qëndresën Antikomuniste. Kjo Kryengritje - dëshmi historike antikomuniste meriton të shpallet: Nderi i Kombit, Heronjtë e saj gjithashtu). Revoltës së Qafë-Barit,

protestave të Kavajës e Shkodrës së viteve '90, do t'u bashkëngjitej si triumf historik Lëvizja Studentore e dhjetorit 1990.

Studentët, pjesëmarrësit e atyre ditëve të mëdha, prijësit e tyre kuptuan se ndërgjegjja dhe logjika bëhen një në të vërtetën e madhe të lirisë dhe se liria është e vetmja rrugë e përshkueshme për të arritur progresin kombëtar dhe shoqëror. Bijë e kësaj lëvizjeje dhe shpirti i ndryshimeve të mëdha historike u bë Partia Demokratike, Partia e Dhjetorit, e cila thirrjet e studentëve i bëri program për të ndërtuar marrëdhënien e re të Shqipërisë me të ardhmen e saj. Atëherë dukej ëndërr Shqipëria në NATO, Shqipëria e integruar në Bashkimin Evropian e mbi të gjitha Kosova e Pavarur ndërsa sot ato janë realitet që na bëjnë krenar e njëkohësisht, gjenerues të shpresave të mëdha. Këto transformime janë të lidhura me historinë e Partisë Demokratike dhe liderit të saj Sali Berisha, themeluesve të tjerë të PD si Azem Hajdari, Arben Broci, Pjetër Arbnori, Gramoz Pashko, Aleksander Meksi e të tjerë, që përvijuan qartë e shpejtë një objektiv: Ti garantonin Atdheut rikthimin në botën perëndimore, në liri e demokraci. Kjo është një histori liberalizimi e bazuar tek vlerat e njeriut, tek demokracia, ekonomia e tregut dhe balancimin e pushteteve. Komunizmi klasik nuk mund ta ruante më vijimësinë por rebelimi i Marsit i vitit 1997, ishte tregues se e majta shqiptare nuk ishte reformuar dhe ajo mirëfilli mbante mbi vete të gjitha valencat e së kaluarës diktatoriale të cilat rrezikuan seriozisht sistemin demokratik dhe të ardhmen e vendit.

Kjo datë, 8 dhjetori-Dita e Rinisë, ka kushtëzuar të gjitha zhvillimet në vendin tonë si kryefjalë e lirisë duke u pasuar nga data të tjera të mëdha gjurmëlënëse për sot e për nesër si 12 dhjetori 1990, 20 shkurti 1991, 22 marsi 1992, 3 korrik 2005, 17 shkurt 2008 etj. Në këto tre vite, Qeveria Berisha si produkt i zgjedhjeve të lira të 3 korrikut ka projektuar një vizion të përcaktuar mirë për vlerat e njeriut, të politikës dhe ekonomisë e mbi të gjitha të dobisë kombëtare, dobisë për të gjithë, e reflektuar tek kjo Shqipëri që po ndryshon e që gjithnjë e më tepër po bëhet pjesë e familjes evropiane. Ky 8 dhjetor si kurrë më parë i gjen shqiptarët më të fortë si komb, me dy shtete të pavarura, të ravijëzuara qartë në rajon, nëpërmjet aortës së kombit, rrugës Durrës-Kukës-Prishtinë, të ideuar me largpamësi historike nga Ibrahim Rugova e Sali Berisha dhe të realizuara me konseguencë nga Sali Berisha. Sot, pas 18 vjetësh si asnjëherë më parë merr rëndësi kjo ditë për ti nxitur akoma më tej shqiptarët e në veçanti të rinjtë që të vazhdojnë në rrugën e demokracisë, mirëqenies, integrimeve të mëdha që Qeveria Berisha po realizon me sukses.

II. 31. "Ligji i spiunëve" i vonuar

Të ndërtohet memoriali i antikomunizmit në qendër të Tiranës

Prononcim dhënë për "Gazeta Shqiptare" 14 dhjetor 2008 (intervistoi Gilmana Bushati)

Bujar Leskaj, deputeti demokrat, shprehet se ligji për spiunët do të bëjë lustracionin e duhur në shoqërinë shqiptare, e cila nuk ka nevojë vetëm për hapje dosjesh, por edhe dekomunistizim të saj. Sipas tij, ky projektligj duhej të ishte miratuar gjashtë muaj apo një vit pasi PD-ja erdhi në pushtet, por gjithsesi mirë është që të miratohet sa më shpejt ai ligj. Më tej ai shton se largimi i disa figurave nga skena politike, publike dhe shoqërore, do të lehtësojë disi shpirtin, vuajtjen të atyre njerëzve që gjatë kohës së regjimit gjatë '45-'90 u është shkatërruar jeta, familja dhe karriera.

Zoti Leskaj të hënën pritet të kalojë për miratim ligji për hapjen e dosjeve. Çfarë mendoni se do të arrijë ky ligj?

Mendoj se jemi të vonuar me paraqitjen e këtij projektligji. Ky proces duhet të konsiderohet si pjesë e luftës që, jo vetëm maxhoranca, por krejt parlamenti dhe deputetët e tij duhet të bëjnë kundër korrupsionit publik, kundër korrupsionit politik. Fillesat e këtyre korrupsioneve gjenden në atë veprimtari të errët kriminale dhe antishqiptare të drejtuesve të lartë të PP-së, të ministrave të qeverive të saj, dhe të drejtuesve të lartë dhe të mesëm të organit famëkeq të Sigurimit të Shtetit.

Po të majtët, pavarësisht vullnetit të treguar, po e kundërshtojnë ligjin për hapjen e dosjeve?

Për ndonjë individë, parti apo segment shoqëror, që përpiqet që ta kanalizojë këtë si kërkesë folklorike do t'i kujtoja dy rezolutat e Asamblesë Parlamentare të KE-së miratuar në një periudhë kohore 1996-2006, në veçanti rezolutën 1488, miratuar në 2006, për

domosdoshmërinë e dënimit ndërkombëtar të regjimeve komuniste. Në funksion të kësaj dhe në vlerësim të vetvetes si legjislator, ne deputetët e Kuvendit, duhet të kujtojmë detyrimin që kemi nga rezoluta e aprovuar nga kjo trupë legjislative në nëntor 2006, për dënimin e krimeve të komunizmit, të Enver Hoxhës ku në një pikë të saj kërkohet : "Hapje e dosjeve për politikanët, drejtuesit e institucioneve të rëndësishme, përfshi edhe ato të organeve kushtetuese, të sistemit të drejtësisë si dhe të mediave kombëtare audio-vizive dhe atyre të shkruara."

Socialistët po akuzojnë demokratët se me këtë ligj ju doni të pastroni prokurorinë apo gjykata nga persona që po ndjekin hetime të rëndësishme, hetime që prekin zyrtarë të lartë të PD-së?

Kur është aprovuar rezoluta e KE-së, as nuk kanë ndodhur ngjarje si Gërdeci, as nuk është hedhur short me gogla apo pa gogla në Gjykatën e Lartë, por nga të gjithë ne, deputetë të djathtët dhe të majtë është thelbësore të kuptohet, që disa institucione të rëndësishme, sektorë të rëndësishëm të drejtësisë në vend, që kontrolloheshin dhe drejtoheshin nga nxënësit besnikë të Aranit Çelës, Rrapi Minos, apo Zylyftar Ramizit duhet të pastrohen. Ky proces do të forcojë, do të shëndoshë partitë tona politike, do të rregullojë dhe do të lartësojë moralin e institucioneve të larta të ushtrisë, të policisë, të gjyqësorit, duke bërë të mundur largimin në radhë të parë të ideatorëve, ekzekutorëve të politikave famëkeqe të ish-Sigurimit të Shtetit dhe Partisë së Punës nga institucionet publike si dhe mënjanimin e bashkëpunëtorëve të tyre nga administrata dhe institucionet legjislative dhe gjyqësore.

Zoti Leskaj mendoni se me miratimin e ligjit do të bëhet e mundur zbatimi i pikave të rezolutës së KE-së për dënimin e krimeve të komunizmit?

Shumë shpejt do të kërkoj në parlament se si është ecur me pikat e tjera të rezolutës së nëntorit 2006. Ne urgjentisht duhet **të ndërtojmë memorialin e qendrës antikomuniste në qendër të Tiranës**, të përfundojë procesi i nisur në 2006 për ngritjen e muzeut antikomunist në Shkodër, të fillojë puna dhe kampi i Spaçit të kthehet në muze, në respekt mes të tjerash edhe të kryengritjes 21-23 majit 1973, të bëhet plotësimi i teksteve të historisë me realitetin e qëndresës antikomuniste të prodhuar në vitet 1945-1990, përmendorja e Azem Hajdarit, e cila ka tre vjet që është prodhuar të vendoset aty ku e meriton, të prodhohet dhe të vendoset përmendorja e Arben Brocit në qytetin Studenti dhe shumë e shumë kërkesa të tjera.

II.32. Deputetët: Të shkarkohet Bollano

Nacionalizmi - streha e fundit e maskarenjve

Marrë me shkurtime nga Gazeta Panorama, dt. 19/12/2008 (nga Bledar Hoti)

Deputetët e Kuvendit kërkojnë që qeveria dhe Presidenti të shkarkojnë kryebashkiakun e Himarës, Vasil Bollano, përndryshe do të nisin vetë protestat. Thirrja e Bollanos në adresë të Greqisë për mos ratifikimin e MSA-së për Shqipërinë ngjalli reagime të ashpra nga parlamentarët shqiptarë dhe ka krijuar një lob deputetësh për shkarkimin e tij. Të djathtë dhe të majtë u bashkuan për të kundërshtuar me forcë deklaratën e Bollanos për t'i kërkuar Greqisë mos ratifikimin e MSA-së me Shqipërinë. Në seancën parlamentare kanë reaguar dy deputetët, Nikollaq Neranxi i LSI-së dhe Frrok Gjini i PDK-së. Ndërsa reagimet jashtë Kuvendit mbërritën dhe nga deputetët e dy forcave të mëdha politike. Deputetët, përfshirë dhe deputetin Spartak Ngjela kërkuan ndjekjen penale të Bollanos, pasi ai ka shkelur Kushtetutën. Ndërsa deputeti i PD-së, Bujar Leskaj tha se, "shprehja klasike: 'nacionalizimi është streha e fundit e maskarenjve', mendoj se në rastin më të mirë i takon Bollanos dhe pasuesve të tij. Për mendimin tim personal është një mbeturinë, rudiment i së kaluarës, i qarqeve nacionaliste ekstremiste greke që nuk gjen terren në Shqipëri, në këtë klimë mjaft të mirë marrëdhëniesh miqësore. Mendoj që të gjithë duhet ta demaskojmë, por natyrisht ne politikanët duhet të bëjmë edhe më shumë", theksoi Leskaj i PD-së. Ndërsa deputeti i LSI-së, Pëllumbi Xhufi deklaroi se, "Bollano në mënyrë të përsëritur shkel Kushtetutën e Shqipërisë, shkel parimet bazë të Shqipërisë si një shtet unitar dhe ka bërë thirrje të hapur për copëtimin e Shqipërisë dhe në të njëjtën kohë i ka hedhur benzinë zjarrit dhe nxit urrejtjen kombëtare. Të gjitha këto janë nene dhe përbëjnë vepra penale të parashikuara në Kushtetutën e Shqipërisë".

II.33. Abstenim mbi një marrëveshje

23 janar 2009, Gazeta Shqiptare (nga G. Bushati)

Bujar Leskaj, deputeti demokrat I Vlorës abstenoi dje marrëveshjen e nënshkruar mes komunitetit ortodoks dhe qeverisë shqiptare. Këtë vote ai e dha dje gjatë séances parlamentare ku u miratuan me shumicë votash, përfshi këtu edhe të maxhorancës dhe opozitës, marrëveshjet për tre komunitetet fetare. Ai e shpjegon këtë abstenim me faktin se në nenin 11 të marrëveshjes mes qeverisë dhe ortodoksëve "legjitimohet Janullatosi si kryetar i këtij komuniteti". Jo vetëm që legjitimohet Janullatos, por edhe fakti që ai nuk është me origjinë shqiptare ashtu siç e kërkon statusi i besimit ortodoks. Leskaj abstenoi dje duke deklaruar njëherësh respektin më të madh të tij për besimtarët ortodoksë.

Leskaj iu drejtua deputetëve të parlamentit se "kur këto marrëveshje diskutoheshin në parlamentin shqiptar në 1923 dhe të 1929 deputetët patën bërë një debat të hapur dhe me argumente, ndërsa sot këto marrëveshje kaluan pa debat.". Ai u kujtoi socialistëve që gjatë tetë viteve në pushtet ata kishin arritur të miratonin vetëm një marrëveshje, atë me katolikët në 2002, ndërsa maxhoranca aktuale po realizon të tria njëherësh, edhe pse me vonesë. Deputeti thekson se këto marrëveshje, që janë detyrim kushtetues, duhej të ishin miratuar në 2007. Leskaj gjithashtu thekson se fillimisht duhej të ishin miratuar ligji për fenë dhe më pas marrëveshjet, por shton se gjithësesi që të dyja janë të përcaktuara qartë në Kushtetutën e Shqipërisë.

II. 34. Si do të zhvillohet ekonomia shqiptare gjatë 2009-ës

Intervistë datë 2 Shkurt 2009 dhënë për gazetën Telegraf (intervistoi Lediana NUSHI)

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim para pak ditësh ka bërë publik raport Tranzicionin e vitit 2008 për vendet ku kjo bankë vepron,duke bërë edhe një parashikim për vitin 2009. Sipas BERZH-it ekonomitë e vendeve ku ajo vepron do të ngadalësohen ndjeshëm në 2009, por gjithashtu ajo ka parashikuar edhe një rritje ekonomike prej 4% në Shqipëri këtë vit. Lidhur me këto raportime, por edhe me probleme të tjera ekonomike që do të shoqërojnë vendin tonë këtë vit është shprehur në një intervistë për "Telegraf ", ish- ministri i Turizmit dhe njëkohësisht anëtar i Komisionit të Ekonomisë, Bujar LESKAJ.

BERZH-i ka nxjerrë disa ditë me parë një publikim, ku thotë se ekonomitë e vendeve ku kjo bankë vepron, sidomos vendet në zhvillim do të ngadalësohen ndjeshëm si pasojë e krizës ekonomike botërore. Një koment tuajin për këtë, duke pasur parasysh që Shqipëria është një prej vendeve në zhvillim ku kjo bankë vepron?

B.L. Me sa jam i informuar paralajmërimi për ngadalësimin e ekonomisë botërore është dhënë nga të gjitha institucionet financiare ndërkombëtare. Në të vërtetë ngadalësimi i ekonomisë globale tashmë është realitet, pasi në vendet perëndimore ngadalësimi i dha shenjat e veta që në muajt e fundit të vitit të kaluar ku ekonomia evropiane dhe ajo amerikane shënuan recesion dhe ku ekonomitë e disa vendeve të tjera të mëdha, siç është Kina, shënuan rënie në ritmin e rritjes ekonomike.

Sa i përket ekonomisë shqiptare e kam shprehur dhe më parë faktin që ne nuk jemi të imunizuar nga kjo krizë. Për fatin tonë të mirë deri më tani kriza akoma nuk ka dhënë shenja të dukshme mbi ritmin e rritjes ekonomike. Ndikimi i saj direkt është ndjerë në një krizë të lehtë likuiditeti të sistemit bankar në muajt e fundit të vitit

2008. Por besoj se tashmë kjo krizë pothuajse është kaluar dhe ulja e fundit e normës bazë të interesit në 5.75% është një zhvillim pozitiv që i vjen në ndihmë rritjes së likuiditetit të sistemit bankar.

Ajo që më bën optimist në këtë situatë është besimi se, krahasuar me vendet evropiane, Shqipëria do vazhdojë të jetë pak e ndikuar nga kjo krizë. Ashtu siç dhe kanë paralajmëruar institucione vendase dhe të huaja, impaktin direkt kjo krizë ekonomike që tashmë ka prekur shumicën e vendeve evropiane, ku jetojnë dhe punojnë pjesa më e madhe e emigrantëve shqiptare, ka për ta dhënë në një rënie të remitancave që hyjnë në Shqipëri. Me rreth 950 milion euro në vit emigrantët japin një kontribut të rëndësishëm për ekonominë e vendit, për financimin e importeve, stabilitetin financiar dhe sidomos stabilitetin e monedhës kombëtare. Deri më tani, edhe pse emigrimi drejt vendeve evropiane ka nisur që prej 17 vitesh, është e kënaqshme ritmi i lartë i remitancave. Pritjet për një rënie të këtyre remitancave gjatë vitit në vazhdim kanë për të pasur ndikimin e tyre mbi ekonomi. Se sa do të jetë ky ndikim kjo është në varësi të nivelit të rënies së dërgesave dhe të mundësive alternative që do të na paraqiten për zëvendësimin e tyre. Gjithashtu kriza mund të prekë Shqipërinë nëpërmjet rënies në vlerë të turizmit. Në lidhje me këtë sektor ndoshta është momenti që Shqipëria të parapërgatitet për një krizë të tregut për shkak se ulja e të ardhurave nga turizmi ka për të prekur gjithë rajonin pasojë e së cilës ndoshta mund të jetë një treg më agresiv, një treg më i ngushtuar, në të cilin Shqipëria do duhet të gjej rrugën për të ruajtur, apo dhe për të shtuar të ardhurat që vijnë nga ky sektor. Dhe një element të tretë që do veçoja si faktor që mund të sjellë pasojat e krizës globale në Shqipëri, janë investimet e huaja direkte. Ulja e këtyre investimeve do të jepte pasojat në projektet që do të realizohen gjatë vitit 2009 duke ndikuar në volumin ekonomik që pritet të realizohet gjatë këtij viti. Gjithashtu tkurrja e investimeve të huaja do të ishte një faktor më shumë që do të pakësonte fluksin e valutës së huaj që do hynte në vend, e cila bashkuar me rënien e remitancave, do të ndikonte në stabilitetin financiar dhe në një dobësim të monedhës kombëtare. Gjithsesi shpresa dhe besimi im është që brenda fundit të këtij viti Evropa dhe Amerika ta kenë kaluar këtë krizë ekonomike dhe Shqipëria do të arrijë të ruaj ritme të kënaqshme të rritjes ekonomike.

Po sipas këtij publikimi Shqipëria do të ketë një rritje ekonomike prej 4 % në 2009. A mendoni se do të jetë e mundur një rritje e tillë duke marrë parasysh edhe faktin që bota është e përfshirë nga kriza ekonomike?

B.L. Sipas të dhënave që kam rritja pritet të jetë të paktën 4% ose dhe me e lartë. Nuk është çudi që ne të kemi një rritje ekonomike ndërkohë që bota perëndimore po njeh recesion. Shqipëria arriti të realizonte një rritje të kënaqshme ekonomike gjatë vitit 2008 edhe pse ekonomia e Eurozonës njohu recesion për herë të parë gjatë ekzistencës së saj si komunitet. Për më tepër ne jemi vend në zhvillim, ekonomia nuk është e ngopur dhe gjithnjë ka hapësira për investime të reja qofshin vendase apo dhe të huaja, të cilat ndikojnë direkt në rritjen ekonomike.

Duhet të kemi parasysh dhe faktin që ky vit përkon me inaugurimin e disa investimeve të rëndësishme për ekonominë e vendit. Përfundimi i disa investimeve infrastrukturore gjatë viteve të fundit dhe inaugurimi i disa investimeve që do përfundojnë këtë vit, sidomos përfundimi i rrugës Durrës-Kukës, kanë për të dhënë impaktin e tyre pozitiv drejtpërsëdrejti dhe shumë shpejt mbi ekonominë.

Sipas jush nëse ulen financimet e jashtme, a do të ndikojnë këto në zvogëlimin e krizës ekonomike ne Shqipëri?

B.L. Financimet e jashtme kanë dhënë një shtysë dhe kontribut të rëndësishëm gjatë viteve të tranzicionit. Financimi nën kujdesin e institucioneve mbikëqyrëse siç ishte FMN ka qenë një faktor i rëndësishëm për rritjen dhe stabilitetin e ekonomisë shqiptare. Ulja e financimeve nga jashtë në formën e huas, ka qenë një politikë e filluar vite më parë ku dhe është synuar kufizimi i borxhit publik, sidomos atij të jashtëm. Rënien e mundshme të tyre gjatë viti 2009 si pasojë e krizës nuk e shoh si faktor me ndikim të ndjeshëm në ekonominë e vendit. Tashmë Shqipëria ka nënshkruar një pjesë të marrëveshjeve të investimit për parqe energjetike me disa investitorë të huaj të cilët përveç përvojës do të gjejnë vetë burimet e financimit për realizimin e projekteve. Investimet publike në projekte të rëndësishme sidomos në infrastrukturë kanë qenë të larta gjatë viteve të fundit duke kompletuar vit pas viti mozaikun çka do të thotë që nevoja për financime të huaja për projektet e ardhshme ka për të ardhur në rënie. Përveç kësaj duhet të kemi parasysh se rënia e informalitetit ka rritur të ardhurat buxhetore duke e bërë atë një burim të ndjeshëm në financimin e projekteve të rëndësishme që ka realizuar vendi. Roli i të ardhurave buxhetore në financimin e projekteve të ardhshme besoj se ka për të ardhur në rritje.

II. 35. Republika e Kosovës - Burim stabiliteti rajonal dhe krenarie kombëtare*)

Shkrim, Gazeta 55, 18.02.2009
Nga Bujar Leskaj

17 shkurti 2008, Dita e madhe e Pavarësisë së Kosovës është skalitur tashmë së bashku me 28 Nëntorin 1912, si dy ditët dhe datat historike më të shënuara në historinë e kombit shqiptar dhe të dy shteteve të pavarura, Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë. Kjo ditë përpos të tjerash është një moment kremtimi dhe vlerësimi përgjatë një viti ekzistence të shtetit më të ri të Evropës, Republikës së Kosovës, e cila tashmë ka konfirmuar politikisht dhe diplomatikisht atë çka udhëheqësit e popullit shqiptar në Kosovë, të zgjedhur në mënyrë demokratike miratuan në Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës më 17 Shkurt 2008, "Kosovën Republikë Demokratike, laike dhe multi etnike, të udhëhequr nga parimet e jo diskriminimit dhe mbrojtjes së barabartë sipas ligjit (pika 2 e Deklaratës) e mbi të gjitha stabilitetin, koherencën dhe integritetin për Kosovën shtet të pavarur dhe sovran" (pika 1 e Deklaratës). Udhëheqja e shtetit të Kosovës, Kuvendi, Qeveria, Presidenti dhe Partitë politike së bashku me qytetarët e Kosovës ia dolën mbanë të konsolidojnë "një Kosovë-shtet të qytetarëve, një Kosovë-të zhvilluar në përputhje me parimet demokratike, një Kosovë-me një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, një Kosovë-shtet i sundimit të ligjit, një Kosovë-të një shoqërie shumë etnike dhe së fundi një Kosovë-të përkushtuar qartë në drejtim të proceseve për integrime evropiane, euro-atlantike dhe mekanizmave të tjera ndërkombëtarë, nëpërmjet përmbushjes së kushteve dhe standardeve më të larta të përgjegjësisë dhe transparencës ("Raporti Vjetor i punës së Qeverisë Thaçi, Prishtinë dhjetor 2008-Përmbledhje ekzekutive).

*) Shkrimi është pjesë e diskutimit që u mbajt nga autori në sesionin shkencor: "Kosova, shteti i pavarur". (Shih f. 377).

Më 15 Qershor 2008 hyri në fuqi Kushtetuta e Republikës së Kosovës e cila në nenin 1 të saj thekson se: Republika e Kosovës është shtet i pavarur, sovran, demokratik, unik dhe i pandashëm. Republika e Kosovës është shtet i shtetasve të vet. Republika e Kosovës nuk ka pretendime territoriale ndaj asnjë shteti ose pjese të ndonjë shteti dhe nuk do të kërkojë të bashkohet me asnjë shtet ose pjesë të ndonjë shteti.

Përgjatë gjithë kësaj periudhe të gjitha proceset dhe zhvillimet politike e shoqërore në Kosovë, për të dhe në raport me vendet e rajonit dhe më gjerë janë bazuar në parimet dhe dispozitat e kësaj Kushtetute, si dokument themeltar i shtetit duke garantuar njëherazi sovranitetin territorial dhe barazinë para ligjit të të gjithë qytetarëve. Viti i parë i Pavarësisë së Kosovës e gjen atë të njohur nga 54 shtete, duke filluar nga SHBA, vendet kryesore të BE-së (shtatë anëtarë të G-8 dhe 80% e BE-së), Turqia, Japonia etj si dhe vendet fqinje Shqipëri, Maqedoni, Mal I Zi. Në Deklaratën e Pavarësisë (pika 6), theksohet qartazi kërkesa e ambicia e politikës kosovare për ta anëtarësuar vendin në Bashkimin Evropian sapo që të jetë e mundur dhe për të zbatuar reformat e kërkuara për integrim evropian dhe euroatlantik. Si rezultat i punës së qeverisë, BE-ja konfirmon hapin e parë të Kosovës drejt saj, studimin e fizibilitetit, i cili pritet të përfundojë në vjeshtë 2009. Konfirmuar në pikën 5 të Deklaratës së Pavarësisë, drejtuesit e politikës kosovare po punojnë që siç deklarojnë ata "ftojmë dhe mirëpresim NATO-n që të mbajë rolin udhëheqës në praninë ndërkombëtare ushtarake dhe të zbatojë përgjegjësitë që i janë dhënë sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (1999) dhe Planit të Ahtisarit". Forcat e Sigurisë se Kosovës punojnë sipas standardeve e parametrave të NATO-s të vijuara në kohë dhe nga krijimi i Agjencisë së Inteligjencës së Kosovës dhe Këshilli Kombëtar i Sigurisë. Përmes intensifikimit të investimeve, ristrukturimit të ndërmarrjeve ata "ftojmë dhe mirëpresim NATO-n që të mbajë rolin udhëheqës në praninë ndërkombëtare ushtarake dhe të zbatojë përgjegjësitë që i janë dhënë sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (1999) dhe Planit të Ahtisarit". Forcat e Sigurisë se Kosovës punojnë sipas standardeve e parametrave të NATO-s të vijuara në kohë dhe nga krijimi i Agjencisë së Inteligjencës së Kosovës dhe Këshilli Kombëtar i Sigurisë. Përmes intesifikimit të investimeve, ristrukturimit të ndërmarrjeve publike, privatizimit dhe shtimit të aftësisë konkurruese po vazhdon të jetë në prioritet parësore të Qeverisë së Kosovës, intensifikimi i zhvillimit ekonomik. Qeveria po aplikon politika që synojnë rritjen ekonomike, uljen

e shkallës së papunësisë, përmirësimin e kushteve sociale dhe zvogëlimin e varfërisë. (kjo konfirmohet dhe në raportin vjetor të Punës së Qeverisë). Prioriteti i Qeverisë është sundimi i ligjit dhe në veçanti përmirësimi i efikasitetit të sistemit gjyqësor, luftimi kundër dukurive negative: korrupsioni, krimit të organizuar dhe të ekonomisë joformale në tërësi. Rritja ekonomike në vitin 2008 ishte 5.2% dhe për vitin 2009 parashikohet 6.6% dhe një rritje e P.B.B për frymë nga 1150 euro në 2007 në 1616 euro për vitin 2009. Buxheti i vitit 2009 do t'i japë zhvillim e përmirësim të mëtejshëm jetës së vendit dhe ekonomisë, jo vetëm në infrastrukturë (rrugë, ujësjellës etj) por edhe në zhvillimin e sistemit financiar, privatizimin në sektorët strategjikë, zgjerimin e biznesit privat (nga 72 mijë biznese në 2007, në 87 mijë në 2008) etj. Buxheti i Kosovës sivjet është 15% më i lartë se ai i vitit të kaluar (nga 1.09 miliard euro në 2008 në 1.5 miliard euro në 2009). Në kuadër të detyrimeve kushtetuese , një vëmendje e veçantë i është kushtuar këtë vit në Kosovë decentralizimit, fushës së sigurisë, krijimit të institucioneve të reja dhe minoriteteve. Dita e pavarësisë së Kosovës, e kremtuar në ditëlindjen e parë të saj, e cila do të jetë e jetëgjatësuar në pafundësi është njëherazi ditë e tolerancës, ditë e stabilitetit, ditë e unitetit politik dhe qytetar dhe ditë e vlerave më të larta demokratike jo vetëm për ata drejtues të lartë të Kosovës që e kanë përkufizuar , por për të gjithë Ne, Shqiptarët, andej dhe këtej kufirit imagjinar Shqipëri-Kosovë.

II.36. Ligji i ekspertëve kontabël

Shkrim i datës 06/03/2009, Gazeta Panorama

Ligji i kontabilistëve përplas deputetët e maxhorancës, duke sjellë një përplasje ndërmjet deputetit Bujar Leksaj dhe Ministrit të Financave, Ridvan Bode në Parlament. Projektligji "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël, të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" shkakton debate ndërmjet pozitës dhe opozitës në Kuvend. Gjithashtu drafti shkaktoi debate dhe brenda përfaqësuesve të maxhorancës. Demokrati Bujar Leskaj ka paraqitur disa amendamente për këtë projektligj, por që nuk janë marrë në konsideratë nga ana e maxhorancës. Amendamenti i Leskajt u mbështet edhe nga ish-ministri i Financave, Arben Malaj. Amendamentet synojnë në mos caktimin e një moshe për kontabilistët, si dhe në njohjen e masterave të kryera jashtë vendit. Këto amendamente u rrëzuan nga Ministri i Financave, Ridvan Bode, i cili i cilësoi si në kundërshtim me direktivën e BE-së. "Ajo që propozoni ju është në kundërshtim me direktivën e BE-së. Është mirë të merret në konsideratë kërkesa e BE-së. Projektligji është konsultuar me grupet e interesit dhe ato janë shoqatat që janë të licencuara", deklaroi Bode. Ndërsa kreu i Komisionit të Ekonomisë, Edmond Spaho, në lidhje me amendamentin e propozuar për diplomat e shkollave, master për ekspertët kontabël u shpreh se "është Ministria e Arsimit që bën certifikimin e diplomës dhe jo organizmat e tjera". "Ne madje kemi punuar me zyrën e Kuvendit për përafrimin e legjislacionit sipas BE-së për këtë projektligj. Nga 24 propozime, kemi pranuar 21 për ndryshim nenesh, duke i pasqyruar", deklaroi demokrati Spaho. Deputeti Leskaj, në lidhje me këto çështje u shpreh se: "Ministri Bode më ka keqkuptuar, pasi jam shprehur se certifikimin do ta bëjnë vetë këto shoqata që kanë të drejtën t'i japin licencën e ekspertit kontabilist. Ndërsa për sa i përket moshës së ekspertit kontabilist, mendoj se është vetë konkurrenca që i vendos ato, nëse do qëndrojnë ose jo. Mosha mesatare në Shqipëri është rritur, pastaj ke nga ato që janë 65

vjeç dhe janë të aftë për punë, ndërsa ke nga ata 55 vjeçar që janë profesor budallenj "mbërtheckash", - theksoi Leskaj. Por Ministri i Financave theksoi se janë shoqatat e kontabilistëve që kërkuan caktimin e moshës. Deputeti socialist Arben Malaj deklaroi se "një p/ligji i tillë po votohet pa u certifikuar nga Ministria e Integrimit, si dhe nuk kanë marrë miratimin nga Banka Botërore. Duhet ta dini se certifikimi nga ministria është i detyrueshëm". Në këtë debat ka ndërhyrë edhe kryekomisioneri i Ligjeve, Ilir Rusmali, duke bërë të qartë se "mosha është vendosur edhe për noterët dhe se një rregull i tillë duhet të zbatohet për të gjithë". Amendamentet e paraqitura u hodhën poshtë nga maxhoranca. Në tërësi projektligji u miratua me 59 vota pro, 29 kundër dhe 13 abstenim. Demokrati Leskaj abstenoj në votimin për këtë projektligj.

Intermexo II

Mirushi dhe Muhameti i tij

Shkrim nga Bujar LESKAJ, botuar në Gazeta Shqiptare
Tiranë më 14 Shkurt 2009

Me një ftesë në dorë, i ftuar nga miku im Mirush u nisa të shoh monodramën "Zoti Ibrahim dhe lulet e Kuranit". I përgatitur për sa do shohësh, me dy qëllimet që autori i thotë në sentencën e vetë të shkruar në ftesë (vendosa të vërtetoj diçka, por dhe të provokoj), me faktin që është një monodramë e interpretuar nga interpretuesi i Sokratit si dhe me koshiencën e të qenurit një apasionues i teatrit dhe jo kritik i tij, zura vendin tim mes shumë spektatorësh të tjerë me deshirën e thjeshtë të shoh një shfaqje, pa marrë përsipër të bëhem vlerësues i saj…Por ajo që pashë, ajo që ndjeva në fund të saj, fakti që dhe sot nuk e di sa zgjati si shfaqje, përveç ndjesisë që përfundoi sapo kish filluar, si dhe emocioneve të tjera, më detyroi të shkruaj këto dy rreshta si një spektator i thjeshtë që e do teatrin pa qenë i detyruar të jap shpjegime për ato që ndjen dhe mendon apo për nxitjen për të shprehur këto ndjesi. Nuk do të doja të analizoj veprën dramatike, pasi ajo i ka dhënë provat e saj, siç i dha dhe njëherë me këtë shfaqje, apo për dy qëllimet e mësipërme të autorit, që tek ne si spektatorë erdhën të qarta dhe evidente, por unë do të ndalesha në prurjen artistike të kësaj monodrame nga mjeshtri tashmë i monodramës të shprehur në shqip, mjeshtri i madh i skenës Mirush Kabashi. E them këtë se vlerat e veprës, idetë, mendimet, sentencat e bukura dhe të mençura. Erdhën tek ne nëpërmjet tij, thjeshtësisë së të shprehurit, mënyrës së komunikimit, syve që shkëlqenin, fizionomisë së fytyrës, duarve që të drejtoheshin drejt teje sikur të ftonin ti takoje…Dikush, duke u nisur nga fjalia e parë e këtij shkrimi (i ftuar nga miku im Mirush) do ti kuptoj këto fjalë të sipërthëna, apo ato që do them me vonë, si detyrim i kësaj miq sie. Jo,sinqerisht jo! Si mik, po të mos kisha këto ndjesi që kam, do ta kisha takuar në një kafene, siç bëhet shpesh në ambjentet e teatrit,

do ta uroja natyrisht për punën e bërë, por nuk do të merrja përsipër të shprehja publikisht ndjesitë e mia. Me medimin tim modest unë e ndjej se pas Sokratit dhe suksesit të saj, unë shoh dhe ndjej një Muhamet të tijin, që do të zërë një vend të rëndësishëm në atë larmi rolesh të luajtur nga ai, një Muhamet (apo Moisi) që pas shumë skenave të ndryshme të botës vjen dhe flet shqip tani në skenën tonë dhe pse jo më vonë dhe në skenat e tjera, duke i dhënë kësaj vepre një Moisi (apo Muhamet) tonin, të veçantë e të papërsëritshëm. E them këtë se në dramaturgji, ndryshe nga gjinitë e tjera, ka një lidhje të padiskutueshme dramë-regji-aktor. Shpesh në diskutimet tona me një konformizëm të dukshëm diskutojmë njërin ose tjetrin kulm të këtij trekëndëshi, duke harruar që një trekëndësh quhet i tille pikërisht se i ka të lidhur të tre këndet e tij me vija të drejta, jo me zikzake apo të lakuara, si psh flasim me një autor, i mburrim dramën duke i justifikuar mossuksesin me lojën e dobët të aktorëve, apo regjinë diletante të saj…e ne te njëjtën kohë kur takojmë aktorët i ngremë lartë lojën e tyre dinjitoze, pavarësisht të dramës së dobët me të cilën kishin të bënin, e kështu me rradhë. Në rastin konkret një dramë e suksesehme në shumë vende të tjera sot e shohim me aktorin Mirush, me regjinë e tij dhe nëqoftëse, për mendimin tim ajo ishte me të vërtetë shumë e suksesehme, kjo është pikerisht merita e tij si aktor dhe regjisor i saj, pa harruar dhe rolin në këtë rast të udhëheqësit artistik Bualjoti. Duke qenë koshient se kjo që po bëj nuk është një analizë profesionale e shfaqjes, gjë që i takon kritikës ta bëj, po mundohem të hedh disa nga ndjesitë e mia personale të drejtepërdrejta nga karrigia 14 e rradhës 7 ku isha ulur. Ndryshe nga një gong i fuqishëm, muzikës impresionuese, apo siparit që ngrihet gjithë peshë, Ai (Mirushi pra) hyri thjeshtë, tepër thjeshtë me një mirëmbrëma dhe mirësekeniardhur ashtu si dhe iku me një natën e mirë plot mirësi dhe dashuri për ata që kishin patur durimin të dëgjonin historinë e tij të thjeshtë…historinë e tij të zakonshme… historinë e tij njerëzore (fjalët e tij). Në këtë këndvështrim e gjithë shfaqja ishte si një bashkëbisedim i aktorit Mirush me spekatorin e tij, një bisedë kokë më kokë, e thjeshtë, pa deklamacione, gjë që bëri që dashur pa dashur dhe ne ta ndjenim vehten atje, bashkë me të, të lidhur me historinë e tij, a thua se një miku jonë po na tregonte historinë e tij dhe pas kësaj priste të dëgjonte tonën. Ishte pikërisht ky trajtim njerëzor dhe tepër komunikues, që mjeshtri i madh i skenës lidhi që në fillim me spektatorin duke e mbajtur për aq sa zgjati shfaqa të lidhur pas tij, duke bërë që pikërisht, gjithmonë sipas mendimit tim, të jetë kyçi i suksesit të arritur. Dhe kështu njerëzor

dhe i drejtpërdrejtë ai shfaq historinë e tij duke të parë drejt në sy, a thua se kërkon pohimin tënd dhe mjeshtërisht pa dijeninë tënde të ka tërhequr në historinë e tij jo thjesht si vëzhgues apo dëshmitarë, por si bashkëbisedues. Me një vërtetësi që nuk të lë të dyshosh për të kundërtën ai të prezantohet me emrin Muhamet, por që e ka të ndryshuar nga Moisi, i cili është emri i tij fëmijërisë dhe motivin madhor për të cilin mund të ndryshohet një emër. Dhe pikërisht këtu spektatori ynë që ka të njohura shumë ndërrim emrash të bashkëatdhetarëeve tanë të shpërndarë nëpër botë për motive të egzistencës të disave, por pse jo dhe për motive te dobëta të disa të tjerëve, dëgjon të qartë dhe pa ekuivoke shkakun e ndryshimit te emrit. Jeta dhe njerëzit ma imponuan këtë ndryshim, thotë Mirushi Moisi i kthyer ne Muhamet. është pikërish ky leitmotivi që aktori mjeshtër me thjeshtësinë e të treguarit të bën ta ndjekësh deri në fund. Pikërisht për mua këtu qëndron mjeshtëria e mjeshtrit, që që në fillim të paralajmëron që nuk janë motivet fetare të këtij ndryshimi dhe duke kërkuar dhe mendimin tënd, hap pas hapi, me historinë e tij të bind për atë pohim të bërë në fillim. Dhe kjo bindje vjen jo vetem nga teksti, por dhe nga mënyra që aktori e sjell atë në skenë…Metamorfozën e këtij ndryshimi ai e sjell me mjeshtëri, jo për të të bindur dhunshëm për ato që do të thotë, por thjesht per ti shpjeguar ashtu si janë dhe ti vetë të gjykosh për drejtësinë e saj… Një Moisi që paguan me 200 frangat e kursyera, por të ndaluara nga babai ti shpenzonte, bërjen burrë…një Moisi që nuk dinte të qeshte, që fliste vrazhdë dhe pa mirësi, një Moisi i mohuar nga dashuria e të jemës dhe i braktisur nga afiniteti me të jatin, që vidhte konservat e zotit Ibrahim, sepse duhet të vidhte diçka…e shohim në mënyrë krejt të natyrshme të shndërrohet në një Momo që arrin të vëzhgoj dhe të vlerësoj jetën përreth…deri sa arrin në një Muhamet që provon për herë të parë ndjenjën e të qënit bir të atij që e kishte zgjedhur për të qenë baba, një Muhamet, që me thjeshtësi lejon fëmijët e tij të therrasin gjyshe nënën e tij, pra një Muhamet tjetër, njerëzor, të dashur dhe që ashtu si babai që e birësoi z. Ibrahim di të jap dashuri, di të fal dashurinë e të jatit të vet…Ne të gjithë këtë apologji njerëzore, të shndërrimit Mirush-Moisi-Momo-Muhamet dhe përsëri Mirush e shohim të na vijë në skenë me mjeshterinë e mjeshtrit që zgjedh tregimin e thjeshtë e pa figuracione të një copëz jete njerëzore dhe kjo arrin kaq natyrshëm sa do të ishte krejt normale që pa ekuivoke dhe me të njejtën mënyrë tregimi të jepet nesër një tjetër shfaqje, ku të shohim që një Muhamet, kthehet në Moisi dhe pse jo në një Sokrat. Është pikërisht kjo qëë një vepër dramatike kthehet universale, shumëkombëshe, ndëretnike e ndërfetare.

Dhe pikërisht këtë vërtetësi Mirushi Sokrat, Moisi e Muhamet, duke shfytëzuar me inteligjencë tekstin e shkëlqyer të autorit e jep me atë që për mua përbën çelsin e gjithë shfaqjes. Buzëqeshja…Ai që nuk dinte të buzëqeshte, sepse jeta e kish ndrydhur në këtë mundësi, fillon të buzëqeshë, në fillim për përfitime të vogla…e deri tek buzëqeshja aq e dhimbëshme para Ibrahimit që po jepte shpirt… Dhe si në një bisedë të bërë këmbëkryq para oxhakut, miqësisht dhe tepër njerëzisht, Mirushi me mjeshtërinë e tij tashmë të provuar, të duket sikur të falë dhe ty, bashkëbiseduesit një buzëqeshje, nga e cila buron mirësia dhe dashuria. Në këtë rast duket se i jepet dhe një përgjigjë motivit madhor për të cilin mund të ndryshohet një emër (që ai e shtron që në fillim të shfaqjes). Njerëzit, jeta e ndryshuan atë në një tjetër njeri: Ashtu si rëra e klesidrës, kur rrotullohet përmbys ka tendencën të mbush zbraztësinë që gjen poshtë saj, kështu dhe jeta e Moisut të zbrazur nga dashuria, mirësjellja, buzëqeshja…mbushet me dashurinë, miresinë, buzëqeshjen e njeriut që e bëri bir, që quhet Ibrahim, për vetë tendencën e provokimit që autori i ka vënë synim drameë, por qeë nga mënyra si na e jep atë në skenë Mirushi mund të quhej dhe Sokrat dhe Moisi, mjafton që në qendër të këtij shndrimi na jepet dashuria njerëzore, thjeshtësia e interpretimit, mënyra e komunikimit nëpërmjet fjalës, syve, buzëqeshjes, fizionomisë që të fton për te pirë një kafë në një bashkebisedim familjar. Një element që më la mbresa nga interpretimi i Mirushit ishte dhe shumëllojshmëria me të cilën ai na u paraqit në skenë. Duke qenë monodramë, që nga mënyra si është shkruar të ngjan më shumë dhe si një tregim, ndoshta jo dhe për teater, ai me shumë mjeshtëri zgjedh ndërthurjen e tregimit të thjeshtë dhe pa shumë figuracione artistike, me dramën qe luhet në skenë me personazhe të ndryshme. Në shohim të luhen 4 personazhe të ndryshme nga i njejti aktor: Moisiu, i jati, Muhameti dhe Ibrahimi (Pa llogaritur këtu prostitutat, mamanë apo policin) dhe pikërisht këtu qëndron dhe forca, mjeshtëria, talenti i interperetuesit. Mënyra si flasin, lëvizjet, mimika të japin katër Mirush në skenë, që përveç se të shfaqen krejtësisht të kundërt në karakter por dhe fizikisht, pavaresisht se është i njëjti Mirush që njohim, të duken të ndryshëm, njëri i gjatë me trup të drejtë (I jati Moisiut),i vrazhdë, i prerë, pa buzëqeshje në fytyrë, tjetri i krrusur, i shkurtër, që flet ngadalë , me një fytyrë që i buron vetëm mirësi dhe buzëqeshje. Pa thënë pastaj për vetë Moisun dhe Muhametin. I njejti personazh, i njëjti aktor dhe ty të vinë të qartë, të dallueshëm dhe tepër të individualizuar një Moisi dhe një Muhamet. E them këtë se në një dramë me shumë personazhe, edhe ndonjë dobësi të individualizmit aktoresk, ty si spektator të bëhet

evident personazhi që të shfaqet nëpërmjet aktorëve te ndryshem fizikisht dhe të ndryshëm në karakter..Në rastin që po diskutojmë është forca e aktorit dhe vetëm ajo që të bën ndjekjen e shfaqjes me deshirë, pa mërzitje, me ankthin e asaj që pret të ndodhë, me daljen nga salla me mendimin e plotë se ke parë një shfaqje të bukur, se ke mbetur i emocionuar nga mesazhet e saj, por akoma më shumë nga mjeshteria e interpretimit të mjeshtrit të madh te skenës Mirush Kabash. Unë kam bindjen se në gjeografinë dhe historinë e shfaqjeve të ndryshme të kësaj drame në vende të ndryshme të botës, siç na prezantohet në ftesë, deri në një film të prezantuar me sukses nga Omar Sherif, Muhameti i Mirush Kabashit do të jetë një risi në realizimin e kësaj figure dhe një prurje e sukseseshme që do ta nderonte dhe mëe tej autorin dhe veprën e tij. Dikush mund të më thote. Ndonjë vërejteje nuk pate? Të them të drejtën edhe mundet, sepse do të ishte absurde të mendoje se në një realizim artistik janë te gjitha konform shijeve te tua…Por unë në këtë rast shpreha emocionet e mia të sapo dala nga spektakli, për ndonjë ërejtje do ta mendoj më mirë dhe do t'ja them direkt Mirushit kur te pimë një kafe, por në sy dhe drejtpërdrejtë duke i uruar gjithashtu që pas një Sokrati te paarritshëm, një Muhameti që përsëris bindjen time që do të bëhet një Muhamet që do të zerë vendin e vet, të shoh…dhe kjo është thjesht dëshira ime…një emër tjetër që të jetë shqiptar dhe me autor shqiptar…

KREU III

Veprimtari kulturore-politike të zhvilluara në Vlorë, nën kujdesin dhe mbështetjen e deputetit

III. 1. Deputeti Bujar Leskaj promovon vitin kulturor – Vlora, ne dhe shkrimtarët

Të ftuar: Adriatik Kallulli, Bardhyl Londo, Rajmonda Bulku, Drita Pelingu, Blegina Agolli

Gazeta 55 dt. 7 maj 2007

Deputeti i Vlorës, Bujar Leskaj, promovoi në qytetin e Vlorës vitin kulturor "Vlora, ne dhe shkrimtarët". Në pallatin e kulturës të qytetit bregdetar në Skelë, u mblodhën mbi 300 pjesëmarrës në çeljen e kësaj nisme kulturore, e cila do të zgjasë 1 vit dhe do të promovojë shkrimtarët e këtij qyteti, duke bashkërenduar punët me shkrimtarët VIP të Tiranës dhe ata nga Kosova.

Promovimi i parë i kësaj nisme, filloi me shkrimtaren e këtij qyteti, Vilhelma Vranari, për 10 veprat e saj më të arrira. Nga kryeqyteti ishin ftuar, shkrimtari Bardhyl Londo, kritiku Adriatik Kallulli, artistet Drita Pelingu, Rajmonda Bulku. Gjithashtu, ishin ftuar nga Kosova, nipi i heroit Adem Jashari, Murat Jashari, si dhe kryetari i komunës Skënderaj.

Drejtori i qëndrës kulturore, Istref Dobi, tha se, "kjo nismë e deputetit Leskaj që fillon me një nga shkrimtaret më në zë të këtij qyteti, Vilhelma Vranari, për të vijuar me shkrimtarët e tjerë", është për t'u vlerësuar me mirënjohje nga ne.

Kritiku Adriatik Kallulli u shpreh se, "duke shqyrtuar në tërësi veprat e kësaj autoreje, kupton se një shkrimtare e niveleve të larta

artistike të shfaqet. Ky qytet që ka emër në letërsi me Ali Asllanin, Petro Markon, Fatos Arapin etj, sjell në letërsinë shqipe edhe autoren e 10 librave, Vranarin", me dinjitet e nivel.

Shkrimtarët vlonjatë, Laureta Petoshati dhe Enver Qamo, gjithashtu u ndalën në vlerat artistike të kësaj vepre.

Ish i persekutuari, Shaban Xhyheri, 87 vjeç, e nisi rrëfimin e tij me thënien: "kur lexoj librat e kësaj autoreje, më kujtohen ditënetët e burgimeve komuniste".

Poeti i mirënjohur Bardhyl Londo, duke shprehur vlerësimet më të larta të tij për këtë nismë të deputetit Leskaj, shprehu gjithashtu edhe konsideratat maksimale për kohën kur ai drejtonte Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë e Sporteve. "Si një nga shkrimtaret që e ka pushtuar Vlorën me librat e saj, pra në fushën e letrave,Vlora e do Vilhelmën siç do Ali Asllanin, Petro Markon. Kjo autore ka ngjitur shkallët, duke u bërë e njohur edhe në të gjithë Shqipërinë", pohoi Londo.

Kryetari i komunës Skënderaj, në Kosovë, Ramandan Gashi tha se, "kjo është një pasuri që u duhet lënë brezave. Ne, atje në Kosovë, flinim dhe ngriheshin me ëndrrën për Shqipërinë".

Ideatori i promovimit të vitit kulturor "Vlora, ne dhe shkrimtarët", Bujar Leskaj në fjalën e tij tha se, "këtë nismë e filluam me personalitetin e letrave vlonjate Vranari dhe do ta vazhdojmë me shkrimtarët vlonjatë Eqrem Canaj, Kujtim Murati, Reshat Kripa, Astrit Xhaferri, Albana Hodo, Gëzim Llojdia, Çlirim Hoxha, Leka Skëndaj, Enver Qamo etj". "Në letrat shqipe, ka "bujtur" prej kohe një shkrimtare. Ju vu kësaj rrugine me një mendjemprehtësi të çuditshme. Ajo nuk priti në kohë sa galaktikat miliona shekuj pritën, por kërkimi i saj zgjoi ëndrrën në shpirtin e thepisur, për të rrugëtuar drejt letrave. Nuk ka formulë të fshehtë, për të gjetur poezinë e shpirtit. Aty, në thellësi të labirintheve, goditjet e kometave krijuan, ose mbrujtën letërsinë, krijesën e magjishme, që lindi brenda thellësisë së thellësive. Vilhelmen pa druajtje e quaj "Musine Kokalari e Vlorës", theksoi Leskaj.

(botohet me shkurtime)

III. 2. Sesion shkencor në Vlorë mbi marrëdhëniet Shqiptaro-Amerikane

Referojnë deputetët Leonard Demi, Bujar Leskaj dhe Prof. Dr. Dhori Kule

Gazeta Republika, gazeta 55, 10 Qershor 2007 (nga Gëzim Llojdia)

Në qytetin e Vlorës, një ditë para mirëseardhjes së Presidentit Bush në Shqipëri, është mbajtur sesioni shkencor "Marrëdhëniet Shqiptaro - Amerikane", organizuar nën kujdesin e deputetit, Bujar Leskaj.

Morën pjesë qindra studentë të Universitetit "Ismail Qemali", pedagogë, intelektualë, gazetarë e studiues. Në sfond të panelit të mbajtur në Pallatin e Kulturës "Labëria", ishte portreti i Presidentit Bush dhe dy flamujt shqiptaro-amerikan. Në hyrje të aktivitetit, moderatori Bujar Leskaj tha se vizita historike e Presidentit Amerikan në Shqipëri, është ditë historike për kombin shqiptar.

Dr.Leonard Demi, deputet, referoi lidhur me marrëdhëniet Shqiptaro-Amerikane duke theksuar ndër të tjerash se: "Marrëdhëniet e Shqipërisë me SHBA, janë marrëdhënie miqësie tradicionale midis dy vendeve demokratike, të cilat nuk drejtohen kundër ndonjë vendi tjetër; marrëdhënie që mbështesin zhvillimet demokratike, shtetin ligjor dhe të drejtat e njeriut në vendin tonë, duke përkrahur institucionet demokratike, arsimore, shkencore, kulturore, etj; marrëdhënie sigurimi, të cilat e kalojnë kuadrin bilateral dhe marrin rëndësi të madhe për sigurimin rajonal dhe më gjerë; marrëdhënie që mbështesin reformën demokratike dhe ekonominë e tregut", u shpreh deputeti Demi. Prof. Dr. Dhori Kule, Dekan i Fakultetit Ekonomik në UT, referoi lidhur me arsimimin amerikan dhe përvojën e bashkëpunimit midis Universitetit të Tiranës dhe Universitetit të Nebraskës, bashkëpunim i cili në nivel pasuniversitar jep diplomat master MBA dhe MPA, në administrim biznesi dhe administrim publik. Drejtoresha e bibliotekës së qytetit të Vlorës, Liliana Gjika, në referatin e saj përmendi këndin amerikan të librit në këtë bibliotekë si dhe ndihmën që ka dhënë Ambasada e SHBA në Tiranë, për pajisjen me libra të të këtij institucioni.

Deputeti, Bujar Leskaj, mbajti referatin: "SHBA dhe fati i Kosovës". Mes të tjerash ai theksoi: "Në Evropën Juglindore, pas shumë shteteve të vogla, përveç Shqipërisë dhe shqiptarëve, për një kohë të gjatë fshiheshin ose qëndronte së paku një nga fuqitë e mëdha. Loja luhej pa rregulla dhe pa u bazuar në asnjë kriter. Më konkretisht, Serbia mbështetej dhe sponsorizohej nga Rusia, Franca e disa shtete të tjera, përkundrejt çështjes shqiptare në vitet 1945, 1989, 1999. Kosova iu dha Serbisë në një mënyrë jo të drejtë, në Konferencën e Ambasadorëve në 1913 dhe ky status i gabuar u konfirmua sërish, në Konferencën e Versajës në 1919.

Në vitin 1986, kur njerëzit në Europë nuk parashikonin ndonjë ndryshim politik në Luftën e Ftohtë, në SH.B.A. u paraqit në Kongresin Amerikan, një rezolutë që dënonte me fjalë të ashpra represionin mbi shqiptarët etnikë, nga qeveria socialiste e RFJ. Kongresi kërkonte të shënohej se shqiptarët përbënin një prej grupeve etnike në Jugosllavi dhe kritikonte shkeljen e të drejtave të tyre. Kjo rezolutë ishte një fitore e Komunitetit Shqiptar në Amerikë, i cili arriti të fuste në diskutim në Kongresin Amerikan, çështjen që Kosova të merrte statusin e Republikës". Deputeti Leskaj i bëri një përshkrim të hollësishëm ngjarjeve, nëpër të cilat eci i gjithë shtrati i politikës kosovare që aspironte dhe kërkonte Republikën e Kosovës. Ai kthjelloi disa ngjarje, lidhur me themelimin e LDK-së dhe faktin sinjifikativ që, dega e saj u themelua menjëherë në SHBA. Leskaj saktësoi lobimin që bëri LDK-ja në SHBA në të gjithë rrugëpërshkrimin e saj. Leskaj përmendi gjithashtu, figurën e Presidentit të parë të Kosovës, Dr.Ibrahim Rugovën, takimet e tij me personalitete të politikës amerikane, mbështetjen amerikane në Senat dhe rezolutat e tij në mbështetje të çështjes kosovare. Leskaj përshkroi historinë e fund viteve 1980 me ngjarjet që ndodhën në Kosovë. Kurse për fillimin e viteve 1990, prezantoi të dhëna mbi organizimin e diasporës dhe lobingun për Kosovën. Deputeti Leskaj solli fakte mbi dhunën dhe represionin serb në Kosovë, Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës, zgjedhjen e Rugovës President, përpjekjen që çështja e Kosovës të futej në rezolutat e Kongresit Amerikan, letrën e Presidentit Bush drejtuar Millosheviçit, që u quajt "vija e kuqe", Planin e Paqes si dhe kontributi Amerikan për statusin e Kosovës, përmes miratimit të Rezolutës së Kosovës. Më tej, ai u fokusua në ngjarjet e vitit 1998, krizën në Kosovë, UÇK-në heroike, goditjen e NATO-s mbi makinën ushtarake serbe.

"Ne, të gjithë, sot biem dakord se vizita e Presidentit Bush në Shqipëri, shkruan një histori të madhe për kombin tonë dhe hap një hapësirë të madhe për prosperitet e forcim kombëtar, gjithashtu", theksoi Leskaj.

(Botohet me shkurtime)

Sesioni u transmetua i plotë në televizionet lokale

III. 3. Në ditën ndërkombëtare të dhurimit të gjakut

Deputeti i Vlorës Bujar Leskaj, dhuron gjak në qytetin e tij. 14 Qershor –Vlorë

Në Ditën Ndërkombëtare të dhurimit vullnetar të gjakut, deputeti Bujar Leskaj, ka zbritur nga kryeqendra e vendit për të dhuruar gjak, në çadrën e dhurimit të gjakut të ngritur nga Kryqi i Kuq Shqiptar, në qendër të qytetit bregdetar të Vlorës. Leskaj, u bëri thirrje edhe pushtetarëve të tjerë të qytetit jugor, të dhurojnë gjak në kushtet kur ndihet nevoja për këtë veprim human.

Kryqi i Kuq shqiptar hapi çadrën e tij për të mbledhur gjak, por, dhuruesit në këtë ditë të veçantë ishin në një numër të kufizuar. I vetmi nga deputetët që ndërmori nismën, si në çdo vit tjetër, ishte deputeti Bujar Leskaj. Me stafin e tij, dy vjet më parë, kur nisi fushatën për kandidimin e tij në qytetin bregdetar, Leskaj dhuroi gjak dhe u zotua se për çdo vit në këtë çadër do të kryente këtë veprim, jo vetëm në ditën ndërkombëtare të dhurimit të gjakut, por edhe në raste të tjera. I vetmi fakt mbetet se, pushtetarët vendorë të qytetit, nuk e kishin të planifikuar në kalendarët e tyre dhurimin e gjakut. Në hije mbetën edhe strukturat e tjera të shëndetësisë së këtij qyteti. Ndryshe nga një vit më parë, kur punonjësit dhe kryesisht bluzat e bardha, si dhe studentët, dhuruan gjak, në këtë ditë ndërkombëtare indiferenca ishte në kulmin e saj. Si pjesëtar i Kuvendit të Shqipërisë, Leskaj përbënte emrin e vetëm që u regjistrua në fletoren e dhurimit të gjakut në qytetin bregdetar. Në Ditën Ndërkombëtare të dhurimit të gjakut, deputeti Leskaj, ka ardhur enkas në Vlorë, së bashku me bashkëshorten, për të kryer këtë veprim human. "Mund ta kryeja këtë veprim edhe në Tiranë, pasi, sikundër thotë edhe slogani i Kryqit të Kuq, kush dhuron gjak shpëton një jetë, por mendoj se shërbehet më mirë në Vlorë dhe për Vlorën, në këtë ditë simbol", tha z. Leskaj. "Gjithashtu, për nostalgji edhe të 2 viteve më parë, kur, së bashku me stafin tim elektoral, në fushatën elektorale të vitit, 2005 dhuruam gjak dhe kjo është një vepër e bukur në shërbim

të komunitetit", shtoi më tej Leskaj. Ndërkohë, në kuadër të kësaj dite, drejtori i spitalit rajonal, Luter Nuraj, bëri të ditur se, dhurimi i gjakut është mjaft i nevojshëm, banka e gjakut në spital ka nevojë për të, pasi kërkesat janë të larta. Kjo edhe për faktin se, Vlora është një nga qytetet me numrin më të lartë të talasemikëve. "Aktualisht, numri i donatorëve të gjakut është shtuar, por sërish unë jam me bindjen se duhen eliminuar donatorët me pagesë dhe qytetarët duhet të sensibilizohen për të dhuruar gjak", nënvizoi Nuraj.

Botuar në Gazetën 55, datë 15 qershor 2007

III. 4. Inteligjenca vlonjate kërkon ridimensionimin e figurës së Eqerem bej Vlorës, intelektual i madh dhe burrë shteti i shquar

Vlorë më, 22 Shtator 2007

Nën kujdesin e deputetit te Vlorës Bujar Leskaj, klubi kulturor mbarëkombëtar "Ali Asllani" nderoi figurën e Eqerem bej Vlorës, në një konferencë historike me temë "Eqerem bej Vlora - patriot, intelektual i madh dhe burrë i shquar shteti", zhvilluar në ambientet e shtëpisë së Vlorajve, sot e mbiquajtur "Shtëpia e Beut", monument kulture. Morën pjesë studiues, historianë, drejtori i Muzeut Historik Kombëtar Beqir Meta, historiani Uran Butka dhe të tjerë të ftuar edhe nga rrethet.

Pas hymnit te Flamurit, Qëndro Meminaj, sekretar i klubit "Ali Asllani", tha: "Klubi kulturor mbarëkombëtar "Ali Asllani", me mbështetjen edhe te deputetit z.Bujar Leskaj, e zhvillon këtë aktivitet për të nderuar kujtimin e një prej figurave më të shquara të Vlorës dhe Shqipërisë, Eqerem Bej Vlora".

Studiuesi i figurave të historisë së Vlorës, Fahri Shaska, mbajti kumtesën "Veprimtaria e Eqerem bej Vlorës si patriot, intelektual e burrë shteti i shquar".

"Biblioteka e Eqerem bej Vlorës, pasuri e madhe kombëtare", ishte referati i drejtores së Bibliotekës së Vlorës, Liliana Gjika.

"Feja dhe Eqerem bej Vlora", ishte kumtesa e z. Gëzim Llojdia - drejtor i parkut arkeologjik Amantia. Sipas tij, "Pasuria shpirtërore tek Vlorajt, nuk ka përmasa të kapshme dhe koordinata sigurisht që nuk ka. Por, tregues është fakti që Vlorajt kanë qënë të lidhur me besimet. Kjo është shprehje domethënëse se, familjet e mëdha kanë pasur në themel të tyre besimin".

Drejtori i Muzeut Historik Kombëtar Prof. Dr. Beqir Meta tha se, "në muze ne po punojmë të potencojmë pasuritë etnografike, që ishte mbyllur në dyert e Institutit të Kulturës Popullore. Ne do të ndërtojmë një muze etnografik. Gjithashtu brenda Muzeut

Kombëtar, figura si Eqrem bej Vlora do të kenë vend posaçërisht".

Historiani Uran Butka foli për kujtimet që kishte lënë gjyshi i tij, Sali Butka dhe i ati, Safet Butka, për këtë figurë të ndritshme të kombit shqiptar.

Më e veçanta e këtij takimi, ishte një fotoekspozitë me fotografi të panjohura më parë, e hapur nga studjuesi Qerim Vrioni, ku ishin të ekspozuara rreth 25 foto të reja për figurën e Eqerem bej Vlorës dhe personaliteteve të tjera shqiptare në kohën e emigrimit.

Kujtime, mbresa e vlerësime për jetën dhe veprimtarinë e Eqerem bej Vlorës, u sollën edhe nga pjesëmarrës të tjerë. Në emër të familjes dhe të afërmve të tij, përshëndeti të pranishmit, z Fatmir Allmuça.

Marrë me shkurtime nga gazeta 55 dhe Republika, 23 shtator 2007
Kronikë në TV Vlora Channel, TV 6+1 Vlora, TV Fokus, TV Amantia.

III. 5. "Lufta Civile në Shqipëri 1943-1945" e Uran Butkës, kalon testin e publikut vlonjat

Vlorë më 13 Tetor 2007

Nën kujdesin e deputetit z. Bujar Leskaj, u organizua në Vlorë Simpoziumi Historik "LUFTA CIVILE NE SHQIPËRI 1943-1945" dhe promovimi i librit të studiuesit Uran Butka me të njëjtin titull, në mjediset e Pallatit të Kulturës "Labëria". Morën pjesë, deputeti i Vlorës Bujar Leskaj, Kryetari i Këshillit të Qarkut të Vlorës, Agron Sharra, studjuesi dhe autori i librit Uran Butka. Simpoziumi ishte i ndërtuar mbi promovimin e librit të studjuesit Uran Butka, "Lufta civile në Shqipëri 1943-1945".

Në panelin e parë, kryetari, Ylli Bora tha se "ky është një libër i shkruar dhe i ndërtuar bukur dhe me realizëm". Sipas tij, "Lufta në Shqipëri filloi si një luftë antifashiste, por përfundoi në luftë mes shqiptarëve. Ajo filloi mes nesh dhe të huajve dhe përfundoi mes nesh. Lufta e klasave pas çlirimit a nuk ishte luftë civile, pushkatimet e deputetëve, ngjarjet e '97, vrasja e Azem Hajdarit, a nuk janë të tilla?"

Deputeti i Vlorës, Bujar Leskaj, organizatori i vitit kulturor në këtë qytet, tha në fjalimin e tij se, "promovimi i librit vjen si një distancim nga qëndrimi që u mbajt 70 vite më parë, kur lufta përfundoi në një vëllavrasje mes shqiptarëve". Deputeti Leskaj përmendi prishjen e marrëveshjes së Mukjes nga forcat komuniste, nën ndikimin serb, ndërkohë që, të majtët edhe pas viteve '90-të, vijonin ritualin e tyre, duke mbrojtur prishjen e marrëveshjes historike. Ne patëm fatin e keq, tha deputeti Leskaj, që njëri nga organizatorët e kësaj vëllavrasjeje, serbi D. Mugosha, në Qarkun e Vlorës filloi pikërisht këtë frymë antishqiptare, duke nisur me eleminimin e Sadik Premtes e të tjerëve me radhë. Deputeti Leskaj tha se, "Uran Butka është një historian i vlerësuar që diti të ndërtojë staturën e vet dhe si politikan, por në këtë periudhë të historisë ka sjellë dokumente të rralla që duhet dhe do të tërheqin vëmendjen

e opinionit. Populli shqiptar ka nxjerrë figura të shquara në Luftën Antifashiste, por, kjo histori shpesh u falsifikua e u ndryshua. Ne duhet të krenohemi me rezistencën dhe figurat që dolën edhe nga Qarku i Vlorës. Respekti qëndron për dëshmorët e luftës, por jo vetëm për ata partizanë, por edhe ata nacionalisë. Dokumentet që sjell Butka janë realiste dhe të befasojnë. Në model të këtij libri duhet të ndërtohet edhe një për qarkun e Vlorës". Deputeti i Vlorës përmendi tre momentet që cek logjika e librit "Lufta civile në Shqipëri". Ai, duke ju referuar librit, përmendi traktatin BRSS - Gjermani, aleancën mes dy diktatorëve Stalin dhe Hitler. Leskaj tha se, "nga viti `39 deri në `41, komunistët nuk zbrazën asnjë pushkë, fakt i njohur dhe i pranuar edhe nga historianët e majtë. Historia të rishkruhet nuk ka gjë të keqe. Historia e Luftës së Dytë Botërore, duhet të rindërtohet në bazë të fakteve".

Prof. Dr. Muharrem Dezhgiu, kumtoi; "Pasqyrimi i luftës civile, në librin e z Uran Butka". Ai theksoi se, "Shqipëria përjetoi gjatë Luftës II Botërore jo vetëm pushtimin e saj nga nazi-fashistët me pasojat e veta, por dhe qëndresën ndaj tyre. Gjithashtu është fakt historik se Shqipëria përjetoi dhe realitetin e luftës civile midis forcave politike shqiptare, në thelbin e se cilës ishte lufta për pushtet".

Studiuesi i figurave historike të rrethit të Vlorës, Fahri Shaska, u përqëndrua më tepër tek "Aspekte të luftës civile në rrethin e Vlorës". Ai dha fakte dhe dokumenta konkrete nga Lufta Civile 1943-1945 në Vlorë. Shaska, ju përgjigj dhe pyetjes se çfarë quajmë luftë civile, duke dhënë edhe argumentet përkatëse, për përgjegjësinë e komunistëve në atë kohë.

Aranit Hoxha, ish i persekutuar politik, tha se, "këto takime, ku përfshihet edhe ai për Eqerem bej Vlorën, kanë meritën që u përgatitën nga Bujar Leskaj, i cili po bën shumë për qytetin e tij".

Autori i librit falënderoi të gjithë diskutantët dhe, në veçanti, deputetin e Vlorës Bujar Leskaj, i cili kur ishte Ministër i Kulturës, sponsorizoi këtë botim dhe theksoi se, "për këtë libër ka ardhur orientim nga Këshilli i Europës të lexohet në qarqe të gjera". "Ne duhet të rindërtojmë shpirtin shqiptar, që e kanë vrarë padrejtësisht", tha Butka. Butka përfundoi se, "libri nuk cënon luftën dhe ata që derdhën gjakun, por hap një këndvështrim realist të saj".

Marrë me shkurtime nga Gazeta 55, Republika dt 14 tetor 2007

Kronikë në TV Vlora Channel, TV 6+1 Vlora, TV Fokus, TV Amantia.

III. 6. Historiku i Vlorës në librin e Enver Memishës

Klubi "Ali Asllani" dhe deputeti i Vlorës Bujar Leskaj, paraqitën para publikut vlonjat studimin e fundit "Nëpër greminat e përgjakura të sistemit komunist", një historik i pashkruar dhe origjinal i karakterit kriminal, që shoqëroi marrjen e pushtetit nga komunistët shqiptarë. Studiuesit e pranishëm, sollën edhe fakte të tjera tronditëse, të cilat i përkasin në mënyrë specifike historisë së qytetit të Flamurit. Referimi shkencor "Historiku i Vlorës në librin e Enver Memishës", ishte përqëndruar në sjelljen e fakteve të reja dhe ndriçimin e një realiteti historik. Klubi kulturor 'Ali Asllani", në bashkëpunim me deputetin e Vlorës Bujar Leskaj, organizuan në mjediset e shtëpisë muze të Eqerem bej Vlorës, promovimin e librit, "Nëpër greminat e përgjakura komuniste", me autor studiuesin dhe publicistin e njohur vlonjat, Enver Memisha (Lepenica).

Në një atmosferë, ku ishin të pranishëm dhjetra përfaqësues të familjeve të shquara të qytetit të Flamurit, konferenca shkencore u hap nën tingujt e himnit kombëtar. Nderonte në këtë promovim edhe Prof.Dr. Omer Stringa, anëtar i kryesisë së PD.

Sekretari i klubit kulturor "Ali Asllani", Qëndro Meminaj, në çelje të këtij aktiviteti tha se, "ky libër, me fakte dhe argumente të padiskutueshme, hedh dritë mbi atë pjesë të errët të luftës, që nuk u zbardh kurrë nga rregjimi komunist". Në përshëndetjen e vet, deputeti i Vlorës Bujar Leskaj, u ndal në krijimtarinë historike të këtij autori jugor, e cila zë fill nga monografia voluminoze për Hysni Lepenicën dhe përvijohet me një mozaik të plotë në librin më të fundit studimor dhe historik, duke rrokur brenda këtij diapazoni, personalitete dhe figura që koha i kishte lënë në harresë. "Këto janë të vërteta të panjohura, janë fakte që kanë qenë të patregueshme e që dritësojnë emrin e një krahine si Labëria dhe të një qyteti historik si Vlora", nënvizoi ai. Deputeti i Vlorës, që është promotorri i këtyre veprimtarive në këtë qytet jugor, tha se në të ardhmen do të ketë të tjera aktivitete të kësaj natyre.

Studiuesi, Fahri Shaska, solli befasi të reja në kumtesën "Historia tragjike e Ballit Kombëtar". "Për të treguar natyrën vrastare të komunistëve dhe atë humane të ballistëve, po marrim nga libri dhe rastin e komandantit të ballit Shahin Nuredini", tha ndër të tjera studiuesi Shaska.

Sekretari i Lidhjes së Shkrimtarëve të Vlorës, Albert Abazi, u shpreh mes të tjerash se, Memisha ka qënë redaktori i librit të tij të parë për nacionalistin Hysni Lepenica. "Pena e tij, si një daltë skulptori, mjeshtërisht skalit portretet e I.Qemalit, O.Haxhiut, Q.Kokoshit, A.Lepenicën, D.Shaskën, M.Myftaraj, A.Mezini, H.Lepenicën, M.Frashërin, S.Muçon, A.Camin, Z.Mezinin, Rr.Meton, S.Hoxhën, A.Mehmetin, Y.Radhimën, H.Isain, e gjithë atyre që luftuan për flamur e komb", tha Abazi.

Ndërkohë, Alfred Sulaj e zhvendosi epiqendrën e referimit tek "Ngjarje të tjera gjatë luftës". Ai theksoi se, "Historia tragjike e luftës civile antifashiste në Shqipëri, si dhe ajo e sundimit të komunizmit, kërkojnë analizë, qetësi, për të hedhur piketat e pajtimit dhe vëllazërimit të një kombi vital".

Publicisti, Gëzim Llojdia, trajtoi kapitullin e fundit të librit prej 512 faqesh: "Grimca jete nga terrori komunist". "Memisha ka shfletuar qindra fletë dhe ka ecur nëpër labirintet ku janë ngrehur kurthet e këtij terrori. Nëse kërkon historinë tënde, e ke të shkruar këtu, është një arkiv i tërë, një bibliotekë e madhe ku mund të gjesh të tëra dosjet e atyre që koha i humbi, është memorja jonë historike, që Vlorës i kishte munguar... ", citoi Llojdia.

Përshtypje, kujtime e vlerësime, solli i persekutuari politik, "Mandela i Vlorës", Petrit Velaj, i cili përmendi fakte dhe dëshmi të kohës kur ai ka qenë në rradhët e Ballit Kombëtar, rreth 70 vite më parë. Fjala e tij u ndoq me një interesim të dukshëm.

Autori, Enver Memisha, që ka sigluar rreth 6 libra historikë nga kjo krahinë jugore, duke sjellë në vëmendje të historisë sonë të vërtetën e të vërtetës me dokumente, tha se, "koha po tregon dhe do të tregojë se faktet dhe dokumentet e reja të zhbiruara nëpër sëndukët e atij rregjimi, po shfaqin histori të pashkruara ende, të cilat po sillen nëpër faqet e librave të studiuesve shqiptarë".

Marrë me shkurtime nga Gazeta 55, Republika
dt. 15 dhjetor 2007
Kronikë në TV Vlora Channel, TV 6+1 Vlora, TV Fokus,
TV Amantia.

III. 7. Zona 94 në epiqëndër të vëmëndjes time

100 milion lekë për Lagjen "15 tetori"

Vlorë 17 Janar 2008

Deputeti i Vlorës, Bujar Leskaj, ka sjellë lajmin e mirë për banorët e qytetit bregdetar dhe sidomos për ata në lagjen "15 tetori", e njohur ndryshe me emrin "Karabash". Ai ka folur për dëmtimin e banorëve të kësaj zone nga vërshimet e ujërave, të shkaktuara nga rreshjet e shiut gjatë ditëve të fundit. Qeveria shqiptare, tha deputeti i zonës Nr 94 të qytetit bregdetar, ka miratuar në mbledhjen e saj të datës 16 janar, një fond prej 100 milionë lekësh të vjetra, për rehabilitimin e kanalit të ujërave të larta. "Ky vendim, që dëshmon për vëmendjen e Qeverisë, parashikon nxjerrjen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave të shumës së mësipërme, që do t'i kalojë Bashkisë së Vlorës, për rehabilitimin e kanalit të ujërave të larta", theksoi deputeti Leskaj. Sipas tij, çelja e këtij fondi është hapi i parë që ndërmerret dhe që do të pasohet me prokurimin e tij nga bashkia e këtij qyteti, për të mundësuar pastrimin e kanalit të ujërave të larta nga mbetejet, ndërtimet pa leje etj. "Pastrimi i këtij kanali, që është në varësi të bashkisë së qytetit, kërkon një bashkërendim të punëve", tha deputeti i zonës Nr 94, duke shtuar se, "është në epiqendër të vëmendjes time, bashkëpunimi për të zgjidhur problemet dhe për të rritur investimet në qytet". Deputeti Leskaj ka folur edhe për dëmshpërblimin e banorëve. "Duhet ngritur një komision, për të përcaktuar familjet e dëmtuara, që do të bashkërendojë punën me Drejtorinë e Emergjencave, si dhe me Prefekturën e Vlorës. Ardhja ime lidhet me shqetësimin e banorëve të kësaj zone. Në këtë situatë ne duhet të bashkërendojmë punën me bashkinë e qytetit, për të vënë në lëvizje mekanizmat, për të zgjidhur problemet e qytetarëve dhe sidomos, kur ata gjenden në situata emergjente, siç ishte edhe përmbytja e banorëve të lagjes "15 Tetori" ditët e fundit, nga vërshimet e kanalit të ujërave të larta", tha ai.

Prej vitesh, kanali i ujërave të larta të qytetit, që derdhet në zonën e Nartës, ka shkaktuar përmbytje tek banorët e kësaj lagjeje, që kanë ndërtuar banesat e tyre pranë tij. Pas viteve '90-të , ai është dëmtuar. Kanali i ujërave të larta disiplinon ujërat e kodrinave përmbi qytet, duke i devijuar ato për në lagunën e Nartës. Ky kanal ka qenë një shqetësim i përhershëm i banorëve të qytetit, për përmbytjet që shkakton në ditët me rreshje intensive. Në mjaft raste, në Vlorë janë shkaktuar situata emergjente, për shkak të vërshimit të ujrave.

Marrë nga shtypi periodik dhe mediat lokale

III. 8. Leskaj u premton mbështetje grave të Transballkanikes

E Martë, 12 shkurt 2008.

Vlorë - Pas mbështetjes që u dha në fjalën e tij në parlament, mbrëmjen e të hënës, deputeti i qytetit të Vlorës, Bujar Leskaj, ka shkuar dje në këtë qytet dhe ka marrë kontakt të drejtpërdrejtë me gratë greviste të rrugës "Transballkanike". Fillimisht ai u ka shprehur atyre keqardhjen për gjendjen e tyre shëndetësore dhe, më pas, i ka garantuar për gatishmërinë e tij dhe të qeverisë, për gjetjen e një zgjidhjeje në të mirë të të dy palëve. Sipas deputetit Leskaj, urdhri për dëmshpërblimin e tyre ka dalë që në fund të muajit nëntor të vitit të kaluar, por ka qenë mungesa e seriozitetit të organeve të qeverisjes vendore, që nuk është dhënë dëmshpërblimi në kohën e duhur. Ai u ka kërkuar atyre të dalin nga greva, për të mirën e shëndetit të tyre, ndërkohë që u ofroi mbështetjen për t'i ndihmuar në marrjen sa më shpejt të dëmshpërblimit. Leskaj i ka garantuar gratë se, asnjë prishje tjetër nuk do të ndodhë në këtë rrugë nga policia ndërtimore, pa u marrë shpërblimi i dhënë nga qeveria, për çdo metër katror trualli që ato kanë në pronësi. Deputeti Leskaj, u ka premtuar grave greviste, që janë ngujuar prej 20 ditësh në një prej banesave përgjatë rrugës "Transballkanike", se do të interesohet edhe pranë prefekturës dhe organeve të tjera të pushtetit vendor, për përshpejtimin e procedurave të marrjes së dëmshpërblimit. Në këtë takim, Leskaj është shoqëruar edhe nga kryetari i qarkut Agron Sharra që është njëkohësisht edhe kryetari i degës së PD-së për Vlorën.

Marrë nga shtypi periodik dhe mediat lokale

III. 9. Deputeti që i gjendet Vlorës çdo ditë

Tiranë më 13 Shkurt 2008

Ka një peshë në qytetin e tij të lindjes dhe sigurisht që nuk mund ta kalojë lehtë. Të hënën në Kuvend i kërkoi kryeministrit, që, 54 familje tek të cilat po shkojnë buldozerët, të shpronësohen më parë dhe pastaj të shkojë ushtria e mjeteve të motorizuara, për të shkatërruar mundin dhe djersën e tyre. Dhe kryeministri Berisha e quajti pikërisht të drejtë këtë arsyetim të deputetit nga qyteti jugor. Dhe nuk ishte rastësi kjo kërkesë e këtij deputeti.

Bujar Leskaj, është dhe duhet shënuar në regjistrin e nderit të qytetit bregdetar nga të vetmit, të paktët dhe nga më të mirët, që guxon dhe kërkon ndërhyrje për çdo banor, ose që i përket zonës së tij elektorale Nr 94, e konfiguruar mes shumë lagjesh në qytetin bregdetar. E ndjen, e ka detyrë, apo është i sugjestionuar me qytetin e tij, ai është i shkrirë tërësisht me zonën e tij elektorale. Edhe kur gjendet në Parlament, pra në kryeqendër të vendit, madje dhe sytë i ka të drejtuar në jug, atje ku është zona e tij elektorale. Ndjek lajmet, shfleton gazetat që kanë shkrime për qytetin e tij, bisedon në telefon, vjen-ikën dhe kthehet sërish. Si do t'i kanalizoja unë veprimet e këtij deputeti të parlamentit shqiptar?

I palodhur dhe i pagjumë. Ndërsa iku nga karrigia e Ministrit, u kthye sërish tek elektorati i vet. Shpalli një platformë tepër moderne për zhvillimin e kulturës në qytetin bregdetar. Vitin 2007, e quajti viti kulturor i Vlorës. Si u përshkruan veprimtaritë dhe cilat ishin ato?

1- Romanet e shkrimtares Vilehma Vranari, ose siç e quajnë vlonjatët, "Petro Markon me fustan". Mbi 200 vetë morën pjesë në këtë veprimtari që zgjati mbi 3 orë. Me rastin e vizitës së Presidentit Bush, ndërmorri nismën për të zhvilluar simpoziumin "Miqësia shqiptaro-amerikane" me lektorë deputetin Leonard Demi, Prof. Dr. Dhori Kule etj. Në bashkëpunim me klubin kulturor "Ali Asllani", zhvilloi veprimtari për Eqerem bej Vlorën, librin e studiuesit Uran Butka, "Lufta civile në Shqipëri", atë të studiuesit Enver Memisha, "Nëpër greminat e përgjakura komuniste".

Pjesëmarrja: Sallat, ku janë zhvilluar ato në pallatin e kulturës dhe "Shtëpinë e Beut", e shpallur monument kulture, kanë mbajtur brenda tyre një auditor të gjerë nga të gjitha ketgoritë dhe moshat, që kanë ndjekur me vëmendje këto veprimtari.

2- Zgjidhja e kërkesave të elektoratit që përfaqëson. Fillimi i muajit shkurt, koinçidoi me një fatkeqësi për lagjet e sipërme të qytetit në zonën Nr 94, që u përmbytën. Deputeti i kërkoi qeverisë një fond për një kanalizim që ekziston, por që, duke qenë i bllokuar, po përmbyt vazhdimisht prej vitesh këto zona nga ujërat që sjellin kodrat me ullinj të qytetit. Fondi 100 milionë, ju akordua këtij rrjeti kullimi për ujërat e sipërme të qytetit.

Dje, deputeti i Vlorës erdhi enkas në qytet. Nuk kishte aktivitet, por një çast të përzishëm. Iku nga jeta kompozitori, Piro Cakrani. Deputeti mori njoftimin, i hipi makinës, u nis për në Vlorë.

Thënia se, deputeti duhet të gjendet pranë elektoratit, nuk ilustrohet vetëm me këto raste të cituara më sipër. Ai ka financuar personalisht sportistë të talentuar për aktivitete jashtë vendit. Është mik i reporterëve të qytetit bregdetar. Dhe, në fund, është një ndër ata që e nderon partinë, që përfaqëson.

3-Ngritja e zërit në parlament. I keni vënë re deputetët e mykur(!) Kur dielli dhe drita e podiumit ka kohë pa i vrarë. Veç të strukur dhe kokëulur. Të heshtur kalojnë përpara saj. Kanë mjegullina nëpër mendje. Mandati po u mbyllet dhe viti elektoral po zgjat krahët, që do të thotë ka mjegull shumë nëpër rrugë, furtunë, shi, rrebesh. Ndërsa me B.Leskajn ndodh krejt e kundërta. Është i lirë dhe kërkon, jep mendime, kundërshton kur e sheh se cënohet nderi, apo dinjiteti i qytetarëve. Nuk ka zhgun murgu veshur, por ka mësuar se jeta e parlamentarit të atyre viteve dhe atyre burrave që bënë Shqipërinë, është e ndritshme sa dielli, sepse mandati është i shkurtër, por punët, fjalët, vepra, në fund të fundit mbetet. Prandaj, kërkon të dritësojë veprat me fjalët. Kërkon që diçka nga qenia e tij, nga puna e tij, të materializohet në zonën e tij ku, tre vite me parë shkoi për votat e tyre.

Rrënqethet, jo kur deti sjell erën e ftohtë, por kur ndjen se ka mangësi në shërbime tek qytetarët, kur kryhen veprime të paligjshme dhe kur kërkojnë të përfitojnë padrejtësisht, qoftë dhe të njohurit e tij dhe në emër të tij. Unë do ta quaj misionar, ndryshe nga ata që ikën nga qyteti i tyre dhe vështirë e kanë të kthehen përsëri. Ky deputet, nuk ka nevojë për urdhëra për të zbritur tek zona e tij, nuk ka nevojë t'i thuhet se çfarë duhet të bëjë, sepse ai është atje dhe e ndjen peshën e saj, forcën e saj, hallin e saj, është një banor i përhershëm i qytetit të tij.

Gëzim Llojdia- botuar në Gazetën 55

III. 10. Këshilli i Bashkisë Vlorë miraton propozimin e deputetit Bujar Leskaj për vendosjen e busteve të kryetarëve të Bashkisë Vlorë për periudhën 1912-1939, në lulishten e Sheshit të Flamurit

Vlorë më 13 mars 2008

20 milion lekë janë miratuar në buxhetin e vitit 2008 nga Këshilli i Bashkisë Vlorë, për të vënë në jetë propozimin e deputetit të zonës Nr 94 të qytetit bregdetar, Bujar Leskaj.

Deputeti i Vlorës, i zonës Nr 94 të qytetit historik, i propozoi Këshillit të Bashkisë Vlorë: "8(tetë) kryetarë bashkie të qytetit historik të Vlorës, nga vitet 1912-1939, të përjetësohen në buste në lulishten e "Sheshit të Flamurit". Emrat e këtyre kryetarëve të bashkisë për këtë periudhë janë: Ibrahim Abdullai, Abaz Mezini, Osman Haxhiu, Ali Asllani, Qazim Kokoshi, Nuredin Vlora, Arshi Halili, Abedin Nepravishta. Këta janë 8(tetë) kryetarët e Bashkisë që kanë drejtuar qytetin historik pas shpalljes së Pavarësisë për periudhën 1912-1939.

Propozimi i deputetit, Bujar Leskaj, është mbështetur në Ligjin "Për Trashëgiminë Kulturore", me numër 9048 dt. 7. 04. 2003, neni 30, i ndryshuar dhe Ligjin Nr 8652 dt 31. 07. 2000 paragrafi 8 –VII/B, "Për Organizimin e Qeverisjes Vendore". Propozimit, që u është drejtuar kryetarit të Bashkisë së Vlorës, Shpëtim Gjika, si dhe kryetarit të Këshillit Bashkiak të qytetit, Arben Sinani, ju dha drita jeshile nga Këshilli i Bashkisë së këtij qyteti, i cili e miratoi atë, duke vendosur në dispozicion shumën 20 milion lekë të vjetra, për të ngritur 8 buste në sheshin e Flamurit. Mes argumenteve që ka sjellë deputeti, Bujar Leskaj, për propozimin e tij përfshihen:

- "Shpallja e Pavarësisë në vitin 1912 nga Plaku i madh, Ismail Qemali dhe patriotët nga krahina të tjera të Shqipërisë, zhvillimet ekonomike e politike të qytetit të Vlorës nga viti 1912, 1920 e vitet 1930, u shoqëruan pa dyshim me kontributin e pamohueshëm të personaliteteve të lart përmendura. Sa më sipër, shpreh mendimin

tim personal, se do të ishte në nder të qytetit të Vlorës, që Bashkia e këtij qyteti, me mbështetjen tuaj si anëtarë të Këshillit Bashkiak, ta vlerësoni këtë vendim. Ky projekt, mund dhe duhet të mbështetet financiarisht nga Bashkia Vlorë dhe përfaqësues të biznesit vlonjat, si dhe përfaqësues aktualë të politikës në qytetin e Vlorës. Unë si deputet i zonës 94 Vlorë, angazhohem të jap kontributin tim financiar për këtë projekt, (i cili nga vlerësimet paraprake të miat nuk e kalon shumën 5 milion të reja). Duke besuar në përmbushjen e këtij detyrimi që i kemi qytetit tonë, mbetem me respekt!"

Gazeta 55, 15 mars 2008

III. 11. Solidarizim me dhimbjen e banorëve të Gërdecit

Tiranë më 18 mars 2008.

Deputeti i Vlorës, z.Bujar Leskaj solidarizohet me familjarët e viktimave të tragjedisë së dhimbshme të Gërdecit. Ai ka dhuruar gjak pranë ambienteve të Parlamentit Shqiptar, si dhe një donacion financiar-1000 USD pranë Raiffeisen Bank.

Njëkohësisht ai gjendet pranë në këtë dhimbje të madhe dhe u shpreh atyre ngushëllimet më të sinqerta për të dashurit e tyre të humbur.

(Nxjerrë nga njoftimi në web-in www. bujarleskaj.com)

III. 12. Ago Agaj, burrë shteti dhe intelektual i shquar

Vlorë, më 10 maj 2008

Klubi kulturor mbarëkombëtar "Ali Asllani", në bashkëpunim me deputetin Z. Bujar Leskaj, organizuan në ambientet e Pallatit të Kulturës "Labëria" (Skelë), takimin: Ago Agaj-patriot, burrë shteti dhe intelektual i shquar.

Takimi u hap nga sekretari i klubit "Ali Asllani". Mbi jetën dhe veprimtarinë e politikanit Ago Agaj foli intelektuali Reshat Kripa.

Deputeti i Vlorës, Bujar Leskaj mes të tjerash tha: "Në librin 'Lufta e Vlorës' të shkruar nga Ago Agaj thuhet se 'Tri herë në jetën time e kam ndjerë veten vlonjat: për Shpalljen e Pavarësisë, për Luftën e Vlorës dhe, më shumë për pritjen e muhaxhirëve, të cilën se kam parë më gjetkë në të gjithë fatkeqësitë, që i ranë më vonë kombit tonë përsipër". Ndërsa ne, sot shtojmë që ndihemi krenarë si vlonjatë, përpos të tjerash edhe për faktin që Vlora ka nxjerrë edhe patriotë e burra shteti të shumtë, midis të cilëve spikat Ago Agaj. Unë ndjej detyrim që, si deputet i këtij qyteti dhe si politikan, të vlerësoj figurën e Ago Agajt, që, në historinë tonë zë një vend të rëndësishëm. Ago Agaj është një personalitet i politikës shqiptare nga viti 1918-1945. Përveç kësaj, ai zhvilloi një veprimtari kulturore të spikatur në kohën e mërgimit të gjatë politik antikomunist, kur, mërgata priste piskamën e lirisë përtej kohës me mjegull. Në këto vite, ai shkruan dhe kryeveprën e tij historike "Lufta e Vlorës, 1920". Në vitet 1930 ai spikat edhe me një veprimtari shkencore, duke qënë bashkëpunëtor i austriakut Ernest Novak, në hartimin e hartës gjeologjike të Shqipërisë. Ai punoi K/Agronom i prefekturës se Gjirokastrës, deri ne vitin 1937, por me ngjarjet e Delvinës, e njohur ndryshe si "Kryengritja e Delvinës" ku mori pjesë pjesërisht, u dënua me tre vjet burg.

Mbas vitit 1939, Ago Agaj, si shumë vlonjatë te tjerë, shkoi vullnetarisht për të punuar në Mitrovicë të Kosovës, ku kreu me sukses detyra të larta administrative, duke e quajtur "Kosovari nga

Vlora". Rregjimi komunist për 45 vjet i persekutoi vajzat dhe të afërmit e patriotit, intelektualit Ago Agaj".

Këtë takim e përshëndetën dhe familjarë të Ago Agajt dhe qytetarë të tjerë vlonjatë.

- Marrë me shkurtime nga gazeta 55
- Ky takim u pasqyrua nga televizionet lokale si: TV Vlora Channel, TV 6+1 Vlora , TV Fokus , TV Amantia.

III. 13. Çamëria – pengu dhe malli ynë.

Në Qafë-Botë shkova si përfaqësues i Vlorës.
64 vjet nga genocidi mbi popullsinë çame.

Vlorë më 25 Qershor 2008

27 Qershori i vitit 1944, shënon ditën kur në Paramithi dhe Çamëri u masakruan mijëra çamë dhe përmbi këtë popullsi rëndoi genocidi më i madh i realizuar ndonjëherë mbi popullsinë shqiptare të mbetur përtej kufijve të saj. Në qytetin e Vlorës, ku ka një komunitet të madh me popullsi çame, të shpërngulur prej vitesh nga toka mëmë e Çamërisë, u zhvillua një bisedë historike në një rrjet televiziv vendor, në TV "Vlora Channel" me deputetin e Vlorës Bujar Leskaj, prof. Bardhosh Gaçe, Bujar Shurdhin (përfaqësues i komitetit çam). Emisioni u drejtua me mjaft profesionalizëm nga gazetari Harilla Koçi.

Deputeti, Bujar Leskaj, i cili çdo vit merr pjesë në pelegrinazhin homazh që organizohet nga komuniteti çam në Qafë-Botë, mes të tjerash u shpreh: " Masakra e 27 qershorit të viti 1944, ishte e orientuar më herët, nga Zerva, përfaqësues i qarqeve ekstremiste greke. Mirëpo ka edhe një shikim më të qartësuar sipas të cilit, ajo ishte frytëzim i një politike antishqiptare që qarqet greke të asaj kohe të errët, kishin filluar kundër shqiptarëve. Që kur zuri fill Lufta e Dytë Botërore, gjenerali famëkeq në bashkëpunim me ushtrinë pushtuese gjermane, ndërmori genocidin më të rëndë karshi popullsisë çame, që jetonte në trojet e veta. Ndërkohë, ajo që duhet cilësuar është përdorimi i forcës ushtarake kundrejt një popullsie të pambrojtur dhe në pabesi. Në skakierën politike të kohës, gjenerali Zerva dinte t'i fshinte qëllimet e mirëfillta të genocidit, ndërkaq ajo që ishte ideuar më parë në vitet 1942 - 1943, përfundoi diku tek viti 1945. Sulmi dhe masakra e Paramithisë dhe përmbi fshatra të tjerë, në çdo këndvështrim, ishte genocidi më i pashembullt kundrejt një populli autokton, i cili, gjithashtu po e luftonte pushtuesin. Masakra e vitit '44 tha deputeti Leskaj, u ndërmor nga Zerva, mirëpo rrënjët

duhen kërkuar në vitin '40, aty kur Italia fashiste nisi pushtimin e Greqisë. S'duhet të kemi një kujtesë të shkurtër. Udhëheqësit e Çamërisë, qysh nga vitet 1900 e në vijimësi, janë përpjekur të mos bien në grackën e qarqeve ekstremiste, provokative greke. Të tillë udhëheqës si, Musa Demi, gjatë Luftës II –të Botërore, bënë përpjekje që popullatat çame të mos përfshiheshin në partinë fashiste, por të inkuadrohen në brigadat antifashiste. Heroi i Popullit, Ali Demi, rënë në Kaninë, brigada partizane si "Çamëria" etj, janë formacione që tregojnë ekzistencën dhe përpjekjet e saj për qëndresë ndaj pushtuesit. Unë dëshiroj të sjell në epiqendër të vëmendjes etapat e masakrës kundrejt popullatës, si një organizim i qarqeve ekstremiste të kohës. Stacioni i parë daton aty rreth viteve 1913 - 1914, kur, krahina shqiptare e Çamërisë mbeti jashtë kufijve, prerë kirurgjikisht, copëtuar e masakruar nga genocidi. Etapa e dytë u përket viteve 1923 – 1926, kur, filluan të shkëmbejnë grekërit me turq, kur qarqet filluan t'i paraqesin shqiptarët si turq. Etapa e tretë i përket Luftës së Dytë Botërore në vitet '44-'45 me Zervën. Në këtë moment, filloi periudha finale e genocidit, e cila shkaktoi rrudhje të popullsisë çame në trojet e veta, aq sa në vitet '47-'51 kishin mbetur fare pak. Etapa e fundit u përket viteve 1945 - 1949, kur, shteti grek përballej me Luftën Civile. Pikërisht në këtë kohë, reaksioni fqinj ka qenë më i ashpri, më mizori, mirëpo edhe qëndresa ka qenë më e organizuar, më e orientuar ndaj peripecive kombëtare. Lidhjet e Vlorës me Çamërinë kanë një zanafillë të hershme. Duke lexuar librin e Hajredin Isufit për patriotin Musa Demi, përcaktohet se, këto lidhje ndërfuten në veprimtaritë patriotike të viteve 1900. Në vitin 1905 patriotë të qytetit të Vlorës, si Ibrahim Abdullai, gjejnë strehë tek vëllezërit Demi në Filat, ku shkuan për shkak të përndjekjeve turke. Në 1910, sërish I.Abdullai dhe të tjerë patriotë, bashkohen në Filat. Kryeministri I.Qemali, ka pritur në takim vëllanë e madh të Musa Demit dhe e ka udhëzuar për masa mbrojtëse të Janinës, si dhe në vitet 1919, 1920, 1924, lidhjet vazhdojnë edhe në vitet 1930 - 1940, kur fillon Lufta e Dytë Botërore. Ka pasur shumë qytetarë çamë në përkrahje të luftës dhe pjesëmarrës në të si antifashistë por, që fshihen nga historianët, nga një dorë e padukshme. Madje, për të kuptuar largpamësinë e disa prej tyre, po përmend Musa Demin, të cilit iu bë një ofertë nga Lef Nosi në vitin 1943-'44, për t'u futur në qeveri, mirëpo ai nuk e pranoi. Shumë çamë janë inkuadruar në luftën kundër pushtuesit. Kemi edhe këtë fakt; në shtator të vitit 1945, rreth datës 23, u organizua në qytetin e Flamurit, në Vlorë, Kongresi çam, i cili zgjodhi Komitetin që i drejtoi politikisht në zhvillimet e mëtejshme të rregjimit që fitoi luftën. Mirëpo, patriotë të kësaj

popullate si, Musa Demi, u konfrontuan edhe me regjimin e ri që po vendosej në vendin tonë pas vitit 1945, kur kishin filluar goditjet dhe këta nuk mund të bënin përjashtim. Ky komitet ju drejtua E.Hoxhës me kërkesën që, për dënimet duhej marrë edhe mendimi i këtij organizmi, ku shumë prej tyre, pra prej qytetarëve çam, s'duheshin dënuar me akuza të pabaza. Krahina e Çamërisë është një krahinë autoktone shqiptare, ka traditat, gjuhën, doket, zakonet, është një zonë e pasur dhe e bukur. Dhe besoj se konflikti lindi edhe për këtë, duke krijuar xhelozinë e atyre qarqeve, që nxituan të ndërmarrin genocidin, duke i shpërngulur me forcë dhe duke i maskuar krimet nën petkun fetar e politik. Udhëheqësit e Çamërisë kanë treguar një zgjuarsi të pashoqe. Ata kanë treguar se nuk janë turq. Madje, në vitet '30 me ansambletë e tyre kulturore, kanë parakaluar në Athinë. Mirëpo historia është treguar e ashpër me Çamërinë, duke mos i ndjerë rënkimet e saj. Ndërsa indiferenca ndërkombëtare, ka qenë inkurajuese për qarqet greke, që të ndërmerrnin ofensivën kundër popullsisë çame. Veçoj një fakt. Kur popullata çame u përzu me zjarr e hekur, me masakër, përtej shpresës së humbur, të shpërngulur nga tokat e tyre, ajo është mirëpritur në vendet ku është vendosur, si në vitet 1913 - 1945, ndonëse vendi ishte në pragçlirimi. Por, rregjimi komunist nuk ka qenë aq dashamirës me çamët. Komiteti çam kërkoi që, në Konferencën e Paqes në Paris, në vitin '46, kjo popullsi të kishte përfaqësuesin e vet, për të rrëfyer me fakte e dokumente genocidin. Musa Demi dhe patriotë të tjerë ishin përgatitur me filmime e dokumente, që të shkruanin atë histori masakre, por, rregjimi i pengoi. Dhe, që atëherë, ai filloi të godiste çamët me format dhe mënyrat e tij, me rrugët që di të zgjedhë një regjim diktatorial, hapur apo fshehtas. Madje, ndaj kësaj popullsie u krye edhe një përndjekje tipike kriminale komuniste. Kështu cilësohet komploti i emërtuar: "Komploti i Teme Sejkos", një akuzë false ndaj atyre që u dënuan. Dua të përmend gjithashtu, politikanë të kohës të viteve 1930 si, Mit'hat Frashëri, që akuzoi ministrin e tij për mosndihmë për Çamërinë apo, Musa Demin, që akuzoi Enver Hoxhën rreth viteve 1950. Në përkujtim të kësaj masakre, vitin e shkuar në kufirin e sotëm ndarës në Qafë-Botë, shkuan rreth 10 mijë veta, por edhe katër deputetë të parlamentit shqiptar. Pra, sot po regjistrohet sinergjizimi i përpjekjeve të politikës shqiptare më ato evropiane dhe ecjen sipas rrjedhave të tyre edhe për zgjidhjen e këtij problemi".

Bisedën e pasuroi dhe plotësoi historikisht, historiani i shquar i qytetit të Vlorës, Bardhosh Gaçe.

Deputeti Leskaj tha ndër te tjera se, si djalë i Vlorës dhe deputet

i këtij qyteti, kishte shkuar dhe do të shkoj çdo vit, në pelegrinazhin e popullsisë çame në Qafë Botë, për të përkujtuar kohën e shkuar, genocidin mbi një popullsi të pambrojtur, si dhe për të respektuar baashkëqytetarët e miqtë e tij me origjinë nga krahina e bukur e Çamërisë.

Gazeta 55, 26 qershor 2008, Gëzim Llojdia

Marrë me shkurtime nga biseda në TV "Vlora Channel"
Për më gjerë shih web-in: www.bujarleskaj.com

III. 14. Profil - Një ditë në zyrën e deputetit, Bujar Leskaj

Tiranë 06 Tetor 2008

Është e çuditshme, por një realitet. Vetëm në datën 5 Tetor 2008, deputeti i zonës Nr. 94 Vlorë, Bujar Leskaj, ka pritur në takim mbi 40 qytetarë të këtij qyteti. Përpara mbërritjes sonë në zyrën e vogël të deputetit, në mjediset e Këshillit të Qarkut Vlorë, qytetarët e fundit në listën e pritjes ishin disa hallexhinj nga lagjia "Partizani", në qytetin e Flamurit.

Ja disa nga kërkesat që qytetarët i shtruan deputetit të zonës së tyre - M.M ngriti problemet në rrugën "Transballkanike", një qytetar, probleme ndihme. Një ish-shofer i larguar nga reforma, kërkonte të kthehej në një punë shteti. Një agronom ngre propozim që, në Armen të ngrihej një bust i patriotit Osman Haxhiu. Një propozim tjetër ishte, për të shpallur "Qytetar Nderi" mjekun e shquar në dekada të këtij qyteti Dr.Fllokon. M.P, veteriner, për punësim; P.XH probleme në arsimim; B.A oficer policie, përfunduar shkollën e histori-gjeografi...lista zgjatej dhe limiti i saj përfundonte tek Nr 40. Unë, si gazetar, "harxhova" disa orë duke qëndruar në pritjen e deputetit. Në këtë pritje, ajo që arrita të kap ishte se nuk vinin vetëm të djathtë që i përkisnin forcës së tij politike. Edhe nga krahu tjetër, mes tyre njerëz të thjeshtë që kërkonin një zgjidhje, mbasi cikli i lodhur i burokracive ua kishte nxirë jetën.

Kjo mënyrë pritjeje e deputetit të Zonës Nr 94, në qytetin bregdetar, ka filluar që pas zgjedhjeve të vitit 2005. Zyra e deputetit në katin e dytë, në Këshillin e Qarkut, qëndron përherë e vazhdimisht e hapur. Mesazhi i zbërthyer është se, deputetët janë njerëz që përfaqësojnë popullin dhe zëri i tyre duhet të ndihet në Kuvendin e Shqipërisë. Dhe ky zë, nëpërmjet deputetit të tyre ka shkuar në kuvend, në qeveri, në pushtetin komunal, kur është fjala për interesa të qytetarëve. Nuk mund të thuhet se "mulliri' i ëndrrave" të një zone elektorale", ngeci në vend pas zgjedhjeve

elektorale të vitit 2005. Shenjat e një korrektësie, në pritjen dhe në kërkimin e zgjidhjes së problemeve të qytetarëve, mbetet prezente në takimet e këtij deputeti në zonën Nr 94. Kjo frymë, tregon se deputetët e PD kanë një shans më tepër për të shfaqur se çfarë kanë bërë për zonë e tyre elektorale. Mirëpo, soç saktëson edhe sekretarja e Leskajt, ajo që duhet theksuar është se, mbi 80 % e kërkesave të adresuara deputetit, kanë shkuar në rrugëtimin e zgjidhjes së shpejtë. Nuk ka ngurosje në orët e pritjes së deputetit, për të zgjidhur qytetarët. Ftohtësinë që qytetarët ndeshin nëpër dyer të administratës dhe gjuhën e mosmirëkuptimit dhe gurëve në trastë, nuk e gjen në këtë derë të përfaqësuesit të popullit. Fundi i orëve për deputetët selimbyllur do të bjerë shumë shpejt, sidomos për ata të krahut opozitar, ndërkohë që harresa do të jetë dhimbja më e madhe për ata vetë dhe për popullin, që i zgjodhi. Nuk ka këtu fjali të pakuptueshme, por një realitet që të zë syri; pritjen e popullit në orët që deputeti ka në fundjavën e tij.

Botuar në gazetën 55, dt. 06/10/2008 nga Gëzim Llojdia

Shënim: *Shkrimin e mësipërm e vendosa në respekt të qytetarëve vlonjatë që më kanë besuar problemet e tyre, të gazetës që e ka botuar, të gazetarit të nderuar, si dhe të kohës së kushtuar takimeve me popullin. Me një përafërsi, vetëm në zyrën e deputetit, për çdo vit të mandatit katërvjecar kam pritur e kam biseduar për problemet e tyre, të komunitetit e më gjerë, me mbi 1500 veta (në çdo muaj kam zhvilluar mesatarisht tre takime me afërsisht 40 qytetarë në çdo takim në zyrën e deputetit).*

III. 15. Përkujtohet Klubi i Shqiptarëve "Labëria", në 100 vjetorin e krijimit të tij

Deputeti Leskaj: Ky klub atdhetarësh, ishte një shtyllë e fortë për Pavarësinë Kombëtare

*Vlorë, më 29 Tetor 2008***.**

Në Pallatin e Kulturës "Labëria", Vlorë, u organizua sesioni jubilar "Vatër lufte dhe kulture për liri e pavarësi", kushtuar Klubit të Shqiptarëve "Labëria", me rastin e 100 vjetorit të krijimit të tij. Referuan: Istref Dobi, Petrit Velaj, Prof.Dr. Bardhosh Gaçe, Drita Shehu dhe Dr. Novruz Bajrami.

Në këtë sesion jubilar përshëndeti edhe deputeti Bujar Leskaj, i cili ndërmjet të tjerash theksoi: "Gjithkush mund të bëjë pyetjen: pse u shpall Pavarësia Kombëtare në Vlorë?! Pavarësia Kombëtare në Vlorë u shpall sepse përpos faktorëve të tjerë politikë, ishte Klubi Atdhetar "Labëria", i cili kishte shumë degë dhe nëndegë të tij dhe kishte përgatitur qysh më përpara terrenin për këtë akt, i cili nuk ishte një akt i thjeshtë, por një proces i tërë veprimtarish kulturore, politike dhe patriotike. Ky proces, që e pat marrë hovin e vet në Rilindjen tonë Kombëtare, filloi punën e tij konkrete drejt Pavarësisë, qysh me thirrjen e Ismail Qemalit drejtuar popullit : "Të gjithë sa jemi shqiptarë, të mëdhenj e të vegjël, të pasur e të varfër, pleq dhe të rinj, duhet të bashkohemi dhe të çojmë vendin përpara, në rrugën e qytetërimit dhe të përparimit, duke i treguar Evropës se shqiptari ka mbetur gjithmonë evropian në gjak dhe se nuk dëshiron gjë tjetër, veçse të forcojë kombësinë e tij dhe të qytetërohet".

Më tej, deputeti Leskaj, duke falenderuar organizatorët e sesionit jubilar, Bashkinë Vlorë, Qendrën Kulturore dhe muzeun e qytetit tha se, "është e rëndësishme që ne, në qytetin e Vlorës, jo vetëm të jemi krenarë për këta patriotë të Klubit Atdhetar "Labëria" dhe të deklamojmë veprimtarinë e tyre atdhetare, por duhet të vlerësojmë edhe studiuesit e sotëm si p.sh. Prof. Bardhosh Gaçen,

etj, të cilët mbajnë gjallë frymën kombëtare dhe vlerat më të larta të kombit tonë."

Edhe mbas 100 vjetësh, Klubi atdhetar "Labëria", me gjurmët e thella që la në ndërgjegjen tonë kombëtare, mbetet krenari kombëtare. Ai u themelua më 1908, si rezultat i zgjerimit të veprimtarisë kombëtare të klubeve dhe shoqërive kombëtare siç janë, Klubi i Manastirit, Klubi i Filatit - Çamëri, shoqëritë shqiptare të Bukureshtit, Sofjes, Kajros, Stambollit dhe Bostonit. Edhe pse kanë kaluar100 vjet edhe pse u shpall jo vetëm Pavarësia Kombëtare, por edhe ajo e Kosovës, përsëri idealet kombëtare të Rilindasve dhe pas-rilindasve të kombit tonë, nuk janë realizuar tërësisht. Ky sesion jubilar është dëshmi e këtyre idealeve, por edhe një premtim se, për kombin dhe atdheun, duhet bërë më shumë. Atëherë do të jenë të gjalla ato fjalë që u shkruan në gazetën "Rrufeja", në Prill të 1909 :

"Rrofshin dhe lulëzofshin shqiptarët e Vlorës, se kësaj here punuan si trimat e vjetër...Trimëresha Vlorë edhe me gjakun e saj përgjigjet, kur është fjala për mbrojtjen e Atdheut."

Marrë me shkurtime nga gazeta 55

III. 16. Vlora dhe Bujar Leskaj, nderojnë 13 krijues vlonjatë për vitin 2008

Vlorë më 23 Nëntor 2008

Me një nismë të drejtpërdrejtë të deputetit të Vlorës, ish ministrit të MTKRS, z.Bujar Leskaj, janë nderuar disa nga personalitetet vlonjate, për krijimtarinë e tyre gjatë vitit 2008. Në një ceremoni të veçantë e festive, të zhvilluar këto ditë në një nga sallat e Pallatit të Kulturës "Labëria", të Vlorës, 13 krijues të këtij qyteti u nderuan me çmime, për veprimtarinë e zhvilluar gjatë vitit 2008. Duhet thënë se, janë nderuar njëherësh edhe 13 figura të tjera që nuk janë më, që kanë dhënë kontributin e tyre ndër vite e që, sot, janë në krye të elitës vlonjate dhe që një pjesë e mirë e tyre janë ikona të artit e kultures sonë kombëtare.

Çmimet e dhëna nuk ishin thjesht çmime, por ato mbajnë edhe emrin e këtyre personaliteteve të shquara. Kjo ceremoni, ku morën pjesë dhjetra artdashës, artistë dhe figura të njohura të qytetit, organizuar nga dega e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Vlorës (në fakt LSHA të Shqipërisë nuk ekziston më, por, në Vlorë, në Fier, në Elbasan, në Durrës, në Korçë e ndonjë qytet tjetër, kjo strukturë e ngritur që vite më parë, funksionon ende, falë përpjekjeve dhe dashamirësisë së drejtuesve), u zhvillua në nderim të Kosovës, në vigjilje të 96-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë dhe në kujtim të 24 nëntorit, ditëlindjes së shkrimtarit të shquar, Petro Marko.

Shkrimtari, Albert Abazi, sekretar i kësaj Lidhjeje, falënderoi deputetin e Vlorës, Bujar Leskaj, i cili mundësoi këtë aktivitet dhe sponsorizoi 13 çmimet e dhëna me këtë rast. Ai theksoi se, "nuk është hera e parë që z. Leskaj organizon e nderon figura të tilla, jo vetëm në rang lokal, por kujtojmë se edhe kur ishte ministër, u nderuan jo pak figura, u zhvilluan shumë aktivitete me mbështetjen e MTKRS, si dhe u dhanë çmime e tituj, me propozim të vetë z. Leskaj".

Çmimet që u dhanë në këtë ceremoni ishin si më poshtë: - Në fushën e teatrit, u dha çmimi "Nazmi Binjaku", në nderim të

themeluesit të teatrit të Vlorës, një regjisor me kontribute të çmuara, i cili u nda nga jeta pak vite më parë. Ky çmim iu dha, për kontribut të vlefshëm në Teatrin e Vlorës, aktorit Vaso Goda, një artist i nderuar, me kontribute të shumta në skenë e kinematografi.

Çmimi "Vasil Talo", për portretin më të mirë në pikturë, iu dha Edi Kojanit; çmimi "David Selenicasi", për kompozimin më të mire në pikturë, iu dha Ticiana Fejzullahut; çmimi "Sadik Kaceli", për peizazhin më të mirë, iu dha Koço Zhezhës; çmimi "Themistokli Mone", për kompozimin muzikor më të mirë, iu dha Viktor Rrapushit, për këngën "Të lodrojë Prishtina, Vlora dhe Tirana"; çmimi "Eqerem Vlora", për memorialin, punimin bibliografik më të mirë", iu dha publicistit Gëzim Llojdia, për librin "Amantia-një ndërtim ilir nga më të rrallët në Ballkan"; çmimi "Ferhat Çakërri", për librin më të mirë për fëmijë, iu dha shkrimtarit Bardhosh Gaçe, për vëllimin poetik, "Pranvera i dërgon letër baba Dimrit"; çmimi "Janko Pali", për përkthimin më të mire në prozë, iu dha Liljana Zogës, për përkthimin nga anglishtja të romanit "Stuhi dashurie" të Nicholas Sparksit; çmimi "Kudret Kokoshi", për përkthimin më të mirë në poezi, iu dha Laureta Petoshatit, për përkthimin nga shqipja në anglisht të "Soneteve", të Ali Asllanit"; çmimi "Nermin Vlora Falaschi", për publicistikën eseiste më të mirë, iu dha publicistit Shkëlqim Zotaj, për sprovën "Tipologjia e lirikës së Ali Asllanit"; çmimi për poezinë më të mirë, iu dha Albert Abazit, për vëllimin poetik "Mërgata e Luleve"; çmimi "Petro Marko", për prozën më të mirë, iu dha Çlirim Hoxhës, për romanin "Nëndetësja e plagosur".

Marrë nga shtypi i kohës. Gazeta 55, 26.11.2008
(nga Flori Slatina)
Aktiviteti u pasqyrua gjerësisht në televizionet lokale

III. 17. Përurimi i librit të shkrimtares Vilhelme Vranari

Në qytetin e Flamurit, në kuadër të festave, klubi kulturor "Ali Asllani" nën kujdesin e deputetit të Vlorës, Bujar Leskaj, përuroi librin, "Unaza e prangosur", e shkrimtares Vilhelme Vranari (Haxhiraj). Përshëndetën, kryetari i klubit kulturor "Ali Asllani", Q.Meminaj, këshilltari i kryeministrit, Petraq Milo.

Në përshëndetjen e vet, deputeti i Vlorës, Bujar Leskaj, që ka mbështetur të gjitha veprimtaritë kulturore të këtij qyteti, nënvizoi: "Nëse Gjirokastra ka Musine Kokalarin, qyteti ynë ka bijën e vet, Vilhelmen, të cilën, pa druajtje e kemi quajtur "Musine Kokalari e Vlorës". Me këtë thënie të 2 viteve më parë, unë personalisht parashikova se, kjo krijuese e mirëfilltë e letrave, padyshim mbetet ndër autoret dinjitoze në letërsinë shqiptare.

Arti nuk mbruhet vetëm në kryeqendër të vendit. Qyteti ynë, Vlora, ka një zë brilant. Qyteti ynë, tashmë njihet edhe nga krijuesit e letrave shqipe, për të cilët unë do të mundësoj çdo vit 13 çmime. Por, qyteti ynë tashmë ka një emër të madh si Vilhelme, një shkrimtare që meriton më shumë vëmendje, nderim dhe respekt.

Si do t'i gjykoja prurjet e kësaj autoreje? Në letrat shqipe, Vilhelme " ka bujtur" në dhjetëvjeçarin e fundit, banore e kësaj rrugine me një mendjemprehtësi të çuditshme, nuk priti në kohë, por kërkimi i saj zgjoi ëndrrën në shpirt, për të rrugëtuar krahas emrave brilantë të letrave shqipe. Nuk ka formulë të fshehtë, por kërkim të përhershëm dhe zgjime poetike, për të gjetur poezinë e shpirtit. Kërkimet e saj janë rrëfime fantastike, që mbërrijnë deri në thellësi të labirinteve. Goditjet e kometave krijuan botën, ndërsa pena e shkrimtarëve dhe poetëve, mes tyre, Vilhemës, mbrujtën letërsinë shqipe. Krijimi tek kjo shkrimtare, është i mbarë dhe, më tej, për të shkuar tek romani. Një krijim tepër i arrirë, me dialog dhe rrëfime interesante. Nga kapitulli në kapitull ndërtohen fjali dhe vizatohen ngjarje, pikturohen skena familjare, që, në çdo shpirt lënë gjurmë. Është mjeshtre e ndërtimit të fjalisë. Skalit karaktere dhe gjen personazhe të habitshëm, që lëvrijnë e zukasin nëpër historinë tonë, historinë e traditën vlonjate.

Marrë me shkurtime nga gazeta 55, Republika, Ndryshe, etj.

III. 18. Pritje zyrtare me rastin e 28 Nëntorit

Mbi 300 të ftuar morën pjesë në pritjen që dha deputeti i zonës Nr. 94 të qytetit të Vlorës, z. Bujar Leskaj, zonë, e cila përfshin lagjet e vjetra të këtij qyteti historik.

Ky është takimi – pritja zyrtare që deputeti organizon çdo vit, me rastin e festës së madhe të Pavarësisë. Pritja u zhvillua në mjediset e hotel "Vlora", në Sheshin e Flamurit. Ishin të ftuar njerëz të shquar të qytetit, qytetarë të thjeshtë dhe kryetarë seksionesh të Partisë Demokratike. Morën pjesë edhe prefekti i Vlorës z. Hasan Halili, Kryetari i qarkut z. Agron Sharra, deputeti z. Ardian Kollozi, Kryetari i Nën Degës së Partise Demokratike, zona 94 z.Shkelqim Alimerko, Sekretarja e Nën Degës Laureta Bejkosala, Sekretare e PD-së Barie Isufi, Nënkryetari i PDI-së Dashamir Tahiri, etj.

Në fjalën e mirëseardhjes, z. Bujar Leskaj u tha të pranishmëve se, "qyteti historik i Vlorës mbledh kujtimet më të shquara nga ditët e vjeshtës së tretë. Nuk mund të rrimë pa i përkujtuar ditët që bënë histori dhe, për më tepër, krijuan shtetin tonë shqiptar". Më pas, deputeti, Bujar Leskaj, u dhuroi të pranishmëve rreth 300 libra. Ndër to, ishin libri i autorit, Sabri Hamiti, për figurën e madhe të Gandit kosovar, Ibrahim Rugova dhe ai i autorit Uran Butka për Mit'hat Frashërin.

Edhe në fundjavë, deputeti Leskaj mblodhi gazetarët e qytetit historik, në një darkë të zhvilluar në një nga lokalet e bregdetit jugor. Nga deputeti, gazetarëve iu dhuruan libra të ndryshem.

Botuar në gazetat 55, Republika,
Hermes – Itali dhe Fjala e Lirë - Angli
Kronikë në TV Vlora Channel, TV 6+1 Vlora ,
TV Amantia, TV Fokus

III. 19. Festimi me 300 të rinj nga Vlora, i Ditës së Rinisë

Vlorë më 8 Dhjetor 2008

Deputeti i Vlorës, Bujar Leskaj, ka organizuar dje në mjediset e vila "Toskana", në Tiranë, një takim me mbi 300 të rinj dhe të reja të qytetit të Vlorës, me rastin e Ditës së Rinisë.

Në fjalën e tij para të rinjve dhe në prani të kryetarit të degës së PD-së, për rrethin e Vlorës, Agron Sharra dhe kryetarit të Forumit Rinor Hysni Sharra, deputeti Leskaj theksoi se, Partia Demokratike vlerëson dhe çmon afrimin e të rinjve, jo vetëm si një proces që do t'i shërbejë rigjenerimit të brezave në vazhdimësi e që do të japin kontributin e tyre, duke ngritur lart vlerat që mbart PD-ja, por, njëherazi, duke ruajtur dhe respektuar identitetin e saj, si forcë politike, themeluese e lirive të shqiptarëve dhe avokate e të drejtave të popullit shqiptar. Deputeti Leskaj, vlerësoi 8 dhjetorin si ditën e lirive të mëdha, si ditën që shënoi mposhtjen e sinonimit të së keqes me emrin komunizëm dhe hedhjen e themeleve të demokracisë dhe pluralizmit politik. Ndaj, tha ai, Partia Demokratike çmon veprën e të rinjve dhe konsideron të rëndësishëm procesin e afrimit të tyre, fillimisht në strukturat e forumit, të cilat kanë një meritë të veçantë në sajë të vullnetit dhe kontributit që japin për PD-në, si në proceset zgjedhore, ashtu edhe në proceset madhore të zhvillimit të vendit.

Të rinjtë e ardhur posaçërisht nga Vlora, ishin të shoqëruar nga një përfaqësi intelektualësh të qytetit dhe sigurisht edhe të rrethinave të saj. Teserat e anëtarësimit të 300 të rinjve, u shpërndanë nga kryetari i degës së PD-së, të rrethit Vlorë Agron Sharra, kryetarja e Forumit te Gruas Demokrate, Nexhi Xhuveli, etj.

Ndërkohë që mbetet për t'u shënuar se, mbi 20 të rinj nga Lumi i Vlorës shpallën krijimin e Forumit Rinor të Partisë Demokratike, për këtë zonë. Të rinjtë e pranishëm në takimin e organizuar nga deputeti Bujar Leskaj, ishin nxënës të shkollave të mesme, si "Ali Demi", "Halim Xhelo", kolegjit "Mustafa Qemal Ataturk" dhe të shkollës së mesme të komunës Kotë-Drashovicë, "Ali Asllani".

Botuar në Gazetën 55, dt. 9 Dhjetor 2008

III. 20. Një shembull që vlen të nderohet

Athinë 12 Dhjetor 2008, Gazeta "Tribuna".

Ka 5 vjet që në Greqi botohet në gjuhën shqipe gazeta:" Tribuna". Ajo është një gazetë e përjavshme informative e pavarur, që ka edhe një numër të madh abonimesh dhe drejtohet nga emra të njohur të gazetarisë shqiptare në Athinë, si dhe ka një grup bashkëpuntorësh dhe shkrimtarësh shqiptarë që punojnë në Athinë, të cilët e mbajnë gjallë me të gjitha fushat madje është edhe tepër cilësore me shkrimet e saj dhe problematikën që rrok. Në nr. e saj të 251, të premten, shkruante Iliaz Bobaj artikullin "Një shembull që vlen të nderohet".

Fakti është ky: Në kuadrin e Festës sonë Kombëtare, në Pallatin e Kulturës ''Labëria'', të qytetit të Vlorës, u organizua aktiviteti i madh kulturor: ''Vlora përshëndet Kosovën''. Ky aktivitet, sipas medias, pati një diapazon të gjerë kulturor e kombëtar. Me të ftuar nga Shqipëria dhe Kosova. Ju lumtë artistëve vlonjate, që dinë të organizojnë dhe të shpërfaqin vlera të tilla kapacitive ! Por kjo është njera anë. Unë dua të ndalem tek një pjesë e këtij aktiviteti që la gjurmë. E inkuadruar brenda këtij aktiviteti, si pjesë organike e tij, ishte edhe ndarja e çmimeve letraro-artistike për krijuesit vlonjatë. Këtu kemi të bëjmë me një fakt interesant, që duhet përshëndetur veçanërisht. U ndanë 13 çmime letrare-artistike për krijuesit vendorë.1. Çmimi ''Nazmi Binjaku'', për kontribut në teatrin e Vlorës. 2. Çmimi "Vasil Talo'', për portret në pikturë. 3. Çmimi ''David Selenicasi'', për kompozim në pikturë. 4. Çmimi ''Sadik Kaceli'', për peizazh në pikturë. 5. Çmimi ''Themistokli Mone'', për kompozim muzikor. 6. Çmimi ''Eqerem Vlora'', për memorial publicistik.7. Çmimi ''Ferhat Çakërri'', për letërsi për fëmijë. 8. Çmimi ''Janko Pali'', për përkthim në prozë. 9. Çmimi ''Kudret Kokoshi'', për përkthim në poezi. 10. Çmimi ''Nermin Vlora Falaschi'', për publicistikë eseiste. 11. Çmimi ''Shevqet Musaraj'', për krijim letrar satirik. 12. Çmimi ''Ali Asllani'', për vëllim me poezi. 13. Çmimi ''Petro Marko'', për prozën më të mirë.

Këto çmime, kanë një gjeografi emrash të trevave vlonjate për t'u patur zili. Janë përjetësuar emrat e krijuesve vlonjatë, duke u dhënë atyre hapësirën e pavdekësisë. (Është tjetër gjë p. sh. nëse duhet shtuar emri i të nderuarit Odhise Grillo dhe i ndonjë tjetri. Besoj se kjo duhet të jetë një temë diskutimi për vlonjatët në vijim). Përsëri them:ju lumtë vlonjatëve, që dinë të nderojnë bijtë e tyre. Kështu kanë nderuar edhe veten. Por u kanë dhënë edhe të tjerëve një shembull. Është një shembull i mrekullueshëm ky. E veçanta tjetër. Të 13 çmimet e mësipërme i sponsorizoi deputeti i Vlorës, Bujar Leskaj. Tjetër shembull ky. Një shembull i mrekullueshëm i një politikani. Por, mbi të gjitha, e një biri vlonjat. I një deputeti, që tregon me vepra se e do dhe e nderon artin dhe kulturën e qytetit të vet. Po aq sa tregon se është edhe vet njeri me kulturë. Nuk e njoh personalisht zotin Bujar Leskaj. Por, kjo nuk më prish aspak punë, për ta falënderuar sinqerisht. Kur ka nderuar krijuesit vlonjatë, na ka nderuar të gjithëve ne, krijuesve. Unë ndihem njëlloj sikur ka sponsorizuar edhe për mua. Edhe të tjerët. Nuk ka rëndësi se kush i ka marrë çmimet. Rëndësi ka veprimi i tij shumë domethënës. Pak më tej. Këtë shembull mendoj se mund ta marrin edhe rrethet e tjera të vendit, disa prej të cilave në këtë pikë, janë pak më pak se asgjë. Nuk besoj se nuk është edhe aq e vështirë për të marrë dhe përhapur shembullin e deputetit vlonjat. Kudo ka biznesmenë, që nuk besoj se do të zbrazin xhepat po të sonsorizojnë ''dy qindarka'' për kulturën e vendit të tyre.

E njëjta gjë po ndodh edhe këtu në emigracion. Kanë 18 vjet krijuesit shqiptarë që krijojnë këtu në Greqi, por askush nuk e ka zgjidhur qesen për ta. Disa konkurse të shpallur këtu, japin ca pllaka ''të arta'' e ''të argjendta'' me bujë e rrëmujë, thjesht për t'u dukur se diçka bëjnë edhe ata. Natyrisht, nuk është faji i tyre që e kanë qesen bosh. Faji i tyre është se duan ta bëjnë teneqenë "flori". Në këtë pikë, mendimi im i prerë është ky. Çdo vit, me krijuesit e shumtë emigrantë shqiptarë, këtu, duhet të ketë konkurs vjetor në të gjitha gjinitë. Mendimi im është që, në këtë pikë të ndihmojë Ambasada jonë në Athinë. Edhe në organizim. Edhe duke sponsorizuar, të paktën një pjesë të çmimeve. Nga ana tjetër, ajo mund të bashkëpunojë edhe me biznesmenët shqiptarë këtu dhe në atdhe. Koha ka treguar se organizmat e vogla letraro-artistike, tërësisht të ndara nga njera-tjetra, nuk ia kanë dalë dhe as që pritet t'ia dalin mbanë ndonjëherë kësaj pune. Atëhere, le të bëjmë diçka tjetër, më të mirë se kjo që kemi bërë deri tani.

III. 21. Konferenca e VII studentore mbi Ekonominë

Vlorë më 21 Dhjetor 2008

Është zhvilluar sot në Vlorë, Konferenca e VII studentore, "Ekonomia Shqiptare, përballë zhvillimeve ndërkombëtare". E kthyer tashmë në një traditë nga studentët e Fakultetit të Ekonomisë, Tiranë, anëtarë të klubit "Financieri i së Ardhmes", kjo konferencë kishte në fokus zhvilimet në ekonominë shqiptare përballë ndryshimeve ekonomike ndërkombëtare. Konferenca pati një pjesëmarrje të gjerë të qarqeve studentore në Vlorë e më gjerë. Pjesëmarrësit në konferencë referuan mbi tendencat në zhvillimet ekonomike në Shqipëri në 10 vjecarin e fundit, mbi zhvillimet ekonomike rajonale dhe shqiptare, mbi investimet e huaja direkt, zhvillimet i SME dhe progresin ekonomik, vendas dhe rajonal. Të tjera tema ishin mbi ndikimin që ekonomia shqiptare ka nga importi, ekonominë informale, krizën financiare botërore, përballë krizës globale financiare që ka kapluar botën. Kriza e karburanteve, parë në sferën dhe impaktin që ajo ka mbi ekonominë shqiptare, mbi krizën ushqimore, roli i organeve mbikqyrse mbi qëndrueshmërinë ekonomike. Studentë dhe ekspertë të ekonomisë në Shqipëri, folën mbi sistemin financiar dhe kërkesat e zhvillimit ekonomik të vendit, mbi mënyrën e evoluimit të risqeve dhe sistemin bankar shqiptar. Perspektivat e zhvillimit ekonomik të vendit, sistemi i sigurimeve, e të tjera tema interesante, ku pjesëmarrësit në auditor dhe referuesit, u përpoqën të hidhnin dritë mbi atë që përfaqëson ekonomia shqiptare momentalisht, por edhe duke e krahasuar me zhvillimin e saj në vite.

Nderuan me pjesëmarrjen në këtë konferencë, Rektori i Universitetit të Tiranës Prof. Dr. Dhori Kule, Shefi i Departamentit të financës, Prof. Dr. Beshir Ciceri, si dhe Prof. Dr. Lavdosh Zaho, Prof. Dr. Sherif Bundo (profesori udhëheqës i studentëve të këtij klubi), Prof. Dr. Halit Xhafa, deputeti i Vlorës, Bujar Leskaj, pedagogë të Universitetit të Tiranës, Universitetit të Vlorës, studentë të Fakultetit Ekonomik të Tiranës e të Vlorës.

Dekani i Fakultetit të Ekonomisë, Prof. Dr. Omer Stringa në përshëndetjen e tij ndër të tjera u shpreh: "Do të desha t'ju falenderoja në emër të fakultetit dhe emrin tim, për punën që keni bërë në këtë drejtim dhe shpresoj që, në të ardhmen, kërkimi nga ana e studentëve do të njoh përmasa më të mëdha. Besoj që punimet tuaja, që do të paraqiten në këtë konferencë janë një ndihmesë modeste në fushën e kërkimit dhe, gjithashtu, jam i bindur që çdo studiues serioz, do të gjejë diçka me vlerë në këto punime. Në fund, do të doja të falënderoja sponsorin e vetëm të këtij aktiviteti, "ProCredit" Bank, me shpresën që, bashkëpunimi ynë do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Një falënderim i veçantë shkon edhe për deputetin e zonës dhe pedagogun e fakultetit tonë z. Bujar Leskaj, për kujdesin dhe mbështetjen e treguar".

Në fund të takimit, për studentët pjesëmarrës u dhanë çmime të ndryshme. Kjo konferencë është kthyer në traditë të përvitshme tashmë.

Marrë nga shtypi
Kronika u transmetua në TV 6+1 Vlora, TV Amantia, TV Fokus, TV Vlora Channel

III. 22. Konferencë shkencore "Ismail Qemali dhe Identiteti i shqiptarëve"

Vlorë më 23 Janar 2009

Në vigjilje të 165 vjetorit të ditëlindjes dhe 90 vjetorit të ditëikjes nga kjo jetë, të burrit më të shquar, patriotit dhe figurës më të ndritshme të kombit në shekullin e XX, Ismail Qemali, Këshilli i Qarkut Vlorë, Prefektura Vlorë, nën kujdesin personal të deputetit të Vlorës, zotit Bujar Leskaj, organizuan Konferencën Shkencore "Ismail Qemali dhe Identiteti i Shqiptarëve".

Në fjalën e hapjes së Konferencës, deputeti Bujar Leskaj theksoi: "Ismail Qemali, për ne është si një mal i lartë. Njerëzit e mëdhenj si ai, dalin rrallë. Ismail Qemal Vlora ky patriot, burrë shteti, themelues i Shtetit Shqiptar, ka hyrë me të drejtë në Panteonin e lavdisë shqiptare, për të mos vdekur kurrë. Unë sot e kam për nder që të lexoj në këtë konferencë një ese për Ismail Qemalin, të shkruar nga Dr. Ibrahim Rugova në vitin 1968, pra, kur ai ishte 24 vjeç, botuar në "Bota e re", Prishtinë në datë 28.12.1968. (Esen e lexuar mund ta shihni në: Intermexo III, faqe 346-347).

Përshëndeti Kryetari i Këshillit të Qarkut Vlorë, zoti Agron Sharra, i cili evokoi traditat më të mira patriotike të Vlorës dhe të viteve të Pavarësisë.

Prof. Dr. Koli Xoxe mbajti referatin kryesor për figurën poliedrike të Ismail Qemalit.

Prof. Dr. Kaliopi Naska, referoi temën: "Veprimtaria e Ismail Qemalit, në mbrojtje të tërësisë territoriale në vitet e fundit të jetës". Mbarë shqiptarët, kudo që janë, e kujtojnë me nderim këtë figurë nga më të shquarat në historinë tonë, këtë personalitet poliedrik, politikan e diplomat, me cilësi të larta të kalibrit evropian. Ai, me veprën e tij i dha dritë Rilindjes Kombëtare Shqiptare, duke kurorëzuar me veprën e tij të madhe e historike, Shpalljen e Pavarësisë në 28 nëntor 1912.

Prof.As.Dr. Bardhosh Gaçe, Kryetar i Shoqatës Mbarëkombëtare Kulturore-Atdhetare "Ismail Qemali", referoi temën: "Ismail Qemali dhe Identiteti i Shqiptarëve". Historiani Hysni Shaqiri nga Maqedonia, ish deputet, pjesëmarrës në UÇK, referoi temën: "Ismail Qemali dhe trojet etnike shqiptare". Laureta Petoshati publiciste, Kryetare e Shoqatës "Për Identitet dhe Bashkim Kombëtar"-dega Vlorë, referoi temën: "Ismail Qemali, në këngët dhe rrëfimet e popullit". Pedagogu i Universitetit të Vlorës, Odise Çaçi referoi temën: "Diplomacia e I. Qemalit". Përshëndetën konferencën në emër të Shoqatës Mbarëkombëtare "Ismail Qemali", z. Petrit Velaj, në emër të fondacionit "Nermin Vlora Falaski" Zenepe Luka dhe Kristo Cipa, në emër të shoqatës "Për Identitet dhe Bashkim Kombëtar".

Në emër të familjes Vlora, Arjana Vlora, solli mesazhin e familjarëve të Ismail Qemalit. Anëtari i Kryesisë së shoqatës "Ismail Qemali", Albert Abazaj, shpalli 5 personalitete të cilët kanë kontribuar në media, brenda dhe jashtë vendit, për figurën e Ismail Qemalit, të cilët janë: Dalip Greca, kryeredaktor i gazetës "Illyria", Kozeta Zylo, Laureta Petoshati, Kristo Çipa, Gëzim Llojdia.

Nxënësit e shkollës "Naim Frashëri", sollën një atmosferë festive me pjesë të ndryshme muzikore. Në fund të konferencës, deputeti Leskaj, falënderoi biznesmenin vlonjat Dashamir Tahiri për mbështetjen financiare të këtij aktiviteti, ndërkohë që u dhuroi të pranishmëve librin e Prof. Bardhosh Gaçes, "Ata që sollën Pavarësinë".

Mbi këtë Konferencë u shkrua dhe në gazetën Iliria, SHBA nga znj. Laureta Petoshati

Marrë me shkurtime nga Gazeta 55, Republika, Ndryshe.
Kronika e plotë e konferencës u transmetua nga TV Vlora Chanel.
Televizionet lokale transmetuan kronikë nga aktiviteti.

III. 23. 200 libra për Gjimnazin Publik "Halim Xhelo"

Një mik i hershëm i librit, deputeti Bujar Leskaj i dhuron 200 libra gjimnazit publik "Halim Xhelo", në qytetin e Vlorës.

Ishte një premtim i bërë në muajin dhjetor dhe që përkoi me ditëlindjen e shkrimtarit Ismail Kadare. Një nismë e lindur jo rastësisht, por bazuar tek ideja se, libri është shoqërues i njeriut të ditur nëpër gjithë historinë e jetës sonë njerëzore. "Fundi i rrugës që nuk kalon përmes diturisë, është errësirë", thonë të mençurit e botës. Drejtori i shkollës Agron Mema, tha se premtimi bërë në muajin dhjetor nga deputeti Leskaj, u bë një realitet i prekshëm. Ai i mban premtimet.

Deputeti, Bujar Leskaj, u tha gjimnazistëve: "Kjo dhuratë, është një inkurajim për punën që ju duhet të bëni me librin. Si qytetar i Vlorës, ju them se ju, shok më të mirë duhet të keni librin. Librat, që po ju dhuroj sot, janë pjesë e kulturës kombëtare, që do ta pasurojnë bibliotekën tuaj".

Ndër titujt e librave ishin: Korpusi i plotë i veprave të Gjergj Fishtës, përfshirë dhe "Lahutën e Malcisë". "Mrizin e Zanave", "Flamuri dhe I.Qemali" të Prof. Dr. B.Gaçe, botimi voluminoz, "Historia e Shtetit Shqiptar 1912-2005", të Kastriot Dervishit, romane të I. Kadaresë, bibliografi e Petro Markos, S.Cvajg, korpusi i plotë i veprave të Ibrahim Rugovës (që përfshinte krijimet e tij që nga viti 1968 e në vijimësi, ky korpus do të jetë një pasuri e çmuar për bibliotekën), libri për kancelaren gjermane Merkel, dy tituj libra të E.Memishës, libri i "Mandelës së Vlorës" P.Velaj, "Antologjia e Mendimit Shqiptar" (botim i shtëpisë botuese "Plejad"); romani 1984 i G.Oruell, libra të autorit vlonjat A.Xhaferi, publicistit N.Lesi, "Eposi i Kreshnikëve", "Kujtime" të Mehdi Frashërit, romane të Zija Celës, Sonetet e Sheksipirit, Albumi Marubi, "Flamuri Kombëtar Shqiptar" i autorit Jaho Brahaj, Konstantin Balsha, "Kanuni i Labërisë" i Prof. Dr. Ismet Elezit, poezi nga autorët e Evropës Lindore, "Gjeniu i Kombit" dhe 'Lufta Civile në Shqipëri", të autorit Uran Butka, romani "Panteoni i Zi" i Fahri Balliut, si dhe shumë tituj të tjerë.

Në emër të senatit të shkollës, presidentja e tij Ilva Aliaj u shpreh: "Ky është një premtim i mbajtur i deputetit, gjesti i dhurimit meriton vëmendje dhe falenderim". Drejtoresha e bibliotekës publike Liliana Gjika tha se: "Nuk është hera e parë dhurimi i librave nga deputeti i Vlorës. Bibliotekës publike të qytetit tonë ai i ka dhuruar një fond prej 5 milion lekësh dhe një sasi librash. Në emër të lexuesit vlonjat, e falënderoj si një ndër lexuesit dhe dhuruesit më të pasionuar të qytetit, deputetin Leskaj. Gazetarja dhe mësuesja Efrosina Papa, përgjegjëse e bibliotekës, tha se kjo ndihmë e deputetit erdhi në një kohë kur biblioteka është e varfër, më shumë se kurrë. Albert Abazaj përgjegjës i biblotekës së Universitetit të Vlorës uroi: "Mirënjohje kulturëdashësit të librit vlonjat e shqiptar, Bujar Leskaj. Ky nuk mund të quhet një mësim i harruar kurrësesi, por një mesazh që dëfton se shqiptarët e kanë ruajtur atë pasion të tyre të fshehur për letrat shqipe".

Kjo bibliotekë, do t'i shërbejë rreth 500 nxënësve. Në fondin që u krijua, prej 7 raftesh, gjithsej me 200 tituj librash te rinj, shkruhet: "Fondi i Deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, Bujar Leskaj".

Marrë me shkurtime nga Gazeta 55 dhe Republika
Kronike speciale në TV 6+1 Vlora, TV Fokus dhe TV Apolon

III. 24. Promovimi i librit "Rezervati i derrave të egër"

Vlorë më 22 Mars 2009

Promovimi më i veantë në Vlorë i përket librit "Rezervati i derrave të egër", i autorit Enver Qamo, plagosur në '97 e i mbetur invalid përjetë. Aktiviteti u zhvillua nën kujdesin e deputetit Bujar Leskaj, në një nga sallat e Pallatit të Kulturës "Labëria". Morën pjesë shkrimtarë, historianë, kritikë e nxënës shkollash. Fjalën e hyrjes e mbajti shkrimtari Myrteza Mara.

Në përshëndetjen e tij, deputeti Leskaj, ndër të tjera tha: "Kohët e fundit lexova "Rezervatin e derrave të egër". E përgëzoj dhe e vlerësoj krijimin e fundit prozaik të Enver Qamos dhe vetë autorin. Shenja të veçantisë do të cilësoja kurajën, vullnetin, durimin dhe qëndresën. Enver Qamo është një krijues dinjitoz. Ndërkaq, megjithëse faktet nuk rrinë fshehur, mendoj se romani i fundit është një pasqyrë ku lexohet bukur dhe qartë mendimi krijues. Eshtë roman me nivel dhe që lexohet shpejt e lirshëm. Nuk ka kurrfarë dileme për t'u shprehur se, Enver Qamo është një autor dinjitoz në letrat shqipe".

Një urim për romanin e ri ka dhënë edhe prefekti i Vlorës Hasan Halili. Në ceremoni përshëndeti edhe nënprefekti i Skraparit, Fadil Kapllani, Gjatë ceremonisë, e përshëndetën botimin e ri edhe poeti Miljano Stefa, publicisti Albert Abazaj, fabulisti Pëllumb Velo dhe krijuesja Aurora Mehmetaj.

Marrë me shkurtime nga Gazeta 55, dt. 23 Mars 2009

III. 25. Më i votuari në sondazhin e medias vendore në Vlorë

Gazeta "Imperial City" e Vlorës, ka nxjerrë në krye të sondazhit të saj, deputetin aktual Bujar Leskaj, me përqindjen më të madhe të votave vlonjate

Një gazetë, që botohet në qytetin e Vlorës, me titullin "Imperial City", ka publikuar dje një sondazh lidhur me mbështetjen e kandidatëve për deputetë për zgjedhjet e ardhshme parlamentare. Në krye të listës është shpallur deputeti aktual i zonës Nr. 94, Bujar Leskaj. Sondazhi, siç thuhet edhe në njoftimin e gazetës, është realizuar me banorë të këtij qyteti përgjatë një testimi të përkohshëm nga redaksia. Një rast më vete përbën dhe fakti që, kjo gazetë është e pozicionuar më afër me opozitën e sotme sesa me mazhorancën. Po ashtu, interesant është fakti se, të gjithë ata që do të kandidojnë në këtë rreth, por që nuk janë me banim në qarkun e Vlorës, kanë marrë zero vota. Bujar Leskaj, pas 4 vitesh që konsumoi një mandat deputeti, ka zënë sërish vendin e parë si më i pëlqyeri dhe më i preferuari, për banorët e qytetit të Flamurit. Cilat janë disa nga arsyet që deputeti Bujar Leskaj renditet në krye të listës së ligjvënësve?

1. Bujar Leskaj, është interesuar për hallet dhe problemet e bashkëqytetarëve të tij.

2. Bujar Leskaj, është nismëtar i vitit kulturor që zhvillohet në Vlorë, prej tre vjetësh, me dy shoqatat; "Lidhjen e shkrimtarëve" dhe grupin kulturor "Ali Asllani". Në total ai ka zhvilluar një sërë aktivitetesh, të cilat kanë nxjerrë nga pluhuri i historisë, figura dhe emra të shquar të këtij qyteti. Ka organizuar sesione shkencore kushtuar Ismail Qemalit, Eqerem Bej Vlorës, Ali Asllanit, Ago Agajt, si dhe simpoziume me librat e studiuesve Uran Butka, Enver Lepenica, Vilhelma Haxhiraj, apo Enver Qamo. Ai ka dhuruar libra për Bibliotekën "Shevqet Musaraj" në Vlorë, bibliotekën e shkollës së mesme të përgjithshme "Halim Xhelo", si dhe për intelektualët e qytetit në takime të ndryshme.

3. Bujar Leskaj e konsumoi një mandat deputeti, duke mos u përzier a përfolur për afera korruptive, emërime apo marrje tenderash. Ai organizoi disa herë me grupime të ndryshme vizita në Kosovë, si dhe ishte për të dytin vit radhazi, pjesëmarrës në marshimin për Çamërinë në Qafë Botë.

Bujar Leskaj, mbetet deputeti më popullor me kredencialitet më të lartë në këtë qytet. Me figurën e Bujar Leskajt, PD do të ketë një siguri më tepër, për fitoren më të rëndësishme në zgjedhjet e qershorit të ardhshëm, siguri që buron nga vota e qytetarëve të këtij qarku, që kanë votuar paraprakisht si një ndër figurat më popullore, deputetin aktual. Sondazhi lë mbrapa emra të njohur të pozitës dhe opozitës së sotme.

Rezultatet e tij nuk janë kontestuar nga asnjë prej krerëve të opozitës në qarkun e Vlorës.

Botuar në gazetën 55, datë 25 Mars 2009, autori Gëzim Llojdia

III. 26. Vlora zhvillon sesionin shkencor "Shqipëria në NATO"

Instituti i Studimeve Politike "Ismail Qemali", në bashkëpunim me Delegacionin e Përhershëm të Kuvendit të Shqipërisë në Asamblenë Parlamentare të NATO-s, Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë, në prag të anëtarësimit te Shqipërisë me të drejta të plota në NATO, mbajti sesionin shkencor "Shqipëria në NATO". Aktiviteti u zhvillua nën kujdesin e deputetit të Vlorës, z.Bujar Leskaj.

Do të duhej afërsisht rreth gjysmë shekulli, kur Vlora, e cila kishte qenë dikur baza ushtarake e Traktatit të Varshavës, traktat nga i cili Shqipëria doli në vitin 1968, të ndiente vërtetë gëzimin e sinqertë, të një aleance të sinqertë dhe të fuqishme. Do të ishte nisma e deputetit të Vlorës, Bujar Leskaj, në krye të Institutit të Studimeve Politike "Ismail Qemali" që, në këtë qytet të organizohej veprimtaria, "Shqipëria në NATO", e cila u zhvillua në mjediset e Pallatit të Kulturës " Labëria", në formën e një sesioni shkencor. Një sallë e mbushur plot e përplot me ushtarakë dhe civilë, intelektualë të spikatur të qytetit, studentë e pedagogë të Universitetit "Ismail Qemali", përfaqësues të Qarkut dhe Prefekturës Vlorë, dëgjuan dhe duartrokitën ligjëratat mbi NATO-n të deputetit Leonard Demi, Kolonelit, Hysen Cekodhima dhe deputetit të Vlorës, Bujar Leskaj.

Ky sesion shkencor, sipas deputetit Leskaj, i cili e hapi atë, kishte si qëllim prezantimin e dimensioneve dhe funksioneve të NATO-s, përfitimet e Shqipërisë nga anëtarësimi në të. "Çdo të thotë të jesh në NATO, përkrahë 28 shteteve, si i barabartë mes të barabartëve?". Deputeti Bujar Leskaj, i njohur në Vlorë dhe më gjerë për ndjenjat e spikatura atdhetare, nuk e fshehu entuziazmin e simbolikës së numrit "28", i cili lidhet jo vetëm me numrin e shteteve, anëtarë të NATO-s, por edhe me ditën e shënuar të Pavarësisë Kombëtare, pikërisht në Vlorën e Flamurit dhe të Ismail Qemalit, emrin e të cilit e mban Instituti i Studimeve Politike, njëkohësisht protagonist i kësaj veprimtarie. Në fjalën e tij të hapjes, deputeti Leskaj tha se: "Më 4 prill 1949, në Washington u nënshkrua një traktat i Atlantikut të Veriut, i cili krijoi një aleancë politiko –ushtarake për

mbrojtjen kolektive, NATO-n, mbështetur në nenin 51 të Kartës së OKB. Si fillim, kjo aleancë bashkoi 14 shtete evropiane, SHBA dhe Kanadanë. Emblema e miratuar në vitin 1953, është simbol i unitetit dhe bashkimit. Parathënia e Traktatit konfirmon se, "Palët janë të vendosura të bashkërendojnë përpjekjet për mbrojtjen kolektive dhe ruajtjen e paqes dhe sigurimit". Artikulli 5 i Traktatit thekson: "Një sulm i armatosur kundër një ose shumë vendeve anëtare në Europë, Amerikën e Veriut, do të konsiderohet si sulm kundër të gjithë vendeve të Aleancës."

Deputeti Leonard Demi, njëkohësisht kryetar i Komisionit Parlamentar për Sigurinë dhe kryetar i delegacionit të Kuvendit të Shqipërisë në Asamblenë e NATO-s, referoi kumtesën me temë: "NATO - Institucioni themelor i sigurisë Euroatlantike dhe përfitimet e Shqipërisë." Në ligjëratën e tij, deputeti Demi theksoi faktin se, "futja e Shqipërisë në NATO, është realizim i ëndrrës së patriotëve shqiptarë për të qenë në një unitet me Evropën dhe Perëndimin, pasi Shqipëria jo vetëm shpirtërisht, por edhe gjeografikisht ka qenë në Europë, në perëndim".

Koloneli, Hysen Cekodhima, Drejtor Drejtorie në Ministrinë e Mbrojtjes, referoi kumtesën :"Ushtria Shqiptare dhe NATO". Koloneli Cekodhima nuk e la pa shprehur emocionin, për shkak se referonte për herë të parë në qytetin e tij, në Vlorë. "Kam referuar në shumë vende të botës, por asnjëherë në Vlorë. Vlora gjithmonë ka nxjerrë ushtarakë të zotë, por edhe politikanë të zotë. Një filozof kinez pat thënë se, "lufta nuk është aq e thjeshtë, sa ta bëjmë vetëm ne ushtarakët, luftën e bëjnë politikanët, të cilët krijojnë aleanca". Pra edhe këtë Aleancë e bënë politikanët shqiptarë, e bëmë të gjithë ne, së bashku."

Deputeti, Bujar Leskaj. referoi kumtesën, "Asambleja Parlamentare e NATO-s", ku theksoi se, zanafilla e kësaj asambleje ishte data 18 korrik 1955. Leskaj vijoi me një shprehje të Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Schefer, sipas së cilës, "Asambleja parlamentare e NATO-s, ishte angazhimi i plotë i popujve tanë në mbrojte të lirisë, që u dha mundësinë Aleatëve Perëndimorë, që të mundin totalitarizmin dhe nazizmin, gjatë Luftës së Dytë Botërore. Rezultati ishte triumfues paqësor i demokracisë mbi ideologjitë anti-liri, që, për shumë kohë e mbajti kontinentin evropian të ndarë dhe që më vonë solli përfshirjen në gjirin e Aleancës dhe të Asamblesë, të demokracive të reja në Evropën e ri-bashkuar." Më tej, ai shtoi se, "qëllimet e Asamblesë Parlamentare janë të lidhura në mënyrë direkte me rolin e parlamenteve, në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, duke pasur parasysh karakterin ndër-parlamentar

. Qëllimet e Asamblesë mund të përkufizohen si, nxitja e dialogut mes parlamenteve mbi çështjet të rëndësishme të sigurisë, rritja e ndjeshmërisë dhe e kuptueshmërisë mbi çështje të rëndësishme të politikave të Aleancës, dhënia e treguesve të opinionit parlamentar NATO-s dhe qeverive përkatëse, krijimi i një transparence më të madhe të politikave të NATO-s dhe, rrjedhimisht, të një raportimi kolektiv." Në vazhdim, deputeti Leskaj u përqendrua tek fuqizimi i marrëdhënieve trans-atlantike, si dhe qëllimet e përhershme të asamblesë, duke nënvizuar se, "që nga viti 1989, janë shtuar edhe këto pika : mbështetja e zhvillimit të demokracive parlamentare në zonën euroatlantike, nëpërmjet integrimit parlamentar nga vendet jo anëtare në punën e asamblesë, mbështetja direkte e parlamenteve të vendeve që përpiqen për t'u anëtarësuar në NATO, rritja e bashkëpunimit me vendet që kërkojnë bashkëpunim më shumë se anëtarësi, duke përfshirë Kaukazin, Azinë Qendrore dhe Mesdheun Jugor. Në shumë fusha, parlamentarët e asamblesë luajnë një rol kryesor, si në parlamentet e tyre përkatës, në debatet me qeveritë dhe përfaqësuesit e tyre, ashtu edhe në sensibilizimin e opinionit publik mbi politikat e aleancës, që është esenciale për legjitimitetin dhe, rrjedhimisht, për suksesin e tyre. Kështu, Asambleja Parlamentare e NATO-s, nuk ka dështuar kurrë në sigurimin e mbështetjen e opinionit publik edhe për çështjet e ndjeshme mbi vendosjen e raketave në Europë, krizën në Kosovë, vendosjen e trupave në Afganistan, etj."

Marrë me shkurtime nga gazeta Ndryshe, 01/04/2009, autor: Laureta Petoshati
Materiali i zgjeruar u botua në gazetat: 55, Republika, Metropol, RD, nga gazetarët Harilla Koçi, Gëzim Llojdia.
Aktiviteti u transmetua në televizionet lokale.

III. 27. Libra dhuratë për gjimnazin "Ali Asllani" në luginën e Shushicës

Vlorë më 21 Prill 2009

Kremtimit të 23 prillit, Ditës Botërore të Librit, që fillesat i ka në Katalonjë të Spanjës, ku çdokujt që blinte libër i dhurohej një lule dhe në Shqipëri ka nisur në vitin 1995, do t'i bashkëngjitej në Vlorë nisma e deputetit, Bujar Leskaj, duke treguar se edhe Vlora shfaqet si vend me traditë të librit, sidomos në vitet e fundit. Deputeti Leskaj ka bërë që nisma e tij për dhurimin e librave, të vijojë në pikën(stacionin) e tretë, në shkolla publike në rrjedhën e Shushicës.

Pikërisht, në vendlindjen e të parëve të tij në luginën e Lumit të Vlorës, në Komunën Kotë – Drashovicë, rreth 20 km nga qyteti i Flamurit, është shkolla e mesme e përgjithshme publike, që mban emrin e poetit më të fuqishëm lirik të kësaj treve labe - Ali Asllani.

Me motive të qartësuara, përmes sentencave, "Dituria është si një ishull, sa më shumë që të rritet aq më shumë zvogëlohet vija e bregut te paditurisë", si dhe "Rruga, që nuk të shpie në dritë, është errësirë", deputeti Leskaj bëri dhurimin e dhjetra titujve sipas listës që ka përcaktuar Ministria e Arsimit dhe SHkencës, për autorët që studjohen aktualisht në lëndën e letërsisë në shkollën e mesme të përgjithshme.

Ka qenë një vizitë një javë më parë në këtë komunë, ku, ndonëse ka të zgjedhur deputetin socialist B.Dervishi, deputeti Leskaj ka shkuar edhe në gjimnazin publik "Ali Asllani", për të dëgjuar nga afër shqetësimet e personelit mësimor. Ndonëse shkolla ishte rikonstruktuar në fillim të viteve 2000, ajo ishte e mirëmbajtur dhe, përbëri saj, busti i poetit Ali Asllani. Por, në të ekzistonte një bibliotekë tejet e varfër, vetëm me disa kopje revistash "Nëntori", një botim i para viteve 1990 dhe disa libra të autorëve të Vlorës, por, jo nga ata që kanë bërë vend në letrat shqipe.

Kërkesës së drejtorit të shkollës Neim Veshaj, për pasurimin e bibliotekës së këtij gjimnazi publik, deputeti Leskaj ju përgjigj

pozitivisht. "Nëse ballafaqohemi me mungesë informacionesh në literaturë, për nxënësit në këtë zonë nuk ka mundësi të tjera. Edhe në komunën me 4500 banorë nuk ka një bibliotekë", u shreh Veshaj. Një nxënës i kësaj shkolle duhet të udhëtojë 40 km vajtje ardhje, për të siguruar në bibliotekën e qytetit ose në libraritë, literaturën e kërkuar për orën mësimore. Por, magjia e librit nuk përfundon këtu, mund të ketë dimensione të ndryshme, ajo mund të jetë e pakufishme për zgjuarsinë e nxënësit. Secili që e lexon me ëndje librin, mund ta zhvillojë intelektin dhe oratorinë e tij, në përmasa të ndryshme.

Me këtë ngarkesë libri, kemi mbërritur në dyert e gjimnazit publik "Ali Asllani", një ndërtesë dy katëshe, lyer me të bardhë dhe një shirit të kuq, godina e gjimnazit gjendej në një bllok banesash 2-5 kate të para viteve 90. Shumë pranë saj është edhe ndërtesa e shkollës 9 vjeçare.

Gjimnazi "Ali Asllani", ka një areal përfshirjeje në 9-10 fshatra të komunës, me rreze 30 km. Këtu mësojnë 205 nxënës. Ata vijnë nga qyteza e Kotës, fshatrat Mavrovë, Hastane, Lapardha, Gumenicë, Mazhar, Vajzë, Hysoverdhë, Vodicë, Drashovicë. Drejtoria arsimore ka zgjidhur problemin e transportit për nxënësit e fshatrave më të largët, Vajzë, Drashovicë , Vodicë dhe Hysoverdhë.

Ceremonia

Dhjetëra nxënës të gjimnazit, kanë përjetuar në ditën e librit ngjarjen e tyre më të shënuar. Dhurimi i librave bibliotekës nga deputeti Bujar Leskaj. Mes një atmosfere festive dhe këngës së grupit polifonik: "Kush ka ardhur sot në Kotë/Mirësevjen me libra plotë/ është Bujari e bujar plotë....." Drejtori i shkollës Neim Veshi tha: "Pas zjarrit, të cilin Prometeu ua mori fshehurazi perëndive, për njeriun shkrimi mbetet krahas arritjeve të tjera, një prej gjërave më të mrekullueshme. Shkolla jonë e nderon librin, ne deri tash kemi pasur një bibliotekë jo të pasur me libra. Prandaj dhe ne i nderojmë ata që na ndihmojnë në pasurimin e bibliotekës, si deputeti Bujar Leskaj".

Deputeti, Bujar Leskaj, e nisi me fjalët e zgjedhura për diturinë: "dituria është si një ishull, sa më shume që të rritet, aq më shumë zvogëlohet vija e bregut te paditurisë". "Në respekt të kësaj dite, iniciativa ime ishte që ky gjimnaz publik në luginë të Shushicës të ketë tash e tutje një bibliotekë të pasur. Festimi i kësaj dite dëshmon një respekt për librin, këtë pasuri që duhet lexuar në masë të madhe për të arritur diçka në jetë. Magjia e librit mund të ketë dimensione të ndryshme, ajo mund të jetë e pakufishme për zgjuarsinë e njeriut. Nëse njohim magjinë e librit me plot kuptimin e fjalës, mund të

themi se kemi kuptuar ecurinë e jetës. Themi se e kemi kuptuar ecurinë e jetës, sepse e gjithë dija që mund të përvetësojmë, gjendet pikërisht në libër, por, sigurisht, duke mos anashkaluar edhe përvojën. Më pas libri njeriun e qetëson dhe e frymëzon për jetë, i jep forcë, e aktivizon dhe, çfarë është më e rëndësishme, e bën te lumtur atë. Mes të lexuarit dhe të mos lexuarit, shfaqet tendenca e mençurisë se njeriut. Sa më shumë që lexojmë, aq më shumë ngrihemi në kulminacionin e dëshiruar. Në të kundërt, sa më pak lexojmë, aq më poshtë do të jemi dhe kështu do të kemi ngecje në procesin e të mësuarit momental, por edhe të mëvonshëm. Pra, e gjithë veprimtaria e njeriut, zgjuarsia e tij, sjellja e tij, të perceptuarit e gjërave të ndryshme e kanë themelin pikërisht në libër. Ju jeni 205 nxënës dhe për çdo nxënës unë kam menduar nga një libër. Gjimnazi juaj publik ka një emër të madh, emrin e poetit Ali Asllani. Ky diplomat i shquar, ish Kryetar i Bashkisë së Vlorës, poet lirik nga më të mëdhenjtë, duhet të njihet dhe të nderohet nga çdo nxënës i kësaj shkolle", theksoi deputeti Bujar Leskaj.

Ai veçoi edhe punën e mirë iluministe të mësuesve të këtij gjimnazi, pasionin dhe përkushtimin e tyre. Titujt e librave ishin 205, ndërsa autorët fillojnë nga antikiteti, letërsia e hershme, e kaluar si dhe ajo bashkëkohore me autorë shqiptarë e të huaj. Autorët më në zë ishin Ismail Kadare, Fishta, Naim Frashëri, Cajupi, Migjeni, Ndre Mjeda, Petro Marko, Zef Skiroi, Ernest Koliqi, Faik Konica, Fan S.Noli, Fatos Arapi, Sabri Godo, Mitrush Kuteli, Ali Asllani, Dritëro Agolli, Ali Podrimja, Anton Pashku, poetë arbëreshë, Homeri, Eskili, Uilliam Shekspir, Johan V. Gëte, Viktor Hygo, Honore de Balzak, Gi de Mopasan, Anton Çehov, Çarls Dikens, Xhejms Xhojs, Xhek London, Ernest Heminguej, G.Marquez, Oskar Uajld, Jorge Luis Borges.

Aktori i mirënjohur, Bujar Asqeriu, recitoi vargje nga poeti Ali Asllani. Ndërsa drejtori i Teatrit Kombëtar, Kristaq Skrami, tha se "kjo mënyrë është përhapja e dritës kudo dhe tek çdo kënd në kuadër të Ditës së Librit".

Nxënësit e kësaj shkolle recituan poezi, aforizma për librin, kënduan këngë polifonike dhe hodhën valle popullore, duke e konceptuar ditën e librit si një festë.

Reportazh i botuar në gazetën Republika, dt. 24 Prill 2009,
autori Gëzim Llojdia.
Kronike Speciale në TV 6+1 Vlora dhe TV Vlora Chanell

III. 28. Promovimi i librit "PËRFAQËSUESIT E VLORËS NË KUVENDIN E SHQIPËRISË, 1912-2009"

Vlorë më, 15 Maj 2009

Deputeti i Vlorës Bujar Leskaj, promovoi në qytetin e tij, librin historiko-politik "Përfaqësuesit e Vlorës në Kuvendin e Shqipërisë 1912-2009", në një takim solemn në Pallatin e Kulturës "Labëria", ku ishin pjesëmarrës jo vetëm ish deputetë të Shqipërisë gjatë legjislacioneve të fundit, por edhe familjarë e të afërm të ish deputetëve të Vlorës që nga viti 1912 e deri në ditët tona.

Ky libër ka zgjuar kërshërinë e shumë intelektualëve, studiuesve, shkrimtarëve, publicistëve, historianëve, jo vetëm nga Vlora, por edhe më gjerë, pasi përmbledh brenda faqeve të tij ngjarjet e rëndësishme të shtetit të parë Shqiptar, punën e ligjvënësve nga Vlora, të cilët jo vetëm e krijuan shtetin me në krye diplomatin dhe shtetarin e parë, Ismail Qemal bej Vlora, por edhe e mbrojtën atë, kur përpara u dilnin dy detyra jetike : Sigurimi i pavarësisë së Shqipërisë dhe ruajtja e tërësisë tokësore të shtetit shqiptar.

Libri i deputetit Bujar Leskaj, "Përfaqësuesit e Vlorës në Kuvendin e Shqipërisë 1912-2009", është një pasqyrë e gjallë, jetësore, që plotëson me dinjitet, ndërgjegje e ndjenjë të thellë përgjegjësie, atë pjesë të publicistikës historike të Shqipërisë, duke shfrytëzuar e cituar botimet e profesorëve të historisë Teki Selenica, Eqerem Bej Vlora, Koli Xoxi, Skënder Luarasi, Kristo Frashëri, Uran Butka, Arben Puto, Bardhosh Gaçe, etj. Me botimin e këtij libri, deputeti Bujar Leskaj, me kulturë shumëdimensionale, pasi është i diplomuar në inxhinieri, jurisprudencë dhe ekonomi, shfaq edhe një dimension tjetër të tij: një zhdërvjelltësi për të na dhënë një informacion historik, jo vetëm me vërtetësi, por edhe në mënyrë estetike. Për ta arritur këtë gjë, duket që ka punuar shumë dhe është e lehtë për të kuptuar se ai është i ndikuar mbi shfaqjen e së vërtetës

sipas shprehjes se, "e vërteta të bën të lirë" edhe nga edukata që ai ka marrë nga apostujt e katolicizmit shqiptar, që i vlerëson shumë si At Gjergj Fishta, At Zef Pllumi,etj, por ai edhe ka shfletuar një literaturë shumë të madhe, i ndihmuar mjaft edhe nga familjet e persekutuar të shumë deputetëve të para viteve 1944.

Publicisti, Gëzim Llojdia, në promovimin e këtij libri, foli për bibliografinë e përdorur nga deputeti Bujar Leskaj dhe më tej përpos të tjerave tha se :"Nëpër rrotativët e historisë, ne kalojmë përmbi urat historike, këmbët e të cilave kanë lidhur pazgjidhshmërisht historinë tonë. Një rikujtim i kësaj copëze, përbën përveç se një detyrim moral e shpirtëror, për atë pjesë historie, ndriçimi i së cilës bën fjalë edhe në 380 fletët e këtij libri.."

Profesor Bardhosh Gaçe, në këtë promovim ligjëroi temën, "Ringjallja e historisë nëpërmjet parlamentit" dhe, midis te tjerave tha : "Dëshiroj të vë në dukje qysh në fillim se, një studim, botimi dhe hulumtimi i tij me arkitekturën e një monografie mbi rolin e parlamentit shqiptar qysh nga 28 Nëntori 1912 e deri në ditët tona, është kontribut i veçantë në bibliografinë shqiptare. Autori, me pasionin dhe këmbënguljen e tij, siç dëshmojnë burimet arkivore dhe të shtypit të kohës, por edhe me intelektin e tij, për herë të parë na shpalos në sytë tanë lulëzimin e parlamentit shqiptar, si dhe kontributin e deputetëve të Vlorës".

Dr. Kristaq Gjyli, zëvendës dekan i Fakultetit Juridik Tiranë, që referoi temën "Mendime rreth librit, në aspektin juridik e politik", u shpreh se, "ky libër është përgatitur me përkushtim nga autori Bujar Leskaj, impresionohesh për shkak te vlerave që mbart "ky fjalor i vogël enciklopedik i përfaqësimit politik". Si rrallë në ndonjë vepër, aty mund të gjesh të ndërthurura vlerat historike dhe aktuale të jetës politike, vlerat e thjeshta njerëzore të shoqërisë me vlerat politike te saj, elitat politike në kohë të ndryshme, përfaqësimin pluralist, figura të shquara historike dhe figura të thjeshta të mendimit të shtypur. Gjithë sa më sipër e bashkon një vlere e vetme, shpirti atdhetar vlonjat. Është ky shpirt që e bashkon edhe autorin me të gjitha figurat e paraqitura në tekst. Të gjithë ata janë vlonjatë, gjë që shpreh shumë. Si qytetar vlonjat, autori ruan një ndjesi të veçantë për ditën e ngritjes së Flamurit në Vlorë dhe aty ka filluar rrëfimin e tij, si për të treguar edhe njëherë se, ç'ditë e shënuar ishte ajo për kombin tonë". Zoti Gjyli, pasi sqaroi se kohët e fundit, ka pasur mjaft përpjekje nga autorë të ndryshëm, për të evokuar përmes botimeve, historinë e vendit të tyre, të zonës apo të familjes se tyre dhe, kjo, sipas tij, është një prirje normale e shoqërisë sonë që rend të kërkojë identitetin lirisht, tha se, "botimi që kemi në duar, është një punim

me vlerë të veçantë në këtë kuadër. Kjo, sepse përmes historisë politike të qytetit, përmes figurave biografike të qytetit të tij, autori synon gjetkë, kërkon të evokojë përfaqësimin politik dhe ligjor, si një parim demokratik mjaft i rëndësishëm. Kështu, punimi ka vlera të padiskutueshme njohëse, gjë që mund të shtyjë lexuesin lehtësisht të arrijë në konkluzione të caktuara, lidhur me përfaqësimin ligjor vlonjat. Sa i aftë ka qenë ky qytet të përfaqësoj në parlament shpirtin e vërtetë të vlonjatit? Të mos harrojmë se, ky shpirt u mbrujt me idenë e evropianizimit, që në fjalimet e para të Ismail Qemalit dhe programin e Qeverise së parë të Shtetit të pavarur shqiptar. Autori ka punuar me kujdes, por nuk ka bërë asnjë seleksionim të figurave që e përfaqësuan në Parlament popullin e Vlorës, pavarësisht nga orientimi i tyre politik."

Në përshëndetjen e tij, deputeti dhe kryetari i PD së Vlorës, Ardian Kollozi tha se, "ky libër është produkt i dashurisë, jo vetëm i Bujarit, por edhe imja edhe e jona, për Vlorën tonë. Është produkt i dashurisë dhe mirënjohjes që u bën atyre, të cilët i përfaqëson në Kuvendin e Shqipërisë një djalë i Vlorës, deputet dhe ish ministër. Ky libër tregon dhe vullnetin e deputetit Bujar Leskaj, për t'i çuar gjërat deri në fund." Drejtori i Muzeve të Vlorës, historiani Skënder Spahiu, i cili referoi temën "Përfaqësuesit e popullit 1912-39", në ligjërimin e tij mbi këtë libër, midis të tjerave tha se, "Rikthimi në vëmendjen e lexuesit të veprimtarive të këtyre personaliteteve në vitet '12-39 dhe deri në 2009 dhe në momente të veçanta kthese të historisë së kombit tonë, i rihap trajtim çështjes shqiptare me të gjitha problemet e kohës. Vlerësimi historiko-politik nga ana e autorit, ka evidentuar në mënyrë të plotë vlerat, kontributet e këtyre personaliteteve, si vazhdues dhe pjesë e sotme e deputetëve vlonjate".

Studiuesi, Enver Memisha, në ligjërimin e tij të titulluar "Libri i dashurisë për Vlorën" për librin "Përfaqësuesit e Vlorës në Kuvendin e Shqipërisë 1912-2009" tha se, "Në librin që po e përuron mes vlonjateve që e votuan, intelektuali aktiv i Vlorës, deputeti Bujar Leskaj, tregoi se deviza e deputetit është dashuria e tij për Vlorën. Ai i bën nder partisë ku militon, ndërsa me këtë libër, që është një enciklopedi e vogël e Vlorës, ai i jep Vlorës vlera të tjera dhe mund të nxjerrim përfundime me vlerë. Stili, gjuha, bibliografia e përdorur, nuk tregojnë vetëm Bujar Leskaj-n inxhinier, jurist dhe ekonomist, por edhe historian".

Në përfundim të kësaj veprimtarie e merr fjalën deputeti, Bujar Leskaj, që gjithmonë e ka pasur pasion librin dhe Vlorën dhe kjo dashuri është shkrirë tashmë në një: për t'u shërbyer pafundësisht të

dyjave si detyrim ndaj kombit shqiptar në përgjithësi dhe komunitetit vlonjat në veçanti. E, pra, ja ku është ai, që në shumë vite shihej në fotografitë e vjetra të Vlorës me një dorë të thyer e të vënë në allçi, mes librave, ku, mes faqeve të tyre, ndoshta gjente përrallat e pa treguara nga nëna e tij, që e la shumë shpejt jetim, ndërsa tashmë do të nxirrte një libër për të cilin vetë do të shkruante : "Nuk e di se ku pata lexuar një thënie që më është dukur nxitëse për këtë iniciativë, sipas së cilës "...historia është varreza e elitave që kanë pasuar njëra tjetrën në pushtet." Kjo tezë, gjithashtu, më nxiti për të përgatitur këtë libër për kontributin parlamentar në vite. Doemos, kur nisa punën për të shkruar, e kam pasur parasysh "koston" e njohur të kësaj ndërmarrjeje. Sepse, kur futesh në territoret e politikës, patjetër që do të përballosh edhe "luanët" e saj e konfrontimin e fakteve dhe fjalëve, përplasjen e interesave të përgjithshme, gjithsesi edhe të personalizuara. Sepse, dihet se, kur merresh me çështje esenciale të historisë politike, zakonisht njerëzit janë të gatshëm të "nxjerrin koburet" e përkatësive politiko-historike".

Merita e madhe e librit, është vërtetësia e tij. Bujar Leskaj i ka rreshtuar të gjithë ligjvënësit që ka pasur Vlora, me jetëshkrimin e tyre, sipas dokumenteve arkivore, pa retushim. Ai dhe libri, për këtë do të vlerësohen më shumë me kalimin e kohës, pasi nuk veproi si dishepujt e Enver Hoxhës, që modifikuan dhe falsifikuan historinë. Tërësia e fakteve, ngjarjeve, personazheve, është reale, ndaj dhe libri ka vlera shumë të mëdha për historinë e Vlorës dhe u shërben disa kategorive të lexuesve. Studiuesit me këtë libër mund të bëjnë shqyrtime historike dhe të nxjerrin përfundime për drejtimin e shtetit shqiptar, që nga krijimi e deri më sot dhe të kuptojnë se çfarë ligjvënësish i duhen Kuvendit të Shqipërisë në të ardhmen.

Marrë me shkurtime nga gazetat Republika, 55, date 18.05.2009. Për këtë promovim libri shkruajtën edhe gazetat e tjera si: Panorama, Shqip, RD, Gazeta Shqiptare, Koha Jonë, Shekulli, Korrieri, Metropol, Ndryshe, nga korrespondentët dhe gazetarët vlonjatë.

Speciale në TV 6+1 Vlora, TV Vlora Channel. Kronikë në Vizion Plus, TVSH, Ora News, Alsat, TV Fokus, TV Amantia, TV Apollon.

Intermexo III

Ese e Dr. Rugovës për Pavarësinë Kombëtare, e shkruar në vitin 1968

Në Konferencën shkencore, me rastin e 165 vjetorit të ditëlindjes dhe 90 vjetorit të vdekjes së tij, "Ismail Qemali dhe Identiteti i Shqiptarëve", organizuar më 23 janar 2009 në Vlorë nën kujdesin e deputetit Bujar Leskaj, në fjalën e tij përshëndetëse të hapjes, deputeti lexoi esen e shkruar nga Dr. Ibrahim Rugova në vitin 1968.

PAVARËSIA KOMBËTARE

Gjithmonë e kemi ndier në veten tonë këtë Ditë të Bardhë, kemi jetuar me të, me gjakun e saj të kuq, që qe i ndrydhur fort ndër zemrat tona , si në zemrën e Plakut mjekërbardhë që e zbardhëlloi më 1912. O , po si të mos e ndiejmë këtë Ditë që është njëra ndër ditët më të bardha, ndër ditët më të kuqe të historisë sonë të vrullshme plot e përplot me shtrëngata e pak më pak me bardhësi të këndshme. Edhe në këtë tokë të lavdishme janë djegur shpirtrat për liri dhe pavarësi, ende digjen dhe prore do të digjen, gjersa të ndrisë ajo drita flakëruese madhështore, që ngre peshë gjakun e një trungu në çdo stinë të kohës.

Zinë e lëngatës së një populli e ndiejnë më së miri dhe më së shumti bijtë më të mirë të tij. Ata shkrumbohen sa s'ka më. Mundohem që ta zhdukin atë dhe të sjellin fatbardhësinë e ëndërruar. Të ngrenë tempullin e lirisë në mesin e Atdheut- vendit të shenjtë , vendit që është simboli i njeriut në mbarë jetën e lavdinë. Ata bëjnë çdo gjë. Digjen si qiriri. E me atë dritë që del nga trungu i tyre i djegur shndrisin tokën e rituar me gjak ndër shekuj. Shumë ka pasur gjaku ynë kësi bijsh , të ndershëm , madhështorë dhe burrërorë. Vargu i tyre ndër faqet e së kaluarës sonë është i gjatë sa të gjithë ne. Më i gjatë është vargu i lavdive dhe trimërive të tyre të paskajshme.

Viti 1912. Zgjedha otomane zë të hiqet. Këtë e bëjnë ata që me shekuj ndjenë peshën e saj, peshën e saj të ndyrë shkombëtarizuese, vëllavrasëse dhe copëtuese. Edhe toka e Mëmëdheut është e zgjuar. S'duron më këmbën e ndyrë poshtëruese që fikte njomësit pa lindur fare. Bota dëgjon për këtë. Ballkani ushton. Trimat enden në të gjitha anët. Kudo dëgjohet kushtrimi: pavarësi dhe liri kombëtare. Zemrat e ndrydhura nxjerrin zërin më të fuqishëm. Kuçedra anadollake iku njëherë e përgjithëmonë pas pesë shekujsh .Gjithkush e priti lirinë dhe qetësinë. Të jetojë me shpirt të vet në trungun e vet, meqë e dinin fare mirë se ç'është kjo, ç'sjell për ringjalljen e një gjaku të vjetër që mijëra e mijëra vite rrodhi nëpër damarët e Ballkanit të lavdishëm. Ikën anadollakët.

Mirë e hetuan këtë ata që ishin mësuar me harbutërinë e kësaj dore. Nuk pritën. U ranë grusht hundëve. E plandosën përtokë dhe simbolin e gjakut tonë –Flamurin e ruajtur në shekuj në gji e çdo vend të tokës së dashur e ngritën lartë. E ngritën atë ditë vjeshte. Atë ditë të bardhë e të artë. Në kalendarin e historisë kombëtare hyri ajo ditë. U shënua: 28 nëntor 1912. U shënua edhe emri i atij që e ngriti : - Ismail Qemali. U shënua edhe vendi : -Vlora legjendare. Vatra e kuqe e Arbrit që qe i zënë për atë truall si rrapat shekullorë buzë Adriatikut. U habit Ballkani. U habit Evropa. U habitën të gjithë, kur pas pesë shekujsh, nga epoka e Skënderbeut në qiellin shqiptar u ngrit simboli i gjakut – Flamuri.

Mirë që u mashturan të gjithë. Mirë që kujtuan se nuk kemi asgjë, se kuçedra e Anadollit na gëlltiti ç'patëm. Po ajo mori shumë çka, gati na zhbiu, por s'mundi të na marrë atë më të vlefshmen, më madhështoren – fuqinë , trimërinë që i çoi në këmbë prore shpirtrat tanë të djegur për tokën e stergjyshërve. S'u harrua porosia e stërgjyshërve. E shpumë më tej dhe do të shpiem gjersa të gjallërojmë mbi këtë tokë të dashur.

I pari që e shpuri në vend porosinë e stërgjyshërve, ai që e ngriti atë që e mbanin lart ndër duar dhe mbi koka e që marshonin përpara me të, qe njëri ndër bijtë më të mirënjohur të kombit tonë - Ismail Qemali, Plaku mjekërbardhë. E ngriti Ai , e mbajtëm ne dhe do ta mbajmë ngaherë dhe do të ecim përpara në histori.

E mbajtëm në zemra, në shpirt. E kemi edhe në dorë. Duam që ta kemi kudo me të vërtetë simbol gjaku, lirie e pavarësie që na shpie më tepër dhe më me hov ndër fitore të reja dhe ngaherë të fitojmë.

("Bota e re", Prishtinë, 28.XI.1968)

Marrë nga vëllimi "Pavarësia dhe Demokracia" (intervista dhe artikuj) i korpusit të plotë të veprës së Rugovës, Shtëpia botuese "Faik Konica", Prishtinë 2005, f. 17-19.

KREU IV

VEPRIMTARI PËR KOSOVËN DHE NË KOSOVË

Poem kosovar (nga Mitrush Kuteli)

Jam kosovar
pra jam shqiptar :
Zot e krenar,
– Zot e bujar
mbi këtë Dhé,
q'e kam si fé,
e përmbi fé :
E kam Vatan !
e kam Atdhe !
Që gjysh stërgjysh,
që bres pas bres,
që gjithëmon !

IV. 1. 17 Shkurti 2008 do të shënohet përkrah 28 Nëntorit 1912

Marrë nga gazeta 55, 19 shkurt 2008

17 Shkurti 2008 do të shënohet përkrah 28 Nëntorit 1912. Qyteti i Flamurit në jug të Shqipërisë ka përjetuar ato emocione që u përjetuan 96 vjet më parë, kur u ngrit flamuri historik i shtetit Shqiptar. Flamuj kuq e zi kishin mbushur qytetin historik. Sheshi i Flamurit që, aktualisht, gjendet në rikonstruksion, ishte zbukuruar

me flamuj të mëdhenj dhe parullat "Kosova-Republikë, Rroftë Pavarësia e Kosovës".

Qindra vlonjatë, janë bërë pjesë e një marshimi simbolik të ngritjes së flamurit në qytetin jugor të Vlorës. Nga deputetët e këtij qyteti ka qenë vetëm deputeti i zonës Nr. 94, Bujar Leskaj. Një karrocë, si ajo që solli Ismail Qemalin, e zbukuruar me flamuj dhe 2 aktorë vlonjatë, veshur me uniformat e Ismail Qemalit dhe Isa Boletinit, kanë përcjellë një mesazh domethënës nga Sheshi i Flamurit deri në godinën në Skelë, ku aktualisht gjendet Muzeu i Pavarësisë dhe ka qenë godina që ka pritur Qeverinë e Ismail Qemalit, gjatë ushtrimit të detyrës. Në ballkonin e saj, deputeti Leskaj dhe pushtetarë të qytetit kanë simbolizuar ngritjen e flamurit shqiptar, si dhe i kanë uruar Kosovës Pavarësinë e madhe dhe të shumëpritur. Në mitingun e organizuar nga bashkia e qytetit në Sheshin e Flamurit, përshëndeti kryetari i bashkisë z. Shpëtim Gjika.

Deputeti i Vlorës, Bujar Leskaj, në mbrëmje ka qenë i ftuar në TV "Vlora Channel", në emisionin "Rrugëtimi i Kosovës drejt Pavarësisë" " së bashku me prof. Dr. Bardhosh Gaçe. Deputeti i Vlorës është pyetur lidhur me hapat që ka ndjekur Qeveria e Kosovës, në fillim të viteve '90. Leskaj ka vlerësuar figura të harruara nga regjimet, që kanë kontribuar në periudhën e Rilindjes tonë Kombëtare, si dhe më pas, atë të ngritjes së Flamurit në Vlorë. Leskaj ka vlerësuar rolin e Ibrahim Rugovës dhe hapat e matura të këtij burri shteti, me qëndrimin e tij gandist dhe me një politikë konsekuente, në favor të Pavarësisë së Kosovës. Ai ka përmendur pritjet dhe takimet e Rugovës në Vatikan, BE, Amerikë për të gjetur zgjidhje për çështjen e madhe të popullit kosovar. Deputeti Leskaj ka vlerësuar rolin e UÇK-së në kohën e fillimit të intervenimit të NATOS në Kosovë dhe rolin e Hashim Thaçit, këtij burri shteti që diti me maturi dhe pjekuri të udhëheqë UÇK.

Leskaj ka thënë se politikanët kosovarë janë më të pjekur se në Shqipëri dhe, kur vjen momenti për çështjen kombëtare, ata bëhen "njësh". Deputeti Leskaj ka përmendur se, piketat e para për urën e bashkimit midis Shqipërisë Mëmë dhe Kosovës, janë hedhur nga dy presidentët Berisha dhe Ibrahim Rugova, ku u projektuan edhe rrugët për në Kosovë dhe sot rruga Durrës-Kukës nuk është gjë tjetër përveçse ajo strategji për të lidhur dhe krijuar ura lidhjeje, mes dy vendeve të një gjuhe të përbashkët. Ai përmendi rolin e madh te SHBA dhe BE. "17 shkurti 2008 i Prishtinës, do të shënohet përkrah 28 nëntorit 1912 te Vlorës" përfundoi Leskaj.

Emisioni, i drejtuar nga gazetari Harilla Koçi, ka patur një audiencë të madhe.

IV. 2. Vizita në Kosovë e gazetarëve vlonjatë

Kosovë 18, 19, 20 Maj 2008

Me iniciativën dhe të sponsorizuar nga deputetit i Vlorës, Bujar Leskaj, rreth 20 gazetarë nga qyteti i Vlorës, përfaqësues të televizioneve lokale dhe medias së shkruara, zhvilluan këtë javë një vizitë tre ditore në shtetin e Kosovës, rreth 3 muaj pas shpalljes së pavarësisë. Mbërritja në Kosovë e një grupi të madh gazetarësh përbën një ngjarje të veçantë. Vizita ishte e shoqëruar me një program që përmbante një udhëtim nëpër qendrat historike, si dhe takime tepër të rëndësishme të grupit mediatik më të madh shqiptar që ka vizituar ndonjëherë Kosovën.

Një nga vendet më impresonuese është për shqiptarët e këtej kufirit edhe shteti më i ri në Europë. Tre muaj pas shpalljes së pavarësisë, rrugët e këtij shteti kanë kohë që popullohen edhe nga shqiptarët e vendit mëmë. Dhe e kundërta, mijëra kosovarë rrugëtojnë nëpër atë rrugë, drejt Shqipërisë. Një lëvizje që është pritur prej kohësh. Pavarësia e Kosovës, afroi atë pjesë të munguar e të shkëputur me forcë nga kirugjigja e pamëshirshme e fqinjëve në fillim të shekullit XX. Kjo tokë e populluar prej shekujsh nga shqiptarët, sot është e lirë dhe e pavarur.

Kryeqyteti i saj, Prishtina, një ëndërr e bukur që po përjeton një realitet të ri, shtetin kosovar të këtij shekulli. Katundet paskufirit, për nga bukuria janë pjesë e një magjistrali të përbërë prej një kurorë diademash. Një tokë, që mban të gjitha stinët brenda. Aty ka ardhur e është sendërtuar bukuria, në dimensionet më të mira që mund të konceptohen: lartësi malesh, fushash me mëngjese dimri të ftohtë acar dhe zheg vere. Udhëtimi për në veri të Ballkanit është nga më të bukurit. Aty, pas këtij kufiri, nuk ka më pjesë të ngrysur të Ballkanit. Aktualisht, shteti i ri pasqyron një pasqyrë që vezullon e shpërndan rreze lirie, të cilën, ne e të gjithë shqiptarët e kemi pritur me thirrjen: "Bac u krye!". Në një udhëtim në fundjavë, vijmë nga qyteti i Flamurit, buzë detit, në jugperëndim të vendit. Vijmë për të përshëndetur shtetin e ri të Kosovës dhe për ta prezantuar më mirë dhe më qartë në mediat e qytetit bregdetar.

IV. 3. Kryeministri, Hashim Thaçi, vlerëson deputetin Bujar Leskaj për vizitën e gazetarëve në Kosovë*)

Në kryeqytetin e Prishtinës grupi i gazetarëve dhe deputeti i Vlorës, Bujar Leskaj, u pritën në një takim të gjatë nga Kryeministri i Kosovës Hashim Thaci. Kryeministri Hashim Thaçi, në fjalën e tij i bëri një falënderim deputetit të Vlorës, Bujar Leskaj, për iniciativën e shkëlqyer e cila, sipas tij "ishte një ide, që i kishte munguar kohës, por që është një ide shumë e mirë, për të përcjellur një vizitë në kryeqytetin e Kosovës, me një grup gazetarësh të të gjitha mediumeve, të shkruara dhe elektronike lokale dhe kombëtare të këtij qyteti". Kryeministri Thaci në takim u tha gazetarëve nga qyteti i Flamurit se, "ndihej shumë falënderues për nderin që i bënë autoritetet e qytetit të pavarësisë Vlorës, duke i dhënë titullin: "Qytetar Nderi i Vlorës."

"Ne, gjithmonë, jemi krenarë për Vlorën dhe unë ndihem vlonjat", nënvizoi Thaçi. Kryeministri Thaçi, tha se, me rrugën Durrës-Morinë dhe më tej, qytetarët kosovarë do të vërshojnë edhe sivjet në bregdetin e Vlorës dhe të Shqipërisë. "Do të ketë një fluks të madh turistësh kosovarë në Shqipëri", tha Thaçi, duke ju bërë thirrje qytetarëve të shtetit më të ri në Europë, mesazhin për t'i kaluar pushimet në bregdetin jugor. Kryeministri Thaçi e cilësoi vitin 2008 "vit të shqiptarëve", përmes ngjarjeve të tilla siç ishin Pavarësia e Kosovës dhe Ftesa e Shqipërisë për anëtarësim në NATO. Në 15 Qershor, tha Hashim Thaçi do të hyjnë në fuqi Kushtetuta e Kosovës. Kryeministri kosovar, njoftoi gazetarët që kishin rrugëtuar nga qyteti i Flamurit për në Kosovë se, në agjendën e tij të punës po përgatitet një vizitë zyrtare në Shqipëri, e cila do të përfshijë dhe qytetin e Vlorës.

*) Nga IV.2 deri në IV.7 përshkruhet vizita e gazetarëve vlonjatë në Kosovë sipas reportazhit të botuar në gazeta.

IV. 4. Lutfi Haziri: Ura Bashkëpunimi

Për grupin e gazetarëve nga qyteti i Flamurit, shfaqi interes edhe ish zv/kryeministri, nënkryetari i L.D.K-së dhe kryetari i grupit parlamentar të LDK-së, Lutfi Haziri, i cili u kushtoi një pritje të gjatë .

Me ish zv/kryeministrin e Kosovës, Lufti Haziri, u zhvillua me interes një bisedë. Z. Haziri e nisi fjalën, duke përmendur ish-ministrin dhe deputetin e sotëm të qytetit të Vlorës, Bujar Leskaj, i cili, sipas tij "po krijon ura bashkëpunimi mes Kosovës dhe Shqipërisë edhe në këtë fushë me interes, siç është media që këto zhvillime pritet t'i përcjellë tek publiku i qytetit të Flamurit". Haziri, duke folur për këtë bashkëpunim, tha se "edhe mes dy qeverive ka rreth 60 marrëveshje, në shumë fusha që priten të konkretizohen".

"1.2 milion pushues priten të dynden kësaj vere në bregun shqiptar", tha ish zv/kryeministri i Kosovës. Duke folur për politikën kosovare Haziri tha se, "shteti kosovar ka qënë në procesin e njohjes dhe rreth 40 shtete e kanë njohur deri tani, ndërsa pritet që ky numër të shkojë deri në 100, ku përmbyllja e këtij procesi do të kërkojë më vonë zhvillime të tjera më të rëndësishme si ekonomike".

IV. 5. Takim me akademikun Rexhep Ferri

Akademiku Rexhep Ferri, një personalitet i respektuar i fushës akademike kosovare, përmendi dhe faktet historike nëpër të cilat ka ecur historia jonë, me 2000 vjet, "por që kemi qenë një komb i vuajtur", theksoi ai. Me heroin Skënderbe, Ali Pashë Tepelenën, me mitet e mëvonshme si ngritja e flamurit në 1912 me I.Qemali. Qytetin e Flamurit e ka vizituar vetëm njëherë. "Por, Vlorën e kam përjetuar nga larg e afër. Vlorën e kam përjetuar edhe në vitin 1997 ku ndodhën trazirat dhe përjetova se u kall Shqipëria, ku Vlora ishte qendra e tyre, aty u plagos flamuri….". Shprehja e akademikut Ferri në fund të përcjelljes ishte se, do të mbërrinte në qytetin jugor me histori flamuri.

IV. 6. Në Prekaz, tek shtëpia e nipit të Adem Jasharit

Për të shkuar në Prekaz, në vendin e famshëm tashmë, për të gjithë shqiptarët, na duhet të udhëtojmë për më shumë se 80 minuta. Jemi nisur në mëngjes nga Prishtina, për të shkuar në vendin, ku u zhvillua një nga ngjarjet më të rëndësishme, në përpjekjet për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Jemi një grup gazetarësh nga qyteti i Vlorës që, në kuadrin e një nisme të ndërmarrë nga deputeti, Bujar Leskaj, kemi ardhur në Kosovë, për t'u njohur nga afër me realitetin politik e shoqëror, me zhvillimet aktuale, me momentet që po kalon shteti më i ri në botë. Natyrisht edhe për të vendosur ura komunikimi mes Prishtinës dhe Vlorës, dy qytete që, kanë hyrë në historinë e kombit shqiptar, për simbolikën që përfaqësojnë. Në Prekaz, zemrën e Drenicës martire, na pret një realitet befasues për ne. Qindra të rinj, nxënës të shkollave nga qytete të ndryshme të Kosovës, burra, gra të të gjitha moshave, kanë mbushur sheshin që ndodhet shumë pranë kullës së Jasharajve. Në krah të djathtë, janë varret e atyre që dhanë jetën në atë luftë të pabarabartë me forcat policore serbe, në atë fillim marsi të vitit 1998, për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Ky vend, tashmë është shndërruar në një Mekë, apo në një Krujë të dytë, për të gjithë shqiptarët, brenda e jashtë Kosovës e Shqipërisë. Çdo ditë, këtu ka mjaft gjallëri. Qindra njerëz, vijnë këtu për të bërë homazhe në varret e Adem Jasharit, vëllezërve të tij, Hamzait e Refatit dhe të gjithë atyre që ranë në luftë për lirinë e Kosovës. Datat 4-5 dhe 6 mars të vitit 1998, shënuan edhe vigjiljen e atyre ngjarjeve madhore, që kulmuan me pavarësinë e Kosovës, në 17 shkurt të këtij viti. Adem Jashari, vëllezërit e tij, ja kushtuan jetën e tyre Kosovës. Beteja e atij fillim marsi, në fakt, nuk ishte e vetmja për ta. Në 31 dhjetor të vitit 1991 dhe, në 22 janar të vitit 1998, serbët nuk arritën t'i kapnin. Shfrytëzuan 4 marsin e 1998-ës, duke qenë të bindur se do t'i gjenin pranë shtëpisë.

7-8 mijë forca serbe, bënë një rrethim të plotë të të gjithë lagjes së Jasharajve dhe të kullës, ku ndodheshin 22 pjesëtarë të familjes. Ajo çka ndodhi në ato tre ditë, kujtohet me krenari. Ishte një luftë tërësisht e pabarabartë. Adem Jashari, komandanti legjendar i UCK, duhej të

asgjësohej patjetër. Kulla u sulmua me të gjitha llojet e armëve. Nga 22 pjesëtarë të familjes, që ndodheshin brenda saj, humbën jetën 20 prej tyre, ndërkohë që, numri i përgjithshëm i të vrarëve nga lagjja e Jasharajve, arriti në 56. Edhe sot, kulla është si atëherë. Në krahun e djathtë të saj, në një kthinë përdhese, dha frymën e fundit, Heroi i Kosovës, Adem Jashari. Ajo është tepër e vogël. Ka një tavan të ulët. Gjithçka ka mbetur ashtu, si 10 vjet më parë. Pranë oxhakut, një pikturë e dëmtuar e heroit të Kosovës. Në fakt, portretet e Adem Jasharit, i has ngado, këtu në këtë vend, por edhe në pjesë të tjera të Kosovës. Gjatë këtyre 10 vjetëve, këtu në Prekaz, kanë ardhur rreth 8 milionë vetë. Nga të gjitha skajet e Kosovës dhe të Shqipërisë, nga të gjitha vendet ku jetojnë shqiptarë, nga vende të ndryshme të botës. Nuk mund të njohësh e të perceptosh historinë e Kosovës, pa ardhur këtu në Prekaz, në zemrën e Drenicës, së Azem e Shote Galicës. Pak më tej, në një mjedis familjar, tepër të këndshëm, na pret nipi i Adem Jasharit, Murati. Së bashku me të edhe Ramadan Gashi, deputet i Kosovës, ish kryetar i komunës. Murati është një figurë tepër e njohur, këtu, në Kosovë. Të qenit pinjoll i familjes së Jasharajve, për të përbën një krenari të veçantë. Gjithë kohës është i buzëqeshur. Pas bisedës telefonike me deputetin Leskaj, u tregua tepër i gatshëm të na presë, pavarësisht angazhimeve të tij të shumta, të atij momenti. Na pret tek dera dhe na udhëheq në sallon. Deputeti Leskaj dhe të gjithë ne, e falënderojmë. Leskaj veçon kontributin e familjes Jashari në historinë dhe përpjekjet për lirinë e pavarësinë e Kosovës. Ai thotë se, Heroi i Kosovës, Adem Jashari, është simbol i qëndresës së të gjithë shqiptarëve dhe i përket gjithë kombit. Leskaj, vlerëson qëndrimin e Murat Jasharit, pinjoll i familjes së njohur, duke u shprehur se ai ka ditur të mbajë emrin e historisë së saj.

Për Muratin, të jesh pasardhës i kësaj familjeje, është një nder dhe përgjegjësi, ndaj kombit, ndaj vlerave të historisë, ndaj të gjithë shqiptarëve. Ai thotë se, Adem Jashari u përket të gjithëve. “Pas asaj ngjarjeje, ku mbetën të vrarë 20 pjesëtarë të familjes sonë, i thanë axhës, diku në një vend perëndimor: “shumë t’u vranë, 20 vetë...”. “Vërtetë janë shumë. Mua më humbën 20 vetë, por fituam 7 milionë (shqiptarë)”. Pasi përfundoi studimet në Gjermani, Murati ka zgjedhur rrugën e jurisprudencës, së cilës i është përkushtuar plotësisht. Nuk i është futur politikës. Kjo, për të respektuar historinë e familjes dhe të traditave të saj. Adem Jashari dhe të gjithë pjesëtarët e tjerë të familjes, që kanë dhënë gjakun e tyre për Kosovën martire, nuk mund t’i përkasin asnjë krahu të politikës. Ata janë vetë historia e Kosovës, janë historia e kombit shqiptar. Me këtë qëndrim ka qenë përherë Murati dhe këtë qëndrim do të mbajë edhe në të ardhmen.

Madje, këtë ai e ka reflektuar në jo pak raste edhe në ngjarje të veçanta që, i kujton herë herë, sikundër ajo me një ushtarak të lartë të forcave të KFOR, të cilit i tha se, Kosova duhet të ishte edhe e atij, që kishte ardhur të shërbente këtu.

Gjatë mjaft viteve, forca të ndryshme politike në Kosovë, e kanë ftuar për të qenë pjesë e tyre. Madje, ka patur edhe oferta për të qenë në kabinetet qeveritare. Por, ai i ka qëndruar besnik mendimit për të ruajtur jashtë çdo ngjyrimi politik, historinë e familjes, kontributin e saj për Shqipërinë. Me një buzëqeshje tepër fisnike, që nuk i fshihet asnjëherë nga buzët, Murati, thotë se Shqipërinë dhe Vlorën, i njeh si një qytetar shqiptar. Me deputetin Leskaj, kanë një miqësi të hershme, që e reflektojnë herë herë përgjatë bisedës. Tashmë, ka edhe një arsye më shumë për të ndërtuar ura të reja komunikimi shpirtëror me Shqipërinë, me Vlorën. Na përcjell deri tek dera ku, ndahemi me besimin se, do të takohemi sërish, shumë shpejt.

IV. 7. Vizita në institucione kulturore në Prishtinë

Gjatë këtij turi, gazetarët e qytetit të Vlorës, zhvilluan takime me deputetë të Kuvendit të Kosovës, ish deputetin dhe një nga nismëtarët e krijimit të LDK, Veli Bytyçi, etj. Pjesë e programit, ishte një vizitë në varrin e ish Presidentit të Kosovës, Ibrahim Rugova. Po ashtu, gazetarët vlonjat, vizituan edhe Muzeun Etnografik, shpellën e famshme të Gadimes, Shtëpinë Muze të Lidhjes Shqiptare. Grupi i gazetarëve të qytetit jugor u ndal nëpër qendra historike të Prishtinës, si dhe të qyteteve të tjera kosovare. Kjo është vizita e parë e një grupi të organizuar mediatik nga qyteti i Flamurit drejt shtetit më të ri në botë, Kosovës, e mundësuar nga sponsorizimi i deputetit vlonjat Bujar Leskaj.

Shënim: Marrë nga ATSH (Gazetar Harrilla Koçi) dhe gazeta 55, 21 maj 2008 (gazetar Gëzim Llojdia).

Vizitat dhe takimet u transmetuan si kronike e zgjeruar në TV 6+1 Vlora, TV Apollon, TV Vlora Channel si dhe në News 24, TV Fokus e TV Amantia, si dhe u paqyrua në gazeta të ndryshme.

IV. 8. Një udhëtim i paharruar me deputetin Bujar Leskaj, në trojet shqiptare*)

Një përfaqësi e ish të përndjekurve politikë vlonjatë në Kosovë dhe Maqedoni

Kosovë 29, 30, 31 Tetor 2008

Në vazhdën e aktiviteteve që zhvillon deputeti, Bujar Leskaj, me vëllezërit tanë që jetojnë në viset Shqiptare në Maqedoni dhe në Kosovën e lirë, për specifikat e tyre në luftën për liri dhe dinjitet kombëtar, kundër barbarive serbe, për njohjen e vlerave kulturore më atë anë të kufirit tonë, për njohjen e bukurisë dhe vlerave të tokave tona, ishte dhe aktiviteti që u zhvillua me një grup qytetarësh vlonjatë, i përbërë prej:

- familjeve të vjetra vlonjate si Sharrajt, Xhyherajt, Llupajt etj.
- Familjeve të persekutuar egërsisht prej regjimit diktatorial komunist si Shaskaj, Xhaferaj, Bonjakaj, Petritajt, Agajt, Koshenjat, Shehajt, Leskajt, Cakrani, Hoxhajt etj.
- Të burgosurve politikë Ceno Caushi, Shemsi Rrapi, Kujtim Murati, Ramadan Muço, Luan Llupa, Reshat Kripa, Bari Çeprati, Feti Rexhepi, Enver Shaqiri, Lavdosh Beqo, Et'hem Kurti etj.

Grupin e hijeshonin dhe dy zonja: znj. Linda Sharra dhe znj. Paqyze Petriti, si dhe ish deputeti i partisë Demokratike, shkrimtari dhe publicisti lushnjar, Izet Shehu, i cili është lidhur me Vlorën nga gjyshi i tij, patrioti i njohur, Sheh Karbunara. Grupit i shtonte larminë shoferi Nesti Pashaj, i cili i shërbeu grupit në të gjitha rastet ku ndaluam, veç të tjerave edhe me humorin e tij. Pas një grupi gazetarësh dhe një grupi të rinjsh të qytetit të Vlorës, ky ishte grupi i tretë, i organizuar nga deputeti Leskaj, që ndiqte këtë itinerar. Ky udhëtim u realizua nën kujdesin e Z. Agron Sharra, kryetari i Partisë Demokratike të Vlorës.

*) Nga IV.8 deri në IV.18 përshkruhet vizita sipas reportazhit të botuar në gazeta.

IV. 9. Në Tetovë rrëzë Malit të Sharrit

Pasi kaluam kufirin në Qafë Thanë; në Strugë u ulëm rreth deputetit Bujar Leskaj, për të pirë një kafe. Biseda rrodhi e këndshme. Gjithkush jepte emocionet që i ngjallte ky udhëtim.... Astrit Xhaferi thoshte se shkelte për herë të parë në Kosovë e Maqedoni dhe, prandaj, ky udhëtim ishte i dëshiruar, i mirëpritur dhe emocionues. Ndërsa Ceno Caushi, me lot në sy tregoi se, për herë të parë e kishte kaluar atë kufi në vitin 1944, në këmbë, me batalionin e Ballit Kombëtar, "kur erdhëm për të çliruar dhe mbajtur Kosovën dhe viset e tjera kombëtare, por ishim tradhtuar prej komunistëve, shërbëtor të Titos". Aranit Hoxhaj, kujtonte se ëndrra e babait të tij, të pushkatuar prej komunistëve vlonjatë, ishte bashkimi i Kosovës me Shqipërinë.

U nisëm drejt Kërçovës, Gostivarit, Tetovës. Kërçova më kujtoi xhaxhanë e babait, Selam Musa Hitaj, i cili, që prej vitit 1941 deri më 1944, me gjithë familjen kishte shkuar atje për t'u mësuar fëmijëve gjuhën e bukur shqipe. Ishin mbi 200 pishtarë të dijes që, qeveria e kohës dërgoi në viset shqiptare, duke bërë realitet bashkimin e trojeve shqiptare.

Në raste të tilla i kthejmë sytë pas, në histori dhe shohim më me vëmendje çdo rrugë e rrugicë, çdo shtëpi apo shkollë, sepse na duket se do të gjejmë gjurmët e të parëve tanë, të atyre burrave fisnikë që u sakrifikuan për bashkimin e trojeve shqiptare.

IV. 10. Takim me personalitetin e shquar z. Arbën Xhaferri

Ja, ku u shfaq para nesh dhe Tetova jonë, e shtrirë rrëzë të malit të Sharrit, atij mali që ka mbajtur dhe strehuar luftëtarët shqiptarë të lirisë.

Mikpritësi ynë në Tetovë ishte z. Miftar Ziberi, profesor i Universitetit të Tetovës, i cili i uroi deputetit, Bujar Leskaj, mirëseardhjen dhe na ftojë për drekë "me bukë e kripë e zemër", sipas zakonit të shqiptarit. Gjatë drekës, u shkëmbyen biseda të cilat përshkoheshin fund e krye nga dashuria vëllazërore dhe nga nevojat e bashkëpunimit dhe vajtje ardhje ndërmjet nesh, për të përforcuar më tepër dashurinë.

Në pasdite, na priste një takim i dëshiruar me personalitetin e njohur të politikës dhe atdhetarisë shqiptare, Kryetarin e Asamblesë së Partisë Demokratike Shqiptare të Maqedonisë, z. Arbën Xhaferi, i cili edhe pse i sëmurë, nuk lodhet së punuari dhe luftuari për çështjen tonë kombëtare. Na priti përzemërsisht dhe na tha se: "Vlora është tingëllim atdhetar. Vlorë ka kudo ku janë viset shqiptare edhe në shtëpinë time, vajzën time e quajnë Vlora....

Partia Demokratike Shqiptare ka në vijën e saj politike nacionalizmin, dashurinë për këtë vend dhe për këtë popull që quhet shqiptar, kudo ku jetojnë në viset e tyre. Nacionalizmi është fenomen evropian dhe për këtë s'duhet të jetë i huaj, as për ne shqiptarët. Nacionalizmi nuk është mburrje, por nevojë kombëtare".

Z. Arbën Xhaferi ju përgjigj pastaj pyetjeve që ju bënë.

Z. Xhevat Leskaj pyeti, si ka mundësi që, intelektualë të Kosovës të festojnë 100 – vjetorin e diktatorit Enver Hoxha? "Ne kemi edhe mangësi në gjykim e në vlerësim. Enver Hoxhën, këtu, tek ne, nuk e kanë njohur ashtu siç ka qënë ai, një diktator që ja ka kaluar edhe Stalinit. Ata që kujtojnë Enver Hoxhën nuk kanë pjekuri intelektuale dhe politike. Ne duhet të mos harrojmë se dy janë sot rreziqet tona: fundamentalizmi fetar dhe komunizmi, të cilat duhet të mbyllen si proces historik".

Z. Devi Sharra, u interesua për shuarjen e divergjencave midis partive politike shqiptare.

"Demokracia – tha z. Arbën Xhaferi, - do të thotë mendime të kundërta, nuk duhet të pretendojmë për unitet totalitar, si në komunizëm. Në sajë të këtyre mendimeve, ne arritëm që, në Ohër të ndryshojmë Kushtetutën për të drejtat e shqiptarëve, për ato të drejta që kanë nevojë shqiptarët."

Z. Avni Agaj pyeti se, si është zgjidhur problemi i ndarjes së pronave në Maqedoni?

"Për pronat në Maqedoni, nuk ka probleme sepse, prona nuk i është marrë apo grabitur asnjëherë shtetasit jugosllav, serb, maqedonas apo shqiptar qoftë, ashtu siç ka ndodhur në Shqipëri dhe, si në fshat dhe në qytet, shtetasi maqedonas dhe ai jugosllav, e kanë trashëguar pronën".

U ndamë me këtë shqiptar të ditur dhe të madh vëllazërish dhe të nesërmen në mëngjes kaluam kufirin e Maqedonisë tek Hani i Elezit, kaluam Lapencin që më kujtonte Lapencin tim, Kaçanik, Ferizaj dhe u ndalëm në Gadime.

IV.11. Në Shpellën e Mermerit të Gadimes së Ferizajt

Deputeti, Bujar Leskaj, kishte planifikuar një befasi tjetër gjatë udhës për të mbërritur në Prishtinë. Në këtë fshat më 1969, teksa Ahmet Asllani po gërmonte në një kodër për të nxjerrë gurë për nevojat e tij, qysqyja i ra në një vrimë dhe nuk mundi dot ta kapë. Duke gërmuar e kërkuar qysqynë, atij i doli përpara një hapësirë nëntokësore, shumë e bukur. I befasuar, ai njoftoi organet e pushtetit lokal dhe kështu u zbulua një hapësirë e habitshme nëntokësore, shumë e bukur. Kështu u zbulua një nga monumentet më befasuese të natyrës shqiptare Shpella e Mermerit e fshatit Gadime të Ferizajt. Ajo u hap si qendër për vizitorët më 1974. Deri tani vizitohet afro 1.5 km shpellë. Është shumë më e gjatë, ndoshta 15 km; ajo mund të shkojë në Janjevë, atje ku kishte shtëpinë Shqiptari i madh, Shtjefën Gjeçovi e sot shtëpia e tij është shndërruar në muzeum, për të edukuar shqiptarët, pra afro 15 km larg. Sipas studimeve, kjo shpellë ka një vjetërsi prej 18 milion vjetësh. Ky monument natyror me vlera i kulturës sonë, të mahnit me bukurinë e tij, me kthesat e xhepat e shumtë, si format e bukura që ka marrë gjatë miliona vjetëve, me stalaktite dhe stalagmite, të tilla që në rajon nuk janë parë ndonjëherë. Shpella ka dy kate, me bukuri të rralla. Tani mund të vizitohet vetëm njëri kat. Nën shpellë ndodhet liqeni nëntokësor me afro 500 m. Edhe udhëheqësi ynë gjatë shpjegimit u dha formave të çuditshme të shpellës tingëllimin atdhetar. "Ja, tha ai, shikoni këtë a nuk është kjo shqiponja dy krenare e flamurit tonë? Më tej shihni, a është kjo fytyra dhe mjekra e Skënderbeut?", e kështu me radhë. Kjo lidhje dhe mënyrë shpjegimi duhet në Kosovë, por edhe në Shqipëri.

IV. 12. Homazhe në varrin e Rugovës

Në Prishtinën e Rugovës, atje ku u përgatit Pavarësia e Kosovës.

Prishtina është kryeqyteti i Kosovës sonë me mbi 500 mijë banorë. 15 km nga Prishtina është zbuluar qyteti Ulpiana, i ndërtuar në kohën e romakëve, i pasur në shumë monumente të tjera historike dhe natyrore si, Tyrbja e Sulltan Muratit, shtatorja e Skënderbeut, Shtatorja e Nënë Terezës, Liqeni i Batllavës, Sahat Kulla, Xhamia e Madhe, Muzeu i Kosovës etj. Sapo hymë në Prishtinë, deputeti Bujar Leskaj na udhëhoqi në atë kodrën ku rri ndezur flaka e lirisë, ku ngrihet varri monumental i shqiptarit të madh, Presidentit të nderuar, Ibrahim Rugovës. U ndalëm para atij varri të bardhë si shpirti i Ibrahim Rugovës, u përulëm me nderime para veprës dhe shpirtit të tij. Me veprën e tij, Rugova radhitet ndër shqiptarët më të mëdhenj, krahas Ismail Qemalit dhe Isa Boletinit, por deputeti Bujar Leskaj që nuk lodhet së foluri për Ibrahim Rugovën, shkon më larg; ai e krahason Rugovën me simbolin e Kombit Shqiptar, me Skënderbeun. Para varrit të Rugovës, çdo njeri mendon masakrat serbe ndaj popullsisë shqiptare....Gjatë Luftës së Dytë Botërore, trojet shqiptare u ribashkuan, por pas përfundimit të saj, Kosova, në mënyrë të dhunshme, prapë u ripushtua nga Jugosllavia.Të drejtat e shqiptarëve u shkelën në mënyrë sistematike. Me dhunë u shpërngulën në Turqi 250 mijë shqiptarë. Më 1989, qeveria serbe suprimoi autonominë e Kosovës. Mijëra shqiptarë u keqtrajtuan, nga policia serbe, ndërsa mbi 400 mijë u detyruan të emigrojnë në Evropë dhe në SHBA. Kësaj dhune dhe shtypjeje do t'i jepte fund shqiptari i madh, me emrin Ibrahim Rugova....

IV. 13. Vizitë në Galerinë e Arteve Prishtinë

Të heshtur, të emocionuar lamë pas varrin frymëzues të Rugovës dhe zbritëm në Galerinë e Arteve. Z. Leskaj si njohës i mirë i pikturës dhe koleksionist i saj, na shpjegoi për vlerat e piktorëve të Kosovës por, mbi të gjitha, dalloi dhe lartësoi z. Luan Mulliqi, i cili njihet në trojet shqiptare si një skulptor me emër. Por, veçanërisht në Shqipëri ai njihet prej shtatores së Nënë Terezës, e vendosur në Aeroportin e Rinasit, shtatore e cila na prezanton me madhështi me botën e jashtme. Z. Mulliqi na shpjegoi e komentoi veprat e artit të ekspozuara aty, pastaj foli për aktivitetin e tij kulturor dhe atdhetar, ku ndërmjet të tjerash tha: "Veçoria e punës sime është se unë punoj me temën, pra, unë e mendoj e saktësoj dhe pas kësaj filloj punën. Në veprat e mia mbizotëron simbolika, le të kujtojmë ciklin e grave që patë, ku një grua paraqitet si shtatzënë e ajo që do të lindi prej saj, është liria e Kosovës. Po kështu edhe lëvizja femërore për emancipim është shprehur me anë të simbolikës. Vepra ime përshkohet nga ndjenja atdhetare, prandaj krijimtaria i është kushtuar personaliteteve që i sollën lirinë Kosovës, si profesor Fehmi Agami, Presidenti i nderuar Ibrahim Rugova, Komandant Adem Jashari, ndërsa figurën e Skënderbeut unë e kam parë jo vetëm si luftëtar, por edhe si diplomat". U larguam nga Galeria e Arteve të Kosovës me ndjenjën se, kishim parë një pjesë të kulturës tonë kombëtare.

IV. 14. Takim i vlonjatëve me akademikun Rexhep Ferri

E diela në mëngjes, na kishte rezervuar një të pa pritur tjetër të këndshme, takimin me piktorin, shkrimtarin dhe akademikun, Rexhep Ferri. Deputeti, Bujar Leskaj, i pa lodhur kërkon të thithë gjithçka duhet nga ai takim me Akademikun. Përpara takimit ai na foli për vlerat e këtij personaliteti të kulturës kosovare. Duke përfshirë edhe pikturën. "Ja, na tha ai, ato pikturat tek "Grand Hoteli" ku flinim dhe pushonim ne, ishin pikërisht të këtij, Rexhep Ferrit". Emri i tij na kujton luftëtarin e madh, Jakup Ferri. Kur mësuam se, pikërisht Rexhep Ferri vinte prej asaj familjeje, respekti për të na u shtua edhe më tepër. Rexhep Ferri i madh nga trupi, i madh nga vepra e tij, i madh në dashurinë dhe kontributin për kulturën shqiptare, erdhi i ngarkuar me dy pako të rënda me libra. Mosha nuk e kish penguar të ngrinte atë ngarkesë, dashuria për vëllezërit e tij i kishte dhënë fuqi. Ai u dhuroi të gjithë pjesëmarësve nga një vepër të tij dhe gjithashtu edhe një dhuratë për bibliotekën e Vlorës. Fjala e Akademikut Ferri, u dëgjua me interes të madh dhe me dashuri, Mes të tjerash ai tha: "Babi ka qenë mësues dhe, së bashku me Esat Mekulin kanë hapur shkollën shqipe në Plavë, ndërsa sot për fatkeqësinë tonë në Plavë dhe Guci nuk ka shkolla shqipe....Babi vdiq në Durrës, dy ditë pas rrëzimit të shtatores së Enver Hoxhës, ku kishte marrë pjesë dhe vëllai im. Unë e kuptoj se ç'kini hequr nën diktaturën e Enver Hoxhës, sepse, atë që ka bërë Enver Hoxha me ju, nuk e ka bërë Titua me ne.....Ne vllazërit tuaj më këtë anë të kufirit, e mbajmë shpresën gjallë duke dëshmuar idetitetin tonë dhe qëndresën tonë. Mbi 250 vajza në Prishtinë mbajnë emrin VLORA. Erëra të mira po fryjnë për kombin tonë. Rruga Durrës-Kukës-Morinë, është një vepër e madhe që po realizoni dhe, për këtë, merita i takon kryeministrit z. Sali Berisha, i cili do të mbetet në historinë e kombit tonë nga personalitetet më të shquara, pikërisht për këtë vepër. Unë i kamë thënë z. Sali Berisha se, si president edhe mund ta harrohesh, se je Kryeministër edhe

mund të harrohesh, por, me rrugën që po ndërton, do të kujtohesh gjthnjë në historinë e kombit tonë".

Më pas, z. Ceno Caushi iu drejtua Akademikut Rrexhep Ferri, duke i thënë se "këtij zotnisë që unë kam në krahun e djathtë, i kanë pushkatuar babanë, Bajram Xeba nga Berati dhe gjyshin. Këtij që kam në krahun tjetër, i kanë pushkatuar babanë, Tasim Halilin e Kaninës, në moshën 35 vjeçare. Kështu jemi të gjithë ne, që na ke këtu përpara". Zoti Fahri Shaska, i cili me gjakftohtësinë që e karakterizon, i kërkoi leje akademikut t'i lexonte një shkresë zyrtare të Prokurorisë së Lartë Ushtarake, drejtuar Gjykatës së Lartë Ushtarake, e cila tregonte se përse i kishte pushkatuar Enver Hoxha shqiptarët.

"Sot, më datën 3 korrik 1946, në orën 5 të mëngjesit, u ekzekutuan të dënuarit me vdekje Qenan Dibra, Hivzi Golja, Sami Ceribashi, Telat Drini, Tut Mëniku, Xhahit Koka, Mehmet Alibeshiri, Shaban Balla dhe Ali Kavaja. Fjala e fundit e secilit në çastin e ekzekutimit ishte:

1. – Telat Drini: Rroftë Shqipëria me Kosovën.
2. – Hivzi Golja " " "
3. – Tut Mëniku " " "
4. - Qenan Dibra " " "
5. - Xhahit Koka " " "
6. - Mehmet Alibeshiri: " " "
7. - Shaban Balla: Ju lë kujdes fëmijën
8. - Ali Kavaja: Rroftë Zogu i Parë Mbret i Shqiptarëve. Rroftë Shqipëria me Kosovën .
9. Vdekjen e kemi hakë.
10. – Sami Ceribashi : Më në fund, t'u plotësua dëshira o prokuror. Edhe ti një ditë do ta paguash, si unë. Rroftë Shqipëria me Kosovën.
11. Qenan Dibra, dorëzoi një letër drejtuar familjes, me lutje që t'u dorëzohet. Firmosur prej prokurorit të Gjykatës së Lartë Ushtarake: Kapiteni i Parë, Nevzat Haznedari.

"Ja, pra, se përse shqiptarët kanë vajtur drejt plumbit dhe litarit", shtoi z. Shaska. Me këtë grup tha ai, është dënuar edhe babai im, prandaj ne shqiptarët e Shqipërisë nuk e presim mirë kur intelektualë, apo deputetë të Kosovës, festojnë 100 vjetorin e diktatorit të shqiptarëve, Enver Hoxhës. Pas kësaj, salla u ndez nga ndjenja e atdhedashurisë. Zoti Enver Shaqiri tha se ai ishte dënuar më 1986, sepse ishte anëtar i një grupi për të luftuar për bashkimin e Shqipërisë me Kosovën. Profesor Vangjel Pici, kujton kohën e hidhur, por edhe të lumtur kur kishin pritur në vitin 1999 vëllezërit kosovarë. "Të hidhur prej asaj që pësuan vëllezërit tanë, por të lumtur se ata gjetën këtu, në Shqipëri, pritjen vëllazërore dhe ne sot

gjendemi këtu, për të puthur me lot në sy tokën heroike kosovare, të larë me gjakun e sa e sa heronjve që nga 1912 deri më sot", tha profesor Pici. Pastaj, ai kujtoi një fragment bisede me një familje kosovare në Vlorë. Ditën që ata do të ktheheshin në vatrat e tyre, ai u kish thënë:

Ku shkoni ? – juve i kini shtëpitë të djegura.

Ani bre burrë, ju përgjigj trimi kosovar, kanë mbet themelet!

Profesor Pici i dhuroi z. Rexhep Ferri një libër të tij. Z. Reshat Kripa, kryetar i Shoqatës Kombëtare të të Persekutuarve Politikë Antikomunistë të Tiranës, tha ndërmjet të tjerave:

"17 shkurtin 2008, ditën e Pavarësisë së Kosovës, e kam përjetuar si 28 nëntorin e vitit 1912, në Vlorë. Askush s'mund ta ndaj kombin tonë në dy pjesë, për këtë bashkim shumë atdhetarë vlonjat në kohët e vështira të luftës 1941-1944 kanë ardhur e punuar këtu, në Kosovë, për bashkimin e kombit tonë, ndërmjet tyre dhe shumë vlonjat si p.sh vjehrri im, Ago Agaj, Kudret Kokoshi, etj". Edhe Z. Reshat Kripa i dhuroi Z. Ferri një roman të shkruar prej tij. Zoti Lavdosh Beqo, tregoi se, në burgun e Burrelit kishte pasur një kosovar, të cilit i shkruante djali i tij nga Kosova : " Babë thuaj baca Enverit të na japë armë se po na vrasin serbët!". I shkreti djalë. Nuk e dinte se i ati kish përfunduar në burgun famëkeq të Burrelit, për të vetmin faj, se e donte shumë vendin e tij. Zoti Nexhat Xhelo, i pa lodhur me kamerën e tij, mundohej të fiksonte çdo çast, fragmente bisede, jo vetëm në këtë takim, por në të gjithë udhëtimin tonë të gjatë dhe të bukur.

IV. 15. Në Prekaz të Skënderajt, në vendin ku edhe burrat derdhin lot

Mëngjesi i së dielës, më 26 tetor 2008, na gjeti në Prekazin e Skënderajt. Sapo hymë në luginën e Drenicës na pushtojnë emocione të shumta. Në mikrobusin tonë ra heshtja. Edhe deputeti ynë i nderuar z. Leskaj, nuk fliste më, dukej sikur ai vend fliste vetë, me gjuhën e historisë, më mirë se çdo orator tjetër i zjarrtë. Na duket sikur para nesh do të na dalë burri legjendar, Azem Galica që u shua për lirinë e Kosovës, na duket sikur para nesh do të dalë nusja e lirisë së Kosovës, Shote Galica. Ndërsa na duket sikur do të na presë trimi legjendar, Adem Jashari, komandanti i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Po, ai do të na presë, me të vërtetë. Se Ademi është gjallë. Atë e pamë të gjallë në çdo qytet të Kosovës, në çdo monument të saj, atë e pamë të gjallë në palat e flamurit tonë kombëtar, në flamurin e Kosovës sonë të lirë e të pavarur. Një anonim kishte shkruar në librin e përshtypjeve të kullës së Adem Jasharit: " Sa herë që rrezikohet liria, njeriu duhet të kujtojë Drenicën. Sa herë që na kaplon dobësia njerëzore, duhet të marrim fuqi nga Dheu i Drerave. Sa herë që përgjumemi dhe ligështohemi si shqiptarë, na pret një truall i shenjtë, që na ndihmon të ngrihemi përsëri në këmbë dhe të shohim nga drita. Se, Drenica e Jasharëve, është drita e lirisë Kosovare, drita e përtëritjes shqiptare! I falem!". Sa mirë që, ky shqiptar nuk e ka vënë emrin e tij në këtë shënim, sepse ai ka shprehur mendimin dhe dëshirën e të gjithë shqiptarëve, kudo ku jetojnë, mendimin e popullit të tij.

Drenica ndodhet në qendër të Kosovës, ka një sipërfaqe prej 700 km 2, ose 6% të sipërfaqes së Kosovës, një popullsi prej 140.000 banorë, të gjithë shqiptarë, ose 6.5 % të popullsisë së Kosovës. Mosha mesatare e popullsisë është 23 vjeç.

Prekazi, fshati më i rëndësishëm i Drenicës, ka 3876 banorë. Millosh Kopiliqi, luftëtari i shquar shqiptar, që udhëhoqi betejën e Fushë Kosovës në 1389, ishte nga Drenica, Hasan Prishtina që mbajti kuvendin e 5 majit 1912, ishte nga Drenica, Azem Galica dhe nusja e tij, Shote Galica, që udhëhoqën rezistencën kundër pushtimit

serb nga 1920 deri më 1932, ishin nga Drenica, Shaban Polluzha, që udhëhoqi rezistencën kundër ripushtimit të Kosovës, më 1945, ishte nga Drenica, i cili u vra pabesisht prej komunistëve të pabesë shqiptarë. Po kështu, shkëndijat e rezistencës ndaj barbarëve serbë më 1986 dhe 1981, lindën këtu, në Drenicë. Lufta e Tahir Mehës, rezistenca e tij më 13 maj 1981 me të atin Nebiun, është vazhdimi i qëndresës për ruajtjen e pragut të nderit Kombëtar, është preludi i sakrificës më sublime në altarin e lirisë.....

Kjo është shkurt, Drenica dhe ky është Prekazi i Adem Jasharit. Por, historia nuk mbaron këtu. Në Prekaz të Drenicës, lindi komandanti legjendar dhe udhëheqësi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Adem Jashari. Ai lindi në një ditë fatlume për shqiptarët, pikërisht më 28 nëntor 1955. Në luftën e fundit 1997, 1998, 1999 vetëm nga Komuna e Skënderajt, ku bën pjesë dhe Prekazi, janë vrarë 1.028 vetë, nga Prekazi janë vrarë 109 vetë, janë zhdukur 80 vetë. Deri tani janë zbuluar 17 varreza masive dhe kërkimet vazhdojnë.....

Kulla e Adem Jasharit në Prekaz, ose kalaja e lirisë së shqiptarëve, u rrethua tre herë prej forcave barbare serbe, më 30 dhjetor 1991 më 22 janar 1998 dhe 5 mars 1998.

Në rrethimin e tretë, nga 30 anëtarët e familjes heroike të Adem Jasharit, 22 prej tyre u gjendën të rrethuar. Atë ditë, Ademi, që nuk flinte, e dalloi rrethimin dhe nuk bëri demarshe për të dalë. Ai u tha familjarëve të tij : " Sot do të kemi luftë, qoftë e hairit !".

Po fillonte beteja më e pashembullt në histori. Një shtet i tërë me të gjithë llojet e makinerisë luftarake, veç aeroplanëve, po sulmonte një shtëpi të vetme, apo të shumtën një lagje të vogël, që nuk përbënte as sa një togë të armatosurish. Lufta kish filluar, krismat ngjanin më tepër me gjëmim moti. Qëllonte artileria, tanke dhe topa të vendosura rreth lagjes së Jasharëve, po villnin zjarr drejt kullës së Adem Jasharit.

Brenda kullës, të gjithë ata që mund të mbanin pushkë, kishin zënë pozicione. Të tjerët, përfshi edhe fëmijët, furnizonin me municione.

Ademi, ky kreshnik i legjendave, nuk e ndalte këngën. " Vdekje më e mirë se kjo, nuk mund të bëhet", u thoshte ai familjarëve luftëtarë. Prekazi u ngre në këmbë, të tjerë sapo dëgjuan krismat vrapuan të luftonin.

I pari ra në fushën e betejës Miftar Reshi, i cili kishte vrapuar jashtë rrethit tii vinte në ndihmë komandantit. Pas tij, në kullë, ra Adilja tek po i çonte fishekë bashkëshortit. Kështu vazhdoi lufta, tre ditë dhe dy netë. Në fund, një predhë topi e kalibrit të madh, kishte

goditur kullën nga prapa. Goditja ishte fatale. Nga 14 familjarë të Adem Jasharit, shumica fëmijë që ndodheshin atje, u vranë 13 prej tyre. E, me gjithë këtë, jeta e Adem Jasharit nuk u ndal asnjë çast, deri sa ra heroikisht para derës së shtëpisë. Kënga e tij u ndërpre për t'u kthyer në këngë. I fundit fare, me automatik në dorë, ra Kushtrimi, djali i Ademit, 13 vjeçar.

Amaneti i Komandantit, kishte shkuar në vend. "Asnjë të mos binte i gjallë në duart e serbëve", kishte thënë ai. Kishin rënë heroikisht në fushën e betejës, 20 familjarë të Adem Jasharit, ndërmjet të cilëve, Valdetja 15 vjecare, Ikbali 13 vjeçar, , Afteja 17 vjeçe , Besimi 16 vjeç, Liria 14 vjeç, Blerimi 12 vjeç, Fatmija 9 vjeçe, Blerina 7 vjeçe, Kushtrimi, djali i Ademit, 13 vjeç.....

Barbarët serbë, nuk lejuan që njerëzit të varrosnin kufomat. Vetëm më 11 mars, 6 ditë pas fillimit të betejës, ata u larguan natën nga Prekazi. Atë ditë, banorët hapën gropat dhe varrosën 153 dëshmorë të lirisë, nga të cilët 20 ishin familjarët e Adem Jasharit.

Barbaria serbe, zgjoi botën e qytetëruar nga gjumi dhe njëkohësisht i dha hov lëvizjes për çlirimin kombëtar. Në ballë të luftës tashmë printe kënga për Komandantin legjendar, Adem Jasharin. Në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës u radhitën të gjithë pjestarët e tjerë të mbetur gjallë të familjes së Adem Jasharit: Shqipja 20 vjeçare, vajza e Adem Jasharit, Bashkimi 20 vjeçar, Sahiti, Musaj, Hatixhja, Xhemilja, Regipi..... Të gjithë këta luftuan me armë në dorë, deri ditën e lirisë së Kosovës. Le të përfundojmë këtë përshkrim heroik me fjalët e Ismail Kadaresë: " Shkreptima e kullës së Jasharëve zgjoi nga gjumi Evropën dhe botën". U kthyem në makinën tonë me kokën ulur.

Ata burra, që nuk kishin lëshuar lotë nën torturat ç'njerëzore, në qelitë e Sigurimit të Shtetit, i shikojmë tani me lot në sy.

IV. 16. Në Gjakovën e Astrit Haraçisë

Në drekë bujtëm në Gjakovën heroike. "Bukë e kripë e zemër", nga mikpritësi, ish ministri i Kulturës z. Astrit Haraçia. Qyteti ka rreth 90 mijë banorë dhe shtrihet në brigjet e lumit Erenik, rrëzë Malësisë së Gjakovës. Në mesjetë, është njohur me emrin Jakova. Mirëseardhjen na e uroi doktor Themi Vula, i cili më pas ja dha fjalën një veprimtari të shquar të Gjakovës dhe Kosovës, z. Astrit Haraçia. Sa shumë punë, para, sakrifica dhe mundime ka bërë ky djalë për Kosovën e tij dhe sot ndodhet në arrest shtëpie se, gjoja ka kërcënuar dëshmitarët që shkonin për të dëshmuar në gjyqin e Hagës!

Astriti e fillojë fjalën e tij, duke ju drejtuar të burgosurve politikë: "Pasi ju keni qëndruar dhe keni kryer burgun e zi komunist të Enver Hoxhës dhe unë do të qëndroj në arrest, do të fitoj. Jam i lumtur që kam një mik, atdhetarin, z. Bujar Leskaj, i cili në detyrën e Ministrit të Kulturës ka bërë për lidhjen Kosovë- Shqipëri më shumë se çdo të bënte çdo njeri tjetër. Dhe jo vetëm në detyrën shtetërore, por edhe si qytetar ka fol shumë për Kosovën tonë dhe për Presidentin tonë të nderuar dhe të paharruar, Ibrahim Rugova. Vlonjatët nuk kanë dy fjalë. E kanë JO-në JO dhe PO-në PO. Ne, këtu dhe ju në Shqipëri, kemi bërë shumë për dënimin e krimeve të komunizmit, por, sot, fatkeqësisht ka njerëz në Kosovë që festojnë ditëlindjen e Enver Hoxhës. Por, ju duhet të dini se kjo nuk është Kosova".

Të pranishmit kërkuan të dinin se si u lidh z. Astrit Haraçia me të pavdekshmin, Ibrahim Rugova dhe ai tha: "Gjithçka që unë kam arritur, ja dedikoj Lëvizjes Demokratike të Kosovës dhe, veçanërisht të paharruarit Ibrahim Rugova, me të cilin jam takuar për herë të parë në 1995 dhe nga ai çast nuk u ndamë më. Në takimin e parë më është dukur sikur takoja vetë Zotin. Pata besim tek ky njeri i madh dhe ju përkushtova atij për lirinë e Kosovës. E gjithë pasuria ime shkoi për luftën. Jam krenar që i kam shërbyer dhe kam punuar me të madhin Ibrahim Rugova. Kosova fitoi lirinë, falë inteligjencës,

diplomacisë, luftës dhe përkushtimit total të Ibrahim Rugovës, si asnjë njeri tjetër. Unë do të vazhdoj udhën që më mësoi Rugova. Një herë ju ankova Rugovës. Po merrnin pushtetin njerëz të pa aftë dhe pa merita dhe ai m'u përjigje: Lëre, se s'dinë ta mbajnë, do ta dorëzojnë vetë. Një herë tjetër ju ankova Rugovës se, shumë po na fyejnë në shtyp dhe ai m'u përgjigj: Djalë, merru me politikë dhe leri të tjerët të flasin ç'të duan! E pyeta se kur do të bashkohet Kosova me Shqipërinë dhe ai mu përgjigj:

-Shqipëria do të bashkohet me Kosovën në Evropë.

I tillë ishte Ibrahim Rugova i bindur që, ç'do problem mes shqiptarëve të zgjidhej në rrugë paqësore. Ishte njeri i paqes, sepse ishte njeri i madh që tërë jetën e tij ja kushtoi vendit dhe, jo pa sukses, prej tij lindi Kosova e lirë dhe e pavarur, prej tij Kosova këputi zinxhirët e robërisë serbe".

Doktor, Themi Vula, me gjallërinë, me elokuencën, me oratorinë por, mbi të gjitha, dashurinë e madhe për vendin e tij, na njohu me Gjakovën. Tek e dëgjoja të fliste, nuk mund të mos admiroja historinë heroike të Gjakovës sonë. Heroike, jo vetëm në të kaluarën, por edhe në të tashmen. Gjakova i kish dhënë Kosovës 1800 luftëtarë trima, që të luftonin për lirinë e vendit të tyre. Në raport me popullsinë, ndofta asnjë qytet tjetër nuk i dha lirisë së Kosovës, kaq luftëtarë. Doktor Vula na shoqëroi pothuajse në të gjitha monumentet e kulturës së Gjakovës. Së pari, u ndalëm përpara madhështisë së Xhamisë së Hadumit, ndërtuar në shekullin e XVI, e cila ka pasur një bibliotekë të ngritur në 1671, që u dogj prej forcave serbe më 1999 dhe xhamia u rinua në tërësi në vitin 2000. Puna ndërtuese dhe restauruese që po bëhej në këtë xhami, monument kulture, tregonte fare qartë gjallërinë e popullit tonë, triumfin e tij mbi barbarinë serbe. Çarshia e Vjetër e Gjakovës, pazari i vjetër që është ndërtuar pas ngritjes së Xhamisë së Hadumit. Kompleksi urban arkitektonik i Çarshisë së Vjetër në Gjakovë, mund të cilësohet një nga vlerat më të mëdha, mund të quhet muze në qiellin e hapur. Mjeshtri popullor, ka nxjerrë një fenomen unik të agloromeracionit historik urban në territorin e Kosovës dhe më gjerë. Edhe Çarshia e Vjetër e Gjakovës u dogj dhe u rrënua prej barbarëve serbë, më 1999.

Më tej u ndalëm në teqenë e bektashinjve, e rrënuar në vitin 1999 prej forcave policore serbe. Po kështu, ishte rrënuar edhe monumenti i Lidhjes së Prizrenit. Por, të dy këto monumente, u ngritën përsëri me vullnetin dhe paratë e gjakovarëve dhe interesin e përkushtimin e shumë intelektualëve, ndër të cilët shquan z. Astrit Haraçia, i cili, në përurimin e teqesë, në korrik 2007, ishte shprehur : " Më lejoni ..... të përsëris edhe njëherë idenë dhe faktin

që, bektashinjtë shqiptarë, me veprën e tyre, kanë qenë dhe mbeten një degë e shëndoshë në trungun tonë kombëtar. Në çdo lëvizje të madhe kombëtare për prosperitet dhe liri, kanë qenë dhe mbeten shpirti atdhetar i bektashinjve, energjia dhe guximi i tyre".

Kur, njëri nga vizitorët shprehu habi dhe admirim për ringritjen e monumenteve të kulturës, pas rrënimit të vitit 1999, doktor Vula ju përgjigj se z.Astrit Haraçia, ish Ministër i Kulturës ka thënë : "Me gjithë baticat dhe zbaticat, populli kosovar, gjatë gjithë historisë së tij dramatike, përherë krijoj, duke lënë pas vetes një trashëgimi të pasur kulturore".

Më pas, ne pamë monumentet e tjera historike, Kodrën e Qaratit, Urën e Terezive, Kishën Katolike, Urën e Shenjtë etj.

IV. 17. Në Prizren, vendi i lidhjes së besës shqiptare

Në udhën e kthimit, deputeti Bujar Leskaj, e ndaloi grupin në Prizren. " Nuk mund të largohemi nga Kosova jonë, tha ai, pa qëndruar dhe admiruar dhe Prizrenin, qyteti ku shqiptarët kanë lidhur besën për liri si në Lidhjen e Parë të Prizrenit më 1878 dhe në Lidhjen e Dytë të Prizrenit më 1943. Qyteti i bukur i Prizrenit, ka 150 mijë banorë dhe shtrihet rrëzë maleve të Sharrit. Ura e Prizrenit, Kalaja me shumë labirinte, e ndërtuar gjatë shekullit XI, i japin atij pamjen e një qyteti të lashtë turistik dhe me pamje të bukura atraktive. Megjithëse ditë pushimi, drejtori i kompleksit muzeal të Lidhjes së Prizrenit u tregua i gatshëm të evokonte historinë e lavdishme të qytetit. Emocionet ishin të shumta kur pamë xhaminë ku, më 10 qershor 1878, ishin mbledhur 300 delegatë shqiptarë për të shpëtuar kombin e tyre nga copëtimet e fqinjëve. Pamë ndërtesën ku ishte ndërtuar e ashtuquajtura, Qeveri e dalë nga Lidhja. Këtë ndërtesë e dogjën dhe rrënuan serbët më 1999. Shtatoret e Ymer Prizrenit dhe Abdyl Frashërit, i kishin tërhequr zvarrë nëpër rrugët e qytetit dhe i kishin flakur tutje. Përballë kompleksit muzeal të Lidhjes së Prizrenit, dukej kalaja madhështore në të cilën kishte vuajtur për tre vjet rresht atdhetari Abdyl Frashëri, i ati i atdhetarit të madh Mit'hat Frashëri. Në vitin 2000, prizrenasit patriotë e ngritën sërish ndërtesën, ashtu siç ua kishin lënë të parët si dhe gjetën dhe vunë në piedestalet e merituara, shtatorret e atdhetarëve Ymer Prizreni dhe Abdyl Frashëri. Po kështu, në shtator të vitit 1943, shqiptarët formuan Lidhjen e Dytë, e cila kishte si qëllim mbrojtjen e trojeve shqiptare prej ripushtimit sllavo komunist. Lidhja u godit rëndë prej sllavo komunistëve dhe prej komunistëve shqiptarë. Anëtarët e Lidhjes u vranë mbas shpine, u burgosën ose u pushkatuan nga serbët. Nëse dikush mundi t'i shpëtojë plumbit dhe litarit të Titos dhe u hodh në Shqipërinë nënë, një fat edhe më i keq e priste nga diktatori Enver Hoxha. Edhe këta vuajtën burgjet, internimet ose ju dorëzuan pabesisht UDB- së serbe, e cila i eliminoi pa mëshir. Ata pak, që mundën të dalin në botën e lirë, e vazhduan luftën për çlirimin e Kosovës.

Po linim Prizrenin dhe po i drejtoheshim kufirit shqiptar, të prekur prej çasteve që përjetuam, duke parë e dëgjuar masakrat serbe mbi popullsinë shqiptare, por dhe të lumtur se, kjo padrejtësi historike, së fundi ishte zgjidhur prej luftës dhe thirrjes së kosovarëve : "Ku je Evropë", por edhe prej bombave që bota e qytetëruar lëshoi mbi atë komb barbar që, për gati një shekull, kishte shtypur dhe shfrytëzuar shqiptarët. Në Kosovë, kudo ndërtohej, ne udhëtuam në rrugë të pa përfunduara, apo në ndërtim. Nga të dy anët e udhës shiheshin vetëm vila, vila, vila, shumë të bukura. Kudo punohej e ndërtohej por, mbi të gjitha, ne lexuam kudo, në sytë e vëllezërve tanë, shpresën për të ardhmen. Kështu e gjetëm dhe kështu e lamë Kosovën, një kantier ndërtimi plotë shpresë dhe gjallëri, duke nxituar drejt Evropës.

IV. 18. Aorta e kombit, Rruga Durrës-Kukës-Morinë-Prishtinë

Sapo kaluam kufirin në Morinë, deputeti Bujar Leskaj, na ftoi të shikonim dhe shijonim madhështinë e rrugës Durrës- Kukës-Morinë, vepra më e madhe e ndërtuar prej Qeverisë së Partisë Demokratike.

Kishim dëgjuar dhe lexuar shumë për këtë rrugë, por, ajo që përjeton njeriu kur shikon atë vepër madhështore, ato ura dhe gërmime malesh, është krejt ndryshe. Madhështia e kësaj udhe tregon edhe madhështinë e kryeministrit tonë, profesor doktor Sali Berishës. Ajo që pamë në atë anë të kufirit na bindi se, Kosova po ecën përpara me ritmin e kohës, po ecën përpara për të kapur kohën e humbur nën barbarët serbë. Kjo, që pamë në këtë anë të kufirit, na bindi se Shqipëria po ndryshonte me ritme të shpejta për të arritur në Evropë dhe të dy krahët e shqiponjës më këtë anë dhe më atë anë të kufirit, fluturojnë për të arritur dhe për të ecur përkrah kombeve të qytetëruara të botës. Udhë të mbarë Shqipëria jonë, udhë të mbarë Kosova jonë që po na bashkon vërtetësisht udha Durrës-Kukës-Morinë-Prishtinë për të shkuar në Evropë.

Reportazh i botuar në Gazetën 55 nga Enver Memisha dt. 5, 6 Nëntor 2008, në gazetën Telegraf nga Izet Shehu me 29 Tetor 2008, si dhe në gazeta të tjera e televizionet lokale të qytetit të Vlorës.

IV. 19. Memento për Rugovën

Në pritjen e organizuar prej deputetit Leskaj më 28 nëntor 2008, me rastin e Festës së Pavarësisë, ai u dhuroi të pranishmëve librin e studiuesit, historianit dhe kritikut të letërsisë, politikanit bashkëkohor shqiptar, Sabri Hamiti, kushtuar figurës së madhe të Presidentit të Kosovës, Gandit shqiptar, "Memento për Rugovën", botuar nga Shtëpia Botuese "55". Qytetarëve të Vlorës ju dhuruan 100 kopje nga libri. Gjithashtu libri është dhuruar në një kohë të mëvonshme dhe për bibliotekat e shkollave të mesme "Ali Asllani", "Halim Xhelo", si dhe për një grup të rinjsh, anëtarë të Forumit Rinor të Partisë Demokratike.

Monografia e Sabri Hamitit u promovua në Tiranë nga botuesi i gazetës 55 dhe shtëpia botuese 55, z. Fahri Balliu më 3 korrik 2008 në ambientet e Bibliotekës Kombëtare me pjesëmarrjen edhe të autorit.

IV. 20. Kosova-Shtet i pavarur

Vlorë, më 17 Shkurt 2009

Instituti i Studimeve Politike "Ismail Qemali", në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë, nën kujdesin e deputetit Bujar Leskaj dhe kryetarit të bashkisë, Shpëtim Gjika, me rastin e 1 vjetorit të Republikës së Kosovës, organizuan sesionin shkencor: "Kosova Shtet i Pavarur. (Historia, politika, ekonomia)".

Në Kumtesën e tij, "Republika e Kosovës -Burim stabilitetit rajonal dhe krenari kombëtare", deputeti Bujar LESKAJ, midis emocioneve dhe kënaqësisë që të jep kjo ditë historike, theksoi: "dhe ne vlonjatët ndihemi si Prishtinasit, sot, në këtë ditë të veçantë të Kombit tonë". Ai u ndal në në kumtesën e tij në veprimtarinë e Qeverisë së Kosovës dhe marrëdhëniet e ngushta Shqipëri – Kosovë (për më gjerë shih shkrimin: Republika e Kosovës– Burim Stabiliteti Rajonal dhe Krenari Kombëtare. Kreu II f. 280-282).

Në fjalën përshëndetëse Kryetari i Bashkisë, z. Shpëtim Gjika falënderoi deputetin e Vlorës, Bujar Leskaj, për organizmin e kësaj veprimtarie në qytetin historik të Flamurit. "Sot mbushet një vit nga pavarësia e Kosovës. Politika më e mirë ndër të tjerash theksoi, është ajo që na bashkon sot, në këtë rast, se kemi dy qytete të Flamurit, Vlorën dhe Prishtinën.

Referati kryesor u mbajt nga studjuesi, Prof. Uran Butka: "Kosova 100 vjet pushtim, 10 vjet liri, 1 vit pavarësi".

Florian Mima, zv/ministër i Financave, referoi temën, "Zhvillimet ekonomike në Kosovë". Po ashtu, referoi edhe studjuesi e publicisti, Ramiz Lushaj, temën "Kosova drejt pavarësisë, në dy dekadat e fundit". Prof. Asociuar. Bardhosh Gaçe, referoi temën "Pavarësia e Kosovës". Shkrimtarja Vilhelma Vranari Haxhiraj, solli për auditorin temën, "Pavarësia e Kosovës, nisi në Janinë, u shpall në Prizren".

Studjuesi i Vlorës, Fahri Shaska, referoi temën, "Vlora dhe Kosova".

Salla e Pallatit të Kulturës "Labëria", është ndezur nga vargjet e poemës "Poem kosovar", të shkruar nga Mitrush Kuteli, të cilën e recitoi një nga korifejtë e artit shqiptar, aktori Mirush Kabashi.

Deputeti Leskaj, shpërndau 100 libra të autorit Ramiz Lushaj, "Kosova me elementë tërësorë të pavarësisë".

Marrë me shkurtime nga shkrimet në Gazetën 55, RD, Republika, 18 shkurt 2009
Kronike speciale në TV Vlora Channel, TV 6+1 Vlora dhe kronikë në TV Fokus, TV Amantia.

NË VEND TË MBYLLJES

- LIBRI I DASHURISË PËR VLORËN –

Rreth librit të deputetit Bujar Leskaj, "Përfaqësuesit e Vlorës në Kuvendin e Shqipërisë , 1912 – 2009 ",

Tiranë 2 Qershor 2009, nga Enver LEPENICA.

Me veprën "Përfaqësuesit e Vlorës në Kuvendin e Shqipërisë 1912 – 2009", që sapo ka dalë në qarkullim, deputeti i Vlorës Bujar Leskaj, shfaqet si figurë shumë dimensionale. Ka kryer arsimin e mesëm me të gjitha dhjeta. Laureuar për inxhinieri, më pas për drejtësi dhe u thellua në ekonomi, duke fituar edhe të drejtën e ligjërimit në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës.

Me librin e sipërcituar, të cilin e përuroi në Vlorë, ai na shfaqet edhe si historian, me një individualitet dhe cilësi të lart të analizave politike. Një intelektual aktiv në të gjitha fushat e dijes. Veçanërisht aktiv, ai u paraqit në pranverën e përgjakur të vitit 1997 dhe, më pas, për ringritjen e Partisë Demokratike, kur shumë njerëz e braktisën atë.

Në vitin 2005, vlonjatët votuan njeriun që u duhej dhe ai nuk i zhgënjeu qytetarët e tij. Hapat e parë në politikë, i hodhi ndryshe nga të tjerët, ose nga tradita e keqe që buronte nga prapambetja e shoqërisë sonë. Ai, zhvilloi një fushatë të kulturuar, duke ju drejtuar qytetarëve të tij dhe, veçanërisht rinisë, me gjuhën e kulturës europiane, duke shpërndarë ngado libra e duke i bërë thirrje rinisë të hynte në botën e kulturës. Fara e mbjellë prej tij, i dha frytet më 3 korrik 2005 kur ai fitoi ndaj kundërshtarit të tij komunist, me afro 1600 vota më shumë. Këtë sjellje, të këtij politikani të ri, njerëzit e mirëpritën, gazetarët dhanë mendimet e tyre për këtë formë të re të shfaqjes së një njeriu të politikës. Por, ai që e përcaktoi saktësisht profilin e këtij politikani, ishte shkrimtari dhe publicisti, Fahri Balliu, shok ideali i tij, i cili tha se Bujar Leskaj paraqitet si një deputet me vizion europian dhe se deviza e tij është dashuria për Vlorën. I shmangem çdo lloj komenti për këtë sentencë. Pritej, pra, që ky njeri

që propagandonte dhe përhapte librat e të tjerëve, një ditë do të shkruante edhe vetë libra. Dhe, ja, këto ditë ai ka botuar dhe hedhur në qarkullim librin e tij të parë "Përfaqësuesit e Vlorës në Kuvendin e Shqipërisë 1912 – 2009".

Është një libër që ka lindur nga dashuria për Vlorën dhe që u kushtohet Vlorës dhe vlonjatëve. Libri i tij është vazhdim i udhës së nisur nga inxhinieri, juristi, ekonomisti dhe, tani së fundi, historiani Bujar Leskaj. Me veprimtarinë e tij intensive në Parlament, në Qeveri si Ministër i Kulturës dhe jashtë saj, Bujar Leskaj e meritoi titullin e nderuar të deputetit që i dha Vlora. Ai diti të ecë në traditën më të mirë që kishin ecur deputetët e Vlorës në vite, që nga Ismail Qemali. Dhe, s`ka asnjë dyshim se, vlonjatët edhe këtë vit do t`i japin atij vendin e merituar në parlamentin shqiptar. Vepra që analizojmë, është historia e zhvillimeve politike të Vlorës, ku, pa dyshim, pjesa më interesante është jeta dhe veprimtaria e deputetëve të Vlorës, prej vitit 1912 deri në ditët e sotme.

Autori, duke ndjekur ligjet e historisë, qëndrimet objektive ndaj ngjarjeve e personaliteteve, gjykimin e veprimtarisë së deputetëve, sipas kushteve e rrethanave në të cilat ata kanë vepruar e punuar, renditjen e materialit sipas kritereve kronologjike dhe, mbi të gjitha, vështrimin e personaliteteve si produkt të periudhës nga kanë dalë dhe të tokës që i ka lindur e rritur, ka arritur të japë një vepër të mirëfilltë historike. Libri ndahet në tre kapituj: Institucioni i parlamentit në Shqipëri, i klasifikuar sipas periudhave dhe disa zhvillime politike; Përfaqësuesit e Vlorës në Kuvendin e Shqipërisë 1912 – 2009; Jetëshkrimi i përfaqësuesve ligjorë të Vlorës në Kuvendin e Shqipërisë. Kjo ndarje në kapituj dhe nënkapituj, e bën librin tërheqës, të lehtë për t`u lexuar dhe për t'u kuptuar. Me këto gjurmime historike, Z. Leskaj është i pari që i jep kulturës shqiptare historinë politike të Vlorës, qytetit simbol të shqiptarëve, nga e cila dalin shumë mësime, për të gjithë njerëzit dhe për të gjithë vëndin.

Paraqitja e jetëshkrimit dhe veprimtarisë së deputetëve, na lë të kuptojmë se autori ka lexuar shumë literaturë historike dhe politike, ka vëzhguar, ka studiuar dhe ka përshkruar gjithë personazhet politike të Vlorës, duke i ndarë në periudha: Nga 1912 deri 1938, 1939 deri 1944, 1945 deri 1990 dhe 1991 deri 2009. Faqet e jetëshkrimeve të këtij libri na kanë ngjallur shumë personalitete të harruara, të historisë së Vlorës dhe autori ka meritën se, midis nesh solli shumë fytyra të bukura, burra të mëdhenj e figura të shquara të historisë së Vlorës dhe të gjithë Shqipërisë, me të cilët vlonjatët, me të drejtë duhet të krenohen. Jetëshkrimi i një deputeti është një

shkëndijë që ndriçon atë vetë dhe 152 shkëndijat e personazheve të këtij libri, përbëjnë një zjarr të madh që ndriçon udhën e historisë politike të Vlorës, si pjesë e historisë politike të vendit tonë. Për të kuptuar dhe vlerësuar deputetët e Vlorës në vite, na duhet të studjojmë mjedisin vlonjat, produkt i të cilit ata ishin, prandaj dhe përfaqësuesit e Vlorës në Kuvendin e Shqipërisë, autori na i jep si produkt natyral të vëndit dhe kohës të cilën ata e jetuan, pa ndarë personazhin nga ngjarjet historike të kohës.

Politikisht, Vlora ka qenë nga qytetet më të zhvilluara të Shqipërisë dhe prandaj shumë ngjarje të historisë sonë të re fillojnë këtu dhe përfshijnë gradualisht gjithë Shqipërinë. Vlora, sidomos pas vitit 1920, asaj luftës gjigante të dragonjve të Labërisë, që vulosi me gjak pavarësinë e Shqipërisë, pati një përlindje politike dhe kulturore që rrezatonte nga Europa e, veçanërisht, nga Italia. Kjo influencoi dhe ndikoi fuqishëm në jetën e vëndit. Përpjekjet që meritojnë të përmenden janë, Komiteti "Mbrojtja Kombëtare" më 1920; krijimi i partive të para politike më 1921; lindja e Lëvizjes së Qershorit më 1924; Lëvizja Antifashiste 1939 – 1944; dhe sidomos Konferenca e Mukjes 1-2 gusht 1943; në të cilat vlonjatët patën një peshë të rëndësishme. Nga pikëpamja kulturore, Vlora, si gjithë qytetet e tjera të Shqipërisë, ishte e prapambetur dhe prandaj autori, duke analizuar periudhat 1912-2009, na lë të kuptojmë se ka patur një luftë të gjatë mes konservatorizmit dhe rrugës drejt Europës. Le të kujtojmë për këtë, kontradiktat që ekzistonin gjatë viteve 1921-1924, ndërmjet partive të para politike, Lëvizjen e Qershorit më 1924, luftën që Partia Komuniste i bëri Ballit Kombëtar, gjatë viteve 1943 – 1944 e, që, autori i përshkruan me dashuri disa nga figurat e mohuara si, atë të Skënder Muços, Hysni Lepenicës, Isuf Luzaj etj. Përmes mendimeve dhe vlerësimeve që autori ka mbledhur me durim për personazhet që përfaqësuan diktaturën komuniste, del e qartë se Partia Komuniste, Partia e Punës i ndoqi kundërshtarët e saj, i helmoi, i mbyti në ujërat e qelbura të gropave të nevojtoreve, ua mori shpirtin në burgjet e errëta, i pushkatoi dhe i vrau pa gjyq, i vari në sheshet publike, i tërhoqi zvarrë nëpër rrugët e qyteteve dhe i ekspozoi për ditë të tëra për të shtirë tmerrin në popull.

Por, komunizmi, sado që hapi një luftë vëllavrasëse dhe sado që e sundoi vendin me zjarr dhe me hekur, nuk mundi ta spastrojë tokën vlonjate nga nacionalizmi. Në Vlorë, Balli Kombëtar veproi fuqishëm. Edhe pas çlirimit u formuan dhe vepruan njësi antikomuniste si, organizata "Rilindja Kombëtare", e udhëhequr nga Bego Gjonzeneli e Maliq Koshena, që përfunduan nën shpatën e diktatorit, apo Lëvizja

e Rinisë Fshatare, e udhëhequr nga Ëngjëll Kokoshi e Klito Lamaj, Partia Fshatare nën udhëheqjen e Pelivan Azizit etj.

